

ETNOGRAFIA SHQIPTARE




390
E 93

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSSH
INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE
Sektori i Kulturës Materiale
Sektori i Kulturës Shoqërore

ETNOGRAFIA SHQIPTARE

14



Tiranë, 1985

Redaksia:

Spiro Shkurti: redaktor përgjegjës
Abaz Dojaka
Mark Tirta

Adresa e redaksisë:

Instituti i Kulturës Popullore, rruga «Kont Urani», nr. 3

Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
A. Gjergji: } A. Dojaka: } M. Tirta: }	— Ndryshime në mënyrën e jetesës së fshatarësisë së sotme. 5
S. Shkurti:	— Mbjellja e drithërave. 35
D. Statovci:	— Zeja e nallanexhinjve në Kosovë. 59
E. Riza:	— Shtëpia e zjarrit në banesën qytetare shqiptare. 75
A. Muka:	— Ndërtimet me gjysmëkat në fshatrat e Shqipërisë së Mesme. 101
P. Thomo:	— Tiparet urbanistike dhe arkitektonike të fshatit Dardhë—Korçë. 139
A. Onuzi:	— Pëlhurat e mëndafshita e të pambukta të Shqipërisë së Mesme dhe Bregdetare Veriore. 185
I. Bihiku:	— Qëndisjet në veshjet popullore të qytetit. 211
K. Ulqini:	— Veprimtaria kanunore e pleqsore në institucionin e bajrakut. 223
K. Nova:	— Mbi pjesën e pasistemuar të dorëshkrimeve të reja të Gjeçovit për Kanunin e Lekë Dukagjinit. 243
K. Luka:	— Klos, Këlcyrë, Derven, Mbyllç, Mshilt në repertorin onomastik të Arbrit. 271
F. Selhani: Xh. Cani:	— Traditat e peshkimit në rrjetin ujqor të Shkodrës. 325
A. Dhima:	— Ecuria kohore e tipareve antropologjike në Kolonjë. 295

Andromaqi GJERGJI
Abaz DOJAKA
Mark TIRTA

NDRYSHIME NË MËNYRËN E JETESËS SË FSHATARËSISË SË SOTMË

Në Shqipëri, për vetë strukturën ekonomike-shoqërore që trashëguam nga e kaluara, çështjet e fshatit, ku në prag të Çlirimit jetonte rreth 85 përqind e gjithë popullsisë, kanë zënë një vend të rëndësishëm në gjithë politikën dhe veprimtarinë e PPSH e të pushtetit popullor për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Sot në fshat jeton rreth 66% e popullsisë dhe politika e Partisë synon që fshati të mbarrëhet i populluar dhe të mos braktiset. Për këtë janë marrë masa vazhdimisht që, krahas zhvillimit të prodhimit e përsosjes së marrëdhënieve në prodhim, të përmirësohet edhe mënyra e jetesës në fshat. Shoku Enver Hoxha ka thënë: «Epërsia e rendit socialist nuk qëndron aq në faktin se ai i siguron ritme shumë të larta të zhvillimit të forcave prodhuese se sa në faktin që ritmet e larta të zhvillimit të forcave prodhuese shoqërohen njëkohësisht me ngritjen sistematike të mirëqënies, jo vetëm të një klase apo të një pjese të vogël të popullsisë por të gjithë punonjësve, të qytetit e të fshatit»¹.

Transformimet e mëdha ekonomike-shoqërore janë pasqyruar gradualisht edhe në mënyrën e jetesës, me të cilën nënkuptojmë jo vetëm veprimtarinë e njerëzve jashtë sferës së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera shoqërore, por edhe një varg marrëdhëniesh të fuqishme ideologjike e shpirtërore. Mënyra e jetesës është në zhvillim të pandërprerë, në vartësi nga transformimet shoqërore, ekonomike e kulturore dhe nga rritja e merëqënies së përgjithshme. Sidomos transformimet e vrullshme sociale demografike, rritja e qyteteve e

1) Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 23, f. 320.

krijimi i qëndrave të reja të banimit, shtimi i klasës punëtore, zhvillimi i gjithanshëm social-kulturor i fshatit, ndryshimet në strukturën dhe në marrëdhëniet e brëndshme familjare, zhvillimi i madh i arsimit e i kulturës, evolucioni i psikologjisë shoqërore, kanë çuar në ndryshime rrënjësore në mënyrën e jetesës.

Materialet e marrura nga rrethet, po ashtu edhe ekspeditat tonë në terren treguan se, të marrë në global, qoftë në shkallë kombëtare, qoftë në shkallë rrethi, treguesit kryesorë kanë patur rritje e përmirësime të vazhdueshme nga një pesëvjeçar në tjetrin. Por po të shqyrtohen më hollësisht këta tregues rezulton se ka edhe disnivele përbrenda zonave të çdo rrethi. Kjo u vu re në të gjithë rrethet e marrë në studim¹.

I. SHNDËRRIME NË KUSHTET MATERIALE TË TË JETUARIT

Së pari duhet vënë në dukje se në rregullimin dhe përmirësimin e vendbanimeve janë bërë ndryshime themelore. Kështu është përfunduar pothuaj për të gjithë fshatrat, caktimi i vijës kufizuese (e ashtuquajtura «vijë e verdhë»), që disiplinon ndërtimet. Nëse kjo detyrë ishte relativisht e thjeshtë për vendbanimet fushore, për fshatrat malore ajo vështirësohej, sidomos në zonat me fshatra shumë të përhapura, me terren të thyer, me lagje e madje edhe me shtëpi larg njëra tjetrës, si janë disa zona të Shqipërisë së mesme e asaj veriore. Kërkohej grumbullimi i fshatit por kërkohej edhe që fshatari të mos largohej shumë nga tokat e punueshme e të mos i braktiste ato. Si përfundim, në shumë fshatra malore vija kufizuese është caktuar jo në bazë fshati por në bazë lagjesh (sigurisht në lagjet kryesore).

Në vitet '60-'70 u hartuan planet rregulluese të fshatrave, për zonën kodrinore-fushore, një pjesë e mirë e të cilave po vihen në zbatim gradualisht. Në këtë drejtim ka tashmë edhe realizime të shënuara, por mund të diskutohet ende se si duhet të jetë pamja urbanistike e fshatit të ri, duke u nisur nga ajo çka ka treguar përvoja e deritanishme e ndërtimeve. Projektuesit urbanistë jo gjithnjë kanë mundur të materializojnë si duhet orientimet e Partisë e të shokut Enver Hoxha dhe kërkesat e kohës. Më anë tjetër duhet parë sa ka mundur të asimilojë fshati nga risitë e propozuara dhe sa i njuh projektuesi kërkesat e jetës bashkëkohore në fshat. Edhe studjuesit e banesës popullore tradicionale mund të thonë fjalën e tyre për shkallën e ruajtjes së traditës lokale e kombëtare etj. Në viset malore, po aty-këtu dhe në

1) Këto rrethe janë: rrethi i Kukësit (NB Krumë), rrethi i Shkodrës (kooperativa e Barbullushit dhe e Pultit), rrethi i Lezhës (kooperativa e Dajçit dhe e Blinishtit), rrethi i Tiranës (kooperativa e Pezës, e Vaqarrit, e Zall-Bastarit dhe NB Kamëz), rrethi i Elbasanit (kooperativa e Gracënit dhe NB Cërrik), rrethi i Librazhdit (zona e Çermenikës), rrethi i Korçës (NB Maliq e Plasë, kooperativa e Zvarishtit), rrethi i Gjirokastrës (kooperativa e Picarit, ajo e Dervicanit dhe NB Dhoksat), rrethi i Vlorës (kooperativa e Himarës) dhe rrethi i Fierit (kooperativa e Greshicës dhe e «Agimit»). Këtu u përdorën dhe materiale të tjera të mbledhura në disa zona e rrethe të tjera, në terren nga vetë autorët.

vende kodrinore e fushore, në jo pak raste, fshatrat apo lagje të fshatrave, kanë qenë të vendosura, sipas traditës, në vende të papërshtatëshme për kohën e sotme. Ndesh në vendbanime të tilla që shtrihen në shpate apo në mes shkëmbenjve të malit, në vende të veçuara nga rrugët e komunikimit. Që ata janë vendosur në atë mënyrë, ka arsye historike: për t'u mbrojtur nga shtypja feudale a nga pushtuesit, por sot ato janë vende me mundësi zhvillimi vetëm të blegtorisë. Dukurinë e veçimit e kanë diktuar dhe motive të pronës private e shkaqe të tjera që tanimë i takojnë së kaluarës. Në të tilla troje këto lagje ose fshatra nuk kanë mundësi zhvillimi. Aty mungon uji, burimet ekonomike, rrugët e lidhjes me fshatrat, qytetet e krahinat fqinje. Pra duhet menduar më me guxim zhvendosja e të tilla vendbanimeve. Hartimi i planeve rregulluese të fshatrave duhet të mbajë më mirë parasysh lidhjet me prodhimin, me rrugët, me qendrat kulturore, me mundësinë e një zhvillimi perspektiv më normal, duke pasur parasysh se të tilla kushte mundësojnë zhvillimin e jetës kulturore në fshat. Në jo pak raste urbanistika e rrethit, gjen rrugët më të lehta e pa kokëçarje në vendosjen e vijës së verdhë të fshatrave, ndonjëherë e ndikuar nga kërkesa të fshatarëve, bile duke u shtyrë dhe nga motive të ruajtjes në një mënyrë a në një tjetër, të pronës personale.

Realizimi i planit rregullues dhe respektimi i vijës kufizuese hasin pengesa të ndryshme. Në to ndikojnë edhe faktorë të karakterit psikologjik. Kështu, pothuaj kudo në rrethet ku janë bërë anketimet, fshatarët duan që shtëpitë e reja t'i ndërtojnë pranë vëllezërve ose kushërinjve të tyre. Këtë qëndrim e motivojnë duke thënë se «në jetë ke nevojën e të afërmve», e «askush nuk të gjindet si i yti» etj., dhe «nuk duam të largohemi nga trojet e të parëve». Për këto arsye kërkojnë që të paktën njëri prej vëllezërve të mbetet atje, «për të mos i lëshuar trojet e të parëve». Këto pretendime janë më të shprehura e më këmbëngulëse kur shtëpia ndodhet jashtë vijës kufizuese. ku faktorëve psikologjikë të mësipërm u shtohen edhe faktorë ekonomikë. Në këto raste, me që ligji nuk i lejon të ngrehin shtëpi të re atje ku janë, ata i bëjnë shtesa e rindertime të pjesëshme shtëpisë së vjetër.

Furnizimi i fshatrave me ujë të pijshëm është një problem, të cilit i është kushtuar vëmendje, sidomos nga viti 1963 e këtej, duke e vlerësuar si një nga kushtet themelore për përmirësimin e jetesës. Vitet e para ujësjellësat u ndërtuan me përparësi në zonat që vuanin më shumë për mungesë uji, por krahas tyre u bënë përpjekje për shfrytëzim më të mirë të ujrave ekzistuese, kudo në fshatra. Gjatë viteve të pushtetit popullor në fshat janë ndërtuar 1390 ujësjellësa që furnizojnë 1527 fshatra, pra 57,8% të fshatrave të Republikës e deri në fund të këtij pesëvjeçari ato do të përfaqësojnë 60% të fshatrave. Në këto fshatra uji shpërndahet me kanale e tubacione të rregullta në 10-15 pika të ndryshme, për të lehtësuar furnizimin e banorëve. Kemi tashmë edhe një numër të mirë fshatrash ku uji shpërndahet në çdo shtëpi.

Megjithë vështirësitë objektive që paraqet zgjidhja e këtij problemi, duhet thënë se ka jo pak fshatra që disponojnë ujra të mjaftu-

eshme në territoret e tyre, p.sh., shumë fshatra në Mirditë, në Çermënikë, në Shpatin e Sipërm etj. Por interesimi i këshillave popullore për t'i sistemuar ato, me mjete të thjeshta e për t'i afruar deri në oborret e shtëpive, nuk ka qenë në shkallën e duhur. Në psikologjinë e banorëve të disa fshatrave, nuk ekziston ende kërkesa e domosdoshmërisë për të pasur ujë në oborr të shtëpisë ose brenda saj. Pajtohen deri diku me ato forma të traditës ku uji për nevojat familjare bartej nga burime larg shtëpisë. Një mendësi e tillë u kundërvihet kërkesave të kohës për higjenë e komoditet në jetën familjare.

Përsa i përket rrjetit rrugor automobilistik po të krahasojmë gjëndjen e vitit 1980 me atë të vitit 1960 del se gjatë kësaj kohe rrugët e asfaltuara janë pesëfishuar. Në vitin 1982 ato lidhnin me rrugët kombëtare pjesën më të madhe të qendrave të kooperativave të zmadhuara ose të KTL. Paraqiten më mirë rrethet kodrinore-fushore dhe zonat e industrializuara. Por një numër fshatrash ende ka komunikacion të parregullt e stinor, me rrugë të paasfaltuara madje dhe pa kalldrëme.

Për disa fshatra malore, largësia, midis banesave dhe frontit të punës në arat e mbjella, është një problem që i vështirëson kushtet e punës, sidomos për gratë. Zhvillimi i rrjetit rrugor sekondar, përbrenda territoreve të kooperativës sikurse e kanë tashmë edhe shumë kooperativa të zonës kodrinore do t'i lejonte që transporti i forcave të punës në parcelat e largëta të bëhej me mjetet e kooperativës.

Ka raste kur rrjetit rrugor përbrenda fshatit nuk i vihet kujdes sa duhet. Në fshatrat fushore atë e dëmtojnë shumë edhe mjetet e SMT-ve, të cilat ende nuk kanë kudo qarkullim të disiplinuar siç është parashikuar në planin rregullues. Disa tradita të mira që ekzistojnë në të kaluarën për mirëmbajtjen e rrugëve të fshatit janë zbehur dhe ka fshatarë që kujdesen vetëm për shtëpitë e tyre, nga dera e oborrit e brenda, dhe jo aq për ambientet e përbashkëta.

Tregtia është bërë në një masë të mirë, ashtu si e kërkon Partia, një hallkë e rëndësishme, që nxit kërkesa të reja të fshatarësisë dhe jep impulse të fuqishme për përhapjen e së resë në mënyrën e jetesës në fshat.

Përmirësimet nga një dhjetvjeçar në tjetrin, për shtrirjen e rrjetit të njësive tregtare në fshat, kanë qenë të dukshme. Ndërsa në vitin 1950 kishim 1486 njësi tregtare në fshat, më 1982 kishim 3585 njësi. Por po ta ndjekim këtë shpërndarje më hollësisht brenda çdo rrethi konstatojmë se ka edhe shpërpjesëtime si p.sh. në Pult, në Gracen etj. Ka pra vend për përmirësime të mëtejshme në shtrirjen e rrjetit tregtar, aq më tepër kur kemi të bëjmë me zona të vështira malore si këto që përmendëm. Kjo do t'u kursente fshatarëve kohën që harxhojnë dhe mundimin që bëjnë për të shkuar në qytet.

Tregtia është më e gjallë përgjithësisht në ato fshatra që kanë të ardhura më të mira por që kanë edhe kërkesa më të larta për një jetesë të kulturuar. Megjithëse njësitë tregtare në fshat janë të furnizuara pothuaj me të njëjtat artikuj si në qytet, ka ende njerëz që preferojnë të shkojnë të blejnë në qytet. Kjo ngjet për dy arsye: e para

me shpresë se në qytet do të gjejnë diçka më të mirë dhe e dyta, duke menduar se atje nuk i merr vesh njeri nga fshati se ç'kanë blerë, sidomos kur blejnë sende për pajë.

Ka fshatra ku personat që disponojnë dhe harxhojnë pare për të blerë artikuj të ndryshëm nuk janë vetëm kryefamiljarët por të gjithë pjesëtarët e rritur të familjes, të cilët punojnë dhe kontribuojnë në buxhetin familjar, që rrjedhimisht disponojnë një sasi të hollash që mund t'i harxhojnë pas shijes të tyre. Në këto raste shijet dhe kërkesat manifestohen më lirisht, sidomos nga të rinjtë e të rejat. Kur të rinjtë hyjnë rregullisht në njësitë e ndryshme tregtare, qoftë edhe thjesht për të parë artikujt e rinj, këtë qëndrim mund ta konsiderojnë si shenjë të zgjerimit të interesave të tyre njohëse, të formimit të shijeve të kohës, të kënaqësive së kontaktit me të renë, si fillimin e një dialogu që i tërheq për të shtuar njohuritë teknike, për të përmirësuar shijet estetike etj. Në këtë, rol të madh edukues luan edhe hapësira e dyqaneve, ekspozimi i mirë i artikujve etj., faktorë këta që ndikojnë në psikologjinë e fshatarit të sotëm.

Jo të gjithë shitësit i kanë parasysh këto probleme në punën e tyre të përditshme. Po ashtu jo të gjithë prindërit u lëshojnë para në dorë fëmijëve të tyre të rritur, e sidomos vajzave dhe preferojnë të shkojnë të blejnë çdo gjë vetë, sipas shijes së tyre. Shitësi që punon me ndërgjegje ka mundësi të kuptojë shumë mirë shijet, dëshirat dhe mentalitetin që diktojnë kërkesat që paraqet fshatari, dhe të përpiket të ndikojë drejt mbi to, me pjekuri ideologjike.

Çdo bashkësi shoqërore ka nevojë edhe për shërbime komunale të ndryshme në territorin ku banon. Në organizimin tradicional të jetës në fshat disa nga këto shërbime kryheshin me kontributin e për-bashkët, si p.sh., mirëmbajtja e rrugëve dhe e urave, çelja e hendeqeve, punimi i kalldrëmeve, rregullimi i çezmave etj. Sot fshati është organizuar mbi të tjera baza, shumë më të përparuara por ndonjë aspekti nuk i është kushtuar kujdes sa duhet.

Duke u nisur nga porosia e Partisë që fshatarit t'ia kursejmë sa të jetë e mundur më shumë kohën, që të mos jetë i detyruar të shkojë në qytet edhe për shërbime të vogla, janë çelur në fshat njësi të ndryshme shërbimi e në radhë të parë rrobaqepësi, këpucari, rrojtore e riparim biçikletash etj. ku punojnë përgjithësisht artizanë vendës. Këto njësi kanë ardhur duke u zgjeruar nga viti në vit dhe kanë arritur të kryejnë shumë lloje shërbimesh.

Ndërtimet social-kulturore, janë tashmë të shumta në fshat. Vetëm shtëpi e vatra kulture janë mbi dy mijë. Ato janë objekte me interes kolektiv dhe Partia i konsideron të domosdoshme. Midis tyre ka ndërtime të mira e me perspektivë, si shkolla, shtëpi kulture, muze, klube e menca që shohim në shumë fshatra. Por ka edhe raste kur këto ndërtime brenda pak vitesh, nuk arrijnë më t'i plotësojnë nevojat e fshatit në zhvillim, ose ndërtohen si njësi të shkëputura, në vend që të projektohen në ansamble më të studjuara, që qëndra e fshatit të marrë një pamje më të organizuar e më tërheqëse. Shtëpia e kulturës mund t'i tërheqë njerzit e të ndikojë për mirë në formimin psikik e ideo-emocional të tyre kur ka ambiente të kulturuar,

organizim të mirë e veprimtari të rregullta kulturore, që ngjallin interes dhe njëkohësisht edukojnë.

Janë ndërtuar tashmë një numër i konsiderueshëm shkollash të mira me projekte tip, të plotësuara me ankesat e nevojshme, me oborre të rrethuara e të sistemuara, që përfshijnë brenda tyre edhe terrrene sportive, sidomos në fshatrat që janë qendra të kooperativave të zmadhuara. P.sh. një shkollë shumë e mirë është ndërtuar në fshatin Shelcan të Shpatit (Elbasan), po ashtu mund të themi për shkollën e fshatit Vashtëmi (Korçë), për atë të Pezës së madhe (Tiranë) e shumë e shumë të tjera.

Klubet dhe mensat në shumë raste janë gjithashtu ndërtime të bukura, me salla të ajrisura e plot dritë, me taraca të shfrytëzueshme gjatë stinës së ngrohtë, si bie fjala klubi i Sinjës (Berat), klubi i Borshit (Sarandë), apo mensa e Kurjanit (Fier) e shumë të tjera, por ka edhe raste kur ato janë në ca ndërtime të papërshtatshme e kështu nuk mund të kryejnë si duhet funksionin e tyre.

Përsa u përket banesave, fshatare mund të thuhet se në shumë rrethe ato janë përmirësuar rrënjësisht në krahasim me të kaluarën. Fondi i banesave përgjithësisht është ripërtërirë, sidomos nga vitet '60 e këtej. Në disa fshatra fondi i banesave të ndërtuara të reja arrin deri në 90%, në të tjera rreth 70%. Në përgjithësi ato pasqyrojnë nevojat dhe shijet e reja të fshatarësisë sonë si edhe një nivel të ri kulturor; njëkohësisht në to kanë gjetur shumë herë pasqyrim edhe traditat e trashëguara në fushën e ndërtimit të banesave.

Në zonat kodrinore-fushore, shumica e banesave të reja janë ndërtuar sipas disa projekteve tip, të hartuara nga zyrat e urbanistikës në rrethe. Pjesën tjetër e bëjnë banesat e tipeve tradicionale. të cilat kanë bërë përmirësime në shumë drejtime.

Ka zona ku popullsia është më e lidhur me tipet tradicionale të banesës, madje synon të bëjë një ndërtesë më të madhe e më të bukur, nganjëherë edhe përtej mundësive ekonomike të saj, vetëm që të bjerë në sy e të tërheqë vëmëndjen. Këtu ndërhyjnë natyrisht edhe faktorë psikologjikë, si psh., sedra e krenaria e tepruar, ndjenja e të dukurit mbi të tjerët etj. Ndërtojnë kështu shtëpi dykatëshe me përmasa të mëdha, që shërbejnë kryesisht për pritjen e miqve, ndërsa familja vazhdon të jetojë në disa raste edhe në shtëpinë e vjetër. Në këto raste ka me të vërtetë përmirësime të ndjeshme në dhomat e miqve, por jo aq në kushtet e jetës së përditshme të familjarëve.

Një mentalitet i tillë është pasqyruar hera-herës edhe në banesat e ndërtuara me projekte të reja, ku gjithashtu kujdesi më i madh vazhdon të tregohet për dhomën e miqve. Kjo është e lidhur pa dyshim me traditat mikpritëse të popullit shqiptar, por mund të bëhet edhe pa lënë mbasdore mjediset e tjera e në rradhë të parë dhomën ku rri e tërë familja (dhomën e zjarrit). Fshatri ynë kooperativist po e kupton sa vjen më shumë se kujdesi për dhomën e ndenjies, (shtëpinë e zjarrit) s'ka pse të jetë më i pakët se ai për dhomën e miqve.

Për kulturën e jetesës rëndësi të madhe ka shfrytëzimi i mirë e racional i hapësirës së banueshme që disponon çdo familje, duke filluar që nga oborri, verandat e ballkonet, dhomat e korridoret etj

Në përgjithësi numri i ambienteve, në raport me numrin e pjesëtarëve të familjes është rritur, në krahasim me të kaluarën dhe ka prirje të barazohet. P.sh., në kooperativën e Lumalazit (Korçë) që në vitin 1979 mesatarja e ambienteve që dispononte familja i afrohej mesatares së pjesëtarëve të saj, kështu çdo familjeje me 5,2 vetë i takonin mesatarisht 4,5 kthina. Afërsisht kjo është gjendja në zonat fushore jo vetëm të rrethit të Korçës, por edhe të Fierit, Vlorës, Beratit e Gjirokastrës. Por ka zona ku këta tregues nuk janë ende të kënaqshëm. p.sh., disa fshatra në malësinë e Tiranës.

Shtëpitë e ndërtuara me projekte, përgjithësisht, kanë mjedise të organizuara mirë, janë të pajisura me mobilje e orendi të reja, me shtresa e mbulesa të përshtatshme dhe kështu jetesa në to është më komode. P.sh., në nëntë fshatrat e zonës së Devollit, më 1981, 65% e banesave kishin dhoma pritjeje të pajisura me divanë, kolltukë, perde të mira, qilima, kurse 70% kishin pajisje të plota me mobiljet përkatëse për dhomat e gjumit. Por ka zona ku pajisjet e dhomës së zjarrit janë ende jo të plota dhe as pajisjet e fjetjes nuk janë përmirësuar sa duhet. Kjo nuk varet gjithnjë vetëm nga vështirësitë e përkohshme ekonomike që mund të ketë familja, por edhe nga një mentalitet frenues që nuk e përkrah sa duhet të renë dhe nuk bën përpjekje për ta vënë në jetë.

Le të shohim në tabelën e mëposhtme sa janë përhapur disa nga pajisjet e rëndësishme shtëpiake, stufat për ngrohje, radiot e televizorët.

Tabela 1

Tab. 1	Fshati—Rrethi						
	Pajisjet	Krumë (Kukës)	Barbullush (Shkodër)	Dajç (Lezhë)	Blinisht (Lezhë)	Greshicë (Fier)	Zvarisht (Korçë)
Stufa	95 %	75%	43%	12%	90%	100%	106%
Radio	95.6%	47%	82%	35%	93%	100%	100%
Televizorë	4.7%	33%	33%	12.4%	35%	31%	44%

Në pesëvjeçarin e shtatë, shtrirje të gjërë në fshat kanë marrë stufat ekonomike për ngrohje e gatim, të cilat po zëvendësojnë me shumë sukses zjarrin e hapur në vatër. Në tabelën e mësipërme ato janë llogaritur një për shtëpi, por në disa zona ka familje që kanë edhe nga dy (kështu në Devoll, në Fushë të Korçës etj.). Por nuk është kudo kështu. P.sh., ndërsa në Himarë e Vuno ngrohen përgjithësisht me stufa, në Pilur (fshat i së njëjtës kooperativë) vazhdon ngrohja me zjarr në vatër, ashtu si edhe në shumë fshatra të rrethit të Tepelenës ose në kooperativën e Blinishtit (Lezhë), ku Troshani, Fishta e Krajni përdorin kryesisht zjarrin në vatër. Sigurisht atje ku përdoren gjërësisht stufat për ngrohje e gatim kemi përmirësime të dukshme edhe në higjienën e banesës e të ushqimit.

Në një pjesë të madhe të fshatrave të vendit, rreth 90%¹ të familjeve janë të pajisura me radio dhe rreth 25% me televizorë, por, si kurse shihet në tabelë, ka luhatje midis rretheve. Me ritme të kënaqshme po përhapen edhe pajisje të tjera elektroshtëpiake, si furnela elektrike, hekur rrobesh, frigoriferë etj.

Të gjitha këto u bënë të mundshme mbas elektrifikimit të plotë të fshatrave, që shënoi një kthesë të madhe në transformimin socialist të fshatit shqiptar. Fshatarët i blejnë me dëshirë pajisjet elektroshtëpiake dhe i përdorin intensivisht, sidomos radiot e televizorët. Ndikimi i këtyre pajisjeve moderne në psikologjinë e mentalitetin e fshatarëve ka qënë i gjërë e i shumëanshëm.

Higjena e banesës fshatare në përgjithësi ka bërë kudo përmirësim të mëdha, në sajë të punës këmbëngulëse të organeve të Partisë e të Shtetit, megjithatë vihen re edhe mangësi. Kështu nuk janë në lartësinë e duhur kudo kërkesat për ambientet hidrosanitare, veçanërisht në disa zona. Me pak kujdes dhe iniciativë nga të rinjtë, ky problem mund të zgjidhej fare mirë në çdo familje fshatare.

Një tregues i rëndësishëm për shkallën e kulturës e të qytetërimin të një populli është higjena vetiake. Ajo zbukuron jetën, ruan shëndetin dhe e çlodh njeriun pas pune. Gjatë viteve të pushtetit popullor është bërë një punë kolosale sidomos në zonat që kishin prapambetje të theksuar, por edhe sot niveli nuk është kudo i njëjtë, ka zona që kanë bërë kapërcime të mëdha në krahasim me të kaluarën (si p.sh. Lini e fshatrat e Prespës etj.), ka të tjera që kanë ecur ngadal.

Sikurse e tregojnë edhe përgjigjet e anketave që kemi bërë, sot fshatarët në përgjithësi lahen e ndërrohen rregullisht e janë të pajisur mirë me ndërresat e nevojshme. Natyrisht ekzistojnë edhe shkallëzime të shumta sipas grup-moshave, stinëve të vitit, llojeve të punës etj., p.sh., të rinjtë lahen më shpesh se pleqtë, fëmijët edhe më shpesh; gjatë fushatave bujqësore gjithashtu lahen më shpesh etj.

Fshatrët parapëlqejnë të lahen në shtëpi. Kjo psikologji aty këtu ku jeta ka ecur më përpara, ka filluar të thyhet por, në një pjesë të madhe të vendit, është e gjallë e vepruese. Sot për sot vende të përshtatshme e të sistemuara si duhet për të bërë banjë kanë tashmë një pjesë e mirë e familjeve në fshat. Madje në disa fshatra vitet e fundit kanë filluar të përdorin duset me vajguri.

Në veshjen e sotme të fshatrësisë kudo mbizotërojnë artikujt industrialë (ndërresa trikotazhi ose puclinash të pambukta, fustane, këmbishë basme e fanellate, triko pambuku, pantallona doku e kadifeje etj.) dhe përqindja e artikujve të prodhuar vetë është fare e vogël. Gjithashtu është rralluar përdorimi i kostumeve popullore, që mbahen tashmë në pak zona e vetëm në disa grupmosha të caktuara. Veshja e përditshme për punë është bërë më e lehtë dhe praktike, mbahet pastër më mirë etj. Në pjesën më të madhe të vendit kostumi për të dalë e për festa që përdorin fshatarët sot, ka prirje që t'i afrohet gjithnjë e më shumë veshjes së punonjësve të qytetit, si për burrat e për gratë. Vihet re se, në përgjithësi më mirë vishen burrat e rinj se ata të moshave të tjera; po kështu edhe për gratë. Por ka raste kur, normat e sjelljes dhe opinionin shoqëror lokal kërkojnë që nuset e reja,

II. NDRYSHIME NË STRUKTURËN DHE ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FAMILJES

Pas Çlirimit struktura e familjes është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme. Prirja kryesore e zhvillimit të familjes ka qenë thjeshtimi i saj duke prekur të gjitha anët kryesore.

Ndarja e familjeve me disa kurorë në familje të thjeshta ka qenë faktori kryesor në uljen e madhësisë numerike të familjes fshatare, krahas uljes së përgjithshme të lindshmërisë. Nga 6,4 i numrit mesatar të vetëve, që ishte në fshat në vitin 1969, në vitin 1979 u ul në 6.2 vetë. Në disa rrethe si në Gjirokastër, Korçë, Vlorë dhe Fier, mesatarja për familje është më e ulët se ajo e Republikës (respektivisht 4,8; 5,3; 5,6 dhe 6). Por ka dhe rrethe me mesatare më të lartë si Kukësi (7,1), Librazhdi (6,9), Elbasani (6,8), Lezha (6,6). Në këto rrethe gjenden edhe familjet më të shumta me dy e më shumë kurorë dhe me tre breza e lart.

Sidoqoftë, bllokun kryesor të familjeve të sotme fshatare e përbëjnë familjet e thjeshta me një kurorë e dy breza, që si Republikë zënë rreth 64% të numrit të përgjithshëm të familjeve që banojnë në fshat. Familje të tilla të thjeshta, që përbëhen nga çifti bashkëshortor me fëmijët e tyre të pamartuar, sa po vinë e po shtohen, prirje kjo mjaft pozitive. Në fshatrat e Fushës e të Devollit (Korçë), në Bregdet (Vlorë), në Myzeqe (Fier), në Lunxhëri e Dropull, (Gjirokastër) në fshatrat e Kolonjës e të Përmetit, por edhe në disa zona të rretheve të Veriut, familje të tilla të thjeshta përbëjnë shumicën. Në familjet e thjeshta edhe mënyra e jetesës rregullohet më mirë. Një çift i vetëm megjithëse është i ngarkuar me punët e administrimit të ekonomisë shtëpiake dhe të mirërritjes e të edukimit të fëmijëve, e ndjen veten jo vetëm më të disponueshëm por edhe më të lirë për ta ndërtuar jetën familjare në pajtim me nivelin e tij kulturor.

Me anë tjetër çifti bashkëshortor, që në përgjithësi është në moshë të re, ka aftësi, sidomos në jetesë, në shije, në tradita e zakone të akumulujë më shpejt përvojën e re shoqërore. Ai është i prirur t'i kapë më shpejt ndryshimet në mënyrën e jetesës, në pamjet materiale e shpirtërore të saj.

Të dhënat dhe anketimet e mbledhura në pikat e studimit, tregojnë se familjet e thjeshta kanë efektivisht një nivel jetese më të ngritur. Organizimi i kohës së lirë në këto familje bëhet më mirë, pjesëmarrja e anëtarëve të saj në veprimtaritë e ndryshme shoqërore, artistiko-kulturore apo sportive është më e gjërë etj. Dhe kjo vjen se tashmë nënat në këto familje janë së paku me arsim 8 vjeçar, por ka mjaft me arsim të mesëm madje dhe të lartë, kështu që ato janë çliruar nga shumë paragjykime të vjetra e zakone të ndryshme të jetës familjare.

Edhe familjet me dy kurorë e tre breza zenë një vend të rëndësishëm (29.20%). Këtu hyn çifti bashkëshortor me fëmijët e tij të pamartuar dhe prindërit e burrit. Në ditët tona rregulli i përgjithshëm në familjet fshatare është që prindërit të jetojnë së bashku me njërin.

nga djemtë e martuar, zakonisht me më të voglin, dhe jo të shkëputur. Kjo tregon se familja fshatare nuk ka përplasje interesash që ta përçajné dhe kujdesi për prindërit e plakur vështrohet si një detyrë e fëmijëve.

Por ka ende familje të pandara me tre dhe katër kurorë, që përbëhen nga prindërit me dy ose tre djem të martuar dhe me fëmijët e tyre. Sikurse e tregon tabela këto familje janë relativisht të pakta dhe në përgjithësi, qëndrojnë të pandara për sa kohë është gjallë babai, prindi i djemve. Këtë e tregon edhe fakti se famljet me dy a më shumë vëllezër të martuar që jetojnë bashkë, janë në numër tepër të kufizuar.

Në tabelën 2 po paraqesim familjet e pandara për disa fshatra të marra në studim:

Tabela 2

Kooperativa Rrethi	Numri i familjeve me një kurorë	Familje me një kurorë	Prindër që jetojnë me			Familje me:		
			1 djalë të martuar	2 djem të martuar	3 djem të martuar	2 vëllezër të martuar	3 vëllezër të martuar	4 vëllezër të martuar
Dajc (Lezhë) Gracen (Elbasan)	567	37	141	42	3	8	2	—
	416	175	149	49	7	27	7	2
Dhoksat (Gjirrokastër)	109	88	16	5	—	—	—	—
	167	130	36	11	—	—	—	—
Burimas (Korcë) NB Maliq (sektori sheqeras Korçë)	496	404	84	5	1	2	—	—

Sipas këtyre të dhënave vëmë re se shumica e familjeve përbëhet nga një kurorë, ndërsa familjet dy kurorëshe përbëhen nga prindërit dhe një djalë i martuar. Por në disa zona si në kooperativën e Dajcit, në kooperativën e Gracënit, (sigurisht edhe në shumë fshatra të tjera të vendit) ka ende familje ku prindërit jetojnë me dy ose tre djem të martuar, ka gjithashtu familje me dy dhe tre vëllezër të martuar. Në shumicën e rasteve këto familje janë me shumë vetë. Kështu në Kukës familjet me 10 vetë e lart zënë 17,90 përqind, në Librazhd 17,92 përqind, në Lezhë 15,66 përqind, në Elbasan 15,47 përqind dhe në Shkodër 12,77 përqind. Por edhe brenda rretheve ka ndryshime. Në përgjithësi familjet me shumë vetë, gjenden më tepër në zonat e thella malore. Në kooperativën e Barbullushit vetëm 3,5 përqind e zënë familjet me mbi 10 vetë, ndërsa në zonën malore të Pulit ato arrijnë në 24.5 përqind.

Në fshat, në sajë të ndryshimeve të mëdha ekonomike e shoqërore, kanë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme edhe marrëdhëniet e brendshme në familje. Janë përmbysur një seri dukurish të marrëdhënieve

patriarkale të së kaluarës në jetën familjare. Mirëkuptimi, marrja e mendimit të njëri-tjetrit, respekti dhe ndjenja e dashurisë së ndër-sjellë, preokupacioni i përbashkët për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve etj., janë dukuri pozitive në marrëdhëniet e familjes së re fshatare.

Megjithatë ka ende shumë familje në krahina e zona të ndryshme ku ruhen koncepte prapanike e norma patriarkale. të cilat, bëhen pengesë serioze në emancipimin e gjithanshëm të familjes fshatare. Këto mbeturina lidhen me administrimin e të ardhurave në familje, me ngarkesën e madhe të gruas në punët e shtëpisë, me ndarjen e punëve të familjes etj.

Rëndësi e dorës së parë për familjen kanë problemet ekonomike brenda saj siç janë administrimi i të ardhurave të përbashkëta, shpenzimet, kursimet etj. Në përgjithësi, në familjet e thjeshta, burri dhe gruaja, duke gjykuar nga të ardhurat që realizojnë, nga numri i fëmijëve që kanë, nga nevojat që u paraqiten etj., blejnë ato sende e objekte që u duhen për lehtësimin e punëve të shtëpisë, për një mirëqënie materiale e kulturore gjithnjë më të lartë. Në shumë fshatra të Korçës, të Gjirokastrës, të Kolonjës, të Përmetit, të Sarandës, të Vlorës, të Fierit, në disa zona të Peshkopisë, po edhe në fshatra të rretheve të tjera vihet re një administrim i mirë e të ardhurave. Megjithatë edhe në këto zona diku i kushtohet kujdes i tepëruar veshmbathjes, diku tjetër bëhen shpenzime jashtë mundësive për pajimin e shtëpisë, për pritje e përcjellje miqsh. Në disa zona të tjera si në Pult, në Barbullush, në Dajç, në Blinisht, në Zall-Bastar, në Vaqar, në Kerrabë, në Çermenikë, në Greshicë, në Zvarisht etj., bëhen edhe shpenzime, sipas zakoneve të vjetra: Kështu me rastin e martesës shpenzimet fillojnë që në fejesë e vazhdojnë pastaj për përgatitjen e pajës dhe për dasmën. Kur të fejuarit punojnë, me kursimet e tyre mund të bëjnë gjërat më të nevojshme për të filluar jetën bashkëshortore. Si rregull do t'i ndihmojnë edhe prindërit. Por nuk është aspak i drejtë «zakoni i ri» që ka hyrë në shumë familje të fshatit për t'i lënë vajzës gjithë pagën e vet për të përgatitur pajën. Ose në shumë zona të Shqipërisë së Veriut, në Çermenikë, në Kerrabë, në Malësi të Tiranës, vazhdon si edhe më parë, që gjithë pajën ta përgatisë dhëndëri. Edhe për dasmën bëhen shpenzime të mëdha, ku si rregull, ftohen për të ngrënë mbi 100 vetë.

Në raste vdekjeje është zakon të shtrohet një drekë apo një darkë. Do të hanë njerëzit e shtëpisë e të afërmit e ngushtë të tyre si dhe ata që kanë ardhur nga larg. Mirpo pse duhen mbajtur për drekë me çdo kusht gjithë farefisi dhe rrethi miqësor? Dhe bëhen aty mbi 100 vetë. Ose bëhen të tretat, të shtatat, të dyzetat, të gjitha me shpenzime. Këto zakone përfaqësojnë një mënyrë të vjetër jetese që i ka kaluar koha.

Vazhdon ende zakoni që në familjet e pandara, por edhe në mjaft familje të thjeshta burri të administrojë të ardhurat.

Ka edhe familje (si në fshatin Agimi, në Greshicë, në Dhoksat, në Dervican, në Rëmbec, në Hoçisht, në Burimas, në Sheqeras, në

Himarë etj.), ku të ardhurat i administrojnë së bashku burri dhe grua dhe në raste të veçanta, edhe vetëm gruaja.

Në familjen fshatare ka përmirësime të dukshme të marrëdhënieve midis burrit e gruas, të cilat karakterizohen nga detyrime dhe të drejta reciprokisht të barabarta. Në mënyrë të veçantë në familjet e thjeshta bashkëshortët komunikojnë e diskutojnë së bashku për shumë probleme, ndihmojnë njëri-tjetrin në punët e shtëpisë, kujdesen për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Dhe këto dukuri nuk vihen re vetëm në disa rrethe po kudo në Shqipëri; madje edhe në ato krahe e rrethina ku zakonet prapanike kanë qënë më të theksuarat. Ka megjithatë zona si në Pult, Dajç, Killojkë, Gracen, Shpat, Çermenikë etj., ku burrat mbajnë qëndrime mospërfillëse ndaj punëve të grave. Në këto zona edhe vetë gratë, duke mos qënë aq të formuara nga pikëpamja kulturore, nuk luftojnë sa duhet për vendosjen e normave të reja në familje. Të gjitha këto kanë lidhje me konceptet prapanike patriarkale se për burrat është «turp» të bëjnë punë në shtëpi. Në këtë drejtim veçanërisht burri, duhet të hedhë poshtë mbeturinat e së kaluarës, të ndryshojë qëndrimin e tij ndaj këtyre problemeve.

Duhet pranuar se, në krahasim me të kaluarën, ku në shumë krahe detyrat shtëpiake të gruas ishin të përqëndruara kryesisht në përgatitjen e ushqimit e të veshmbathjes, në pastrim e larje rrobash, në kujdesin për fëmijët dhe për bagëtitë e shtëpisë etj., tani një pjesë e tyre janë kufizuar. Megjithatë edhe sot detyrat tradicionale të gruas në shtëpi zenë pjesën më të madhe të kohës jashtë punës. Sipas materialeve të terrenit dhe të përgjigjeve të anketave dhënë nga gratë rezulton se, koha në shërbim të familjes është mjaft e madhe. Duke u nisur nga llogaritje të përafërta në përgjithësi, punët e shtëpisë i hanë gruas 6-8 orë në ditë. Në këtë gjendje ndikojnë një varg faktorësh.

Së pari, në pjesën më të madhe të familjeve fshatare vazhdon të ruhet karakteri tradicional i ndarjes së punës, ku burri kryesisht, kryen punët jashtë shtëpisë, punët e rënda, duke e lehtësuar gruan nga kjo barrë, por më anë tjetër ai nuk ndihmon ose ndihmon pak në punët e brendshme të shtëpisë. Kjo vihet re më tepër në familjet e pandara, por edhe në familjet e vogla.

Së dyti, megjithë përparimet që vihen re në shoqërimin e ekonomisë shtëpiake në fshat, ato janë ende të pamjaftueshme.

Me kujdesin e Partisë e të pushtetit popullor deri tani janë marrë një sërë masash të rëndësishme që shkurtojnë kohën e nevojshme për kryerjen e punëve të përditshme të shtëpisë, për rritjen dhe edukimin e fëmijëve etj. Në fshat janë hapur me qindra çerdhe dhe kopshte. Gati çdo fshat apo sektor ka çerdhen dhe kopshtin e fëmijëve. Janë hapur furra buke e menca, banja e lavanderi. Është zgjeruar rrjeti i tregtisë, shërbimet komunale etj., të cilat e lehtësojnë deri diku gruan nga punët e shtëpisë. Megjithatë, ndofta edhe nga mungesa e organizimit dhe e shpërndarjes të shërbimeve komunale, të çerdheve dhe kopshteve, të pikave të shitjes etj., ato u shërbejnë pak nevojave të fshatarëve,



Së treti, ndikim negativ në çështjen e ndarjes së punëve të shtëpisë dhe të ngarkesës me punë të shumta të grave të reja, ushtrojnë edhe disa të moshuar, me një nivel të ulët kulturor, duke i quajtur punët e shtëpisë, punë kryesisht të gruas. Gruaja nikoqire, sipas mendimit të të moshuarve, e gjen kohën për të bërë të gjitha punët dhe për të mbajtur shtëpinë në rregull, pa qenë nevoja e ndihmës të pjesëtarëve të tjerë të familjes, aq më tepër të burrit. Koncepte të tilla ndikojnë negativisht edhe në disa të rinj, të cilëve u vjen zor dhe e quajnë përulje t'u ndihmojnë grave në punët e shtëpisë. Ndërsa nuset e reja, vajzat dhe në pjesën më të madhe edhe të rinjtë, theksojnë nevojën e ndarjes së punëve të shtëpisë midis gjithë anëtarëve të familjes:

Së katërti, burrat në një shumicë rastesh punojnë në fronte që janë shumë më larg shtëpisë se sa puna e gruas, sidomos kur burri punon në mal, në punë shtetërore etj. Kjo bëhet shkak që burri në mënyrë të natyrshme të tërhiqet nga punët e detyrat e ndryshme në mbarështrimin e shtëpisë e të jetës familjare. Të gjitha këto i mbe-
ten mbi kurriz gruas.

Së fundi në familjen e re fshatare, si pasojë e vendosjes së barazisë ligjore të gruas me burrin, gruaja filloi të kryejë edhe funksione cilësisht të reja për të, të marrë pjesë gjallërisht në prodhim shoqëror, si edukatore, si veprimtare shoqërore etj. Këto funksione të gruas brenda familjes, përputhen plotësisht me rolet shoqërore, e formojnë atë si personalitet, ndihmojnë në zbulimin e fuqive krijuese të saj. Rolet e reja nuk e çliruan shumicën e grave nga punët e vjetra tradicionale në shërbim të pjesëtarëve të familjes, si përgatitja e ushqimit, rregullimi i shtëpisë, larja, arnimi etj., punë që i hanë gruas një kohë të madhe. Lind pra konflikti midis roleve të reja dhe atyre të vjetra. Rolet e vjetra, duke u gërshetuar me ato të rejat, krijojnë ngarkesa të tepërta për gratë dhe vështirësojnë shfrytëzimin real të të drejtave të barabarta. Ato nuk kanë kohë të lirë për të bërë një jetë të kulturuar, për t'u marrë me leximin e librave, për të dëgjuar radion, për të parë televizionin etj.

Për shkak të mungesës së kohës së lirë para grave lind shpesh herë alternativa: Ngritje ideo-profesionale apo shtëpi të rregulluar mirë e të mbajtur pastër. Dhe kjo, sipas konstatimeve tona, në shumë raste zgjidhet duke lënë të parën për hir të së dytës. Ekziston pra një kontradiktë e cila kërkon zgjidhje. Rruga e zgjidhjes së saj është organizimi më i mirë i mënyrës së jetesës ku në punët e shtëpisë të marrë pjesë aktive jo vetëm gruaja, po edhe burri, djali e vajza, të martuarit, po dhe beqarët.

Marrëdhënie të drejta janë vendosur ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Tani anëtarët e rritur të familjes marrin pjesë së bashku në diskutimin dhe zgjidhjen e shumë problemeve të familjes. Këto marrëdhënie e kanë forcuar më tepër kohezionin e familjes që bazohet në ndjenja e qëndrime më të lirëshme.

III. NGRITJA ARSIMORE E KULTURORE E FSHATARËSISË

Në ndryshimet thelbësore që kanë ndodhur në mënyrën e jetesës, përveç faktorëve materialë objektivë, rol të madh ka ushtruar edhe ngritja e nivelit arsimor të punonjësve të fshatit që ka ndikuar drejtpërdrejt për një jetë më të kulturuar në familje, për një mënyrë jetese më të mirë. Realizimi i arsimit të përgjithshëm të detyruar 8-vjeçar ka bërë të mundur që brezi i ri të marrë të paktën arsimin 8-vjeçar.

Tani rinia fshatare që mbaron shkollën tetëvjeçare ka dëshirë të vazhdojë edhe më lart. Në vitin 1983 nga 156 248 nxënës të arsimit të mesëm gati 54% ishin nga fshati. Ndërsa në shkollat e larta 37% e numrit të përgjithshëm të studentëve në vitin 1983-84 ishin fshatarë. Ndryshime janë bërë edhe në arsimin e vajzave.

Një nga mjetet kryesore për emancipimin e plotë të femrës për ngritjen e personalitetit dhe të dinjitetit të saj është edhe ngritja e nivelit arsimor. Pothuaj të gjitha vajzat janë përfshirë në arsimin e detyruar 8 vjeçar, pjesa më e madhe e të cilave e mbaron atë. Në vitin shkollor 1983-1984 ato përbënin 47.6% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të fshatit. Në përgjithësi prindërit, tashmë nuk i largojnë vajzat nga shkolla, përkundrazi shumë prej tyre kërkojnë që ato të vazhdojnë më tej. Kjo ka bërë që edhe diferencat e shkolllimit midis vajzave e djemve për moshat e reja të jenë zhdukur.

Vajzat që vazhdojnë shkollat e mesme zënë një vend të konsiderueshëm, 42% të numrit të përgjithshëm të nxënësve nga fshati. Por kjo gjëndje nuk paraqitet në të gjitha rrethet njëjloj. Ka rrethe si Vlora, Lezha, Fieri, Elbasani, Tirana, Gjirokastra që e kanë përqindjen më të lartë se ajo e Republikës. Në anë tjetër ka edhe rrethe si Kukësi dhe Librazhdi që e kanë përqindjen më të ulët, respektivisht 34 dhe 38 përqind.

Por edhe brenda rretheve, ndërmjet zonave të ndryshme ka ndryshime, nganjëherë edhe shqetësuese. Kështu në Gracen e Xibrakë (Elbasan), në Zvarisht (Korçë), në NB Krumë (Kukës), në Dajç e Blinisht (Lezhë), në Qinam (Tiranë), në Himarë dhe mundet edhe në shumë zona të tjera, përqindja e vajzave është më e ulët se ajo e rrethit përkatës.

Ç'del nga kjo?

Së pari, është e vërtetë se tani rrjeti arsimor i shkollave të mesme ka marrë një shtrirje të mirë, madje për të plotësuar më mirë kërkesat e sotme të zhvillimit intensiv të bujqësisë e të blegtorisë, gjatë këtyre tre vjetëve të fundit janë hapur në fshat mjaft shkolla të reja bujqësore. Por shtrirja e tyre nuk është bërë aq e studjuar, sepse mjaft zona, veçanërisht zonat e thella malore, mbeten të zbuluara. Zona e Kërrabës (Elbasan) nuk ka asnjë shkollë të mesme. Po kështu edhe shumë zona të tjera. Hapja e shkollave të mesme është bërë në ndonjë rast jo afër vendbanimeve më të shumta fshatare. Kështu fshatarët e Kirit dëshirojnë që fëmijët e tyre të vazhdojnë shkollën e mesme, por shkolla është shumë larg. Në Polis (Librazhd) dhe në Zverisht (Korçë) ka shkolla të mesme, të cilat i vazhdojnë shumë

nxënës të fshatrave përreth. Shumica e tyre janë djem, sepse vajzat, për shkak të kushteve klimatike dhe të terrenit të thyer, nuk kanë mundësi praktike të shkojnë aq larg. Prandaj del detyrë që të studjohet më mirë shtrirja e rrjetit të arsimit të mesëm në fshat dhe, për nxënësit e zonave të thella, të shihet mundësia e çeljes së konvikteve.

Së dyti, pengesë kryesore në ndjekjen e shkollave për disa vajza, bëhen edhe konceptet prapanike që shfaqin disa prindër, të cilët mendojnë se «vajzave s'ka ç'ju duhet shkolla». Ka zona, si në Gracën, që vajzat me të mbaruar shkollën 8 vjeçare fejohehen dhe në moshën 16-17 vjeç martohen. Në kooperativën «Zaho Koka» të Himarës vajzat që vazhdojnë shkollat e mesme përbëjnë 23%, të numurit të përgjithshëm të nxënësve. Këtu ka zënë rrënjë mendimi i së kaluarës, se djemtë mund të dalin nga fshati, të marrin shkollë e zanat, ndërsa vajzat duhet të përdoren si krahë pune ose të martohen.

Edhe në ndjekjen e shkollave të larta ka shpërpjestime midis djemve e vajzave. Kështu në rrethet e Librazhdit, të Korçës, të Elbasanit dhe të Gjirokastrës përqindja e studentëve është më e ulët se ajo e Republikës.

Në ndjekjen e shkollave të larta nga ana e studentëve fshatarë vihet re se shumica e tyre marrin arsimin e lartë bujqësor. Sigurisht kjo gjendje është deri-diku e justifikueshme sepse u përgjigjet më mirë drejtimeve të sotme e perspektive të ekonomive bujqësore. Por në anën tjetër fshati ka nevojë edhe për mësues, për mjekë, për punonjës të kulturës. Është një kërkesë e ligjshme e shumë fshatarëve të anketuar që, përveç degëve të bujqësisë, shfaqin dëshirën edhe për degë të tjera të arsimit të lartë. Por seksionet e arsimit e të kulturës, në rrethe, kur vjen koha e ndarjes së të drejtave të studimit, nxënësit e fshatit i çojnë vetëm në Institutin e lartë Bujqësor. Kjo vjen për arsye se në përgjithësi, shkollat e mesme në fshat janë të profilit të bujqësisë.

*
* *
*

Shkolla jonë e re, krahas edukimit komunist të brezit të ri, ka shërbyer e shërben si qendër e rëndësishme për futjen e përhapjen e së resë në jetën e fshatit, për një kulturë jetese më të mirë.

Në etapën e tanishme roli i shkollës në fshat për përhapjen e dijeve e të kulturës është rritur. Ajo përgatit brezin e ri për nevojat e sotme e të ardhmen të fshatit, duke qenë kështu në ballë të luftës për përhapjen e së resë në të gjitha fushat, për ndryshimin e mënyrës së të menduarit, për përmirësimin e mënyrës së jetesës.

Në këtë drejtim rol të rëndësishëm luajnë arsimtarët. Ata, duke punuar në skajet më të largëta të Atdheut, përhapin dijen dhe kulturën, japin një ndihmesë të çmuar në përparimin e fshatit. Në përmirësimin e kushteve të të jetuarit në fshatrat e Korçës, të Kolonjës, të Gjirokastrës, të Bregdetit, të Fierit, të Dibrës, etj., për-

veç traditës, ndihmesë të madhe japin edhe mësuesit e fshatit. Duke bashkëpunuar me organizatat e masave, me punonjësit e shëndetësisë etj., ata interesohen për përmirësimin e mënyrës së jetesës, për futjen e së resë në çdo familje.

Por në punën dhe jetën e arsimitarëve vihen re edhe të meta. Ka mësues që nuk e kuptojnë drejt rolin e tyre fisnik si misionarë dhe përçues të kulturës socialiste në fshatin tonë të ri.

Dihet se pjesa më e madhe e mësuesve të fshatit janë nga qyteti dhe një pjesë e mirë e tyre nuk banojnë në fshat. Kjo gjendje pengon dhënien e ndihmës konkrete nga ana e mësuesve për përmirësimin e mënyrës së jetesës. Këndeje lindin edhe disa probleme.

Së pari, është mirë që shumica e kuadrit të nevojshëm të fshatit të jetë vendas. Rrethet dhe zonat që kanë një shpërndarje racionale të kuadrit vendas si rrethi i Korçës, i Gjirokastrës, i Kolonjës, i Përmetit, i Sarandës, i Vlorës, i Fierit etj., dallohen edhe për një mënyrë jetese më të mirë.

Së dyti, arsimitarëve nga qyteti, që nuk janë me banim të përhershëm në fshat, nuk u krijohen kushte të përshtatshme jetese, kështu që ata nuk kanë mundësi për të dhënë shembullin e tyre vetiak për një jetë të kulturuar. Në fshatrat e Librazhdit ka një numër të madh mësuesish, shumica vajza, nga Korça, Tirana, Elbasani. Por ato pak lidhen me familjet fshatare dhe ndikimi i tyre nuk ndihet në drejtim të përmirësimit të mënyrës së jetesës.

Është fakt se specialistët e ndryshëm japin një ndihmë të madhe në zgjidhjen e shumë problemeve ekonomike, kulturore e shëndetësore. Agronomët, zooteknikët, ekonomistët, janë bërë këshilltarë e bashkëbisedues të vazhdueshëm të fshatarëve për zbatimin e metodave shkencore në të gjitha fushat e intensifikimit të bujqësisë. Por ata, të rrëmbyer nga këto punë, pak ndihmojnë në ndryshimin e jetesës, për të futur edhe në jetë të renë, kulturën. Madje ka prej tyre që e shikojnë veten si mysafirë të përkohshëm dhe vështrimi i tyre kthehet vetëm si specialistë të ngushtë në një degë të caktuar. Në këtë mënyrë ata shkaputen nga jeta e fshatit dhe nuk ndihmojnë në përparimin social-kulturor të tij.

Duke vënë në jetë orientimet e Partisë për të zhdukur shpërpjestimet në zhvillimin kulturor, që ekzistonin në të kaluarën, ndërmjet fshatrave dhe zonave të ndryshme, janë arritur një varg suksesesh. Në fshat ka sot 447 shtëpi kulture dhe 1648 vatra kulture të cilat zhvillojnë një veprimtari të dendur kulturore-artistike, e ndikojnë drejtpërdrejt në psikologjinë e fshatarit për mënyrën e jetesës.

Edhe pse ka një rritje të ndjeshme të institucioneve kulturore, po të shohim shpërndarjen e tyre në rrethe e zona brënda rrethit, vihen re ende shpërpjestime. Në rrethet e Elbasanit, të Kukësit të Librazhdit, të Tiranës, më shumë se gjysma e fshatrave nuk kanë shtëpi apo vatra kulture. Në nëntë fshatrat që ka zona e Kërrabës (Elbasan) vetëm tre prej tyre kanë vatra kulture. Një gjendje e përafërt paraqitet edhe në mjaft rrethe të tjerë.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe përgatitjes dhe zgjedh-

jes së kuadrit të kulturës. Nga 591 punonjës të kulturës që kanë patur zonat malore në vitin 1963, vetëm 157 ishin me shkollë të mesme, të tjerët kishin arsimin 7-vjeçar ose fillor. Ndërsa sot në fshat ka 265 kuadro të lartë, 1266 kuadro të mesme dhe 387 me arsim 8-vjeçar.

Megjithë këto suksese ka akoma punonjës të kulturës që nuk kanë arsimin përkatës. Në rrethet e Librazhdit, të Fierit, të Kukësit, të Tiranës, të Elbasanit, të Korçës etj., një pjesë e mirë e kuadrit është me arsimin 8-vjeçar. Nuk ka arsye që një e treta e kuadrove të vatrave të kulturës të fshatrave të Korçës të jenë me shkollë 8 vjeçare. Dhe këta punojnë kryesisht në zonat kodrinore e malore si në kooperativën e Voskopojës, të Brozdovecit, të Melçanit, të Moglicës etj., ndërsa në fshatrat e fushës kuadri është me arsim të mesëm e të lartë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rrethin e Elbasanit e atë të Tiranës.

Përse ndodh kjo, kur dihet që në këto rrethe ka me qindra njerëz me arsim të mesëm, madje edhe të profilizuar? Arsyet duhen kërkuar në konceptet e ngushta që kanë disa drejtues për punën kulturore, në nënvleftësimin e rolit të kulturës në fshat, duke e quajtur atë një punë të lehtë dhe jo një punë militante që i shërben edukimit ideo-politik të masës dhe që ushtron një ndikim të fuqishëm në psikologjinë e fshatarësisë për mënyrën e jetesës.

Në stadin që kemi arritur është e nevojshme që jo vetëm shtëpitë e kulturës por edhe vatrave të kulturës të kenë kuadrin e tyre të profilizuar, me arsim të mesëm ose të lartë, i cili të shërbejë jo me 10 e 15 ditë pune në muaj, po të jetë i përhershëm dhe përgjegjësia të bjerë mbi të ashtu siç i bie punonjësit të kulturës edhe në qendër. Punonjësi i vatrës së kulturës, duke qenë në nivelin mesatar, nuk i njeh sa duhet problemet që shqetësojnë fshatin, e quan punën e kulturës vetëm sa për të mbajtur çelsat e vatrës, të hapë e ta mbyllë atë sa herë që të ketë ndonjë mbledhje etj. Në këtë mënyrë zbehet edhe qëllimi i ngritjes së këtyre institucioneve.

Shtëpitë dhe vatrave të kulturës janë të angazhuara në një veprimtari të gjërë kulturore-artistike, në zbrëthimin e materialeve të Partisë e të veprave të shokut Enver Hoxha, në propagandimin e traditave më të mira të popullit tonë, në punën për një jetë më të kulturuar në familje.

Ka rrethe si Tirana, Lezha, Mirdita, Gjirokastra, Vlora, Korça, etj.; që kanë një veprimtari të gjallë artistike. Në kooperativën «Myslym Peza» (Tiranë), ka 2 shtëpi kulture dhe 11 vatra kulture, me 11 grupe amatore-artistike, në të cilat marrin pjesë 410 amatorë, 200 prej të cilëve vajza e gra: Aty jepen 10-12 shfaqje në vit, në pajtim me kërkesat dhe shijet e kooperativistëve. Veprimtari të pasur zhvillon edhe vatra e kulturës e Pëllurit (Vlorë).

Por ka edhe dukuri negative. Në disa vatra dhe shtëpi kulture të disa rretheve si në zonën e Pultit, në Dajç, në Gracen; në Zall-Bastar; në Greshicë, në Çermenikë, në Zvarisht etj, veprimtaritë kulturore-artistike bëhen me fushata, në raste konkurimesh apo festivalesh. Kjo gjëndje sigurisht ndikon edhe në gjëndjen shpirtërore të fshatarit:

Arritje pozitive ka edhe në pjesëmarrjen e femrave në grupet e ndryshme artistike e amatore të fshatit. Në fshatin Agimi, në Dervican, Dhoksat dhe Picar, në Pilur, në NB «Ylli i Kuq», në Sheqeras etj. janë me qindra vajzat e gratë që aktivizohen në këto grupe.

Por edhe në këtë drejtim ka ndonjë shfaqje negative. Kështu në Pult dhe Burbullush, në Dajç, në Zall-Bastar e Gropaj, në Gracen, në Greshicë, në Himarë, në Zvarisht e Burimas etj., vajzat sa kohë që janë në shkollë 8 vjeçare ose të mesme, lejohen nga ana e prindërve të marrin pjesë në keto veprimtari. Pas martesës vihet re një tërheqje e menjëhershme e tyre, gjoja se nuk kanë kohë, janë të zëna me punët e shtëpisë, me kujdesin për fëmijët.

Revolucioni ideologjik-kulturor i zhvilluar gjatë këtyre 40 vjetëve nën udhëheqjen e Partisë e çliroi fshatarësinë punonjëse nga prangat e besimeve fetare, të ceremonive e riteve që shprehin interesat klasore të regjimeve shfrytëzuese feudo-borgjeze, të klerikëve, të lidhura ngushtë me pronën private dhe që ishin një konfirmim i mendësisë dhe psikologjisë së vjetër patriarkale.

Në procesin e gjatë e të ndërlikuar të shndërrimeve, në luftën kundër së vjetrës reaksionare, kanë lindur festa, ceremoni, zakone e rituale të reja popullore. Disa rite, zakone e festa prodhimi me përmbajtje deri diku pozitive evoluan, duke u spastruar nga ndikime të ideologjisë së klasave shfrytëzuese të së kaluarës, dhe vazhdojnë të praktikohen aty-këtu.

Në ditë të sotme në gji të fshatarësisë vërejmë ceremoni e rite, zakone e festa të formave më të ndryshme. Kanë filluar të hyjnë në jetën e popullit festa të reja si ajo e ditës së formimit të kooperativës bujqësore, ditët e formimit të brigadave partizane, festat me karakter politik e kombëtar si 28-29 Nëntori, 8 Nëntori, 1 Maji etj.

Në disa vise, rituale e ceremoni në lindje, në martesë, në vdekje, në festa popullore kanë hyrë si shartesa krejt të papërshtatshme të së resë me të vjetrën. Ndosht që të pranishmit të puthin me rradhë fytyrën, duart e gjoksin e të vdekurit para se të varroset ose para se të nisët nga shtëpia për varrim; ndosht që shpërndajnë grurë të zier të varret; bëhen të shtatat, të nëntat etj., me dreka e me darka, kur dihet se këto rite e ceremoni kanë origjinë thjesht fetare e nuk përfaqësojnë ndonjë zakon të mirë.

Ka raste që rite e ceremoni të caktuara dikush i lufton si të vjetëruara e dikush vazhdon t'i mbajë në përdorim duke i quajtur «të reja» a «zakone të mira», pra nuk ka një mendim të konsoliduar, të përcaktuar mirë se ç'duhet quajtur e vjetër e arkaikë e që i ka kaluar koha siç janë disa rite e ceremoni fejesash e martesash. vdekjesh, e se ç'quhet e mirë.

Ndosht që ceremonive e gëzimeve familjare e shoqërore t'u japin një farë zyrtarizmi që i zhvesh nga ajo thjeshtësi, çiltërsi e ngrohtësi që kanë ato në traditën popullore, i bën anemike. Ka raste që dasmat, kremtimet e lindjes apo festat popullore kthehen në konferenca, gjë që i çvesh nga ngjyrat e traditës popullore.

Duhet vënë në dukje që në ritualet e festat popullore në ndonjë rast është krijuar një zbrazëti. një varfërim. Njeriu, familja, një ko-

lektiv i caktuar shoqëror në shoqërinë tonë, punon, po don dhe të gëzojë, të bëjë festa dhe ceremoni, me përmbajtje të re, por të thjeshta dhe sipas qejfit të tij. Ka ardhur koha që në mënyrë më të studjuar të orientohen ceremonitë e festat popullore.

Jo vetëm nga mungesa e propagandës kulturore ateiste e kundër zakoneve prapanike, por dhe nga kjo zbrazëti e krijuar ndodh që në disa fshatra të Shkodrës, të Lezhës, të Vlorës e të Gjirokastrës të praktikohen akoma fshehurazi dukuri besimesh e diku festa fetare. Një problemi të tillë siç janë zhvillimi dhe pasurimi i ceremonive e festave të reja popullore, nuk i kushtohet kujdesi i duhur nga ana e shtëpive të kulturës e as nga ana e organizatave të masave në fshat.

Në traditën e popullit tonë ka pasur disa festa prodhimi që në përmbajtjen e tyre themelore nuk kishin karakter fetar. Shumë mirë ato mund të shndërroheshin në festa të prodhimit shoqëror kolektiv në fshat.

IV. LËVIZJE (SHPËRNGULJE) TË POPULLSISË DHE NDRYSHIME NË MËNYRËN E JETESËS

Një ndër faktorët themelorë që kanë ndikuar me forcë në zhvillimin e përgjithshëm të fshatarësisë e në veçanti në mendësi e në qëndrimet ndaj mënyrës së jetesës ka qenë lëvizshmëria e popullsisë. Në këtë dukuri hyjnë shpërnguljet me familje me synim për kushte më të mira jetese në vendin e ri të banimit; shpërngulje me detyrë, me punë; të inkuadruarit në qendra pune që ndodhen në afërsi a në territor të fshatit; të shkuarit në aksione, në krahina të tjera për shkëmbim përvoje, në shërbim ushtarak, në shkolla e kurse kualifikimi.

Shndërrimet e mëdha ekonomiko-shoqërore që u kryen në vitet e pasqirimit, Reforma Agrare, krijimi e zhvillimi i kooperativave bujqësore e i ndërmarrjeve bujqësore, mbi të gjitha, kthimi i tërë Shqipërisë në një kantier të madh pune e ndërtimi, prunë me vete riorganizimin e rigrupimin e forcave njerëzore në një formë të re e në një drejtim krejt të ri. Këta janë faktorët themelorë të kësaj lëvizshmërie të gjerë të popullsisë në këto 30-40 vitet e fundit. Vetë këto lëvizje, që e kanë bazën në shndërrimet socialiste të ekonomisë, pasqyrojnë një qëndrim të veçantë, një gjendje shpirtërore e një mendësi që i shtyn njerzit të ndërrojnë vendin e punës tradicionale, të ndërrojnë profesionin e drejtimin e burimeve ekonomike, të marrin pjesë vullnetarisht në aksione të ndryshme kombëtare. të arsimohen e të specializohen, të ndërrojnë vendbanimin familjar. Këto flasin për një shoqërizim të një shkalle në thelb të re, kërkesë për të ndërruar mënyrën e të jetuarit, rrugë për të krijuar një jetesë më të mirë. Vetë të lëvizurit, qe një faktor me rëndësi që zhvilloi më tej një gjendje psikologjike të re, qëndrime të reja për mënyrën e të jetuarit, mendësi e re e paparashikuar nga ata që lëvizën. Lëvizshmëria qe faktor i një kthese të fuqishme në ndjenja e në mendime.

Lëvizjet u kryen kryesisht nga zonat e brendshme në drejtim të tokave pjellore fushore, në lugina e pellgje të lumenjve, sidomos në

fushat bregdetare të Shqipërisë, në drejtim të qëndrave punëtore e në qytete: në ndërtim e në industri, tregti, shërbime. Këto qendra përsuan një përzierje të madhe të popullsisë në pikëpamje etnografike e këtu efekti ka qenë edhe më i madh. Në fshatrat malore lëvizja që më e pakët; pati vetëm largime me shpërngulje të një pjese të popullsisë; përzierje etnografike në mjedise bujqësore të fshatrave malore të thuash se nuk u bë, përveçse në qendra punëtore e në ndërmarrje bujqësore. Por nga ana tjetër duhet theksuar se fryma e lëvizshmërisë, në një formë a në një tjetër preku çdo familje, goftë dhe të viseve më malore. Kjo që në vetvete një faktor zhvillimi.

Lëvizshmërinë e popullsisë mund ta ndajmë në dy periudha: e para: 1945-1960; e dyta: 1961-1984. Në periudhën e parë në përgjithësi vihet re prirja për të mos u larguar nga lidhjet e zakonet krahinore; përpjekjet për të mos u larguar nga traditat krahinore janë shumë të dukëshme sidomos në vitet 1945-1953. Në periudhën e dytë lëvizjet janë të një shkalle më të përparuar e nuk kushtëzohen nga lidhjet tradicionale krahinore.

Në periudhën e parë lëvizjet nuk qenë kudo të një natyre; në viset ku popullsia kishte rrahur kurbetin si Korçë, Gjirokastrë, Sarandë, Bregdeti i Himarës etj, lëvizshmëria që më e lirë e më e dendur; në krahinat pa tradita kurbeti lëvizjet u bënë më ngadalë e me plot ngurrime. Lëvizjet e bëra nga këto të fundit patën në vitet e para pas Çlirimit më shumë shtytjen e këshillimeve nga ana e organeve të Partisë e të pushtetit popullor.

Lëvizshmëria pruri me vete ndryshime të mëdha në mënyrën e jetesës; disa prej tyre po i përmendim:

a; Duke u inkuadruar në punë në ndërmarrje apo në institucione shtetërore, ose duke u shpërngulur me familje në drejtim të tokave më pjellore e më të bollëshme, u vunë në kushte ekonomike të reja që u bënë bazë për përmirësimin e mënyrës së jetesës. Këto dukuri, së bashku dhe me faktorë të tjerë shoqërorë-ekonomikë, çuan në kërkesa për një mënyrë jetese më të përparuar, rrënjësisht të shndërruar.

b. Ata që, duke u shpërngulur, u vendosën në vendbanime të reja bujqësore, në disa aspekte u shkëputën nga tradita e zakone prapnike të fshatit të lindjes, ku forca e dokëve të të parëve të tyre ishte tepër e fortë, ashtusi dhe forca e komunitetit etnografik krahinor e ruajtur ndër shekuj. Ata u vendosën në vende me popullsi të përzier. Ata prejardhje nga krahinat të ndryshme etnografike. Mjedisi i ri shoqëror u imponoi që të ndryshojnë mënyrën e jetesës e zakonet tradicionale që pengonin zhvillimin e familjes. Këto ndryshime i kërkonte domosdoshmërisht lidhja e re fqinjësore dhe e punës. Mirditasi, malësori, pukasi, tropojasi që u vendosën në fushat bregdetare (Zadrimë, Bregmate, Fushë-Krujë etj..) nuk mbetën më ashtu si ishin, ndryshuan në tipare, ndryshuan dhe në psikologji të mënyrës së jetesës. Shpatanë raku i Malësisë së Shpatit që ra në Fushë të Elbasanit nuk mbeti më ai i mëparshmi. Këtë ta tregojnë më së miri shtëpitë e bukura e të pajisura për bukuri në Kuqan, Shtërmen, Gjergjen të bëra nga të ardhurit prej malësive të Shpatit. Të ardhurit në Myzeqe nga malësitë

e Beratit, të Skraparit apo të Labërisë, kanë bërë gjithashtu shumë ndryshime në mënyrën e jetesës, në doke e zakone.

c) Nuk lëviz si vend pune apo si banim e tërë popullsia, po me mënyra të ndryshme kontaktesh, me «vajtje e ardhje» e tërë popullsia u bë «e lëvizshme» në drejtim të mënyrës së jetesës. Shumë familje të fshatrave malore a fushore, duke u shpëngulur, u vendosën në mjedise bujqësore bregdetare, në qytete a qyteza industriale e bujqësore. Këta të ardhur jo vetëm u zhvilluan vetë në vështrim të psikologjisë së mënyrës së jetesës, por me vajtje e ardhje me ish fqinjët e tyre, me miq e farefis të vendbanimit të vjetër, ndikuan shumë për të përhapur të renë në mënyrën e jetesës në male, në fshatra të largët e të veçuar nga kontaktet me jetën qytetare.

ç) Lëvizja i hapi fshatarit shesh pamje, e bëri më «të gjerë» e më kërkues në mendimet e tij për jetën, e nxori atë nga ai veçim i së kaluarës, krijoi në të një gjendje shpirtërore të etëshme për zhvillim në pikëpamje shoqërore e të jetesës.

d) Dukuritë e reja të inkuađrimit në punë dhe shpërnguljet thyen në themel kufijtë e ndarjeve krahinore tradicionale, që pengonin kontaktet e shpeshta dhe zhvillimin ekonomik ndërkrainor. U krijuan kushtet për një përfitim më të madh të përvojës jetësore, të ndërsjell-të midis njerëzish nga krahina të ndryshme: familje nga krahina më të prapambetura mundën të përfitojnë nga familjet prej krahinave me tradita të mënyrës së jetesës të një shkalle më të zhvilluar, siç janë ato me origjinë nga fshatrat e Korçës, të Përmetit, të Gjirokastrës etj.

e) Në jetën e të shpërngulurve shihen ndryshime të mëdha në banesë, në strukturë të të ushqyerit (kanë hyrë në përdorim zarzavate që më parë nuk njiheshin si spinaqi, karota, mashurkat, patllixhanet etj. njëkohësisht mënyra e të gatuarit ka ecur shumë përpara), në veshje (në mënyrë të veçantë në moshën e re, 40 vjeç e poshtë dhe në gra kanë hyrë veshje të kohës e veshje praktike, për punë), në mobilim të shtëpisë, në paraqitjen estetike të saj, dhe në higjenë. Popullsia e fshatit Fajzë (Has i Kukësit) është e prejardhur para 7-8 vjetësh nga disa fshatra relativisht të prapambetur, po këtu në një pjesë të madhe të familjeve në pikëpamje të mobilimit të shtëpisë dhe në higjenë bëjnë një jetë që nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm nga ajo e familjeve qytetare. Por ndryshime të tilla nuk kanë ndodhë kudo e në çdo familje. Disa familje të shpërngulura në fushat bregdetare të vendit tonë pak kanë bërë përpara në mënyrë jetese. Kjo në disa raste varet edhe nga fakti se nga ç'krahinë ka ardhë dhe nga ngritja kulturore e familjes. Ata që kanë ardhë nga krahina me një traditë të një niveli më të lartë në mënyrë jetese si nga Kolonja, Përmeti, Gjirokastra dhe në vendin e ri kanë ecur më përpara. Disa familje që kanë ardhë nga krahina të thella e me tradita të një mënyre jetese të një niveli të ulët, edhe në vendin e ri, megjithë kushtet ekonomike që i favorizojnë, nuk kanë bërë sa duhet përpara, sidomos në higjenë, në mobilim e në mënyrën e shpenzimeve të të ardhurave të ekonomisë familjare. Këtu luajnë rol negativ dhe disa mbeturina të zakoneve prapanike që kanë të bëjnë me martesat, me vdekjet, me shpenzimet

e tepërta në gosti të ndryshme. Është e nevojshme të ndërmerren studime nga ana e institucioneve kulturore e të atyre shëndetësore të fshatit, ashtu si dhe nga organet e pushtetit dhe të Partisë (lokale) për këto prapambetje në nivelin e mënyrës së jetesës, të bëhen ballafaqime e të ndikohet që familjet më të prapambetura në mënyrë jetese të ecin e të arrijnë më të përparuarat.

f. Përzjerja e unifikimi etnografik në vendbanimet e reja ka ndikuar në mënyrë jetese e veçanërisht kur marrëdhëniet fqinjësore janë shtrirë dhe në doke, zakone e mjete argëtimi, po sidomos në marrëdhënie martesore. Shumë rite të lindjes, të dasmës, të vdekjes me një përmbajtje tradicionale që në disa raste, pasqyrojnë një mendësi mjaft të prapambetur, janë lënë, disa elemente kanë pësuar transformime duke marrë një përmbajtje të re. Kështu ka ndodhur në fshatra të përzier të Myzeqesë, të Fushës së Krujës, të Zadrimës etj. Në një dasëm në Povelçë ose në Levan të Fierit, ku ka popullsi tepër të përzier etnografikisht, nga rituali e argëtimet nuk merr vesh në se aty martohet një lab, një skraparli apo një myzeqar, kaq i përzier e i transformuar është repertori i elementeve të dasmës që vëren aty. Ndryshe nga tradita, në këto grumbullime të reja nga krahina të ndryshme ka hyrë rregulli i të ftuarve për urime dhe i të ftuarve për drekë e kështu dhe shpenzimet bëhen më të pakëta. Në këto vendbanime të reja ka hyrë në një masë të dukëshme programimi i shpenzimeve në mënyrë më të rregullt të të ardhurave që siguron familja. Ajo që ka më rëndësi është fakti se në martesat të tilla të të dy shembujve që u përmendën nuk vërtetohen jo ndarje, por as mungesë harmonie në këto familje të reja. Në këto mjedise bujqësore e të reja kemi mjaft shembuj pozitivë të martesave, të personave nga krahina të ndryshme, e bile dhe me ish besime të ndryshme. Në Shtërimen të Elbasanit kemi mundur të saktësojmë 35 martesat të lidhura në mes personave nga besime të ndryshme e nga krahina të ndryshme, në Sanxhak të Krujës 18 martesat të tilla etj.

Por ka jo pak raste ku martesat të tilla të të rinjve pengohen nga njerëzit e moshuar të familjes. Pleq myzeqarë nga Levani i Fierit dhe nga fshatra të tjera të Myzeqesë pohojnë se në përgjithësi «kur na kërkohet vajza për martesë të ardhurit nga malësitë e Labërisë e të Skraparit, ne ua japim vajzat, kurse kur djemtë tanë myzeqarë kërkohet të martohen me vajza të tyre, ata nuk e lejojnë të bëhet një gjë e tillë». Kjo ka të bëjë me disa mbeturina të së kaluarës në ndërgjegjen e këtyre njerëzve, mbeturina që bëhen pengesë në lidhjet e reja martesore pa dallim krahinor apo të ish besimeve të ndryshme.

*
* * *

Me krijimin e ndërmarrjeve bujqësore u përthith shumë fuqi punëtore jo vetëm nga vendet fushore, por edhe nga krahinat e thella malore. Në këto vende si në NB «Perlat Rexhepi» Shkodër, në NB e Lezhës, në Sukth, në Thumanë, në Levan të Fierit, në Llakatund

të Vlorës, në Maliq, një pjesë e fuqisë punëtore, u shpërngul me familje nga fshatra të tjera e u vendosën këtu, por pjesa më e madhe ndodheshin familjarisht në territorin e këtyre ndërmarrjeve. e pranuk lëvizën nga vendbanimi i mëparshëm. Në këto raste pësoi ndryshime natyra social-klasore e fshatarësisë duke u kthyer në gjendje punëtore të bujqësisë.

Kantieret e ndërtimit, bonifikimet, industria minerare e ajo pyjore, përthithën shumë punëtorë nga fshatrat, punëtorë kryesisht nga krahina në territorin e të cilave ndodheshin ndërmarrjet. Shumë forca nga fshati tërhoqën qëndrat e reja punëtore ku u formuan dhe qytete të rinj si Cërriku, Q. Stalin, Kombinati i Tekstileve «Stalin». Laçi etj. Një pjesë e madhe nga punëtorët e industrisë minerare, të asaj pyjore, të ndërtimit, të Rruga-Urave me familje qëndruan në fshat dhe anëtarët e familjes punojnë në bujqësi. Ka rrethe si Mirdita, Puka etj. ku mbi 70-80% e punëtorëve banojnë në fshat.

Numri i punëtorëve me banim në fshat, i marrë si republikë, përfshin një masë të gjerë që vjen duke u rritur nga viti në vit si rrjedhojë e zhvillimit të industrisë e të ndërtimeve në trevat e vendbanimeve fshatare. Këtë e tregon dhe tabela e mëposhtme:

Punëtorët me banim në fshat

Viti	Numri i punëtorëve gjithsej	Numri i punëtorëve me banim në fshat	Në % ndaj numrit të përgj. të punët.
1976	422,138	71,136	16,8%
1977	452,784	74,975	16,6%
1978	473,847	80,562	17%
1979	481,135	84,360	17,5%
1980	505,768	91,591	18,1%

Pra sipas këtyre të dhënave, kemi dy kategori lëvizjesh të forcave njerëzore: lëvizje vetëm me punë dhe lëvizje me punë dhe me familje. Në lëvizjet me punë në disa raste nuk ndërron profesionin siç është puna në bujqësi dhe, së dyti, lëvizja duke ndërruar profesionin: nga bujk e blegtor fshatari u bë punëtor, bile edhe u specializua. U bë minator, shkrirës minerali, traktorist, specialist për perime e kështu me radhë. Këto mënyra të lëvizuri përcaktojnë dhe shkallën e ndikimit të tyre në mënyrën e jetesës, në hedhjen poshtë të disa zakoneve e traditave të prapambetura në jetën e në marrëdhëniet familjare. Në fshatra vepron një masë e madhe intelektualësh si mësues, mjekë, mami, agronomë, ekonomistë që kanë kërkesa të jetës qytetare.

Punëtorët dhe intelektualët me banim në fshat kanë futur në një masë të gjerë elemente të reja të mënyrës së jetesës qytetare në përkim me zhvillimin e sotëm; së pari i kanë futur këto elemente të reja

në familjet e tyre e pastaj këto vlera kulturore përthithen nga masa e gjerë e fshatarësisë, në fqinjësi me ta. Në Çermenikë, në Dukagjin, në Mirditë, ku nga e kaluara kanë trashëguar një mënyrë jetese mjaft të prapambetur, në ditë të sotme vëren në jo pak familje, pjesëtarë të të cilave janë punëtorë a intelektualë, mjedise të jetës familjare krejtësisht të shndërruara: mobilim shtëpish, higjenë e pastërti, rregull që mund të barazohet me jetesën e familjeve në qytete. Por kjo nuk ndodh kudo. Në disa raste ndodh e kundërta.

Punëtorët me banim në fshat me të vërtetë në shumë raste janë përçues të përparimit atje, por një pjesë e tyre duke qenë me banim në fshat nuk janë shkëputur nga disa zakone e tradita prapanike në jetesë e në marrëdhëniet familjare, por dhe në lidhje me pronën e me disiplinën e punës. Në qendra të punës bëhen në disa raste nga punëtorë shpenzime të tepërta në pijetore, gjë që rëndon shumë buxhetin familjar, pengesë kjo për përmirësimin e kushteve të jetesës. Ka dhe intelektualë të fshatit me një mënyrë jetese që nuk i përgjigjet zhvillimit të sotëm.

Ka një pjesë jo të pakët të punëtorëve e të intelektualëve me banim në fshat që e kanë shtëpinë relativisht larg nga qendra e punës; është e natyrisht që këta do të shpenzojnë një pjesë të pagës për të ngrënë, por nuk është i arësytuar fakti që një pjesë (natyrisht jo shumë) nga këta kalojnë orë të tëra në pijetore ku shpenzojnë para të tjera nga paga e marrë. Në këto kushte ngarkesa më e madhe në mbarështrimin e familjes e në rritjen e fëmijëve, i mbetet gruas, e cila duhet të punojë edhe në bujqësi. Kjo gjë bëhet shkak dhe për një farë prapambetjeje në mënyrën e jetesës.

Që punëtorët e intelektualët të mos kalojnë orë të tëra në pijetore do të ishte mirë që klubet e kulturës dhe komitetet profesionale të organizonin veprimtari të ndryshme çdo ditë ku këta të kalonin kohën e lirë në mënyrë të kulturuar e pa shpenzime që rëndojnë buxhetin familjar. Veprimtari argëtuese organizohen vazhdimisht, por jo aq sa të mbushin kohën e lirë të punonjësve.

Lëvizshmëria e popullsisë, krahas rrjedhëve të mira që sjell me vete, nxjerr nga koha në kohë probleme. Lëvizja shtyhet nga motive të mirëqënies familjare. Këtu në disa raste bie ndesh interesi personal me interesin e përgjithshëm shoqëror, ose bien ndesh, në këtë vështrim, interesat lokale me ato të shkallës kombëtare. Del nevoja e studimit për t'i ndaluar të tilla dukuri negative.

Ka një prirje të tiposur në psikologjinë e fshatarëve, për t'u lidhur sa më shumë në anë ekonomike me qendrat më të urbanizuara, në viset fushore bregdetare, me qytetin. Në shumë raste në mendësinë popullore kjo shihet si kusht për një mënyrë jetese më të përparuar. Në drejtim të kontakteve kjo nuk ka asgjë të keqe, veç të mira. Por kur vjen rasti i shpërnguljeve me familje këtu ndryshon puna.

Që nga viti 1958 e këtej ekzistojnë prirje (natyrisht në një masë të kufizuar) për të lëvizur me punë e me banim një pjesë popullsie fshatare nga malësitë e viset më të largëta për në fusha e lugina pjellore, në vende më të urbanizuara, nga kooperativat bujqësore në ndërmarrjet bujqësore e ato industriale, nga fshati në qytet. Kjo prirje e

mendësi e bregdetomanisë dhe e qytetomanisë ekziston më tepër në një kategori njerëzish të moshave të reja.

Më 1945 banonte në qytet vetëm 15% e popullsisë së vendit tonë. Zhvillimi i gjithanshëm i ekonomisë sonë në rrugën e socializmit pruri në mënyrë të domosdoshme shtimin me ritme të shpejta të popullsisë së qyteteve dhe lindjen e qyteteve të reja; kanë lindur dhe shumë qyteza që, ndonëse emërtohen si fshatra e qendra punëtore, në brendinë e tyre kanë marrë formën e një jete qytetare. Këto janë rrjedhojë e zhvillimit të sotëm. Në këto 30 vjetet e fundit rreth gjysma e shtimit vjetor të popullsisë qytetare ka ardhur nga lëvizja me shpërngulje me burim nga popullsia fshatare. Edhe pse kjo shtesë mekanike e qyteteve gjatë këtij 5 vjeçari të fundit është rreth 2 herë më e ulët, ajo përsëri zë rreth 33% të shtimit të përgjithshëm të popullsisë qytetare. Nga të dhënat statistikore për popullsinë del se gjatë viteve 1979-1983 janë larguar nga fshati për në qytet rreth 36000 banorë, 70% prej të cilëve (rreth 24000 banorë) janë larguar nga fshatrat e rretheve Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kolonjë, Mat, Shkodër, Tiranë, Vlorë. Vetëm nga fshatrat e rrethit të Korçës janë larguar gjatë kësaj periudhe 3884 banorë, nga të rrethit të Fierit 3154 banorë, nga të rrethit të Shkodrës 2590 banorë. Gjatë vitit 1983 janë shpërngulur familjarisht nga fshatrat në qytete e qendra pune 9141 frymë, vetëm nga fshatrat e Korçës janë larguar këtë vit (1983) 1012 vetë, nga të Fierit 808 veta, nga të Sarandës 609 veta, nga të Tiranës 488 veta, nga të Vlorës 460 veta, nga të Shkodrës 404 veta, nga të Matit 401 veta. Ajo që bie në sy më tepër është fakti se 70-80% e atyre që largohen nga fshatrat e vijnë në qytete janë me shoqërim të atyre që vijnë me punë ose me martesë. Ka dhe lëvizje jo të pakta popullsie nga qyteti në qytet; prirja është për të kaluar nga qytete provinciale drejt qyteteve më të rëndësishme si Tirana, Durrësi, Fieri, Korça, Vlora, Elbasani. Vetëm në vitin 1982 kanë lëvizur nga qyteti në qytet 5159 banorë. Natyrisht ka një pjesë të madhe të tyre që kanë lëvizur sepse kështu e ka kërkuar puna shtetërore.

Është krejt e kuptueshme që industria e veçanërisht veprat e mëdha si uzina e Ballshit, kombinati metalurgjik (Elbasan), uzinat e Laçit e kështu me radhë do të tërhiqnin doemos një sasi forcash nga fshati. Pra do të bëhej e do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme shtesë mekanike e qyteteve e të qytezave. Por nga ana tjetër ka dhe popullsi që hyn në qytete në mënyrë të panevojshme. Ka plot raste që shumë njerëz rrahin të tëra rrugët e mundshme për të hyrë me banim në qytet e, në se është e mundur, në qytetet kryesore a në kryeqytet. Kur nuk munden të hyjnë në qytet, vijnë e vendosen në fshatrat pranë qyteteve, kështu në NB rreth Tiranës, Shkodrës, Fierit, Lushnjës, Vlorës etj. janë vendosur shumë banorë të rinj, sidomos këto 20 vjetet e fundit. Në këto fshatra vijnë lehtë sepse nuk ka kërkesa të forta për leje banimi.

Ka një prirje të fortë për t'u vendosur në qytet ose, së paku në fushat bregdetare, me anë të martesave, vajzat më tepër, por dhe djemtë. Është vënë re që jo pak vajza nga fshatrat e Korçës, të Vlo-

rës, të Sarandës, të Dropullit, presin të gjejnë një burrë me banim në qytet e kështu bëhen të moshuara pa u martuar. Kjo dukuri, në një shkallë më të vogël, vërehet dhe në vise të tjera të vendit tonë. Nga një studim i bërë për kooperativën bujqësore të Pezës del se nga 12 fshatrat e zonës së thellë malore të kësaj kooperative 45% e vajzave të martuara më 1982 janë vendosur me martesë në fushë ose në qytet. Në këtë vit asnjë vajzë nga fshatrat e fushës nuk është martuar në fshatrat e zonës së thellë. Dukuri të tilla bëhen problem dhe për martesën e djemve të malësisë nga që vajzat duan të martohen gjetiu.

Megjithatë prirja për t'u larguar nga fshatrat malore, nuk është ende një dukuri me përmasa të gjëra. Zhvillimi me hop të shpejtë i fshatit socialist, urbanizimi, tregëtia, mjetet social-kulturore të ngritura atje bëjnë që popullsia të mos kërkojë të largohet prej andej. Popullsia e fshatit ka shtesë natyrore më të madhe se ajo e qytetit e pra dhe largimi i një pjese të popullsisë nga fshati nuk e dëmton atë. Këtë e tregon dhe pasqyra që po japim më poshtë:

Ndryshime në përqindje i raportit të popullsisë fshat-qytet

Popullsia	Vitet					
	1938	1950	1960	1970	1980	1984
Popullsia e fshatit	84,6	79,5	70,7	66,3	66,4	66,3
Popullsia e qytetit	15,4	20,5	29,3	33,7	33,6	33,7

Duhet pasur parasysh dhe fakti që disa fshatra janë kthyer këto vitet e fundit në lagje të qyteteve, p.sh., Sanxhaku i Krujës është bërë lagje e qytetit të Laçit. Pra prirje të rrezikëshme të shpopullimit të fshatit ende nuk ka.

*
* *
*

Shqyrtoam më lart disa aspekte të psikologjisë së mënyrës së jetesës në fshatin e sotëm shqiptar, duke synuar të nxjerrim në pah krahas arritjeve në sfera të ndryshme, edhe mangësitë e të metat që i bëhen pengesë përhapjes të së resë në fshat.

Problemi i mënyrës së jetesës është shumë i gjerë dhe prandaj nuk është aq lehtë që të nxirren përfundime e të bëhen përgjithësimet, në kushtet e mungesës së studimeve të posaçme e më të thelluara për tema ose krahasime të veçanta.

CHANGES IN THE MODE OF LIVING OF THE PEASANTRY TODAY

In this article the authors examine a problem of current importance, which has to do with the mode of living of the peasantry today.

The large-scale socio-economic transformations carried out in Albania after Liberation have been reflected gradually in the mode of living, by which we imply not only people's activity outside the sphere of production, but also a series of relations in the ideological and spiritual field. The mode of living develops ceaselessly, depending on the social, economic and cultural transformations and the raising of general well-being. The vigorous social and demographic transformations, the growth of cities and the creation of new dwelling centres, the increase in the working class, the all-round socio-cultural development of the countryside, the changes in the structure and in the internal family relations, the great development of education and culture, the evolution of social psychology, especially, have led to radical changes in the mode of living.

The present article is based on the material collected in villages and agricultural enterprises from ten districts of the Republic.

The study is divided into four parts:

The first part, *Transformations in the material living conditions*, deals with the changes that have occurred in dwelling places and dwelling-houses, the supply of villages with drinking water, the improvement in the motor-road network, the extension of the trade network, the communal services, the socio-cultural buildings, the personal hygiene, the mode of nutrition, eating, etc.


In the second part, *Changes in the structure and internal organization of the family*, it is pointed out that the main tendency in the countryside today is the simplification of the family, which affects all its main aspects: its numbers, couples and generations. Referring to concrete data, the simple one couple families with two generations comprise the majority of the families of the zones examined. Although there is a percentage of families with two couples and three generations, the tendency is towards their reduction. Significant changes have occurred also in the internal relations in the family. A positive phenomenon of relations in the new rural family are understanding, the respect for one another's opinion and love for another, the preoccupation for the rearing and education of children, etc. Alongside positive aspects, manifestations of norms of the past which become an obstacle to the all-round emancipation of the rural family, are also seen.

In the third part, *The educational and cultural uplift of the peasantry*, it is shown that along with the objective material factors, the raising of the educational and cultural level of the working people of the countryside has also played a great role in the change in their mode of living. In this respect, the school, alongside the communist education of the younger generation, has always served as an important centre for the introduction and distribution of the new in the life of the countryside, for a better cultured life. Good work is also done in the hearths and houses of culture, which have become centres for the propagation of the new in the countryside.

In the fourth part, *Movement of the population and changes in the mode of living*, it is said that one of the factors that have strongly influenced the general development of the peasantry and, especially, the attitude towards the mode of living has been the movement of the population. In this phenomenon are

included the movement of families to new settlements with prospects of better living conditions, movements conditioned by the distance of the work place, the employment in work places of those living close to or in villages, going to mass actions in other districts for exchange of experience. military service, school attendance. qualification courses, etc.

Alongside the positive achievements in the improvement of the mode of living, the article points out also the shortcomings which become obstacles to the spread of the new in the countryside.



Spiro SHKURTI

MBJELLJA E DRITHËRAVE

*«Me e punue tokën tri herë, nuk ta di për ner/, me e punue katër herë, për hatër ta besoj/, me e punue pesë herë, merr këmesën e korr».
Një bujk nga Guri i Zi*

(Shkodër)

Mbjellja e drithërave në traditë zinte një vend të rëndësishëm në proceset e punëve bujqësore. Nga kryerja mirë dhe në afatet e caktuara e kësaj pune varej në një masë të madhe edhe prodhimi i pritshëm. Për këtë arsye mbjelljes bujku i ka kushtuar kujdes e vëmendje të veçantë. Në përgatitjen e tokës për mbjellje dhe në hedhjen e farës bujku kishte fituar një përvojë të madhe vetiake e kolektive. Ai, në mënyrë empirike, kishte përvehtësuar përvojën e brezave paraardhës dhe në punë e sipër e pasuronte atë vazhdimisht. Në këtë përvojë, krahas veglave të punës, ishin përcjellë edhe një numër traditash e zakonesh, në bazë të të cilave qëndronte dëshira për një prodhimtari të bollshme. Këto tradita e zakone janë krijuar në një fazë të mocme të zhvillimit historik të shoqërisë që përkon me mesjetën e hershme ose me periudhat para saj. Si të tilla ato janë dëshmi të lashtësisë së procesit të mbjelljes në veçanti dhe të bujqësisë në përgjithësi. Në procesin historik të zhvillimit ato kanë luajtur një rol frenues, duke u bërë pengesë për futjen e të rejave shkencore në bujqësi.

Mbjellja e drithërave nuk është bërë objekt i ndonjë studimi të veçantë, por për të është shkruar në kuadrin e një teme më të gjërë

për fshatra të veçanta¹. Këto studime janë të pakta në numër. Edhe materiali arkivor është mjaft i kufizuar. Për këto arsye jemi mbështetur në materialin e mbledhur prej nesh në një numër fshatrash brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë. Si kohë materiali i përket fundit të shekullit të kaluar dhe fillimit të shekullit tonë. Kjo nuk do të thotë se ai nuk shtrihet më në thellësi të kohëve. Shumë zakone, tradita e besime kanë kaluar nga brezi në brez dhe kanë ardhë të pandryshuara ose të shndërruara disi në kohën tonë.

Kulturat e arave zinin vendin kryesor në bujqësinë shqiptare të paraçlirimit. Me to mbilleshin sipërfaqet më të mëdha të tokave të punuara. Por roli dhe pesha e tyre në sigurimin e bukës nuk ishte i njëjtë. Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 1926, në të gjithë vendin u prodhuan 214536 kv. grurë, 797256 kv misër, 13964 kv thekër dhe 50811 kv elb². Si mund të shikohet, prodhimi i misrit ishte rreth tri herë e gjysmë më i madh se ai i grurit dhe rreth 57 herë më shumë se i thekrës. Pra ai jo vetëm zinte vendin e parë midis kulturave të arave, por edhe siguronte bukën për pjesën dërrmuese të popullsisë. Edhe në sipërfaqet e mbjella me kultura drithore misri zinte vendin e parë. Me të mbillej një sipërfaqe dy herë më e madhe se me grurë. Viti 1926 nuk përbën një përjashtim. Edhe në vitet e tjera për të cilat ka të dhëna, gjëndja në mos është e njëjtë është shumë e përafërt. Për të pasur një ide sa më të qartë për këtë problem, po japim pasqyrën e mëposhtme për prodhimin e përgjithshëm të drithrave në vitet 1932-1936³.

Prodhimi i drithërave për vitet 1932-1936

(në ton)

Viti	Grurë	Misër	Elb	Thekër
1932	42400	108.000	7.170	3.150
1933	65.100	110.000	9.000	4.800
1934	44.300	147.600	6.550	3.600
1935	42.300	115.500	4.400	2.880
1936	30.000	124.700	4.070	2.900

1) A.Gjergji: *Provë për një studim etnografik në fshatin Rrëmbec (Korçë)*, në «Etnografia Shqiptare» I, Tiranë, 1962, f. 193-250. A. Gjergji: *Provë për një studim etnografik në kooperativën bujqësore «Shkëndia» në rrethin e Korçës*, në «Etnografia Shqiptare», II Tiranë 1963, f. 81-109. A. Gjergji: *Të dhëna mbi bujqësinë tradicionale në fshatin Pojan-Fier*, në «Etnografia Shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 131-154. U. Xhemaj: *Mënyra tradicionale e mbjelljes, korrjes dhe shirjes në rrethinën e Kaçanikut*, në «Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji» VIII, Prishtinë 1978,, në «Etnografia shqiptare» 11, Tiranë, 1980, f. 131-151.

2) T. Selenica: «Shqipëria më 1927», Tiranë, 1928, f. CLXXX.

3) I. Fishta, V. Toçi: «Gjëndja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat», Tiranë 1983, f. 103.

Si mund të vërehet nga të dhënat e mësipërme, prodhimi i përgjithshëm i misrit ishte afër 3 herë më shumë se i grurit, rreth 20 herë më i madh se i elbit dhe përmbi 40 herë më i madh se i thekrës. Prodhimi i përgjithshëm i misrit ishte afër 2.5 herë më i madh se i të gjitha të lashtave të marra së bashku.

Edhe në sipërfaqet që ziheshin me këto kultura kishte ndryshime. Për t'i parë këto po japim tabelën e mëposhtme⁴.

Sasia e tokave të mbjella me drithëra në vitet 1932-1935.

(në ha)

Viti	Grurë	Misër	Elb	Thekër
1932	36.692	74.512	5.454	2.505
1933	43.329	77.259	6.100	3.422
1934	38.947	94.637	5.501	2.897
1935	38.671	65.407	4.203	2.416

Edhe në sipërfaqet e mbjella, misri zinte vendin e parë. Në të mbillej një sipërfaqe pothuaj dy herë më e madhe se me grurë. Çdo vit sipërfaqet e mbjella me të lashta (grurë, elb, thekër) ishin më të vogla se ato që mbilleshin me misër. Në vitin 1935 sipërfaqja e mbjellë me këtë kulturë zinte 25,84 përqind të të gjithë sipërfaqes, me thekër 0,73 për qind⁵. Në vartësi nga pesha që zinte në sigurimin e bukës dhe nga sasia e tokës së zënë me çdo kulturë, ishte edhe kujdesi i bujkut, qoftë në përgatitjen e tokës për mbjellje, qoftë në hedhjen e farës. Meqë misri zinte vendin kryesor në prodhimet e arave, për të bujku tregonte kujdes më të madh dhe derdhte më shumë djersë. Sigurisht që tradita për këtë kujdes të diferencuar midis të vonave dhe të lashtave nuk mund të jetë më e hershme se shekulli XVII, kur filloi të futej misri në Shqipëri. Para kësaj kohe kujdes tregohet për të lashtat. Për përparësitë e shumta që kishte kultura e misrit, fshatari filloi t'i kthejë sytë nga kjo kulturë dhe, shkallë-shkallë, të heqë dorë nga shërbimet që u bënte të lashtave, veçanërisht grurit si përfaqësues nga shërbimet që u bënte të lashtave, filluan të kalojnë edhe tek misri, bile në ndonjë rast në atë masë sa zbatoheshin vetëm në mbjelljen e tij.

Kujdesi i diferencuar për kulturat e arave vihej re që në përgatitjen e tokës për mbjellje. Për misrin, toka para se të mbillej, punohej të paktën tri herë. Para mbjelljes ajo shkrifërohej aq mirë sa «po të lë-

4) «Statistikë e prodhimit bujqësor në vitin 1934-1935», Tiranë, 1936, f. 8.
5) «Statistika e prodhimit bujqësor në vitet 1934-1935», Tiranë, 1936, f. 8.

shohej një vezë e pa zier mbi të, të mos thyhej», thonë fshatarët. Ky punim i kujdesshëm i tokës nuk ka qenë karakteristik vetëm për zonat fushore, por edhe për zonat kodrinore e malore. Nga punimi i mirë i saj para mbjelljes varej në një masë të madhe edhe prodhimi. Për këtë arsye në zonat ku misri zinte vend kryesor në kulturat e arave qarkullonte shprehja: «Me e punue tokën tri herë, nuk ka ta di për nder, me e punue katër herë, për hatër ta besoj, me e punue pesë herë, merr këmesën e korr».

Në pjesën më të madhe të fshatrave të vendit punimi i parë i tokës për mbjelljen e misrit bëhej në muajin janar, në mënyrë që toka të kishte mundësi të thithte sa më tepër ujë nga shirat e dimrit e të pranverës. Është kjo arsyeja që në popull qarkullon shprehja: «puna e janarit është vlaga e beharit». Një vit më vonë, kur toka mund të mbillej me grurë, ky punim mund të bëhej edhe në fund të muajit shtator e në fillim të tetorit, në mënyrë që toka «të kalbej» nga shirat e vjeshtës. Punimi i parë, pavarësisht nga koha kur bëhej, në vjeshtë ose në dimër, quhej *çarje* apo *ugar*. Ky ishte emërtimi më i përgjithshëm, se në zona të veçanta etnografike ky punim thirrej edhe *parmenda e parë* ose *lavër*. Punimi i dytë bëhej nga fundi i muajit shkurt e fillimi i muajit mars dhe kudo njihej me të njëjtin emër: *thyerje* ose *parmenda e dytë*. Punimi i tretë, që ndryshe quhej edhe *përzierje*, bëhej në fund të muajit mars ose 10 ditëshin e parë të muajit prill. Punimet e tjera para mbjelljes bëheshin në prill ose në maj. Si shihet, tokës, që do të mbillej me misër i bëhej pothuaj çdo muaj një punim, në mënyrë që ajo të shkrifërohej e të thithte sa më shumë lagështi. Mbas çdo punimi parmenda shkonte më thellë. Kështu ndërsa në punimin e parë parmenda shkonte 15-17 cm. në të dytin kjo thellësi shkonte 17-22 cm. dhe në të tretin deri në 30 cm. Bujku kishte kujdes që punimi i fundit, ai mbas të tretit, të mos shkonte më thellë se ai i parafundit, se përndryshe toka nxirrte plisa të rinj.

Në punimet që i bëheshin tokës që përgatitej për mbjellje, bujku zbatonte disa rregulla të caktuara, që ishin të lidhura me pozicionin e saj. Në tokat fushore punimi i dytë bëhej tërthor me të parin dhe i treti tërthor me të dytin e kështu me radhë. Punimi i tokës në këtë mënyrë ndihmonte në copëtimin e plisave të mëdhenj dhe bënte që lesimi të ishte sa më dobiprurës. Këtë dukuri dmth. kalimin e punimeve tërthor njeri mbi tjetrin, e kanë hetuar edhe studiues të tjerë.⁶ Në tokat kodrinore e malore, që kishin një farë pjerrësie, nuk zbatoheshin kjo mënyrë e punimit. Parmenda në të gjitha punimet ndiqte të njëjtin drejtim, dmth. paralel me rënien e terrenit. Kjo formë e punimit e tokave të pjerrëta ishte përcaktuar nga dy arsye: së pari, nëse edhe në tokat e pjerrëta punimet do të kryheshin tërthor njeri mbi tjetrin, tokat e punuara do të dëmtohejshin shumë nga grryerjet gjatë shirave të vjeshtës dhe të dimrit. Së dyti, bujku dhe kafshët tërheqëse e kishin më të lehtë punimin në të njëjtin drejtim, pikërisht në atë anë ku pjerrësia ishte më e butë, sesa ta

6) A. Gjergji: *Të dhëna mbi bujqësinë tradicionale në fshatin Pojan-Fier*, «Etnografia Shqiptare» V, Tiranë, 1974, f. 131-154.

punonin tokën nga lart-poshtë ose nga poshtë-lart, gjë që nuk ishte praktike dhe do të kërkonte një forcë dhe energji shumë të madhe. Si shihet, të dy arsyet e këtij punimi të tokave të pjerrëta janë të karakterit praktik. Ato kanë dalë nga përvoja e bujqëve.

Përgatitja e tokës për mbjelljen e të lashtave, si rregull, ndryshonte nga ajo që bëhej për misrin. Kujdesi i bujkut në këtë rast ishte më i pakët. Asaj, në rastet më të mira, i bëheshin dy punime e një lesim. Vitin pasardhës, kur toka nuk futej nën kulturë, bëhej çarje e saj. Kjo punë kryhej në muajin shtator ose tetor, mbas shirave të para të vjeshtës. Çarja e tokës bëhej në vjeshtë vetëm atëherë kur ajo do të mbillej me grurë dimëror. Në rastet kur toka, do të mbillej me grurë veror, kjo punë bëhej në shkurt e mbjellja në mars. Në rastet kur toka ishte mbjellë me misër, i cili ishte korrur në muajin shtator ose tetor dhe në vjeshtë do të mbillej përsëri me grurë, asaj nuk i bëhej asnjë punim. Fara e grurit hidhej direkt mbi sipërfaqen e tokës dhe pastaj punohej për ta mbuluar atë. Fshatarët mendonin se tokat e mbjella me misër, që është kulturë prashitëse, nuk kanë nevojë për punë, mbasi toka e ka punën brënda, të bërë që më parë. Në raste të veçanta, kur familja ishte e varfër dhe nuk kishte kafshët e nevojshme të punës, ose gjatë periudhës së mbjelljes në familje kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi e madhe, kujdesi për përgatitjen e tokës mungonte krejtësisht. Në këto raste fara e grurit hidhej direkt mbi tokën e palëruar, ose mbi lëndinë dhe pastaj punohej me parmbindë për të mbuluar farën. Në disa raste, mbjelljes së të lashtave të tjera u kushtohej më pak kujdes. Në mbjelljen e tyre ruhen më shumë se kudo forma të hershme e primitive. Kështu zakonisht thekra mbillej në toka të varfra, të cilat ndodheshin larg qendrës së banimit. Fara e saj hidhej drejtpërdrejt mbi tokën e papunuar, pra mbi lëndinë, dhe pastaj ajo punohej për ta mbuluar atë. Në disa fshatra të Lumës, të Malësisë së Madhe, të Labërisë etj., përdorej një formë më primitive. Këtu zgjidhej një tokë e mbuluar me shkurre, i vihej zjarri dhe mbas disa ditësh, mbi hirin e mbetur shpërndahej fara. Toka nuk punohej dhe fara vetëmbulohej me hi. Bimës së mbjellë në këtë mënyrë fshadari nuk i bënte asnjë shërbim para korrjes. Shumë e afërt me këtë mënyrë është edhe mbjellja e thekrës në stane nga barinjët. Ata disa ditë para shënmitrit (26 tetorit), kur do të linin kullotat verore për të zbritur në ato dimërore, shpërndanin në vathën, ku kalonte natën bazbritur në ato dimërore, shpërndanin në vathën, ku kalonte natën bazgëtia, farën e thekrës. Ato, duke lëvizur, e mbulonin farën në pleh. Kur bagëtitë ktheheshin në kullotat verore në muajin maj ose qershor të vitit pasardhës, thekra ishte bërë gati për t'u korrur. Edhe në këtë rast thekrës së mbjellë nuk i bëhej asnjë shërbim. Sikurse shihet në të dy mënyrat e mbjelljes së thekrës ruhen metoda primitive, që të kujtojnë hapat e parë në zhvillimin e bujqësisë. Kështu mënyra e përdorur në disa fshatra të vendit për djegien më parë të një toke të mbuluar me shkurre e pastaj shpërndarjen e farës mbi hirin e mbetur, pa e punuar tokën, të shpien në atë fazë të hershme të zhvillimit të kësaj dege, që njihet me emrin «bujqësia me prerje e djegie».

Puna dhe kujdesi i diferencuar në përgatitjen e tokës për mbjellje sillte që edhe prodhimi i misrit dhe i të lashtave për hektar të ishte

i ndryshëm. Në fund të shekullit të kaluar për çdo hektar të mbjellë me grurë nuk merreshin më shumë se 5 kv⁷, madje në një zonë si ajo e Korçës, ku kishte më shumë tradita në mbjelljen e të lashtave. Edhe pas vitit 1930, kur erdhën farëra të lashtash më të qëndrueshme dhe më prodhimtare, këto rendimente ishin të ndryshme. Kështu në vitin 1937-1938 prodhimi i grurit për hektar ishte 7 kv. i thekrës 7 kv., ndërsa prodhimi i misrit 11,5 kv⁸. Vitet e mësipërme nuk ishin një përjashtim. Kështu, psh, edhe në vitin 1936 gjendja paraqitej pothuaj e njëjtë. Nga gruri u morën afro 8 kv. për hektar, ndërsa nga misri rreth 14 kv⁹.

Në përgatitjen e tokës për mbjellje, përveç punimit, rol të rëndësishëm luante lesimi. Ky, si rregull, ndiqte gjithnjë drejtimin e punimit të tokës, dmth, nëse punimi ishte bërë në drejtimin lindje-perëndim, po në këtë drejtim bëhej edhe lesimi. Për këtë proces pune bujku kishte mjete të veçanta, që në popull njihen me emrat: *lesë*, *trinë* ose *vllaçë*. Ndërsa emërtimi i parë ka një shtrirje të gjerë në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme, i dyti përdoret më gjërë në Shqipërinë e Veriut dhe në Kosovë. Emërtimi i tretë përdoret në zona të veçanta të Shqipërisë Veriore. Lesimi bëhej disa ditë mbas punimit, atëherë kur toka ishte tharë aq sa nën peshën e lesës plisat e dalë nga punimi të mund të grimcoheshin. Lesat e përdorura në fund të shekullit të kaluar e në fillim të shekullit tonë ishin dy llojesh: druri dhe hekuri. Në llojin e parë ndeshen dy forma: lesa të rënda, të punuara me trungje druri dhe lesa të lehta, të punuara me degë pemësh. Këto në popull njihen edhe me emrin *lesë shkuresh*. Lesat e llojit të parë përgatiteshin prej dy copash trungu lisi ose rrapë, pra prej një druri të rëndë. Copat e trungut dystoheshin në të dy anët. Në pjesën e poshtme atyre u përshtateshin dhëmbë druri me gjatësi 5-7 cm., të cilët futeshin në trung, kur ai ishte ende i njomë. Ishin këta dhëmbë që, nën peshën e trungut, coptonin plisat e mëdhenj të dalë gjatë punimit me parmendë. Këto lesa kishin formën e një trekëndëshi (Fig. 1). Më rrallë janë përdorur lesa në formën e një trekëndëshi dybrinjë-




Fig. 1

7) A. Gjergji. *Provë për një studim etnografik në fshatin Rrëmbec (Korçë)* «Etnografia shqiptare» I, Tiranë, 1962, f. 193-250.

8) «Anuari statistikor i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1958», Tiranë 1958, f. 56, 57.

9) Statistika e prodhimit bujqësor në vjetet 1935-1936», Tiranë, 1936, f. VI-VII.

njëshëm. Në këtë rast, poshtë copave të drurit që formonin skeletin, ngjiteshin dhëmbë druri, të cilët shërbenin për të thërmuar plisat, Shpeshherë, për të shtuar peshën e lesës, mbi të viheshin gurë e plisa dheu, ose mbi të hipte vetë bujku që drejtonte pendën e qeve (Fig. 2).



Fig. 2

Lesat e llojit të dytë punoheshin me degë shkurresh, që thureshin në formë gërsheti. Lesa e thurur në këtë mënyrë fiksohej në një skelet druri, por duke pasur gjithnjë parasysh që degët që dilnin nga skeleti në pjesën fundore të liheshin të lira, dmth. ato nuk bëheshin në formë gërsheti. (Fig. 3). Dy llojet e lesave të drurit përdoreshin në procese




Fig. 3

të veçanta. Ndërsa forma e parë përdorej vetëm për thyerjen e plisave që dilnin mbas punimit të dytë e mbrapa, forma e dytë përdorej më shumë mbas mbjelljeve, për të mbuluar farën. Të dy format e lesave të drunjta përbëheshin nga tri pjesë kryesore: trupi, krahët dhe oshta. Kjo e fundit është një tra i gjatë rreth 2,5 m. që shërben për të lidhur lesën me zgjedhën e qeve dhe ka pasur të njëjtën formë si edhe shtiza e parmendës. (Fig. 4). Për thyerjen e plisave të mëdhenj është përdorur një vegël tjetër që njihet me emrin tokmak. Ai kishte formën e një çekiçi, por në përmasa shumë më të mëdha dhe ishte i gjithë prej druri (Fig. 5). Me të bujku godiste plisat e mëdhenj dhe i coptonte.




Fig. 4




Fig. 5

Përdorimi i lesave të hekurta është një dukuri relativisht e vonë në vendin tonë. Sipas të dhënave që kemi në dorë, ato filluan të përdoren gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Ndonëse filluan të hyjnë që në këtë kohë, ato nuk gjetën përdorim masiv në procesin e lesimit të tokave. Numri i lesave të hekurta të importuara ishte mjaft i kufizuar, gjë që të lë të kuptosh se nuk para pëlqeheshin nga bujku shqiptar. Gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore pushtuesit italianë krijuan në Llakatund të Vlorës një fermë bujqësore, e cila do të plotësonte nevojat e ushtrisë. Krahas veglave të tjera të punës, të përparuara për kohën, u soll edhe një numër i kufizuar lesash hekuri¹⁰. Për të krijuar një ide më të qartë për masën e përdorimit të tyre po japim numrin e lesave të importuara nga Çekoslovakia dhe Greqia në vitet 1926-1927 dhe në vitin 1929.

10) Revista «Bujqësia» viti 1930, nr. 1, f. 16.

Lesa hekuri të importuara nga:					
Nr.	Greqia (1926-1927) ¹¹		Nr	Çekosllovakia (1929) ¹²	
1.	Delvinë	15	1.	Shijak	13
2.	Përmet	10	2.	Krujë	11
3.	Korçë	15	3.	Kavajë	95
4.	Gjirokastër	35	4.	Durrës	15
5.	Vlorë	40	5.	Tiranë	16
Shuma	115			150	

Lesat që importoheshin nga Greqia ishin të firmës «Stamatopulos», ndërsa ato që vinin nga Çekosllovakia të firmës «Ludog Becker». Nga Greqia në vitin 1926-1927 u importuan gjithsej 115 lesa hekuri, ndërsa nga Çekosllovakia në vitin 1929 erdhën 150 lesa. Ky numër lesash është shumë i vogël po të marrim parasysh se po në këto vite u importuan nga Greqia 1750 plugje hekuri dhe nga Çekosllovakia 1400. Në vitet '30 të shekullit tonë një pjesë e familjeve fshatare kishte blerë plugje hekuri, por ato nuk kishin blerë edhe lesa të tilla, sepse vazhdonin të përdornin më shumë lesat e drurit. Për t'u bindur për këtë majfton të përmendim se deri në vitin 1931 në fshatrat e Kavajës kishte 564 plugje, ndërsa lesa hekuri vetëm 70 copë¹³. Që për lesat e hekurta kishte kërkesa të pakta nga bujku shqiptar, vërtetohet edhe nga vendimi i vitit 1929 i ministrisë së ekonomisë kombëtare, e cila bën porosi për 1600 plugje dhe vetëm për 150 lesa¹⁴. Shkaqet e mosfutjes në përdorim të lesave të hekurta në fshatin shqiptar, të paktën në atë masë sa edhe plugjet, janë të shumta e të natyrave të ndryshme, por mendojmë se dy janë kryesoret: varfëria e bujkut shqiptar dhe paragjykimet e tij për veglat e reja të punës. Në dhjetëvjeçarët e fundit të pushtimit osman, bujqësia shqiptare ishte nga më të prapambeturat e Evropës. Klasat sunduese interesoheshin vetëm për të nxjerrë të ardhura nga fshatarësia, nëpërmjet taksave të shumta dhe nuk bënë asnjë investim për përparimin dhe vënien në baza shkencore të bujqësisë. Kjo prapambetje e përgjithshme e bujqësisë ndikonte drejtpërdrejt në gjendjen ekonomike të fshatarit. Është kjo gjendje e vështirë ekonomike që e ka detyruar qeverinë e kohës të marrë vendime të posaçme për shitjen e veglave bujqësore të importuara. Kështu në vendimin nr. 723 datë 19.VIII.1929 këshillohet që të gjitha veglat

11) Revista «Bujqësia», viti 1931, nr. 6, f. 73.

12) *Po aty*, f. 72.

13) *Po aty*, f. 44.

14) Revista «Bujqësia». viti 1929, nr. 10-11, f. 348.

bujqësore që do të importoheshin në këtë vit «t'u jepen bujqëve me kredi e me kiste për një kohë mjaftë të gjatë»¹⁵. Në vonesën e futjes në përdorim të lesave të hekurta ka ndikuar edhe mentaliteti i bujku. Ai në shekuj ishte mësuar të përdorte lesat tradicionale të drunjtë, prandaj përdorimin e lesave të reja e shikonte me dyshim e pasiguri njëkohësisht.

*
* * *

Si vumë në dukje edhe më lart, bujqësia jonë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit tonë kishte mbetur mbrapa në krahasim me atë të vendeve të tjera mesdhetare. Klasat sunduese nuk interesoheshin për përparimin e saj. Mungonin veglat e përparuara të punës, farërat e zgjedhura e plehrat. Në fshatin shqiptar sundonte analfabetizmi. Më shumë se 80 për qind e popullsisë nuk dinte të shkruante e të lexonte. Numri i kuadrove të përgatitura në mënyrë speciale për bujqësinë ishte i papërfillshëm. Në kushtet e mungesës së kuadrit të specializuar bujqësor vetë fshatari duhej të zgjidhte të gjitha problemet që kishin të bënin me bujqësinë në përgjithësi e me mbjelljet në veçanti. Vetë ai, duke u mbështetur në përvojën e tij, lipsej të zgjidhte farën, kohën e mbjelljes dhe të gjitha problemet e tjera.

Ndër problemet e shumta që duhet të zgjidhte bujku, duke u mbështetur në përvojën e tij, ishte përcaktimi i afateve të mbjelljeve. Përcaktimi i këtyre afateve nuk mund të bëhej në mënyrë mekanike dhe nuk ishte i njëjtë për të gjitha kulturat. Të tjera kushte tokësore e klimatike kërkonte mbjellja e të lashtave e të tjera ajo e të vonave. Në përcaktimin e afateve të mbjelljes së të lashtave dhe të të vonave detyra ishte më e lehtë për grupin e parë. Nga përvoja fshatari i çdo zone etnografike kishte përcaktuar një afat fillimi e mbarimi, sipas kushteve klimatike të fshatit ku banonte. Kështu në zonat malore e rrafshnaltat e vendit, ku klima ishte e ashpër, mbjellja fillonte mënjëherë mbas shirave të para të vjeshtës, pra në muajin shtator ose tetor. Në fshatrat e malësisë së veriut, Rrafshin e Dukagjinit, Fushën e Kosovës, Pllajën e Korçës etj., si rregull, mbjellja e grurit fillonte 6 javë para shënmitrit, pra afërsisht në dyjavorin e dytë të muajit shtator dhe vazhdonte deri sa të fillonin dëborat e para, pra deri aty nga java e parë e muajit dhjetor. Afati përfundimtar, që lidhej me rënien e dëborës së parë, ishte vetëm për ato familje që për njëjërën ose tjetrën arsye kishin mbetur mbrapa, sepse bora e parë ishte mirë ta gjente grurin jo vetëm të mbjellë, por edhe të rritur disi. Për tokat fushore, me klimë më të butë, këto afate ishin më të shtyra. Në këto zona mbjellja fillonte një ose e shumta dy javë para shënmitrit (26 tetorit) dhe vazhdonte 2-3 javë pas tij. Në këto zona kërkohej që kur të fillonte mbjellja toka të ishte shumë e lagur «aq sa bishti i kaut të bëhej me

15) Po aty, f. 348.

lerë (llucë) dhe këmba e kaut të ngecej në baltë». Mendohej se po të ishte toka e tillë, grurin nuk do ta dëmtonte pajaga (vrugu) në pranverë. Tërshëra mbillej në shtator, pas shirave të para, në kohën kur toka ishte tharë mirë, se «tërshëra është bimë qibare e nuk pranon lagështi». Mbjellja e tepës fillonte në shënmitër e vazhdonte 2-3 javë pas tij. Mbjellja e të lashtave të pranverës fillonte në muajin mars e vazhdonte edhe në prill, sipas kushteve klimatike të zonave, por gjithnjë kur kishte shkrirë bora në tokat që do të mbilleshin.

Si mund të shihet nga ato që shënuam më lart, për mbjelljen e të lashtave populli kishte përcaktuar kufij të prerë mirë. Në këta kufij kohorë kishte luhatje midis zonave malore e atyre fushore, sepse merreshin parasysh edhe kushtet klimatike. Me gjithë këto luhatje kudo kishte një pikë të mesme përcaktuese, që ishte e vlefshme si për zonat fushore ashtu edhe për ato malore. Kjo ishte dita e shënmitrit, që njihej si nga bujqit e besimit të krishter, ashtu edhe nga ata të besimit mysliman. Në zonat malore mbjellja fillonte 6 javë para shënmitrit, ndërsa në ato fushore ky afat zbriste deri në dy javë para kësaj dite. Po kështu edhe mbarimi ishte i përcaktuar mirë, veçse në kah të kundërt me atë të fillimit të mbjelljeve. Në zonat e ulta mbarimi i mbjelljeve mund të shtyhej deri në 6 javë pas shënmitrit, pra afërsisht deri në festën e Shënkollit (6 dhjetor), në ato malore ky afat shkoste deri në dy javë pas festës. Tek bujqit ishte ngulitur mendimi se koha më e mirë për mbjellje ishte periudha dy javë para e dy javë pas ditës së shënmitrit. Kush cënonte këta kufij kohorë rrezikonte prodhimin e pritshëm.

Edhe për mbjelljen e të vonave, veçanërisht të misrit që përbënte drithin kryesor ndër to, kishte një cak kohor të përcaktuar nga tradita. Këtë cak kohor e përbënte dita e shëngjergjit (24 prill). Pozicioni i tokave që do të mbilleshin dhe fakti nëse ato ishin «nën ujë» apo «mbi ujë», përcaktonte edhe kohën e mbjelljes. Në tokat që nuk kishte mundësi të ujiteshin, mbjellja fillonte pak para shëngjergjit, ndërsa në ato që mund të ujiteshin ajo fillonte në këtë festë dhe vazhdonte deri në 6 javë pas saj. Pavarësisht nga luhatjet që kishte në fillimin e mbjelljeve, mbarimi i tyre në të gjithë vendin kishte një afat të përcaktuar saktë. Ky afat maksimal ishte 24 qershori. Mbas kësaj date nuk mund të mbillej më misër, sepse në popull mendohej se ai nuk arrinte të pijej. Ky afat i përfundimit të mbjelljeve ishte ngulitur aq shumë në ndërgjegjen e popullit sa që kur shikonin ndonjë bujk të prapambetur që mbillte mbas këtij afati e pyesnin: «E, përse po e mbjellë, për lopë»? Në popull qarkullonte shprehja: «Po hyri korrik, merr pendën e ik». Përcaktimi i këtij afati lidhej me nevojat biologjike të bimës për diell e lagështi. Ai lidhej gjithashtu edhe me nevoja të karakterit praktik. Fushat mbylleshin për kullotjen e bagëtive në ditën e shëngjergjit, pak para ose pak mbas saj dhe hapeheshin për kullotë pak para ose mbrapa shënmitrit. Në kohën që lejohej kullotia e bagëtive në fushë, prodhimi duhet të ishte korrur. Në kohën kur hapej fusha për bagëti, ato mund të kullotnin kudo, bile mund të futeshin edhe në arat e rrethuara me gjerdhe. Kjo gjë nuk përbënte shkelje, sepse «bujku duhet ta kishte vjelë djersën e tij, tani e kanë radhën bagëtitë të hanë hakun e tyre». Koha e hapjes dhe e mbylljes

së fushës për bagëtitë përcaktohej gjithnjë nga mbledhja e përgjithshme e fshatit, pra me anën e sulleve.

Si vumë në dukje më lart, në popull kishte afate të përcaktuara edhe për mbjelljen e misrit, se edhe ai «ishte bimë qibare», kishte kërkesa të caktuara për temperaturën dhe lagështinë e tokës. Për këto arsye këto afate nuk mund të ishin të njëjta jo vetëm në tokat e një zone etnografike, por edhe në ato të një fshati, bile edhe të një pronari. Krijimi i këtyre dy kushteve kryesore për fillimin e mbjelljeve varej shumë nga pozicioni i tokave: disa prej tyre ishin vendosur në vende të pjerrëta e kullonin më shpejt se të tjerat që ishin në vende të rrafshëta ose në luginat midis kodrave, disa toka i zinte mirë dielli, të tjerat jo etj. Edhe të njëjtat toka, për shkak të kushteve klimatike, një vit vinin më parë për t'u mbjellë, ndërsa tjetrin më vonë. Në këtë vështrim bujku nuk mund të shfrytëzonte deri në hollësi jo vetëm përvojën e brezave të tjerë, por as edhe atë të tij, sepse koha e mbjelljes lëvizte për të njëjtën tokë nga një vit në tjetrin. Në këto kushte çdo bujk duhej të caktonte kohën për të filluar mbjelljet, duke pasur parasysh veçoritë e tokave që kishte në pronësi. Për përcaktimin sa më mirë të kësaj ai bënte një numër provash të lidhura me shënjat e jashtme të natyrës. Këto ishin të shumta e ndryshonin nga krahina në krahinë, prandaj më poshtë do të shënojmë ato më të rëndësishmet e që kanë pasur një shtrirje më të gjerë. Për një parashtrim më të mirë të tyre këto prova po i ndajmë në dy grupe: në ato që lidheshin me vrojtimin e shenjave të dukshme të natyrës dhe në ato që bënte bujku duke përdorur trupin e tij.

Në zonat e ulëta fushore e kodrinore ku rritej fiku, bujqit vërenin çeljen e gjetheve të tij. «Kur fiku çel tri llapa (gjethe) nis mbjellja e misrit», thonë fshatarët. Në zonat e larta e pllajtat e vendit si shenjë paralajmëruese për fillimin e mbjelljeve ishte çelja e gjetheve të dushkut në një kufi të caktuar të malit afër fshatit, ose shkrirja e borës në një vend të caktuar të fshatit. Këto shenja të jashtme shërbenin si paralajmërim se mund të fillonin mbjelljet, por nuk kishin vlerë për të gjitha tokat e fshatit. Në këto kushte bujku mbështetej në përvojën e tij. Ne, thonë bujqit, në kohën kur fiku kishte çelë tri fletë, ose kur dushku kishte filluar të gjelbëronte, shkonim çdo mëngjes në tokat që kishim përgatitur për mbjellje dhe prisnim që t'i zinte dielli. Nëse ugari ishte mbuluar me «fije teli» (fije merimangash), që shkëlqenin nën rrezet e diellit, atëherë toka ishte gati për t'u mbjellë, në të ardhur koha për të mbjellë, bënte edhe prova të tjera për t'u siguruar dhe fuste plorin ose hekurat e zgjedhës në një gropë dhe i mbulonte me dhé. Të nesërmen nxirrte plorin dhe shikonte. Nëse ai ishte pak «i djersitur», toka duhej mbjellë që atë ditë, sepse ajo kishte nxehtësinë e nevojshme. Në raste të tjera bëheshin prova me farë. Në të katër qoshet e arës mbilleshin nga 3-4 kokrra misri. Mbas 5-6 ditësh shikonte në arë dhe shikonte nëse kishin mbirë ose jo. Nëse kishin mbirë 2 kokrra, ai fillonte mbjelljen, por duke u kujdesur që kjo punë të fillonte nga ajo anë ku mbirjet e provës ishin më të shumta.

Nga provat me trup ose gjymtyrët e trupit që bënte bujku për të

parë nëse ugari kishte ardhur në kohë për t'i mbjellë, më të rëndësishmet ishin dy: së pari, bujku shkonte në tokën e përgatitur për mbjellje dhe merrte në dy-tre vende të saj nga një grusht dhë, dhe e shtrëngonte fort. Nëse dheu pas hapjes së grushtit nuk shkoqej, kjo do të thoshte se duhej pritur edhe disa ditë, sepse toka kishte ende shumë lagështi. Së dyti, bujku shkonte në arë dhe ulej këmbëkryq në disa vende të saj. Në qoftë se ndiente ftohtësinë e tokës, ose në qoftë se vendi ku ishte ulur ishte bërë gropë dhe dheu ishte i ngjeshur, ugari duhej lënë edhe disa ditë pa u mbjellë.

*

* * *

Përgatitja e tokës dhe gjetja e kohës më të mirë për mbjellje ishte njera anë. Ana tjetër po kaq e rëndësishme ishte zgjedhja dhe hedhja e farës.

Zgjedhjes dhe ruajtjes së farës që do të përdorej për mbjelljet e ardhshme bujku i kushtonte kujdes e vëmendje të veçantë. Ky kujdes fillonte që në periudhën e korrrjes dhe të shirjes, kur bujku pjekjes së farës. Që në kohën kur fillonte korrrjen, ai caktonte pjesët e tokës ku prodhimi ishte më i mbarë. Ndërsa sipërfaqet e mbjella me drithëra zakonisht korreshin pa arritur në fazën e plotë të pjekjes, për të mënjeluar sa të ishte e mundur më shumë humbjet, në copat e tokës të lëna për farë, korrrja bëhej kur drithërat të kishin arritur në fazën e pjekjes së plotë. Edhe në shirjen e prodhimit që do të përdorej për farë po ky kujdes tregohej. Të lashtat që do të përdorreshin për bukë zakonisht shiheshin në lëmë, duke përdorur forcën shtypëse të kafshëve. Ato shiheshin edhe me dorë, me purtekë. Edhe të lashtat që do të përdorreshin për farë shiheshin në lëmë, por këtu futeshin kafshë të pambathura, në mënyrë që të mos dëmtoheshin kokrrat. Shpesh ndodhte që të lashtat e caktuara për farë të shkoqeshin në një krehër të veçantë, që vendosej horizontalisht mbi tokë. Dorëza e të lashtave futej në dhëmbëzat e krëhrit dhe tërhiqej me forcë¹⁶. Edhe për farën e misrit po ky kujdes tregohej. Zgjidheshin kallëzat më të mirë, me kokrra të plota e rrjeshta të drejtë. Ata lidheshin me njëri-tjetrin nëpërmjet xhufkave të lëna enkas për këtë qëllim e vareshin në trarët e dhomës së zjarrit për t'u tharë e ruajtur sa më mirë prej dëmtuesve. Kur bujku shkoqte farën e misrit, kishte kujdes që të mirrte vetëm kokrrat e mesit të kallirit, duke lënë jashtë kokrrat e nuk digjej e as nuk hidhej, ashtu si ndodhte në rastet kur misri përdorej për bukë; ai mblidhej me kujdes e hidhej zakonisht në një lumë ose përrua e më rrallë edhe në pus të ujit. Si rregull kjo hedhje nuk mund të bëhej në çdo kohë, por vetëm në mëngjes, sapo kishte

16) Më gjerë shih: S. Shkurti. *Shirja e drithërave*, në «Etnografia Shqiptare». IX. Tiranë 1978, f. 57-113.

lindur dielli, ose në darkë, pak para perëndimit të tij. Hedhja e macurrit të misrit të farës në një lumë, përrua ose pus, kishte përhapje të gjërë territoriale, që nga fshatrat e Labërisë e deri në ato të Kosovës, të banuara nga popullsia shqiptare. Kur macurri i misrit hidhej në lumë, përrua, vijë uji ose pus, shoqërohej gjithnjë me shprehjen: «macurri tëposht, talla përpjetë». Më rrallë ndodhte që macurri i misrit edhe të digjej, por në këto raste ai, para se të futej në zjarr, më parë lagej me ujë. Ky veprim lidhej ngushtë me dëshirën që të rritej mirë kjo kulturë. Në mendësinë popullore ky besim lidhej me nevoja të karakterit praktik. Si dihet, misri ka nevoja të mëdha për ujë, mirëpo në të kaluarën, kur mungonin sistemet e ujitjes, bujku mendonte se, duke hedhur në ujë macurrin e misrit që do të përdorej për farë, ky veprim do të sillte shira në kohën kur bima e misrit do të kishte nevojë për ujë. Edhe ruajtja e farës, veçanërisht e farës së misrit, bëhej jo si ajo e drithit tjetër. Ajo zakonisht futej në enë të madhe druri, mbi të hidhej një shtresë hiri e pastaj mbyllej me kapak. Përdorimi i shtresës së hirit kishte karakter praktik, mbasi ai e mbronte farën nga dëmtimi i parazitëve, mizave e krimbave. Që hiri ta kryente sa më mirë funksionin mbrojtës, mendohej se ai nuk duhet të ishte nga një zjarr dosido, por nga zjarri i një dite të shënuar. Në shumë zona etnografike pëlqehet hiri i zjarrit të 24 dhjetorit. 31 dhjetorit dhe 6 janarit, pra hiri i zjarrit të solsticit të dimrit, dhe festave të tjera më të shënuara. Në Myzeqe fara spërkatej me ujin e bekuar të 6 janarit¹⁷. Në zona të tjera natën e 31 dhjetorit një enë plot me farë nxirrej e lihej jashtë shtëpisë dhe të nesërmen në mëngjes e futnin brenda saj, me mendimin që fara të rritej mirë e shtëpia të kishte gjithmonë bereqet¹⁸. Në asnjë rast fara nuk ruhej në enë metali. Mendohej se, po të veprimeve kështu, bereqeti nuk do të zhvillohej mirë, atë do ta zinte sëmundja e urthit.

Dita e parë e fillimit të mbjelljeve ishte një festë e vërtetë për familjen. Me këtë kanë qënë të lidhura një numër zakonesh e ceremonish, në themel të të cilave qëndronte dëshira për një prodhim të mbarë. Këto kanë qënë më të shumta në ditën e parë të fillimit të mbjelljes së të lashtave e më të pakta në ato të të vonave. Dhe kjo është fare e natyrshme. Të lashtat kanë qënë drithëra të vjetra, ndërsa misri kulturë relativisht e re. Kur ai u fut si kulturë arash në vendin tonë, shoqëria nuk mund të krijonte më besime e rite pagane. Ajo e kishte kaluar këtë stad prej kohësh. Është e vërtetë se edhe në mbjelljen e misrit ka pasur disa besime pagane, për këto nuk janë të tilla që të jenë krijuar enkas për misrin. Ato janë besime që kaluan nga të lashtat edhe tek misri. Kjo është kaq e vërtetë sa në asnjë rast nuk gjejmë qoftë edhe një besim a ceremoni që të jetë e veçantë vetëm për misrin dhe jo për të lashtat. Përkundrazi mjaft besime e ceremoni janë ruajtur vetëm për të lashtat, pamundur t'u përshtaten të vonavë.

17) J. Nushi: *Mitologji e besimeve në Myzeqe*, në «Etnografia Shqiptare», V, Tiranë 1974, f. 309.

18) AE, dok. 283/12, f. 157-158.

Në pjesën dërrmuese të fshatrave të vendit nxjerrja e farës nga shtëpia për në oborr shoqërohej me disa ceremoni të cilat në themel kanë qënë shfaqje të besimeve pagane. Gruaja, zonjë shtëpie, që duhet të nxirrte farën, kujdesej që ta spërkaste atë me pak mjaltë, qumësht e në kohët më të vona edhe me sheqer. Ajo kujdesej gjithashtu që në thesin e farës të fuste një gozhdë a një copë hekur, një hudhër e një kokërr shegë. Në mjaft fshatra në thesin e farës fusnin edhe një grusht me arra. Në fshatrat e Myzeqesë në shportën e farës futej edhe një kokërr hudhër në të cilën kalonte përmes një gozhdë¹⁹. Në fshatrat e Labërisë kokrra e hudhrës varej jashtë thesit të farës. Pra hudhra ka qënë gjithnjë e pranishme në farë, pavarësisht nga ndryshimet e vogla krahinore. Të gjitha veprimet e mësipërme, që kryente gruaja para nxjerrjes së farës në oborr, bëheshin me paramendime të caktuara. Spërkatja e farës me mjaltë, qumësht a sheqer bëhej për të ëmbëlsuar e marrë me të mirë demonin e farës, në mënyrë që ai të linte të zhvillohej mirë. Futja e një gozhide a e një cope hekuri në thesin e farës llohej me kultin për këtë metal, që fara të ishte e fortë e të mos dëmtohej nga parazitët. Që ka ndodhur pikërisht kështu, vërtetohet edhe prej një formulë stereotipe që shqiptonte gruaja tri herë rrjesht kur fuste copën e metalit në thesin e farës. Ajo thoshte «Nëse e hëngërt miza (miu, shpendi) këtë gozhdë, aq e hëngërt edhe farën». Shëga futej me paramendimin që fara e grurit të mbinte dendur ashtu si kokrra e shegës. Ndërsa arrat që bima të rritej e shëndetshme dhe kokrrat e saj t'i ngjanin në madhësi asaj të arrës. Këtë dëshirë e vërtetojnë edhe fjalët «të bëhet gruri sa arra», që thoshte gruaja kur i fuste ato në farë. Hudhra ka qënë përdorur për ta mbrojtur prodhimin nga syri i keq. Në fshatrat e Malësisë së Madhe farën, para se ta mbillnin, e kalonin përmes një guri të brimuar, nëpërmjet të cilit më parë kishin shikuar diellin²⁰. Këtu shihen qartë kultet për gurin dhe për diellin.

Gruaja që merrej me përgatitjen e farës dhe personat e tjerë që do të punonin në mbjellje, atë ditë duhet të ishin të pastër, të lartë e të ndërruar. Sipas mendësisë popullore, pastërtia e personave që do të punonin në mbjellje ishte një domosdoshmëri që do të përcaktonte edhe mbarësinë e prodhimit. Nëse bujku nuk do të ishte i pastër, farën do ta hante miza dhe krimbi. Edhe në nxjerrjen e sendeve të domosdoshme që do të merrte bujku me vete kishte një radhë të përcaktuar. Së pari nga dera e shtëpisë dilte thesi i farës, pastaj një bukë rituale që do të thyhej në brirët e qeve kur të fillonte mbjellja dhe në fund nxirrej plori dhe hekurat e zgjedhës. Gratë e shtëpisë kishin kujdes që të mos jepnin asgjë hua tek të afërmit e komshinjtë gjatë gjithë kohës së mbjelljes, se ndryshe mendohej se «ikte prodhimi nga ara». Gjithashtu ato kujdeseshin që thesi i farës të mos kishte të çara, prej të cilave të derdhej fara, se ndryshe prodhimi do të dëmtohej.

19) J. Nushi: *art. cit.*, f. 311.

20) A.E., *Doke të ndryshme, besime e bestytëni*, f. 133.

Nxjerrja e farës në oborr shoqërohej me një ceremonial magjik. Kur ajo nxirrej nga dera, para saj dilte një grua me një pëlhurë të bardhë. Mendohej se kjo do të sillte mbarësi në prodim. Gjithashtu «përgjakej» fara. Kjo do të thoshte se atë ditë therej një pulë ose një gjel mbi shtizën e parmendës, nën të cilën vendosej thesi i farës. Gjaku i pulës ose i gjelit detyrimisht duhet të binte mbi farën që do të mbillej. Në thesin e farës futeshin këmbët dhe koka e shpendit të therur, që mbuloheshin në hullinë e parë. Qëllimi i këtij veprimi ka qënë fare i qartë. Demonit të farës dhe atij të arës u bëhej një flijim për t'i marrë me të mirë. Ky flijim në ditën e parë të mbjelljeve ka qënë në të gjithë vendin, por është ruajtur deri vonë në Rrafshin e Dukagjinit, në Drenicë, në Fushë Kosovë, në Kaçanik dhe në Gorë e Opojë²¹. Gjeli a pula zakonisht therej brenda murit rrethues të banesës, por më rrallë ky veprim bëhej edhe në krye të arës që do të mbillej. Ky flijim destinohej vetëm për demonin e farës, andaj në popull ai quhej edhe «pula e farës».

Edhe fillimi i mbjelljeve lidhej me një ceremonial magjik. Ai lidhej ngushtë me marrjen më të mirë të demonit të tokës. Ndër praktikat me karakter magjik na ka tërhequr vëmendjen një formulë që përsëritej tri herë, para se bujku të niste mbjelljen. Kur ai kishte mbrehur qetë në zgjedhë, drejtohej nga ara që do të mbillte dhe shqiptonte me zë të lartë:

O i zoti i arës
Lëshoi vendin farës!

Këtë formulë e kemi ndeshur në fshatrat e Shqipërisë së Veriut dhe në ato të Labërisë. Si mund të kuptohet, populli mendonte se çdo tokë kishte demonin e vet, që ishte zotëruesi i saj. Me këtë paragjykim janë të lidhura dhe të gjithë flijimet që bëheshin në fillim të mbjelljeve. Për këto flijime ne kemi dhënë material më të plotë në një tjetër vend²², por këtu do të shënojmë edhe ndonjë shembull të ri. Në disa fshatrat të Skraparit, të Përmetit e të Leskovikut, kur fillonte së pari mbjellja, ishte zakon të pritej një degë ferre me gjatësinë e trupit të njerit ka. Këtë degë e futnin në hullinë e parë duke shqiptuar vargjet:

Siç i ngjitet ferra dheut
Të mos i shqiteç edhe ti dheut²³.

Si shihet, këtu i bëhet thëror demonit të tokës një degë ferre e gjatë sa trupi i kaut. Pra kemi të bëjmë me një flijim jo të përgjakur. Vetë fakti se dega e ferrës duhet të ishte sa shtati i kaut, të lë të kup-

21) U. Xhemaj: *Relike e besime pagane e totemike në Gorë e Opojë*, në «Gjurmime albanologjike-folklor etnologji» IX, Prishtinë 1979, f. 102.

22) S. Shkurti, *Parmenda në mite, rite e besime pagane*, në «Etnografia Shqiptare» 12, Tiranë, 1983, f. 37-50.

23) AIKP: Dosja Xh. Veizi, f. 5.

mbjelljeve. Sipas të dhënave të mbledhura në terren pëlqej për fillim më shumë dita e hënë, si ditë më e mbarë e pastaj dita e diel dhe e enjtja. Në shumë pak raste pëlqej edhe dita e shtunë. Është me interes të vemë në dukje se ditët: e martë, e mërkurë dhe e premte nuk dalin në asnjë fshat si ditë të pëlqyera për të filluar mbjelljen. Nga ditët e pëlqyera mendimi është shumë i ngatërruar për ditën e enjte. Diku ajo shënonte mbarësi e diku tjetër prapësi, sepse mendohej se po u mboll në këtë ditë bereqetin e vret breshri. Në Myzeqe ditën e enjte e mbanin si ditë të kremte e nuk dilnin në ara²⁴. Nga përhapja territoriale duket se ky mendim ka qenë i përgjithshëm, por si duket nga nevoja praktike ka ardhur duke u kufizuar. Në Rrafshin e Dukagjinit nuk fillonin mbjelljen tri të enjte midis shëngjergjit plak e shëngjergjit të ri²⁵. Në fshatrat e besimit ortodoks e enjtja quhej si ditë e shkretë. Në disa fshatra të besimit mysliman nuk dilnin në ara vetëm një të enjte të prillit, ndërsa në të tjerat punonin. Këtë dukuri e ka vënë re edhe Sh. Gjeçovi për pjesën veriore të vendit. Ai shënon se «gjastë të enjte para të kremtes së shëlbuesit nuk preket punë e rëndë me dorë, sidomos në punët bujqësore²⁵».

Mbasi kishte kryer të gjitha këto veprime, bujku fillonte mbjelljen. Fara e drithrave shpërndahej në dy mënyra: *me të hudhshme* e *me të shtime*. Këto janë emërtimet më të përgjithshme; sepse në zona etnografike të ndryshme ka pasur edhe emra të tjerë. Kështu për mënyrën e parë të shpërndarjes së farës janë përdorur edhe emërtimet: *fluturim* (Shqipërinë e Veriut, Kosovë), *fërsht* (Çamëri), *përmbi dorë* (Shqipëria e Jugut). Për mënyrën e dytë përdorehin edhe emërtimet *nën dorë*, *kokërr nga një kokërr*, *për vijë* etj. Mënyra e parë e shpërndarjes së farës ishte karakteristikë për të lashtat, por ajo përdorej edhe për shpërndarjen e farës së misrit, veçanërisht në ato raste kur tokat kishin pjerrësi, ose kur bujku për një rënë ose tjetrën arsye ishte vonuar në mbjellje. Forma e dytë e shpërndarjes së farës ishte karakteristikë vetëm për misrin e nuk përdorej për të lashtat. Në formën e parë shpërndarjen e farës mund ta bënte edhe vetë bujku që ngiste qelë, e dyta kërkonte detyrimisht edhe një person tjetër që të shkonte mbas bujku e të hidhte farën. Farën e grurit si rregull duhet ta hidhte një burrë, që të kishte përvojë, sepse ajo duhej shpërndarë mbi sipërfaqen e arës në mënyrë të njëtrajtshme, në mënyrë që «në çdo gjurmë kau të binin vetëm tri kokrra farë», ndërsa farën e misrit e hidhte zakonisht një vajzë ose një grua. Fara e grurit shpërndahej më parë në një parcelë ose *spuar* të caktuar, pastaj fillonte bujku punën për ta mbuluar. Fara e misrit hidhej në vijë, dmth., bujkun që punonte e ndiqte pas një grua që shpërndante farën kokërr e nga një kokërr. Mënyra e parë e shpërndarjes së farës është më e hershme. Ajo është e dokumentuar së paku që nga fillimi i shekullit XVIII. Në kishën e Shënkollit në Voskopojë në një pikturë murale, të bërë prej David Selenicës, është dhënë shpërndarësi i farës së grurit. Ai mbante të he-

24) J. Nushi, *art. vit.*, f. 312.

25) «Bota Shqiptare», Tiranë 1943, f. 65-66.

dhur krahëqafë një torbë leshi të mbushur me farë dhe me dorën e djathtë shpërndan farën e grurit (Fig. 6). Edhe në mbajtjen e farës para shpërndarjes kishte ndryshime midis të lashtave dhe të vonave. Fara e të lashtave mbahej në një torbë leshi, ose në një hejbe, fara e misrit ruhej në një shportë në formë konike, që përfundonte në fund me një majë, e cila kishte funksion praktik. Kur gruaja që hidhte farën priste pendarin, shportën e farës nuk e mbante në dorë, por e ngulte në ugar (Fig. 7).




Fig. 6




Fig. 7

Shënuam më lart se shpërndarja e farës së të lashtave bëhej me spuar (parcela) ose lehe nga vetë bujku, ose një person tjetër me përvojë. Mbas shpërndarjes bujku e punonte tokën cekët me parmendë e mbi të pastaj kalonte lesën e shkurreve për ta mbuluar më mirë farën e për ta dystuar tokën. Mbasi mbaronte spuarin (lehen) e parë hap-

te me parmendë një vijë të thellë rreth 15-20 cm, e cila ndante lehet nga njëri tjetri e shërbente njëkohësisht për largimin e ujërave nga ara e mbjellë. Mbase mbarohej plotësisht së mbjelli një spuar, fillonte i dyti e kështu me radhë deri sa ara të mbarohej plotësisht. Për mbjelljen e misrit ndiqeshin dy mënyra: *mbjellja me të çelta* (rrjesht) dhe *mbjellja me qorre* (ngaraz). Në mënyrën e parë një vijë ishte me farë dhe e dyta bosh, për ta mbuluar atë. Në të dytën një vijë ishte me farë dhe pastaj dy të tjera bosh. Në mënyrën e parë largësia midis hullive me farë ishte 17-20 cm., në të dytën 30-35 cm. Në të dy rastet hedhjen e farës e bënte një grua ose vajzë e më rrallë edhe fëmijë ose burra të moshuar. Kur hedhësja e farës ishte nuse, ajo duhej të vishej me kostumin e nusërisë. por duke mos përdorur zbukurueset e qafës e të gjoksit. Ky ishte një rregull i përgjithshëm dhe kishte një shtrirje mbarë shqiptare. (Fig. 8). Kur misri mbillej *me të çelta*, he-



Fig. 8

dhësja e farës shkonte mbas bujkut, duke hedhur farë në hullinë që hapte ai. Gjatë kthimit ajo ndiqte bujkun, por pa hedhur farë, sepse në këtë rrugë ai mbulonte vetëm farën e hedhur në rrugën e parë. Ndodhte shpesh që në mbjellje të punonin dy pendë qe. Edhe në këto raste për hedhjen e farës shërbente vetëm një person, i cili shkonte mbas pendës së parë dhe farën që hidhte ai e mbulonte penda e dytë. Pra edhe në vajtje edhe në kthim hidhej farë. Në këtë mënyrë mbjell-

jeje farë hidhej gjithnjë në hullitë teke, pra në hullitë 1. 3, 5, e kështu me radhë. Në mbjelljen qorre gruaja hidhte farë në hullinë e hapur nga bujku dhe kur arrinte në fund priste aty. Bujku me pendën e qeve në kthim mbulonte farën e pastaj bënte një hulli boshe, derisa arrinte në fund të arës e pastaj, kur kthehej në hullinë e re që hapte, hidhte farë.

Misri zakonisht mbillej i shoqëruar me fasule, kunguj, bostan e fshesë. Në mënyrë të veçantë misri shoqërohej me fasule. Për këtë arsye në popull qarkullonte shprehja: «Ara e mbjellë me misër të jep edhe bukë edhe gjellë, ndërsa ajo e mbjellë me grurë le që gjellë s'të jep, por të le edhe pa bukë». Nga fasulet e mbjella në shoqërimin me misër, në vitin 1934 u morën 26,982 kv, në vitin 1936 u morën 39.262 kv.²⁶ Kur misri shoqërohej në mbjellje me fasule, përdorehin tri mënyra: së pari, bujku sasinë e fasuleve që do të përdorte për farë e shpërndante «me të hudh», një lloj sikur do të mbillte grurë e pastaj vazhdonte mbjelljen e misrit me hulli. Së dyti, fara e fasules përzihej me atë të misrit, por gjithnjë në përpjestimin 1:5 ose 1:6. Së treti fasulet mbilleshin në vijë, ashtu si edhe misri, por duke hedhur fasule vetëm në çdo tre rreshta me misër. Kur mbilleshin kunguj e pjepra në shoqërim me misrin fara e tyre përzihej me atë të misrit, por duke u kujdesur që në një thes me farë misri të hidhej jo më shumë se një dorë farë kungulli e po kaq pjepri. Me misër mbillej edhe fshesë. Në këto raste ajo mbillej në qoshe të arave, ose në çdo 5-6 rrjeshta misër mbillej një me fshesë.

Dita e mbarimit të mbjelljeve ishte festë për familjen. Mbarimi i kësaj pune shoqërohej me një numër zakonesh, që lidheshin me ruajtjen e prodhimit. Në fshatrat e Labërisë e të Çamërisë, posa mbaronte mbjellja, bujku nxirrte plorin prej parmendës dhe e godiste atë me forcë, që të bënte sa më shumë zhurmë. Në fshatrat e Vurgut dhe të Çamërisë për këtë qëllim përdornin edhe enë të tjera metali. Kur i pyet fshatarët për këtë veprim, të thonë se me këtë zhurmë donin t'u jepnin lajmin bujqëve të tjerë se i mbaruan mbjelljet. Sigurisht këtu ka mbetur i gjallë kuptimi praktik i veprimit, por ne mendojmë se prapa tij fshihet edhe një kuptim magjik. Posa mbaronte mbjelljen e misrit, bujku kujdesej që në mes të arës të vinte një kryq prej druri. Pëlqehet më shumë druri i krekëzës, por edhe ai i shelgut. Në fshatra të veçanta në vend të kryqit vinin vetëm një copë dru, të gjatë rreth 1 m. Në të dy rastet drurit i zhvishej lëkura, prandaj quhej edhe «bardhëza». E njëjta gjë bëhej edhe në arat e mbjella me grurë, por jo kur mbaronin së mbjelli, por në ditën e shëngjergjit. Bujqit e arsyetojnë vendosjen e «bardhëzave» me nevoja të karakterit praktik, që udhëtarët e çobenjtë ta dallonin nga larg se toka ishte mbjellë, prandaj të mos kalonin mbi të e të mos lejonin futjen e bagëtisë. Këto kanë pasur edhe karakter magjik. «Bardhëza» kërkohet të ishte prej dru krekëze, e cila në mendësinë e popullit ka aftësinë të largojë syrin e keq, pra

26) «Statistika e prodhimit bujqësor në vitet 1935-1936», Tiranë, 1936, f. VI, VII.

të mbrojnë prodhimin. Ato viheshin në arat e grurit kur ai ishte zhvilluar mirë e rreziku nga dëmtimet ishte më i vogël, sepse në këtë kohë fusha mbyllej për bagëtinë, dmth, ato nuk lejoheshin të kullotnin më në të. Në darkën e mbarimit të mbjelljeve organizohej një gosti në familje, në të cilën merrnin pjesë dhe të afërm e gjitonë. Në familjet me gjëndje relativisht të mirë ekonomike për këtë darkë therej «mish për hell», pra një bagëti e imët, ndërsa në të tjerat therej një pulë a gjel. Kurhani ishte i detyrueshëm për çdo familje. Në fshatrat e Labërisë kjo gosti ishte «daveti i toprakut, i qeve dhe i krahëve të bujkut». Ç'është e vërteta në shekullin tonë kjo gosti organizohej më shumë kur mbaronte së mbjelli misri, se sa për grurin. Kjo ndodhte vetëm për rolin më të rëndësishëm që luante ai në sigurimin e bukës.

Mbas mbjelljes, në të lashta kryheshin fare pak shërbime. Në fund të muajit prill ose në fillim të majit kryhej tëharrja, dmth., shkuleshin me dorë barërat e këqia, që kishin mbirë së bashku me grurin. Tëharrja ishte shërbimi i fundit që bëhej në të lashta para korrjes. Në fshatrat e zonave kodrinore e fushore, kur gruri në muajin shkurt e mars ishte rritur shumë, futnin në të kopetë e qëngjave, të cilët hanin vetëm majat, duke penguar kështu atë zhvillim të parakohshëm dhe njëkohësisht plehronin arat e mbjella. Me misrin puna ndryshonte. Atij i bëheshin zakonisht tri prashitje e po kaq ujitje. Prashitja e parë bëhet kur ai kishte nxjerrë tri llapa (fletë), e dytë kur lartësia e tij arrinte në lartësinë e gjurit të këmbës së bujkut dhe e treta kur lartësia e tij arrinte deri në mes. Në popull kjo prashitje ngihej edhe me emrin mbushje. Me prashitjen e misrit merreshin më shumë gratë se sa burrat. Ata që prashitnin kishin gjithënjë kujdes që, para se të fillonin punën, të shkullnin tri bimë misri e t'i vinin ato në mes, përmbra. Mendohej se duke vepruar kështu do të ndihej më pak lodhja e mesit nuk do t'u dhimbe.

*
* *
*

Nga i gjithë materiali që parashtruam më lartë shihet mirë se edhe në procesin e mbjelljes në popull ruhet një traditë e pasur, që vjen e transmetuar nga shekujt. Mjaft zakone e tradita, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me të lashtat, janë krijuar në mugëtirë të historisë dhe kanë ardhur deri në ditët tona, sigurisht të ndryshuara e të transformuara nga koha. Disa prej tyre ruajnë përmbajtjen fillestare të kohës kur janë krijuar, si ka ndodhur me flijimet që i bëheshin demonit të tokës dhe të farës, ndërsa zakone të tjera kanë humbur kuptimin e tyre fillestar gjatë rrjedhjes së kohës. Në të dy rastet këto zakone janë ruajtur të gjalla në shumë fshatra e zona të vendit, veçanërisht në ato kodrinore e malore, ku zhvillimi i përgjithshëm ekonomik e shoqëror kishte mbetur relativisht më mbrapa. Shumë prej këtyre zakoneve janë ruajtur deri në vitet '50 të shekullit tonë e në zona etnografike të caktuara deri në mesin e viteve '60. Në këtë drejtim marrëdhëniet më të kaluarën u ndërprejnë përfundimisht me kolektivizimin e plotë të bujqësisë, që i hapi rrugë futjes së njohurive

shkencore bashkëkohore. Me gjithë këtë nuk mund të themi se zakonet e besimet pagane janë zhdukur plotësisht. Ato jetojnë ende në mendësinë e të moshuarve e në raste më të rralla zbatohen në punimin e mbjelljes e kopshteve vetiake.

Si kemi shënuar, edhe më lartë, në procesin e përgatitjes së tokës dhe mbjelljes populli ynë përdorte një numër veglash pune, që ishin krijuar enkas për këtë qëllim. Mënyrat e ndryshme për shpërndarjen e farës, lesat e rënda, që përdoreshin për thyerjen e plisave, lesat e lehta për mbulimin e farës, koshi i farës apo tokmaku janë përdorur në të kaluarën, por ato ende vazhdojnë të përdoren edhe sot, veçanërisht në copat e vogla të tokës në zonat malore, ku mjetet e mekanizuara e kanë të vështirë të hyjnë. Këto vegla pune kanë variuar nga një zonë etnografike në tjetrën, duke ju përshtatur gjithënjë kushteve tokësore, por gjithashtu duke vazhduar edhe traditën. Ndryshimet krahinore midis këtyre veglave janë jo të rëndësishme, të dorës së dytë, ndërsa afritë janë shumë më të mëdha, qoftë në formë, qoftë në emërtim, që shpesh herë është mbarë shqiptar.

Edhe të dhënat që parashtruam më lartë, krahas të tjerash, hedhim dritë mbi atë se populli ynë në të kaluarën e afërt e të largët ka pasur në bazë të jetës së tij bujqësinë, krahas aktiviteteve të tjera ekonomike. Dhe kjo është krejtësisht e natyrëshme. Vetëm një popull bujqësor mund të krijojë vegla pune të veçanta për procese pune, mund të krijojë zakone, tradita e besime për tokën e farën. Këto zakone e besime u futën thellë në mentalitetin e psikologjinë e fshatarit, aq sa u bënë pjesë e jetës së tij të përditshme. Ato hynë aq thellë në mënyrën e të jetuarit sa që kaluan vargun e shekujve dhe erdhën të gjalla deri në ditët tona. Një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm tek një popull bujqësor, si ka qenë populli ynë.

SOWING OF BREAD GRAINS

Sowing of cereals occupied an important place in the agricultural pursuits. The Albanian farmer had a great individual and collective experience in the preparation of the soil for sowing and throwing the seed. Apart from the skill in making work tools, this experience included a number of customs and traditions, which were permeated by the desire for abundant yields. On the basis of rich material collections, the author makes a detailed analysis of the preparation of the soil for early and late sowing, harrowing, selection of the most appropriate time for the throwing of the seed, services for the crops, etc.

From the analysis of the sowing of bread grains, the author reaches the conclusion that many customs and traditions, especially those that have to do with cereals, were created in the darkness of history and have come down to recent times, of course, in a changed and transformed shape. Some of them have preserved the initial content of the time when they were created, as in the case of the sacrifices rendered to the demon of the soil and seed, whereas, other customs have totally lost their initial significance.

In the process of the preparation of the soil and of the sowing, a number of work tools, particularly made for this purpose, were used. The manners of seed throwing that are mentioned above, the heavy harrows for breaking up ground after ploughing, the light harrows for covering, the seed, the ram, the special basket that contained the seed, etc., were characteristic of the past, but they continue in use down to our days, especially, in the small plots in the mountainous and hilly zones, introduction of mechanized means is difficult. These work tools vary from one ethnographic zone to the other. There have not been significant differences among the zones, whereas their similarities have been greater, either in form or in names, which are often all-Albanian.

The data presented in our study throw light on the fact that, alongside other economic activities, in the past our people's main pursuits was agriculture.

Drita STATOVCI
(Prishtinë)

ZEJA E NALLANEXHINJVE NË KOSOVË*

Për të kaluarën e kësaj zejeje dimë fare pak, sepse në burime dhe në literaturë nuk kemi gjetur të dhëna statistikore e dokumentare me ndihmën e të cilave do të mund të ndriçonim gjendjen e kësaj mjeshtrie në kohët e shkuara. Edhe ato të dhëna të pakta nuk çojnë më larg se fundi i shek. XIX e fillimi i shek. XX.

Sidoqoftë, zeja e nallanexhinjve, gjykuar sipas tregimit të njerëzve të moshuar, që herët ishte mjaft e zhvilluar në krahinën tonë, gjendej në një shkallë zhvillimi më të lartë se sot. Gati çdo qendër e rëndësishme urbane kishte së paku nga një punishte nallanexhinjsh. Nallane tipash të ndryshëm për gra, burra e fëmijë punoheshin rëndom me dru ahu. Për çdo lloj ose tip nallanesh ekzistonte emër i veçantë, sikurse ekziston edhe sot. Ndër to po përmendim nallanet e shquara, «me sedef» ose «sedefi», të cilat prej kohësh, nuk punohen më në krahinën tonë. Tipat e tjerë edhe sot punohen dhe për to do të flasim më vonë. Nallanet me sedef zbukuroheshin me pllakëza sedefi me teknikën e ngulitjes. Sipas traditës që ende gjallon, nallanexhinj që punonin nallane të zbukuruara me pllakëza të sedefta kishte në Prishtinë, Prizren dhe Vuçitern. Këto ishin pajisje të detyrueshme për hamamet (banjat publike) turke. Gratë e pasanikëve bënë gara se cila do të ketë nallane më të bukura.

Mirëpo, zbukurimi i nallaneve me sedef u braktis e u zhduk nga fundi i shekullit XIX. Janë gjetur vetëm nja dy palë nallane të këtij lloji në Prishtinë, që sot ruhen në koleksionet e Muzeut të Kosovës në Prishtinë, çka dëshmon se mjeshtër të këtillë kishte edhe në këtë qytet.

Në bazë të informatave të marra në terren, mund të vërehet se kjo zeje në të kaluarën ishte e përfaqësuar gati në të gjitha qendrat e mëdha të Kosovës.

* Punimi është marrë nga «Gjurmime Albanologjike — folklor dhe etnologji», nr. 12, Prishtinë, 1982, f. 91. Botohet me disa shkurtime.

Këtë zeje shpeshherë e hasim të kombinuar me zeje të tjera. Fjala vjen në të kaluarën, sikurse edhe sot, nallane punonin dhe punojnë jo vetëm zejtarët nallanexhinj të «pastër», por edhe zejtarë siç janë çibukçinjtë, zdrukthëtarët dhe fshatarët e viseve malore të Kosovës. Kështu në ca qendra tona kishte zejtarë dhe punishte dyjare: çibukçinj-nallanexhinj ose anasjelltas, nallanexhinj-çibukçinj¹.

Në vitet 1945, 1948 e deri më 1957 në Prishtinë kishte zejtarë dyjarë: nallanexhinj dhe çibukçinj².

Në dokumentet burimore³ shihet se në vitet tridhjetë të shekullit tonë ekzistonin një numër dyqanesh zejtare të nallanexhinjve, si për shembull: në territorin e Odës Zejtare të Prishtinës (në periudhën 1919-1941) ekzistonin 2 dyqane nallanexhinjsh, në atë të Mitrovicës (më 1932) 1 dyqan, të Prizrenit (1919-1941) 5, të Ferizajt, (1919-1941) 5 dhe të Pejës (më 1977) 1 dyqan. Në regjistrin e Odës Zejtare të Prishtinës (për periudhën 1910-1954), ekzistonin 6 dyqane nallanexhinjsh⁴.

Disa shënime të marra në terren⁵ gjatë viteve 1958-1959 dhe 1960, ndihmojnë mjaft për të ndriçuar gjendjen e kësaj zejeje në të kaluarën jo fort të largët. Sipas këtyre të dhënave në Vuçitërnë, «në kohën e turkut» punoheshin nallane me sedef, kurse në Prizren ekzistonte një dyqan për nallane në pjesën e çarshisë që quhej «nallanexhillëk», në anën perëndimore të hamamit të lashtë që ekziston edhe sot.

Pikërisht në vitin 1960 në qendrat e Kosovës kishte pak dyqane nallanexhinjsh, ngase nallanet i punojnë fshatarët e viseve malore dhe i nxjerrin për shitje ditëve të pazarit nëpër qytet. Është vërejtur se në këtë vit punëtori nallanexhinjsh ekzistonin: në Prishtinë 3, në Gjakovë 2, në Kaçanik 1, në Ferizaj 1 dhe në Gjilan 1 — pra, gjithsej 8. Prej 3 punishteve të nallanexhinjve të evidentuara atëherë në Prishtinë, konstatoam se sot ekziston vetëm një. Mjeshtri i saj më parë ishte nallanexhi fshati dhe pastaj, pas luftës, u shpërngul dhe erdhi në Prishtinë.⁶ Ai deklaroi se zejen e tij do ta trashëgojë i biri i tij. Me gjasë kjo zeje me një modifikim të vogël të prodhimeve, do të ruhet e do të jetojë edhe për një kohë të caktuar.

Në bazë të rezultateve të gjurmimeve tona në terren del se sot në Krahinën tonë ekzistojnë ende disa punishte të nallanexhinjve. Kemi vërejtur se nallanexhinj, me dyqan publik ose që punojnë në shtëpi, sot gjenden: në Prishtinë 3, në Podujevë 1, në Gjilan 1, në Prizren 1, në Gjakovë 1, në Ferizaj 1, në Pejë 1 — pra, gjithsej 9 zejtarë nallanexhinj. Gjendja e sotme (1981) numerike me atë të vitit

1) Kadri Halimi, *Çibukdžijski zanat na Kosovu i Metohiji*. «Glasnik Muzeja Kosova i Metohije» (GMKIM) III, Pristina 1956, 131.

2) *Po aty*, 133-134

3) Arkivi i Kosovës (AK), *Fondi i odave zejtare të Mitrovicës, Prizrenit, Ferizajt, Pejës dhe Prishtinës (regjistrat)*.

4) AK, *Fondi i Odës Ekonomike Krahinore (OEK), Regjistri i dyqaneve zejtare në Prishtinë (1950-1954)*; inv. nr. 12. fletët 20-55, dhe 60-80.

5) Shënimet e marra në terren në vitet 1958, 1959 dhe 1960 janë të K. Halimit, i cili ia la në dispozicion Arkivit të Institutit Albanologjik të Prishtinës.

6) *Po aty*, f. 135.

7) Me kërkimet tona në terren përkojnë edhe të dhënat në «Rilindja», dt. 14.XII.1978.

1960 është pothuajse e njëjtë — 9 kundrejt 8. Mirëpo, doemos duhet theksuar se është shumë vështirë të gjendet numri i saktë i këtyre zejtarëve, ngase nuk kanë gjithherë dyqane publike, por punojnë pranë shtëpive. Prandaj, ky numër nuk mund të jetë bazë mbështetëse për ndonjë vlerësim ekonomik dhe hapësinor të shkallës së kësaj zeje dhe të shpërndarjes së saj në krahinë.

Është e domosdoshme që këtu të ceket edhe dukuria se këta mjeshtër rëndom janë me kualifikime të degës së zdrukthëtarisë, sepse kjo mjeshtëri nuk konsiderohet si zeje e veçantë e nallanexhinjve, për të cilën duhet dhënë provim me një specializim kaq të ngushtë. Ndaj, këta edhe nuk janë thjesht vetëm nallanexhinj, ndonëse kryesisht punojnë nallane. Pas nallaneve këta mjeshtër punojnë edhe sende e vegla të ndryshme të drunjta siç janë: sofrat, tëholluesit, djepat e fëmijëve, lodra të drunjta për fëmijë, funda buke e dërrasa mishi, zgjedha, boshta e shtiza për tjerrje e dredhje, tërfurq, lopata, bishta për vegla të ndryshme dhe ca të tjera.

*
* *

Punishtet ose punëtoritë e nallanexhinjve vetë mjeshtërit i quajnë rëndom dyqan ose edhe dugajë. Ato gjenden zakonisht në qendrat më komunikative të qyteteve të Kosovës. Për nga karakteristikat arkitektonike nuk dallojnë prej punishteve të zejtarëve të tjerë. Punishtet e nallanexhinjve janë ndërtime relativisht të reja, të ngritura pas çlirimit e këndeje. Pra, nga këto punishte, s'ka mbetur asgjë arkaike, kështu që nuk vlen t'i përshkruajmë detajisht e në hollësi. Këto janë dyqane të rëndomta dhe zakonisht kanë dy mjedise. Mjedisin ku ekspozohen dhe shiten punimet dhe ku kryhen disa faza më të ndieshme të prodhimit të punimit të produkteve. Kjo pjesë gjendet në anën e përparcesit të punimit të produkteve. Nga rruga, pjesa tjetër është në anën e pasme dhe e ndarë me një paravan ose zdakt ose thjesht me perde. Aty, në pjesën e pasme, që njëherazi shërben edhe si depo (mjeshtri i Prishtinës i thotë magazinë), mjeshtërit mbajnë lëndën e parë, kryejnë punë të zakonshme paraprake dhe ai që ka, mban makinat prerëse motorike. Meqë mungojnë qendrat pengat tradicionale, nallanexhinjtë i ekspozojnë produktet në rafte pranë dritareve që këqyrin nga rruga.

Ka nallanexhinj që nuk kanë punishte publike në qytet, por i kanë në oborret e veta pranë shtëpive. Janë këto mjedise të lloj-llojshme me dy ose me vetëm një ndarje, por ka edhe asosh që gjenden vetëm nën çati (u thonë poslome). Kur janë me dy mjedise, edhe për to vlen ajo që thamë për punishtet publike.

*
* *

Për zejen e nallanexhinjve lëndë e parë kryesore është druri i ahut. Për nallanet rrallë përdoret edhe bliri (Pejë), sepse nallanet prej tij janë shumë të lehta. Druri i arrës, thonë mjeshtërit, është më i miri, por edhe më i shtrenjti (Gjakovë), ndaj edhe nuk përdoret më.

Nallanexhinjtë e qendrave të ndryshme urbane lëndën e parë, drurin e ahut, e sigurojnë dhe e blejnë prej fshatarëve të viseve malore. Kështu nallanexhinjtë e Prishtinës, të Podujevës e të Vuçiternës drurin e blejnë prej fshatarëve të viseve malore. Llapashticës, Këçikollës dhe të fshatrave të tjera të Llapit e Gollakut, ata të Gjilanit prej malësisë së Gollakut të Kamenicës, ata të Prizrenit prej Budakove e Masiteve, Mushtishti etj, ata të Gjakovës prej Batushe e Juniku, të Mitrovicës prej Shalës së Bajgorës, Peja prej Rrugovës dhe anës së Suharekës dhe kështu me radhë. S'duhet lënë pa përmendur se nallanexhinjtë më së shumti e preferojnë ahun prej Budakove (Prizreni, Gjakova, Peja, Ferizaji etj.), por nuk e dijnë shkakun. Ndoshta është prej cilësisë më të lartë.

Drutë i sjellin fshatarët me qerre ose kuaaj, të prera me gjatësi prej një metre. Më parë fshatarët drutë i binin të prera nga një metër e të latuara në të katër anët, por tash, i sjellin të papunuara. Në kohët më të reja nallanexhinjtë drurin e blejnë edhe në depot e qytetit.

Veç drurit të ahut që përdorin për nallane, këta zejtarë përdorin edhe lloje të tjera druri për sende të tjera që punojnë. Kështu për lodra fëmijësh përdorin breun dhe pishën, për zgjedha frashrin.

Pos drurit nallanexhinjve u nevojiten edhe materiale të tjera: ngjyrë, rripa dhe thumba. Për zbukurimin e nallaneve me bojë, përdorin tri ngjyra: të gjelbrën, të kuqen dhe të verdhën. Këto janë ngjyra të rëndomta aniline që përdoren për ngjyrosjen e leshit, ose edhe të trikotazhit. Në kohën më të re po përdorin edhe ngjyrë polikolor. Ngjyrën e blejnë në shitoret lokale.

Materialin për rripa të nallaneve e blejnë prej saraçëve lokalë. Në të kaluarën përdornin rripa prej lëkure që ishin më të mirë e më të pëlqyeshëm. Sot po përdorin edhe rripa prej gome dhe lëkurë artificiale.

Kemi hasur në dukurinë që për zbukurimin e nallaneve, në vend të ngjyrave, të përdoret letër e thjeshtë ngjyrash të ndryshme (si në Kaçanik). Tash kjo mënyrë zbukurimi e nallaneve është braktisur.

Për ngjitjen e rripave të nallaneve, këta zejtarë përdorin thumba të rëndomtë, që i blejnë në shitoret lokale.

Lëndë të para dhe materiale të tjera të kjo zeje nuk përdoren përpos spangos, thasëve për transport dhe letrës zumpara për të iemuar nallanet.

*
* *
*

Zejtarët nallanexhinj për punimin e nallaneve përdorin një numër mjaft të madh veglash dhe mjetesh të ndryshme të metalta. Gjatë qëndrimit në terren për të hulumtuar çështje të ndryshme etnografike, kemi bërë vrojttime edhe në dyqanet dhe shtëpitë e nallanexhinjve në Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj e gjetiu. Kemi vërejtur një sërë veglash, dhe ato janë të rëndomta dhe të thjeshta që shumë sosh i përdorin edhe zejtarë të tjerë, si bie fjalë, zdrukthëtarët, saraçët e të tjerë. Këto janë vegla të zakonshme, sepse nuk ekziston ndonjë vegël

specifike për punimin e nallaneve, pos një ose dy që i përdorin edhe saraqët (të ashtuquajturat: zoma dhe beshkia).

Veglat që përdorin nallanexhinjtë janë kryesisht këto:

zdrukthi ose prerësja motorike (s'e kanë të gjithë),
dërrasa ose tezga për zdrukthim me dorë,

sakica (sëpata),

sqepari (teslica),

mengenet (të drunjta ose të hekurta),

shara (e madhe ose e konopit),

Sharra (e vogël ose e dorës),

thika,

brisku,

hjekësi (ose hekësi),

çekiçë të ndryshëm,

dana (darë),

beshkia (për prerjen e rripave të nallaneve),

zoma (zëmba),

gërshërët,

lima për dru,

lima për hekur,

bølegia (gur zmeril për mprehje),

cungu (trupci për gdhendje),

cung (për ngjitjen e rripave),

seshte (shestë — model i vizatuar për nallane-shabllon).

Ne kemi shënuar veglat me ato emërtime që përdorin vetë mjeshtrit. Terminologjia e veglave gati kudo është e njëjtë. Te termi për sharrën e madhe, kemi hasur në «sharrë e madhe» ose «sharrë e konopit» (Prishtinë) dhe sharrë e vogël ose sharrë dore. Trungun për gdhendje e quajnë rëndom trupe, por edhe cung. Cungu është zakonisht prej qarri ose bungu, kurse mjeshtri i Prizrenit e kishte prej vidhi, madje të vjetër, si na tha, nja 150-200 vjet. Sqeparin e quajnë rregullisht «teslicë» ose «teshlicë», përveç Pejës ku mjeshtri i atjeshëm e quante sqepar. Në Prizren në terminologjinë e veglave ka edhe turqizma. Gurit zmeril i thonë «bilek tashi» — gur mprehës, kurse limës «ege» ose «jege» dhe kjo shërben, si tha mjeshtri i Prizrenit, për t'i hapur sharrës «çaprazat» — për t'i mprehur dhëmbët që në sendorësi gjenden në pozicion të përkundërt (çapraz).

Se për çfarë përdoret secila nga këto vlega s'ka nevojë të zgjatemi, sepse dihet — ato shërbejnë për prerje, gdhendje e latim, për zdrukthim (strugitje siç thonë mjeshtrit), për lëmuarje, për prerjen e rripave, për ngjitjen e rripave etj.

*
* * *

Procesi i punimit të nallaneve është mjaft i gjatë dhe i ndërlikuar. Gjatë punimit produkti kalon disa faza pune. Mjeshtri i Ferizajit thotë se «nallja nandë herë kapet me dorë», çka do të thotë se

janë nëntë faza të procesit. Në Gjakovë kemi shënuar dhjetë faza dhe kështu me radhë edhe në qytete të tjera. Në vazhdim po shënojmë fazat e përmendura ashtu siç u thonë vetë mjeshtrit. Pra, fazat e punës, sipas qyteteve ku i kemi shënuar dhe me termat që përdorin vetë mjeshtrit, janë këto:

Në Prishtinë: 1) mjeshtri gdhend drurin me sakicë, 2) vizaton «nallmet» me laps, 3) pret nallmet me «sharrë të sixhimit» (të madhe), 4) nxjerr «parmakët» me teshlicë (shliron vendin për «nallçet»), 5) nxjerr (rrumbullakon) nallmen me teshlicë, 6) ia nxjerr «vetllat» nallmes me hjekës, 7) ia pret «vetllat» me sharrë të dorës, 8) ia lëmon «vetullat me limë; vetullës i thotë edhe «kthysë», 9) i strugit (lëmon) nallmet me strug (me xham i lëmon shkomijtë e jo nallmet), 10) ia ngjet rrypat (veç me çekiç), 11) i bën çift dhe ua qet numrat çfarëdo qofshin («veç mos m'u ndërrue nallmet ndërveti»).

Në Gjakovë: 1) me shestue (sigurisht shestue — të vizatuarit e nallanes me shabllon), 2) me sharrue (me sharrë të madhe), 3) me sharrue (me sharrë të vogël dore), 4) me shestue për së dyti në mënyrë më preçize, 5) me rrumbullakue, 6) me gdhend me brisk, 7) me limue, 8) me i ly me bojë, (pa ndonjë model), 9) me i pre rrypat, 10) me i ngjitë rrypat, 11) me i zomue.

Në Ferizaj: 1) me e sharritë drurin, 2) me gdhend, 3) me rrumullue nallanen, 4) me zbardhue, 5) me shkruie (vizatuar), 6) me ia nxjerr gojën, 7) me limue gojën, 8) me i ba çift dhe 9) me ua ngjit rrypat.

Në Pejë: 1) cepanicën e ndajnë me katërsh, 2) këto katër copa i la-tojnë të gjana 10 dhe të trasha 5 cm, 3) copat e shpërlajnë në zdrukth, 4) i nxjerrin «enazet» (d.m.th. vizaton modelin e nallanës — modelit mjeshtri i thotë «enaze» ose masë), 5) me sharrë dore nxjerr distancën ndërmjet takeve, 6) me sqepar nxjerr copat ndërmjet takeve, 7) me bansek (fletë sharre me dhëmbë të imët që pret edhe hekurin) nxjerr formën e vizatuar, 8) përgatit rrypat dhe 9) ua ngjet rrypat nallaneve. (Një fazë pune është edhe ngjyrosja e nallaneve, por mjeshtri i Pejës këtë nuk e praktikon).

Në bazë të këtyre shënimeve të marra nga goja e vetë mjeshtërve dhe në bazë të kundërimeve që kemi bërë vetë gjatë procesit të punës, duket se kjo procedurë ka më tepër se 9 ose 10 faza pune.

Siç thamë, druri blihet me metër në depon e qytetit ose blihet nga fshatarët. Trungjet kanë gjatësi zakonisht prej një metri. Së pari merret një trung i tillë dhe me makinë prerëse (frezë) ose me sëpatë ndahet në katër pjesë. Më parë druri gdhendet me sëpatë dhe i jepet formë katërfaqëshe. Nëse trangu është më i hollë, atëherë ndahet në dy pjesë dhe ato pastaj gdhenden. Më pas njërin prej këtyre pjesëve (mjeshtri i Gjakovës e quan kushakë) e gdhendin dhe zdrukthojnë deri në gjerësinë prej 10 cm. dhe trashësi prej 5 cm. Prej këtij kushaku të gjatë një metër dalin dy palë nallane për të rritur dhe vetëm një nallane e vogël për fëmijë. Pra, me sharrë e ndajnë në pesë pjesë (për katër nallane të mëdha dhe një të vogël). Këto copa sërish i gdhendin e i «shpërlajnë», me zdrukth. Kuptohet, para se të pritët kushaku në pesë copë, më parë vizatohen me shabllon konturet e nallaneve, siç thotë mjeshtri i Gjakovës «drunit ia qes masën e i 'daj

venet e nallave». Në vazhdim, një nga një, copave, të cilave u janë lëmuar faqet e sipërme të nallaneve të ardhshme, në anën e kundërt u nxirren taket, përkatësisht distancat (goja) ndërmjet takeve dhe boshllëqet, i pami dhe i pasmi. Këtë punë e bëjnë me sharrë dore pasi të jenë hequr vijat ku duhet sharruar. Pasi të sharrohen, pjesët që duhen mënjanuar hiqen me sqepar. Pasi të jenë nxjerrë goja dhe boshllëqet, këto pastaj lëmohen e gdhenden sërish. Pas kësaj punohen dy pjesët anësore. Pjesës së parme të nallës i jepet formë trapezi, kurse të pasmes rrumbullake; pjesa e parme e nallanës është pakëz më e gjerë se e pasmja. Ndërkaq në mes nxirret një si hark në të dyja anët e nallanes, që mjeshtrit e quajnë vetull ose kthesë. Këto punohen me veglën e quajtur hjekës. Sërish zdrukthojnë nallanet dhe ia lëmojnë të gjitha sipërfaqet, duke përfshirë edhe anësoret. Pastaj i bëjnë çift, ua zomojnë anën e pasme me zomë dhe i ngjyrosin me bojë. Përdoren tri ngjyra; së pari lyhet nallja me ngjyrë të verdhë (të sarihtë), pastaj me të gjelbërtën (jeshilen) dhe në fund me të kuqen. Në Kaçanik, në kohën kur kishte nallanexhinj në vend të ngjyrës, nallaneve u ngjitnin shirita letre të thjeshtë ngjyrash të ndryshme. Mjeshtrit thonë se me bojë nuk i lyen të gjitha nallanet, por vetëm tipin e quajtur *takërdia*. Këto të shumtën i blejnë gratë rome, dhe herëherë edhe të tjerat. Pas kësaj faze pune, për nallane përgatiten rripat. Ato mund të jenë të gatshëm fashë-fashë, por në të kaluarën ishin copa lëkure të përpunuara. Rripat, pasi ua matnin gjatësitë, i pritnin me veglën e quajtur *beshki*, (një si brisk i gjerë me teh në formë gjysmësferike). Rripat ua ngjisnin nallaneve pasi t'i kenë bërë çift dy nga dy. Rripat ngjiten me thumba duke i goditur me çekiç. Thumbat janë të vegjël, gjatësia e tyre varet nga madhësia e nallaneve (për të rritur ose për fëmijë). Nallaneve të vogla u ngulin nga dy thumba, kurse të mëdhave nga tre. Në buzë të rripit ku ngulen gozhdët u vënë nga një copëz rripi a materiali tjetër më të qëndrueshëm për të mos dalë rripat nga thumbi. Rripat përforcotë qëndrueshëm për të mos dalë rripat nga thumbi. Rripat përforcotë anash në takën e parme të nallanes. Pas ngjitjes së rripave, nallaneve u shkruhen numra, jo të madhësisë, por çfarëdo qofshin për të mos u përzier nallanet pasi të jenë bërë çift. Faza e fundit, siç na tha një mjeshër, është shitja e prodhimeve.

Sikurse po shihet nuk janë vetëm 9 ose 10 faza pune, por, duke përfshirë të gjitha punët, të rëndat e të lehtat, të mëdhatë e të imëtat, numri i fazave të punës arrin në 30, por si faza kryesore, ku ndryshon forma e copës së drurit prej konturit e deri te prodhimi në të vërtetë s'ka më tepër se 10 faza pune.

Nallanet i quajnë zakonisht nallane, nallone, nallëne, nallme, nalle, ndërkaq zejen ose këtë profesion e quajnë nallanexhi, nalllexhi, nallënxhi dhe nalletar. Vetë fjala «nal» është arabe që do të thotë

mbathje, por edhe patkua⁸. (së këndejmi edhe emërtimi për zejën e nallbanëve, mbathtarëve).

Sa u përket tipave të nallaneve, në bazë të shënimeve të marra në terren, del se për nga trajtja janë 5-6 tipa, kurse për nga destinimi tre lloje. Për nga destinimi ndahen në nallane të meshkujve, të femrave dhe të fëmijëve, ndërsa për nga forma kemi: 1) nallane me sedef që nuk prodhohen më, 2) nallane të rrafshëta pa take (në Gjakovë u thonë petajka ose korita, në Prishtinë nallme të hamomit), 3) nallane me rrypa të gjërë që mbathen me pandufe, 4) nallane të nalta me dy topukë, që i mbajnë gratë fshatare shqiptare (në Prishtinë u thonë nallme të thjeshta, në Kaçanik vetëm nalle, në Gjakovë të çelne pse kanë dy topukë e gojë përfundi), 5) nallane të rrafshëta ose takërdia (këto përfundi nuk kanë take, sidomos në pjesën e përparme ku kanë një të dalë, por të rrafshët, kurse në anën e pasme qëndron topuku i gjërë jo fort i lartë, si taket te nallanet e larta) dhe 6) nallane fëmijësh vetëm të çupave të vogla, sepse djemtë nuk mbajnë nallane). Ndoth ndonjëherë që nallanexhinjtë të punojnë me porosi ndonjë palë nallane sipas shijes së porositësit. Mjeshtri i Gjakovës i ndan nallanet edhe kështu: «Të gjitha nalleve u thonë nalle me edhe pa topukë».

Për faktin se kush e mban secilin tip nallanesh kemi këto shënime: nallanet e rrafshëta, pa topukë i mbajnë burrat, nallanet e larta gratë fshatare shqiptare, takërdiat gratë e qytetit dhe romet. Në fshatra gratë i mbajnë nallanet si në shtëpi ashtu edhe jashtë saj, ndërsa burrat «mbajnë nalle vetëm rreth shpisë», me to nuk dalin jashtë oborrit.

Terminologjia për gjuhësinë pa dyshim do të jetë interesante. Në vazhdim po sjellim ca terma që kemi shënuar në terren prej mjeshtrëve në vende të ndryshme të krahinës.

Mjeshtri i Prishtinës thotë një «nallme ka ftyrën, nallçet (d.m.th. taket), kthyesat (ose vetullat d.m.th. harqet në dy anët) dhe përmjetin përfundi (gojën ose hapjen në mes dy takeve), si dhe rrypin; mjeshtri i Ferizajit rreshton: rrypin, majën (pjesa e parme), themrën (pjesën e pasme), gojën dhe dy topukët; mjeshtri i Gjakovës: rrypi, maja, themra (topuku i pasmë), topuku (i parmë) dhe nërmjeta, ndërsa ai i Prizrenit majën e quan parmakllëk, pjesën e pasme arkallëk, taket topukë dhe ndërmjetin bel. Pjesa e parme e nallanes është më e gjerë se e pasmja.

Shitjen e nallaneve dhe të prodhimeve të tjera nallanxhinjtë e bëjnë kryesisht në vendin ku kanë edhe dyqanin publik ose pranë shtëpisë. Pra, së pari furnizojnë blerësit lokalë të qendrave urbane dhe

8). A. Skaljić. *Turçizmi u srpskohrvatskom jeziku*, sarajevo, 1973, te fjalësit nalca dhe nalumë, f. 485-486.

të rrethinave të qyteteve. Ata që kanë dyqanet e veta publike, nallanet i shesin në dyqan, kështu që dyqani njëkohësisht është edhe shitore edhe punishte. Këta pra s'kanë nevojë t'i nxjerrin nallanet nga dyqani në treg. Myshterinjtë vijnë vetë pas tyre. Ndërkaq ata që s'kanë dyqane publike, por që punojnë në punishtet pranë shtëpive, nallanet i nxjerrin në treg dhe aty i ekspozojnë. Zakonisht këtë e bëjnë në tregjet e perimeve ose pranë tyre, në hyrje si dhe në pjacën e vjetërsinave (që te ne i thonë zakonisht pazari i grave).

Veç kësaj, disa nallanexhinj prodhimet e veta i çojnë për shitje edhe në qendra të tjera ku nuk ka kësi zejtarësh. Kështu deri sa ekzistonte kjo zeje në Kaçanik, nallanexhiu i atjeshëm, përpos në dyqan edhe në vetë Kaçanikun, nallane shiste edhe në Lipjan, në Mitrovicë etj., ditëve të pazarit. Nallanexhiu i Prizrenit, që ka punishten pranë shtëpisë, thotë se nallane shet edhe në shtëpi, por në sasi të vogël. Aty vijnë vetë myshterinjtë që dinë për të. Mirëpo, shumicën e nallaneve i shet në treg ditëve të pazarit. Në vigjiljen e pazarit, të martën, mbush thasët me prodhime dhe të nesërmen, të mërkurën (ditë pazari) i nxjerr në treg dhe i shet. Në stinën e verës çdo ditë pazari shet rreth 50 palë nallane, kurse dimrit mezi 10 palë — siç deklaroi vetë mjeshtri. Kështu veprojnë edhe të tjerët në Prizren dhe në vende të tjera që s'kanë dyqane publike. Mjeshtri i Gjilanit, për shembull, në një rrugë që shpie në treg, mu afër tij ka një barakë të veten dhe aty një rrugë që shpie në treg, mu afër tij ka një barakë të veten dhe aty shet nallane. Shitja e nallaneve në tregjet e qendrave urbane, në Kosovë është dukuri e përgjithshme. Aty nallane sjellin jo vetëm nallanexhinjtë e vendit përkatës, por edhe ata të fshatrave. Nallane blejnë si vendësit ashtu edhe fshatarët, por për nevoja të tyre personale. Rrallëherë ndodh që ndokush të blejë nallane me shumicë për t'i shitur në vende të tjera. Një rast ose dukuri të këtillë e kemi shënuar në Prizren, ku nallane blejnë rahovecjanët për t'i shitur në Rahovec, sepse atje nuk ka ndonjë mjeshtrë nallanexhi.

*
*
*

Dikur në të kaluarën e largët zejtarët nallanexhinj merreshin me prodhimin vetëm të nallaneve. Ishin me të vërtetë nallanexhinj të «pastër». Mirëpo, si duket të tillë zejtarë ka mjaft. Prandaj, tregu është i ngopur dhe këta zejtarë vetëm me fitimin prej kësaj zeje, që e quajnë, «zeje fukara», «zeje e vogël», nuk mund të jetojnë. Prandaj, doemos ata duhet të merren edhe me prodhimin e sendeve të tjera. Sikurse pamë më përpara, në të kaluarën kishte edhe zejtarë dyjarë. Shenja të transformimit të zejës duken edhe sot. Bie fjala, gati çdo nallanexhi, përveç, nallaneve, punon edhe sende të tjera. Kështu si thotë mjeshtri i Pejës, ai kryen edhe shtrëngimin e veglave (u vë bishtat që ka punuar vetë), ndaj edhe thotë se sot nallanet po i mbesin simbolike. Ky mjeshtrë gjatë luftës punonte edhe kallpë për këpucë. Nallanexhinjtë punojnë sende të drunjtja si: zgjedha, bishta për sëpata, tërfurq, lopata, kazma, shata (prej druri të frashrit). Punojnë edhe: funda për bukë, dërrasa mishi, boshta, shtiza, garuzhda, djepa, lodra

fëmijësh, grabuja etj. Gjithashtu nëpër dyqanet e tyre mund të hasen edhe sende ose artikuj që nuk i punojnë vetë, por i blejnë dhe i stërshesin ose ua sjellin të tjerë mjeshtrë për shitje, kuptohet, me një shpërblim. Kështu, kemi parë në këto dyqane edhe papuçe, kllompe, cigarllëqe, çibukë e kamisha që ua kanë sjellë tetovarët.

Pra të gjitha këto janë shenja të transformimit të kësaj zejeje, e cila në realitet ka filluar të shuhet. Sa do të qëndrojë dhe çfarë modifikimi do të pësojë, këtë s'mund ta themi.

*
* * *

Zeja e nallanexhinjve në të kaluarën nuk ka qenë zeje e përbuzur, por as zeje që qëndronte në ndonjë shkallare të lartë të hierarkisë së zejeve në përgjithësi. Mirëpo, sot kjo zeje ose mjeshtri çmohet shumë më pak se të tjerat. Është kjo një dukuri psikologjike e kuptueshme, sepse edhe kërkesat për nallane në shoqërinë bashkëkohore janë zvogëluar fort. Edhe vetë zejtarët nallanexhinj për zejen e tyre thonë se s'është e rëndësishme. Mjeshtri i Prishtinës thotë se dikur kjo zeje çmohej më mirë se tash, dhe vazhdon: «Këtyne herave me ia çue një palë nallme ndoj grueje, si me ia pa' çue një palë këpucë, e sod s'i ban hesap kush», pra, kjo zeje është e vogël, pa fitim të madh. Mjeshtri i Gjakovës thotë se kjo zeje «asht zanat fukara», kurse dikur me këtë zeje «kemi jetue nom». Ndërkaq, mjeshtri i Prizrenit thotë se kjo zeje ende çmohet deri diku, sepse nallanet janë më të shëndetshme se papuçet.

Dukuri e përgjithshme sociologjike është se këtë zeje në Kosovë gjithëherë e kanë ushtruar pjesëtarë të kombësisë shqiptare. Kështu deklarojnë edhe vetë nallanexhinjtë (Prizren, Gjakovë, Prishtinë e gjetiu).

Në pikëpamje të organizimit profesional nallanexhinjtë, meqë ishin në numër të vogël, kurdoherë gjendeshin në një esnaf të përbashkët me zdrukthëtarët (marangozët) dhe çibukçinjtë.

Një dukuri tjetër sociologjike është se në këtë zeje kanë njëfarë roli dhe ndihmojnë edhe gratë. Ato ndihmojnë zakonisht në kryerjen e punëve më të lehta rreth prodhimit të nallaneve. Në Prizren, bie fjala, ato ngjyrosin nallanet. Edhe në Pejë gruaja kujdeset në dyqan, sidomos ditëve të pazarit. Ndërkaq, nallanexhiu i Prishtinës thotë se kur është nevoja, punon edhe gruaja. Ky gjithëherë ka punuar bashkë me gruan dhe shton: «Plaka i punon nallmet njësoj si unë, bile veç ma të mira».

Te nallanexhinjtë çështja e mësimit të zejës nuk paraqet ndonjë problem. Këta, siç thamë, në sendorësi janë zdrukthëtarë të kualifikuar dhe sa për nallane atë e kanë deri diku edhe hobi. Të gjithë mjeshtrit deklarojnë se zejen e kanë mësuar vetë «nga nevoja për të jetue». E kanë mësuar pa ndihmën e askujt dhe s'kanë dhënë ndonjë provim të posaçëm për punimin e nallaneve. Kështu, mjeshtri i Prishtinës thotë se këtë zeje e ka pëlqyer edhe ngase dëshiron ta ushtrojë dhe për «nallme» s'ka dhënë provim. Këta zejtarë s'kanë as kallfa as shegertë. Mjeshtri i Gjakovës thotë; «Me kon marakli, njeri e merr

zanatin për një mujë, veç tue këqyrë tjetrin qysh punon», s'kam as kallfë as shegert. Por, ndodh që i biri ta mësojë zejen nga i ati. Mjeshtri i Prishtinës ia mësoi zejen të birit, të cilit edhe ia la dyqanin. Raste të trashëgimit ka edhe në vende të tjera.

Gjatë hulumtimeve kemi shënuar edhe disa dukuri etnografike; zakone e bestytни të ndryshme, të cilat po i sjellim këtu si një dëshmi të së kaluarës.

Sikurse edhe te zejet e tjera, edhe te kjo zeje ekzistonte zakoni (sot i rrallë) që mbi derë të dyqanit të varet simboli i kësaj zejeje — një palë nallane të mëdha. Kështu ishte edhe te zejtarët e degëve të tjera. Mirëpo, ky zakon gati është braktisur krejt, ngase tani dyqanet janë më moderne dhe në vitrinat prej xhameve prodhimet mund të shihen mirë nga kalimtarët.

Kur mjeshtri çel dyqanin në mëngjes, ai këtë punë e bën me «bis-milah» dhe hyn brenda së pari me këmbën e djathtë për t'i shkuar puna mbarë e kurrsesi me të majtën, sepse atëhere nuk do t'i shkonte puna mbarë (Prishtinë). Në Gjakovë kush blen «sefte» (i pari), mjeshtri i thotë «lëshoji (paratë) në tokë», pra, mjeshtri nuk i merr në dorë, por nga toka duke besuar se kështu shitja dhe puna do t'i shkojnë mbarë. Diku paratë e para i fërkojnë për mjekre, duke dëshiruar që prodhimet të shiten shumë — sa qime që ka mjekra. Në Prizren paratë e para i sjellin rreth thesit të mbushur plot me nallane — që të shiten që të gjitha nga thesi. Nganjëherë edhe i «shkrepin» (shpërndajnë) rreth tavolinës së punës.

Përkundër transformimeve shoqërore te ne, zeja e nallanexhinjve edhe sot po gjallon. Zejtarët nallanexhinj gjenden në shumë qendra urbane të KSA të Kosovës dhe jo vetëm aty, por edhe nëpër fshatra malore. Në qytete këta zejtarë kanë edhe dyqanet e tyre publike të evidentuara nga organet kompetente komunale, por ka edhe më tepër asish që s'kanë punishte publike, por ato i kanë pranë shtëpive dhe nuk janë të regjistruara. Për evidentimin e nallanexhinjve nëpër fshatra as që mund të flitet. Prandaj, është shumë e vështirë të vlerësohet numri i saktë i nallanexhinjve në krahinë.

Marrë së bashku dyqanet e regjistruara dhe të paregjistruara në qytet e fshat, mund të thuhet se kjo zeje është e shpërndarë nëpër mbarë krahinën dhe po i plotëson nevojat e popullsisë për këtë lloj mbathjeje.

Me hulumtimet tona nëpër qendrat urbane kemi evidentuar një numër nallanexhinjsh në to, duke marrë shënime dhe informata për zejtarët dhe gjenealogjinë e tyre.

Në vazhdim po i përmendim ata zejtarë për të cilët kemi të dhënat e duhura, duke çekur të gjitha qendrat urbane ku kemi gjetur kësi zejtarësh.

Prishtina. — I vetmi nallanexhi që sot ka punishten e vet publike në Prishtinë është Bajram Lutolli, i lindur më 1900 në fshatin Llapanë shticë të Llapit. I takon fisit Gash. Babai i Bajramit ishte Rama. Të parët e tij nuk janë marrë me këtë zeje. Në Prishtinë ky mjeshtrë ka ardhur në vitin 1959 dhe prej asaj kohe ka dyqanin ku edhe ushtron zejen e nallanexhillëkut. Shumë kohë (10-15 vjet) si punëtor ndihmës ka punuar te njëfarë Hysen Sveqla, tani marangoz në Podujevë.

Pastaj, dha provimin e zdrukthëtarisë dhe mori leje për të hapur dyqan të pavarur. Pra, me zejen e nallanexhinjve merret prej 22 vjet. Asnjëherë s'ka pasur punëtorë në dyqanin e vet përveç djalit të vet, Ramadanit, i cili vazhdon zejen e të jatit.

Në Prishtinë janë edhe dy nallanexhinj që punojnë në shtëpi. Këta janë Shefqet Bajgora dhe Bejtush Koliqi, të cilët shesin nallane ditëve të pazarit.

Në vitin 1960 dyqane publike të nallanexhinjve kanë pasur edhe Idriz Namani dhe Abid Hoxha. Këta të dy ka kohë që kanë vdekur pa lënë trashëgues të tyre në këtë zeje.

Gjakova. — Në këtë qendër, «në kohë të Turqisë» kanë qenë këta nallanexhinj: Sahit Ramadan Çela, Vehbi Kalaveshi dhe Mahmut Sulejmoni. Këta kanë vdekur.

Në vitin 1960 në Gjakovë ekzistonin dy dyqane zeytare të nallanexhinjve. Këta ishin vëllazërit Iljaz dhe Riza Vehapi që punonin vetë pa ndihmës. Babai i vëllazërve Iljaz dhe Vehap ishte Mahmuti që ishte nallanexhi dhe «kerraxhi» në kohë të Turqisë.

Ndërmjet dy luftërave botërore në Gjakovë nuk ka pasur nallanexhinj me dyqane publike. Këta punonin vetëm nëpër shtëpi dhe prodhimet ua jepnin saraçëve për shitje. Këta dy vëllazër (Iljazi dhe Riza), që hapën dyqanet pas çlirimit, më 1960 deklarorin se edhe këta do t'i mbyllnin, ngase i konkurorin nallanexhinjtë e katundeve (sidomos ata të Junikut dhe të Batushës).

Më 1981 në Gjakovë ndeshëm vetëm në një nallanexhi. Ky është Riza Vehapi (njëri nga ata dy vëllazërit që kishin dyqane më 1960). Pos nallaneve punon edhe dërrasa mishi, funda dhe shula veku. Në dyqan punon vetë, ndonëse ka pesë djem, por nuk dëshiron as vetë as ata ta mësojnë e të merren me këtë zeje. Riza sot është në moshën 65 vjeçare, zejen e mësoi qysh kur ishte 15 vjeçar, pra zejen e ushtron që 50 vjet. E ka mësuar prej babait të vet, Mahmutit.

Peja. — Sipas informatës së shënuar në vitin 1960, në Pejë në këtë kohë s'kishte nallanexhinj, por i punonin rugovasit dhe i sillnin për shitje në Pejë ditëve të pazarit. Mirëpo, më 31.X.1981 në Pejë gjetëm një nallanexhi, e ky është Myhedin Morina. Në lejen për hapjen e dyqanit shkruan se është nalletar. Ka lindur më 1922. Me këtë zeje merret nga viti 1964. Të parët i ka pasur dyfekçinj e vetë është bërë nallanexhi. Punon vetëm dhe ndonjëherë i ndihmojnë, siç thotë ai, «çunat» (djemtë). Zejen e ka mësuar që në vegjëli. Sipas disa informatave, në Pejë gjenden edhe nallanexhinj që punojnë pranë shtëpive. Ka edhe raste kur këpucëtarët — arnuet blejnë nallane të gatshme prej rugovasve, u ngjisin rrypat dhe i shesin në dyqan të tyre.

Ferizaj. — Në vitin 1959 është marrë shënimi se aty akzistonte një nallanexhi me dyqan. Ky ishte Sylë Musliu. Të parët e këtij nallanexhiu nuk janë marrë me këtë zeje por me drugdhendje dhe punonin sende të ndryshme si: zgjedha, lopata, tërfurq, magje dhe shkëmbinj. Vetë Sylë në Ferizaj ka ardhur prej fshatrave të Jezercës më 1925. Zanatin e ka mësuar te njëfarë Hamdi Kotlina nallanexhi, te i cili ka punuar 3 vjet si shegert. Sylë edhe sot (1981) punon nalle në Ferizaj, por në shtëpi, sepse është pensionuar.

Kaçaniku. — Në vitin 1958 në Kaçanik është shënuar se aty

Zeja e nallanexhinjve në të kaluarën ka qenë mjaft e zhvilluar dhe e përfaqësuar gati në çdo qendër urbane dhe me sukses ka plotësuar nevojat e popullsisë. Dalngadalë kjo zeje sa vjen e dobësohet, edhe pse sot ende gjallon. Megjithatë edhe kjo zeje sa vjen e dobësohet e si duket edhe i tejkalon, sepse nallanexhinjtë janë të detyruar të merren edhe me punë të tjera, përkatësisht të punojnë edhe sende të tjera për ta shtuar fitimin.

Zeja e nallanexhinjve, me sa del nga hulumtimet tona, është e shpërndarë në tërë krahinën, si në qytete, ashtu edhe nëpër fshatra. Domethënë se në pikëpamje gjeografike-hapësinore mbulon tërë territorin e krahinës.

Historiku, procesi i punës, terminologjia e fazave të punës, e pjesëve të nallanes dhe e tërë zejtarisë, është mjaft interesante, herë-herë arkaike. Dukuritë etnografike po ashtu janë me interes shkencor. Në arkitekturën e dyqaneve s'ka asgjë arkaike. Zeja disi po gjallon edhe sot dhe konsumues kryesorë janë gratë fshatare, madje deri diku edhe në qytete ende po mbajnë nallane.

Dukuri e përgjithshme është se këtë zeje, duke qenë se është e «vogël», «fukara», është vështirë ta kapësh e ta njohësh në tërësi. Punishtet nuk janë të evidentuara tek organet kompetente.

Nallanexhinjtë dhe nallanet kanë lënë gjurmët e veta edhe në dukuritë etnografike dhe në folklorin popullor, duke filluar prej nallaneve «sedefli» e deri te takërdiat, në nallanet e larta.

Në popull shikohet se cila grua dhe çfarë nallanesh mban dhe si i mban këto. Gratë e fshatrave kanë qejf t'i kenë nallanet e larta, të qytetit të kenë takërdia (ose tëkërdia), që duke ecur bëjnë «tëkër-tëkër». Populli thotë këqyre femrën se si ec me nallane: nëse i mban zvarrë (zhag) me atë femër diçka nuk është në rregull. Vajzat mbajnë nallane takërdia.

THE CRAFT OF WOODEN SANDAL MAKING IN KOSOVA

Although data about wooden sandal making in Kosova go no further than the end of the 19th century and the beginning of the 20th century, it has been more developed than today. The author has traced this craft all over the territory of Kosova and provides concrete information on its proportions, the craftsmen, the workshops, the technology, the work tools, the different forms of wooden sandals, etc.

The craft history, the work processes, the terminology of the work phases, the parts of wooden sandals, etc., are of great interest.

ORIGINAL ARTICLES

1. The first article is by Dr. J. H. ...
2. The second article is by Dr. ...
3. The third article is by Dr. ...

4. The fourth article is by Dr. ...
5. The fifth article is by Dr. ...

6. The sixth article is by Dr. ...
7. The seventh article is by Dr. ...

8. The eighth article is by Dr. ...
9. The ninth article is by Dr. ...

10. The tenth article is by Dr. ...
11. The eleventh article is by Dr. ...

12. The twelfth article is by Dr. ...
13. The thirteenth article is by Dr. ...

14. The fourteenth article is by Dr. ...
15. The fifteenth article is by Dr. ...

16. The sixteenth article is by Dr. ...
17. The seventeenth article is by Dr. ...

18. The eighteenth article is by Dr. ...
19. The nineteenth article is by Dr. ...

20. The twentieth article is by Dr. ...
21. The twenty-first article is by Dr. ...

22. The twenty-second article is by Dr. ...
23. The twenty-third article is by Dr. ...

24. The twenty-fourth article is by Dr. ...
25. The twenty-fifth article is by Dr. ...

26. The twenty-sixth article is by Dr. ...
27. The twenty-seventh article is by Dr. ...

28. The twenty-eighth article is by Dr. ...
29. The twenty-ninth article is by Dr. ...

30. The thirtieth article is by Dr. ...
31. The thirty-first article is by Dr. ...

32. The thirty-second article is by Dr. ...
33. The thirty-third article is by Dr. ...

34. The thirty-fourth article is by Dr. ...
35. The thirty-fifth article is by Dr. ...

Emin RIZA

SHTËPIA E ZJARRIT NË BANESËN QYTETARE SHQIPTARE

«Shtëpia e zjarrit»¹ është mjedis i parë dhe shpesh i vetëm i banesës shqiptare që luan një rol të rëndësishëm në jetën e familjes. Megjithëse njihet me këtë emërtim në mbarë vendin, në disa qendra njihet edhe me emra të tjerë: «oda e zjarrit» dhe «shtëpia e bukës». Në këto emërtime të bie në sy termi *shtëpi* që tregon qartë se në një fazë të caktuar të zhvillimit të banesës shtëpia formohej nga një ambient i vetëm. Përcaktorët e *zjarrit dhe e bukës* tregojnë se elementi më i qënësishëm në këtë ambient mbahej zjarri, dhe në disa raste buka, me kuptimin e vendit të përgatitjes së saj, siç e tregon edhe emërtimi «magjëri» që përdoret në Labëri. Vendi i rëndësishëm që luante zjarri në jetën e familjes dhe kulti për të shpjegojnë qartë pse ai përmendej në cilësimin e këtij mjedisi. Zëvendësimi i tij me funksionin tjetër, të rëndësishëm, si vend i përgatitjes së bukës dhe më pas i marrjes së ushqimit duken shfaqje më të vonshme.

Megjithëse me zhvillimin në kohë të banesës shqiptare shumë funksione të shtëpisë së zjarrit u kaluan shkallë-shkallë ambienteve të tjera, emërtimi i këtij mjedisi mbeti i tillë.

Kur shtëpia e zjarrit ishte mjedis i vetëm i banesës ajo ishte praktikisht shumëfunksionëshe; përgatitej e merrej ushqimi, qëndronte e flinte familja, pritej miku. Prej të gjithë këtyre funksioneve së pari u shkëput ai i pritjes së mikut dhe më tej fjetja e ngrënia. Funksioni më jetëgjatë mbeti ai i përgatitjes së ushqimit, i cili lidhej me zjarrin. Zjarri ndizej në një vend të veçantë që njihej me emrin vatër. Vatra lidhet me vetë ngritjen e banesës. Ky element tepër i lashtë, i cili në vendin tonë zë fill që prej gjurmëve të ndërtimeve prehistorike, vazh-

1) Përdoret në terminologjinë popullore dhe shpreh një koncept të lashtë. Megjithëse ky emërtim në disa qendra qytetare ndryshoi, ne do ta përdorim duke dhënë emërtimin e ri.

don deri vonë në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit tonë, jo vetëm në shtëpinë e zjarrit të banesave fshatare, por edhe në disa shembuj të banesave qytetare, që lidhen me tipologjinë e formacionit feudal të shoqërisë. Vatra e zjarrit ndërtohet drejtpërdrejt mbi truallin e ambientit. Ajo ka formën e një drejtkëndëshi i cili në volum krijon dy rrafshime të shkallëzuara. Në pjesën e ulët, një gropëzim shërben për ndezjen e zjarrit. Drutë vendosen në pjesën e ngritur, duke u zgjatur sipër vendit të zjarrit. Në shkallëzimin e të dy sipërfaqeve anash vendosen dy gurë të ngulur në truall. Gjithmonë mbi vatër varet një zinxhir hekuri, i kapur në trarët e çatisë. Në të varen enët e gatiimit. Nëse vetë konstruksioni i thjeshtë i vatrës mbeti thujse i pandryshuar në rrjedhë të shekujve, vendi i tij në kompozimin e shtëpisë së zjarrit si edhe përmirësimi i tij me synimin e mbledhjes së tymit dhe largimit të tij të organizuar, duhet mbajtur si një zhvillim i rëndësishëm. Lidhur me vendin në kompozim vatra ka lëvizur nga vendi tradicional rreth mesit të ambientit, duke u mbështetur më pas përbri njërit nga muret perimetrale. Ndërtimi i kanalit të tymit dhe pajisja e vendit të zjarrit me tamburin, i cili i bashkëngjitet kanalit të tymit, në një nivel të caktuar mbi vatër, përbën shkallën më të përparuar të organizimit të vendit të zjarrit, jo vetëm në shtëpinë e zjarrit, por edhe në mjediset e tjerë të banimit, të cilët kanë qenë zakonisht të pajisur me të. Ashtu si edhe në dukuritë e tjera ndërtimore, format primitive të vendit të zjarrit, vetëm me vatër, kanë bashkëjetuar gjatë me forma më të përparuara si shprehje e diferencimit klasor, brenda një qendre të banuar, ose si shprehje e shkallëve të ndryshme të zhvillimit nga një qendër qytetare në tjetrën.

Në vetvete shtëpia e zjarrit, ashtu si oda e miqve paraqitet si një njësi kompozicionale e pavarur nga tipologjia e banesës. Njëlllojshmëria e funksioneve dhe kërkesat estetike, mjaft modeste për vetë natyrën e këtij ambienti, i japin atij një baraztrajtim të spikatur.

Ndryshimi i tij ose më saktë shpërbërja graduale, veçanërisht në disa variante të zhvilluara të kundërta me odën e miqve, e cila përgjithësisht rrit vlerat e saj paralelisht me kalimin nga variantet e thjeshta në ato më të zhvilluarat.

Në përputhje me funksionet që kryen shtëpia e zjarrit, ajo zë vende të ndryshme në kompozimin e banesës qytetare shqiptare. Varësia ndërmjet numrit të këtyre funksioneve të shtëpisë së zjarrit dhe vendit të saj në kompozim, është e drejtë. Sa më i madh është ky numër funksionesh, aq më qendror është vendi i shtëpisë së zjarrit. Në rastin më të skajmë në banesën njëkthinëshe përfshihen të gjitha funksionet jetësore të familjes.

Në katër tipet e banesës qytetare që lidhet me formacionin feudal të shoqërisë: banesës tiranase, asaj me hajat, banesës me çardak, banesës gjirokastrite si dhe të zgjidhjeve të veçanta relativisht të shumta, shtëpia e zjarrit luhatet në vendosjen kompozicionale. Kjo luhatje në raport me mjediset e tjera, lidhet me zhvillimin e banesës shikuar kryesisht në theksimin e monofunksionalitetit të çdo mjedisi që çon në dobësimin e rolit të shtëpisë së zjarrit. Në tipe të ndryshme kjo lëvizje është e ndryshme, madje me dallime thelbësore. Në tipet

më pak të zhvilluara si banesa tiranase shtëpia e zjarrit mbeti në të gjitha variantet qendra e kompozimit, ndryshe nga banesa gjirokastrite ku ky ambient pëson një evolucion të ndjeshëm funksional dhe kom-pocional.

Tipi i banesës tiranase paraqet shembullin më me interes të shtëpive të zjarrit të zhvilluara, të cilat, për arsytet e njohura të kushteve të kësaj qendre², ruajnë në të gjithë variantet vendin qendror në kompozimin e banesës. Në gjendjen e sotme numri i shtëpive të zjarrit të ruajtura në gjendjen origjinale ose me pak ndryshime është mjaft i vogël, megjithatë ato që ruhen mundësojnë karakterizimin e plotë të këtij ambienti. Shembulli më me interes dhe njëherazi më i zhvilluar është ai i banesës në Rr. «Vildan Luarasi» Nr. 22, në Tiranë (Tab. 1). Banesa në fjalë paraqet variantin më të zhvilluar të banesës tiranase, në të cilin shtëpia e zjarrit, është vendosur në qendër të banesës e rrethuar në të katër faqet me mjedise të tjera banimi. Këto të fundit zhvillohen në dy kate, ndryshe nga shtëpia e zjarrit, e cila ngrihet në lartësi sa të dy katet e mjediseve rrethuese. Kjo karakteristikë e fundit, së bashku me vendin në kompozim të shtëpisë së zjarrit, përbëjnë tiparet më thelbësore në karakterizimin e tipit të banesës tiranase. Shtëpia e zjarrit ka sipërfaqe 51.7 m² (7.30 x 7.08 m) dhe lartësi 5.76 m, pra një volum të madh prej 298 m³. Megjithë disa ndryshime të vogla që ka pësuar ky mjedis, sipas gjurmëve ekzistuese mund të ndiqet lehtë gjendja origjinale e tij. Në këtë mjedis, vatra ka qenë ndërtuar kundrejt hyrjes kryesore nga hajati, pranë murit ka fundor. Pranë saj ishte ndërtuar shtrati, një element i zakonshëm në shtëpitë e zjarrit të banesës tiranase. Shtrati është një podium i thjeshtë, i ngritur rreth 50 cm nga trualli, i cili formohet nga një skelet binarësh, mbi të cilin shtrohen dërrasa. Ky është i vetmi vend ku mund të qëndrohet në një farë komoditeti, sepse mbi të vendosen shtroje të ndryshme e jastekë. Natën pranë zjarrit, i cili mbahej gjithmonë i ndezur, flinin zakonisht pleqtë e shtëpisë. Një element karakteristik, i cili në rastin e dhënë paraqitet mjaft i zhvilluar, është mafili. Ai përfshin thujtë të tri faqet e shtëpisë së zjarrit, duke lënë të lirë vetëm atë që ka më pranë vatrën, për arsye të kuptueshme me të sigurisë ndaj rrezikut të zjarrit.

Mafili është një element i zakonshëm në shtëpinë e zjarrit të banesës tiranase, ndërtimi i të cilit bëhet i mundur nga lartësia e madhe e saj. Ai është një lloj ballkoni i brendshëm, që formohet nga zgjatimi i trarëve të dyshemesë së mjediseve përbri shtëpisë së zjarrit. Ky lloj ballkoni kufizohet nga parmakë druri në formë panelash me binarë ose kafazlie që përfshihen në hapësirat që krijohen nga shtyllat vertikale, të cilat mbërthehen me konstruksionin e trarëve të tavanit. Funkcioni i mafilit nuk ka qenë i njëjtë gjatë kohëve, ai ka ndryshuar në përputhje me zhvillimin e varianteve të banesës tiranase. Në variantet e thjeshta, mafili ka pasur funksione fjetje për çiftin e ri ose për djemtë e shtëpisë. Me kalimin në variante më të zhvi-

2) E. Riza — *Arkitektura popullore në qytetet tona shek. XVIII-XIX*, «Kultura Popullore» 2, 1980, f. 13-35.

lluara, në të cilat shtrohej problemi i ndërlidhjes së shtëpisë së zjarrit me mjediset e katit të parë përreth saj, ai filloi të humbasë funksionin e fjetjes në dobi të atij ndërlidhës. Ky funksion i ri bëri që mafili shpesh të arrinte në një shtrirje të gjërë, për të mundësuar kalimin sa më të shpejtë në ambientet e katit, me një numër sa më të vogël shkallësh. Praktikisht zgjidhjet më të zakonshme janë me një palë shkallë druri, por nuk mungojnë edhe dy të tilla, siç i kemi në rastin e dhënë. Krahas zgjidhjeve me mafil të zhvilluar në variantet fillestare të banesës tiranase shpesh shkallët mbështeten mbi një ballkon të vogël, i cili nëpërmjet derës siguron ndërlidhjen me një mjedis të vetëm, prej nga kalohet në mjediset e tjera të katit të sipërm.

Në faqen kundrejt shkallëve tre rradhë sergjenësh shërbejnë për vendosjen e enëve të kuzhinës. Pranë tyre vendoseshin shtambat e ujit. Në faqen përkundrejt vatrës dy dollapë muri janë ndërtuar në dy anët e hyrjes kryesore për në shtëpinë e zjarrit. Hyrje të tjera më të vogla siguronin ndërlidhjen me ambientet e katit përdhe. Shtëpia e zjarrit është e shtruar, si zakonisht, me shtresë balte të punuar drejtpërdrejtë mbi truallin natyror. Muret janë të suvatuara me llaç balte dhe të lyera me gëlqere. Në rastin në shqyrtim shtëpia e zjarrit nuk ka asnjë mundësi ndriçimi natyral nga muret anësore, sepse ato mbyllen nga mjedise banimi, prandaj ndriçimi sigurohet nga 4 baxha. Kjo praktikë ka qenë e përhapur edhe në variantet ku ishte i mundur ndriçimi natyral nëpërmjet dritareve. Siç duket parapëlqimi për këtë mënyrë ndriçimi të lashtë, duhet kërkuar me largimin nga dritaret e mëdha dhe përgjithësisht nga dritaret, për arsye të gjendjes së pasigurtë, e cila sugjeronte mbylljen sa më të madhe të ndërtimeve. Shtëpia e zjarrit e banesës në shqyrtim, ashtu si të gjithë shembujt e tjerë në banesën tiranase, është pa tavan. Vatra pa mbledhës tymi ka kushtëzuar këtë zgjidhje të cilën e gjejmë të tillë thuajse në mbarë shtëpitë e zjarrit. Shembulli i përshkruar, që, siç përmendëm, është një nga më tipikët, ndeshet me formulime paralele thuajse në mbarë shtëpitë e zjarrit të banesës tiranase. Të gjithë këta shembuj i bashkojnë karakteristikat thelbësore të përbashkëta, si volumi i madh i mjedisit, vatra e hapur, mafili, shtrati, sergjenet si dhe ndriçimi i pakët nga baxhat, trualli prej dheu dhe mungesa e tavanit. Këto elemente luhaten nga përmasat dhe kompozimi i tyre në vartësi nga faktorë të ndryshëm prej të cilëve më me rëndësi është ai i vendit të shtëpisë së zjarrit në kompozim. Lidhur me këtë të fundit në banesën tiranase, hasim një sërë variacionesh në vendin e shtëpisë së zjarrit në bashkëmarrëdhënie me mjediset e tjera të banesës.

Në të gjitha variantet, duke lënë pas atë me një mjedis të vetëm, shtëpia e zjarrit mban vendin qendror në kompozim. Mjediset e banimit që zhvillohen në dy kate, vinë e qarkojnë shkallërisht mjedisin qendror, i cili nga variantet e thieshtë në ato të zhvilluara nuk pëson asnjë ndryshim që të tjetërsojë sadopak kompozimin dhe trajtimin e saj. Kjo ndodh sepse shtëpia e zjarrit ruajti një diapazon të gjërë funksionesh, që përfshinin përbërësit më thelbësor të jetës familjare në të kaluarën. Mjediset rreth saj shërbenin kryesisht si dhoma për çiftet, ndërsa një pjesë e zinj mjedisit e hapura, hajatet e çardaqet, si dhe ambientet ndihmëse në katin përdhe. Në këtë drejtim evolucioni i

banesës tiranase ka më tepër karakter sasior se sa cilësor. Ajo u shërben familjeve me numër të ndryshëm pjesëtarësh, duke u ndërtuar në mjaft variante, ku numri i mjediseve në rritje nuk tjetëron thelbin funksional dhe kompozicional të shtëpisë së zjarrit. Mbeturinat e mënyrës së jetesës patriarkale dhe niveli relativisht i ulët i shoqërisë së kohës i dhanë kësaj banese një qëndrueshmëri të theksuar në tiparet kryesore të saj. Me thjeshtësinë dhe origjinalitetin e saj kompozicional, banesa tiranase paraqet pa dyshim tipin më të lashtë të banesës shqiptare, e cila duket se ka qenë e lidhur me zona ku ka zotëruar zhvillimi i ekonomisë bujqësore.

Një tip tjetër i banesës qytetare shqiptare, ku shtëpia e zjarrit vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm për nga kompozimi dhe funksionet e saj është banesa me hajat. Megjithëse me arritje më të larta se ajo tiranase, banesa e lashtë me hajat në evolucionin e saj u kush-tëzua nga ajo shkallë e ulët e zhvillimit të forcave prodhuese të qyteteve në kuadrin e shoqërisë feudale, ku ekonomia bujqësore e blegtorale luante një rol të rëndësishëm. Kompozimi i banesës me hajat ka dallime thelbësore nga ai i banesës tiranase. Tremet e hapura luajnë një rol të rëndësishëm në këtë banesë përdhese. Kompozimi i saj i thjeshtë me shtrirje horizontale formohet nga tre breza paralele mjedisesh, përkatësisht hajati, mjediset e banimit dhe ato ndihmëse. Edhe në këtë tip banese, shembujt njëkthinësh nuk ruhen më, ndërsa ata me dy kthina banimi kanë një përhapje të mirë. Shembujt trekthinësh janë disi më të rrallë. Kuptohet se në variantin dykthinësh të banesës me hajat njëri mjedis është shtëpia e zjarrit, ndërsa tjetri oda e miqve. Në variantin me tre mjedise banimi shtëpia e zjarrit ze vendin qendror në kompozim. Ajo gjithmonë ndërlidhet së brendshmi me mjediset e tjera të banimit. Madhësia e shtëpisë së zjarrit, ndryshe nga banesa tiranase, nuk ndryshon ndieshëm nga ajo e mjediseve të tjera të banimit. Ka shembuj ku shtëpia e zjarrit është me sipërfaqe më të madhe se ajo e mjediseve të tjera, ashtu siç ndeshim shembuj ku shtëpia e zjarrit është më e vogël. Nga sa kemi vërejtur, prirja drejt shtëpisë së zjarrit është karakteristike për shtresat e zvogëlimit të shtëpisë së zjarrit është karakteristike për shtresat e pasura, te të cilat dallimi funksional i mjediseve është më i theksuar, duke sjellë si pasojë zvogëlimin e funksioneve të shtëpisë së zjarrit pra dhe të përmasave të saj.

Banesa me hajat ka pasur përhapje të gjërë në qytetet e Shqipërisë së mesme, veçanërisht në Elbasan, Kavajë, Peqin dhe Tiranë. Në gjendjen e sotme ruhen disa shtëpi zjarri me ndryshime të pakta, shumë rrallë në gjendjen origjinale. Elementi më i ndryshueshëm i tyre është vendi i zjarrit, i cili nga vatra e hapur ka kaluar në sistemin e njohur të shoqërimit të saj me kanal in e tymit dhe tamburin tymmbledhës.

Një shëmbull me interes i një shtëpie zjarri të zakonshme është ai i banesës në rrugën «Vllëzërit Huta» Nr. 65 në Tiranë (Tab. 2). Shtëpia e zjarrit ze vendin qendror në kompozim, duke pasur një sipërfaqe thujse sa dyfishi i mjediseve pranë. Prej tyre ai i krahut të djathtë (e majta e vrojtuesit), është quri, një ambient ndihmës ku zakonisht ruhen rezervat ushqimore, ndërsa ai i majti është oda e miqve. Shtëpia e zjarrit, përdhese e pa tavan, ruan tre elementet bazë të këtij mjedisi: vatrën (sot me tambur), shtratin dhe sergjenin. Me interes të

veçantë është shtrati i gjërë, i cili nuk është ndërtuar në vendin e tij të zakonshëm pranë vatrës, por në pjesën fundore të mjedisit. Ashtu si zakonisht, prej shtratit kalohet në mjedisin e qurit. Një shembull më i zhvilluar i një banese me hajat tre ambientëshe është ai i rrugës «A. Arapi» Nr. 9, në Elbasan.

Shtëpia e zjarrit këtu (Tab. 3) megjithëse ruan vendin qendror në kompozim dhe ndërlidhjen e brendshme me mjediset rrethuese, është me sipërfaqe më të vogël se secili prej dy mjedisëve përbri. Ky shembull i variantit me tri kthina, shquhet për qoshqet e zhvilluara dhe pasurinë e ornamentikës në odën e miqve. Trajtimi i saj tregon qartë se kjo banesë u përkiste shtresave të pasura, ndryshe nga shembulli i Tiranës, i cili nga shumë tregues duket se u përket shtresave të mesme. Krahasimi i shtëpive të zjarrit të këtyre dy banesave shfaq dukshëm prirjen për atrofizimin e shtëpisë së zjarrit, e cila humbet funksionin e banimit, duke mbajtur vetëm funksionin e gatimit.

Shembullin më të arritur dhe njëherazi më të ruajtur të shtëpisë së zjarrit në tipin e banesës me hajat e ndeshim në një banesë dy-familjare të ndërtuar në qytetin e Kavajës, e cila është kthyer në muze etnografik.

Të dy shtëpitë e zjarrit zenë vendin qendror në kompozim (Tab. 4) duke u zhvilluar, ashtu si mbarë banesa, me simetri të rreptë. Secili prej këtyre mjedisëve, i vendosur në qendër të kompozimit, ndërlidhet me anë të katër hyrjeve me mjediset përreth. Sipërfaqja e shtëpisë së zjarrit është më e madhja se ajo e mjedisëve të tjera. Ajo si zakonisht ka thujtë formën e katrorit në plan. Ajo është përdhese dhe pa tavan, ndriçohet nga dy dritare që dalin në hajat, si dhe nga një baxhë. Vatra e hapur është e ndërtuar thujtë në qendër të mjedisit. Përbri ngrihet një shtrat i gjërë, prej të cilit nëpërmjet një dere kalohet në odën përbri. Shtëpisë së zjarrit nuk i mungojnë sergjenët dhe dollapet e murit. Është me interes të vërejtë se, ndryshe nga shtëpia e zjarrit me vatrë të hapur, në odën pranë vatra e vendosur përbri murit anësor, është e pajisur me instalimin tymtërheqës të formuar nga tamburi dhe kanali i tymit. Ndërtimi i të dy formave të vendit të zjarrit, në të njëjtën banesë, është një dukuri mjaft e përhapur në ndërtimet qytetare të shek. XVIII-XIX, që i përkasin tipit të banesës tiranase dhe asaj me hajat.

Banese me çardak paraqet një tip me arritje më të mëdha në krahasim me banesën me hajat, jo vetëm sepse është banesë me kat, por edhe sepse dallimi funksional i mjedisëve arrin një theksim të ndieshëm në variantet e zhvilluara, krahas rritjes së dukshme të trajtimit arkitektoniko-dekorativ të dhomave të banimit dhe veçanërisht të dhomës së miqve. Skema kompozicionale e banesës me çardak ka paralele të dallueshme me banesën me hajat. Edhe në këtë tip banese shihet qartë prirja drejt atrofizimit të shtëpisë së zjarrit, duke kaluar nga variantet e thjeshta në ato të zhvilluarat. Vendin e zjarrit në shembujt që ruhen, në përgjithësi nuk është më i hapur, por i pajisur me tërheqës tymi.

Përsa i përket vendosjes në kompozim, në variantin me dy kthina banimi dhe atë me tri kthina, shtëpia e zjarrit zë të njëjtin vend si në banesën me hajat. Në variantin me tri kthina banimi të vendosura

përbri çardakut shtëpia e zjarrit mbetet në pozicionin qendror dhe me ndërlidhjen e zakonshme me mjediset rrethuese e me çardakun. Madje në mjaft raste shtëpia e zjarrit ndërlidhet së brendshmi me shkallë shërbimi me katoin ose ahurin nën të. Në variantin me dy kthina shtëpia e zjarrit ka përmasa thujtë të njëjta me odën ndërsa në atë me tri ose më tepër kthina banimi, shtëpia e zjarrit zvogëlohet ndieshëm, duke u kthyer në mjedis gatimi.

Shembuj nga Berati dhe Shkodra, ku banesa me çardak pati përhapjen më të gjerë, janë të shumtë³. Me interes të veçantë janë disa shembuj në Shkodër në të cilët humbja e funksioneve të banimit të shtëpisë së zjarrit pasqyrohet edhe në zhvendosjen e saj nga vendi tradicional. Në këto raste ky mjedis ngrihet në pjesën e prapme të banesës duke dalë në formë dhëmbi përtej konturit (Tab. 5), pa humbur ndërlidhjen me të gjitha mjediset e tjera. Një element i ri që takohet dendur në shtëpinë e zjarrit të banesës me çardak është edhe blloku i musandrës, i cili, shpesh sipër tij, ka një volum të hapur ku vendosen zahire ushqimore për periudhën e dimrit. Në përgjithësi muvëndosja e një dollap me përmasa të mëdha, është e përfshirë në një bllok më të gjërë, që përfshin raftet e hapur dhe dy dyert. Sqolli, është gjithashtu një element që ndeshet shpesh, veçanërisht në banesën shkodrane me çardak. Në këtë të fundit rrallë gjejmë të ndërtuar edhe furrën, e cila mund të jetë në shtëpinë e zjarrit, ose në një mjedis ndihmës të banesës. Ky mjedis ndihmës është zakonisht i pajisur me sqoll dhe me vendin e zjarrit me oxhak. Ai, për nga kompozimi ka paralele të qarta me qilarin në banesën gjirokastrite. Për t'u theksuar është ndërtimi i jerevisë, siç thirret në Shkodër një ndërtim përdhës i pajisur me oxhak, i cili shërbente edhe si kuzhinë verore. Të njëjtin ndërtim e gjejmë shpesh në banesën korçare. Të dy këto raste gjejnë paralele edhe në disa banesa të mëdha gjirokastrite, ku qilari përbën një ndërtim të veçantë në oborrin e parë të banesës, i pajisur me oxhak dhe shpesh me furrë. Në rastin e banesës me çardak dhe të banesës gjirokastrite, shembujt e mësipërm kanë të bëjnë me shtresat e pasurokastrite, brenda banesës ishte bërë e para të popullsisë, për të cilat gatimi brenda banesës ishte bërë e para të pëlqyer. Në banesën korçare, të ndërtuar nga shtresa të ndryshme të borgjezisë qytetare mjedisi i veçantë për gatim bartëte praktikisht funksionin kryesor të shtëpisë së zjarrit. Krijimi i tij lidhet kryesisht me kërkesën për të mbajtur pastër banesën.

Nga shembujt më të spikatur të shtëpisë së zjarrit në banesën me çardak, po ndalemi së pari në një banesë beratase (Tab. 6) në rrugën «G. Karakashi» Nr. 16. Banesa është dykatëshe, me dy mjedise në secilin prej tyre, me hajatin dhe çardakun në katet respektive. Shtëpia e zjarrit zë krahun e djathtë, duke pasur ndriçim natyral dhe va-

3) V. Shtylla; *Studimi mbi restaurimin e një banese në Shkodër* «Monumentet», 2/1971.

E. Riza, *Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX*, «Monumentet», 4/1971.

E. Riza, *Banesa popullore në qytetin-muze të Beratit*, «Monumentet», 1/1981, f. 5-35.

trën me oxhak. Në murin fundor të saj ngrihet musandra, e cila mbyll krejt pjesën fundore, duke pasur në të dy skajet dyer që të çojnë nga parahyrja në çardak dhe në mjedisin sanitar. Mbi këtë volum krijohet një platformë, e cila arrihet nëpërmjet shkallëve. Kuptohet se kjo shtëpi zjarri, përveç funksionit të gatimit, kishte edhe funksionin e banimit, veçanërisht në stinën e dimrit.

Me interes është edhe shtëpia e zjarrit në banesën e rrugës «Xhamia e Plumbit» Nr. 27. Ky mjedis është me përmasa më të vogla se mjedisi përbri dhe ka në pjesën e prapme një kthinë ndihmëse, ku është ndërtuar sqolli. Me interes të veçantë është vendi i zjarrit (Tab. 7), i cili paraqet një fazë kalimtare në rrugën drejt vendit të zjarrit me oxhak. Në rastin e dhënë pranë vatrës është ndërtuar kamaria karakteristike, e cila ndeshet rëndom përpara përdorimit të kanalit tymtërheqës. Një perde murature e ndan atë nga një nike e dytë, mbi të cilën pastaj zhvillohet kanali tymtërheqës. Në shtëpinë e zjarrit të një banese të të njëjtit variant takojnë vendin e zjarrit në një zgjidhje më të thjeshtë, dhe padyshim më të hershme (Tab. 8). Pranë vatrës hullia tymtërheqëse pa tambur ndahet pak mbi sheshin e vatrës nga një perde, zgjidhje kjo e njohur gjërisht në banesat fshatare. Mbi vatrë një konstruksion druri i mbërthyer në trarët e tavanit shërbente për vendosjen e ushqimeve që tymoseshin për t'u ruajtur për një kohë të gjatë. Si rast të rrallë përmendim ndërtimin e furrës brenda shtëpisë së zjarrit, në një banesë me tri kthina banimi. Furra zë këndin e mjedisit. Me interes është edhe tamburi mbi vatrën e këtij mjedisi, i cili formohet nga një volum prizmatik, me skelet thuprash lyer me baltë. Sqolli i madh plotëson pjaisjet fikse të shtëpisë së zjarrit, e cila në shembullin në shqyrtim është thjesht vetëm mjedis gatimi.

Në shembujt e varianteve të zhvilluara të banesës me çardak të Shkodrës dhe të Beratit vërehet qartë një mospërputhje e theksuar ndërmjet trajtimit arkaik të shtëpisë së zjarrit dhe mjediseve të banimit, e veçanërisht të odës së miqve, ku përpunimi arkitektoniko-dekorativ ka arritur në realizime vërtet të shënuara.

Shtëpia e zjarrit në banesën gjirokastrite ka një evolucion më të ndërlikuar sesa në tre tiparet e shqyrtuara më sipër, për arsye të arri-tjeve më të rëndësishme të saj në planin kompozicional. Veçanërisht në variantet e zhvilluar me shumë mjedise banimi, mjedis të veçantë gatimi (qilari) dhe mjedis për vendosjen e rezervave ushqimore, (qilari i zahiresë) — funksionet origjinale të shtëpisë së zjarrit dhe trajtimit i saj në variantet e thjeshta humbasin ndieshëm njësinë e tyre, duke u shpërbërë shkallë-shkallë.

Në rrugën e gjatë të zhvillimit të banesës gjirokastrite varianti me dy kthina, i cili kompozohet zakonisht me thyerjen karakteristike volumore, e vendos shtëpinë e zjarrit në pjesën përdhese të katit të banuar, kryesisht për përparësinë që paraqet trualli përdhes i padjegshëm, mbi të cilin ndërtohet vatra. Në shembujt që ruhen ende sot, prej të cilëve shumica datohen të shek. XIX dhe vetëm pak të shek. XVIII, nuk kemi takuar asnjë rast të mungesës së instalimit të tymarit dhe tamburit. Gjithashtu për t'u theksuar është edhe ndërtimi i shpeshtë i tavanit në këto mjedise. Kompleksi musandër-dhipato,

është gjithashtu krahas sqollit dhe dollapëve të murit, një konstante në shtëpitë e zjarrit të varianteve të thjeshta. Me kalimin në banesën trekatëshe shtëpia e zjarrit mbetet në katin e ndërmjetëm në të cilin, ashtu si dhe në variantet e zhvilluara, kalon jeta e familjes në periudhën e ftohtë të vitit. Banesa në rrugën, «A. Toro», Nr. 20 (Tab. 9) është një shembull tipik i kësaj zgjidhjeje. Edhe në variantet e thjeshta të banesës gjirokastrite trekatëshe, fillon shpejt kalimi i funksionit të gatimit, së bashku me ato të pastrimit të enëve, në një kthinë të veçantë pranë shtëpisë së zjarrit. Në këto raste shtëpia e zjarrit merr emërtimin «odaja e dimrit». Banesa në rrugën «R. Gozhita», Nr. 7, e variantit të thjeshtë trekatësh, ka në katin e ndërmjetëm pranë shtëpisë (Tab. 10) mjedisin e gatimit. Ky ndeshet rëndom në variantet e zhvilluara të banesës gjirokastrite. Mjedisi i gatimit brenda volumit të banesës ose si një ndërtim i veçantë në oborrin e parë të saj, është i pajisur zakonisht me vendin e zjarrit me oxhak, furrën e sqollin. Dollapet e murit si dhe platforma për vendosjen e enëve të mëdha prej qeramike janë një dukuri e zakonshme. Mjediset e gatimit brenda volumit të banesës, kanë shpesh edhe një mjedis sanitar pranë. Në variantet e zhvilluara shtëpia e zjarrit nuk ka funksione banimi, dhe praktikisht ajo humbet gjurmët e saj. Megjithëkëtë vërejmë se në mjaft nga variantet e zhvilluara, si një lloj reminishence, në qendër të kompozimit mbetet një mjedis i vogël i cili të kujton menjëherë shtëpinë e zjarrit. Edhe ky mjedis në Gjirokastër thirret «dimërore».

Po të krahasojmë variantet e zhvilluara të banesës gjirokastrite me ato të banesës me çardak do të vërejmë se në tipin e parë shtëpia e zjarrit thuajse shpërbëhet, sepse familja e kalon jetën e përditshme gjatë stinëve të ftohta në «dimërore», një odë e zakonshme me vend zjarri si gjithë të tjerat, ndërsa stinët e ngrohta në mjediset e katit të dytë me shumë volum e dritë. Në banesën e zhvilluar me çardak dimri gjithashtu kalohet në njërin prej odave më të ngrohta, ndërsa në stinët e ngrohta çardaku kryen më shumë funksione banimi, por shtëpia e zjarrit, në shumicën e rasteve, megjithëse me funksione gatimi mbetet në një vend kryesor në kompozim.

Përpara se të kalojmë në evolucionin e këtij mjedisi, në banesën korçare, po qëndrojmë në disa trajtime me interes të shtëpisë së zjarrit si përsa i përket vendit në kompozim, ashtu edhe formulimit të saj.

Siç dihet, tipologjia e banesës shqiptare, ashtu si tipologjia e çdo ndërtimi në përgjithësi, nuk përfshin të gjitha shfaqjet konkrete të shembujve të panumërt të banesave. Shumë prej tyre duke ruajtur të njëjtin program, si përbërësin më të pandryshueshëm e njëherazi kompozime që shmangen ndieshëm nga tipologjia e njohur. Lidhur me vendin e shtëpisë së zjarrit në këtë kompozim, kuptohet se kemi zgjidhje nga më të ndryshmet, ndërsa përsa i përket formulimit të saj ai nuk ka lidhje me vendin në kompozim. Shembujt më me interes të cilët mund të mbahen si zgjidhje të veçanta janë ato të Beratit, veçanërisht banesat e ndërtuara në lagjet Mangalem e Goricë. Shkaku i këtyre duhet kërkuar në truallin mjaft të pjerrët dhe përgjithësisht të aksidentuar. Aty ndërtimet i vishen truallit shkëmbor duke u zhvi-

lluar me kompozime tepër të improvizuara, veçanërisht në katin ose katet e poshtme sepse ndërtimet shpesh zhvillohen plotësisht ose pjesërisht me tre kate. Në katin e banuar, sipas rastit, më të përhapura janë kompozimet me një varg mjedisesh, përgjatë një lloj rrugine që vendoset përbri shkëmbit natyral, ose një muri fundor. Në këto raste shtëpia e zjarrit ndërtohet në njërin nga mjediset ballorë. Një shembull me interes është shtëpia e zjarrit e banesës (Tab. 11) në rrugën «Z. Tole», Nr. 30, në lagjen Mangalem të Beratit. Ajo ka një formë të rregullt planimtriqe. Në ballë është ndërtuar vendi i zjarrit me oxhak, ndërsa anash dy dritare për ndriçimin e mjedisit. Në pjesën fundore ngrihet musandra, ndërsa si zakonisht në muret anësore janë ndërtuar dollape muri dhe kamare. Krahas këtyre kompozimeve me një radhë mjedisesh, më të shpeshta janë ato me dy radhë të tilla, duke pasur në pjesën qëndrore një rruginë ose një lloj salloni të ngushtë ndërlihdës. Në këto zgjidhje mjediset e vargut fundor në shumicën e rasteve nuk kanë mundësi të marrin ndriçim natyral, nëpërmjet dritareve, prandaj ndërtimi i baxhave të gjëra, është një dukuri e zakonshme, pa përjashtuar dritaret që fusin pak dritë nga mjedisi ndërlihdës. Një shtëpi zjarri tipike e banesave të kompozuar me vendosje dy brezash paralele mjedisesh, është ajo e banesës në rrugën «A. Beqari», Nr. 45, gjithashtu në lagjen Mangalem. Trualli i aksidentuar ka bërë që forma planimtriqe (Tab. 12) e saj të jetë e çrregullt. Ajo përmirësohet disi duke ndërtuar në ballin më të pjerrtë një konstruksion druri, ku janë vendosur musandra dhe dollapë. Vendi i zjarrit me oxhak dhe dy kamare karakteristike anash zenë ballin fundor të mjedisit, i cili ndriçohet përveç baxhës, edhe nga dy dritare që dalin në një sallon të vogël. Shtëpia e zjarrit është e shtruar me rrasa guri, sepse ngrihet mbi truallin natyral dhe ka tavan. Një zgjidhje të veçantë paraqet vendi i marrjes së ujit nga stera, e cila është ndërtuar një kat më poshtë dhe mbulohet nga një rrasë guri.

Shtëpia e zjarrit me fillimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve kapitaliste, pëson ndryshime me rëndësi si përsa i përket vendit në kompozim, ashtu edhe trajtimin të saj, sepse ndryshon edhe funksioni i këtij mjedisi në jetën e familjes.

Por krahas ndryshimeve cilësore të shtëpisë së zjarrit në banesën e tipit të ri, siç është banesa korçare, ky mjedis pëson ndryshime të rëndësishme⁴ edhe në tipologjinë e banesës tradicionale. Në përgjithësi ato lidhen me ndryshimet e vendit të zjarrit, i cili tanimë ndërtohet pranë njerit nga muret dhe pajiset me oxhak. Në shumë raste ndërtohet tavani, zgjerohen dritaret dhe fillon prishja e shtretërve, duke i zëvendësuar shkallërisht me orendi.

Në tipin e ri të banesës qytetare shqiptare shtëpia e zjarrit për mjaft arsye e humbet rolin e saj të rëndësishëm në jetën e familjes. Shkaqet duhen kërkuar në vetë evolucionin e mënyrës së të jetuarit, që lidhet me tiparet e ndryshme të familjes borgjeze. Largimi përherë

⁴ E. Riza, *Banesa qytetare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX deri rreth çerekut të parë të shek. XX*. «Monumentet» 20/1980.

e më tepër nga ekonomia bujqësore, marrja e gatshme e shumë produkteve ushqimore, rritja e shkallës së kërkesave për një jetë më të kulturuar bënë që shtëpia e zjarrit tashmë të humbasë parësinë, ose vendin e rëndësishëm në banesë. Në tipin e banesës korçare shpesh gatimi bëhet në një mjedis ndihmës që ndërtohet në oborr. Kjo krijon mundësi për një pastërti më të madhe në banesë. Por kjo dukuri nuk përbën të përgjithshmen, megjithëse është mjaft e përhapur. Shpesh gatimi bëhet në njërin prej mjediseve të banesës, i cili veçanërisht gjatë dimrit është edhe mjedisi i qëndrimit të familjes, që paraqitet si një atrofizim i shtëpisë së zjarrit dhe ndërtohet gjithmonë në katin përdhe të banesës. Ai pajiset me vendzjarri me oxhak. Aty nga fillimi i shek. XX, në mjaft familje fillon të hyjë edhe soba për ngrohje e gatim. Tashti ky mjedis ka përmasa më të vogla, musandrat vijnë e zvo-gëlohen deri sa zëvendësohen me orendi. Kështu, shtëpia e zjarrit bëhet oda e ditës me kuptimin bashkëkohor të fjalës, duke u baras-trajtuar me mjediset e tjera të banimit. Por është e kuptueshme se në banesën qytetare shqiptare të lidhur me formacionin borgjez të shoqërisë, diferencimi klasor gjen shprehjen e qartë edhe në karakterin e këtij mjedisi. Kështu në banesat e shtresave të varfra dhe të mesme të popullsisë qytetare, në një program të kufizuar mjedisesh, oda e dimrit mbetet kthina kryesore ku familja kalon pjesën më të gjatë të ditës.

Shtëpia e zjarrit përbën mjedisin më të lashtë të banesës qytetare shqiptare, e cila si vetë ajo, ka një zhvillim të dallueshëm në kohë, si pasqyruese e mënyrës së të jetuarit. Ajo ndryshon sipas periudhave historike në tre përbërësit thelbësorë: funksionin, vendin në kompozim dhe trajtimin e saj. Shumë tregues në këtë drejtim është krahasimi i këtij mjedisi me tipologjinë e banesave, që lidhen me formacionin feudal të shoqërisë, me atë të formacionit kapitalist.

Por edhe brenda një periudhe të caktuar historike, veçanërisht në formacionin feudal i cili karakterizohet nga një shfaqje e theksuar e pabarazisë së shkallës së zhvillimit ekonomik, ndeshim dallime të shtëpisë së zjarrit nga një qytet në tjetrin, ose ndërmjet disa grupeve qytetesh, të cilat lidhen deri diku edhe me vetë larminë e tipologjisë së banesës qytetare. Po ashtu edhe brenda një tipologjie të caktuar shtëpia e zjarrit ka një evolucion të qartë, shprehje e dallimit klasor. Siç u parashtrua më sipër, në të gjitha tipet e banesës qytetare shqiptare vërehet qartë lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet zvogëlimit të funksioneve të shtëpisë së zjarrit, krahas zhvillimit të varianteve brenda së njëjtës tipologji. Kjo dukuri shpreh kalimin nga banesa me pak mjedise e me shumë funksione në banesën me shumë mjedise, përgjithësisht secila me një funksion. Për t'u vënë re është tipari i qëndrueshmërisë së theksuar të trajtimit të shtëpisë së zjarrit, e cila brenda kuadrit të shoqërisë feudale, edhe në banesa të zhvilluara. madje me trajtim të pasur dekorativ, mbetet në formë primitive. Shembull shumë tregues për këtë janë banesat e zhvilluara me çardak. veçanërisht në qytetin e Shkodrës. Inercia në trajtimin e shtëpisë së zjarrit tregon për një rrënjosje të thellë të saj në jetën familjare, ashtu siç ishte konceptuar nga të parët për breza e breza.

Në bashkëpërqasje me shtëpinë e zjarrit të banesës fshatare, ajo e

banesës qytetare ka paralele herë tepër të afërta deri në identitet e herë ndryshime të rëndësishme cilësore. Kjo lidhet me faktorin e formacionit ekonomik-shoqëror dhe me shkallën e zhvillimit të një qendre të caktuar. Kështu në përgjithësi në kuadrin e formacionit feudal afria e mjedisit në fjalë, ndërmjet fshatit dhe qytetit është e ndjeshme, ndryshe nga formacioni kapitalist, i cili, me thellimin e dallimit ndërmjet fshatit dhe qytetit, krijon kushte dhe për largimin e ndjeshëm ndërmjet këtyre mjedisëve në dy qendrat e përmendura. Në kushtet e vendit tonë, ky dallim nuk paraqiste një dukuri të përgjithshme e të spikatur për arsyen e kuptueshme të mpleksjes, deri vonë në prag të Çlirimit, të marrëdhënieve kapitaliste me mbeturinat e shfrytëzimit feudal e madje jo vetëm mbeturina, veçanërisht në fshat. Pra konkretisht dallimet ndërmjet mjedisit në fjalë në fshat e në qytet me fillimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste lidhen vetëm me njërin përbërës të të dy njësive të krahasuara, dhe pikërisht me zhvillimin e shtëpisë së zjarrit në banesën qytetare të tipit të ri.

Nëse do të krahasojmë shtëpinë e zjarrit me odën e miqve, kjo e fundit për vetë funksionin e saj më të njësuar, paraqitet me një baraz-trajtim më të dalluar sesa shtëpia e zjarrit, e cila përta i përket funksionit paraqitet me dinamikë në kohë e hapësirë. Përkundrazi përta i përket trajtimit të brendshëm të këtyre dy mjedisëve, oda e miqve paraqet një zhvillim relativisht të shpejtë, duke pranuar edhe ndikime në shtresat e pasura të popullsisë, ndryshe nga shtëpia e zjarrit që i qëndroi besnike traditës shumëshekullore.

THE «FIREPLACE ROOM» IN ALBANIAN URBAN DWELLING

The «fireplace room» is the primary, and frequently, the only milieu of the dwelling. Its functions vary perceptibly with the general tendency to their limitation. The most lasting functions of this milieu, that of the preparation of the food, was linked with the fire. The fire was lit in the fireplace, which from old times had a device to take smoke out. The «fireplace room», in general, represents a compositional unit independent from the typology of the dwelling. Its various place in the whole of the Albanian urban dwelling varies according to the functions this milieu performs.


The Tirana dwellings represent more interesting examples of the developed «fireplace room» which, in this type, preserves the central place in all the variants. In the dwelling with a corridor, too, the «fireplace room», plays an important functional role. In the dwelling with a loft and in the Gjirokastra dwelling, as contrasted with the first two types, we observe the passage from the simple to the more developed types, the tendency towards the crumpling of the «fireplace room», which is reduced to a simple cooking place, put up at the secondary part of the building.

In the type of the Korça dwelling, which is an original dwelling of the strata of the urban bourgeoisie, the «fireplace room» loses much of its role in the family life.


With the passage of time, the «fireplace room», the most ancient milieu of the Albanian dwelling, has undergone significant alterations in its three main components: the function, the place of the composition and its treatment.


In comparison with the guests' room, the «fireplace room» has a more dynamic development as far as its function is concerned. On the contrary, the treatment of the interiors of this milieu developed slowly, while remaining for a long time close to the centuries-old tradition, as againsts the guests room which developed more obviously in the shape of its interiors.

Tab. I




Tab. II







Tab IV




Tab. V




Tab. VI




Tab VII




Tab. VIII




Tab. IX




Tab. X




Tab. XI



Tab. XII



Tab. XII



Ali MUKA

NDËRTIMET NË GJYSMËKAT NË FSHATRAT E SHQIPËRISË SË MESME

Gjurmimet në zonat kodrinore e malore të Shqipërisë së Mesme, të bëra në vitet pas Çlirimit, kanë sjellë një material të gjerë dokumentar për ndërtimet popullore të dy shekujve të fundit. Këto gjurmime dhe studimet e deritanishme na japin një tablo të mirë e të pasur të ndërtimeve në përgjithësi dhe të karakterit të banesës në veçanti.

Fshatrat shtrihen në terrene me natyrë të ndryshme. Konfiguracioni i truallit ka shtruar përpara mjeshtrit probleme konkrete të mënyrës së vendosjes së një ndërtimi të caktuar. Kombinimi i kërkesave, me mundësitë që i jepte terreni, e kanë çuar ndërtuesin në realizime të larmishme dhe me interes. Në këto zona gjejmë ndërtime të vendosura në troje relativisht të sheshta dhe të tjera të vendosura, në terren me pjerrësi të ndryshme, paralel ose normal me rënien e tij. Këto realizime, duke plotësuar kërkesat dhe mbarësinë funksionale të diktuar nga vetë fshatari, zbulojnë edhe rolin e rëndësishëm të mjeshtrit ndërtues.

Në këtë punim do të ndalemi në shqyrtimin e ndërtimeve të vendosura normal me rënien e terrenit, në të cilat ka gjetur zbatim koncepti i gjysmëkatit, i njohur që herët në trojet tona dhe që vazhdon të gjejë përdorim deri në kohën e sotme. Duke sjellë material nga zona e krahina që shtrihen në të dy anët e lumit Shkumbin do të përpiqemi të ndriçojmë shkallën e futjes së tij në ndërtimet fshatare të Shqipërisë së Mesme. Vëmëndja do të përqendrohet kryesisht te banesat, pasi ato zënë vendin kryesor e më të rëndësishëm. Këto banesa nuk përbëjnë një tip të veçantë në zonat që shqyrtojmë. Ato paraqesin shembuj me veçori individuale brënda varianteve të tipologjisë së banesës popullore në Shqipërinë e Mesme.

*
*
*

Futja e konceptit të gjysmëkatit në kompozimin volumor të ndërtimeve, të realizuara në terrene të pjerrëta, nuk lidhet as me kategori e lloje të caktuara ndërtimore dhe as me një tip ose variant të cak-



Fig. 1



Fig. 2

tuar banese. Atë e shohim të përdorur në ndërtime të ndryshme ndihmëse e ekonomike (foto 1), në ndërtime të realizuara jo me një material të vetëm ndërtimi, në banesa dykatëshe ose trekatëshe, një-ose dyfamiljare, në banesa me telize (Foto 2) ose me qoshk, në banesat me hajat e me çardak (Foto 3), e deri në tipin e banesës së vjetër tiranase (Foto 4).

Tipari më karakteristik i ndërtimeve të ngritura normal me pjerrësinë e terrenit është realizimi i një volumi me kate, por me shtrirje sipërfaqore jo të barabartë të tyre.

Për ilustrim po shqyrtojmë në fillim disa ndërtime të thjeshta, nga të cilat me interes paraqiten gazhदारët, kasollet dhe ndërtesa e



Fig. 3



Fig. 4

barinjve në stanet verore. Këto zakonisht i bën vetë fshatari për qëllime të caktuara. Praktikiteti e përvoja e gjatë njohëse ka bërë që në realizimin e tyre të kemi një përdorim të arsyeshëm të truallit të pjerrët. Me germime minimale volumi i ndërtimit «i vishet» terrenit në mënyrë të tillë që lejon shfrytëzimin e disa niveleve, deri edhe të nënçatisë, me hyrje drejtpërdrejt nga jashtë, pa ndërmjetësinë e shkallëve, ose me një numër mjaft të kufizuar të tyre.

Kështu, në gazhdaren e paraqitur në *Tab. I*, vërejmë të jenë përdorur dy nivele. Kthinëza e sipërme shtrihet edhe në truallin prej dheu. Në pjesën me dysHEME dërrase depozitohet misri në formë kalinjsh të pashkoqur, ndërsa në pjesën mbi truall janë të pranishme dy gropëza të hapura, me konture të rregullta, të veshura me mure guri dhe të mbuluara me kapakë dërrase. Ato kanë kryer rolin e hambarëve të drithit ose për të mbajtur bulmetin si rezervë për dimër. Mbyllja me kapakë dërrase e bënte të përdorshme edhe hapësirën mbi të. Hyrja realizohet me një derë me përmasa të vogla, të vendosur në ballin e ngushtë fundor të gazhdarit. Veshja e jashtme me binarë dhe çatia me tre kullime lejonin një ajrosje normale të produkteve të depozituara brënda. Kthinëza nën dyshemënë me dërrasa përdorej për mbajtjen e pulave ose të qenit.

I njëjti tipar vërehet edhe në kasolle të llojeve të ndryshme të ndërtuara në këto zona. Vendosja normal me truallin ka bërë të mundur shfrytëzimin me lehtësi edhe të hapësirës nën mbulesën e catisë (Foto 5, 6). Kasolle të tilla janë ndërtuar sidomos pranë lëmenvje për depozitim të kashtës ose në oborrin e banesës për ruajtjen e barit të thatë. Kthinëza përdhese, në varësi të madhësisë, është përdorur ose për mbajtjen e gjësë së gjallë (Foto 7), ose si vend ruajtjeje për vegla bujqësore, e deri edhe për mbajtjen e druve të zjarrit. Shëmbulli i sjellë në *Tab. II*, 2 ilustron karakterin e kasolles që përshkruam.

Ndërtime me karakteristikat e mësipërme janë bërë edhe në stane. Këtu mbahej bagëtia e imët në periudhën e verës, nga një ose disa familje së bashku. Një ndërtim përdhes, ose pjesërisht i tillë, ka qenë element me rëndësi i stanit. Ai ngrihej zakonisht me mure guri e çati të mbuluar me kashtë, furde ose rrasa guri. Rreth tij, në një ose dy anë, sajohen vathë, numri i të cilave ishte në varësi nga lloji i bagëtisë që mbahej në stan. Pranë secilës vathë sajohej gjithashtu një «shtrunjë» ose «shtrungë». Ndërsa në vathë bagëtitë qëndronin natën, në shtrungë ato kalonin vetëm për t'u mjelë. Vatha e shtrunga lidhe-shin midis tyre me një derë. Rrethimi i vathës dhe i shtrungës bëhej me shkurre e ferra, me gardh purtekash ose me dërrasa sopate, me një lartësi rreth 1,60 m, duke ndjekur konfiguracionin e terrenit. Një shëmbull të tillë, ku janë të pranishëm të gjithë elementet e një stani, e kemi gjetur në fshatin Kostenjë të Çermenikës (*Tab. II*, 1). Ndryshe nga rastet e shumta, kur ky ndërtim bëhej me përmasa të vogla, shëmbulli që sjellim është një ndërtesë pjesërisht dykatëshe,



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

e cila nuk dallon aspak nga një banesë e zakonshme (Foto 8). Kati i sipërm, i shtrirë përtej përdhesis, shërbente për të jetuar barinjtë dhe një pjesë e familjes, që në verë shkonte në stan. Në katin e poshtëm mbareshin kafshët e ngarkesës. Në kohë të keqe mund të futej aty përkohësisht një pjesë e bagëtisë. Për këtë dëshmon edhe fakti që vendasit e quanin «hajati i bagëtive».



Fig. 8

Në të tre shembujt e sjellë nga ndërtimet ndihmëse, duket se ka gjetur zbatim koncepti i gjysmë-katit. Ky zbatim nuk ka qënë një gjë e rastit. Karakteri i ndërtimit dhe kërkesat funksionale kanë luajtur një rol parësor. Mënyra se si janë realizuar këto kërkesa flet natyrshëm për një përvojë të mirë njohëse në përdorimin me leverdi të trojeve të pjerrëta. Ndërtime të karakterit që përshkruam, sidomos kasollet, janë përdorur gjerësisht në zonat kodrinore e malore të Shqipërisë së Mesme. Konceptime si ai që pamë në ndërtesën e stanit, të kujtojnë ndërtime të përdorura për banimin e familjes, të cilat do t'i shqyrtojmë gjerësisht më poshtë.

Ndër banesat e ndërtuara në troje të pjerrëta, zgjidhjet më të thjeshta i përkasin atij grupi ku «shtëpia e zjarrit» është e vetmja kthinë banimi e familjes. Të tillë janë shembujt e sjellë në *Tab. III; 1, 2*; të gjetur në fshatrat e Sulovës së Sipërme. Shembulli i parë ka një mënyrë organizimi të brendshëm të kthinës, me veçoritë e veta. Aty familja plotësonte të gjitha nevojat jetësore. Banesa është e vendosur në një terren me pjerrësi të zbutur. Brenda volumit të vetëm, me një ndarje të lehtë me gardh, veçohet pjesa ku jetonin njerëzit nga pjesa ku mbahej bagëtia. Këndi i bagëtisë ndodhej 60 cm. më poshtë nga këndi ku rrinin njerëzit. Familja që ka jetuar aty, ka qënë e vogël dhe një nga më të varfrat e fshatit. Suvatimet e brendshme me baltë dhe oxhaku i pajisur me vatër, tambur e tymar janë bërë më vonë. Në ditët tona ky ndërtim përdoret si depo dhe familja ka ndërtuar në afërsi një banesë të re. Pamundësia ekonomike e familjes dhe nevoja e veçimit të pjesës për banim, nga ajo për mbajtjen e bagëtisë, janë arsytet që kanë diktuar një realizim të tillë si

ai që përshkruam. Gjurmë të rralla banesash të tilla kemi gjetur edhe në Shpatin e Sipërm dhe në Malësinë e Tiranës.

Në shembullin e dytë (*Tab. III*) kemi përsëri një ndërtim me një kthinë banimi. Ngritja në truall të pjerrët është paraprirë nga një kërkesë tjetër, e ndryshme nga ajo e rastit të parë. Këtu është ndjerë nevoja e krijimit të një kthinëze të vogël nën dyshemenë me dërrasa të ambientit të banimit. Kjo kthinëz përdorej më shumë si depo, pa derë të jashtme, por me komunikim nga sipër, nëpërmjet një kapaku dërrase dhe shkallëve të lëvizshme prej druri. Edhe në këtë banesë ka jetuar një familje e vogël dhe ekonomisht e varfër. I vetmi element i ndërtuar me përkujdesje është porta e hyrjes. Hapësira e saj rrethohet nga një mbulesë me gurë të skalitur të vendosur në formë harku. Të tilla dyer kanë gjetur përdorim të gjerë në banesat e Sulovës, jo vetëm në hyrjen e jashtme, por edhe në ato që lidhin kthinat me njëra tjetrën.

Banesa të realizuara në troje të pjerrëta dhe me një kthinë të vetme banimi kemi gjetur edhe në zona të tjera. Të tillë janë dy shembuj nga Gryka e Zaranikës (*Tab. IV, 2, dhe Tab. V*) dy nga Malësia e Tiranës dhe një nga Martaneshi¹. Në të gjithë këta shembuj vërehet që raporti midis pjesës së katit të banimit, që shtrihet mbi truallin prej dheu, dhe pjesës me dysheme dërrase të tij, nuk është i njëllojtë. Ky raport i është diktuar ndërtuesit nga propositësi, sipas nevojave që ka pasur. Në pjesën mbi truall të kthinës së banimit, elementi kryesor është vatra e hapur, e vendosur zakonisht disi pranë murit. Aty merrnin përparësi funksionet e mbajtjes, të gatimit dhe të ngrënies së ushqimit, ndërsa në pjesën tjetër, me dysheme dërrase, merrnin përparësi funksionet e qëndrimit, të fjetjes dhe të pritjes së mikut. Në shembullin nr. 1 nga Malësia e Tiranës, ky raport është më i ekuilibruar. Kthina fillestare e banimit, me përmasa të mëdha, në një etapë të dytë, është ndarë duke na dhënë dy kthina të veçanta, secila me funksionet e saj. Hapja e një dërrase tjetër për kthinën që del mbi katin përdhes, e ka përforcuar më tej këtë ndarje. Për këtë flet edhe realizimi i dy nyjeve sanitare, nga një për secilën kthinë. Në këtë fazë kthina fundore ka shërbyer si shtëpi buke ndërsa kthina ballore si odë miqsh. Ndryshe nga ky rast në shembullin nga Fusha e Domosidovës (Foto 9), (*Tab. VI, 2*), në katin ku banon familja përveç kthinës përdhese në ballin e saj është sajuar një kënd pritjeje dhe qëndrimi për periudhën e ngrohtë të vitit. Për këtë flet prania e «oxhakut të kafesë», sikurse e quajnë vendasit. Në rastet më të zakonshme kthina në katin përdhes është përdorur për strehimin e kafshës së ngarkesës dhe të qeve të punës. Në ndonjë rast, si ai në shembullin e *Tab VI; 2*, kjo kthinëz me përmasa të vogla është përdorur si vend depozite.

1) A. Muka *Banesa fshatare në Malësinë e Tiranës gjatë shek. XIX e fillimit të shek. XX*. «Etnografia Shqiptare» IX, Tiranë, 1978, Tab. VIII, f. 237. A. Muka *Arkitektura e banesës fshatare në Martanesh* «Etnografia shqiptare» VII, Tiranë, 1976, Tab. VIII, f. 237.

Në të gjithë shembujt e sjellë deri tani duket qartë futja e konceptit të gjysmëkatit në kompozimin volumor të banesës. Kjo nuk ka ndikuar në tiparet karakteristike që e dallojnë banesën e një zone nga një tjetër. Fjala vjen, në studimet e deritanishme është treguar se në zona të tilla si Çermenika, Martaneshi, Shmili ose Malësia e Tiranës, tipi mbizotërues i banesës tradicionale njihet në popull me emrin «banesa me telizë».



Fig. 9

Shembujt që sollëm nga këto zona i ruajnë të gjitha karakteristikat tanimë të njohura të kësaj banese. Po ashtu, studimet kanë treguar se në zonat kodrinore të Shqipërisë së Mesme (përfshirë dhe luginën e Shkumbinit) ka gjetur përdorim banesa me hajat ose me çardak². Në shembujt e sjellë nga Gryka e Zaranikës ose nga Fusha e Domosdovës, ndonëse është zbatuar kon-

cepti i gjysmëkatit, tiparet që karakterizojnë tipin përkatës nuk janë tjetërsuar. Pa hyrë në hollësi, e njëjta gjë ndodh edhe me shembujt e sjellë nga banesa e përhapur në Sulovë.

Banesat njëkthinëshe në përgjithësi nuk kanë pasur përdorim të gjerë në këto zona. Në ditët tona jo vetëm nuk i gjen më në përdorim për banim, por edhe janë mjaft të rralla. Në mjaft raste ato kanë pësuar shtesa e shndërrime, duke ndryshuar rrënjësisht edhe karakterin fillestar të përdorimit. Brenda zonave ku janë marrë, ato përfaqësojnë shembuj të thjeshtë të varianteve të tipit të banesës së përdorur. Duke ruajtur veçoritë lokale, bie në sy se këta shembuj kanë edhe gjera të përbashkëta. Kryesorja që i bashkon qëndron në mënyrën e vendosjes ndaj truallit dhe në mënyrën e shfrytëzimit të tyre nga familjet që i kanë përdorur.

Një përdorim relativisht më të gjerë kanë pasur banesat e vendosura normal me rënien e terrenit dhe me dy kthina banimi. Të tilla janë shembujt në Tab. IV; 1 (Shëmil), në Tab. VI; 1 (Shpat) në Tab. VII (Fusha e Domosdovës), në Tab. VIII (Herr-Tiranë), në Tab. IX (Martanesh), në Tab. X (Baldushk-Tiranë) dhe në Tab. I; 2 (Sopot-Librazhd). Disa tipare që vërehen në këta shembuj janë:

1) Dy kthinat e banimit, janë «shtëpia e bukës» dhe «oda e miqve». Ato qëndrojnë ngjitur me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë

2) A. Muka. *Tipe banesash në disa fshatra të Librazhdit*. «Etnografia shqiptare» X. Tiranë 1979, f. 198.

që e para zë gjithmonë pjesën fundore, ndërsa e dyta pjesën bailore të banesës. Këto kthina kanë hyrje të veçanta nga jashtë, por edhe derë të brëndshme që i ndërlidh me njëra-tjetrën. Përmasat e këtyre kthinave janë thujtë të njëjta, ndërsa ndryshojnë nga shkalla e formulimit të brëndshëm që është në varësi nga funksionet që kryejnë dhe nga veçoritë e banesës së zonës. Kjo duket më qartë në odën e miqve, si kthina më paraqitëse në raport me shtëpinë e bukës.

2) Kati përdhes paraqitet me shtrirje më të kufizuar nga kati i sipërm. Ky tipar shpreh qartë zbatimin e konceptit të gjysmëkatit në ndërtimin e këtyre banesave. Në këtë drejtim vërehen dy raste si më tipikët. Rastin e parë e më kryesorin e përfaqësojnë ato banesa, në të cilat shtrirja e katit të sipërm në truallin prej dheu lidhet me përmasat në plan që është kërkuar t'i jepen «shtëpisë së bukës», e cila në këtë rast është krejtësisht përdhese. Kjo duket në shembuj të tillë si: banesa nr. 1 (Tab. VI), banesa në Tab. VIII, banesa në Tab. IX, banesa në Tab. X dhe banesa nr. 2 (Tab. I). Në këta shembuj përmasat në plan të kthinës në katin përdhes janë të njëjta me ato të odës së miqve, që ndodhet gjithnjë mbi të. Kjo strukturë planimetricke e volumore takohet në zonat në shqyrtim me përdorim disi më të gjërë. Kthina e katit përdhes ka kryer më shumë funksionet e «burgut» ku strehoheshin sidomos kafsha e ngarkesës dhe qetë e punës. Përveç hyrjes së veçantë nga jashtë, ajo lidhet me katin e sipërm nga brenda me anë të shkallëve prej druri dhe të një kapaku dërrase të lënë në dyshemenë e odës së miqve. Kjo hyrje e brëndshme përdoret për të kontrolluar bagëtinë natën, sidomos në periudhën e dimrit. Ajo

shërbente edhe si dalje e fshehtë e njerëzve të familjes në raste të veçanta rreziku. Në disa zona kthina e katit përdhes është përdorur edhe për qëllime të tjera. Kështu nga shëmbulli (Foto 10) i fshatit Herr të Tiranës (Tab VIII), në këtë kthinë është vendosur mulliri i vajit. Në fshatrat kodrinore të rrethit të Tiranës, me tradita të njohura në kultivimin dhe përpunimin e ullirit, kjo ka qënë një dukuri thujtë e zakonshme. Të njëjtën gjë



Fig. 10

e kemi vërejtur edhe në ndonjë fshat të Grykës së Zaranikës (si në Godolesh), ku gjithashtu ka pasur tradita në nxjerrjen e vajit të ullirit. Në Shpatin e Sipërm dhe në Sulovën e Sipërme kjo kthinë është përdorur edhe për nxjerrje vere ose rakie dhe nënproduktesh të tjera nga rrushi.

Rasti i dytë lidhet me ata shembuj, ku edhe vetë «shtëpia e bukës» është pjesërisht përdhese (Banesa nr. 1, Tab. IV dhe banesa në Tab. XI). Këtu vërehet se në pjesën me dysHEME të «shtëpisë së bukës» sajohej një kthinëz tjetër, zakonisht me përmasa të vogla. Ajo vishej nga brenda me mur guri dhe përdorej sidomos për mbajtjen e bulmetit e të rezervave dimërore të familjes. Në Godolësh në një kthinëz të tillë, të lyer nga brenda edhe me llaç, depozitohej ulliri i papërpunuar. Një aneks të tillë, të lidhur kryesisht me shtëpinë e bukës, e gjejmë të përdorur në Çermenikë, në Martanesh e në Shmil. Veçanërisht në Malësinë e Tiranës atë e kemi taktuar edhe të hapur posaçërisht, në një kënd të shtëpisë së bukës, të njohur nga banorët me emrin «quri i bulmetit». Ai mbulohet nga sipër me kapak dërrase dhe nuk dallohet me një shikim të zakonshëm. Këtë njësi volumore, që shoqëron *shtëpinë e bukës*, e vumë re edhe në banesat njëkthinëshe që trajtuam. Shembujt që shqyrtojmë nuk e kalojnë, si ndërtim, shekullin XIX ose e shumta fundin e shekullit XVIII. Megjithatë, nisur nga vendi që ze në shtëpinë e bukës, roli që luan dhe kërkesat modeste në realizimin e tij, shtyhemi të mendojmë se ky element, ashtu si vetë kthina ku ndodhet, duhet të jetë me përdorim të hershëm në banesën tonë fshatare.

Edhe në banesat me dy kthina banimi, të ndërtuara në terren të pjerrët, zbatimi i konceptit të gjysmëkatit nuk ka çuar në asnjë ndryshim të atyre tipareve që karakterizojnë tipologjinë e banesës së një zone të caktuar. Për ilustrim le të ndalemi tek dy shembujt e sjellë nga fshatrat Herr dhe Baldushk të rrethit të Tiranës, (Tab. VIII dhe Tab. X.). Te këta shembuj bie në sy se shtëpia e bukës nuk e ka dysHEMENË në një nivel me atë të «odës së miqve», por më poshtë saj dhe komunikon me të me shkallë të brendshme. Kjo specifikë të kujton shembujt të thjeshtë të variantit kryesor të banesës së vjetër tiranase, që karakterizohet nga «shtëpia e zjarrit» me lartësi përgjatë dy kateve. Këtë veçori nuk e shohim të realizuar plotësisht në të dy shembujt. Me sa duket shmangia e gërmimeve të panevojshme kanë diktuar zgjidhjet e mësipërme. Po ashtu banesat dykthinëshe që analizuam ruajnë mjaft elemente arkitektonike karakteristike për zonat ku janë ndërtuar. Për këtë flet prania e hajatit (Foto 11) në banesat nga Fusha e Domosdovës (Tab. V, 2 dhe Tab. VII) ose në banesën nga Gryka e Zaranikës (Tab. IV, 2). Po ashtu për këtë flet prania e telisit (Foto 12) në banesën nga Shmili (Tab. IV, 1) e në atë nga Martaneshi (Tab. IX), ose prania e ballkonit të hapur në shembullin nga Shpati (Tab. VI) e në atë të Baldushkut (Tab. X) etj.

Banesat që shqyrtoam janë përdorur nga familje relativisht të vogla për nga numri i pjesëtarëve. Përveç këtyre nuk mungojnë edhe banesa me një konceptim të njëjtë në mënyrën e vendosjes ndaj terrenit, por të përdorura nga dy familje. Të tillë janë shembujt e sjellë në Tab. VII, 1, 2, nga Shpati i Sipërm dhe nga Polisi. Kompozimi i tyre planimetrik e volumor karakterizohet nga përngjitja e dy skemave të njohura të banesave për një familje. Në këtë mënyrë, nën një çati kanë jetuar dy familje të ndara, pa ndërlihdje

të brendshme me njëra-tjetrën*. Pjerrësia e terrenit është shfrytëzuar në një mënyrë të tillë që vetëm shtëpia e bukës të dalë përdhese për secilën familje. Në pjesën ballore janë vendosur të dy odat e miqve, duke pasur secila edhe «burgun» për bagëtinë në katin përdhës. Në




Fig. 11




Fig. 12

Polis dhe në Shpatin e Sipërm, banesat e ndërtuara në këto dy shekujt e fundit, kanë mjaft gjëra të përbashkëta. Të dy shembujt e sjellë e ilustrojnë qartë këtë tipar jo vetëm në strukturën planimetrike e volumore e në formulimin e brendshëm të kthinave me destinacion të njëjtë, por edhe në veshjen e jashtme arkitektonike.

Ndonëse në masë të kufizuar, në zonat malore të Shqipërisë së Mesme janë ndërtuar edhe banesa dy ose trekatëshe të vendosura normal me rënien e terrenit dhe të përdorura nga familje me numër relativisht të madh pjesëtarësh. Kjo ilustrohet me shembujt e sjellë në *Tab. XI*, në *Tab. XII*, në *Tab. XIV*, në *Tab. XV*, në *Tab. XVI* dhe në *Tab. XVII*. Banesa të tilla me një numër të madh kthinash për banim ose janë ndërtuar njëherësh ose kanë pësuar shtesa në kohë, sipas nevojave që i lindnin familjes. Në të gjithë këto shembuj shtëpia e bukës është vendosur në pjesën fundore dhe është pjesërisht përdhese e shoqëruar me një kthinë të vogël nën dyshemenë me dërrasa. Oda e miqve është vendosur në pjesën ballore të banesës. Kthinat e

*) Ndërsa shembulli i Shpatit është ndërtuar që në fillim për dy familje, banesa e Polisit në fillim i ka shërbyer familjes së pandarë. Dera e brendshme që ndërlihte kthinat, me ndarjen e familjes në dysh u mbyll dhe nuk u përdor më.

tjera kanë shërbyer për fjetjen e kurorave. Në banesën e *Tab. XI*, dy kthina të tilla përdhese i janë përngjitur nga dy anët shtëpisë së bukës e komunikojnë me të. Në banesën e *Tab. XIII* (Foto 13) vërejmë një strukturë planimetrike të katit të sipërm disi të veçantë. Edhe këtu oda e




Fig. 13

miqve ka zënë ballin e banesës, ndërsa shtëpia e bukës vjen prapa saj. Veçse ndarja e këtyre kthinave nuk është e plotë, tipar që vërehet edhe në dy ndarjet e vogla të sajuara në pjesën fundore të shtëpisë së bukës. Të krijohet përshtypja se i gjithë volumi i katit, ku ka banuar familja, ka qenë njëkthinësh. Me kohë janë bërë ndarje të brendshme. Nga një anë ato lejojnë një komunikim të lirë në mbarë katin dhe nga ana tjetër veçojnë sipërfaqet e banimit sipas funksionit që kryejnë. Kjo banesë është e ndërtuar në një lagje të fshatit Gurakuq (Çermenikë) dhe mbahet si një nga më të vjetrat. Ndonëse nuk ka gjurmë të plota, ideja që banesa ka qenë njëkthinëshe e më vonë ka pësuar modifikime, nuk përjashtohet. Një supozim tjetër do të ishte prania e ndarjeve të lehta prej druri në fazën e parë. Prania e tri dyerve për hyrje nga jashtë, flet në të mirë të këtij supozimi.

E ngjashme me dy shembujt e mësipërm është edhe banesa e sjellë në *Tab. XV*. Ndonëse ka shtesa të vonshme, ose modifikime të brendshme, skema e përgjithëshme e banesës është kompakte. Në të dy anët e «shtëpisë së bukës», janë shtuar edhe kthina të tjera që kanë shërbyer për fjetjen e çifteve. Ato njihen nga banorët me emrin «shtrate». Këndet ndërmjetëse, që formohen përpara hyrjeve nga jashtë për në shtëpinë e bukës, njihen me emrin «hajate». Nga dy kthinat ballore është punuar me një përkujdesje të veçantë ajo djathtas, e cila ka kryer funksionet e odës së miqve. Kthina majtas, e përpunuar vetëm pjesërisht, është përdorur për fjetje. Ndërmjet dy kthinave ballore të ndara në mes me perde dërrase është formuar një rrugicë, në ballin e së cilës ndodhet një musandër ku mbaheshin teshat e fjetjes për miqtë. Shtëpia e bukës është pjesërisht përdhese. Në truallin prej dheu është vendosur një vatër e hapur, përmbi të cilën qëndron shkorsi në formë trung piramide. Përveç hambarit për mbajtjen e bereqetit, në kthinë ndodhet gjithashtu magjja për gatimin e bukës, këndi ku lihen enët e gatimit, të ngrënies dhe ato të mbajtjes të ujit. Nën pjesën me dysheme dërrase është sajuar një aneks me funksionet e qurit të bulmetit.

Familja që ka jetuar në këtë banesë ka pasur pesë çifte të martuara në përbërjen e saj. Në një faqe muri të *qepenit* (qoshkut të

brendshëm) janë skalitur në një gur tre emra dhe një datë e palexueshme qartë. Pronarët e sotëm të banesës thonë se ata janë mjesntrit ndërtues dhe kanë qënë dy nga Gurakuqi e një nga Shëngjergji i Tiranës. Mendohet të jetë ndërtuar aty nga fundi i viteve '20 të shekullit tonë. Bindja jonë është se banesa duhet të jetë më e vjetër. Caku i mësipërm kohor që japin banorët ndoshta lidhet me punime të brendshme druri të kryera në odën e miqve, të cilat duken më të vona se koha kur është ndërtuar banesa.

Me interes paraqiten edhe dy shembuj në *Tab. XIV*, nga Malësia e Tiranës. Bërthama kryesore e banesës n. 1 është shtëpia e bukës, pjesërisht përdhese. Në ballin e saj e në komunikim me të janë ndërtuar oda e miqve, tri kthina për fjetjen e çifteve dhe një depo. Pjesa me dysheme e shtëpisë së bukës me thellësi jo deri në nivelin e katit përdhes është përdorur si «qur bulmeti». Familja që ka jetuar në këtë banesë ka pasur tre kurorë dhe fëmijët e tyre. Edhe në banesën nr. 2 (*Tab. XIV*) bërthama e parë formohej nga shtëpia e bukës dhe oda e miqve. Në një fazë të dytë, në pjesën fundore të shtëpisë së bukës është ngritur një volum dy katesh (Foto 14). Kati i sipërm është përdorur për fjetje, ndërsa përdhësi, që shkon më thellë nga niveli i dyshemesë së shtëpisë së bukës, është përdorur në një kohë edhe për mbajtjen e ndonjë bagëtie të imët.*



Foto. 14

Në shembujt që shqyrtoam (*Tab. XI, Tab. XII, Tab. XIII, Tab. XIV dhe Tab. XV*), bie në sy që në kompozimin volumor të tyre ka gjetur zbatim koncepti i gjysmëkatit. Aksi gjatësor i këtyre ndërtimeve bie normal me rënien e terrenit. Për banim shfrytëzohet vetëm kati i sipërm. Në kompozimin planimetrik të këtij kati të tërheq vëmendjen roli i rëndësishëm që luan shtëpia e bukës, jo thjesht për funksionet që kryen, por për vendin që zë në kompozim. Më i spikatur ky rol e ky vend i saj zbulohet në shembullin e *Tab. XV* dhe në banesën nr. 1 të *Tab. XIV*. Veçanërisht në rastin e parë, me realizimin e kthinave përreth kësaj bërthame, kompozimi i katit të banimit ka marrë një shtrirje të dukshme horizontale, duke na dhënë një skemë

*) Për shkak të dëmtimit, oda e miqve u hoq nga trualli ku ndodhej më parë dhe pronari ndërtoi një volum të ri dykatësh, ngjitur me shtëpinë e bukës, në të majtë të saj.

mjaft kompakte. Këtu del i qartë roli parësor i shtëpisë së zjarrit si qendër kompozimi. Parësia e saj del edhe nga përmasat e mëdha dhe nga ndërlidhja e drejtpërdrejtë me kthinat e ndryshme të vendosura përreth.

Banesa me kompozime të tilla të shtrira, me bërthamë qendrore dhe me një numër kthinash për fjetjen e kurorëve, dëshmojnë për jetesën e një kolektivi me shumë pjesëtarë. Këto familje e kanë pasur të nevojshme një kthinë qendrore me përmasa më të mëdha nga të tjerat. Në këtë kthinë kryhen punët kryesore shtëpiake dhe në momente të caktuara të ditës aty grumbullohen të gjithë pjesëtarët e familjes. Pra kjo kthinë bart funksione të rëndësishme, edhe pse ndërtohen ose shtohen kthina të tjera të vogla. Fjala vjen, ajo asnjëherë nuk i humbet jo vetëm funksionet e përgatitjes e të ngrënies, por edhe funksionin e vendqëndrimit gjatë ditës të një pjese ose të gjithë familjes. Kthinat që shtohen rreth saj, kanë funksione të ngushta e të përcaktuara, si fjala vjen, për fjetjen e çifteve me fëmijë e tyre të vegjël. Ky shtim i kthinave flet në radhë të parë për praninë e një familjeje të madhe, por ai duhet parë edhe si shenjë e ngritjes së kulturës së banimit.

Kompozime si ai që dëshmojnë shembujt në *Tab. XI*, në *Tab. XIII*, në *Tab. XIV* dhe në *Tab. XV*, i kemi talkuar me numër të kufizuar në Çermenikë e në Shmil, ndërsa disi më shumë në fshatrat e Tiranës. Një skemë e tillë të kujton mjaft tipare të një tipi të lashtë banese të njohur me emrin «banesa tiranase», emër që e ka marrë nga përhapja e gjerë që ka pasur në këtë trevë. Kjo banesë, veçanërisht në fshatrat e malësisë së Tiranës dhe në fshatrat kodrinore përreth qytetit, paraqitet me dy variante. Varianti më klasik i saj, i realizuar në troje të sheshta, është ai me shtëpi zjarri përgjatë dy kateve. Tiparet që karakterizojnë variantin e dytë duken në shembujt që sollëm më sipër. Në këtë variant shtëpia e zjarrit përsëri luan rolin e bërthamës qendrore, por ka vetëm lartësinë e një kati. Kompozime të tilla janë të njohura edhe në zona të tjera. Kështu në krahinën e Matit banesat e vjetra që kanë ekzistuar përpara përhapjes së kullës, kanë qenë të mëdha e të shtrira³. Veç kujtimit të trashëguar nga vendasit, ndonjë shembull i tillë është gjetur në fshatrat Benjë, Plani i Bardhë, Derjan, Lis etj. Disa nga këto banesa, veçanërisht ato të Gurit të Bardhë, janë ndërtuar në terrene të pjerrëta, dykatëshe, me një skemë kompozicionale me gjysmëkat⁴. Nisur nga disa prej këtyre banesave, që mbajnë të shënuar vitin e ndërtimit, është shfaqur mendimi se qysh në shek. XVIII kompozimi në plan horizontal i kthinave ka qenë një praktikë e njohur. Në këto kompozime bie në sy që shtëpia e zjarrit ka qenë e madhe dhe ka luajtur rol të rëndësishëm jo vetëm funksional, por edhe kompozicional⁵.

Një kompozim të tillë kemi pasur rastin ta shohim në vitin 1980 në një banesë në fshatin Zym (Has) të Prizrenit. Kati i sipërm

3) P. Thomo, «Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore», Tiranë, 1981, f. 182.

4) *Po aty*, f. 162.

5) *Po aty*, f. 247-248.

i saj kishte një kompozim planimetrik mjaft të ngjashëm me shembujt që shqyrtoam. Shtëpinë e zjarrit, me përmasa të mëdha, e paraprinte një hajat me dalje të vogël. Përveç odës së miqve, të vendosur në ballë, me shtëpinë e bukës kishin lidhje të drejtpërdrejtë edhe kthina të tjera më të vogla që, me sa duket, do të kenë shërbyer për fjetjen e çifteve. Pra kemi të bëjmë me një familje relativisht të madhe. E gjithë banesa çarkohej nga dy anë në katin e sipërm me një ballkon të hapur prej druri, i cili lidhej në njërin krah edhe me hajatin e shtëpisë së bukës, (Foto 15, 16).



Foto. 15

Përveç banesave dykatëshe, takohen edhe banesa trikatëshe, të vendosura normal me rënien e terrenit. Kjo ilustron me shembujt e sjellë në *Tab. XVI*, 1, 2 dhe në *Tab. XVII*. Në banesën nr. 1 (*Tab. XVI*) në fazën e parë të ndërtimit ka pasur dy kthina në katin e sipërm, dy në të mesit dhe vetëm një në katin përdhes. Në këtë fazë nga të pesë kthinat që ka pasur banesa, vetëm tre (dy të katit të sipërm dhe kthina ballore e katit të mesit)




Foto. 16

përdoreshin për banimin e familjes. Në një fazë të dytë brenda shtëpisë së bukës, që ndodhet në pjesën fundore të katit të sipërm, janë realizuar dy kthina të vogla për fjetjen e dy çifteve. Në një fazë të mëvonshme edhe kthina fundore e katit të mesit është përshtatur për banim. Realizimi i kthinave me përmasa të mëdha qysh në fazën fillestare të ndërtimit të banesës nuk e ka penguar familjen që në kohë të ndryshme t'i zgjidhë nevojat e saj brenda tyre me përshtatje ose sajime kthinash të reja. Në fazën që e kemi fiksuar banesën, aty kanë jetuar katër kurorë me fëmijë e tyre. Banesa nr. 2 (*Tab. XVI*) dhe banesa në *Tab. XIV* janë përdorur respektivisht nga dy familje. Kompozimi i secilës prej tyre të kujton

përsëritjen dy herë të banesës trekatëshe që shqyrtoam më lart. Për këtë flet simetria e plotë e kthinave përballë murit ndarës gjatësor. Terreni i thyer dhe vendosja e banesave normal me të, ka lehtësuar hyrjet e veçanta për secilin kat, të vendosura në anë të kundërta për çdo familje. Dy kthinat ballore të katit të tretë në banesën nr. 2 (Tab. XVI) në fillim kanë qenë një e vetme. Prania e dy oxhaqeve përkundrajt njëri-tjetrit, qoshku në mesin e faqes ballore dhe dy hyrje për në kthinat fundore, kanë favorizuar ndarjen e saj në dy pjesë simetrike, gjë që ka ndodhur kur familja është e ndarë më dysh. Banesa është vendosur në një truall me pjerrësi të butë. Kjo ka bërë që kati i mesit dhe ai përdhes të dalin respektivisht me nga dy kthina. Për të mënjeluar gërmimet dhe për të rritur lartësinë e katit të mesit, dyshemeja në shtëpinë e bukës të secilës familje ka dalë me dy nivele. Është krijuar kështu një podium me lartësi rreth 1 m. nga trualli, i cili është shtruar me dysheme dërrase. Nëpërmjet këtij «shtrati» komunikohet me odën e miqve të secilës familje. Ai është përdorur pjesërisht edhe për fjetje. Një element i tillë të kujton *mafilin* e shtëpisë së zjarrit në banesën fshatare të Tiranës⁶ ose «shtratin» në ndërtimet e njohura me emrin «çiflig» të Shpatit të Sipërm⁷. Në pjesën fundore janë shtuar për secilën familje nga dy kthina të vogla, që kanë shërbyer për fjetjen e çifteve. Me kohë në




Foto. 17

këtë banesë janë bërë edhe shtesa e modifikime të tjera, sipas nevojave që kanë pasur familjet e ndara. Banesa ka kaluar tri faza kryesore ndërtimi. Pjesa më e vjetër (Foto 17) ka mbi 100 vjet që është ndërtuar. Fazën e dytë e përbëjnë shtesat në krahun e djathtë që janë bërë në vitet '20 të shekullit tonë, ndërsa faza e tretë i përket vitit 1942, sipas një shënimi që ka të skalitur në një faqe muri. I gjithë ky kompleks i takonte së pari një familjeje të vetme, e cila më vonë u nda në dy familje të veçanta.

Banesat trekatëshe për një ose dy familje, të ndërtuara në troje të pjerrëta, janë të rralla dhe takohen në fshatra të Çermenikës, të Shmilit e të Malësisë së Tiranës. Një shembull të vetëm e kemi gjetur në luginën e Shkumbinit, në fshatin Pishkash. Në të tilla banesa kanë jetuar familje me gjendje ekonomike relativisht më të mirë nga të tjerat.

6) A. Muka. *Banesa fshatare në Malësinë e Tiranës...* art. cit. f. 226, 230, 246,
7) A. Muka, *Vendbanimet dhe ndërtimet popullore në Shpat* art. cit. f. 217, 220.

Ndërtimet popullore në zonat kodrinore e malore të Shqipërisë së Mesme janë realizuar në terrene të ndryshme, në varësi nga kushtet që kish dhe nga kërkesat që shtronte vetë fshatari ndaj tyre. Kur janë realizuar në terrene të pjerrëta, në kompozimin volumor të tyre, ka gjetur zbatim edhe koncepti i gjysmëkatit. Tipari dallues që flet për këtë zbatim është shtrirja e pabarabartë e kateve përkundrejt terrenit. Me këtë vendosje, pa cënuar programin e kërkesave, është realizuar një ndërtim racional, i lidhur në mënyrë organike me terrenin e në përshtatje me konfiguracionin e tij. Në zbatimin e këtij koncepti ndërtuesi nuk është lidhur as me një kategori të veçantë ndërtimore dhe as me një tip të vetëm banese. Këtë zbatim nuk e ka frenuar as përbërja numerike e familjes. Shembujt që sollëm janë përdorur jo vetëm nga familje të vogla, por edhe nga familje të mëdha, jo vetëm nga një familje, por edhe nga dy të tilla që jetonin të ndara nën një çati. Pra, zbatimi i këtij koncepti përfshin mbarë tipologjinë e banesës fshatare në Shqipërinë e Mesme. Madje, siç është vënë në dukje⁸, ky koncept ka gjetur përdorim në mbarë tipologjinë e banesës sonë popullore. Ky realitet është shprehje e një përvoje të mirë njohëse të terrenit dhe të mundësive që të jep ai për një shfrytëzim sa më ekonomik.

Në shembujt që sollëm nga Shqipëria e Mesme del e qartë se ky koncept është zbatuar më shumë në banesa dykatëshe. Këto banesa kanë pasur përhapjen më të madhe në këtë pellg. Në rastin kur ato janë vendosur normal me truallin dhe kanë vetëm një kthinë për banim, kjo realizohet pjesërisht mbi truallin prej dheu. Kur këto banesa kanë dy kthina kryesore për banimin e familjes, atëherë vërehet si tipar dallues një mënyrë e caktuar e vendosjes së tyre (shtëpësisë së zjarrit dhe odës së miqve), përkundrejt terrenit. Kjo mënyrë vendosjeje është e lidhur me funksionet që kryejnë këto kthina. «Shtëpësisë e zjarrit» ze gjithmonë pjesën fundore të katit të banimit të familjes dhe është pjesërisht ose tërësisht përdhese, ndërsa oda e miqve, me kërkesa edhe më të mëdha për ndriçim natyror, zë gjithmonë ballin e katit të banimit. Të dyja këto kthina, që përbëjnë bërthamën kryesore për banim, janë të ngjitura me njëra-tjetrën, sipas aksit gjatësor, dhe komunikojnë ndërmjet tyre, në një kohë që nuk mungojnë për secilën hyrjet e pavarura nga jashtë. Banesa të tilla u kanë shërbyer familjeve relativisht të vogla për nga numri i pjesëtarëve e me mundësi të kufizuara ekonomike. Kthinat që shtoheshin janë përdorur kryesisht për fjetjen e çifteve dhe janë realizuar ose brenda «shtëpisë së bukës» ose përreth saj e me lidhje të drejtpërdrejtë me të. Kjo mënyrë zgjidhjeje krijonte lehtësi funksionale për familjen. Kjo zbulon më mirë rolin parësor funksional e kompozicional të shtëpisë së

8) E. Riza. *Tipare të krijimtarisë popullore në banesën qytetare shqiptare. «Monumentet»* nr. 2 (1982). Tiranë. 1982. f. 17.

zjarrit dhe praninë e koncepteve patriarkale në mënyrën e të jetuarit të familjes së madhe.

Në Shqipërinë e Mesme kanë punuar kryesisht dy duar mjeshtrish. Në të djathtë të rrjedhjes së Shkumbinit, sidomos në zonat malore, kanë punuar dibranë dhe çermenikas (nga fshati Kostenjë, Prevall etj.). Në të majtë të rrjedhjes së Shkumbinit kanë punuar sidomos oparakë, por edhe rajcjanë e grabovarë. Në fshatrat kodrinore, në të djathtë të rrjedhjes së Shkumbinit, përveç dibranëve, kanë punuar edhe oparakë, që në popull njihen më shumë me emrin «korçarë». Ideja e shfrytëzimit racional të terrenit të pjerrët, lidhja organike me këtë të fundit, duke futur në përdorim konceptin e gjysmëkatit në kompozimin volumor të ndërtimeve, përbëjnë atë bazë të gjerë, që dëshmon se mjeshtrit e ndërtimit, pavarësisht se nga ç'krahinë ose zonë vinin, kishin po atë përvojë. Kjo përvojë e njëjtë nuk ka cënuar respektimin e tipareve thelbësore krahinore ose lokale të tipologjisë së banesës në përgjithësi dhe deri të individualitetit të çdo shembulli në veçanti.

Në këto banesa, ndonëse karakteri utilitar zë vendin më të rëndësishëm, nuk mungojnë realizime të goditura nga ana arkitektonike. Të tilla kemi takuar sidomos në fshatra të Çermenikës ku përdorimi relativisht i bollshëm i lëndës së drurit dhe mënyra e vendosjes ndaj terrenit i ka dhënë mundësi të madhe ndërtuesit si në përpunimin e brendësive ashtu dhe në formulimin e jashtëm arkitektonik. Kjo ka të bëjë edhe me vetë tipin e banesës së përhapur në këtë zonë e në zona të tjera përreth, pasi në fund të fundit jo çdo tip banese i përhapur në Shqipërinë e Mesme ka paraqitur mundësi të njëlllojta përpunimi. Madje edhe vetë individualiteti krijues i mjeshtrit ka gjetur shprehjen e vet në përshtatje me kushtet dhe me rrethanat në të cilat ka punuar. Deri edhe përdorimi i të njëjtit material nuk ka dhënë trajtime të barasvlershme. Këtë e vërejmë jo vetëm në formulimin e jashtëm, por edhe në trajtimin e brendshëm të kthinave. Kjo duket më e spikatur në odën e miqve. Fjala vjen, në banesat e zonave malore të krahut të djathtë të rrjedhës së lumit Shkumbin ballin e odës së miqve e gjallëron sidomos qoshku i brendshëm i njohur me emrat «qepen», «sergjen» etj., ndërsa në banesat e zonave që shtrihen në të majtë të rrjedhës së Shkumbinit ballin e odës së miqve e gjallëron oxhaku përgjithësisht «allafranga» dhe anash tij vendet e ndenjes dhe dritaret me përmasa të tilla që lejojnë një ndriçim të bollshëm natyror. Pra pavarësisht nga konceptet e njëjta në shfrytëzimin e terrenit, në banesën e një zone janë të pranishme elemente arkitektonike të cilat trajtohen në përputhje me karakterin e përgjithshëm arkitektonik të një tipi të dhënë. Kur është fjala për zgjidhjet konstruktive dhe tekniken e ndërtimit, veçoritë ndërmjet zonave ku kanë punuar duar të ndryshme mjeshtrish janë pak ose aspak të dallueshme.

Pa mohuar rolin e rëndësishëm të terrenit dhe veçanërisht të mjeshtrit në individualitetin e shembujve që sollëm, ato në thelb janë realizim i kërkesave të caktuara e konkrete të fshatarit, në varësi nga mundësitë dhe nga mënyra e tij e jetesës. Pra, vendosja në truall të pjerrët e një ndërtimi të caktuar nuk është diktuar mekanikisht nga mjeshtri ndërtues. Edhe vetë fshatari, nga përvoja e tij, njihhte lever-

dinë praktike të një mënyre të tillë vendosjeje. Për rrjedhim ai i kërkonte mjeshtrit ndërtues realizimin e kompozimeve me thyerjen karakteristike në volum, ku katet dalin në sipërfaqe jo të barabartë, Këtu zbulohet natyrshëm gjithashtu se nuk ka qënë terreni ai që ka imponuar ndërtime të tilla. Përkundrazi, duke u njohur mirë vetitë e terrenit, qoftë nga mjeshtri, qoftë dhe nga fshatari, kjo lloj vendosjeje e ndërtimit është parapëlqyer dhe si e tillë ka gjetur përdorim në kohë dhe në hapësirë.

Në vështrim tipologjik vërehet se veçanërisht banesat njëkthinëshe dhe ato me dy kthina për banim përbëjnë shembuj brenda varianteve të thjeshta të banesës tipike të zonës ku janë ndërtuar. Ato janë përdorur nga familje të vogla e të varfëra. Format e zhvilluara janë përdorur nga familje të mëdha e me gjendje disi më të mirë ekonomike. I gjithë ky realitet shpreh edhe praninë e shtresimit shoqëror. Ai njëkohësisht tregon se futja e këtij koncepti në ndërtim nuk ka qënë i lidhur me një shtresë të caktuar të fshatarësisë.

Ndërtime popullore ku ka gjetur zbatim koncepti i gjysmëkatit takohen në mbarë vendbanimet tona fshatare e qytetare të ngritura në terrene të pjerrëta. Ato takohen në Shqipërinë Veriperëndimore⁹, në Shqipërinë Verilindore¹⁰ dhe në atë Juglindore¹¹ e Jugperëndimore¹². Po ashtu takohen në qytete të tilla si Gjirokastra¹³, Kruja¹⁴, Berati¹⁵, lagjet kodrinore të Shkodrës¹⁶ etj. Veçse shkalla e shtrirjes dhe masa e futjes në përdorim të këtij koncepti nuk është kudo i njëjdhë. Kjo duket edhe në vetë pellgun që morëm në shqyrtim. Koncepti i gjysmëkatit në Shqipërinë e Mesme, ndonëse është përdorur në masë të ndjeshme, nuk ka zënë vend parësor. Fakti që atë e gjejmë të përdorur qysh në ndërtimet e thjeshta ndihmëse e ekonomike e deri tek banesa të zhvilluara dy a trekatëshe, dëshmon për një familjarizim të gjatë me të.

Ndonëse ndërtimet që shqyrtuam nuk e kalojnë shekullin XIX, e shumta fundin e shekullit XVIII, shtrirja më thellë në kohë e përdorimit të këtij koncepti nuk përjashtohet. Për këtë dëshmon prania jo vetëm në forma të zhvilluara, por edhe në forma të thjeshta banesash. Këto të fundit kanë vazhduar të ndërtohen nga familjet me mundësi të kufizuara ekonomike. Një dëshmi tjetër bindëse janë vetë vendbanimet e këtyre zonave, të cilat janë të vjetra e me vazhdimësi të

9) *Historia e arkitekturës shqiptare* (nga fillimet deri në v. 1912). Maket, Tiranë 1980, f. 513.

10) *Po aty*, f. 527.

11) *Po aty*, f. 628.

12) *Po aty*, f. 590 e vazhdim.

13) E. Riza, *Qyteti Muze i Gjirokastrës*. Tiranë, 1981, f. 316.

14) K. Zheku, «Kulla krutane», «Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike» II, Tiranë, 1969, f. 223.

15) E. Riza, *Banesa popullore në qytetin-muze të Beratit «Monumentet»* 1/1981. Tiranë, 1981, f. 11-12.

16) E. Riza, *Banesa popullore në Shkodër gjatë shekullit XVIII-XIX. «Monumentet»* 4, Tiranë, 1972, f. 158.

pandërprerë. Mjaft prej tyre përmenden në defterët turq qysh në shekullin XV¹⁷.

Studimet kanë vërtetuar se në zona të tilla si Labëria ky koncept ka pasur një përdorim të gjërë¹⁸. Po ashtu në qytetin e Gjirokastrës, me arritje madhore në fushën e arkitekturës popullore, këtë koncept e gjejmë të përhapur gjerësisht në variantet e ndryshme të banesës gjirokastrite¹⁹. Ajo ka pasur përdorim të gjërë edhe në mbarë fshatrat që shtrihen përreth këtij qyteti.

Zbatimi i këtij koncepti, siç kanë treguar gjurmimet e studimet, njihet qysh herët në trojet tona. Në vendbanimet e braktisura që ekzistojnë në formë rrënojash, ai takohet të paktën qysh në shekullin XIV²⁰. Në këto vendbanime shumica e të cilave janë gjetur në Jug, por që nuk mungojnë edhe në Veri, banesa me gjysmëkat në planin kompozicional përbën tipin mbisundues²¹. Po ashtu edhe gjurmimet arkeologjike kanë konfirmuar praninë e ndërtimeve të realizuara në troje të pjerrëta, qysh herët në territorin tonë²².

Për një njohje e familjarizim të gjatë me ndërtimet e vendosura normal me rënien e terrenit, ku ka gjetur zbatim koncepti i gjysmëkatit, flet edhe emërtimi që u ka dhënë atyre populli në zona të ndryshme. Në Shmil ato njihen me emrin «të ngulura në trap», në Sulovë «të futura në brinjë», në Labëri me emrin «të ngulura në bisht»²³ ndërsa në zonën e Lezhës me emrin «me jerevi përkjet»²⁴.

I gjithë ky shqyrtim, i bazuar në materialin e sjellë nga Shqipëria e Mesme, përforcon mendimin e shprehur se gjatë shekullit XVIII-XIX koncepti kompozicional me gjysmëkat në disa krahina e qëndra ka gjetur përdorim, duke qëndruar edhe në zanafillën e kompozimeve planimetrike-vëllimore më të përbëra²⁵.

Ideja e shfrytëzimit racional të terrenit të pjerrët, lidhja organike e ndërtimit me të, njohja e gjatë dhe përvoja e fituar e gjen shprehjen e vet dhe tek përdorimi ende në ditët tona i këtyre ndërtimeve të realizuara në troje të pjerrëta. Kjo duket edhe në fshatrat kodrinore e malore të Shqipërisë së Mesme. Natyrisht ndërtimet e reja kanë një përpunim të brendshëm e të jashtëm dhe një shfrytëzim të kthinave në përputhje me kërkesat e sotme, si shprehje e atyre shndrrimeve dhe përparimeve të vazhdueshme që po ndodhin në mënyrën e jetesës së fshatarësisë sonë kooperativiste.

17) A. Muka, *Banesa fshatare e Malësisë së Tiranës... Tipa banesash në disa fshatra të Librazhdit*. «Etnografia Shqiptare» X Tiranë 1979, f. 178.
Vendbanimet dhe ndërtimet popullore në Shpat... art. cit. f. 200.

18) *Historia e arkitekturës shqiptare*, vep. cit. f. 589-613.

19) E. Riza, *Banesa e fortifikuar Gjirokastrite*, «Monumentet», 1. Tiranë 1971, f. 128, E. Riza, «Qyteti-muze i Gjirokastrës», vep. cit. f. 308.

20) E. Riza, P. Thomo. *Karakterit dhe tiparet e vendbanimeve dhe të banesës fshatare në shek. XIV-XVIII*. «Kultura popullore» nr. 2, Tiranë, 1983, f. 129-146.

21) *Po aty*, f. 139.

22) V. Bushati. *Banesa në Iliri* — Disertacion i pabotuar. Tiranë, 1983.

23) E. Riza. *Banesa popullore në fshatrat e rrethit të Vlorës*, «Monumentet», 15-16, Tiranë 1978, f. 193.

24) F. Zarshati. *Banesa popullore në Malësinë e Lezhës* «Monumentet» 12, Tiranë 1976, f. 86.

25) E. Riza. *Banesa me gjysmëkat — perpendikular* «Monumentet», 7-8, Tiranë, 1974, f. 203.

THE HALF-STOREYEDE BUILDINGS IN THE VILLAGES OF CENTRAL ALBANIA

The article is written on the basis of an extensive material collected by the author in villages of various zones of Central Albania, such as Martanesh, Çermënika, the Highlands of Tirana, the Gorge of Zaranika, Shmil, Shpat, Sulova, article examines the building sput up vertically to the gradient of sloping where the concept of the half-storey, which developed early in our territories and continues well into our time, was used. The article shows that the introduction of the concept of half-storey in the composition of voluminous buildings set up on slopy terrain, has nothing to do either with certain categories and types of buildings or with a given type or variant of dwelling. We see that it takes shape in various auxiliary and economic buildings (photo 1), in buildings for which more than one kind of material, is employed, in two- or three-storeyed dwellings where one or two families live, in the dwellings with *telize* (photo 2), or with *qoshk*, in the dwellings with a corridor and *çardak* (photo 3), up to the type of the old Tirana dwelling (photo 4).

The most characteristic feature of houses built perpendicularly to the terrain is the dwelling with stories which varied in their extension in surface. This type of building includes stables, huts and shepherds' summer huts, all of which the peasants built for definite purposes. Practice and long experience have taught them to suit the buildings to the slopy terrain in a reasonable manner. By a minimal volume of several levels, up to that under the roof.


Extensive treatment is devoted here to the dwelling-house. In the beginning the author deals with the two-storeyed building consisting of one room each. Such examples are illustrated in the Table 3, Table 4, Table 5, Table 6. Further on the dwellings built perpendicularly to the sloping of the terrain, with two living rooms, are also examined. Such examples are quoted in Table 4.1, Table 6.1, Table 7, Table 8, Table 9, Table 10 and Table 1.2.

The two- or three-storeyed dwellings set up according to the terrain, inhabited by relatively large families, comprise another group of examples. These dwellings are graphically represented in Table 11, Table 12, Table 14, Table 15, Table 16 and Table 17. The many living rooms of such dwellings are built either all at the same time, or have been supplemented in the course of time, according to the needs of the families.

People's building, where the concept of half-storey has been employed, is met throughout our urban and rural settlements situated in slopy terrain.


Although it has been used on a considerable scale, the concept of half-storey did not have priority in the buildings of Central Albania. The very fact that it has been practised in the simple auxiliary and economic buildings up to the developed two- or three-storeyed dwellings, testifies to the long familiarity with it. Therefore, although the buildings studied do not go beyond the 19th century, up to the end of the 18th century at the most, it is not ruled out that this concept had greater extension in time. Moreover, this concept, as studies have shown, developed from the prehistoric dwellings in our country.

TAB. I




1. Gazdhar në fshatin Nezhari (Shpati i Sipërm-Elbasan)
 2. Banesë në fshatin Sopot (Librazhd)

TAB II




1. Stan në fshatin Kostenjë (Çermenikë-Librazhd)
 2. Kasolle në fshatin Gurakuq (Çermenikë-Librazhd)

TAB III




1



2

1. Banesë në fshatin Duzhë (Sulova e Sipërme-Gramsh)
2. Banesë në fshatin Sulcë (Sulova e Sipërme-Gramsh)


TAB IV



1. Banesë në Shmil (Elbasan)


2. Banesë në fshatin Godolesh (Gryka e Zaranikës-Elbasan)

TAB. V




Banesë në fshatin Godolesh (Gryka e Zaranikës-Elbasan)

TAB. VI




1. Banesë në fshatin Valësh (Shpati i Sipërm-Elbasan)
2. Banesë në fshatin Pishkash (Librazhd)




PLANIMETRIA

Banesë në fshatin Urakë (Librazhd)

TAB. VIII




Banesë në fshatin Herr (Tiranë)




Banesë në fshatin Val (Martanesh)

TAB. X




Banesë në fshatin Baldushk (Tiranë)

TAB. XI




Banesë në fshatin Gurakuq (Librazhd)

TAB. XII




1. Banesë në fshatin Pashtresh (Shpati i Sipërm-Elbasan)
2. Banesë në fshatin Polis i Vogël (Elbasan)




Banesë në fshatin Gurakuq (Çermenikë-Librazhd)

TAB. XIV




1. Banesë në fshatin Shëngjin i Madh (Malësi e Tiranës)
2. Banesë në fshatin Derje (Malësi e Tiranës)

TAB. XV




Banesë në fshatin Gurakuq (Çermenikë-Librazhd)

TAB. XVI



1. Banesë në Shmil (Elbasan)
2. Banesë në fshatin Zdrajsh (Çermenikë-Librazhd)

TAB. XVII



Banesë në fshatin Floq (Çermenikë-Librazhd)

Pirro THOMO

TIPARET URBANISTIKE DHE ARKITEKTONIKE TË FSHATIT DARDHË — KORÇË*

Procesi i kalimit nga formacioni ekonomik-shoqëror feudal në lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste, në fshatin shqip-tar pati një karakter tepër të ndërlikuar. Futja e marrëdhënieve të reja nuk u bë në mënyrë të njëtrajtshme, nuk pati të njëjtën shtrirje dhe nuk qe e njëkohshme në të gjitha krahinat. Shkallë-shkallë ato u shtrinë në marrëdhëniet ekonomike, në strukturën shoqërore, si dhe në mënyrën e jetesës. Të gjitha këto ndikuan dhe u pasqyruan edhe në fizionominë arkitektonike të fshatrave. Karakteri urbanistik dhe tipafizionominë arkitektonike të fshatrave. Karakteri urbanistik dhe tiparet arkitektonike u nënshtrohen ndryshimeve në raport të drejtë me përhapjen e marrëdhënieve të reja.

Të rejat në arkitekturën fshatare u futën në mënyrë të ndryshme. Në disa raste ato shfaqen në përmirësimet e skemës funksionale, në përpunimin e trajtimit arkitektonik të brendshëm e të jashtëm, në rritjen e repertorit teknik e teknologjik të ndërtimit, por, shpesh, duke mos u shkëputur tërësisht nga tipologjia tradicionale. Në raste të tjera konceptet e reja arkitektonike ecën më përpara. Ato prekën edhe zgjidhjen kompozicionale të banesës, sipas një programi të ri, që pasqyronte kërkesat e reja të përdoruesve. U futën kështu tipa të rinj banese, të cilët tjetrësuan pjesërisht ose tërësisht aspektin arkitektonik të venbanimit.

Përfaqësues i procesit të fundit është edhe fshati Dardhë i rrethit të Korçës. Rëndësia e studimit të arkitekturës së këtij fshati nuk qëndron vetëm në evidentimin e pasurisë ndërtimore që ai trashëgoi, por edhe në faktin se përmban në vetvete rëndësinë e një shembulli tipik të një rruge zhvillimi të fshatit shqiptar.

*) Materiali është mbledhur gjatë ekspeditave në terren në vitet 1979 dhe 1983 me pjesëmarrjen e skicografëve Dh. Koti, H. Sava, dhe Gj. Martini. Informuesit kryesorë S. Thimio dhe A. Raci nga fshati Dardhë. Përpunimi i skicave nga Gj. Martini. Foto të autorit.

Dardha është një ndër vendbanimet e pakta të ngritura në një kuotë mjaft të lartë. Lartësia e saj mbi nivelin e detit i kalon të 1000 m. Gjeografikisht shtrihet në shpatin lindor të vargmalit të Moravës, në rrjedhjen e sipërme të lumit Devoll. Etnografikisht Dardha bën pjesë në krahinën e Devollit të Sipërm, e cila në disa aspekte të kulturës materiale dhe shpirtërore ndryshon nga fshatrat e Devollit të Poshtëm.

Historikisht fshati nuk është shumë i vjetër. Gojëdhëna mban si zanafillë të fshatit një vendqëndrim provizor blegtoral, stanet e të cilëve ngriheshin në skajin veriperëndimor të fshatit, ku ruhet toponimi «Stani në Dardhë». Që këtej, shton gojëdhëna, mori emrin fshati. Falë pozitës së mbrojtur, i struktur në thellësi të maleve, vendbanimi i ri i Dardhës filloi të popullohej me banorë të ardhur nga fshatrat përreth. Shkatërrimi i Nikoliçës në shek. XVIII, e cila pësoi të njëjtin fat me simotrat e saj, qendrat e zhvilluara në trevën e Korçës, Voskopoja, Vithkuqi, Shipska e më tej Llënga, nga sulmet e bejlerëve dhe derebejve, i dha hov zhvillimit të Dardhës së mbrojtur¹. Shumë nga familjet dardhare mbahen me prejardhje nga Nikolica.

Zona e thellë malore, klima tepër e ashpër dhe terreni i thyer, nuk mund të siguronin kushte të favorshme për kultivimin e bujqësisë. Arat e punueshme ishin të shpërndara përreth fshatit. Ato kishin përmasa të vogla, buzë përrenjve, por fshatarët i përftonin më tepër me taracim. Gjurmët e të cilit shihen edhe sot. Kushte më të favorshme kishte rritja e bagëtive të imta, që formonin një mbështetje të mirë për ekonominë e familjes.

Vendi, nga ana tjetër, është shumë i pasur me pyje. Nxjerrja dhe përpunimi i lëndës drusore u bë shpejt mbështetje e sigurt ekonomike. Me këto zeje dardharët u bënë të njohur jashtë fshatit e vendit. Ata filluan të bëheshin të kërkueshëm për shfrytëzimin e pyjeve në vendet fqinje, në viset e Kosovës (Pejë), të Greqisë e të Turqisë. Kjo i dha shkas përhapjes në masë të emigrimit sezonal. Ashtu si dhe për mjeshtritë e tjera të ushtruara nga popullsia shqiptare, largimi i burrave fillonte në nëntor (Shën Mitër) dhe mbaronte në pranverë (Shën-Gjergj). Fitimi nga puna e krahut ishte mjaft i vogël, prandaj një rol të rëndësishëm në ekonominë e familjes luante ende ekonomia vendase e bazuar në prodhimin e paktë të bujqësisë dhe të ardhurat nga blegtoria.

Rritja e ndjeshme e rendimentit dhe e prodhimit të lëndës së drurit u bë nëpërmjet futjes në përdorim të sharrave të ujit. Ndërsa në fshat ato ishin të pakta, në viset tradicionale të mërgimit të dardharëve, sharrat u ngritën me shumicë. Sipas të dhënave të tërthorta, ngritja e sharrave të ujit filloi andej nga gjysma e dytë e shek. XVIII. Ato erdhën gradualisht duke u shtuar, përsosur dhe zmadhuar, duke u

1) P. Pepo, *Kontribut mbi historinë e tregut të Korçës e të Voskopojes gjatë sundimit otoman*, në «Korça e Re», Korçë, 1964. fq. 180.

kthyer në ndërmarrje të vogla prodhimi. Ndërtimi dhe administrimi i tyre nuk bëhej më në mënyrë individuale, por me «ortakëri», zakonisht nga bashkëfshatarë. Kështu p.sh. sharra e ndërtuar në Adalia të Anadollit (Turqi), e ndërtuar në fund të shekullit të kaluar, për të cilën janë ruajtur të dhëna të plota dhe fotografia e saj (Fig. 1), ishte pronë e katër bashkëfshatarëve. Sipas të dhënave gojore ajo prodhonte deri në 85.000 dërrasa katërmetërshe në vit.



Fig. 1

Ndërtimi i sharrave u dha dorë dardharëve që, diku vetë e diku në bashkëpunim me pronarë vendas, të shtinin në dorë jo vetëm prodhimin e lëndës, por, më vonë dhe tregtinë e saj. Kjo bëri që disa familje ose individë të familjes të shpërnguleshin përfundimisht nga fshati. Megjithëse të ardhurat nga prodhimi i lëndës erdhën duke u shtuar, nuk mund të ishte një zgjidhje përfundimtare për ekonominë e fshatit, për më tepër që kjo zeytari që fatlume vetëm për një numër të kufizuar familjesh. Krijimi i shteteve të pavarura ballkanike dhe konfliktet ndërmjet tyre, vënia dorë mbi shfrytëzimin e pyjeve nga shtetet dhe pronarët vendas u preu rrugën dhe u hoqi punën shumë krahëve të afta dardhare. Ekonomia e vendit ishte e pamjaftueshme për sigurimin e jetesës së masës së gjerë të fshatarësisë. Fundi i shek. XIX, fillimi i shekullit XX shënon një shtim të ri të valës së emigrimit për shitjen e krahut të punës, në fillim në vendet e Ballkanit (kryesisht në Rumani), e më vonë në SHBA dhe vendet e tjera të Amerikës.

Të ardhurat e nxjerra nga kurbeti u investuan kryesisht në ndërtimin e banesave, në pajisjet dhe mobilimin e tyre, si dhe në punimet

komunale: në shtrimin e rrugëve, në sjelljen e ujit, në ndërtimin e çezmave etj., ndërsa mbas kthimit në atdhe, në hapjen e punishteve dhe dyqaneve në fshat. Një hov të madh morën punimet komunale, sidomos në vitet 20-30 të shekullit tonë, me krijimin e shoqërive në fshatra. Në Dardhë u ngrit shoqëria «Shpresa». Një nga detyrat kryesore të këtyre shoqërive, përveç gjallërimit të jetës shoqërore në fshat, ishte dhe grumbullimi i ndihmave dhe mobilizimi i popullsisë për kryerjen e punëve komunale. Në kushtet e një prapambetjeje të përgjithshme ekonomike të vendit dhe të mungesës së plotë të investimeve nga ana e shtetit, sidomos në fshat, kjo ishte e vetmja rrugë për rregullimin e fshatrave. Kështu u zgjerua dhe u shtrua me kalldrëm rruga qendrore e fshatit, u ngritën disa ndërtesa shoqërore, si shkolla etj., u bënë projekte për shfrytëzimin e ujit mineral që buron në afërsi të fshatit etj.

Si rezultat i kësaj rruge zhvillimi, fshati i Dardhës në fillim të shek. XX paraqitej me një fizionomi urbanistike dhe arkitektonike të formuar dhe të përparuar për kohën. Të gjitha rrugët ishin të kalldrëmuara, fshati ishte i pajisur me një sistem të plotë ujësjellësi dhe me çezma të përhapura në të gjitha pikat, me ndërtesa të bukura e solide dhe dallohej për një jetë të gjallë, një rrjet të plotë tregtie e shërbimi. Në fshat funksiononin një numër i madh punishtesh të hapura në lokale të veçanta ose në shtëpi, ku ushtroheshin zejet kryesore: rrobapës, këpucarë, teneqexhinj, marangozë, sahatçinj, saraçë, kovaçë e deri fotografë. Funksiononin gjithashtu njësi tregtie (bakallë), furra, kasapë, ëmbëltore, hane e hotele.

I gjithë zhvillimi historik i fshatit Dardhë mund të ndahet në tri periudha kryesore me karaktere të ndryshme ekonomiko-shoqërore dhe me tipare të dallueshme arkitektoniko-urbanistike. Periudha e parë shkon nga themelimi i fshatit deri në mesin e shek. XIX, periudha e dytë përfshin gjysmën e dytë të shek. XIX, ndërsa e treta dhjetvjeçarët e parë të shek. XX.

KARAKTERI URBANISTIK

Fizionomia urbanistike e Dardhës erdhi duke u formuar e përsosur shkallë-shkallë dhe ne sot kemi një tablo të plotë të saj, gjendjen që arriti në dhjetvjeçarët e parë të shekullit tonë.

Për ndërtimin e fshatit është zgjedhur pjerrësia e një shpati, e orientuar nga lindja, pra që rrihet mirë nga dielli dhe është e mbrojtur nga rrymat e ftohta të erërave. Shpati zbrit jo tepër butë mbi përroin e Dardhës, afërsisht i Devollit, i cili e kufizon fshatin nga ana jugore dhe lindore. Fshati është i shtrirë gjatë gjithë shpatit, me konfiguracion gjatësor, me një shtrirje tërthore më të madhe nga ana veriore (Tab. I). Ai është mjaft i mbledhur, me ndërtesa pranë njëra-tjetrës (Fig. 2). Kështu është formuar një ndarje ose shpëputje e zonës së banuar dhe asaj bujqësore dhe instalimeve të saj. Siç e kemi vënë në dukje më sipër, arat ishin të shpërndara përreth fshatit. Brenda fshatit pranë shtëpive kishte parcela të vogla që përdroreshin si kopshte. Në pjesën fundore të fshatit ishin ndërtuar disa lëmenj, por këta

ishin të paktë. Zona tradicionale e lëmenjve ndodhej në një lartësi përkundrejt fshatit, në krahun e majtë të përroit.

Ende sot ka mbetur toponimi «Të lëmenjtë». Gjatë përroit ishin të rreshtuar 9-10 mullinj drithi, pronë e familjeve të veçanta, të cilat merreshin kryesisht me këtë mjeshtëri, ose e kishin si ekonomi ndihmëse. Me ujërat e këtij përroi funksiononin dhe dërstilat e batanet. Sot ka mbetur vetëm toponimi dhe kujtesa e të moshuarve si dëshmitarë e kësaj zeje. Në pjesën e sipërme të përroit ishte ndërtuar një sharrë uji.



Fig. 2

Në zonën e banuar nuk vihej re ndonjë ndarje e prerë lagjesh ose ndonjë qendër e theksuar kompozicionale. Megjithatë vërehej një parapëlqim për vendosjen e ndërtimeve me funksion të përbashkët. Ishte krijuar kështu një zonë me përqëndrim ndërtimesh të tilla në krye të fshatit, në një pozitë zotëruese, në afërsi të vendqëndrimit të hershëm të blegtorëve, «te stanet», që, sipas gojëdhënës, qënë zanafilla e fshatit. Aty ishte ndërtuar kisha, një han i vjetër, më vonë, gjatë këtij shekulli, një hotel-restorant, shkolla, ndërtesa e komunës, etj. Me hapjen e rrugës automobilistike që lidhte Dardhën me Korçën, në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX dhe të frekuentimit me kafene dhe në të hyrë të fshatit, nga ana veri-perëndimore. Gjithashtu aty ishin përqëndruar disa dyqane e punishte zejtarësh.

Por ndërtimet e këtij karakteri nuk ngriheshin vetëm në këtë zonë. Ato ishin shpërndarë në të gjithë fshatin. Zejtaritë ushtroheshin në

ndërtime të veçanta ose brenda banesës. Disa banesa kishin për këtë qëllim ambiente që përdorshin si dyqane, e me lidhje të drejtpërdrejta me rrugën. Kështu dora-dorës, nga gjysma e dytë e shek. XIX, filloi të merrte rëndësi dhe rruga e poshtme e fshatit, ku ishin të grupuara disa dyqane kryesore e punishte (Tab. II).

Fshati përshkohet nga tri rrugë gjatësore, që ndjekin nivelet e terrenit. Në skajin jugor ato bashkohen, duke krijuar një unazë që e qarkon të gjithë fshatin. Pjesa jugore ka një rrjet rrugor disi më të çrregullt. Në pjesën qëndrore kalon një rrugë tërthore, e cila ngjitet me gjarpërime dhe lidh rrugët gjatësore. Rrugica të tjera më të ngushta degëzohen nga rrugët kryesore dhe lidhin mbarë njësitë ndërtimore të fshatit.

Rrugët e fshatit janë të kalldrëmuara. Gjerësia e tyre është e ndryshme, duke u luhatur nga 2.5 m. deri në 6 m. (Tab. III). Rrugët kufizohen nga banesat, muret rrethuese të oborreve ndërsa në shumë vende, nga muret mbajtëse, të cilat ngrihen në pjesët e poshtme për të mbajtur rrugën dhe në të sipërmen si mbështetje e terrenit të pjerrët. Disa herë lartësia e mureve mbajtëse shkon deri 4-5 m. Në këto raste ato ndërtohen me pjerrësi dhe me shkallëzime. Profili i rrugëve ose ndërtimi i tyre është i ndryshëm, në varësi nga terreni, pjerrësia dhe, së fundi, në varësi nga koha e ndërtimit. Profilet më të përdorshme kanë qënë ato me kunetën e largimit të ujit në mes të rrugës. Ky tip zakonisht është zbatuar në rrugicat e ngushta dhe në rrugët e vjetra. Një tip më i përparuar kalldrëmi, i përdorur në rrugët e gjëra dhe ato të shtruara më vonë, është me kurriz në pjesën qëndrore, ndërsa largimi i ujërave atmosferikë bëhet nga dy kuneta anësore në të dy skajet e rrugës. Kurrizi i rrugës është trasuar me gurë të mëdhenj lumi, kunetat me plloça ose me gurë plloçakë, ndërsa mbushja e kalldrëmit me gurë të zakonshëm lumi.

Një shpërndarje të rregullt kishte edhe rrjeti i ujësjellësit. Uji sillej me tubacione qeramike dhe shpërndahej në pika të ndryshme të fshatit. Çezmat janë të ndërtuara në kryqëzimin e rrugëve, si dhe gjatë rrugëve kryesore, në pika të hapura në muret mbajtëse. Shumë nga çezmat dallohen nga përkujdesja në trajtimin arkitektonik. Disa ishin të mbuluara (Fig. 3), grykat e çezmave përpunoheshin me gurë të gdhendur në formë lugu (Fig. 4), ndërsa poshtë tyre ishin vendosur koritat ose govatat prej druri ose guri, ku pinin ujë kafshët dhe laheshin rrobat.

Njësitë kryesore ndërtimore të fshatit janë banesat me ndërtimet e tyre ndihmëse. Banesat janë të rrethuara me oborre zakonisht të vogla, të cilat kanë karakter të ndryshëm në periudha të ndryshme. Në periudhat e hershme rezervat kryesore ekonomike dhe bagëtitë e familjes ruheshin në ambiente të përfshira brenda volumit të banesës. Në oborr ngriheshin plëvicat, ashefet dhe furra e pjekjes. Në parcelën përreth banesës kultivoheshin pemë dhe perime. Nga banesat e periudhave më të vonshme largohen bagëtitë dhe strehohen në plëvicat, të cilat ngriheshin pranë ose dhe larg banesës. Plëvicat zakonisht ndërtoheshin dykatëshe: kati përdhe shfrytëzohej për mbajtjen e bagëtive,




Fig. 3



Fig. 4

ndërsa i dyti për depozitimin e barit e të kashtës. Me ndërtimin e banesave të reja, të vjetrat u përdorën gjerësisht për plevica.

Periudhat më të reja sollën ndryshime të ndjeshme dhe në fizionominë e përgjithshme urbanistike të fshatit. Ndërsa banesat e vjetra zakonisht ishin të tërhequra nga rruga ose dilnin me një faqe anësore në rrugë, duke pasur ballin kryesor të orientuar nga oborri, banesat e reja dalin shpesh në rrugë, marrin pjesë në formimin arkitektonik dhe e gjallërojnë së tepërmi atë. (Fig. 5, 6, 7).




Fig. 6




Fig. 5

TIPOLOGJIA E BANESËS DARDHARE

Ndërsa për urbanistikën e fshatit, për shkak të ndërtimeve dhe të përmirësimeve të herëpashershme, është e vështirë të përcaktohet fizionomia sipas periudhave të zhvillimit të fshatit, tipologjia e banesës e pasqyron shumë qartë këtë zhvillim. (Tab. IV).

BANESAT E PERIU DHËS SË PARË

Një tablo deri diku e plotë për ndërtimet e kësaj periudhe mund të krijohet nga disa ndërtesa të mbetura ende në këmbë, ruajtja e të cilave u favorizua shumë nga përdorimi i tyre deri vonë si plevica. Megjithëse në shumicën e rasteve ato nuk ruhen të plota, mund të zbulohen tiparet kryesore arkitektonike, si të kompozimit planimetriko-volumor, ashtu edhe të trajtimit të brendshëm e të jashtëm.

Banesa nr. 1 (Tab. V).

Nga banesa e vjetër ruhet një pjesë, por gjurmët e mbetura e bëjnë të mundur rikonstruksionin e kompozimit fillestar. Banesa ka qenë me gjysmëkat përpjendikular, me dy ambiente të banuara. (Fig. 8). Nga këto, ambienti ballor, që ka nën vete ahurin e bagëtive, shërbente si korridor dhe quhej «shtrat». Ai paraprinte dhomën e ndenjes, përdhese, e cila quhej «kënd» dhe kryente funksionet e gatimit, të ndjenjës dhe të fjetjes. Shtrati me hyrje nga jashtë, ka një faqe muri të ndërtuar me dërrasa, në mes të së cilës është hapur një dritare e madhe, e mbrojtur nga një skarë druri dekorative. Në murin ballor është hapur edhe një dritare tjetër e vogël, me mbulesë në for-




Fig. 7




Fig. 8

më harku, e mbrojtur edhe kjo nga skarë druri. Sot ruhet vetëm pjesa dykatëshe që përmban shtratin dhe ahurin.

Banesa nr. 2. (Tab. VI). Përbëhet nga disa njësi të veçanta, të ndërtuara në kohë të ndryshme. Nga njësia e parë ka mbetur në gjendjen fillestare, me gjithë elementet e saj formuese të brendshme e të jashtme, vetëm pjesa e parë që përmban shtratin dhe ahurin. Në shtrat është ndarë një kthinë e vogël, që shërbente si dhomë pritjeje. Ajo është e shtruar me dysheme dërrase dhe e pajisur me tavan. Oxhaku ndërmjet dy dritareve shënon ballin kryesor të dhomës. Faqja tjetër e jashtme, që sheh në oborr, është ndërtuar me skelet druri të mbushur me gurë shmërçi (lloj guri i lehtë poroz). Aty janë hapur dy dritare të mëdha, të mbrojtur me kafaze druri në formë rrjete kuadratike. Në korridorin e ngushtë dalin shkallët që e lidhin me ahurin nga brenda dhe hyrja e veçantë nga jashtë. Trajtimi i kësaj pjese shquhet për përpunimin dekorativ të elementeve të drurit, strehës së çatisë, shtyllave të skeletit, kafazit të dritareve, dollapëve të brendshëm etj.

Ambienti i dytë në vazhdim u është nënshtuar ndryshimeve të mëvonshme, të cilat kanë prekur krejt murin ballor, çatinë e tavanin, duke tjetërsuar kështu trajtimin e brendshëm e të jashtëm, por duke ruajtur në vija të përgjithshme skemën planimetrike. Ai ka shërbyer si dhomë ndenjeje ose kënd. Dyshemenë e ka të shtruar me dhe të ngjeshur.

Pjesa tjetër, e cila bashkohet në një qoshe me të parën, duke formuar një kënd të drejtë, ruan një skemë të thjeshtë. Ajo është dykatëshe me nga dy ambiente: hajati i mbyllur dhe ahuri në katin përdhe dhe shtrati e këndi në katin e sipërm. E gjithë faqja që sheh nga oborri është ndërtuar me skelet druri e mbushur me shmërç.

Një skemë e tillë kompozicionale me forma të ndryshme bëhet mbizotëruese në banesat e vjetra të Dardhës. Ajo takohet e thjeshtë, si banesa e mësipërme, ose e përsëritur dy herë duke formuar banesa

vëllazërishte. Ajo merr kështu një zhvillim të mëtejshëm, duke pasur dy ambiente banimi, ose përmirësohet duke shtuar një dhomë të ndarë në shtratin e banesës.

Në banesën nr. 3 kemi të bashkëngjitura dy njësi të thjeshta dykatëshe, të ndara nga muri tërthor dhe simetrike karshi tij. (Tab. VII, fig. 9). Çdo njësi ka hyrje të veçantë në hajatet e mbyllura që paraprijnë hauret të ven-




Fig. 9

dosura në pjesën e prapme të katit përdhe. Të njëjtën skemë planimetricke ka edhe kati i sipërm i shtratit në ballë të banesës dhe këndet mbrapa tyre. Shkallët e veçanta për çdo njësi janë të vendosura në hajatet dhe përfundojnë në shtratet, hapësira e të cilave mbyllet me qepen. Siç ndodh zakonisht në banesat vëllazërisht dhomat kanë komunikim ndërmjet tyre. Muri ballor i katit të dytë është i ndërtuar me skelet druri, mbushur me gurë shmërçi, ku janë hapur dritaret, të mbrojtura me kafazë druri. Në fund të shtratit të njësisë së djathtë ngrihet një platformë rreth 20 cm për të formuar aty një kënd ndenjeje. Këndet kanë përmasa të mëdha, janë të shtruara me dhe të ngjeshur dhe të pajisura me oxhakë të mëdhenj me tambur dërrase.

Në një kohë më të vonë janë bërë disa ndryshime: në hajatin e katit përdhe është ndarë një ashef, ndërsa në shtratet e katit të dytë dy këthina të vogla fjetjeje. Në gjendjen e sotme ruhet vetëm një pjesë e kësaj banese.

Një fazë më të zhvilluar paraqet **banesa nr 4** (Tab. VIII). Kati i sipërm përbëhet nga shtrati i cili shtrihet gjatë gjithë ballit dhe dy ambienteve të rrethuara, gjatë saj: këndit dhe odës. Për ndarjen e ambienteve shërbejnë hambarët, duke lënë edhe një derë komuny nikimi. Shtrati ka një pjesë të muraturës të ndërtuar me skelet. Në katin përdhe një portë e vetme të çon në hajatin e mbyllur, i cili ndërlihet me dy hauret në pjesën fundore.

Përmirësime të zgjidhjes funksionale të skemës kompozicionale, të thjeshtë dykthinshe, kemi atëherë kur në shtratin e katit të sipërm ndahet një dhomë e vogël, e cila përdoret si dhomë pritjeje.

Një shembull i kësaj faze zhvillimi është **banesa nr. 5**. (Tab. IX). Ajo përbëhet prej dy njësisish të bashkëngjitura, nga të cilat ka mbetur e plotë vetëm një njësi, e cila përdoret sot si plevicë. (Fig. 10). Në katin përdhe hyrja përfundon në një korridor të ngushtë, ku janë vendosur shka-



Fig. 10

llët prej druri për në katin e dytë. Korridori ndërlihet me dy ambiente: me ashefin përbri, që del në pamjen ballore, dhe me ahurin në pjesën fundore. Në katin e sipërm pjesa ballore, që në banesat e para zihej nga shtrati, këtu formohet nga korridori i ngushtë ndërlihdës dhe oda e miqve. Këndi ka ruajtur vendin e vjetër në kompozim, d.m.th. në pjesën fundore të banesës. Me mur të hollë është ndërtuar vetëm faqja ballore e korridorit, në të cilën janë hapur dy

dritare që mbyllen me kapak dërrase. Përmirësimi i skemës kompozicionale të banesës ka sjellë dhe ndryshime në trajtimin e brendshëm të ambienteve. Ndërsa këndi mbetet si në banesat e para, d.m.th. pa tavan dhe me dysheme të shtruar me dhe të ngjeshur, me oxhak të madh me tambur dërrase, ndërmjet dritareve e nikeve, dhoma e miqve i ka më të përpunuara elementet e brendësisë.

NJËSITË DHE ELEMENTET PËRBËRËSE TË BANESËS

Megjithëse shembujt e mësipërm të sjellë për ilustrim përfaqësojnë variante të një zgjidhjeje të caktuar kompozicionale, ato trajtojnë një rrugë zhvillimi të tipologjisë së banesës së vjetër dardhare. Tipizimi është një dukuri më e qëndrueshme për sa u përket elementeve të veçanta formuese të banesës, si trajtimi i jashtëm arkitektonik, pajisjet e brendshme, teknika e materialet e ndërtimit, përpunimi dekorativ i elementeve arkitektonike e dekorative etj.

Zhvillimi i vrullshëm i fshatit në periudhën pasuese, braktisja e banesave të vjetra, ose kthimi i tyre në pleveca, ka bërë që sot të mos kemi mundësi të krijojmë një tablo të saktë të oborrit dhe të jetesës që kryhej në banesat e vjetra dardhare. Kështu që do të mjaftohemi me një përfytyrim të përafërt mbi këto aspekte, duke u nisur nga funksioni i ambienteve dhe nga disa prej pajisjeve të tyre të mbetura.

Pranë banesës nr. 1 ruhet ende një furrë e vjetër pjekjeje. Dëshmitë gojore na njoftojnë se furra të tilla kishte çdo familje, e cila ishte e detyruar të siguronte vetë bukën. Kjo traditë vazhdoi deri vonë, edhe mbas ndërtimit të furrave kolektive në fund të shekullit të kaluar ose në fillim të shekullit tonë, me përdorim të kufizuar; pjekje tavash, kuleçësh, lakrorësh etj. Furrat ngriheshin në oborr, jashtë volumit të banesës. Ato ishin të thjeshta dhe ndërtoheshin zakonisht nga vetë njerëzit e shtëpisë. (Tab. X/1). Hapësira e pjekjes ishte rrethore në plan dhe mbulohej me kësulë sferike, të ndërtuar me copa tjegullash. Në ballë lihej dritarja për futjen e tavës, ndërsa në mbulesë vrma për daljen e tymrave dhe nxehtësisë së tepërt, të cilat mbas ndezjes të plotë vuloseshin me baltë. Zjarri ndizej në dyshemenë e furrës dhe mbasi formohej prushi dhe nxehej furra, futej buka ose tava për t'u pjekur.

Shfrytëzimi i katit përdhe për strehimin e bagëtive dëshmon se cila familje i mbante ato në shtëpi. Në Dardhë nuk njihej shtegtimi stinor i bagëtive. Në oborr mund të ketë pasur ndonjë plevicë për sigurimin e barit dhe të kashtës. Rezervat ushqimore të familjes janë mbajtur brenda banesës, në hambarët e drithit e të miellit, siç i shohim ende në banesën nr. 4 (Tab. X/2).

Ambientet e banimit të banesës së vjetër dardhare, të përqëndruara në katin e dytë ishin kështu të pakta. Ambienti kryesor, këndi ose dhoma e përditshme, ku gatuhej, hahej dhe flihej, kishte përmasa të mëdha, Zakonisht ato ishin pa tavan, ndërsa dyshemeja shtrohej me dhe të ngjeshur. Një shtresë e tillë krijonte një izolim të mirë nga erërat që vinin nga hauri në katin përdhe, kishte njëkohësisht

dhe veti të mira termoizoluese. Faqja në oxhak shënonte ballin e dhomës. Në qëndër ndërtohej oxhaku, thuhet për të gjitha banesat e kësaj periudhe. Ato janë të pajisura me kanal tymi dhe me tymtar. (Tab. XI/1). Tymit thitëj nga një tambur i gjerë cilindrik, i ndërtuar me dërrasa të punara dhe që përfundonte në pjesën e poshtme me një linjë të valëzuar. Në të dy krahët oxhaku shoqërohet nga kamaret karakteristike, të hapura ose të mbyllura dhe dritaret ose dollapët. Në muret e tjera janë hapur kamare e dollapë të tjerë. Zakonisht sipërfaqet e mureve janë të zhveshura, por në disa raste ato thyhen me fashatura dërrase, që qarkojnë pjesën e sipërme, me sergjena (polica) mbi to, për vendosjen e orendive të shtëpisë. Prania e hambarëve të mëdhenj, që zënë një faqe të tërë muri dhe me përpunimin e tyre të pasur, pasurojnë trajtimin zakonisht të thjeshtë të këndeve (banesa nr. 5).

Në krahasim me këndet, shtratet janë akoma më të thjeshta. Ato shërbejnë si sipërfaqe komunikimi, por përdoren gjithashtu edhe për kryerjen e punëve të ndryshme të ekonomisë shtëpiake, për përpunimin dhe tharjen e produkteve bujqësore, si dhe për ndenje gjatë stinëve të ngrohta. Mbyllja e hapësirës së shkallëve me kapak rriste mundësinë e shfrytëzimit të sipërfaqes.

Shtratet përgjithësisht ishin pa tavan dhe të shtruara me dysheme dërrase, ndërsa në mure janë hapur kamare e dollapë. Shtrati ndahet nga këndi me mure të trasha guri që shkojnë deri në pjesën e sipërme të çatisë, në formë kallkani. Shpesh dera e këndit sigurohet me shul të futur në mur. Në murin ndarës lihen dritare që përveç ndriçimit të këndit, krijojnë një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet dy ambienteve, ndërsa, në disa raste, sipërfaqja e murit qarkohet në pjesën e sipërme me fashatura dërrase, që kornizojnë gjithashtu dyert, dritaret e dollapët. Muratura e hollë e ballit të këndit, e ndërtuar me skelet druri dhe me gurë shmerçi, jep mundësinë e hapjes së dritareve të mëdha, që e bën më komod qëndrimin dhe punën në ambient, si dhe e gjallëron së tepërmi trajtimin e jashtëm të banesës.

Në banesat me skemë më të zhvilluar, dhoma e miqve, që përftohet nga ngushtimi i hapësirës së shtratit, fiton një përpunim të ri. Ajo është e shtruar me dysheme dërrase. Mungesa e haureve në katin përdhe, e nën to, e bën të panevojshme shtresën izoluese me baltë. Tavanët bëhen me dërrasa ose me suva. Dhomat e miqve janë të pajisura me oxhakë, struktura edhe forma e të cilëve, janë të ndryshme nga ato të këndeve. Këta oxhakët janë më të vegjël, me tamburë prizmatikë, që vijnë duke u mbledhur nga sipër, të ndërtuar me strukturë çatmaje dhe të mbrojtur nga një shtresë suvaje me baltë të lyer me gëlqere. (Tab. XI/2).

Dekoracioni i brendshëm në banesat e vjetra dardhare ishte i kursyer. Ai përqëndrohej kryesisht në ato pak elemente druri të përdorur sidomos në oxhakë, dyer, dritare, kapakë, tavanë etj. Përgjithësisht ato janë të punuara me dërrasa të zdruguara dhe herë-herë të gdhendura me profile të ndryshme. Spikasin në mënyrë të veçantë dollapët e murit me kanata të gdhendura, kryesisht me motive bimore.

Teknika e ndërtimit, me materiale rrethanore, është e një cilësie të lartë. Muratura ndërtohej me gurë të lidhur me baltë dhe përforcohej me breza druri. Qoshet punoheshin me gurë të latuar, por dhe faqja e jashtme e muraturës ka prirje për një radhim të rregullt të gurëve. Faqja ballore e këndeve ndërtohet me skelet druri të mbushur me gurë shmërçi. Skeleti formohet nga shtylla vertikale druri, të përforcuara vende-vende me binarë horizontale. Shtyllat përfundojnë me jastëkë druri, që në disa raste janë të gdhendur.

Çatia mbulohet me plloça guri. Ajo i zgjat flegrat e saj duke formuar një strehë të gjërë, e cila e mbron muraturën nga agentët atmosferikë. Strehët më të përdorshme janë dyfishe të zbuluara. Rada e parë formohet nga zgjatimi i trerëve horizontale të tavanit, ndërsa e dyta, nga zgjatja e binarëve të çatisë. Bishtat e strehës janë të gdhendura, ndërsa sipër tyre kalon një tra i dhëmbëzuar në pjesën që duket. (Tab. XII/1).



Fig. 11




Fig. 12

Elemente shprehëse të përkujdesjes dekorative janë edhe dritaret. (Tab. XII/2). Format e tyre janë dy llojesh: me mbulesë të harkuar dhe të rrafshët. Ato nuk kanë kanatë xhami, por mbyllen me kapakë druri, ndërsa nga jashtë mbrohen me kafazë druri. Këto të fundit janë të shumëllojshme. Më të thjeshtat përbëhen nga binarë druri gjatë gjithë lartësisë ose mbrojnë vetëm pjesën e poshtme të hapësirës së dritares. Në raste të tjera binarët gdhendën (Fig. 11). Në dritaret më të mëdha zbatohet veshja e gjithë hapësirës me skara druri. Ato formohen nga kryqëzimi me kllaposje i dërrasave të gdhendura, duke formuar një rrjet me sythe rrethorë, (Fig. 12, 13) ose me shufra të holla të futura tek njëra-tjetra, që formojnë një rrjet kuadratik. Këto të fundit zakonisht përdoren në dritaret e shtretërve. Edhe te dyert ndjehet përkujdesja dekorative, e cila arrihet thjesht, thujse në mënyrë spontane. Ato punohen me dërrasa të zdruguara, duke lënë të duken kokët e mëdha të gozhdëve të kovaçit, me të cilat mbërthehen me parvazët, si dhe elementet e tjera metalike, menteshat dhe trokitëset metalike në dyert e jashtme. (Fig. 14).

Siç shihet, trajtimi arkitektonik, ndonëse i përmbajtur, nuk mbetet i varfër. Balli i katit të sipërm, i ndërtuar me skelet druri dhe me shmërc, e lehtëson masën e plotë të muraturës së gurtë, diferencon volumet e kateve, le të nënkuptohen funksionet e ndryshme dhe krijon një karakter të lirshëm e të lehtë, i cili theksohet dhe nga përpunimi i elementeve arkitektonike e konstruktive, dritareve, strehëve, shtyllave të drurit etj.




Fig. 13




Fig. 14

BANESAT E PERIUDHËS SË DYTË.

Një numër i mirë i banesave janë të datuara, gjë që na lejon të ndjekim me saktësi zhvillimin e tipareve arkitektonike të kësaj periudhe. Uniformitetit dhe zhvillimit relativisht të ngadalshëm të banesës paraardhëse, tani i zenë vendin procese të vrullshme zhvillimi si në tipologji, ashtu edhe në trajtimin arkitektonik, dekorativ dhe teknikë ndërtimi.

Në dhjetëvjeçarët e parë të kësaj periudhe shkëputja nga format e vjetra është ende e ndrojtur. Në banesat e kësaj etape fillestare ruhen mjaft elemente, madje edhe skema kompozicionale të vjetra, ndonëse me një trajtim të ri arkitektonik dhe të zbatuara me një teknikë ndërtimit të re.

Banesa nr. 6 — E ndërtuar në vitin 1860, paraqet një zhvillim të mëtejshëm të skemës së




Fig. 15

vjetër kompozicionale. (Tab. XIII). Ngrihet në skajin veriperëndimor të fshatit, në një terren mjaft të pjerrët, që ka kushtëzuar ndërtimin e saj të shkallëzuar: njëkatëshe në pjesën e poshtme dhe dykatëshe në pjesën e sipërme. Hyrja kryesore nga pjesa e sipërme, nëpërmjet një tremeje të hapur në katin e dytë, përfundon me një korridor të ngushtë, që ndërlidh katër mjedise banimi me përmasa të mëdha. Katet e poshtme shërbenin si katoje dhe haure.

Përmasat e mëdha, lartësia e madhe, sidomos në krahun e poshtëm, dritaret e vogla dhe muratura e gurtë, e pathyer me elemente arkitektonike e dekorative, që kanë krijuar një vëllim të mbyllur, janë karakteristikat e trajtimit të jashtëm. (Fig. 15).

Një vëllim arkitektonik të njëjtë ka edhe **banesa nr. 7**, e datuar në vitin 1867, në afërsi të së parës, që së bashku, nga kjo anë krijojnë një pamje imponuese në hyrje të fshatit. (Fig. 16). E ndërtu-



Fig. 16

ar në terren të pjerrët, banesa del me 4 kate në anën e poshtme dhe tre kate në të sipërmen. (Tab. XIV/1). Përbëhet prej dy njësisish të bashkëngjitura dhe simetrike ndaj murit ndarës tërthor, secila me hyrje të veçantë. Skema planimetrike përsëritet me besnikëri atë të banesës së zhvilluar të periudhës paraardhëse. Hyrjet në katin e dytë përfundojnë në korridorët e ngushta që komunikojnë me dy ambiente të përdorura si dhoma ndenje dhe gatimi. Ato përmbajnë bllokun fundor, i cili përbëhet nga hyrjet për në dhomë, hambaret e drithit e të miellit, së bashku me magjen dhe musandrat. Me shkallë të thjeshta druri, hapësira e të cilave mbulohet me kapak, zbritet nga çdo dhomë e katit të parë në qilaret, të cilët përdoren për depozitim dhe drurëve dhe zahireve. Qilarët kanë edhe hyrje të veçanta nga jashtë. Ato komunikojnë ndërmjet tyre, janë të shtruara me plloça guri dhe kanë ndriçim të pakët. Poshtë tyre, nga ana e pjerrësisë së terrenit, janë hapur edhe dy qilare të tjera, të errëta dhe të freskëta, që lozin rolin e «frigoriferëve» natyralë për ruajtjen për një kohë të gjatë të produkteve ushqimore.

Kati i sipërm i banesës përdoret kryesisht për pritje. Ai ka të njëjtën skemë me katin e dytë. Dhoma e madhe është e pajisur me oxhak, dritare të mëdha e dollapë muri, ndërsa pjesa e sipërme e murit fundor është e veshur me një fashaturë dërrase, sipër të cilës janë vendosur sergjenë (polica), që shërbejnë për varjen e rrobave. Dhoma e vogël përbri korridorit ka trajtim më të thjeshtë, ndonëse ka të njëjtët elementë si të dhomës së madhe. Nga korridori dilet në ballkonet që dalin mbi hyrjet e banesës.

Përveç skemës planimetrike banesa ruan edhe shumë elemente, si oxhakët e musandrat me hambarët, të përpunuara në të njëjtën mënyrë si në shembujt e vjetër. (Tab. XIV/2). Në elemente të tjera fillon një trajtim i ri. Dritaret dhe dollapët e murit janë të qarkuara me fashatura dërrase, nga të cilat ajo e kreut është më e gjerë dhe përfundon me një kornizë të profiluar. Trajtimi i tyre, fashaturat që qarkojnë sipërfaqet e mureve, shkallët që lidhin katet e banuara etj. na kujtojnë pafaqet e brendive të dhomave të Korçës dhe të qyteteve të tjera të kësaj jimin e brendive të dhomave të Korçës dhe të qyteteve të tjera të kësaj periudhe. Përmirësime u sollën në teknikën e ndërtimit dhe, në mënyrë të veçantë, në zgjidhjen funksionale. Bagëtitë nuk strehohen më në volumin e banesës, por në plevicën jashtë shtëpisë, e cila dikur ka qenë banesa e vjetër e familjes.

Por ndërkohë, njëkohësisht me përdorimin e skemave kompozicionale të vjetra vihen re përpjekje për futjen e një tipologjie të re. Këto përpjekje janë ende të paformuara në **banesën nr. 8**, e ndërtuar në vitin 1861. Këtu prirja për zbatimin e një skeme të re planimetrike është e veshur me elemente të trajtimit të vjetër, si p.sh., balli i katit të sipërm i ndërtuar me mur të hollë prej shmerçi. (Tab. XV. Fig. 17).

Banesa nr. 9, e ndërtuar në vitin 1864 paraqet jo vetëm një zgjidhje të re, por dhe të zhvilluar kompozicionale. (Tab. XVI). Banesa përshkohet tej për tej, në pjesën qendrore, nga një korridor gjatësor, me hyrje në të dy skajet e tij. Në të dy krahët e korridorit janë vendosur dy ambiente. Në katin përdhe, ato përdoren si ashef, qilare, ndërsa i katërti, me hyrje të veçantë nga jashtë, si haur. Në katin e dytë të katërt ambjentet kanë trajtim thuajse të njëjtë. Ato janë të shtruara me dysheme dërrase, kanë tavane të suatuara dhe janë të pajisura me oxhakë. Traj-

timi i jashtëm ka tipare të ngjashme me banesat e mësipërme: ai është tepër i kursyer, me elemente të pakta arkitektonike, me një formë




Fig. 17

prizmatike, ku mbizotëron masa e mbyllur e muraturës së gurtë. (Fig. 18).

Shkallë-shkallë, kristalizohet dhe fiton përhapje të gjerë tipi i ri i banesës. **Banesa nr. 10**, e datuar në vitin 1867, përfaqëson një variant të thjeshtë të tipit të ri (Tab. XVII). Ajo është dykatëshe, me një skemë simetrike, ku theksohet në mënyrë të veçantë pjesa qendrore, në këtë rast e dalë jashtë (Fig. 19). Salloni qendror ose siç thirret në popull «tremja», e shtruar me plloça guri, ka në çdo krah një ambient.




Fig. 18




Fig. 19

Njëri përdoret si kuzhinë ose «sobë», ndërsa i dyti si qilar. Soba është e shtruar me dërrasa, e pajisur me oxhak, ndërmjet dy dritareve që dalin në ballë dhe me musandër në pjesën fundore, në formë kthine të ndarë nga hapësira e dhomës.

Në katin e dytë anash sallonit ose «sallës» është vendosur dhoma e ndenjëse, «këndi» dhe «oda». Këndi është i shtruar me baltë të ngjeshur, pa tavan dhe i pajisur me oxhak. Oda, e cila shërbente edhe si dhomë pritjeje, ka dysHEME dërrase e tavan SUVAJE, ndërsa në pjesën fundore musandra. Në pjesën ballore të sallës, poshtë dritareve që shohin në oborr, ngrihet një minder ose kënde për ndenje. Balli i sallës është ndërtuar me mur të hollë shmerçi.

Skema simetrike me theksin qendror, e njohur dhe e përhapur gjerësisht në qytetin e Korçës dhe në fshatra të tjera të rrethit, gjatë kësaj periudhe u bë në Dardhë tipi më mbizotërues, duke arritur në fund të shekullit të kaluar realizime arkitektonike të shënuara.

Banesa nr. 11, e ndërtuar në vitin 1883, ka një kompozim të zhvilluar. (Fig. 20). Ajo është dykatëshe, por meqë është ndërtuar në terren të pjerrët, krahu i djathtë del trekatësh. Ambientet e përfutuara në këtë mënyrë janë përdorur si dyqane. Ndërtimi i banesave me dyqane




Fig. 20

është një dukuri e përhapur në Dardhë, e filluar të paktën që në vitin 1871, kur kemi banesën më të vjetër të datuar, me dyqane në gjithë katin përdhe. (Fig. 20).

Banesa ka pjesën qendrore të futur, ku është vendosur hyrja, e mbrojtur nga vazhdimi i çatisë. Në çdo anë të korridoreve qendrore dalin nga dy ambiente. Me përpunimin e kujdesshëm, volumin dhe ngritjen në lartësi (trekatëshe nga ana e rrugës), ajo spikat në grumbullin e banesave përreth.

Banesa nr. 12, e ndërtuar në vitin 1883, është një shembull tjetër i zhvilluar. (Fig. 21). Ajo ngrihet trekatëshe në terren të pjerrët dhe ka nga një ambient në çdo krah të korridoreve qendrore. Kati përdehe pjesërisht i futur në truall, përdoret për qilar, në katin e dytë janë dhomat e ndenjes, ndërsa në të tretin dhoma e pritjes dhe një dhomë gjumi. Pjesa qendrore është e futur në dy katet e poshtme, e mbuluar me qemer cilindrik, që mban muraturën e katit të tretë dhe një ballkon të dalë, i cili përkryen edhe më tepër theksimin qendror të banesës.




Fig. 21

Krahas skemës kompozicionale, gjatë periudhës së dytë, një zhvillim të mëtejshëm merr teknika e ndërtimit dhe ndryshon koncepti dekorativ. Muratura ndërtohet me gurë, brezat e drurit, edhe kur përdoren, nuk janë të dukshëm në sipërfaqen e jashtme të muraturës. Si lidhës përdoret balta në pjesën e brendshme të muraturës, ndërsa fugaturat mbrohen nga një shtresë llaçi gëlqereje. Në banesat e zhvilluara përdoret gjerësisht llaçi i gëlqeres si lidhës i muraturës. Elementet e drunjtja zhduken krejtësisht në pamjet e jashtme. Një vend gjithnjë e më të madh ze përdorimi i detajeve prej guri të gdhendur, me të cilët vishen shpatullat e dyerve të dritareve dhe ndërtohen mbulesat e harkuara të tyre. Shpesh këto të fundit lozin rolin e harqeve shkarkuese, nën të cilët vendosen arkitrarë druri ose mbushje me muraturë, për të krijuar një konfiguracion të rrafshët të hapësirave.

Përpunimi dekorativ përqendrohet në gdhendjet në relief. Ato zbatohen kryesisht në mbimbulesat e portave dhe në qoshtet e muraturës. Motivet më të përdorshme janë të nxjerra nga bota shtazore, si shqiponja, demi, qeni etj., por nuk mungojnë edhe portretet njerëzore dhe motivet bimore. Një motiv tjetër i pëlqyer është ai i diellit dhe i hënës. Në banesën nr. 12 motivi i diellit është konceptuar si një portret njeriu përballë, i rrethuar me rreze, ndërsa i hënës në formën e harkut të hënës me profil njerëzor, i qarkuar me rreze më të shkurtra. (Tab. XVIII).

BANESAT E PERIUdhËS SË TRETË

Tipologjia e re e banesës, e fiksuar gjatë periudhës së dytë, pati qëndrueshmëri dhe vazhdoi të ruhet edhe gjatë periudhës së tretë. Por, meqenëse tiparet e saj kryesore ishin tashmë të formuara, në periudhën e tretë ajo iu nënshtrua përpunimeve të formës dhe të teknikës, duke na dhënë një numër variantesh nga më të ndryshmet. (Tab. XIX). Në bazë të përpunimit arkitektonik qëndron gjithnjë theksimi i pjesës qendrore. Zhvillimi planimetrik mund të jetë simetrik, me ambiente të vendosura në të dy krahët e korridorit qendror, ose kjo skemë thyhet me daljen e një krahu përpara, duke fituar formën e shkronjës L. Skema kompozicionale mund të jetë e thjeshtë ose e përbërë, nga një ambient deri në tre të tillë të vendosur në çdo krah të korridorit qendror, ndërsa numri i kateve luhetet nga një në dy, shpesh duke pasur dhe bodrume ose qilare që dalin mbi nivelin e truallit. Pjesa qendrore formohet e futur, e dalë ose e rrafshët dhe e gjallëruar me erкера ose ballkone të hapur, të rrethuara me parapete hekuri të punuar. Një nivel të lartë arrin teknika e punimit me elemente të shumta guri të gdhendur. Brenditë e dhomave çlirohen edhe nga orenditë e pakta fikse dhe oxhakët dhe pajisen tashmë me mobilje e stufa. Banesat e reja të Dardhës fitojnë kështu një aspekt gjithnjë e më të afërt me banesat qytetare.

*
* *
*

Shtresimi i ndërtimeve të Dardhës, tiparet arkitektonike të tyre ecuria e zhvillimit dhe e zëvendësimit të tipeve të banesës, janë një pasqyrë besnike e gjithë etapave që përshkoi historia e fshatit.

Duke e filluar jetën si një vendbanim i përkohshëm blegtor, ndonëse në kushte të disfarvorshme ekonomike, larg shfrytëzimit feudal, kushte mirë natyrore, i struktur thellë në male, larg fshatarësia e lirë, ai mundi të që çmoheshin në periudha pasigurie nga fshatarësia e lirë, ai mundi të çajë rrugë drejt zhvillimit dhe të fuqizohet nga periudha në periudhë.

Ndërtimet e periudhës së parë dëshmojnë për një stad ende të ulët zhvillimi. Ato i përgjigjen një programi të varfër. Strehimi i bagëtimeve brenda ndërtesës, numri i paktë i ambienteve të banimit, përmasat e tyre të mëdha dhe shfrytëzimi i tyre me disa funksione, nevoja për ambiente pune të përditshme kushtëzuan parapëlqimin për tipa banesash me një skemë të thjeshtë, të njohur dhe të përhapur gjerësisht edhe në krahina të tjera të vendit, por me formulim arkitektonik specifik. Pasuria me pyje e zonës dhe aftësia e dardharëve në përpunimin e lëndës së drurit ishin të vetmet mundësi që mund të përdorëshin në përpunimin dekorativ të banesës.

Periudha e dytë, që përfshin gjysmën e dytë të shek. XIX. shënon një kthesë në zhvillimin e fshatit. Proceset e reja që po ndodhnin në jetën ekonomike të vendit fillojnë të ndjehen qysh herët në Dardhë. e cila fitoi një karakter të ri ekonomiko-shoqëror. Dardha u bë një qendër e rëndësishme e prodhimit dhe e shërbimit zejtar dhe e shkëmbimit të mallrave si një stacion i afërt, ku fshatrat përreth plotësonin kërkesat

e tyre imediate, pa pasur nevojë të zbrisnin në tregjet e qyteteve të zonës (Korçë, Kostur etj.). Në fshat funksiononin një numër i madh zejtarësh, dyqanesh e banesash. Fshati kishte fituar njëkohësisht një shtrirje të gjerë, ishte rritur popullsia e tij, e cila në vitet 1880-90 arrinte deri më 1454 frymë². Ai ishte pra një nga fshatrat më të mëdhenj të gjithë rrethit të Korçës dhe kishte një fizionomi urbanistike të formuar, si një vendbanim i mbledhur, i ngjeshur me ndërtime, me rrjet rrugor të shtrirë në gjithë fshatin dhe një furnizim të rregullt me ujë të pijshëm, siç dëshmojnë datat e çezmave (1876, 1880 etj.).

Karakteri i ri i fshatit i bënte të papranueshme banesat e vjetra dhe shkallë-shkallë po fitonte në terren përhapja e tipave të rinj të banesës. Banesa e re dallohet nga e vjetra dhe nga gjerësia e programit, nga përmirësimet e zgjidhjes funksionale dhe nga karakteri i ri i trajtimit arkitektoniko-dekorativ, që plotëson më mirë kërkesat për një jetë komode e më të qytetëruar. Kështu dhe fshati i Dardhës u përfshi në proceset e rëndësishme që u ndjenë në mbarë arkitekturën popullore dhe që karakterizohen nga futja e tipave të rinj të banesave dhe prirjet e theksuara konvergjente, më të spikatur kjo në Shqipërinë e Jugut. Banesa të ngjashme me ato të periudhës së dytë të Dardhës, pavarësisht nga shkalla e përpunimit arkitektonik dekorativ, takohen gjatë kësaj periudhe dhe në fshatra të tjera të trevës së Korçës, por dhe të krahinave të tjera të vendit.

Shekulli XX e gjeti fshatin me një fizionomi arkitektoniko-urbanistike të formuar, kështu që ai nuk pati barrën e shndërrimit dhe të formimit të një karakteri të ri, që e kishte mbajtur periudha e dytë. Megjithatë periudha e tretë solli përmirësime të dukshme të këtij karakteri dhe e pasuroi më tepër atë, duke e sjellë në gjendjen që e gjejmë sot dhe duke i përforcuar tiparet qytetare.

Në ditët tona, me fuqizimin e qendrave të tjera me kushte më të favorshme ekonomike e të çliruara nga ndrydhja e shfrytëzimit bejlerogjilgar, me përhapjen uniforme dhe të rregullt në çdo fshat të shërbimeve e të tregtisë dhe të sistemit arsimor, kulturor e shëndetësor, fshati i Dardhës e humbi rëndësinë e dikurshme në jetën ekonomike dhe shoqërore të krahinës. Falë klimës dhe bukurive natyrore ai u kthye në një qendër të frekuentueshme kurative pushimi. Krahas ndërtimeve të reja moderne, të ngritura vitet e fundit për pushimin e punonjësve, shfrytëzohen edhe disa nga banesat e vjetra, që, me ndërtimin dhe ambientet komode, e kryejnë më së miri këtë funksion të ri.

2) Karmici — *Gjeografia e Korçës dhe e rrethit*, Selanik, 1888, f. 40. (Përkthim në Arkivin e Inst. të Historisë).

THE URBAN AND ARCHITECTONIC CHARACTERISTICS OF THE VILLAGE OF DARDHA — KORÇA DISTRICT


The village of Dardha has an interest for the student not only because of its architectonic values, but also because it represents a typical way of development of the Albanian village during a period that is characterized by the emergence and spread of the capitalist relations.


As a result of the historical road of development, the constructions in Dardha are divided into three main periods. The first period begins from the founding of the settlement (about the 17th century) to the middle of the 19th century. During this period, Dardha had the character of a secure settlement, nestled among the mountains, populated by families that had come from neighbouring villages. Its inhabitants were engaged mainly in livestock-raising but they would pick up seasonal work as sawers, chiefly outside the village. The buildings of this period respond to a limited range of requests. The main typological characteristics of the dwelling was determined by the need for keeping the livestock within the dwelling, the limited living milieu, their large sizes and their multi-functional character.

The second period, from the second half of the 19th century, marks a turning-point in the development of the countryside. Dardha became an important centre of production and craftsmanship. In the village there were a great number of craftsmen, shops and inns. The population increased, the village extended and had an irrigation network over the entire area, and was regularly supplied with drinking water. The new requirements conditioned the introduction of a new type of dwelling which was distinguished from the previous one by the extension of its programme, the improvement of the functional solution and the new type of the architectonic-decorative treatment.

In the 20th century, that is, the third period of its development, the village had an established architectonic-urban physiognomy. Nevertheless, this period brought about other improvements and further enriched its character.

In our times, despite the rising power of other centres of the region, the village of Dardha played its former economic and social importance. With its climate and beautiful natural scenery, it has been turned into a curative and resort centre.









TABELA IV









TABELA VI



0 1 2 3 M



0 1 2 3 M










TABELA • VIII




0 1 2 3 M



0 1 2 3 M

TABELA IX

PAMUJE LINDORE





0 1 2 3 M



0 1 2 3 M












TABELA XII/4


QERE E BRENDESHME




DETAJ STREHE



KORNIZE MBI DRITARE



STREHE ÇATIE



DERE E JASHTME










TABELA XII/2






0 1 2 3 cm

TABELA XIII



0 1 2 3 M











TABELA XV



0 1 2 3 M



0 1 2 3 M




TABELA XVI








TABELA XVII






Fig. 1



Fig. 2




Fig. 3




Fig. 4



Fig. 5




Fig. 6

TAB. XIX



Fig. 1




Fig. 2

TAB. XII



FIG. 1




FIG. 2

Afërdita ONUZI

PËLHURAT E MËNDAFSHTA E TË PAMBUKTA TË SHQIPËRISË SË MESME DHE BREGDETARE VERIORE

Gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX në veshjet e popullit tonë, si edhe në pajisjet e ndryshme të interioreve fshatare e qytetare, veç pëlhurave të lijta e të leshta, bënin pjesë dhe pëlhurat prej mëndafshi e pambuku të punuara me avlëmend.

Masa e përdorimit të njërës ose tjetrës lëndë ishte e lidhur jo vetëm me kushtet klimatike të kësaj ose asaj zone, por edhe me kushtet ekonomike shoqërore dhe mënyrën e jetesës së tyre. Ndryshe nga zonat e ftohta, ku si në veshje dhe në pajimet shtëpiake mbizotëronin objektet e leshta, në zonat me klimë të ngrohtë, objektet prej liri e prej pambuke ishin më të shumta. Ndërsa në qytete, veçanërisht në Elbasan, Tirkunë, Krujë, Shkodër etj., një pjesë e këtyre pajisjeve për veshje dhe për interiore banesash ishin edhe prej mëndafshi. Punime të tilla qenë të pranishme jo vetëm në shtresat e pasura qytetare, por edhe në ato të mesmet, mbasi në shumë familje rritja e krimbit të mëndafshit, përpunimi i fijeve dhe endja e tyre në avlëmend, konsideroheshin si punë të zakonshme të gruas.

Në mënyrë të veçantë kjo mjeshteri, shkëlqeu në shekujt XVIII-XIX dhe vazhdoi të ruhej ende deri në vitet '40 të shekullit tonë në fshatrat fushore dhe në qytetet e Shqipërisë së mesme (Tiranë, Elbasan), në Krujë, në krahinën e Zadrimes si dhe në qytetin e Shkodrës.

Ndonëse kanë kaluar vite të tëra nga koha që kjo mjeshteri nuk ushtrohet më, kujtimet për të janë ende të gjalla.

Në këtë studim do të bëhen përpjekje për të paraqitur disa të dhëna lidhur me zhvillimin e kësaj mjeshtrie tradicionale kryesisht në fund të shekullit XIX dhe deri në vitet '40 të shekullit XX.

Punimi bazohet në të dhënat e grumbulluara drejtpërdrejt në terren në vitin 1982 si në fshatra dhe në qytete, në njohjen nga afër të një numri të madh ekzemplarësh që ruhen nëpër muzetë e qyteteve Shkodër,

Krujë, Kavajë, Elbasan, Tiranë¹, si dhe të atyre që vazhdojnë të ruhen ende nëpër familje të ndryshme.

Veç këtyre janë shfrytëzuar dhe punime të autorëve vendas e të huaj që trajtojnë këto probleme të ndryshme rreth kësaj mjeshtërie. Një ndihmesë me vlerë në studimin e kësaj teme ka dhënë etnografi Rr. Zojzi dhe historiani Z. Shkodra², të cilat më shumë janë ndaluar në problemet ekonomike të kësaj mjeshtërie.

Qëllimi i punimit është të japë një ndihmesë për njohjen e mëtejshme të kësaj tradite të pasur të popullit tonë në drejtim të zhvillimit historik teknik e artistik të saj. Në një artikull tjetër kjo mjeshtëri do të trajtohet si kulturë e popullit tonë.

1. VËSHTRIM HISTORIK MBI TRADITËN E TEKSTILEVE TË MËNDAFSHTA E TË PAMBUKTA

a) *Kultura e mëndafshit.*

Burime të shumta arkivore të periudhës së mesjetës dëshmojnë për kultivimin në masë të gjërë të mëndafshit në vendin tonë. Dëshmia më e hershme që njohim deri tani është teksti që i referohet muajit tetor të vitit 1318. Në të thuhet se nga porti i Vlorës dhe Himarës eksportohej mëndafsh në formë të punuar si dhe fshikëza, të sjella nga zona që ndodhen midis Beratit dhe Këlcyrës³.

Siç del nga dokumentet e kohës, eksportimi i tij bëhej në mënyrë të vazhdueshme. Dokumenti, që mban datën 9 shtator 1325, bën fjalë për një venecian i cili ngarkoi 20 thasë me fshikëza mëndafshi në portin e Vlorës. Dy vjet më vonë dëshmohet se prothontinusi N.G. i këtij qyteti u reklamonte venecianëve çmimin e këtyre fshikëzave⁴.

Të dhëna të tjera dokumentare të shekullit XIV na informojnë se në Shqipërinë e atëhershme kultura e manit ishte shumë e përhapur. Në mënyrë të veçantë përmenden plantacionet që përqëndroheshin përreth liqenit të Shkodrës, prej ku edhe tregtoheshin sasira të mëdha fshikëzash e fijesh mëndafshi. Për prodhimin dhe eksportimin në sasira jo të vogla dhe në mënyrë të vazhdueshme flet edhe fakti se në Shkodër në v. 1397 dhe në Drisht në vitin 1402, ekzistonin edhe dogana të posaçme për mëndafshin⁵. Njoftime të tjera nga shekulli XV tregojnë se kjo kulturë njihet edhe në zona më të thella të vendit tonë. Në defterin e Dibrës të

1) Fondet e Institutit të Kulturës Popullore.

2) Rr. Zojzi: *Tregu i Shkodrës dhe fillimet e industrisë së mëndafshit në vendin tonë*. «Buletin i Shkencave Shoqërore», Tiranë, 1954, nr. 1. Z. Shkodra, «Esnafët Shqiptarë» Tiranë, 1973.

3) A. Ducellier: «*La façade maritime de l'Albanie au moyen age*» Selanik, 1981, f. 365.

4) A. Ducellier: *Vep. e cit. f. 365*.

5) E. Shyflau. «*State und Burgen Albanies*», Wien und Leipzig, 1924, f. 42.

mëndafshi, dhe për çdo prikë, nevojiten disa çarçafë të punuar po me këtë lëndë¹⁰.

Mëndafshi i kësaj qëndre i njohur me emrin «seta scutarina» ishte shumë i kërkuar në tregjet e Evropës Qëndrore.

Kështu Shkodra dhe disa qytete të tjera shqiptare ishin bërë qendra të rëndësishme të tregtimit të fijeve dhe pëlhurave të mëndafshta jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Perandorinë Turke. Në gjysmën e dytë të shek. XVIII qytete si Shkodra, Prizreni e Peja ishin në kulmin e zhvillimit të kësaj tradite¹¹. Me të drejtë disa studiues të shek. XIX kanë shprehur mendimin se këto qytete si dhe disa të tjerë në Shqipëri luajtën një rol shumë të rëndësishëm në punimin e pëlhurave prej mëndafshi duke e konsideruar si një periudhë të artë të kësaj «industrie»¹².

Në vitet 30-40 të shekullit XVIII në qytetin e Selanikut organizoheshin panaire të herëpashershme në të cilat shiteshin edhe pëlhura të mëndafshta, të ardhura nga Shqipëria dhe Morea. Jo një herë ato konkuruan në shitje edhe ato që vinin nga Franca¹³.

b — Përhapja e fijeve të gatshme të pambukut.

Hapja e portave nga ana e perandorisë otomane tregut kapitalist botëror, bëri që në tregjet tona të depërtonin gjithnjë e më shumë mallra nga vende të ndryshme të Europës. Midis tyre sa vinte e më shumë filluan të tregtoheshin edhe fije të gatshme pambuku. Nuk u desh shumë kohë dhe ato u bënë si të zakonshme në avlemndet e grave qytetare e fshatare. Kështu repertori i pëlhurave tradicionale u pasurua edhe me ato prej pambuku, të cilat paraqiteshin mjaft të larmishme, të punuara tërësisht prej pambuku ose të përziera me mëndafsh. Në gjysmën e parë të shekullit XVIII në tregjet e disa qyteteve shqiptare ishin të pranishme dhe lloje të ndryshme pëlhurash të pambukta të punuara nga endeset vendase. Shpejt pëlhurat e punuara nga gratë shkodrane filluan të përmenden për cilësinë e tyre të lartë¹⁴.

Fillimisht kjo lëndë u përdor vetëm në qytete ndërsa në fshatra u njoh më vonë dhe kryesisht në formë pëlhurash të endura. Fijet e gatshme prej pambuku në mënyrë masive endëset fshatare filluan t'i përdorin në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Shumë prej tyre e sidomos ato fshatra që ishin njohur dhe për punimet e pëlhurave të mëndafshta, u bënë të famshme edhe për punimet e pambukta.

Pambuku si kulturë, ndonëse në sasira të pakta njihej edhe më përpara në zotërimet e Bushatllijve, por në pamundësi për ta përpunuar

10) J.G. Hahn «Albanesische Studien», Jena, 1854, f. 108.

11) Muller J. «Albanien Rumelien und die Osterreichisch — Montenegrinische Gränze», Praga 1844, f. 29-30.

12) Ubicini A. «Lettere sulla Turchia», Milano 1853, f. 342.

13) Demokratie Iliadou — «Inventaire des documents des Archives de la Chambre de Commerce de Marseille». Lemme Salonique (XVII-XVIII Siecles p. 151, 160.

14) Ubicini A.: «Lettere sulla Turchia», Milano, 1853, f. 342.

në vend ai mbeti vetëm si material eksporti, gjë që na del edhe nga manifest-ngarkesat e viteve '50 të shekullit XVIII¹⁵.

Procesi i tjerrjes së fijeve të pambukta për endje pëlhurash në Shqipëri u njoh vonë. Gratë fshatare tirnin sasira të pakta dhe me cilësi të dobët. Këto lloj fijesh u përdorën prej tyre vetëm për të thurrur ndonjë palë çorape dhe akoma më pak disa krahina endnin motivet e përparjeve, kur donin të theksonin më shumë ngjyrën e bardhë. Prandaj këtë problem në punimin tonë nuk po e çekim.

*
* *

Shtimi i kërkesave për pëlhura të mëndafshhta e të pambukta bëri që ritmi i punimit të tyre të shtohet në përmasa të konsiderueshme.

Sikurse tregojnë burimet dokumentare vendase si dhe përshtypjet e udhëtarëve të huaj, në fund të shekullit XVIII pothuajse çdo shtëpi që nga Elbasani deri në Shkodër ishte kthyer në një punishte prodhuese për treg sendesh të ndryshme prej mëndafshi, pambuku, si dhe të atyre prej liri dhe leshi.¹⁶

Në fund të shekullit XIX edhe në këtë mjeshtëri u shfaqën dhe forma të reja të organizimit të punës. Në qytetin e Shkodrës e të Prizrenit mjaft gra filluan të punojnë me pagë për llogari të sipërmarrësve të ndryshëm. Ata porositnin më shumë se çdo gjë pëlhura për pjesë veshjesh, kryesisht për këmisha, mbulesa koke, përparje etj. Kjo përpunim thotë me atë periudhë kur disa zona si Zadrime, Fushë-Kruja e disa fshatra të tjera fushore të rrethit të Tiranës e të Elbasanit, kishin filluar t'i njësonin disa pjesë veshjesh si psh., pëlhurat për këmisha etj. Mjaft gra fshatare (sidomos ato të Zadrimes) pëlqenin më shumë t'i blinin të gatshme, mbasi ato ishin të lidhura me shijet tradicionale të tyre.

Si kudo edhe në këtë fushë koha bëri punën e saj. Në fund të shekullit XIX e fillim të shekullit XX nga tregjet evropiane vërshuan me shumicë pëlhura të ndryshme të fabrikuar, të cilat brenda një kohe të shkurtër, në mjaft zona zëvendësuan pëlhurat tradicionale, sidomos në veshjet ceremoniale. Nuk kaloi shumë kohë edhe për këtë mjeshtëri vërshimi i tregut evropian filloi të bëhej gjithnjë e më i rrezikshëm.

Nga ana tjetër kulturën e mëndafshit e dëmtoi rëndë edhe sëmurdja *pebrinë* e cila u shfaq në Europën Qendrore në vitin 1860, prej nga u përhap, me shpejtësi të madhe, edhe në viset e Turqisë Evropiane.¹⁷

Megjithatë kjo mjeshtëri nuk pësoi fatin e shumë të tjerave. Forca e traditës dhe nevoja për këto punime vazhdonin të ishin ende e fuqishme. Në mënyrë të veçantë pëlhurat e pambukta vazhdonin të përdorreshin në masë të konsiderueshme, ndërsa të mëndafshatat më pak.

15) «Shqipëria e Veriut në shekullin XVIII», Vëll. I, Tiranë 1967, f. 355.

16) Z. Shkodra, *Problemi i tregut shqiptar në shekullin XVIII*, «Studime Historike», Tiranë, 1966, nr. 3, f. 73.

17) G. Hahn: «Reise durch die Gebiete des Drin und Vardar», Vien, 1867, f. 446.

Endja e pëlhurave të pambukta e të mëndafshita në sajë të forcës së traditës arriti të mbahej gjallë deri në vitet '50 të shekullit tonë, kur kultivimi i kulturës së mëndafshit u organizua nga shteti. Mbas kësaj periudhe këto lloj pëhurash më shumë përcilleshin nga nëna tek vajza se sa prodhoheshin. Vite të tjera më pas në disa familje vazhdoi të mbejtesh si një kërkesë e domosdoshme të kishte në pajë një ose dy çarçafë mëndafshi, dy ose më shumë çarçafë pambuku, një komplet pecetash e mbulesë tavoline, dy tri këmisha etj., të punuara në avlemend. Është kjo arsyeja që në baullet e disa familjeve ende dhe sot mund të gjesh ndonjë objekt të këtillë.

Në fund të shekullit XIX e në fillim të shekullit XX familje të tëra në qytetet Shkodër, Krujë, Tiranë dhe Elbasan u ngjanin shpesh herë punishteve të vërteta, ku njëri nga pjesëtarët qëndiste, tjetri punonte në avlemend, një tjetër ishte kazaz, një argjendar etj. Në disa nga këto familje mund të shikoje deri në 2-3 avlëmente që punonin njëherësh. Ishte e kuptueshme, që në këto raste ato nuk endnin vetëm për nevojat e familjeve të tyre, por edhe për tregun. Këto familje ishin kthyer në manifaktura, të vogla shtëpiake.

Në fillim këto gra dilnin në treg me pëlhura të pambukta të punuara me fijet e blera prej tyre. Me paratë që mirrnin ato fillonin gradualisht të rritnin më tej sasinë e këtyre punimeve, prej të cilave kishin fitim vetëm kohën që harxhonin për t'i punuar. Ndërsa në pëlhurat e mëndafshita nxirrnin të ardhura më të favorshme, sepse lëndën e parë e siguronin brenda ekonomive familjare.

Në rastet e tjera endëset që kishin nevojë të shitnin punime të tilla hynin në marrëveshje me tregtarë që shitnin fije të gatshme, Në fillim u linin atyre peng një objekt me një farë vlere (unazë, vathë, bylyzyk ose pëlhurë të gatshme të mëndafshit) dhe mirrnin prej tyre një sasi të caktuar fijesh. Pastaj ato dorëzonin pëlhurat dhe si shpërblim për punën e kryer nuk mirrnin para, por fije të gatshme. Një pjesë tjetër punonin për porosi të ndryshme që u vinin nga fshatrat ose nga familje qytetare që përgatishnin pajën e vajzave. Ato sillnin fije të gatshme dhe porostnin, sipas dëshirës, llojet e punimeve, modelet etj.

Në Shkodër në këto raste praktikohesh një formë tjetër. Familjet e kamura, që përgatiteshin për të martuar vajzat, mirrnin në shtëpitë e tyre një endëse për aq kohë sa të përfundonin ato çfarë duheshin për pajë. Përveç pagesës për çdo kut, kësaj i jepnin edhe dy vafte për të ngrënë.

Në këtë qytet edhe kjo mjeshtëri shtëpiake u përfshi në sferën e prodhimit kapitalist. Tregtarë të ndryshëm, që përveç mallrave të tjera regtonin edhe fije të gatshme pambuku ose mëndafshi, akaparorin një numër endësesh të varfëra të njohura në këto punime. Ato merrnin prej akaparuesit një sasi të caktuar fijesh dhe i punonin në shtëpitë e tyre sipas porosive që jepte ai. Shpërblimi bëhej me para, në bazë të sasisë që punonte brenda një muaji. Kështu një «base» (endëse) e mirë mund të endte 100-200 kut në muaj. Për çdo kut ajo mirrte 50 pare (në fund të shek. XIX) ose 25-30 korona (në fillim të shek. XX).

Sipas informatorëve të ndryshëm, në Shkodër deri në vitet '20-30 të shekullit tonë kishte ende 12 tregtarë të këtillë, ndonjëri prej të cilëve kishte edhe 20-25 base që punonin për llogari të tij.

Zadrimoret, edhe pse të njohura si endëse të mira, pëlhurat për këmisha dhe mbathje i blinin vazhdimisht tek këta tregtarë.

Një kategori tjetër grash endëse të këtyre qyteteve i nxirrnin prodhimet e tyre drejt e në treg, duke i shitur vetë (më rrallë), ose nëpërmjet disa grave të quajtura *telallesha* ose tregtarëve të vegjël ambulantë të njohur me emrin *qarxhi*. Nëpërmjet tyre shpërndareshin pëlhura të ndryshme jo vetëm në tregjet e afërta të krahinave përkatëse, por deri në Korçë, Vlorë, Berat, Fier, Lushnjë, etj. Pëlhurat e gegëve ishin shumë të pëlqyeshme e të kërkueshme në këto qytete.

Punime të tilla të endëseve fshatare shpërndareshin kryesisht brenda tregjeve të krahinës, mbasi prodhimet e tyre bëheshin në përshtatje me veshjet tradicionale të zonës. Endëset prezake punonin pëlhura që u përshtateshin shijeve lokale të veshjes së grave të Malësisë së Tiranës, të rrethinës së Mamurrasit, Milotit etj. Kështu bënin edhe endëset e fshatrave Bubq e Budëll të rrethit të Krujës. Pikat kryesore ku shiteshin prodhimet e tyre qenë tregu i Urës së Zezë, ai i Shijakut dhe i Milotit. Shitja bëhej më shumë me para dhe më rrallë praktikohesh shkëmbimi me bulmet ose prodhime të ndryshme bujqësore.

Në një formë ose në një tjetër deri në vitet '40-50 të shekullit tonë këto punime zinin një vend me rëndësi në veshjet dhe interoret e gjithë zonës që morëm në studim.

2. — RRRITJA E KRIMBIT DHE PËRPUNIMI I FIJES SË MËNDAFSHIT

Ndërsa për punimin e pëlhurave të pambukta lënda e parë sillej tërësisht nga jashtë, për të mëndafshatat në të shumtën e rasteve ajo sigurohej brenda në familje. Një dëshmi e gjallë për këtë janë dhe drurët e manave që, ndonëse shumëvjeçarë, vazhdojnë të ruhen në oborret e shtëpive. Druri i tij nuk mbahej aq për frutin se sa për gjethet e tij, që ishin baza kryesore për kultivimin e krimbit të mëndafshit.

Disa herë në, terren kemi dëgjuar nga kultivueset e ndryshme të na thonë «krimbi e do hyzmetin në kambë, si fëmija e vogël», ose «nuk duhet me ba be (me u betue) rrejshëm për krimbin e mëndafshit, se të zen mundi i tij». Domethënia e tyre ka të bëjë me një varg procesesh të mundimshme e delikate që nisin nga momenti kur ngrohet veza e deri në nxjerrjen e fijos.

Vezët e fluturës ose farat e mëndafshit, siç i quajnë kultivuesit popullorë, kërkonin një ngrohtësi të caktuar, për t'u zhvilluar. Ndaj ato me një përkujdesje të veçantë i mbanin në gjë për tre ditë e net. Prej tyre dilte një lloj mize, e cila ushqehet me gjethe të njoma mani (në Krujë, gjenë mungesë të tyre, u vinin majat e gjetheve të njoma të ferrave.) Gjenë thotë shtroeshin mbi çerapë balte ose tepsia bakri, në të cilat më përpara hidhej një shtresë e hollë hiri e pastaj mbi to vendosnin mizat. Në këtë fazë ato janë shumë të ndjeshme ndaj ambientit të jashtëm, dhe për këtë arsye vendoseshin në kthina të veçanta e të pastra. Pasi kalonin 3-4 ditë e deri sa plotësoheshin rreth gjashtë javë ndërroeshin, duke i zëvendësuar gjithnjë me më të mëdha (veçse të palagura nga vesa). Gjatë kësaj periudhe miza duke u rritur shndërrohej në krimb, që dalngadalë fillonte të ecte.

Në këtë moshë nuk i ushqenin me gjethe mani të butë por me gjethe mani të egër, me qëllim që të mos hanin shumë. Në rast të kundërt ato dembeloseshin, «bahen budallej» (Shkodër), «shurdhoheshin» (Krujë) dhe nuk endnin fije në masën e duhur. Krimbat e quajtur «budallë» ose «bullicë» veç kësaj e endnin fijen edhe më të trashë se krimbat e tjerë. Ky lloj ushqimi ishte i vlefshëm për 2-3 ditë, më pas u vinin gjethet të njoma fieri ose prej lisi. Pikërisht kjo është periudha kur ai fillon të ende fshikëzën me fije (mshejkillën-Krujë, mshikën-Tiranë, shikën-Shkodër). Në këtë fazë krimbin nuk e linin më për tokë, por e ngrinin në skela të ndërtuara posaçërisht. Periudha e krijimit të fshikëzës dhe e mbushjes së saj me fije zgjaste rreth dy javë. Në këtë proces rritësi duhej të ishte shumë e saktë në përcaktimin e kohës kur duhej të ngrohete krimbi flutur, prëndryshe ai shponte fshikëzën dhe kështu fije e endura këputeshin. Prandaj për të parandaluar këtë gjë fshikëzat e mbushura plot i nxirrnin në diell me qëllim që pas disa orë të ngrohete krimbi.

Sasia e nevojshme e fshikëzave për «farë» ruhej në një degë fieri të varur diku në trerët e shtëpisë.

Nxjerrja e fijeve nga fshikëza ishte një proces që kurorëzonte gjithë mundin e punës së bërë deri në atë fazë. Gruaja që do të merrej me këtë veprim, përgatiste një enë me ujë të valuar ku fuste një numër të caktuar fshikëzash. (Një masë e këtillë, e cila zakonisht nuk shkonte më shumë se 160 fshikëza, të numëruar 40 herë nga 4 kokrra, në Krujë e rrethinat e saj quhej «një ptej»). Mbas disa përzierjesh (gjithnjë në të njëjtin drejtim) bëhej tërheqja e fijeve. Në fillim ato dilnin të trasha, pak a shumë me pamjen e fijeve të lirit, pastaj cilësia e tyre vinte duke u përmirësuar, deri sa dilnin fijet më të mira. Sipas nevojave, tërhiqeshin më shumë fije më të trasha ose më të holla.

Për të mos u ngatërruar njëra me tjetrën, gjatë tërheqjes ato visheshin të palosura mbi një tepsi.

Ashtu siç ishin, veçse të lidhura me një fije prej materiali tjetër, ato vendoseshin në vende të caktuara për t'u tharë, pasi hidhnin mbi to disa gurë të vegjël lumi.

Një nënë e kujdesshme, sidomos kur kishte disa vajza, duhej të kishte mënjanë një sasi të konsiderueshme fijesh të tilla për t'i pasur të gatshme kur të paraqitej nevoja. Prandaj ajo herëpashere grumbullonte fije, të cilat mbasi i mbështillte në trasta pambuku, i ruante në fund të arkës.

Kur vinte rasti për t'i punuar në avlëmend, këto fije i dridhnin më parë me anë të një mjeti të posaçëm, të njohur me emrin çark (fig). Në të dridheshin në të njëjtën kohë 16 fije më të njëjtën masë. Shkalla e dredhjes (më pak, mesatare ose më shumë) matej me njësi gjatësish të caktuara midis çarkut dhe personit që kryente këtë punë. Çdo njësi gjatësie përbënte një këmbë, ose «kamçë». Një këmbë larg kryhej dredhja më e lehtë, ndërsa dredhja më e madhe realizohej 21 këmbë larg.

Zakonisht kjo punë bëhej në orët e hershme të mëngjezit (në stinët e ngrohta) kur nuk kishte lëvizje ajri. Vajzat ose gratë mblidheshin dy-tre së bashku dhe vendosnin çarqet në hajatin e shtëpisë së njëres prej tyre. Këto raste për vajzat zadrimore ishin momente shumë të këndshme. Lëvizjet e çarkut shoqëroheshin me të qeshura e me këngë:




Fig. 7. Peshqir për banjo (Fragment)



Fig. 8. Pëlhurë për këmisha grash e punuar me fije pambuku e mëndafshi.



Fig. 9. Mbulesë koke prej pambuku (Fushë-Krujë)




Fig. 10. Mbulesë filxhanash prej pambuku



Fig. 11 Perde e punuar me fije pambuku (Shkodër)



Fig. 12. Çarçaf «i kuq» prej pambuku Shkodër (Fragment)



Fig. 13. Mbulesë jastekësh prej mëndafshi (Fragment).



Fig. 14. Mbulesë koke, e përdorur nga gratë e Fushës së Zadrimës (Fragment)

«Po shkon vajza bregut Drinit, tir-shtir
Fija e mëndafshit, rreze diellit, tir-shtir»¹⁸ etj.

Në të njëjtën kohë bëhej dhe ndarja e fijeve sipas trashësisë dhe cilësisë së tyre. Një kategori fijesh, që përdoreshin për të punuar pëlhurat e mira (për këmishë ose çarçafë), i nënshtroheshin dhe një fazë tjetër përpunimi që kishte të bënte me rritjen e masës së shkëlqimit. Në këtë rast ndikonte shumë zjerja për disa orë e fijeve të përzjera me sapun të grirë e sidomos me një lloj sapuni të quajtur «gjirit» i cili vinte zakonisht nga Kreta.

3. — LLOJET E FIJEVE TË PËRDORURA

Për fijet e llojeve të ndryshme, qofshin ato prej pambuku ose prej mëndafshi, u krijua dhe një terminologji e posaçme në fjalorin e grave endëse dhe të atyre që i tregtonin.

Fijet e trasha dhe më pak të dredhura, prej mëndafshi, njiheshin me termin *anë* (Shkodër, Tiranë, Elbasan), ose *anie* (fshatrat midis Tiranës e Krujës) dhe *qinar* (Krujë). Këto fije zakonisht përdoreshin për të bërë qenarët, vijat e vendosura së gjati, me të cilat zbukuroheshin pëlhurat e përdorura për këmisha ose «gishtarët», «ujsat», topat» në pëlhurat e përdorura për çarçafë dhe për të zbukuruar «krenat» e rizave.

Ato, herë të ngjyrosura, herë jo, janë përdorur edhe për zbukurimin e pëlhurave të pambukta.

Për fijet e holla e të dredhura shumë përveç termit *fije hollë* ndeshim sidomos në qytete edhe fjalën turke *byrynzyk*, po me këtë kuptim. Me këto punoheshin pëlhurat e cilësisë më të mirë, për të bërë këmishat «e para», «rizat e mira» dhe çarçafët e përdorur për zbukurim.

Fijet e pambukta, duke qenë se fabrikoheshin, ishin më të shumta në lloje si nga trashësia dhe nga masa e dredhjes. Veç këtyre ato ndryshonin dhe nga shkalla e bardhësisë ose cilësia e vetë pambukut (i gjatë a i shkurtë). Lidhur me këto ishin krijuar emërtime të posaçme për t'i dalluar fijet nga njëra-tjetra. Veç atyre vendase, u përdorën edhe disa të huaja, të importuara më shumë nga tregtarët e qyteteve. Kjo ndodhte edhe për faktin se këto fije vinin të gatshme nga jashtë e duke mos qenë prodhime vendase hynë bashkë me emërtimet përkatëse. Kështu, p.sh., fijet e cilësisë së parë të ardhura me shumë nga tregjet turke, u njohën me emrin *sekez* e *bogosi*, ndërsa për fijet më të holla, të cilësisë së mirë, përveç termit vendas *pamukhollë* ndeshim dhe termat *dylben* (Tiranë, Krujë, Elbasan) e *mëlez* (Shkodër).

Për nga shkalla e bardhësisë ato ndaheshin në tre grupe. Fijet më të zbardhura i quanin *pamuk sheqeri*. Në grupin e dytë futeshin fijet e quajtura i *zbardh*. Ato u përdorën gjërësisht për pëlhurat për këmisha e pjesë të tjera veshjeje, për peceta duarsh, mbulesa koke etj. Në grupin e tretë bënin pjesë fijet me ngjyrë kremi, të cilat u njohën me emrin

18) Këngë e kënduar nga vajzat e rrethit të Shkodrës në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 1978.

pamuk i zi. Fije të këtilla u përdorën më shumë nëpër fshatra, për të endur pëlhurat për veshjen e përditshme. Në mënyrë të veçantë kjo fije është përdorur në pëlhurat e këmishave të grave katolike të Fushë-Krujës.

Emra të veçantë u përdorën edhe për fijet me trashësi të ndryshme. Në Shkodër fijet e trasha i njohën me emrin *tir*, në Krujë *tëjër*, (*tir*), ndërsa në Tiranë e Elbasan u thonin *anë Shkodre*. Fijet më të holla se këto u njohën me termin *fije krap* (Shkodër), (Tiranë) ose *krep* (Krujë). Këto pastaj i ndanin duke kombinuar trashësinë me zbardhjen në: *krep i parë* (fije e bardhë dhe e fortë), *krep i dytë* (fije më pak e zbardhur, por e dredhur më shumë), *pamukaq* (fije me shkëlqim). Për vetitë e tyre të mira këto fije gjetën përdorim të gjërë në të gjithë trevën në studim.

Nën ndikimin e tregtarëve masa e trashësisë përcaktohej dhe me numra¹⁹, sidomos nga konsumatorët në qytete. Tregtoreshin e konsumoreshin më shumë fijet me numur 14, 18, 20, 22, 24, 30, 32, 60. Fijet me numër 14, 16, 20, përdorëshin për të punuar një lloj pëlhure të ngjashme me bezen. Në fshatra dhe në shtresat e varfra të qytetit me to bënin pjesë veshjesh të brendshme.

Fijet me nr. 22 ishin shumë të përshtatshme për t'u përdorur për maje (trame) në pëlhurat e punuara për brekeshja burrash. Me fije 24-she janë endur pëlhurat «me anë», me të cilat bëheshin këmishat «e dyta» për gratë e shtresës së mesme. Rizat për përdorim të përditshëm, të njohura dhe me emrin «banike», janë punuar me fije 30-she dhe 32-she, ndërsa për «të dytat» përdorej fije 60-she.

4. — AVLEMENDI DHE TEKNIKA E PUNIMIT

Si për endjen e pëlhurave të mëndafshta dhe të atyre prej pambuku u përdor avlëmend i horizontal, i njohur me terma të ndryshme si *vegje* (Tiranë, Elbasan), *vegël* (Krujë) dhe *tezgjah* (Shkodër).

Përgjithësisht atë e punonin mjeshtrit fshatarë të punimeve në dru, të cilët herë i shitnin në treg bashkë me punimet e tjera, herë i punonin me porosi të veçanta. Ndërtimi i tij qe i njëjtë si për pëlhurat e mëndafshta dhe për ato prej pambuku. Deri në fillim të shekullit tonë atë mund ta gjeje ende në disa faza kalimtare të zhvillimit të tij, sidomos në rrethet Krujë e Tiranë.

Ndonëse numëroreshin me gisht, në vitet '20 të shekullit tonë kishte ende gra në Tiranë që për forcë të traditës vazhdonin të punonin «me kamë në tokë». Kjo thënie na kujton atë fazë kur avlëmend i ishte i palëvizshëm e kur ndërtimi i tij bazohej në nguljen e trungjeve mbajtëse mbi një gropë me formë katërkëndëshi, me thellësi 20-30 cm. Në kohën e përdorimit të tij fijet e pëlhurës, të lëshuara për së gjati, i thurinin në formë gërsheti dhe i lidhnin diku në trarët e shtëpisë (Fig. 1). Për këto arsye vendi i avlëmendit paracaktohej që kurse ndërtohej shtëpia, duke pëlqyer gjithnjë këndet më të ndriçuara.

19) Fijes më të hollë i përgjigjet numri më i madh.




Fig. 1

Në mënyrë masive përdorej avlemendi i lëvizshëm, i cili në këtë periudhë përjetonte njëkohësisht dy faza zhvillimi. Kishte gra endëse që prej kohësh punonin në avlemend të lëvizshëm, ndërsa fijet e lëshuara së gjati vazhdonin t'i mbanin të lidhura në tra, ose në rastin më të mirë këtë rol e luanin dy dërrasa të vendosura pjerrtas mbi avlemend, të cilat vendasit i quajtën *majtëse* (mbajtëse) (Fig. 2).

Fazën më të zhvilluar e përfaqësonte avlemendi me dy shula, i cili, sipas informueseve të ndryshme, e zëvendësoi shumë shpejt atë me




Fig. 2

mbajtës. Kjo ndodhi, sepse mbështjellja e fijeve në shul jo vetëm e thjeshtësoi ndërtimin e avlemendit dhe zvogëloi volumin e tij, por e bëri edhe më praktik në përdorim (Fig. 3).

Në përgjithësi emërtimi i pjesëve të veçanta të avlemendit, ndryshon pak nga njëra trevë në tjetrën apo edhe nga trevat e tjera më larg²⁰.

20) A. Onuzi, *Tekstilet tradicionale të krahinës së Hasit*, «Etnografia Shqiptare», Nr. 13, Tiranë, 1983, f. 75.




Fig. 3

Kështu dërrasa ku ulej endësja gjatë procesit të punimit quhej *shkam*. Dy bazamentet ku mbështeten pjesët e avlemendit i quanin *trupa* (Shkodër), *trungje* (Krujë), *kama* (Tiranë, Elbasan) ndërsa dy trun-gjet e sipërme, ku varen në përgjithësi pjesët lëvizëse të avlemendit, janë emërtuar me termin *shpatulla*.

Pjesë të tjera të avlemendit janë shpata e përbërë nga *dhamt* dhe *tefet me liqtë*. Për pedalet, që bëjnë ndërrimin e lisave, përdorenshin termat *kamestra* (Krujë, Tiranë, Elbasan) dhe *kama* (Shkodër). Makaratë ku vareshin lisat, diku quheshin *makalla* (Krujë) e diku *nakollare* (Tira-në, Shkodër). Për shulin e përparmë në rrethin e Tiranës përdorej fjala *barks*, ndërsa në Shkodër *shuli paranik*. *Shuli i pasmë* në rrethinat e Krujës, Tiranës e Elbasanit quhej *shuli i mramë*, në Shkodër i thoshin *shuli mrapanik*. Kunjat, që shërbenin për të fiksuar shulat, quheshin *ngrehc* ose *birs*.

Në fazën kur fijet e pëlhurës lidheshin në tra, në vend të shulit të pasëm kishte një shkop të quajtur *nevren* i cili ruante kufirin e fijeve në vendin ku fillonte të thurej gërsheti.

Më vonë ai u bë pjesë e *mbajtësit*. Gojën e fijeve të kryqëzuara e ruanin dy purteka ose dërrasa të vogla të emërtuara me termat *komish* (Shkodër) dhe *kallama* (Krujë, Tiranë).




Fig. 4

Me interes janë dhe shprehjet ose fjalët që përdoren gjatë procesit të punimit. Në Krujë e rrethinat e saj thuhet «jam tue vej», kur punohet në vegje, ndërsa endëset në qytet i quanin *veglore*, ato të fshatrave fushore *vegjëtare*. Terma *veglore* përdoret edhe në rrethinat e Tiranës. Në Shkodër thuhet «jam tue inu-», ose «tue ba me tezgjah», gratë endëse quheshin *base*.

Të shumta janë dhe termat e përdorura për emërtimin e fijeve të lëshuara për së gjati dhe të atyre që kalojnë majtas e djathtas tyre.

Të parat, endëset shkodrane i kishin emërtuar, *i giati*, krutanët e *shlume*, ndërsa në Tiranë e rrethinat e saj *termosi*, në Elbasan *tramë*. Fijet që i mbushin këto në Shkodër e Elbasan i quanin *in* (ind) në Krujë e *mushmja* ose e *mëllmja*, në Tiranë *drugë*.

Me kalimin e kohës shumë procese pune u «mekanizuan». Për disa prej tyre që kërkonin kohë të gjatë për t'u marrë me to u përdorën disa mjete të ndërtuara nga mjeshtër të posaçëm të punimeve në dru. Këto mjete ishin të domosdoshme edhe për faktin se fijet e përdorura, duke qenë më delikate, kërkonin saktësi e kujdes më të madh në çdo fazë përgatitore. Konkretisht lëmshat mbështilleshin duke i vendosur torkat në një mjet të ndërtuar me dru e kallama që quhej *elemine* (Fig. 5), ndërsa masuret me fije të ndryshme mbusheshin me anë të një mjeti tjetër prej druri, të quajtur, çikrik (fig. 6 a, b).

Endja e fijeve për së gjati bëhej në një mënyrë shumë praktike e të përshtatshme, veçanërisht në rastet kur punohej me fije të mëndafshita.

Tradicionalisht ky proces bëhej me kunjat të ngulura në mur, por për të kryer më shpejt këtë punë, gruas që endte fijet i vinte në ndihmë një mjet i posaçëm i quajtur endës (Krujë, Tiranë, Elbasan) ose *kafaz* (Shkodër) i cili kishte formën e një kornize me përmasa 1.20x70 cm, i ndarë në mes me një rrip dërrase. Në dy të ndarat vendoseshin për së gjeri shufra metalike, nëpër të cilat kalonin një numër i caktuar masuresh të vogla të mbushura me fije. Kështu endësja për një kohë të shkurtër tërhiqte disa fije njëherësh dhe ashtu i kalonte nga njëri kunj në tjetrin. Pastaj këto fije, ashtu si në punimet e leshta, i mbështillnin në shulin e pasëm dhe i kalonin nëpër lisa e shpatë për t'i fiksuar në shulin e përparmë.

Boshtet e vegjël, në të cilët mbështillnin fijet që kalonin për së gjeri, përgjithësisht i quajtën *druga* (Fig. 4).

Për të ruajtur drejtimin e anëve të pëlhurës është përdorur një lloj vizore metalike me dy skaje paksa të thyera e të dhëmbëzuara, e njohur me termin *çimarë*.

Për emërtimin e avlemendit dhe pjesëve të tij, me ndonjë përjashtim u përdorën terma të vjetra të gjuhës shqipe, të cilat kanë ecur e janë transformuar bashkë me rrugën e zhvillimit të këtij mekanizmi popullor.




Fig. 5




Fig. 6, a, b.

Teknika më e praktikuar në punimet me këto materiale ka qenë ajo me dy lisa. Rrallë herë janë punuar breza ose pëlhura pambuku për brekesha burrash me katër lisa. Në pëlhurat me dy lisa, janë zbatuar variante të ndryshme si ajo «me rica» (me shufër), «me gjylpanë», «të rrahur një herë me shpatë», «me kapërcime», «me të mushme» etj.

5. LLOJE PËLHURASH DHE ZBUKURIMET E PËRDORURA NË TO.

Repertorin e këtyre punimeve mund ta admiroje njëherësh në pajën që përgatiste çdo vajzë për martesë. Në të, vend kryesor zinin pajisjet e ndryshme për shtëpinë dhe pjesët e veshjeve prej pambuku ose prej mëndafshi, të punuara të gjitha në avlemend. Merrej një sasi e atillë që llogaritej të plotësonte nevojat e viteve më të shumta të jetës, madje duheshin marrë edhe ato pajisje që përdreshin për ditën e vdekjes. Nuk është e rastit që në pajën e vajzave të shtresave të mesme të qytetit e të fshatit të bënin pjesë këto objekte: 10-12 çarçafë, dy prej të cilëve prej mëndafshi (ato prej pambuku qenë krejt të bardhë ose me ngjyra) 3-5 mbulesa jastëkësh prej mëndafshi, 30-40 peceta duarsh (peshqir duarsh) 4-5 mbulesa tavoline ose sofra (sofrabezë), dy sofrapeshqirë (fletë pëlhure e gjatë sa t'i vinte sofrës rreth e rrotull), 15-20 mangore (këmisha të shkurtra), 4-5 prej tyre prej mëndafshi, 10-15 këmisha e po kaq palë mbathje për burrin (një pjesë të punuara me të *zbardh* e një pjesë me *dredhac*), 6-7 shalle që hidheshin në kokë kur dilnin nga shtëpia, 15 palë mbathje për vete, 35-40 bohçe (në përshtatje me periudha të ndryshme të jetës), dy tre palë perde, 40-50 kut pëlhurë pambuku e paprerë, 10-15 mbulesa koke (levere), 8-10 peshqirë për banjo etj.

Për ditën e vdekjes vajzat e besimit mysliman sillnin 5 çarçafë të bardhë si dhe dy përparje e dy peshqirë që i përdorte personi që lante të vdekurin. Vajzat e besimit katolik për këtë ditë duhej të kishin mënjanë katër çarçafë, dy të bardhë e dy me ngjyrë²¹.

Te vajzat e besimit katolik binin në sy objektet që përbënin atë që quhej «pajë e kuqe». Kjo ishte dhe pjesa më e vlefshme, mbasi në punimet e ndryshme përdreshin kryesisht fije bogosie me ngjyrë të kuqe. Këtu përfshiheshin 12 çarçafë «odalij» (katrorë me ngjyra të ndryshme, ku më shumë bie në sy ngjyra e kuqe), një mbulesë djepi, 12 jastekë, dy mbulesa tavoline, 12 msalla, një ose dy palë perde etj.

Ndër shtresat e pasura sidomos të qyteteve numri i këtyre objekteve që disa herë më i madh, aq sa gratë që kanë punuar për këto i hiperbolizojnë në këtë masë: «ato merrnin në pajë çarçafë, mangore, bohçe, msalla etj. sa mbin bar në tokë».

Vlerat artistike qëndrojnë jo vetëm në zgjedhjen e kombinimit e ngjyrave e të motiveve, por edhe në mënyrën e të punuarit, në variantet e shumta teknike dhe në kombinimin e fijeve me trashësi e përbërje të ndryshme.

21) Sipas një zakoni, çarçafët me ngjyrë ia hidhnin bashkëshortit që vdiste më përpara. Ndërsa çarçafët e bardhë që tregonin shenjë zie, ia hidhnin atij që vdiste më pas

Të gjitha këto së bashku kanë krijuar atë larmi e pasuri të madhe formash zbukurimi që vihet re në këto punime. Në fondin e tyre ka të atilla që me të vërtetë të befasojnë me finesën e rrallë e të duket e pabesueshme të jenë punuar në një avlemend shtëpiak. Përsosmëria teknike e tyre në disa raste është në atë shkallë sa do ta kishte zili edhe endësi më i mirë i kohëve moderne. Në përgjithësi për zbukurim ndiqen të njëjtat kritere si për pëlhurat e mëndafshta dhe ato të pambukta. Motivet më të parapëlqyera janë vijat paralele, ato zikzake, vijëzat e ndërprera, trekëndëshet, katrorët, rombet, lulet me katër, gjashtë e tetë cepa, gjetet etj. Në të folmen profesionale të endëseve vijat me trashësi të ndryshme quheshin «klyshe», «thupra», «ujsa», «qenarë», «gishtore», etj. Katrorët që simbolizonin një gjë të rrumbullakët i quanin «topa». Trekëndëshat, vijat zigzake, që vendoseshin në skajet e rizave në Zadrinë, përmbli-dheshin me emrin «zogjtë e rizave». Në fshatrat e Fushë-Krujës lulet me katër e gjashtë cepa si dhe rombet e shprehur në variante nga më të ndryshmet kishin emrat e tyre si: «me hoka», «planc pule», «liman shoshe» (lloj luleje), «lule seferë», «putër mace», «gjurmë mushke». (Shih tab. I, II).

Endëset nëpër qytete më të parapëlqyer kishin motivet e quajtur «kame rose» «me nuska» (rombe), «me zog shqipe», «me gjethe rrapi» etj.

Për të ndarë blloqet e motiveve nga njëri-tjetri, përveç vijave të drejta është shpesh i pranishëm dhe një kordon dy-tre ngjyrash, që kalon vetëm një herë në drejtim horizontal. Në rrethinat e Shkodrës këtë e quanin «driaze», në ato të Krujës, Tiranës e Elbasanit «përdredhës». Kur kalonte midis fijesh të zakonshme, efekti i tij qëndronte vetëm në përzierjen e ngjyrave, ndërsa kur pëshkonte fijet më të holla, ai ishte i dyfishtë, sepse krijonte një farë azhuri me një pamje krejt të veçantë.

Pavarësisht nga emërtimi, motivet pothuajse janë të njëjta në të gjithë zonën e marrë në studim. Ndryshe ndodh me kompozimin e ngjyrave. Është vënë re se në pëlhurat e përdorura nga popullsia e ish besimit mysliman në përgjithësi ngjyrat janë më të përmbajtura. Ato janë një ose dy ngjyrëshe ose përdoren me nuanca të lehta e në masë më të pakta. Psh në një çarçaf, peshqir ose çfarëdo objekti tjetër goftë, rrallë herë mund të shohësh më shumë se dy ngjyra, edhe kur janë më shumë, ato vendosen në formë piklash ose vijash të holla.

Parapëlqeheshin më shumë ngjyra e bardhë (kjo në të shumtën e rasteve ishte mbizotëruese), rozë, lejla e lehtë, ngjyrë pjeprë, bojë qielli, e verdhë, e zbehtë etj. Në pëlhurat e përdorura nga popullsia e ish besimit katolik ka një gjallëri më të madhe motiveve e shpërthimesh më gazmore në ngjyra. Rregullisht në çarçafët «e mirë», perdet, jastëkët, mbulojat e djepit, përparjet, rizat etj., të mbajtura nga ish katolikët e Shkodrës, gjejmë të vendosura me shumë guxim pranë e pranë njëra-tjetrës ngjyrën e kuqe, të verdhë, portokalli, rozë, të bardhë, çiklamin, bojë qielli të mbyllur ose të hapur, të gjelbër etj.

Kjo është një prirje e përgjithshme e popullsisë së kësaj krahine, e cila manifestohet edhe në qëndisjet ose punimin e pjesëve të tjera për veshje.

Vlera të veçanta artistike përmbajnë ato lloje pëlhurash ku janë përdorur përzjerje materialesh të ndryshme, ose fije me trashësi dhe dredhje të ndryshme.

Përveç anëve praktike, kombinimi i fijeve të pambukta me ato të

mëndafshita, ose të pambukta me të lijtta, kanë dhënë efekte artistike mjaft interesante qoftë nëpërmjet nuancave të ngjyrave, qoftë dhe për plasticitetin e njërës ose tjetrës fije. Kësisoj përparjet e bardha, të quajtura *harkade* (që mbaheshin në rast zije nga gratë katolike të Shkodrës) sofrabezet e përditshëm, pëlhurat e këmishave të grave fshatare etj. shquhen për pamjen e veçantë të krijuar nga ndërthurja e vijave me fije liri dhe pambuku të vendosura herë për së gjati herë për së gjeri, duke krijuar katrore.

Efekte të këtilla krijohen edhe kur kombinohen fije të pambukta me të mëndafshat, ku njëra prej tyre (zakonisht fija e mëndafshit) përdoret për motive (vija ose figura të tjera). Të tilla janë pëlhurat e përdorura për *mangore* (këmisha të shkurtra), për të cilat është përdorur si truall fije e hollë pambuku ngjyrë krem, ndërsa për vija sipas rastit fije mëndafshi me ngjyra të ndryshme. Duke qenë më e trashë dhe më me shkëlqim, ajo krijon një relief të theksuar. Në raste të tjera fija e mëndafshit e vendosur për së gjati, alternohet me fije të pambuktë gjatë punimit e si rezultat krijohen kokriza të vogla të vendosura në linjë vertikale. Në një fletë të këtillë pëlhure që arrin deri në 40 cm, vendosen dy ose tri vija të tilla me gjërësi rreth 3-4 cm. Rregullisht këto vendosen në dy anë e fletës së pëlhurës kështu që roli i tyre nuk është vetëm zbukurues, por edhe përforcues, mbasi fijet e trasha prej mëndafshi që përdoren në këto raste janë të forta gati sa fijet e lirit.

Në pëlhurat ku janë përdorur fije me trashësi dhe dredhje të veçantë, ka të atilla që me të vërtetë janë ndër realizimet e përkryera të artit tonë popullor.

Edhe pse shpeshherë fijet e të njëjtit material janë me ngjyrë të njëjtë, vijat ose motivet e tjera të krijuara me fije më të trashë në sfond më të hollë, jo vetëm dalloheshin mirë, por i fisnikëronin më shumë pëlhurat e punuara me ta. Kështu ndodhte në pëlhurat e mëndafshita ku përdorshin pranë njëra-tjetrës fije të holla dhe fije më të trasha e më shkëlqim, ose në pëlhurat e pambukta ku vendoseshin pranë e pranë fije me dy tri masa trashësie.

Në raste të tjera ku ndryshonte jo vetëm trashësia e fijos por edhe masa e dredhjes së njërës fije nga tjetra (njëra shumë e dredhur tjetra pak) nëpër fletët e pëlhurës krijoreshin pufka të vogla, të cilave endëset u kanë vënë emrin «kamë thnegle». Figura e përdorur me këtë rast është më se e saktë, mbasi në të vërtetë pufkat krijojnë përshtypjen e gjurmëve të këmbëve të milingonave, kur ecin mbi dhé të shtypur. Shumë të shquara për elegancën e tyre janë dhe ato pëlhura të pambukta të punuara me një lloj fije me ngjyrë natyrale krem të hapur e shumë të dredhur. Kjo masë dredhjeje e të dy fijeve (majës dhe indit), mbas punimit në avlëmend, shkaktonte në sipërfaqen e pëlhurës një rudhosje uniforme, e cila mbas larjes theksohej edhe më shumë. Plasticiteti i fituar si dhe ngjyra natyrale e pambukut u jepnin një finesë të rrallë këmishave të qepura me këto pëlhura. Në harmoni të plotë me to ishin dhe dantellat e punuara me gjilpërë e me fije të së njëjtës ngjyrë, që u viheshin tek mëngët dhe gryka. Pëlhura të tilla për këmisha i kanë përdorur shumë edhe gratë e qyteteve Korçë, Berat, Vlorë etj., por gjithnjë të punuara nga endëset e qyteteve Shkodër, Krujë, Tiranë e Elbasan etj.

Përsa i përket mënyrës së organizimit të motiveve, nga rastet e verifikuara, mund të bëjmë këtë grupim: a) pëlhura me motive të vendosura në linjë horizontale qofshin ato vija të thjeshta lineare ose figura të tjera të vendosura njëra pas tjetrës. Shembuj të tillë i gjejmë në pëlhurat e punuara për mbulesa jastekësh, për jastekë, për peshqirë, për perde, për mbulesa koke etj. Në një variant pëlhure të punuar për peshqirë banjoje janë krijuar alternime vijash me ngjyrë të bardhë, vishnje dhe përzierje fijesh me ngjyrë të bardhë e karrotë. Midis tyre kapërcen një kordon 10-12 fijesh me ngjyrë kafe. Ky kompozim përsëritet në të gjithë sipërfaqen.

Në mbulesat e jastekëve përdoren alternime vijash me të trasha e më të holla në të cilat janë kombinuar herë ngjyra portokalli me të bardhë e herë e verdha me të bardhë.

Në pëlhurat e përdorura për perde dhe jastekë (Shkodër) si dhe në mbulesat e kokës (Zadrimë e Fushë-Krujë) përveç vijave me trashësi të ndryshme janë përdorur dhe figura të tjera gjeometrike të stilizuara, të vendosura dhe këto në linjë horizontale.

Te këto pëlhura vlen të theksohet para së gjithash teknika e punimit «me kapërcime» (që të krijon përshtypjen se motivet janë qëndisur me të mbushur) si dhe vendosja shumë e guximshme e ngjyrave. Mbi sfondin e kuq ose të verdhë vendosen pranë njëra tjetrës në një mënyrë origjinale ngjyra e verdhë portokalli, e bardhë e më pak ajo blu. Jo rrallë midis tyre mund të gjesh edhe ngjyrën bezhë.

Ndër mbulesat e kokës qofshin prej mëndafshi ose prej pambuku, shquhen ato të punuara nga gratë e Zadrimës, në të cilat shprehen më shumë se kudo aftësitë krijuese të këtyre endëseve. Njëherësh në to mund të admirosh realizimin teknik të përkryer si dhe kompozimin e motiveve dhe të ngjyrave. Motivët përgjithësisht janë të përqëndruara vetëm në dy skajet gjë që është e lidhur me mënyrën e lidhjes së tyre në kokë. Sipërfaqja është kurdoherë një ngjyrsh e bardhë ose e verdhë (ashtu si ngjyra natyrale e mëndafshit). Edhe pse motivet janë shumë të ngjeshura, zgjidhja kompozicionale e tyre është e atillë, që njeri bllok motivesh nuk e shqetëson aspak bllokun tjetër që ka pranë. Tonet shpërthyes të ngjyrave u japin atyre një gjallëri të veçantë.

Në këtë grup bëjnë përjashtim mbulojet e kokës prej pambuku të grave të ish besimit katolik të fshatrave të Fushë-Krujës. Te këto përveç motiveve të vendosura në dy skajet ka edhe të tjera të shpërndara në të gjithë sfondin veçse për këto nuk përdoren fije me ngjyra, por në trashësi të ndryshme. Por duhet thënë se shpërndarja e tyre është bërë me një rregull të caktuar, sipas të cilit motivet edhe pse të shkëputura, qëndrojnë në një vijë me njeri tjetrin. Kjo zgjidhje kompozicionale edhe këtu është bërë në përshtatje me mënyrën e vendosjes së saj në kokë. Lëshimi lirshëm mbi supe, e bënte atë krejtësisht të dukshme.

b) pëlhura me motive të vendosura në linjë vertikale. Motivët mund të jenë vija me trashësi të ndryshme të kompozuara që në lëshimin e fijeve të majës së pëlhurës, ose motive të shkëputura të vendosura në varg për së gjati. Me vija të tilla punoheshin zakonisht pëlhurat e pambukta e të mëndafshita të përdorura për këmisha grash, të quajtura pëlhura «me ujsa». Përmendim këtu pëlhurat e përdorura nga gratë e fshatrave ish katolikë të Fushë Krujës. Për të bërë «ujsat» janë përdorur vazhdi-

misht dy ngjyra, e bardha dhe bezha. Në pëlhurat e këmishave që kanë mbajtur gratë e Zadrimes «ujsat» bëheshin me fije me trashësi të ndryshme ose me dredhje të ndryshme. Nuk ishin të rrallë rastet që për krijimin e tyre të përdorreshin dy lëndë të ndryshme, li dhe pambuk.

Te pëlhurat e mëndafshita veç alternimeve të vijave më të gjëra dhe atyre më të ngushta, ka dhe diçka tjetër që të tërheq. Kontrasti i krijuar midis vijave të punuara me fije të hollë dhe atyre me fije më të trashë e me shkëlqim si dhe realizimi i përkryer teknik, krijojnë efekte mjaft emocionuese.

Në pëlhurat e tjera prej mëndafshi të përdorura për çarçafë zbukurimi, sipërfaqia paraqitet e mbushur me motive që përsëriten në linjë vertikale. Këto mund të jenë trekëndësha, rombe, lule me tre ose pesë gjethe, «zogu i shqipes» etj. Është për t'u vënë në dukje se në to edhe pse ka motive të tilla, nuk përdoren shumë ngjyra. Edhe kur përdoren, ato janë shumë të kursyera dhe vendosen në formë pikash ose konturesh. Ashtu si vijat, edhe figurat e tjera dallohen nga sfondi me të njëjtën ngjyrë nga përdorimi i fijes më të trashë dhe me shumë shkëlqim. Nuk janë të rralla rastet ku në vend të tyre përdorej fija e telit të butë me ngjyrë të verdhë ose të bardhë.

c) Pëlhura të zbukuruar me katrorë. Shembuj të tillë janë pëlhurat e pambukta për çarçafë, përparje e mbulesa djepi, të punuara nga gratë e ish-besimit katolik të qytetit të Shkodrës në të cilat janë përdorur tre ose më shumë ngjyra. Në ato me tre ngjyra (zakonisht e bardhë, bezhë dhe e kuqe) mënyra e vendosjes së tyre në majën e pëlhurës si dhe kombinimi i tyre me fijet e indit, krijojnë katrorë me madhësi të ndryshme, ku herë mbizotëronte ngjyra e bardhë, herë ajo bezhë ose e kuqe. Në një mënyrë origjinale, ngjyrat e katrorëve vijnë duke u zbehur nga ekstremet në qendër të çarçafit, ndërsa «midisi» mbetet krejt i bardhë. Po kështu vijnë duke u zvogëluar edhe katrorët.

Çarçafët e quajtur «topalij» ose «të kuq», janë ndër punimet më të bukura të endseve shkodrane. Vlerat e tyre janë të lidhura para së gjithash me mënyrën e kompozimit të shtatë lloj ngjyrave e pastaj edhe me dantellat shumëngjyrëshe e të punuara me gjilpërë, që u vihen në anë dhe në vendet ku bashkohen fletët.

Me katrorë zbukuroheshin edhe disa çarçafë mëndafshi ose shallët që lidhnin gratë në kokë kur dilnin për vizita. Rregullisht, si tek çarçafët dhe tek shallët, meqenëse katrorët krijoheshin me fije të së njëjtës ngjyrë, por me trashësi të ndryshme, në skaje vendosnin një bllok motivesh të tjera me ngjyra.

d) pëlhura të zbukuruar tërësisht ose pjesërisht me përdorim teknikash të ndryshme («me kamë thnegle» ose «me rica»).

Me teknikën «me kamë thnegle» zbukuroheshin çarçafët e bardhë prej pambuku. Kjo teknikë herë zbatohet në tërë sipërfaqen, herë pjesërisht, duke krijuar disa rreshta. Me teknikën me rica zakonisht punoheshin peshqirët e syve, ndërsa për zbukurim kjo teknikë zbatohet në skajet e bohçeve të ndryshme ose në mbulesat e tavolinave, duke krijuar në to vija ose katrorë të vendosura në grupe ose në linjë horizontale. Ndër këto pëlhura vlera të veçanta përmbajnë ato ku vijat ose katrorët janë punuar me fije mëndafshi të ngjyrosura.

*
*
*

Ndonëse përgjithësisht në këto punime zbatohen teknika të njëjta, përdoret i njëjti material, objektet e punuara kryejnë të njëjtin funksion, secila zonë paraqitet me veçoritë e veta, gjë që ndjehet më shumë në punimet e grave fshatare. Menjëherë dallohen rizat dhe objektet e tjera të punuara në Zadrimë nga ato të fshatrave të Fushë-Krujës dhe ato të Tiranës. Kjo gjë duket si në mënyrën e kompozimit, në pëlqimin e ngjyrave të caktuara, ashtu dhe të motiveve të veçanta.

Kështu në pëlhurat e punuara nga endëset e Elbasanit e të Tiranës, krahas motiveve të tjera, motivi i quajtur «gërshanëz» është i pamungueshëm, në ato të Krujës e fshatrave të Fushës, është rombi i shprehur në lloj-lloj formash, kurse në Zadrimë pëlqehet më shumë ylli me gjashtë ose tetë cepa.

E njëjta gjë ndodh në përdorimin e ngjyrave. Në gjithë fushën e Zadrimës në këto punime gjen shtatë apo më shumë ngjyra, në ato të fushës së Krujës në përgjithësi mbizotëron ngjyra e kuqe në vishnje, ngjyra e bardhë dhe në masë më të kursyer ngjyra blu, e gjelbër. Ndryshe ndodh me pëlhurat e punuara nga endëset e qyteteve, të cilat pothuajse nuk dallojnë nga njëra-tjetra me përjashtim të atyre të punuara nga gratë e ishbesimit katolik të qytetit të Shkodrës. Kjo spjegohet me kushtet e njëjta ekonomike shoqërore në të cilat u zhvilluan për vite me radhë këto qytete, si dhe me shkëmbimet dhe marrëdhëniet e vazhdueshme midis tyre. Kurse pamja e njëjtë e disa pëlhurave, si psh., ajo e llojeve të ndryshme të peshqirëve që përdoreshin në shërbesat fetare të popullsisë myslimane ose pëlhurat transparente prej mëndafshi me të cilat bëheshin këmishat ceremoniale, ishte thjesht një ndikim i kulturës orientale në mënyrën e jetesës të këtyre qyteteve.

*
*
*

Shumë zeje tradicionale e humbën rëndësinë përballë kushteve shoqërore më të përparuara të socializmit. Disa prej tyre gradualisht filluan të ndryshojnë ose të modifikohen krahas zhvillimit të jetës së re socialiste. Kështu ndodhi edhe me traditën e punimit të pëlhurave të mëndafshita e të pambukta. Në vitin 1947 mbi bazën e kësaj tradite të pasur popullore në qytetin e Shkodrës, pranë fabrikës së tisazhit, u hap një repart i posaçëm për punimin në mënyrë të industrializuar të pëlhurave me mëndafsh natyral. Më vonë, në vitin 1952, u ngrit edhe kombinati i tekstileve «Stalin» për punimin e pëlhurave të pambukta, i cili nga viti në vit shtonte jo vetëm sasinë e metrave lineare por edhe llojet e prodhimeve.

Për të furnizuar repartin e pëlhurave të mëndafshita në fillim krimbi i mëndafshit rritej nëpër familje sipas mënyrave tradicionale ndërsa fija përgatitej në një formë më të industrializuar. Me kalimin e kohës edhe kjo fazë punimi u organizua në forma më të përparuara, rritja e krimbit të mëndafshit filloi të bëhet në stacione të përqëndruara, nën

misht dy ngjyra, e bardha dhe bezha. Në pëlhurat e këmishave që kanë mbajtur gratë e Zadrimes «ujsat» bëheshin me fije me trashësi të ndryshme ose me dredhje të ndryshme. Nuk ishin të rrallë rastet që për krijimin e tyre të përdreshin dy lëndë të ndryshme, li dhe pambuk.

Te pëlhurat e mëndafshta veç alternimeve të vijave më të gjëra dhe atyre më të ngushta, ka dhe diçka tjetër që të tërheq. Kontrasti i krijuar midis vijave të punuara me fije të hollë dhe atyre me fije më të trashë e me shkëlqim si dhe realizimi i përkryer teknik, krijon efekte mjaft emocionuese.

Në pëlhurat e tjera prej mëndafshi të përdorura për çarçafë zbukurimi, sipërfaqia paraqitet e mbushur me motive që përsëriten në linjë vertikale. Këto mund të jenë trekëndësha, rombe, lule me tre ose pesë gjethe, «zogu i shqipës» etj. Është për t'u vënë në dukje se në to edhe pse ka motive të tilla, nuk përdoren shumë ngjyra. Edhe kur përdoren, ato janë shumë të kursyera dhe vendosen në formë pikash ose konturesh. Ashtu si vijat, edhe figurat e tjera dallohen nga sfondi me të njëjtën ngjyrë nga përdorimi i fijes më të trashë dhe me shumë shkëlqim. Nuk janë të rralla rastet ku në vend të tyre përdorej fija e telit të butë me ngjyrë të verdhë ose të bardhë.

c) Pëlhura të zbukuruara me katrorë. Shembuj të tillë janë pëlhurat e pambukta për çarçafë, përparje e mbulesa djepi, të punuara nga gratë e ish-besimit katolik të qytetit të Shkodrës në të cilat janë përdorur tre ose më shumë ngjyra. Në ato me tre ngjyra (zakonisht e bardhë, bezhë dhe e kuqe) mënyra e vendosjes së tyre në majën e pëlhurës si dhe kombinimi i tyre me fijet e indit, krijojnë katrorë me madhësi të ndryshme, ku herë mbizotëronte ngjyra e bardhë, herë ajo bezhë ose e kuqe. Në një mënyrë origjinale, ngjyrat e katrorëve vijnë duke u zbehur nga ekstremet në qendër të çarçafit, ndërsa «midisi» mbetet krejt i bardhë. Po kështu vijnë duke u zvogëluar edhe katrorët.

Çarçafët e quajtur «topalij» ose «të kuq», janë ndër punimet më të bukura të endseve shkodrane. Vlerat e tyre janë të lidhura para së gjithash me mënyrën e kompozimit të shtatë lloj ngjyrave e pastaj edhe me dantellat shumëngjyrëshe e të punuara me gjilpërë, që u vihen në anë dhe në vendet ku bashkohen fletët.

Me katrorë zbukuroheshin edhe disa çarçafë mëndafshi ose shallët që lidhnin gratë në kokë kur dilnin për vizita. Rregullisht, si tek çarçafët dhe tek shallët, meqenëse katrorët krijoheshin me fije të së njëjtës ngjyre, por me trashësi të ndryshme, në skaje vendosnin një bllok moti- vesh të tjera me ngjyra.

d) pëlhura të zbukuruara tërësisht ose pjesërisht me përdorim teknikash të ndryshme («me kamë thnegle» ose «me rica»).

Me teknikën «me kamë thnegle» zbukuroheshin çarçafët e bardhë prej pambuku. Kjo teknikë herë zbatohet në tërë sipërfaqen, herë pjesërisht, duke krijuar disa rrjeshta. Me teknikën me rica zakonisht punoheshin peshqirët e syve, ndërsa për zbukurim kjo teknikë zbatohet në skajet e bohçeve të ndryshme ose në mbulesat e tavolinave, duke krijuar në to vija ose katrorë të vendosura në grupe ose në linjë horizontale. Ndër këto pëlhura vlera të veçanta përmbajnë ato ku vijat ose katrorët janë punuar me fije mëndafshi të ngjyrosura.

*
*
*

Ndonëse përgjithësisht në këto punime zbatohen teknika të njëjta, përdoret i njëjti material, objektet e punuara kryejnë të njëjtin funksion, secila zonë paraqitet me veçoritë e veta, gjë që ndjehet më shumë në punimet e grave fshatare. Menjëherë dallohen rizat dhe objektet e tjera të punuara në Zadrimë nga ato të fshatrave të Fushë-Krujës dhe ato të Tiranës. Kjo gjë duket si në mënyrën e kompozimit, në pëlqimin e ngjyrave të caktuara, ashtu dhe të motiveve të veçanta.

Kështu në pëlhurat e punuara nga endëset e Elbasanit e të Tiranës, krahas motiveve të tjera, motivi i quajtur «gërshanëz» është i pamungueshëm, në ato të Krujës e fshatrave të Fushës, është rombi i shprehur në lloj-lloj formash, kurse në Zadrimë pëlqehet më shumë ylli me gjashtë ose tetë cepa.

E njëjta gjë ndodh në përdorimin e ngjyrave. Në gjithë fushën e Zadrimës në këto punime gjen shtatë apo më shumë ngjyra, në ato të fushës së Krujës në përgjithësi mbizotëron ngjyra e kuqe në vishnje, ngjyra e bardhë dhe në masë më të kursyer ngjyra blu, e gjelbër. Ndryshe ndodh me pëlhurat e punuara nga endëset e qyteteve, të cilat pothuajse nuk dallojnë nga njëra-tjetra me përjashtim të atyre të punuara nga gratë e ishbesimit katolik të qytetit të Shkodrës. Kjo spjegohet me kushtet e njëjta ekonomike shoqërore në të cilat u zhvilluan për vite me radhë këto qytete, si dhe me shkëmbimet dhe marrëdhëniet e vazhdueshme midis tyre. Kurse pamja e njëjtë e disa pëlhurave, si psh., ajo e llojeve të ndryshme të peshqirëve që përdorshin në shërbesat fetare të popullsisë myslimane ose pëlhurat transparente prej mëndafshi me të cilat bëheshin këmishat ceremoniale, ishte thjesht një ndikim i kulturës orientale në mënyrën e jetesës të këtyre qyteteve.

*
*
*

Shumë zeje tradicionale e humbën rëndësinë përballë kushteve shoqërore më të përparuara të socializmit. Disa prej tyre gradualisht filluan të ndryshojnë ose të modifikohen krahas zhvillimit të jetës së re socialiste. Kështu ndodhi edhe me traditën e punimit të pëlhurave të mëndafshta e të pambukta. Në vitin 1947 mbi bazën e kësaj tradite të pasur popullore në qytetin e Shkodrës, pranë fabrikës së tisazhit, u hap një repart i posaçëm për punimin në mënyrë të industrializuar të pëlhurave me mëndafsh natyral. Më vonë, në vitin 1952, u ngrit edhe kombinati i tekstileve «Stalin» për punimin e pëlhurave të pambukta, i cili nga viti në vit shtonte jo vetëm sasinë e metrave lineare por edhe llojet e prodhimeve.

Për të furnizuar repartin e pëlhurave të mëndafshta në fillim krimbi i mëndafshit rritej nëpër familje sipas mënyrave tradicionale ndërsa fija përgatitej në një formë më të industrializuar. Me kalimin e kohës edhe kjo fazë punimi u organizua në forma më të përparuara, rritja e krimbit të mëndafshit filloi të bëhet në stacione të përqëndruara, nën

drejtimin e specialistëve të përgatitur për këtë mjeshtëri. Stacione të tilla sot ka në rrethet Shkodër, Mat, Mirditë, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Librazhd, Pogradec, Gjirokastër dhe në disa ndërmarrje pyjore.

Duke pasur parasysh edhe përvojën popullore në to kanë filluar të zbatohen dhe disa metoda të reja shkencore lidhur me kushtet e ngrohjes dhe strukturën e ushqimit. Përveç ushqimit me gjethe mani, këto tre vjetët e fundit kanë filluar të përdorin edhe gjethet e njoma të dushkut. Është duke u eksperimentuar dhe rritja me gjethe recini, të cilat mund të sigurojnë shtatë rritje në vit nga një që bëhet me gjethe mani.

Me industrializimin e mëtejshëm të të gjitha fabrikave të tisazhit në vendin tonë, në vitin 1981 reparti i pëlhurave të mëndafshta është pajisur me makineri shumë më moderne, të cilat kanë rritur më tej cilësinë e këtyre pëlhurave. Gjithashtu në Shkodër tani ka dhe një repart të posaçëm edhe për punimin e pëlhurave të pambukta, ndërsa në qytetin e Beratit ekziston një kombinat i madh për punimin e të gjitha llojeve të pëlhurave të pambukta.

THE SILK COTTON CLOTH OF CENTRAL AND NORTHWESTERN ALBANIA

The many archival sources on the mediaeval period show that sericulture was widespread in our country. Sericulture and silk weaving continued to develop after the Turkish occupation, reaching its climax in the 18th-19th centuries. By the end of the 17th century and in the beginning of the 18th century this tradition was enriched with the processing of cotton cloth made of ready-made cotton threads that came from European markets. This craft was especially developed in many towns and villages situated in the plains of Central Albania (Tirana, Elbasan, Kavaja, Durrës), Kruja, the Plain of Zadrima, in the towns of Shkodra, Peja and Prizren (outside the present state borders of the PSRA).

In the beginning of the 19th century, the constant demands for such products explains why many households in these centres turned into small producers of silk and cotton cloth for the market. Some families had 2-3 looms that worked simultaneously, indeed, some of them secured their living from this trade.



By the end of the 19th century, new forms of the organization of work were introduced in this craft. Many women in the towns of Shkodra and Prizren were employed by and worked for employers. According to oral testimonies, until the 20-30' ies of this century there were 12 such employers, some of whom took in up to 25-30 weavers.

The end of the last century and the beginning of this century brought about changes in the development of this craft. The cloths of European manufacture were replacing the traditional local cloths.







In the time of the flourishing of this craft, the elements of (cotton and silk) dresses, as well as the various cloths for home use, occupied the main place among the traditional cloths.

Apart from their practical values, these objects are distinguished also for their artistic values, such as the selection and combination of colours and motifs, as well as their manner of processing, their many technical variants and the combination of threads of various thickness, and their composition. All of them together have created a variety of rich ornamenting forms. In many cases their technical skill reached enviable levels.

Tab. I



Tab. II



1840

The first of these was the discovery of gold in California in 1848, which led to a massive influx of people to the West.

The second was the discovery of gold in Nevada in 1859, which led to a massive influx of people to the West.

The third was the discovery of gold in Colorado in 1858, which led to a massive influx of people to the West.

The fourth was the discovery of gold in California in 1848, which led to a massive influx of people to the West.

The fifth was the discovery of gold in Nevada in 1859, which led to a massive influx of people to the West.

The sixth was the discovery of gold in Colorado in 1858, which led to a massive influx of people to the West.

The seventh was the discovery of gold in California in 1848, which led to a massive influx of people to the West.

The eighth was the discovery of gold in Nevada in 1859, which led to a massive influx of people to the West.

Ikbal BIHIKU

QËNDISJET NË VESHJET POPULLORE TË QYTETIT

Gjurmë të hershme të qëndisjeve popullore hetojmë që në Mesjetë, por lulëzim të madh kjo degë e zejtarisë njohu gjatë shekujve XVII-XVIII. Kjo është koha kur në disa nga qytetet shqiptare ndodhi një zhvillim i shënuar ekonomik e shoqëror. Sipas studiuesve tanë, në këto qytete u zhvilluan një varg zejesh, prodhimet e të cilave tregtoheshin në vise të ndryshme të Ballkanit, madje edhe në Evropë. «Për herë të parë në vendin tonë më 1680 ne hasim në qytetin e Elbasanit esnafët e tabakëve (lëkurëpunues), të terzinjve (rrobaqepës), të çullahëve (leshpunues) etj. Por nuk ka dyshim se në këtë kohë, ndoshta dhe më parë, këto të kenë ekzistuar edhe në qendra të tjera të vendit tonë.

... Në peshën e prodhimit zejtar shekulli XVII shënoi fillimin e një periudhe të re zhvillimi, e cila do të arrijë kulmin një shekull më vonë (në shekullin XVIII)».¹

Në zejet e shumta që arritën në këtë periudhë një shkallë të lartë zhvillimi bëjnë pjesë edhe qëndisjet, të cilat ushtroheshin si zeje më vete nga mjeshtër të specializuar. Në disa nga qytetet shqiptare me rëndësi qëndisjet morën hov të madh. Në qendrat e këtyre qyteteve dhe pranë manastireve kishte mjeshtër qëndistarë të njohur për punimet e tyre me vlera të mëdha artistike. Ndër to mund të përmendim epitafin e Gllavenicës në rrethin e Beratit (1375), një nga veprat e shquara artistike të epokës së Mesjetës në këtë fushë. «Në këtë kohë jo vetëm kishat dhe manastiret, por edhe jeta oborrtare e fisnikërisë së lartë, kërkonin përqark tyre ato pajisje të kushtueshme që u jepnin shkëlqim e madhësi sugjestionuese ambienteve të tyre. Edhe vetë veshja e klerit dhe e fisnikëve të kohës, e rënduar me qëndisje mëndafshi, fije ari e gurë të çmuar integrohej plotësisht në këtë ambient».² Kjo traditë punimi vijoi edhe në she-

1) Z. Shkodra, «Esnafët shqiptarë», Tiranë, 1973, 38, 58.

2) A. Gjergji, *Arti fshatar dhe zejtaritë artistike në Shqipëri*, «Nëntori», 8, 1975, f. 177-178.

kujt e mëvonshëm, por duke iu përshtatur kërkesave të reja të kohës. Në kohët më të reja, përveç zbukurimeve me karakter fetar, në qëndisje filluan të hyjnë edhe elemente të marra nga jeta e përditshme. Kjo prirje vjen duke u theksuar gjithnjë e më tepër në qëndisjet e shekullit XVIII-XIX të punuara nga mjeshtër qëndistarë shqiptarë të cilët, sipas dokumenteve historike, i gjejmë të vendosur në Prizren, Shkup, Shkodër, Elbasan, Tiranë e Berat.

Mjeshtërit qëndistarë bënin punë me porosi për persona të veçantë nga shtresat e larta dhe të mesme të shoqërisë qytetare. Në këto punime vëmë re dallime në mënyrën e zbukurimeve dhe në materialin e përdorur për përgatitjen e tyre që përcaktoheshin nga kërkesat e porositësve. Kështu, p.sh., përfaqësuesit e shtresave të larta për veshjet e tyre zgjidhnin coha nga më të shtrenjtat dhe parapëlqenin për to motive të gjithfarshme. Mjeshtërit qëndistarë zbukuronin veshjet për burra e gra, si jelek, xhamadan, mëngore, xhybe, fustan, breza, silah, toslluk, pirqiri etj. Përveç kësaj ata merreshin gjithashtu me zbukurimin e disa pajisjeve shtëpiake, si mbulesa tavolinash, banda muri, boçe për paketim plaçkash, faqe jorgani, koka jastëku etj., objekte që porositeshin nga shtresat e larta të shoqërisë qytetare. Zeja e qëndisjeve në Shqipëri është ushtruar edhe nga gratë të cilat, përveç punëve të tjera shtëpiake, prodhonin sende për nevojat e familjes dhe një pjesë të tyre për t'i shitur në treg. «Artizanati shtëpiak është i njohur në tërë trevën e Ballkanit, por edhe në Shqipëri. Artizanati i grave ka shërbyer edhe si ndërlidhës për të plotësuar kërkesat e mjeshtërve të tjera, si p.sh. përgatitjen e fijos për qëndisje, përgatitja e pëlhurës në vegje etj.»³. Përveç mjeshtërve profesionistë dhe grave shtëpiake që bënin punë me porosi, me qëndisje u morën dhe vajzat e reja të shtresave të mesme dhe të ulta të qytetit. Ato përgatishnin për vete një sasi objektesh të qëndisura që do t'u nevojiteshin për familjen e re që do të krijonin.

Në këtë mënyrë qëndisja, që lindi dhe u zhvillua në gjirin e artizanatit shtëpiak dhe atij profesionist, vijoi të jetojë për shekuj me radhë duke plotësuar kërkesat e popullsisë qytetare.

Në shekullin XIX, me përfshirjen e vendit në sferën e marrëdhënieve kapitaliste, sidomos me depërtimin gjithnjë e më të madh të artikulave industrialë të sjellë nga jashtë, artizanati pëson një krizë të thellë. «Në kushtet e një politike kapitulluese të ndjekur nga sundimtarët turq, vendi ynë sikurse shumë vise të Ballkanit po hynte gjithnjë e më shumë nën ndikimin e kapitalit të huaj evropian. Po ky fenomen u theksua edhe më tepër në kohën e reformave të Tanzimatit 1839, çka solli në përgjithësi rënien e zejeve të reja. Në fushën e zejtarisë e cila përbënte bazën prodhuese të ekonomisë qytetare mjaft zeje u zhdukën e të tjera po zhdukeshin me shpejtësi. Një pjesë e tyre u zhdukën qysh në shek. XVIII dhe një pjesë në shekullin XIX dhe në çerekun e parë të shekullit të XX humbasin rëndësinë e tyre të dikurshme»⁴. Pra, së bashku me krizën

3) Drita Statovci, «Zhvillimi historik i zejtarisë dhe vendosja e saj bashkëkohore për strukturën ekonomiko-shoqërore të KSA të Kosovës». Prishtinë, 1982, f. 160.

4) Z. Shkodra, «Esnafët shqiptarë», f. 223-328.

e thellë që pësoi artizanati, edhe qëndisja pati një rënie të vazhdueshme, që zgjati nga Shpallja e Pavarësisë deri në prag të Çlirimit të vendit.

Pas vendosjes së pushtetit popullor, në vendin tonë, në kuadrin e zhvillimit e të forcimit të kulturës kombëtare, një rëndësi e posaçme iu dha ruajtjes, zhvillimit dhe përhapjes së traditave vendase në fushën e arteve të zbatuara, duke përfshirë edhe qëndisjet si një ndër degët e rëndësishme të artit popullor.

*
* * *

Në punimin tonë do të mundohemi t'u bëjmë një analizë të shkurtër qëndisjeve të zbatuara në veshjet e popullsisë të qytetit, të cilat përbëjnë një fond të pasur me vlera të mëdha të krijimtarisë artistike popullore. Qëndisjet në veshjet qytetare kanë tiparet e tyre karakteristike që i dallojnë nga qëndisjet e zbatuara në veshjet popullore të fshatit. Ky ndryshim duket në format e stilizimit të motiveve, në mënyrën e kompozimit, në kombinimin e ngjyrave, në materialin me të cilin janë punuar dhe në zbatimin e tyre. Por me gjithë këto dallime, qëndisjet e fshatit dhe ato të qytetit kanë disa tipare të përbashkëta, çka flet për një njësi kulturore dhe për një ndikim reciprok ndërmjet fshatit dhe qytetit.

Për qëndisjet qytetare bëhej një punë më e organizuar nga mjeshtrit profesionistë dhe nga gratë shtëpiake. Kështu p.sh. në dyqanin e rrobaqepësit (terziut), përveç mjeshtrëve që përgatitnin fijen, gajtanet, bukmet etj., dhe qëndistarëve, punonin edhe shkruesit, të cilët merreshin me përgatitjen e modeleve zbukuroese. Më të shumtën e rasteve shkruesit jo vetëm përgatitnin modelet por edhe i qëndisnin vetë ato në objekt. Për përgatitjen e modeleve dhe përhapjen e tyre shkruesit dhe qëndistarët kanë përdorur shabllonet. Nëse gratë fshatare modelet zbukuroese i zbatonin duke numëruar fijen e pëlhurës ose duke kombinuar ngjyrat, shkruesit dhe qëndistarët shtëpiake modelet i shkruanin në objekt me anë të letrës kopjative ose me anë të tegelit (teknikë pune). Metoda e kopjimit të modeleve me anë të shablloneve lehtësonte shumë punën dhe krijonte mundësi që modelit t'i jepej forma e dëshiruar. Për këtë arsye këto qëndisje janë realizuar në forma më të rregullta.

Me sa duket modelet e përgatitura kalonin dora-dorës nga një mjeshtrë te tjetri ose nga një qëndistar te tjetri. Formë tjetër e përhapjes së modelit ka qënë dhe ekspozimi i pajës, i cili bëhej zakonisht ndër familjet e pasura qytetare.

Për arsye të ditura historiko-shoqërore qëndisjet shqiptare nuk kanë mundur t'u shpëtojnë ndikimeve nga qëndisjet e popujve fqinjë të Ballkanit, të cilat gjithashtu kanë huazuar mjaf elemente nga arti popullor shqiptar. Në mënyrën e zbukurimit të veshjeve dhe në materialin që përdorej për përgatitjen e tyre vihen re ndikime artistike të jashtme, gjë që deri-diku shpjegohet me faktin se mjeshtrit profesionistë shqiptarë përgatiteshin pranë mjeshtrëve vendas dhe një pjesë e tyre përgatiteshin nga mjeshtrit qëndistar të Stambollit, të Selanikut a të Janinës dhe, kur ktheheshin në atdhe sillnin me vete një pjesë të shijes dhe mënyrën e zbukurimit të veshjeve të vendit ku ishin përgatitur. Pavarësisht nga kjo, zbu-

kurimet e zbatuara në veshjet qytetare të punuara nga mjeshtrit shqip-tarë ruajnë fizionominë e tyre, çka i bën të dallohen fare mirë nga ato të popujve fqinjë të Ballkanit. Ato janë një pasqyrë e gjallë e aftësisë krijuese të mjeshtrëve tanë profesionistë dhe qëndistareve të talentuara shtëpiake të cilat kanë ditur t'u përgjigjen fare mirë shijes dhe kërkesave të kohës dhe shoqërisë ku ata kanë jetuar.

Hijeshinë e zbukurimeve, madhështinë dhe elegancën e veshjeve popullore i kanë vënë në dukje këngëtarët dhe vjershëtarët popullorë në krijimet e tyre, ku futet sidomos jeleku i grave dhe xhamadani i burrave.

Jelekun rrush e bajame
peshqesh lala ty ta ka pru
mora vesh se të erdh tamam
sa je rrit je zbukuru⁵.

Veshjet tona popullore qytetare për origjinalitetin e tyre kanë tërhequr gjithashtu vëmendjen e shumë vizitorëve ose studiuesve të huaj, të cilët, duke kaluar nëpër Shqipëri, na kanë lënë një numër të madh vizatimesh, gravurash ose akuarele (Shtakelberg, Hoket, Lik etj.).

Objektet e këtyre veshjeve tërheqin vëmendjen jo vetëm me zbukurimet, por edhe me prerjen dhe qepjen në të cilat duket dora e mjeshtrëve të talentuar. Jelekët, sakot dhe kondoxhupet e kostumit të grave gjirokastrite, jelekët, sakot dhe fustanet e grave të Beratit, të Përmetit, të Leskovikut, etj., xhamadanët dhe mëngoret e burrave të Vlorës, të Beratit dhe të Korçës, xhybet e kostumit të grave të qyteteve të Elbasanit, të Tiranës dhe të Krujës, xhamadanët e burrave, jelekët dhe xhybet e grave të Prizrenit, të Pejës dhe të Gjakovës, xhybet dhe japanxhet e kostumit të grave shkodrane etj., të gjitha këto objekte shquhen për një bukuri të rrallë artistike si përsa u përket motiveve zbukuruese, ashtu edhe prerjes dhe qepjes së tyre.

Për veshjet qytetare një pjesë e materialit, si pëlhura e mëndafshit dhe ajo e pambukut, përgatitej nga gratë shtëpiake në vegje. Këto pëlhura përdoreshin për veshje të brendshme si këmishë, fusta, të linta etj. Për veshje të sipërme (xhybe, sako, xhamadan, jelek, çitjane, fustan etj.) përdoreshin atllazi, kadifeja, coha, pëlhurë shámi, mermeri, basmaja etj., që silleshin nga jashtë. Për qëndisjet e zbatuara në veshjet qytetare përdorej fija e mëndafshit, fija e pambukut, fija e arit e llojeve të ndryshme, si tel ari, tirtiri, gjyrmushi etj. Në këto qëndisje janë përdorur gjithashtu gajtanet, shiritat, tehëria, dhe bukmja, të cilat mund të ishin të përgatitura me fije mëndafshi, pambuku, ari, ose argjendi. Përveç materialeve të përmendura më sipër në qëndisjet qytetare janë përdorur në masë të gjerë rruazat e llojeve të ndryshme. Më të parapëlqyera nga qëndishtarët kanë qenë ato që u ngjasonin perlave natyrore e që quheshin *inchi*. Për të krijuar relief më të theksuar ose për t'ia arritur më tepër formës natyrore të gjetheve të një peme ose petaleve të luleve a formës së ndonjë sendi tjetër, qëndistaret shtëpiake dhe mjeshtrit profesionistë kanë

5) Këngë popullore lirike. Elbasan.

përdorur kartonin dhe pambukun, që priteshin dhe qepeshin sipas formës së motivit dhe vendoseshin në vendin e caktuar; sipër tyre bëhej pastaj qëndisja, e cila mund të kryhej me fije mëndafshi, ari, argjendi ose me rruaza.

Sikurse në qëndisjet e fshatit dhe të qytetit motivet zbukurose mbajnë emrin e sendeve që kanë shërbyer si model. Porositësit e veshjeve parapëlqenin lulet e llojeve të ndryshme. Krahas luleve në masë të gjerë, si motive zbukurose, janë përdorur edhe shpendë si pëllumbi, palloi, shqiponja etj. Në qëndisjet qytetare nuk mungojnë motive të tjera, si hëna, dielli, ylli, gjarpri, dragoi etj, të cilat kishin kuptim simbolik. Motivët janë stilizuar në mënyrë të tillë që kanë forma të përafërta me sendet e marra nga natyra dhe figura shquhet për një linjë tepër elegante e të zhdërvjellët. Motivët ndërthuren në mënyrë të tillë që lejojnë të duket fare qartë motivi kryesor me të cilin lidhen motive të tjera, më të vogla, duke formuar një kompozim të caktuar. Kompozimet ndryshojnë nga njeri objekt në tjetrin, por në çdo objekt të veçantë ato krijojnë një tërësi harmonike.

Motivët e para zbukurose të zbatuara në veshjet qytetare kanë qenë rreshtat, bedenat e madhësive të ndryshme, dredhëzat etj., të cilat vendoseshin gjatë buzëve të objekteve, si dhe lastaret e stilizuara me forma të ndryshme, që vendoseshin në formë gjarpëruese në pjesët anësore të tij. Si rezultat i zhvillimit të madh që mori kjo mjeshtëri dhe i rritjes së kërkesave nga ana e tregut, qëndisjet u pasuruan me motive të shumta dhe me kompozime nga më të larmishmet. Motivët nuk vendoseshin vetëm në pjesët anësore të objekteve, por, të kompozuara në mënyrë mjaft të përshtatshme, ato u zbatuan edhe në pjesët e tjera të veshjeve, si p.sh. në qoshet e përparme të jelekëve e të xhybeve të grave, në pjesën qëndrore të shpinës së jelekëve të grave, të xhamadanëve të burrave etj. Ka raste që kompozimet janë bërë në mënyrë të tillë që motivët, pa u shkëputur nga njeri-tjetri, mbushin tërë sipërfaqen e objektit. Në këtë mënyrë janë qëndisur xhybet e kostumit të gruas katolike të qytetit të Shkodrës. Gama e përdorimit të ngjyrave, e zbatuar në veshjet e qytetit, është e kufizuar. Në këto qëndisje nuk përdoren më tepër se tri ngjyra. Përshtatim bëjnë zbukurimet e përdorura në japanxhet e kostumit popullor të një pjese të grave të qytetit të Shkodrës, qëndisjet e punuara nga gratë e Kosovës dhe disa qëndisje të punuara nga gratë shtëpiake të vendit tonë, ku është përdorur një gamë më e pasur ngjyrash. Ajo që bie në sy në qëndisjet qytetare është se ngjyrat kanë tonalitete të ëmbëla dhe pa kontraste të forta. Të kombinuara bukur me sfondin ku janë zbatuar, ato të krijojnë përshtypjen e një tabloje të harmonizuar, ku motivi, ngjyra dhe kompozimi janë vendosur në mënyrë të tillë që ndihmojnë për të nxjerrë në pah vlerat estetike të njëra-tjetrës. Një rol të madh në vlerësimin e ngjyrave të zbatuara në qëndisjet qytetare ka luajtur dhe materiali si fija e mëndafshit, e arit, e argjendit, e rruazave dhe e teminave që u jepte shkëlqim dhe madhësi zbukurimeve të këtyre objekteve. Dëshira për të qenë sa më afër modelit të marrë nga natyra, i ka çuar qëndistarët dhe qëndistaret tona ndonjëherë në nota natyraliste në punimet e tyre.


Ndër teknikat më të njohura në qëndisjet e qytetit është teknika me të mbushur, zbatuar kjo në disa mënyra: teknika e gërshetit, e shkopit, tek-

nika e gjysmëkryqit etj. Është për t'u theksuar se qëndisjet tona popullore të shumtën e rasteve bëheshin nga pjesa e prapme e modelit, d.m.th. nga pjesa e brendshme e objektit. Natyrisht, kjo ishte një punë e vështirë që kërkonte vëmendje dhe kujdes të madh. Kjo mënyrë punimi bëhej me qëllim që qëndisja të dilte sa më e rregullt dhe më e pastër. Mjeti për zbatimin e qëndisjeve qytetare ka qenë gjilpëra e zakonshme. Më vonë hyri në përdorim gjergjefi, tellarua, makinat për qëndisje etj. Këto mjete lehtësuan punën, ndihmuan në shtimin e prodhimit në fushën e qëndisjeve dhe njëkohësisht në to u futën në përdorim disa teknika të reja punimi, që u zbatua më vonë në zbukurimin e pajisjeve shtëpiake të qytetit.

Po t'u bëjmë një analizë qëndisjeve të zbatuara në veshjet e qytetit, del se ato sipas materialit me të cilin është bërë qëndisja, (materiali ka luajtur një rol të madh në dhënien e formës së motivit, në ngjyrat, në kompozimin dhe në teknikat e punimit), mund të ndahen në dy grupe: qëndisje punuar me kordon dhe qëndisje punuar me fije ari, mëndafshi e pambuku.

Grupin më të madh të qëndisjeve qytetare e përbëjnë ato që janë punuar me kordon. Këto qëndisje për vlerat historike, etnografike dhe për vlerat estetike që kanë, meritojnë të bëhen objekt studimi të veçantë. Këtu do të mundohemi t'u bëjmë një analizë të shkurtër këtyre qëndisjeve të cilat i gjejmë të zbatuara në veshjet popullore të burrave, të grave dhe të fëmijëve të qyteteve. Kordoni si material për qëndisje është përdorur më shpesh në zbukurimin e veshjeve të sipërme, në jelekët, xhamadanët, mëngoret, xhybet, këmbëzat e dimiteve, armaqët, tostehri, sakot etj. Sipas llojit kordonat kishin emra të ndryshëm, si bukme, mjeshtrit kazazë. Fijet me të cilin ato janë përgatitur ishin: fija e pambukut, fija e mëndafshit, fija e arit ose e argjendit. Qëndisjet me kordon në veshjet e qytetit i gjejmë të zbatuara mbi pëlhurën e cohës, mbi personat që bënin porosinë ka qenë coha dhe kadifeja. Kordonet sipas llojit që kishin janë përdorur për qëllime të veçanta. Kështu, p.sh., tehria dhe bukmeja, që ishin më të holla se gajtani dhe shiritët, në pjesët e tjera të objekteve. Me anë të këtij materiali (bukmas dhe tehri) mjeshtrat popullorë kanë krijuar një numër të madh motivesh të cilat janë përfytyrime të sendeve të marra nga natyra. Motive të tilla si lulet e llojeve të ndryshme, zogu, dielli, hëna, ylli, gjarpri, selvija, tērfili katērpetalēsh, bajamja, dredhēzat etj., janë stilizuar bukur me linjë të lajnē natyrshmēri të veçantē. Kēto motive të ndërthurura me njëra-tjetrēn një elegancē dhe një dinamizēm plastik. Nē disa raste kompozimet e dhe të shqetēsuarā krijojnē pērshtypjen e lēvizjeve të vrullshme dragoi, gjarpēri etj.

Për t'i dhënë formën motivit dhe për të krijuar larmi në mënyrat e kompozimit së bashku me materialin kanë ndihmuar edhe teknikat e punimit, nga të cilat më e njohura është teknika me të mbushur. Kjo teknikë lejonte çdo lëvizje dhe i krijonte mundësi qëndistarit t'i jepte



1) Motive të qëndisura në japanxhën e kostumit popullor të gruas qyteti i Shkodrës.



2) Motive të qëndisura në rizat e kostumit popullor të gruas Kosovë.



7) Motive të qëndisura në mbulesë tavoline — rrethi i Vlorës.



8) Motive të zbatuara me qëndisje në peshqir — qyteti i Tiranës.

modelit forma dhe përmasa të ndryshme. Në pjesët e përparme dhe anësore të xhybeve të grave, dhe në pjesën qendrore në shpinën e jelekëve të grave, në qoshet e përparme dhe në pjesën e mëngëve të mëngoreve të burrave, ose në pjesën e shpinës dhe në pjesët e përparme të xhamadanëve të burrave etj., motivet janë të bukura dhe të vendosura në mënyrë të ngjeshur. Motivët e qëndisura me kordona të kombinuara me njëra-tjetrën janë kompozuar në formë blloqesh zbukurues dhe mbushin sipërfaqe të caktuara. Këto blloqe zbukuruese herë marrin formën e një vargu të lulëzuar që qëndron në mënyrë vertikale ose horizontale mbi sipërfaqen e objektit, herë na kujtojnë formën e gjethes me përmasa të mëdha, të një peme a të ndonjë sendi tjetër. Në objekte të veçanta, siç është rasti i xhybeve të kostumit popullor të grave të një pjese të popullsisë së qytetit të Shkodrës, motivet zbukuruese kanë një mënyrë tjetër kompozimi. Motivët si zogu, gjarpri, lulet e llojeve të ndryshme, tërfili tre-katër petalesh, bajamja etj, pa u shkëputur nga njëri-tjetri mbushin pothuaj krejt sipërfaqen e objektit; ato kanë përmasa të vogla dhe rrinë aq shumë pranë njëri-tjetrit, sa që është e vështirë të dallosh sfondin nga qëndisja. Në qëndisjen e këtij grupi është me interes të përmendet përdorimi i ngjyrave. Zakonisht nuk përdoren më tepër se dy ngjyra; më të shumtën e rasteve ngjyrat e motiveve janë të përafërta me ato të sfondit të objektit ku është bërë qëndisja. Më të goditura janë qëndisjet e zbatuara në xhybet e kostumit të gruas së qytetit të Tiranës e të Krujës dhe në xhamadanet e burrave të Gjakovës e të Prizrenit. Për zbukurimin e xhybeve të kostumit të grave në qytetin e Tiranës e të Krujës janë përdorur gajtane, bukme dhe teheri prej pambuku ose mëndafshi me ngjyrë të zezë. Mbi sfondin e zi prej cohe janë krijuar kombinime të tilla, ku gajtani në ngjyrë kafe më të errët ose në kafe më pak të çelët, zbatohet në sfondin kafe të xhybes.

Të kësaj natyre janë edhe zbukurimet e xhamadanëve të burrave të Kosovës. Këto objekte përgatiten me pëlhurë cohe me ngjyrë kafe të errët ose në vishnje të errët. Në këto objekte janë përdorur gajtanë, bukme, dhe tehri që kanë ngjyrë të njëjtë me atë të sfondit, por me nuanca pak më të çelta ose pak më të errëta se sfondi. Relievi i krijuar nga materiali i përdorur për qëndisje me trashësi të ndryshme, u jep këtyre punimeve pamjen e një basorelievi zbukurues, ndërsa ngjyrat e kombinuara, si kafeja me të zezën ose kafeja me ngjyrën vishnje me nuanca të ndryshme, të kujtojnë motivet zbukuruese në objektet e bakrit të punuara me teknikën e rrahjes, që me kalimin e kohës marrin një farë patinimi. Nuk përjashtohen rastet kur në zbukurimin e veshjeve me kordone prej pambuku ose mëndafshi të përdoren dhe kordonë të përgatitur, me fije ari ose argjendi. Një kombinim i tillë është zbatuar në mënyrë mjaft të goditur në pirpiritë e kostumit popullor të grave të Leskovikut. Në grupin e qëndisjeve më kordona një bukurie të rrallë janë gjithashtu sakot e kostumit të grave të Beratit, të Gjirokastrës, të Përmetit dhe të Leskovikut. Këto objekte, me një gjatësi që arrijnë të mbulonte tri të katërtat e trupit të gruas, në fillim janë mbajtur me këmisha të gjata prej pëlhure të endur në vegje, pastaj me fustanet e gjata deri në fund të këmbëve, të qëndisura me ar. Sakot si për sa i përket formës së prerjes, qepjes dhe mënyrës së zbukurimit, ashtu dhe materialit me të cilin janë qëndisur, numurohen ndër objektet më të bukura të veshjeve të grave

qytetare. Ato përgatiteshin zakonisht me cohë në ngjyrë të zezë për gratë e moshuara dhe pëlhurë kadife vjollcë ose lejla për gratë dhe nusët e reja. Motivet e zbatuara në zbukurimin e sakove kanë qenë të përafërta me ato që janë përdorur në xhybet dhe jelekët e kostumit të grave të qytetit, por, kuptohet, të realizuara në mënyrë kompozimi të tjera. Motivet si shqiponjën, sahatin, hënën, yllin etj., i gjejmë të vendosura në pjesën e përparme të gjoksit të objektit, në pjesët e poshtme të mëngëve, në pjesën qëndrore dhe të sipërme të shpinës së tij. Në sakot nuk mungojnë motive të tilla, si rreshtat, bedenat ose dredhëzat, të cilat së bashku me motive të tjera vegjetale të vendosura në formë vargu, e rrethojnë objektin në tërë pjesët anësore të tij si një kurorë lulesh. Materiali i përdorur në qëndisjet e këtyre objekteve kanë qenë gajtani, teheria dhe bukmja, të përgatitura me fije mëndafshi ose me fije ari e argjendi. Kordonet për zbukurimin e sakove i ndeshim në pëlhurë cohe ose atllazi, por efekte më të bukura krijojnë kur përdoren në pëlhurë prej kadifeje. Kadifeja me butësinë e saj dhe me tonalitetet e ëmbla të ngjyrave të sfondit (si violet, lejla, jeshile etj.) lejon të duken qartë motivet zbukuruese dhe, nga ana tjetër, ndihmon që ngjyra e çelët e praruar e fijos së arit ose të argjendit të dalë më në pah.

Grupin tjetër të qëndisjeve qytetare e përbëjnë ato që janë punuar me fije ari ose argjendi, fije mëndafshi e fije pambuku. Në këto grupe bëjnë pjesë qëndisjet që i gjejmë të zbatuara në japanxhat e kostumit popullor të grave të një pjese të popullsisë së qytetit të Shkodrës. Qëndisje me fije ari, mëndafshi dhe pambuku kanë punuar gjithashtu dhe gratë e qyteteve Krujë, Tiranë, Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Shkodër, Kosovë etj. Këto qëndisje të zbatuara me fije mëndafshi dhe pambuku për t'u përmendur janë ato që zbukurojnë japanxhat e kostumit popullor të grave të qytetit të Shkodrës, të cilat kanë tipare të veçanta që i dallojnë nga qëndisjet e tjera qytetare. Në këto objekte zogu, palloi pëllumbi, dielli, hëna, gjarpri etj., si motive karakteristike janë punuar me fije pambuku ose fije mëndafshi me teknikën e gërshetit, e cila numërohet ndër teknikat më të hershme të qëndisjes shqiptare. Sfondi ku janë zbatuar ato përbëhet nga rripa dyngjyrësh në gjerësi të barabartë, të vendosur herë në mënyrë vertikale dhe herë në mënyrë horizontale. Këta rripa janë në ngjyrë të afërt, vishnje me të zezë, kafe me vishnje ose vishnje të kuqe, kuq e zi. Në këtë sfond dyngjyrësh vendosen motive në ngjyrë okër të kuqe, portokalle, rozë, lejla, jeshile, të cilat qëndrojnë fare mirë pranë njëra-tjetrës, të bashkuara nga ngjyra e bardhë, që nuk mungon asnjëherë në këto punime.

Edhe përsa i përket kompozimit këto qëndisje të japanxhes ruajnë tiparet e veta që u japin këtyre punimeve një fizionomi të veçantë. Shpesh ato janë të kompozuar me një figurë qëndrore e cila mund të jetë përfytyrim i një luleje, i gjarpërit, a i dragoit, i yllit me gjashtë cepe ose i dy pëllumbave të vendosur përballë njëri-tjetrit me krye të kthyer paksa anash. Figura qëndrore shoqërohet me motive të tilla: tërfil katër petalesh, me lule, gjethe dhe lastar të llojeve të ndryshme, të cilat pa u shkëputur nga njëri-tjetri qarkullojnë në mënyrë gjarpëruese dhe mbushin sipërfaqe të caktuara, duke u përsëritur disa herë me një ritëm e simetri të rregullt. Këto qëndisje vendosen në jakën e objektit e cila lëshohet prapa në formën e një katërkëndëshi me përmasa aq sa mbulon

shpatullat e gruas, pastaj ajo vazhdon dhe zbret në të dy anët e sipërme dhe të përparme të objektit. Qëndisja e bërë në këtë mënyrë të krijon përshtypjen e një shalli të zbukuruar me një mori lulësh e ngjyrash që varet lirshëm mbi shpatullat dhe gjoksin e gruas. Zbukurimi i japanxhave ka qenë punë e qëndistarëve shkodranë. Përveç mjeshtërve profesionistë, me qëndisje të punuara me fije mëndafshi ose pambuku fije ari ose argjendi janë marrë dhe gratë shtëpiake të cilat bënë punë të tillë si zbukurimi i rizave, i brezave, qëndisje e disa mbulesave të kokës, zbukurimi i këmishave, i çerveve, i sallmaneve e përparëseve, zbukurimi i pajisjeve shtëpiake etj., të një cilësie të lartë dhe mjaft të goditura ndër qëndisjet e këtij grupi janë ato të punuara nga gratë shqiptare që banojnë në Prizren, në Gjakovë e në Pejë. Ato kanë zbukuruar objekte të tilla, si riza, përparëse, bohçe, çarçafë, jastëkë etj. Motivet zbukuruese që janë zbatuar në këto objekte kanë qenë lule, zogj të stilizuar në trajta dhe përmasa të ndryshme. Kompozimet i janë përshtatur objektit ku janë zbatuar. Kështu, p.sh., kur objektet kanë formën e katrorit, motivet i gjejmë të vendosura herë në qoshe të tij dhe herë në gjithë sipërfaqen e objektit. Ndërsa në rizat që kanë formën e katërkëndëshit të zgjatur, motivet vendosen në formë tubëza lulësh në dy skajet anësore të rizës. Por ka raste që në përparëset e kostumit popullor të grave të Prizrenit motive të qëndisura vendosen në pjesët anësore të objektit.

Teknika e punimit në këto qëndisje ka qenë me të mbushur, e zbatuar në disa mënyra, dhe teknika e gjysmëkryqit. Ndonëse motivet janë stilizuar me linja pak të ngurtësuara, me forma arkaike dhe me përmasa të mëdha në krahasim me objektin ku janë zbatuar, ngjyrat janë kaq të arrira, sa të befasojnë me kombinimin e tyre të ëmbël dhe delikat. Kështu, p.sh., në sfondin ngjyrë krem dhe transparent të pëlhurës vendosen motive me ngjyra të tilla, si krem, lejla, ngjyrë rozë ose e blertë, ngjyrë e kaltër ose limon. Ngjyrat janë vendosur në formë blloqesh dhe pa nuanca të shkallëzuara. Por ajo çka i bën tërheqëse këto qëndisje është tonaliteti tepër i qetë i ngjyrave, të kombinuara bukur me njëra-tjetrën, njëkohësisht të ndihmuara nga shkëlqimi dhe refleksat e krijuara nga materiali me të cilin është bërë qëndisja me transparencën e pëlhurës, të krijojnë përshtypjen e një natyre të qetë të punuar me teknikën e akuarelit.

Fija e arit dhe e argjendit që është përdorur për qëndisjet e grupit të dytë, sikurse dihet, ka ngjyrat natyrale të materialit. Për këtë arsye nga pikëpamja koloristike këto objekte kanë një natyrë të veçantë.

Për t'u përmendur në këto raste janë këmishët dhe çervet e kostumit popullor qytetar të grave të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut (Shkodër.). Çervet janë objekte me përmasa 1 m x 1,50 m, të cilat të palosura në formë trekëndëshi vendosen në ijet e trupit të grave dhe varen lirshëm poshtë, duke krijuar një sërë palash të lehta. Këmishët e grave qytetare janë të përgatitura me pëlhurë mëndafshi të endur në vegje, ndërsa çervet me mermer (pëlhurë e bardhë transparente e importuar). Motivet zbukuruese të këtyre objekteve janë zogj, lule, flutura, mollë etj. të stilizuara me linja të papërcaktuara mirë. Motivet vendosen në formë vargu ose tufa lulësh gjatë mëngës së këmishës ose në buzët anësore të çerves dhe në qoshet e saj. Materiali për qëndisjen e këtyre objekteve ka qenë gjyrmishi (fije ari e petëzuar). Kjo lloj fije qëndisej me

vështirësi, për këtë arsye gjatë punimit së bashku me gjilpërën përdorej edhe gërshëra, me të cilën pritej pëlhura në atë vend ku do të kalonte fija. Ajo që u jep një bukuri të veçantë këtyre objekteve është gjyrmishi, i cili gjatë qëndisjes krijon reflekse të forta dhe tepër të shkëlqyeshme. Ky material i shndritshëm, i vendosur në mermerin transparent, krijon përshtypjen e një llampadari vezullues.

Të një natyre tjetër janë qëndisjet e zbatuara në këmishat e kostumit të grave të qytetit të Korçës, të Gjirokastrës, të Prizrenit dhe të Gjakovës. Këto objekte përgatiten me material mëndafshi në ngjyrë kremi që është ngjyra natyrale e mëndafshit, të endur në vegjë. Motivët zbukuroese janë lule dhe gjethe të llojeve të ndryshme, të cilat janë të qëndisura me tel ari ose me gjyrmish. Në buzë të jakës, të gjoksit të këmishës dhe në buzë të mëngëve janë vendosur me shumë mjeshtëri hojatë e punuara me gjilpërë, në ngjyra të përafërta me ato të sfondit të këmishës ose me ngjyrën e arit. Hojatë, me format e tyre karakteristike, krijojnë lëvizje pak shqetësuese, ndërsa nën peshën e lehtë të fijos së arit dhe argjendit krijojnë disa pala të lehta plastike, që u japin bukuri të veçantë këtyre objekteve.

Në këtë grup bëjnë pjesë ato qëndisje që u punuan pothuaj nga të gjitha gratë e qyteteve tona. Ndonëse janë më të vona nga ato që përmendëm më lart, këto qëndisje ruajnë vlerat artistike të tyre dhe janë përfaqësuese të një periudhe kohe të caktuar, (rreth viteve 20 të shekullit tonë), kur veshjet popullore të qytetit filluan të zëvendësoheshin me veshje evropiane, atëherë qëndisjet me fije mëndafshi ose pambuku filluan të zbukuronin veshjet e brendshme të grave si: këmishët, fustat, këmishat e natës, të mbathurat etj., duke mos lënë mënjanë edhe zbukurimet e pajisjeve shtëpiake, punimi i të cilave mori në këtë periudhë, një zhvillim të madh. Modelet zbukuroese të këtyre objekteve më të shumtën e rasteve u sollën nga jashtë. Së bashku me modelet u sollën dhe makinat e para qepëse, që në disa raste përdorëshin edhe për të qëndisur. Krahas modeleve të jashtme qëndistaret tona kanë përdorur dhe modelet të përgatitura në vend nga modelistët më me talent dhe me një përvojë të madhe pune. Pas vitit 1912 një motiv shumë i dashur dhe i parapëlqyer për qëndistaret tona u bë motivi i shqiponjës dhe i flamurit kombëtar. Këto qëndisje bëheshin në formën e tablove zbukuroese dhe vendoseshin zakonisht në dhomat e pritjes të shumë shtëpive qytetare.

Në punimin tonë vumë në dukje disa nga karakteristikat dalluese të motiveve të qëndisura që kanë qenë të zbatuara në veshjet dhe pajisjet shtëpiake të qytetit. Dihet se këto modelet bëjnë pjesë në pasurinë e madhe të artit të zbatuar popullor dhe kanë plotësuar për shekuj me radhë kërkesat estetike të shtresave të ndryshme të popullsisë qytetare. Duhet theksuar se qëndisjet e qytetit, të punuara nga mjeshtër profesionistë burra dhe nga gratë shtëpiake, shquhen për elegancën dhe zhdërvjelltësinë e linjës së figurës, për format plastike motivore, për tonet e ëmbla të ngjyrave dhe për harmoninë e kompozimeve. Për vlerat e mëdha estetike dhe për vetë natyrën komunikuese dhe më të kapshme, motivet e qëndisjeve të qytetit kanë gjetur përdorim të gjerë në zbukurimin e objekteve të ndryshme të prodhuara nga industria jonë. Kështu p.sh., ato i gjej-

më të zbatuara me shumë shije në basmat dhe poliestrat e Kombinatit të tekstileve «Stalin», në damaskat e Kombinatit të tekstileve Berat, në sexhadet e ndërmarrjeve artistike të disa qyteteve të vendit tonë, në punimet e porcelanit dhe ato të qelqit etj. Piktorët dhe modelistët në përgatitjen e modeleve të ndryshme zbukuruese kanë përdorur edhe motive popullore të marra nga qëndisjet qytetare, të cilat i kanë zbatuar nëpër objekte në mënyrë të përpunuar dhe krijuese, duke i ngritur në një shkallë më të lartë artistike, në përshtatje me kërkesat e kohës dhe të konsumatorëve.

EMBROIDERY IN THE FOLK COSTUMES OF THE TOWN

The introduction to the article is a brief analysis of the historical-ethnographic background of folk embroidery in our towns. The article says that this craft has been practised by both men and women. Embroidery, as one of the most important skills of the Albanian professional masters and housewives, has met for years on end the aesthetical requests of the urban population, and at the same time, has played an important role in their socio-economic development in the past. The article goes on with a detailed analysis of the aesthetical values of the urban embroidery. The folk embroidery, as a component part of the applicative folk art, is a living reflection of the tireless work of the talented professional embroiderers and the industrious housewives of our country. In order to give a more accurate idea of this skill, the article is divided into two parts, on the basis of the material and cloth used for embroidery.

In the first group fall the embroideries with silk thread, cotton thread and silver or gold thread. This groups makes up the bulk of this article. The second group, comprised of embroideries with silver or gold thread, occupies less space in this article for the reason that, due to some of their characteristics, these kinds of embroideries should be taken up for study in a separate article.

Kahreman ULQINI

VEPRIMTARIA KANUNORE E PLEQSORE NË INSTITUCIONIN E BAJRAKUT

Institucioni i bajrakut qe një lloj i veçantë organizimi administrativ tokësor, me funksione ushtarake e gjyqësore, i krijuar në fund të shek. XVII. Ky sistem organizimi shtrihet vetëm në viset malore të sanxhakut të Shkodrës dhe të Dukagjinit (me qendër në Pejë), brenda kufijve që këto sanxhaqe kishin në shek. XVII. Këtë e krijoi me dekret të veçantë Porta e Lartë për të vënë në kontroll dhe për të shfrytëzuar (në drejtim të aftësive luftarake) fshatarësinë kryengritëse të këtyre viseve, ku nuk kish mundur të vendosë sistemin e timareve. Ky ishte një kompromis midis kësaj fshatarësie të lirë dhe pushtuesit osman; kështu Turqia, sadoqë në një masë të paktë, mundi t'i përdorë aftësitë luftarake të këtyre malësorëve. Por në suazën e organizimit të bajrakut këta malësorë mundën të ruanin një farë vetëqeverisje, ruajtën formën e organizimit të tyre të vjetër, të mbështetur në të drejtën zakonore. Ky sistem organizimi u përdor me sukses në kryengritjet popullore kundër sundimit osman në shek XVIII fillimi i shek. XIX e gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare¹

Veprimtaria kanunore dhe procedurale-gjyqësore² në trevën e bajrakut paraqitet më e plotë e më e dokumentuar se në krahinat e tjera të

1) Tradita popullore tregon se «në kohën e Karamahmutit asht punue me Kanunin e Lekës ashtu si ka qenë motit». Ka edhe burime të shkruara që e vërtetojnë këtë. Historiani Xhevdet Pasha shkruan se nën Bushatliun «drejtësia nuk funksiononte, gjyqtarët ishin zhdukur dhe sherjati kishte pushuar» (S. N. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatlijve*, Tiranë 1964 fq. 226-227; po ai, *Përtritja e Pashallëkut të Shkodrës nën qeverisjen e Ibrahim Pashë Bushatliut...*, «Studime historike», 2, 1982 f. 163). Një kronikë e shkruar në Bosnje më 1786 flet për drejtësinë që Karamahmuti kishte vendosur në pashallëkun e vet dhe se nuk lejonte të bëheshin dhunime nga ajanët, kadilerët e myftijtë *Kronikë e Mulla Mustafajt Besheskiut*, f. 47 (Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë).

2) Ky shkrim është pjesë e një studimi të gjërë, Bajraku si organizimi shoqëror në Shqipëri të Veriut

vendit tonë. Studimi i kësaj veprimtarie si pjesa më karakteristike e elementeve të organizimit shoqëror është një kontribut edhe për hartimin e historisë së shtetit e të së drejtës shqiptare. Në anën tjetër, për arsye të kushteve ekonomiko-shoqërore të prapambetura të trevës së bajrakut dhe të zhvillimit të pabarabartë ndërkrahinor, veprimtaria pleqësore zgjati deri në prag të Çlirimit. Në etapën e parë të ndërtimit të shoqërisë socialiste në vendin tonë, kanuni dhe shfaqjet e bajraktarizmit u përdorën nga reaksioni i jashtëm dhe klasat e përmbysura kundër reformave të pushtetit popullor, emancipimit të gruas, u bënë pengesë për futjen e marrëdhënieve të reja në jetën familjare e shoqërore. Për këtë shoku Enver Hoxha ka porositur që «studiuesit tanë ta bëjnë mirë diagnozën e gjendjes aktuale të marrëdhënieve shoqërore në veri, për të parë përmbysjet, evolucionet dhe për të forcuar punën tonë ideologjike, propagandistike dhe organizative»³.

*
* *
*

Me ndryshimet ekonomiko-shoqërore që ndodhën në trevën e bajrakut gjatë shekullit XIX, disa doke e zakone u braktisën, duke mos qenë në pajtim me kushtet e reja që u krijuan, disa të tjera pësuan ndryshime dhe së fundi u fiksuan norma të tjera kanunore. Shoku Enver Hoxha na mëson se «zakonet janë ligje të pashkruara, që pësojnë ndryshime si dhe ligjet e shkruara, por në periudha vazhdimësie më të gjata»⁴. Nga burime të ndryshme marrim vesh për një «kanun të ri» e një tjetër «të moçëm»⁵. Me këtë nuk duhet menduar se këto qenë dy kanune të ndryshme që zëvendësuan njëri-tjetrin. Këtu kemi një zhvillim të së drejtës zakonore. Plotësimi i kanunit me norma të reja bëhej në kuvendet e bajrakëve ose të krahinave. Këto kuvende kishin karakter ligjëvënës. Në këtë drejtim kishte një farë lirie, pse kushdoqoftë mund të vinte norma të reja të nevojshme, pa rënë në kundërshtim si me frymën e kanunit në përgjithësi, ashtu edhe me vendimet (usullet) e katundit e të bajrakut në të cilin bënte pjesë. Një vendim i marrë në një bajrak mund të bëhej shembull për bajraqe të tjerë. Kështu në shtator të vitit 1902 Vukli vuri ligjin që për gjakmarrje «mos me bue veçse shpia shpinë»⁶ dhe u bëri thirrje bajrakëve të tjerë të Kelmendit që edhe ata të vepronin kështu. Vendime të përbashkëta mund të merrnin edhe bajrakët fqinjë të dy krahinave,

3) Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1967-1968», Tiranë, 1969, f. 104.

4) Enver Hoxha, *vep. cit.*, f. 103-104.

5) Sh. Gjeçov, *KLD*; gazeta «Bashkimi» (Shkodër), 9 prill 1911, nr. 15; f. 3.

6) Për gjak të mos vriten kushërinjtë, por vetëm meshkujt e shtëpisë së vrasësit. Në Hot ishte zakoni që për gjak të shkohej deri «në rubë të zezë», dmth deri në atë rreth familjar që në raste vdekjeje mbante zi.

siç ka qenë marrëveshja e Bogës me Gimajt për çështje vjedhjeje. Në disa kuvende kërkohej të fuqizohej ndonjë normë ose zakon që ishte braktisur në praktikë. Ky rast duhet shikuar në rrafshin klasor — kujt i interesonte ruajtja e një norme të caktuar kanunore, vegjëlisë apo krerëve e pushtetit shtetëror. Vendimet e marra kishin karakter të përhershëm. Normat e reja, sado që miratoheshin nga të gjithë, nuk gjenin zbatim ashtu menjëherë e pa kundërshtime. Kjo parashikohej që më parë në kuvend derisa vendimet shënonin edhe masa dënimi kundër atyre që nuk do t'i respektonin. Në kuvendet e gjera të bajrakut kur mblidheshin «burrë për shpi» vendimin e nënshkruanin përveç krerëve dhe përfaqësuesit e vegjëlisë. Ka mendime që pohojnë se vendimet e marra në kuvendet shqiptare nuk kanë qenë shkruar asnjëherë⁷. Ne kemi pasur rastin të shohim dhjetëra e dhjetëra vendime të shkruara në vise të ndryshme të trevës së bajrakut, që i përkasin periudhës që nga mesi shekullit XIX deri më 1912. Sipas rasteve ato janë shkruar shqip, turqisht, italisht duke u shoqëruar në fund me shenja gishti, vula e rrallëherë me nënshkrime. Në fund janë legalizuar nga bylykbashi e serxherdeja. Këto dokumente ruheshin nga bajraktari dhe kopje të tyre i dërgoheshin bylykbashit.

Kuvendet zakonisht mblidheshin dy herë në vit «para shëngjergjit» (në pranverë) dhe «në shmitër» (vjeshhtë), por kishte edhe kuvende të jashtëzakonshme. Mbledhja lajmërohej me lajmëtar. Për pjesëmarrjen dhe qëndrimin në kuvende kishte rregulla të caktuara. Ai që nuk paraqitej në to qoftë edhe nga krerët, dënohej me gjobë⁸. Në kuvendet e përgjithshme përfaqësoheshin edhe ato shtëpi që qëndronin «të ngujueme» (në gjak), të cilat, viheshin në besë të kuvendit e askush brenda bajrakut nuk guxonte t'i cënonte. Kjo besë zgjaste «diell më diell» (gjatë tërë ditës). Krerët e pleqtë rrinin në kuvend sipas prijët e tagrit⁹.

Qëllonte që në kuvend të thirreshin edhe gra të veja, «zonja shtëpie», vetëm për të dëgjuar, ato rrinin në fund, larg burrave, me kokë ulur me shaminë zbritur deri në sy e duart të lidhura njëra mbi tjetrën te këmbët. Ato nuk kishin të drejta të flitnin; interesat e tyre i mbronte një nga të afërmit e vllaznisë ose të fisit.

Kuvendet e krahinës mblidheshin në vende të përshtatshme për të gjithë. Ndonëse qendra administrative i Mirditës qe Oroshi, kuvendi bëhej në Shpal, i Pukës në Kabash, i Dukagjinit te Ura e Shalës, i Maleve të Shkodrës te Çesmja e Koplikut, i Malësisë së Madhe në Brigje të Hotit, i Malësisë së Gjakovës në Bregun e Llukës etj.

Përveç kuvendit norma kanunore, ndonëse në mënyrë të kufizuar, mund të vendoste edhe djelmnia e Shalës. Në zhvillimin e pasurimin e së drejtës kanunore kanë dhënë kontributin e tyre edhe një numër individësh të shquar, «pleq kanuje» ose «kanutarë» (Kosovë) si Binak Alia i Gashit. Mehmet Shpendi i Shalës, Lleshi i Zi i Mirditës, Cun Mula i Hotit, Bali Rama i Martinajt (Guci), Niman Aga i Iballës (Pukë), Ramadan

7) E. Elic «Krvna osveta i umir u Crojgori i Severnoj Albaniji», Beograd, 1926.

8) *Iskodra vilajeti salnamesi*, 1312 (1894)

9) Sh. Gjeçov, «KLD», SS 1112

Shabani e Xhemal Ohrija (Drenicë), Sali Rusta (Deçan), Musë Ballëgjini në Çermenikë, Idriz Suli në Labëri etj.

Ndryshime në normat kanunore ndodhën jo vetëm për shkak të zhvillimit ekonomik-shoqëror, të këtyre trevave por edhe për shkak të ndikimeve ideologjike fetare e ndërhyrjes shtetërore. Në trevën e bajrakut, sidomos në viset e Kosovës që në shekullin XVI nisi islamizimi i popullsisë. Ky proces në rrethinat e Shkodrës si në Postrribë, Krajë, Rranxat e Mbishkodrës që më i kufizuar në shtrirje dhe u shfaq në shekujt XVII-XVIII ndërsa në Anë të Malit në fillim të shekullit XIX. Në viset, ku popullsia u kthye në fenë e re u dukën disa ndikime sidomos në të drejtën familjare. Megjithatë ndikimi i sheriatit në normat kanunore ka qenë aq i kufizuar sa nuk e ka prekur origjinalitetin e tij. Në bajrakët e Kosovës fshatarët nuk kishin fare besim në drejtësinë e sheriatit. Atje dëgjohen shpesh tregime e anekdota, ku vihet në dukje paaftësia e kadilerëve për t'i zgjidhur çështjet gjyqësore. Një gojëdhanë e mbledhur në një fshat të Podujevës tregon se kadiu vetëm pasi u takua me Lekë Dukagjinin, të veshur si bari, diti ta ndajë pasurinë e tre vëllezërve, të trashëguar nga i ati i tyre¹⁰. Albanologia angleze E. Durham, që njohu mirë traditat shqiptare, ka shkruar se kanuni i Lekë Dukagjinit «fitoi më tepër bindje sesa dhjetë urdhnimet e tenzot, dhe mësimet e hoxhallarëve e të priftërinjve ishin shpesh herë të kota po të ishin në kundërshtim me ato të Lekës»¹¹.

Nga gjysma e dytë e shekullit XIX fillon të gjallërohet kisha katolike, e cila ishte goditur fort nga pushtuesit osmanë. Në kuadrin e forcimit të ndjenjës e të zakoneve fetare si misionet françeskane e jezuite ashtu edhe famullitarët, kanë bërë përpjekje të ndikojnë mbi ato norma të kanunit, që ishin në kundërshtim me urdhërimet e moralin e kishës. Klerikët afishuan në dyert e kishave dhe lexuan përpara besimtarëve «emërname» (urdhëra) e «ndalesa» (proibirioni) të bëra nga arqipeshkvi e misionet. Dora e klerit njihet edhe në vendimet e ndonjë kuvendi të krerëve të bajrakut. Kështu janë hartuar dispozita në përkrahje të kishës e të klerit dhe në ndonjë rast janë përdorur dënime më të rënda se ato që jepte kanuni, si djegie e banesës, vrasje, grabitje e tjerë¹². Shpesh kleri

10) *Skëndërbeu dhe Lekë Dukagjini në traditën popullore* «Gjurmime Albanologjike — folklor dhe etnologji», 1, 1971, f. 225.

11) M.E. Durham, *Some tribal origins laws and customs of the Balkans*, London, 1928, f. 65. Për të krijuar një mendim se deri ku shkonte mosbindja e malësorëve ndaj urdhërave të kishës po japim një statistikë rreth numrit të të mallkuarve në Shalë sipas viteve:

më 1774 të mallkuar	73	më 1820	të mallkuar	50
1809	» 103	1836	»	59
1819	» 47	1888	»	103

12) Me ndërhyrje të «misionit shëtitës» jezuit Sadik Mehmeti (i krishterë) i Dardhës (Pukë) u gjobit me 250 grosh për t'ia paguar kishës pse i kishte dhënë më 1887 vajzën një myslimani, kurse Mark Kolës nga Harapi i Berishës (Pukë) më 1898 iu dogj shtëpia dhe familja e tij u dëbua nga fshati pse kishte martuar mbesën e vet me një mysliman në fshatin Degë të Krasniqes.

katolik bënte edhe marrëveshje me autoritetet qeveritare turke si bujurulldia e lëshuar në emër të qeverisë nga valiu i Shkodrës Ismail Pasha më 1864¹⁴. Për të forcuar pozitën e vet kleri bënte pjesëtar në gjoba edhe zyrtarët. Megjithëse pozita e kishës u forcua dhe u arritën suksese në heqjen e disa zakoneve, prapëseprapë kleri nuk pati ndonjë pozitë të veçantë që ia njihte kanuni. F. Nopça ka vënë re se «botimi i Gjeçovit vuan nga e meta, që apriori i vë vetes detyrën të paraqesë kanunin siç e paraqet kleri i Shqipërisë së Veriut, prandaj duhet përdorë me kujdes»¹⁵. Klerikët nuk bënë pjesë në institucionin e pleqësisë. Rastet e ndërhyrjeve janë tepër të rralla. Kur në një fshat të Plavës hoxha mori «librin e shenjtë» me të cilin gjoja desh të zgjidhte një pleqësi, i thanë: «lene, hoxhë, se pleqnia nuk nxirret prej kuranit, por prej menes së insanit»¹⁶.

Duke qenë se nga lufta e armatosur e malësorëve nuk u arrit zbatimi i reformave të Tanzimatit në trevën e bajrakut, qeveritarët osmanë e njohën përsëri kanunin dhe deshën ta inkuadronin në një farë mënyre veprimtarinë pleqësore brenda caqeve të administratës shtetërore. Më 1858 u hartua në Shkodër «Kanuni i Xhibalit» në bazë të Kanunit të Lekë Dukagjinit (KLD) duke shtuar disa norma penale të reja, që ishin në interes të pushtetit qeveritar. Në Kosovë autoritetet zyrtare formuan një komision me sekretarin e vilajetit në krye, i cili mori detyrë të mbledhte e të studionte KLD. Një pjesë e tij u botua në gazetën «Prizren» më 1871. Shtesa të bëra në KLD me shtytjen e autoriteteve qeveritare janë ato të vitit 1864 në Malësi të Madhe dhe të miratuara nga valiu¹⁷, të Bajzës së Kastriotit¹⁸ më 1892. Në fillim të shekullit XX flitet për një Kanun të Maleve «të miratuar nga qeveria»¹⁹. Si shëriati, ashtu edhe ligjet moderne turke qenë të huaja për natyrën e shqiptarit, nuk pajtoheshin me mendësinë e psikologjinë e tij, nuk i përgjigjeshin zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit, traditës së lashtë juridike e frymës liridashëse që zotëronte në shekuj. Burimet e huaja shënojnë se shqiptarët i urrenin gjykatat e reja. Në disa bajrakë si në Shalë, Nikaj, Mërtur e Kurbi kuvendet nxorën vendime që ndalonin paditë në gjykatat shtetërore në Shkodër e Gjakovë²⁰.

13) Sh. Gjeçov, *KLD*, f. 128-129.

14) Në Dukagjin ishte marrë një vendim me ndërhyrjen e «misionit shetitës» (tjetër se nuk u zbatua) që kush merrte «grua në gjynah» gjobitej me 1000 grosh, një pjesë e të cilëve i jepej bylykbashit.

15) F. Nopça, *Shqipëria, fiset e Malësisë së Shqipërisë Veriore dhe ligji i zakoneve* (dorëshkrim në Haus-Hob staatsarchiv Politisches Archiv-Albania, sipas përkthimit në A.I. të Historisë, f. 316).

16) F. Çetta, *Këngët e Kurt Mehmetit dhe Sadik Ramës*, «Gjurmime albanologjike — Folklor dhe etnologji» IV, 1976, Prishtinë, f. 173.

17) V. Meksi, *Privilegjet, imunitetet dhe detyrimet e krahinave autonome shqiptare gjatë pushtimit turk*, «Drejtësia popullore» 6, 1965, f. 67.

18) Sh. Gjeçov, *KLD*, f. 126.

19) Arkivi i Vjenës, filmi XXXI-XXX, viti 1902, nr. inventarit 846 (Në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë).

20) Sh. Gjeçov, *KLD*, f. 120, 129.

*
*
*

Veprimtaria pleqësore. Plaku nuk tregonte vetëm moshën e shtyrë në mote, por mbartte urtësinë, nderin e lavdinë e kohëve. Ai ishte mësues i brezave, dinte shumë gjëra të vërteta, ruante të fshehta e përcillte nga e kaluara amanete. Përvoja e tij vlente çdo ditë si në rregullimin e jetës familjare ashtu edhe në marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore. Aq shumë vlerësoheshin të tillë pleq sa, kur një vllazni, fis ose katund nuk kishte një plak që ta përfaqësonte në kuvend (ndonëse të moshuar mund të mos mungonin) gjendej ngushtë dhe të tjerët gjykonin kështu: «kishin pleq të papleqni». Me pleqtë që u kishte «dalë zani», matej nga opinioni i gjërë i kohës vlera moralo-shoqërore e një bashkësie. Një plak i tillë që mbartte traditën, kur «punonte me zakon», ishte gjykatës²¹. Pleqtë dilnin nga gjiri i popullit, nuk emëroheshin, as nuk zgjidheshin e as nuk vareshin nga ndonjë zyrë qeveritare. Ata e afirmojnë veten gjatë punës në lëmin e pleqnisë²² si njohës të mirë të kanunit, të mprehtë, të drejtë e të ndershëm në dhënien e gjykimeve. Duhej të kalonin tre breza prove duke «pleqnue» që një familje të fitonte emrin «shtëpi gjyqi» dhe ky trashëgohej brez mbas brezi, deri sa të mund të mbahej me nder e aftësi. Pleqnari i vinte syrin njërit nga djemtë ose nipat e tij të cilin e gjykonte më të aftin, dhe e mbante pranë vetes në pleqësime për t'i lënë trashëgim thesarin e ligjeve, mënyrën e interpretimit të tyre. Pleqnarët dhe pleqësia janë një institucion i vjetër. Populli i paraqet Skënderbeun e Lekë Dukagjinit edhe si pleqnarë. Pleqnarët ishin nga shtresa të ndryshme shoqërore. Kur niseshin për ndonjë pleqësim merrnin shkopin²³, jo për t'u mbajtur, por për të treguar gjatë rrugës se për ç'qëllim shtegtonin, prandaj ata nuk mund t'i cënonte njeri. Pleqnarët e zakonshëm merreshin me punët e përditshme vetiake bujqësore, kurse një kategori tjetër ata «në za» (më të kualifikuarit) nuk bënin asnjë punë, por tërë kohën e kalonin në pleqësime e kuvende. Kjo ishte për ta një burim të ardhurash ekonomike e forcim i pozitive shoqërore.

*Disa raste të veçanta që nuk kanë të bëjnë me një procedurë të vërtetë gjyqësore:*²⁴

1. «I zoti i shtëpisë» ose kryefamiljari në një farë mënyre luante edhe rolin e gjykatësit në familjet e mëdha, pleqësonte e shuante grindjet e mosmarrëveshjet e vogla në mes të pjesëtarëve të saj, mbante disiplinën e punës e të ndenjes si për meshkujt e rritur, ashtu edhe për gratë e fëmijët, pasi për çdo veprimtari të tyre përgjigjej përpara bashkësisë dhe autoriteteve të katundit e të bajrakut. Ky qortonte të mëdhenjtë për fajet,

21) Termat që shënonin gjykatësin ndryshonin sipas krahinave: *plak gjyqi, plak, pleqnar, plak kanuje, plak pengjesh etj.* Në punimin tonë kemi gjetur më të arsyeshme të përdorim termin pleqnar.

22) I përgjithshëm që termi «pleqni» — pleqnoj». Përdorshin dhe termat «me da pleqni», «me ba pleqni», «gjyq», «me da gjyq», «gjykoj», «gjykohej» etj.

23) Në viset e Kosovës hidhnin në supe qyrkun.

24) K. Nova, *Zhvillimi historik i gjyqimit në Shqipëri* «Referate e Kumtesa», Tiranë, 1965, f. 46.

gratë i pengonte të shkonin në gjini dhe djemtë «kryekcyem» (të pabindur), që kishin vënë armët në brez, i ndante ekonomikisht nga shtëpia. Kur në familje kishte mosmarrëveshje të thella bënte pjesëtimin e pasurisë sipas rregullave të njohura: për vëllain tokën e bagëtinë, kurse për gojë, bukën e ushqimet. «I zoti i shtëpisë» vetëm në një rast kishte të drejtë të vriste njërin nga të shtëpisë, «për mik të premë në besë», Sipas krahinave ndryshonin edhe të drejtat e zotit të shtëpisë. Në Mirditë e Bajrakët e Ohrit dënimet qenë më të ashpra se sa në Malësinë e Madhe e Malësi të Gjakovës. Përsa u përket nuseve mjaftonte që ai «t'ia shtinte në vesh të shoqit» fajin, që ta rrihte e për çështje nderi dhe ta vriste. Kur njëra nga nuset «kishte dorë», kryefamiljari kërkonte nga i shoqi që ta «përzente» d.m.th. ta ndante e në qoftë se kjo nuk bëhej, e veçonte çiftin ekonomikisht. Sadoqë autoriteti i babajt, zot shtëpie, ishte më i madh se i një tjetri, nuk ka ndodhur ndonjëherë që ndonjëri nga djemtë «të delte pa hise». Familjet e mëdha, të përbëra prej disa kurorësh, kanë pasur një rregullim të brendshëm të veçantë.

2. Veprimtaria pajtuese (pajtimi) ishte e praktikuar gjërësisht. Për të pajtuar dy shtëpi me marrëdhënie të afërta farefisnore, miqësore, e fqinjësore që «kishin mbet prish» për çështje pasurie, krushqie, etj. «bijnë miq e kumarë». Pra ata që ndërhyjnë për pajtim janë të rrethit familjar të të dy palëve, janë të interesuar. Mjafton të thotë dikush: «për hatrin tim» dhe siç e ka vënë re F. Nopça, kjo formulë në Shqipëri «bën mrekulli si në asnjë vend të botës». Në kësi rastesh nuk kemi ballafaqime, be, dëshmitarë, kapucarë, pleqnarë, pengje, gjoba e dorëzanë. Pajtuësit e të pajtuarët nuk kanë dallim njëri nga tjetri. Ndonëse çdo gjë në rregullimin e çështjes mbështetet në të drejtën dokësore, aty zotëronte dashamirësia, lëshimi i ndërsjelltë në emër të miqësisë, vëllazërisë e të interesit të përbashkët familjar. Buka e pajtimit shtrohej me radhë në të dy familjet e pajtuara, por jo si gjobë, por si shenjë gëzimi e ceremonie, konfirmim vendimi.

3. I afërt me pajtimin paraqitet institucioni i ndërmjetësimit. Ndërmjetësim kishte në ato raste kur dy vetë ose dy palë ishin në prag të një mosmarrëveshjeje ose kur kishte filluar grindja në mes tyre. Ndërmjetësi shkonte pranë dhe ndërhynte: «leni fjalët or juni, jam ndërmjetës un! — Prani pushkën; burra, un jam ndërmjet me ke t'mirremi vesh»²⁵. Me dëshirën e palëve në grindje fjalët ose pushkët pushonin. Me vështirësi ka arritur që ndërmjetësi t'i rregullojë palët. Detyra e tij ka qenë që në momentin e paqës t'u marrë pengjet kundërshtarëve e të mbetet si dorëzanë për ta deri sa pengjet t'i çojë në pleqnarë. Kushdo nuk mund të ishte ndërmjetës. Ai duhet të ishte njeri me autoritet, i njohur për besë e burrëri dhe kryesorja, të gëzonte besimin e atyre që ishin në grindje. Në raste përpjekjesh të armatosura ndërmjetësimi i grave ishte imponues. Ato nuk flitnin, por, kur hynin në mes të zjarrit të pushkëve, për të mos «lënë faqe të zezë», po të përgjakej ndonjëra prej tyre, palët pushonin pushkën. Nuk kishte ndërmjetësim më të fortë se vendosja e djepit me foshnjën në mes të kundërshtarëve. Po përmendim këtu atë të Dulo Man Krajës në shek. e kaluar i cili qëllon mbi kundër-

25) Shtjefen Gjeçov; KLD, 679.

shtarët dhe vrau disa, kur ata, gjendeshin në lundër. Kur malësorja Luke Ujkja nga Kastrati çoi djepin, pushoi pushka²⁶.

Ndërmjetës mund të ishte edhe një kolektiv, lagje, fshat, bajrak etj. «Ndërmjetësimi i çartun» barazohej me kanun me «mikun e premë në besë»²⁷.

* *
*

Ashtu si gjenden të përziera normat e të drejtës penale me ato civile në KLD, po kështu edhe rregullat proceduriale nuk dallohen në mënyrë të qartë nga normat thelbësore (substanciale). Kështu paraqiten dy raste:

1. Fillimi i gjykimit bëhej ose me kërkesën e palës që këmbëngulte për vendosjen e një të drejte që pretendonte se i ishte cënuar ose me kërkesën e të dy palëve ndërgjyqësore. Kur palët në grindje nuk kishin arritur të pajtoheshin më parë, duhej «me ra në pleq», d.m.th, ta shtronin çështjen për gjykim. Secila palë zgjidhte pleqnarët e vet, në çdo vend që të dëshironte, edhe jashtë bajrakut e krahinës. Numri i tyre varej nga rëndësia e çështjes që gjykohej. Zakonisht pleqnarët ishin persona të dalë nga «shtëpi gjyqi», pa ndonjë funksion administrativ shtetëror. Në ndonjë rast për pleqnar mund të merrej edhe ndonjë nga krerët, por gjithnjë ruhej karakteri privat i gjykimit të çështjes. Procesi gjyqësor fillonte kur të dy palët u dorëzonin pleqnarëve pengjet («me shtrure pengun»). Peng jepej çdo send i përdorimit vetiak si: kuti duhani, armë, orë, pip argjendi etj. Dhënia e pengut është shpjeguar nga disa studiues si shprehje e bindjes ndaj vendimit që do të jepej. Kjo nuk të bind përderisa palët ndërgjyqësore kishin të drejtë apelimi. Me anë të pengut shprehej besimi ndaj gjykimit të pleqnarëve, për më tepër ata i bënte përfaqësues të autorizuar të secilës palë. Pengu²⁸ në fund kërkonte shpërblimin e pu-

26) Luke Ujkja po çon djepin,
Aman, se bat gazepin,
Çon malsorja djepin përpjetë:
Ndale Man, pushkën e shkretë,
Ndale Maq, n'mujsh me e ndalue,
Tre ke vra e dy ke varrue....

27) Një njeriu mikpreme KLD i njihte vetëm detyrën e marrjes së gjakut, kurse, po të mbeste mikpreme katundi ose bajraku, masat ishin më të forta e kolektive: «grihej» e shkonte «gjaku hup», i digjej shtëpia e njerëzit e shtëpisë dëboheshin.

28) Ka pasur disa lloj pengjesh:

a) Pengje gjyqësore, që palët ndërgjyqësore ua dorëzonin pleqnarëve: «peng paqi», «pengu i pëlqimit apo i zabukës», «pengu i razisë» etj. Shih Sh. Gjeçov, KLD, § 1017-1033.

b) «Pengjet që kthehen»: 1. me rastin e marrëveshjeve për borxhe e që thirret «peng i dhanë», dhe 2. «peng i ndal» ose «i kapun». Bagtia e gjetun në dëm «ndalet» dhe arma e hajdutit apo e vrasësit që është lënë «kapet» e ruhet me «pengun e paqës». Kthimi bëhet nëpërmjet pleqnarëve, që e kanë edhe si mjet prove të fajësisë.

ç) «Pengje të nxjerr» («peng i ndalun me forcë»), që praktikonte administrata osmane për të siguruar besnikërinë e ndonjë bajraku a krahine. Njihet interesave të larta të lirisë e të nderit.

nës. Po të dorëzohej një herë pengu, edhe në qoftë se pendohej kush, nuk mund të tërhiqej e as nuk kërkohet ndërrim pleqsh. Pleqënarët caktonin vendin ku do të mblidheshin. Gjyqet bëheshin në ndonjë shesh të shënuar të katundit ose të bajrakut, por edhe brenda në banesë. Kur ndonjë palë në grindje kishte njerëz të rrezikshëm, të pabindur, pleqnarët kërkonin që pleqësimi të bëhej në një «shtëpi të fortë», ku askush nuk guxonte të nxirrte armët ose të kërcënonte njeri, se të zotit të shtëpisë i pritej miku. Gjatë zhvillimit të bisedimeve ai rrinte pranë vatrës në vendin e vet pa folur e herë herë u sillte miqve kutinë e duhanit e u piqte kafe. Pleqnarët e secilës anë rrinin përballë njëri-tjetrit duke vënë në krye të vendit atë më të zotin («pa kqyr moshë e fis») që të fliste në emër të shoqëve. Pra dy pleqnarët ishin kryesorët në dialog. Këta loznin edhe rolin e gjykatësit edhe rolin e avokatit mbrojtës për anën që përfaqësonin. Përpara se të fillonin nga puna ishin të detyruar të betoheshin se çështjen do ta gjykonin me drejtësi e paanësi: «Pleqni na keni thirrë me ba e pleqni po bajmë me kanu»... «Si e bajshim ke ju e gjetshim ndër robët tonë»²⁹. Në Dukagjin palët në grindje venin një gurë përpara pleqve e u thoshin: «Mbi mish e mbi shpirt e paçi ket gurë». Në fillim e merrnin fjalën pleqtë e anës ankuese. Në qoftë se akuzat ishin të ndërsjellta fjalën e merrte i pari plaku më me konsideratë nga të dy palët. Kur i akuzuari nuk e pranonte fajin, kërkohet prej tij beja, sepse sipas KLD «mohi ka benë». Nga rëndësia e çështjes që gjykohej varej edhe numri i betarëve. Akuzuesi i shënonte me emër ata që do të betoheshin për pafajsinë e të akuzuarit, mundësisht njerëz sa më të afërm nga rrethi familjar e fqinjësor. Një rëndësi të dorës së parë kishin ata që thirreshin «betarë shahitë» d.m.th. që kishin qenë dëshmitarë të një veprimi ose ngjarjeje që kishin dijeni drejtpërdrejt për çështjen. Në procedurën gjyqësore sipas kanunit nuk ekzistonte dëshmia veçse nëpërmjet besë³⁰. Sipas rrethanaeve, betarët mund të ishin edhe njerëz të largët. Mohuesi, ai që nuk pranonte akuzën, kishte të drejtë «të kthente» (të mos pranonte) deri në dy betarë, të cilët ai mund t'i gjykonte jo si dashamirës ose armiq e t'i zëvendësonte me dy të tjerë. Pleqnarët caktonin ditën, vendin dhe mënyrën se si do të bëhej beja³¹. Për këtë caktohej koha nga tri javë deri në tre muaj. I akuzuari shkonte nëpër shtëpitë e betarëve që t'i vinte në dijeni se ishin caktuar për be, u tregonte se për çka akuzohej, kohën e mënyrën e besë dhe së fundi i luste: «me m'la me be». Betarët mblidheshin e bisedonin herëpashere me njëri-tjetrin rreth ndershmërisë ose fajësisë së tij, për të cilin do të betoheshin. E thërritnin të akuzuarin dhe e pyetnin me hollësi për të gjitha rrethanat që kishin të bënin me çështjen në gjykim dhe së fundi e detyronin të betohej përpara tyre. Në qoftë se edhe

29) Ende sot kanë mbetë në toponomastikë gjurmët e zhvillimit të proceseve gjyqësore. Në krahinën e Postribës dëgjojmë: «Kshtëja e Kuvendit» (Mes), «Lami i Gjyqit (Ura e Shtrejtë), «Tu a' ba Beja» (Domën) etj.

30) Kur dikush ishte thirrë në be për të dëshmuar fjalët që kishte dëgjuar nga një njeri, tashti i vdekur, kapte gurin e varrit të vendosur pingul të koka dhe e ngrinte duke thënë: «me mish e me shpirtë e me hak e me marrë njëjt (këtë) punë e di prej një ti burri njishtu... (Dukagjin). Kjo be-dëshmi konsiderohej e barabartë me benë që do të bënte i vdekuri po të ishte gjallë.

31) Në Dukagjin kësaj i thonë «me da benë».

formal, i jepte rrugë zgjidhjes së pleqnisë⁴². Pasi pleqnarët merrnin provat e nevojshme, fillonte rrahja e mendimeve në lidhje me vendimin që do të merrej. Ata ndonjëherë e zgjatnin procesin, për arsye të vështirësisë që mund të gjenin tek palët në grindje edhe pse ishin që në fillim të një mendje. Shkonin për darkë së bashku «me u ble mendimin» e për t'i parapërgatitur. Kur njeri nga pleqnarët nuk mendonte njësoj si të tjerët, ai vihej në dyshim se mos e bënte këtë për arsye miqësore ose pse «ishte i thyem me rushat». Në këtë rast bashkëgjyqtarët e ftonin të merrte përgjegjësinë për mënyrën e vet të gjykimit, duke i thënë: «kape gurin». Po qe se ai ishte me anësi, nuk mund ta prekte. Kur të gjithë pleqnarët e preknin gurin jepej gjykimi përfundimtar.

Këto lloj gjykatash nuk kishin të drejta për të dhënë dënime të asnjë lloji, veçse caktonin masën e dëmshpërblimit në disa raste vjedhesh, dëmsh e gjaqesh. Vendimin e bënte të njohur njëri nga pleqnarët e në qoftë se të dy palët shpreheshin: «sa qofshi pleqnofshi», çështja gjente zgjidhje. Shumë herë vendimi i një pleqnie është shkruar. Në një vendim të tillë të marrë në Has më 22 prill 1896, ankuesi mbas vendimit të bërë lëshon një «ispatname» (dëshmi) se hiqte dorë nga kërkesa e tij. Këtë dokument e firmosën edhe dymbëdhjetë betarët. Në qoftë se pleqnia kishte mbetur pa u përfunduar për shkak të mosmarrëveshjeve në mes të pleqnarëve, çështja kalonte në «pleq të dytë», të cilët merrnin shpërblimin e caktuar për të parët. Përpara se të jepeshin pengjet, ishte bërë «pazarllëku» për «opangët» e pleqnarëve, gjë që varej nga rëndësia e çështjes në gjykim⁴³. PAGESA bëhej nga palët ndërgjyqësore⁴⁴. Pas kësaj pleqnarët u kthenin pengjet të zotërve. Mirëpo mjaft të varfër nuk ishin në gjendje të paguanin menjëherë prandaj vinin një dorëzanës. Kur shpërblimi bëhej gati, u jepej pleqnarëve nëpërmjet dorëzanësve e po nëpërmjet këtyre kthehej pengju.

Dorëzania njihej prej shumë kohësh në vendin tonë. Në veprimtarinë administrative e shohim të praktikuar nën sundimin e Bushatlinjve. Në një rast, kur Mehmet Pashë Plaku (Bushatliu) shkoi në fshatin Barbullush, i detyroi banorët të bëhen dorëzanës për njeri-tjetrin dhe kjo u regjistrua në librin e dorëzanisë⁴⁵. Në Kanunin e Xhibalit është shënuar se të

42) «Ni pasanik e kishte ni gjak të moçëm. I ka gjetë dy mohaxhi shejtarë t'mirë me ja vra hasmin dhe u ka premtue «Kush e vret i ka treqin lira». Hasmin e kish pasë të fortë. Duelën të dy m'ni pritë, m'ni ven. Edhe pushkët i kishin nisoj. Të dy qitën përnihërë. E vranë hasmin e pasanikut. Kur e kqyrën, i dekni kish pas sall ni varrë. Secili dojke me i marrë paret për vete. S'mujtëm m'u pajtue kurrqysh nërmje veti. E qitën punën në pleqni.

Plaku shka bani? E muer ni pe e shkoi n'ven ku ish arra. E hodhi penin nalt n'mi dru dhe e lëshoi poshtë. N'funn t'konopit e vuni ni gur. Kta dy mohaxhitë i çoi n'ven prej kah e kishinq gjeujt hasmin e pasanikut me qeto pushkë e u tha me gjeujt me ren njoni mas tjetrit.

Gjuejti i pari e s'un ja qilloi penit. Kur gjuajti i dyti e kputi penin: Plaku i tha:

— Ty t'binë paret se je shejtar. «Edhe qeshtu met». (Anton Çetta, *Prozë popullore nga Drenica*, Prishtinë, 1972, f. 245).

43) Sh. Gjeçov, *KLD*, § 1028.

44) Sh. Gjeçov, *KLD*, § 1027.

45) S.N.Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatlijve (1757-1796)*, Tiranë, 1964, f. 257. Edhe kisha katolike për çdo famulli ka kërkuar dorëzanë, «dorëzanët e kishës».

dyshimtët do të linin dorëzanës dhe, në qoftë se fajtori nuk i përgjigjej thirrjes për t'u paraqitur mbahej i burgosur dorëzanësi, deri sa i kërkuari të kapej ose të dorëzohej.

Edhe në marrëdhëniet familjare, pronësore, tregtare etj. dorëzania luante rol me rëndësi. Huatë⁴⁶, që përbënin një farë shume si dhe likuidimet me rastin e blerjeve të tokave, kërkonin medoemos dorëzanës, të cilët do të përgjigjeshin në mbarim të kohës së caktuar⁴⁷. Këta dorëzanës ishin betarë të klasit të parë në pleqni.

Në procedurën gjyqësore dorëzanët ishin një element sigurie⁴⁸, prandaj në vendimet e shkruara të ndonjë pleqësie shënoheshin edhe emrat e dorëzanëve⁴⁹.

Ishte edhe një lloj gjykate që formohej me pleqnarë të rekomanduar nga autoritetet e bajrakut, por domosdo të pranuar nga palët në grindje, kur njëra nuk i përgjigjej tjetrës në pleqësi, ose kur të dy palët për njëherë shkonin e paraqitnin ankesën te bajraktari. Bajraktari caktonte mënyrën se si do të bëhej beja. Në këto raste, ai që nuk dëgjonte të dorëzonte pengun, deklaronte «mos ju kjoftsha falë». Ky proces kishte të njëjtën ecure si e kemi shtjelluar më sipër, porse zhvillimi i tij mbikqyrej nga bajraktari. Ky ose një zëvendës i tij ishte i pranishëm për të «pa benë». Në qoftë se betarët nuk ishin të bindur, shkonin e deklaroin: «na filanin e kemi lanë mbrendë», «nuk mund ta lamë me be» etj.

2. *Fillimi i gjykimit për çështjet që ndiqeshin kryesisht me iniciativën e bajraktarit e të krerëve e pa kërkesën e asnjërës palë.* Këto gjykata kryesoheshin nga funksionarë të administratës e merreshin me gjykimin e fajeve, që u binin ndesh zakoneve të vendit, vendimeve të marra në kuvende, për faje politike dhe gjykimin e çështjeve të palëve në grindje që kishin rëndësi shoqërore. Karakteri i detyruar shihet se në këto gjyqe nuk jepeshin pengje, pleqnarët nuk zgjidheshin, nuk paguhehin, por shpërbleheshin nga pjesa që i përkiste në gjobat, që u merreshin fajtorëve dhe nuk bënin be kur fillonte procesi gjyqësor përpara të pandehurit ose palëve në grindje. Këtu roli i kapucarit ishte më i madh dhe shpërblehej nga gjoba që merrnin.

Për zbatimin e dënimeve si vjelje gjobash e konfiskime pasurie emëroheshin gjobarët, që janë përcaktuar si një organ administrativ-ekzekutiv, për çdo vëllazëri ose bark prej 5-10 shtëpish. Bajraku i Bogës kishte 9 gjobarë, 5 në lagjen Kolaj e 4 në Gjokaj, kurse në Junik kishte nga një gjobar për lagje⁵⁰. Kush kundërshtonte ose pengonte gjobarët në zbatimin e detyrës dënohej⁵¹. Prania e tij ishte e domosdoshme në cilëndo shka-

46) Sh. Gjeçov, *KLD*, § 683-694.

47) «Dorëzanë — dërëdhanë» (populli).

48) Shih: Sh. Gjeçov, *KLD*, dorëzanët e gjakut § 973-976, dorëzanët e të hollave të gjakut» § 977-981.

49) Sh. Gjeçov, *KLD*, f. 126; Nikolla Aschata. *Das Gewohnheitsrecht der stame Mi-Schkodrak (oberskutarinere stämme) in den Gebirgen nördlich von Skutari*, «Illyrisch-albanische Forschungen», München und Leipzig 1916, f. 18. Në një vendim që morën krerët e Hotit më 15 maj 1872 caktohen 250 grosh gjobë për atë që nuk pranonte pleqnarët e caktuar.

50) S. Shkurti, *Material nga ekspedita etnografike në Kosovë më 1979*. (Arkivi etnografik, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë), f. 1.

51) Shih *KLD*, § 1171-1175 dhe f. 124-125.

detyrë të përgatitej për pritjen e zabitnames, që së bashku me djemtë që i shoqëronin, përbënin, një çetë jo të vogël njerëzish me shpenzime të rënda për fshatarët. Për këtë në Pukë bënin «konak» dhe në Mirditë «razogjt» ishin «dy hae bukë», që i kishte të detyrueshme çdo shtëpi në katundin ku vepronte zabitnamja. Kjo gjykatë në Pukë ka vazhduar deri më 1912, zabitnamen e fundit e ka kryesuar Mustafë agë Kryeziu, në Mirditë, ka vazhduar me ndërprerje deri më 1920. Zabitnamja gjykante me KLD. Si nga shpërblimet për pleqësitë e bëra, ashtu edhe për gjobat e vëna kryetarët e zabitnames merrnin gjysmën e shumës, kurse të tjerët ndanin atë që mbetej. Vendimet e kësaj gjykate ishin të paapelueshme.

Pajtimi i detyruar i gjaqeve. Njihën disa mënyra e mjete për pajtimin e gjaqeve: 1) me ndërhyrjen e miqve e me pleqnarë, 2) me gjyqin e krenave e të bajrakut, 3) me kuvend, kur i gjithë populli ndodhej përpara ngjarjesh që kërkonin bashkim. Zakonisht pajtimi i gjaqeve ndërmerrej çdo pesë vjet. Bylykbashët e Malësisë së Shkodrës shkonin secili në bajrakun që kishin në varësi të shoqëruar nga një sekretar e disa zaptije. Pajtimi bëhej sidomos në prag të luftrave, kur qeveria osmanë⁶² kishte nevojë të madhe për forcat ushtarake të bajrakut dhe për të holla. Në Malësi «delte zani» «erdhi paqi prej zabiti»⁶³. Bylykbashi, kryesonte gjykatën, anëtarë të së cilës ishin: bajraktari, krerët e gjobarët. Vendimet e pajtimit bëheshin me shkrim në dy kopje, njëra i jepej dorasit e tjetra depozitohej në zyrën e Xhibalit në Shkodër. Pajtimi qe me afat prej pesë vjetësh dhe për këtë hynin dorëzanë nga fshati. Bylykbashi, shoqëruesit e tij dhe krerët mbaheshin me shpenzimet e fshatit që ndaheshin «për shpi». Për pajtim të dy palët paguanin përgjysmë 250 groshë, që i ndanin krerët në mes tyre, kurse bylykbashi merrte të holla sa një bajraktar. Përveç kësaj fajtori paguante 150 groshë gjobë për vrasje e 75 groshë për plagosje, që i merrte bylykbashi⁶⁴.

Në viset e Kosovës, me dhënien e urdhrin për pajtim gjaqesh, krijohej një komision i përbërë nga funksionarë, krenë, pleqnarë etj., që thirrej islihat⁶⁵.

— Shpejt me u shkruie islihati
islihati sa shpejt u shkruie:
Me dalë gjakat me i pajtue,
Reka besë gjashtë muej ka vnuie.

Në qytetin e Shkodrës ky komision u njoh me emrin «muslihunë»⁶⁶ dhe akti i pajtimit legalizohej nga gjyqi i sherisë, të cilin e kryesonte

62) Ky lloj pajtimi linte shteg hakmarrjeje deri sa në kanunin e njohur nga qeveria pranohej që «në qoftë se dikush mbas pajtimit vret atë që e fali, të afërmit e tij janë të lirë të hakmerren e nuk pësojnë asnjë dënim nga bajraku e qeveria». Paragrafi 6 i kanunit, të dhëna nga Sokol Baçi i Grudës.

63) «Dita e paqit» thirrej dita kur bëhej pajtimi.

64) *Das Recht der Stamme von Dukadschin*, «Illyrisch-Albanische forschung», 1916, f. 397.

65) Islihati njihet që nga vitet 1861-1865 (S. Pupovci, *Betimi dhe betarët në të drejtën zakonore shqiptare*, «Gjurmime Albanologjike — folklor dhe etnografi», VI-1976, Prishtinë, 1978, f. 123. Në komisionin e islihatit kanë marrë pjesë edhe figura të njohura si Haxhi Zeka e Isa Boletini.

66) Fjalë arabe e hyrë tek ne nga turqishtja me kuptimin paqtues.

kadiu. Shumë vëzhgues të kohës kanë shkruar se kjo mënyrë pajtimi me imponim nuk ka qenë e dashur për shqiptarin e se këta gjithnjë e kanë çmuar e nuk i kanë prishur pajtimet me miq e pleqnarë. Pushteti osman donte në këtë mënyrë të ndikonte në të drejtën zakonore.

Kuvendet e popullit në bajrak ose krahinë, të mbledhur «burrë për shpi» shndërroheshin edhe në gjykata. Kjo bëhej në raste të jashtëzakonshme për çështje që tronditnin jetën e doket e mbarë popullit, për konflikte kufijsh e kullotash në mes bajrakësh etj. Ndonëse mblidhej i tërë populli, gjykata formohej nga pleqtë e bajraku⁶⁷ me bajraktarin në krye. Vendimi i marrë paraqitej përpara burrave të mbledhur e zakonisht miratohej. Kur kishte grindje e përpjekje ndërmjet bajrakësh të ndryshëm mblidhej kuvendi krahinor⁶⁸ dhe gjykonte çështjen.

Pleqësimet për çështje të ndryshme në mes të bajrakëve bëheshin në kufinj. Kështu Shala nxirrte pleqnarët te «Podi i bajraktarit» në kufi të Nikaj, te «Rrethi i Qershisë» me Nikç, te «Qafa e t'Thores» me Shkrel, në Rrogam me Krasniqe.

Kuvendi «burrë për shpi» i krahinës ose i bajrakut kishte rolin e një gjykate të lartë, vendimet e tij nuk mund t'i prishte asnjë autoritet shtetror.

«Gjyqe të preme» quheshin disa vendime që ishin marrë në kuvende për disa raste të parashikuara. Në Dukagjin përdorej termi «me ba ixhra» (me vu në zbatim). Kështu me rastin e ndonjë vrasjeje, vrasësi paguante 4 qese e 200 groshë (2200 groshë). Nga kjo shumë 1000 groshë i merrte qeveria, 1000 bajraktari e 200 bylykbashi me zaptie, kurse në Mirditë kapidani merrte 500 groshë për çdo vrasje. Kur gjatë grindjeve për kufinj vritej dikush në tokën që më parë nuk i përkiste, aty vihej kufiri i ri. Ky thirrej «kufiri i fituem me gjak», që i jepej si shpërblim për gjakun e bërë anës së dëmtuar. Zakonisht pretenduesi vritej në tokën e pretenduar. Ndonjëherë ky paragraf i kanunit nuk është kuptuar drejt. Pasi bëhej pajtimi, ana e dëmtuar zgjeronte tokën deri në vendin e vrasjes dhe në anën tjetër hiqte dorë nga gjakmarrja.

*

* *

Disa autorë të huaj që janë marrë me studimin e së drejtës kanunore shqiptare e kanë mohuar karakterin klasor të pleqësisë, të procedurës dhe të gjykatave, duke e marrë KLD si pasqyrim i vullnetit të gjithë popullit⁶⁹. Mirëpo dihet si përmbajtja klasore e normave të KLD, ashtu edhe fakti se gjykatat e formuara nga krerët ishin në ndikimin e organeve

67) Në bajrakët e Kastratit, Trieshit e Shalës kjo gjykatë përbëhej nga 24 pleq. në Berishë 12.

68) Kur vepronte gjykata ndërkrahinore, në Shkodër përdorej shprehja «bijshin malet e na pajtojshin».

69) I. Elezi, *E drejta zakonore penale e shqiptarëve*, Tiranë, 1983, f. 92; K. Novava, *Zhvillimi historik i gjyqimit në Shqipëri*, «Referate e kumtesa» Tiranë, 1965, f. 45.

qeveritare. Krerët e zgjedhur për pleqnarë paguheshin nga 10 groshë secili kurse pleqnarët e thjeshtë nga 5 groshë. Edhe në vetë gjirin e pleqnarëve ishin thelluar ndryshimet ekonomiko-shoqërore⁷⁰. Ankesat e popullit për pleqësitë e për pleqnarët ishin të vjetra⁷¹. I pasuri zakonisht merrte një «pleqnar në za» dhe e paguante mirë, kurse dorëholli një pleqnar të zakonshëm, që nuk kushtonte. Familjet e pasura e me ndikim gjithnjë e më tepër kërkonin t'u shmangeshin pleqësimeve në vend e çështjet t'i zgjidhnin nëpërmjet gjyqit të Xhibalit, përkrahjen e të cilit e siguronin më lehtë⁷². Edhe në institucionin e besë shihet pabarazia shoqërore. Kapidani i Mirditës dhe një plak i madh konsideroheshin secili të barabartë me 12 betarë. Njihej si gjë e zakonshme «shkelja» e pleqnarëve me ryshfet sa u bë e njohur thënia: «groshi ban gjyqin». Për disa pleqnarë pleqësimet ishin burim të ardhurash, prandaj nuk shtyheshin në zgjidhjen përfundimtare të ngatrrësive në mes të palëve ndër gjyqësore, e bënë «pleqni me shteg», d.m.th. çështja të mbetej për një kohë të gjatë e hapur. Në Malësi të Madhe populli vinte në gojën e pleqnarëve të tilla shprehje: «gurin që ka xanë rrugën mos e hedh poshtë nën rrugë, veç sa largoje». Duket se kishte aq arbitraritet në vënien e gjobave, sa në vendimet e marra më 1892 në bajrakun e Kastratit shënohet «kush të gjobisë kend pa e ba kuvendisht e nji zani, ka për të la 1000 groshë e 10 deshë»⁷³. Megjithëse sipas kanunit nuk bëhej vrasje për faj, ishin pleqësimet e padrejta që shtonin rastet e vetëgjyqësisë e deri përdorimin edhe të mjeteve të egra⁷⁴. Këtyre kushteve u përgjigjet shprehja «lum i forti» e i forti nuk ishte një trim i çartun ose një kapadai, siç e paraqitën disa studiues, por ishte elementi që gëzonte një pozitë të rëndësishme ekonomike e shoqërore. Në Malësi të Gjakovës njerëz të fuqishëm, kur merrnin vesh për pleqësimin e disfavorshëm të bërë nga pleqnarë të një shtrese të ulët, qitnin pushkë e dilte zani: «N.N. e ka vra pleqninë». Pleqsimi kursesi nuk mund t'u vritej krerëve se përndryshe paguhej me kokë ose me djegien e shtëpisë. Për gjyqin e Xhibalit shtypi i kohës paraqiste ankesën e malësorëve «se asht ba shportë e pafund e asgjë pa ru-

70) Në Kosovë tregojnë se pleqnari në za Xhemal Obrija, kur e njohu se Deli Gashi ishte aq i mençur e pyeti se pse të tjerët nuk kërkonin mendimin e tij. Ai u përgjigj: «nuk shkojnë fjalët e mija se jam i hollë prej takati» (d.m.th. nuk jam në gjendje të mirë ekonomike), A. Çetta, *vep. e cit.*, f. 167.

71) Më 1771 malësorët ankoheshin «nuk kemi gjykatës të cilëve mund t'i drejtohem», «*Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëllimi III, Tiranë, 1962, f. 227.

72) Hani ka vënë re se, në qoftë se i akuzuari ishte një i pasur me rëndësi padia e akuzuesit përcillej te pasha në Shkodër dhe me anë të bylykbashit me shkresë lajmërohej caktimi i pleqnarëve, I. Hahn, *vep. e cit.* f. 179.

73) Sh. Gjeçov, *KLD*, f. 125

74) Shih *Mbledhës të hershëm të folklorit*, vëllimi III, Tiranë, 1962, f. 331.

shat e pa hatër nuk pleqnohet»⁷⁵. Pat edhe raste revoltash. Më 1878 një fshatar nga bajraku i Merturit për një pleqësim të padrejtë vrau bajraktarin. Ankime të shumta kishte edhe për Gjomarkajt e bajraktarët në Mirditë, të cilët kur paraqitej interesi, vepronin jashtë normave të KLD. Më 1846 Bibë Doba vrau një mirditas që falcifikonte monedha turke. Sipas zakonisht të vendit dy vëllezërit e të vrrarit shtinë mbi kapidanin dhe e plagosën. Atëherë B. Doda «me qëllim që në të ardhmen të mbetet kujtim i një terrori shembullor, mblodhi një kuvend të madh të krerëve dhe u vendos, që të gjithë pronat e farefisit të më të afërmeve të dy vëllezërve të konfiskoheshin, kurse shtëpitë e tyre të digjeshin»⁷⁶. Ky vendim u zbatua. Veprime arbitrare kanë treguar edhe ndaj pleqnarëve.

Edhe mbas shpalljes së Pavarësisë kombëtare e me krijimin e Shtetit Shqiptar e të organeve të drejtësisë në trevën e bajrakut, rregullimi i çështjeve civile mbeti në dorën e pleqnarëve, që gjykonin sipas KLD. Kjo ndodhi për dy arsye: e para nga toleranca e vetë organeve qeveritare, pse bajraktarët e krerët ishin mbështetja kryesore shoqërore e regjimit të Zogut dhe së dyti, marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore të trevës së bajrakut kishin ndryshuar fare pak nga ato të viteve para 1912. Gjatë kohës së pushtimit fashist (1939-1944) u ringjallën për së tepërmi rastet e vetgjyqësisë, të nxitura me qëllim që të përçanin sa më shumë malësorët me njëri tjetrin. Vetëm gjatë Luftës Antifashiste Nacional-çlirimtare filloi të çimentohej bashkimi i popullit mbi një bazë të re ideologjike e klasore, duke përjashtuar mënyrat negative tradicionale. Pajtimi i gjaqeve u bë nga njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare jo sipas KLD me shpërblime e dorëzanës dhe rastet ekstreme u gjykuan nga gjyqet partizane. Mbas Çlirimit të vendit në kushtet e reja politike dhe ekonomiko-shoqërore që u krijuan u zhduk çdo veprimtari e pleqnarëve dhe normat e KLD në tërësi u luftuan si mbeturina që pengonin ndërtimin e jetës së re në malësi.

75) «Ma tepër njerzit që do të kqyrshin këto punë (drejtësinë K. U.) ishin njerëz ndihmozot, njerz të shitun që me një bakshish nën dorë i jepshin kanunin vështrimin që dojshin vetë, pshtojshin batakçinjtë e fikshin të pafajin. Ixhreja e fyne ishte fitimi i kuletës». (Gazeta Bashkimi», 13 nëntor 1910) Bylykbashët për «nji dash e shesin gjygin» (N.H., Përmbi Qazim Pashën, «Albania» nr. 7, 1900, f. 130).

76) Historiski Arkiv Zadr, Presidialni Spisi X mikrofilm në Arkivin e I. të Historisë në Tiranë.

THE ACTIVITY OF ELDERS AND OPERATION OF CANONS IN THE
INSTITUTION OF BAJRAK

The institution of bajrak, set up by the end of the 17th century, was a specific type of administrative regional organization which carried out functions of a military court.

The article included in this book deals with the activity, of elders and operation of canons of this institution which in the territory of bajrak appears more complete and documented than in the other regions of our country. The study of this activity is of importance also in the drafting of the history of the Albanian state and law.

The activity of elders and the institution of bajrak, in the territory where this institution operated, endured until the eve of Liberation. With the liberation of the contry and the establishment of the people stete power, the last hangovers of this institution ceased to function.

Koço NOVA

MBI PJESËN E PASISTEMUAR TË DORËSHKRIMEVE TË REJA TË GJEÇOVIT PËR KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT

I

Në pjesën e parë të dorëshkrimeve të Gjeçovit që ruhej nga sh. Emid Tedeskini, ndodheshin ndryshimet dhe plotësimet e paragrafëve konkrete që autori iu bënte normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit të shkruara prej tij dhe botuar fillimisht pjesë-pjesë gjatë viteve 1913 e vijues në të përkohshmen franceskane¹. Gjithashtu në këtë pjesë të përpunuar të dorëshkrimeve të tij autori kishte vendosur disa shtesa lidhur me institute të patrajtuar në botimet e sipërme siç janë: «nusja në pjakje», «gruaja me shtat të xanë», «martesa me fjalë», «martesa me barrë të vrame», «gruaja e dhunueme» etj.

Në pjesën e dytë të këtyre dorëshkrimeve, që përbëjnë gati dy të tretat e tyre, janë vendosur një numër jo i pakët normash kanunore (178 të tilla) si dhe disa vërejtje («oroe») e konsiderata të tjera të vetë autorit apo të ndonjë tjetri, por të kopjuara prej tij, që bëjnë fjalë për institutet më të ndryshme të Kanunit, të cilat autori nuk arriti t'i sistemojë në vendin përkatës e t'i krahasojë me të parat.

Ne po i botojmë shumicën e këtyre normave duke u orvatur t'i sistemojmë ato sipas përmbajtjes e t'i radhitim në librat apo pjesët përkatëse të botimit postum të Kanunit², pavarësisht nga radha e vendosjes e trajtimit të tyre. që siç e kemi thënë nuk ndjek plotësisht kriteret e duhura juridike e metodologjike. Me këtë ne përpiqemi të vëmë në jetë një nga

1) Konkretisht në numrat e viteve 1913, 1921, 1922, 1923, 1924 dhe madje 1930.

2) «Kanuni i Lekë Dukagjinit» (vepër postume) Shkodër 1933, është ndarë në 12 libra, të cilat janë ndarë në 23 krerë, dy artikuj, 159 nyje dhe 1263 paragrafe. Disa nyje nuk ndahen fare në paragrafe, ndërsa mjaft paragrafe pjesëtohen në pika të veçanta sipas gërmave të alfabetit. Lënda që trajtohet në këto ndarje e ndarje shpesh përfshin norma të degëve të ndryshme të së drejtës.

porositë kryesore që dha shoku Enver Hoxha vitin e kaluar duke folur për shkencat që merren me historinë, gjuhën dhe kulturën e popullit tonë, që të bëhet një analizë e thellë shkencore e ligjeve dhe zakoneve që kanë genë në fuqi në vendin tonë gjatë shekujve.

Nga përmbajtja e këtyre normave të reja të pabotuara të Gjeçovit, të bie në sy në radhë të parë një prirje e theksuar për të ndriçuar më qartë e shprehur më drejtpërdrejt e në mënyrë më sintetike e të përgjithësuar disa institute kanunore që vetëm tërthorazi e jo të plota dalin nga Kanuni i botuar.

Mënyra koncize e formulimi i qartë e padykuptime i këtyre normave të dorëshkrimeve ve pikat mbi «i» mbi disa probleme të diskutueshme që kishin një trajtim disi kontradiktor në botimin e parë si ato lidhur me pozitën e gruas, atë të zotit të shtëpisë dhe marrëdhëniet me gjinden e shtëpisë, të drejtat dhe detyrimet e tyre, tagrat e kuvendeve e të pleqve, përgjegjësia penale e civile, procedura e gjykimit etj. Gjithashtu në këto dorëshkrime vërehet edhe kujdesi i autorit të vejë në dukje edhe karakteristikat lokale të disa normave si dhe datën e vendin e shënimeve të marra.

Këto norma nga më të larmishmet mbi institute të Kanunit që ishin trajtuar fillimisht, shpjegojnë se Gjeçovi e ka quajtur të domosdoshme nevojën e këtyre plotësimeve e retusheve të normave kanunore.

Nga letërkëmbimi i Gjeçovit me kryeredaktorin e së përkohshmes franceskane që ndodhet në Arkivin e Shtetit del edhe se atij i kërkohe-shin me ngut e këmbëngulje pjesët vijuese të Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke i vënë në dukje, qoftë edhe tërthorazi, se pikërisht këto norma ishin pjesa më e kërkuar dhe më e lexuar e së përkohshmes³, në një kohë kur ishte në lojë fati i popullit shqiptar që kishte ngritur tanimë flamurin e pavarësisë në Vlorë pas kryengritieve të armatosura të fillimit të dhietëvjeçarit të dytë të këtij shekulli dhe protestonte kundër padrejtësisë së hapur që i bënë fuqitë e mëdha që cunguan territorin e tij me kufijt e 1913-ës.

Dihet se në miaft norma të Kanunit, me gjithë notat e theksuara anakronike, të kushtëzuara nga marrëdhëniet ekonomike shoqërore përkatese, shprehet qartë vitaliteti i popullit shqiptar, shpirti i tij i panësh-truar e luftarak, aftësitë e tij vetëqeverisëse dhe vetitë e larta morale. Por njerëzit e «Hyllit të Dritës», duke vënë në pah në mënyrë të një-anshme institutet patriarkore e konservatore të Kanunit, ndiqnin qëlli-

3) «Dorëshkrimi yt ka më i dhanë një randësi të madhe të përkohshmes» — thuhet në letrën dt. 14.XI.1913 të Kryeredaktorit drejtuar Gjeçovit. «Po çoj këtë nieri me marrë e me prue dorëshkrimet e Kanunit» vijon kryeredaktori në letrën dt. 5.V.1913... «Kësaj here Kanuni ka kenë fort i interesantshëm... «Çall-tisë e na ç'o ose më mirë na bjen vetë dorëshkrimet për numër të frurit e mundou me qitë sende sa ma t'interesantshme, thuhet në një letër tjetër. «Me këtë numër t'marcit mbaron dorëshkrimi i Kanunit, vazhdon letra vijuese: t'lutena pra qi ta gatosh vijimin për muej t'Prillit... Dhe më në fund: «... Aman baj gjaret e m'i co edhe pak dorëshkrime t'Kanunit pse janë fort t'interesantshme ... Mndyra e palejueshme me t'cillen asht tuj u prue D.N.Nikaj n'botim t'Hyllit Dritës po na ngushton me t'porositë qi t'bajsh si t'mundesh e t'ua çojsh dorëshkrimin për 15 ditët t'majit». (Ark. i Shtetit, fondi Sh. Gjeçov, Dosja 95/47 dt. 1905-1926).

min regresiv e obskurantist për të përjetësuar shfrytëzimin patriarkor feudal të malësorëve. Në këtë drejtim flasin ndër të tjera edhe ditirambet e Fishtës dhe klerit katolik për të hyjnizuar Shqipërinë e Kanunit si model të organizimit shoqëror e shtetëror të vendit tonë. Këtë e dëshmuuan edhe orvatjet e këtyre qarqeve për të vënë në krye të Shqipërisë që sapo shpalli pavarësinë, figura feudalësh reaksionarë. Prandaj ata e pritën me bujë e zhurmë të madhe Prenk Bib Dodën, kur u kthye nga syrgjyni i Sulltanit, i transportuar nga një luftanije italiane gjë, që ndeshi në qëndresën e njëzëshme të masave të popullit dhe të opinionit përparimtar të asaj kohe.

Duke u nisur nga metodologjia dialektike marksiste-leniniste, ne bëjmë qartë dallimin ndërmjet synimeve regresive të këtyre qarqeve dhe përpjekjeve të gjithëanshme të Gjeçovit, këtij punëtori të palodhur patriot, që megjithëse klerik, u është kundërvënë synimevet të sipërme të qarqeve reaksionare⁴; ai shkriu gjithë jetën e tij duke u përpjekur pa iu trembur presioneve e shantazheve për të gërmuar, grumbulluar e saktësuar zakonet e vendit tonë, që janë dëshmi e pamohueshme e kulturës sonë të lashtë popullore, si dhe e shpirtit patriotik e liridashës të popullit shqiptar, traditat e të cilit kanë qënë e do të jenë gjithmonë frymëzuese për brezat e ardhshëm.

Për të siguruar arritje sa më të mira në këtë punë të vështirë e fisnike Gjeçovi përdorte mënyra të ndryshme, takohej vetë me pleq të njohur, u shkruante kolegëve të tij meshtarë në famullitë e ndryshme, kontrollonte e rishikonte të dhënat e mëparshme etj.⁵

Përmbajtja e dorëshkrimeve të Gjeçovit dëshmon qartë se ai ka patur parasysht të bënte një plotësim e riformulim të Kanunit të botuar në mënyrë disi të ngutur në të përkohshmen franceskane. Vrasja e tij e pabesë nga shovinistët serbë nuk e lejoi që këtë plotësim e riformulim ta çojë në krye, me gjithë materialin e rëndësishëm bruto të grumbulluar prej tij. Prandaj zbulimi e përjetësimi i këtyre normave të dorëshkrimit të grumbulluara për një kohë të gjatë sidomos në dhjetëvjeçarin e

4) Është për t'u përmendur si dëshmi e pikëpamjeve të ndryshme politiko-shoqërore të Gjeçovit në krahasim me politikën e qarqeve reaksionare të vendit, letra që ai i ka drejtuar më 28 kalinduer 1922 Fan Nolit, Kreut të opozitës të qeverisë reaksionare çifligaro-borgjeze të Zogut me shokë të cilët mbështeteshin e pikërisht në forcën e bajraktarëve dhe feudalëve si Gjon Markagjoni. Në letërën e përgjigjes që i bën Gjeçovit më 18 shkurt 1922 Fan Noli e falenderon për fjalët e mira që i ka drejtuar me atë letër (Arkiv i Shtetit-Gjeçov, Dosia nr. 95/27).

5) Në një letër që i drejton p.sh. Prend Sullit dhe që ndodhet në bibliotekën e Shkodrës (pa datë) ai i ka shënuar rastet e veprave të dënueshme duke i kërkuar për secilin rast numërin e poronikëve ose betarëve që duhen për shfajësimin e tyre si dhe gjobat dhe ndëshkimet e tjerë që parashikon kanuni. Të gjitha këto o Prend i dashtun — shkruan Gjeçovi, m'i shenjo si t'jet Kanuja, si kahë ata qi bin n'gjobë sa u shkon për faje t'përmenduna n't'shmajten X edhe sa e për ç'faj merr e larta, der e Gjomarkut gjobë... Mos u baftë zanni kush me ardhë ktu te une për qëllim qi t'thashë në letër m'ban me dije se kam me t'i shkruet ty t'pvetunat qi i përkasin Kanus e ti ke me pyetun atje e ndoj t'mençëm e mandej «questionas resolutas» ke me pas mirësin me m'i çue tek unë.

parë e të dytë të këtij shekulli është një thesar i vërtetë i kulturës sonë popullore.

Megjithëse të pasistemuara si pjesa e parë e këtyre dorëshkrimeve që përmendëm në një vend tjetër, ato kanë një vlerë të madhe njohëse e krahasuese dhe do të zënë një vend të rëndësishëm në Korpusin e së drejtës Kanunore të popullit shqiptar. Botimi i tyre kompleks në kontekstin e shkrimeve të tjera të Gjeçovit me temë zakonore është jo vetëm zbatimi i porosisë së Partisë dhe mësimëve të shokut Enver, por në të njëjtën kohë edhe vënia në jetë e ëndrrës së Gjeçovit, që gjithë jetën e tij e shkriu për studimin e etnografisë së popullit shqiptar dhe sidomos për përjetësimin e kanunit (në kuptimin: «monument kulturor») si pjesë qenësore të saj⁶.

Në vlerësimin e këtyre dorëshkrimeve plotësuese të Gjeçovit nuk duhet lënë pa përmendur edhe ndikimi në botimin fillestar e në atë postum i klerikëve intelektualë që në kanun të futet edhe ndonjë formulim skolastik e libresk, apo ndonjë përkufizim i kërkuar e i gjetur në literaturën juridike-teorike të asaj kohe, që largohet nga mendimi i drejtpërdrejtë i popullit⁷. I tillë është për shembull, përkufizimi i familjes, që Gjeçovi, jo pa ndikimin e sipërm e ka marrë nga Abate Felice («Filosofia del diritto») dhe disa përkufizime të tjera⁸.

Sikurse dihet, populli nuk bën përkufizime, por ai ka krijuar gjatë shekujve disa aforizma e fjalë të urta, të limuara nga përdorimi i gjatë tradicional dhe të formuluar, në mënyrë lakonike e metaforike, të cilat përbëjnë sentenca të vërteta të mendimit popullor.

Në dorëshkrimet e Gjeçovit, që kemi gjetur në bibliotekën e në muzeun e Shkodrës «Kanuni i Malevet» dhe sidomos «Kokrra Kanujet». ashtu dhe në dorëshkrimet që po analizojmë në këto rreshta shohim mjaft sentenca të tilla popullore ku spikat mendimi i mirëfilltë burimor, të cilat zëvendësojnë denjësisht frazat e krijuara nga ndikimet e sipërme apo ndarjet e stërholluara të normave në pika e gërma të alfabetit. Këto u kanë dhënë tonin në përgjithësi dorëshkrimeve të bëra objekt studimi. Prandaj, për sa i përket ndërtimit, karakteristikë e rregullave që përmbajnë këto dorëshkrime është se ato janë më përmbledhëse, kanë një ndërtim më të thjeshtë, me fraza që shprehin në mënyrë treguese e të drejtpërdrejtë mendimin, siç e ka zakon të flasë populli. Kështu që ato kanë ndonjë herë edhe karakter dialogu, me pyetje përgjigje, janë ndërtuar në vetën e parë e të dytë të njëjësit, apo mbajnë me vete disa

6) «E dij se ideali yt, i thotë Gjeçovit një koleg i tij, a kenë e ka me kenë ethnografia e popullit shqiptar». (Ark. i Sht. dosja 35/74 dt. 2.4.1923.)

7) Dorëshkrimi yt m'asht pëlqye, i thotë Gj. Fishta Gjeçovit, por për me i dhanë *nji trajtë dijetare* (nënvizimi ynë — KN), si dishroj vetë qi ta kesh, ka nevojë me u shetue pak ndryshe... unë dishroj qi vepra jote mi Kanu t'jetë e dobishme për dijetarë». Shkodër 14.XI,1913 (Ark. Shtet. Dosja 95/47).

8) Ja skema orientuese që i ka dhënë Fishta si K/redaktor i H. Dritës Gjeçovit për ndërtimin e kreut mbi martesën, «Martesa», Kaptina I, *Përkufizimi i martesës* (nënvizimi im KN) sipas Kanunit: Të drejtat e atyre që lidhin martesë. Njji parë: Të drejtat e burrit. Nëse burri ka të drejtë të zgjedhë bashkëshorten... etj. (Ark. i sht. Dosja 95697 v. 1905-1926),

shpjegime shkoqitëse të autorit, që i shmangen formulimit impersonal e abstrakt thjesht normativ-juridik.

Prandaj edhe në këtë drejtim botimi i dorëshkrimeve të Gjeçovit do të jetë një zëvendësim i mirë i përkufizimeve e frazave të tjera të krijuara, me ndërtime abstrakte që largohen pak a shumë nga burimi popullor.

Korpusi i së drejtës Kanunore do t'i përfshijë këto dorëshkrime duke i vendosur e radhitur ato bashkë me normat e tjera ekzistuese të Kanunit të botuar si dhe me materialin e përgatitur për botim të dytë të Kanunit, me dorëshkrimet «Kanuni i Malevet» (1911-1928); «Kokrra Kanujet», «Doke darzmash» etj. Kjo do të krijojë edhe premisat për studime më të thelluara monografike mbi të drejtën tonë kanunore, që është quajtur gati njëzëri nga dijetarët tanë e të huaj si nga më origjinalet e më të vjetrat në botë⁹.

Më në fund lidhur me këto dorëshkrime, është për t'u përmendur se një pjesë e normave që përfshihen në to janë përdorur pa u cituar në mënyrë të mirëfillta nga B. Palaj në një artikull të tij të botuar në Studime e Tekste në v. 1943 mbi Kanunin e Maleve. Në këtë artikull kur trajton familjen malësore autori shkruan: «...për tagre qi i ngarkon të zott të shpis e gjith pjestarvet... asht ma mirë qi të flasin vetë Kanuni, njashtu si e përmbloodh nëpër malet e Shqypnis dora e arët e P. Shtjefën Gjeçovit¹⁰. Ky referim gjenerik, le të kuptohet autorësia e normave që përmenden në artikull megjithëse nuk flet për dorëshkrime të pabotuar të Gjeçovit.

Për qënien e këtyre shënimeve e dorëshkrimeve qysh në gjallëri e B. Palaj flasin edhe burime të tjera¹¹, ndërsa aty nga vitet 1943-1944 me grumbullimin e tij u muar një frat tjetër franceskan B. Dema, i cili kishte arritur t'i shtinte në dorë këta shënime dhe mendonte të përgatiste me të një botim të dytë, të plotësuar të Kanunit të Lekë Dukagjinit, në bashkëpunim me juristin F. Tedeskinin, i cili i ruajti ato.

Po të kihen parasysh marrëdhëniet midis B. Palajt dhe B. Demës si fetare françeskanë dhe hulumtues të së drejtës Kanunore, është e lehtë të mendohet se B. Palaj, i ka patur parasysh këto dorëshkrime kur shkroi artikullin në fjalë¹².

Është për t'u theksuar gjithashtu se materiali i përgatitur nga B. De-

9) Asnjë komb i Europës nuk ka zakone më të vjetra», (se ato shqiptarët) ka vënë në dukje dijetari francez i shekullit të kaluar Albert Dumond (Les Balkans et l'Adriatique», Paris, 1874), «Ligjet e pashkruara të Maleve, shprehët më vonë M.E. Durham, janë trashëguar që nga kohët më të lashta dhe janë përmbledhja më e vjetër e ligjeve në Evropë (The burden of the Balkans, London 1905). Mendime të tilla kanë përmendur Hahn, Nopça, Taloci, F. Gibert etj,

10) «Studime e Tekste». Instituti i Studimeve Shqiptare, 1943, f. 116.

11) G. Schiro, në artikullin; P. Gjeçov e la frase del Kanun di Lekë Dukagjin (Le terre albanesi redente», Kossovo, Roma, 1942, fq. 183 shkruan se atij i ka thënë P. Pal Dodaj frat kosovar dhe ai që ka qenë shumë afër Gjeçovit në punën e tij për rregullimin e materialit e që përkthen italisht kanunin e Lekës, se Gjeçovi punonte vazhdimisht për plotësimin e pikave që i kishte lënë mangët edhe pas botimit në H. Dritës, duke mbajtur shënime mbi ekstraktët e revistës, shënime të cilat nuk diheshin kur u bë botimi postum i vitit 1933.

12) Vep. cit. 270-288.

ma e E. Tedeskini si botim i dytë i Kanunit të Lekë Dukagjinit të Gjeçovit filloi të dalë në një pjesë të tij në shtyp qysh në vitin 1944 kur B. Palaj ishte gjallë. Megjithatë ai nuk ka ngritur ndonjë pretendim për autorësinë e këtyre shënimeve që siç e thamë edhe më sipër i përmend si të Gjeçovit, ndërsa ai vetë ka botuar si një material të grumbulluar prej tij po në «*Studime e tekste*» përmbledhjen e Kanunit të Lekë Dukagjinit, sipas shqyptimit të Mark Sadikut, Shalë, 1940, që ka një numër të kufizuar normash. (34) kryesisht mbi të drejtën familjare.

Në përgjithësi B. Palaj ka patur një admirim të madh për punën e Gjeçovit dhe i është afruar vetëm ta ndihmojë atë në këtë punë duke përkthyer mendimet e albanologëve të gjuhës gjermane mbi të drejtën kanunore të vendit tonë¹³.

Një argument tjetër që përforcon tezën se B. Palaj i ka shfrytëzuar dorëshkrimet e Gjeçovit në artikullin e tij është edhe fakti se B. Dema ndër materialet që i dorëzoi E. Tedeskinit për përgatitjen e botimit të dytë të Kanunit të Gjeçovit i ka përfshirë edhe disa citate të artikullit të Palajt si ai mbi mikpritjen, kumbarinë, etj. që me sa duket i ka quajtur interesante, të cilat B. Dema i ka dalluar nga dorëshkrimet e Gjeçovit, duke u vënë atyre në kllapë emrin e B. Palajt. Këto citate janë përmendur si referencë po me emrin e B. Palajt edhe në materialin e përgatitur për botim të dytë të Kanunit të Gjeçovit.

II

Në librin e dytë të Kanunit të Lekë Dukagjinit, kushtuar familjes, Gjeçovi, veç përcaktimit të familjes që e trajtuan më sipër, ka vendosur edhe pjesëtarët e familjes, të drejtat e detyrimet e tyre.

Në dorëshkrimin e Gjeçovit ndodhen këto norma që i referohen kësaj pjese dhe që, siç shihet përmbajnë rregulla parimore që nuk ishin përmendur në botimet e njohura.

Në paragrafin 19 të veprës postume flitet për pjesëtarët e familjes dhe vihet një përkufizim pak a shumë abstrakt si ai i familjes për të cilin folëm më sipër, kurse në dorëshkrimin e Gjeçovit gjejmë këto norma parimore thjesht burimore që flasin për pjesëtarët e shtëpisë.

«Të tanë robët e shpis barabar janë në fitime ashtu në zollume»¹⁴.

Pjesëtarët e shpis për shkado qi të bajnë mirë a keq, nderen e marrën e biejn me vedi në shpi. Njehen të bame prej shpis si hajri i bariut qi vrau shqerrin e pruni te shpija, si fika e shpis qi vrau nierin. Nderojn vedin e shpin si grueja qi ban dru në mal, si edhe vajza qi në kapole

13) Unë tjetër shërbim nuk mundem me ba, porsa jam i zoti me t'u ba shegert për me letsue angarien në studime tueja. Mue m'ke gadi ç'me ditë të sodit n'daçë me t'përkthye ndaj gjasend qi t'lypet, ndaç me t'përfutue shkurt mendimet e tyne (t'autorëve alemane — KN) në at cillën pikpamje etnografike, ndaç me parazue, ndaj mendim tandin me t'atyne. Për tjetër s'jam i zoti./ Arkivi i Shtetit, Dosja 95/14, v. 1923.

14) Faqe 27 nr. 176 e kopjes së daktilografuar të dorëshkrimit të Gjeçovit (tani e tutje do ta përmendim shkurt, d.Gj.).

xuer thikën qi kanuja ia len për mproje të virgjinisë së vet e përgjaku nierin e keq»¹⁵.

Ky parim trajtohet në dorëshkrim edhe një herë, me nuancat përkatëse, në lidhje me pjesën e këtij kreu që bën fjalë për tagrin e të zotit të shpis, për të cilin gjejmë material mjaft të bollshëm. «Qiti pushkë, vrau ose varroi nierin robi i shpis pa fjalë të tjetërkuej, veç të mendes së vet, gjithmonë por për me ndorë shpin, i zoti i shpis asht pjestar për atë pushkë si aj qi i qiti, e i del zot asaj baje. As ditën e daes Kanuja nuk ia xen ato të vrame në vedi, pse mbas Kanuje edhe paret e gjakut do t'i dajn rrethas si pasunin e shpis»¹⁶.

Në një vend tjetër të dorëshkrimit kjo ide në lidhje me përgjegjësinë e të zotit të shpisë për veprimet e pjesëtarëve të familjes është formuluar më qartë: «Kanuni ia ngarkon të zotit të shpis gjith të mbarën e të mprashten; pse gjithshka të bahet, aj do të përgjigjet për robët e shpis së vet: shkurt si për të mirë, si për të ligë do të përgjigjet i zoti i shpis. Ditën e daes shka të xaie daeia: si hairin si zollumin, si borxhin, si të marrurin e kanë gjithashtu përgjysë»¹⁷.

Këto formulime të një ideje të vetme Gjeçovi i ka shënuar në dorëshkrimet e tij sigurisht duke transkriptuar burimet e ndryshme të informatorëve. Ato kanë megjithatë rëndësinë e tyre, jo vetëm pse pohojnë karakterin universal e parimor të kësaj norme, por edhe se japin dritë, herë mbi njerën herë mbi tjetrën nuancë të pjesëve në-hërëse të normës.

Në lidhje me pozitën e të zotit të shpisë, dorëshkrimi i Gjeçovit sjell mjaft plotësime dhe madje edhe ndonjë ndryshim nga normat e botuara të Kanunit. Kështu, duke trajtuar problemin e parë që lind në këtë fushë-kush njihet zot shpije, në dorëshkrim thuhet prerazi:

«Zot shpije njihet ma i vjetri në lindie ndër njesëtarët e shpis qi hanë bukë bashkë deri ditën e daes»¹⁸. Për sa i përket tagrit të zotit të shpis. në dorëshkrim përmenden gjerësisht të drejtat e tij, pastaj dhe detyrimet:

«I zoti i shpis për atë asht zot shpije: me dhanë e me marrë. Prandaj as shejin e fejesës, fen pa fjalë të tij s'guxon kush me e lëshue as me e nëlqye. as s'e ka këtë të drejtë kurrnji rob shoiie tjetër. pse në rasë të përkundërt, i zoti i shpis ka të drejtë me e ngushtue robin cilidó kjoftë kv-posë tatës së djalit, a të çikës qi nuk mundet ma me e hangër fjalën e vet për me e marrë ose me e këthye atë peng»¹⁹.

Po në lidhje me fejesën, në dorëshkrim ka edhe një formulim tjetër që merr parasysh edhe këshillimin me prindin (babën) e vajzës e të djalit:

«Fejesë e martesë i ka me i këputë e me i lidhë i zoti i shpis. gjithmon me pleqnin të tatës si të djalit si të çikës e të kurrkuut tjetër. Tata i djalit e i çikës në caktimin e kësaj të drejtë janë të dy ortakë»²⁰

15) D. Gj., f. 21 nr. 130.

16) D. Gj., f. 21, nr. 131

17) D. Gj., f. 27, nr. 167.

18) D. Gj., f. 21, nr. 127

19) D. Gj., f. 22, nr. 133,

20) D. Gj., f. 21, nr. 132.

Dhe më poshtë përcaktohet ç'mund të ndodhë në rast shkeljeje të këtij rregulli:

«Po bani fejesën tata ose vëllaj i çikës pa dijë të zotit të shpis, ky atëherë, ndo ua falë këtë gabesë, ndo ngrehë dae, pse i mbaroi zotimi²¹.

Më në fund në lidhje me pozitën e zotit të shpis, në dorëshkrim ndodhet edhe një normë parimore mbi përgjegjësinë e tij, si ndaj pjesëtarëve të familjes për drejtimin e shpisë, ashtu dhe ndaj fisit, qoftë për veprimet e tij, qoftë edhe të gjithë shpisë si qelizë e fisit, duke nënkuptuar edhe veprimet e secilit anëtar të saj.

«Për gjithshka të bahet aj do t'i përgjigjet robvet të shpis, për fajet e shpijakut do t'i përgjigjet fisit kur t'i bieje në dorë²².

Duke bërë krahasimin ndërmjet tagrit të zotit të shpis dhe atij të zojës së shpis, në dorëshkrimin e Gjeçovit përcaktohen në mënyrë lapidare ndarja e kompetencave sipas parimit të familjes patriarkore: «Gjithsi i zoti i shpis ka kujdesimin e puntorvet njashtu e zoja e shpis ka drejtimin e gravet të shpis në punë²³. Zoja e shpis do të punojë gjithmonë përmbas urdhrave të të zotit të shpis, prandej ajo nuk ka tbanas as tregtime²⁴.

Në përgjithësi në dorëshkrimin e Gjeçovit është përcaktuar më qartë pozita e zonjës së shtëpisë në krahasim me paragrafin 23 të Veprës postume, që trajton me pika e në mënyrë fragmentare disa kompetenca të saj:

«Zojë shpije asht gjithmonë ma e vjetra grue në shpi. Kësaj i përket rregullimi i shpis në derë e mbrendë²⁵. «Për sa i përket detyrvet të zojës së shpis, thuhet më tej në dorëshkrimet e Gjeçovit, Kanuja njef atë më të parën kujdestare për të mbajtunit e pastrimit në mbrendë të shpis, për gatimin e gjellës si të robit, si të mikut²⁶.

Është për t'u theksuar se në familjet e mëdha patriarkore detyrat shpërndahen në mënyrë të tillë midis burrave të shpis që, pas zotit të shpis, vijnë ata që punojnë tokën e që ruajnë bagëtinë. Si bujku ashtu dhe bariu bëjnë pjesë në familje. Nga kjo vjen që edhe në veprën postume në pikat 4 e 5 të paragrafit 24 që flet për gjinden e shpis, Gjeçovi flet pikërisht për tagrin e bujkut mbi qe e atë të bariut mbi tufën e dhenve, tagër që përkatësisht kufizon atë të zotit të shtëpisë.

Këto dy pika janë të futura si pa lidhje në këtë paragraf dhe të lihet përshtypja se ato nuk janë të shtëpisë, por megjithatë gëzojnë të drejtat e anëtarit të saj, gjë që vjen në kundërshtim me nyjen e katërmëdhjetë (§ 17 e vijues) që bën fjalë për marrëdhëniet midis zotnisë e rrogtarit. Ajo që e sqaron këtë problem është kjo normë që e gjejmë në dorëshkrimin e Gjeçovit:.

21) D. Gj. f. 22 nr. 134.

22) Në një shënim të Gjeçovit që ndodhet në bibliotekën e Shkodrës lidhur me këtë moment thuhet: «Miku kurr s'hin n'shpie t'huej pa bam za n'oborr. Natën thurret miku n'oborr para se ta njofin se kush asht e kah asht. Granias dalin n'oborr e burrimimi rrin gati me pushkë nëpër frangia».

23) D. Gj. f. 23, nr. 148.

24) D. Gj. f. 23, nr. 141.

25) D. Gj. f. 23, nr. 140.

26) D. Gj. f. 23, nr. 141.

«Si buqari, si çobani ka të drejta të njëjshme në shpi»²⁷. E vendosur para pikave 4 dhe 5 të paragrafit 24, kjo normë i bën të kuptueshme edhe të dy këto pika që flasin pikërisht mbi privilegjet që kanë këta anëtarë të familjes që janë ngarkuar me përgjegjësinë e punëve bujqësore e blegtorale në krahasim me anëtarët e tjerë kur trajtohen problemet që kanë të bëjnë me qetë e tufën e dhenve nga përfaqësuesi i shtëpisë që është personi juridik i familjes së madhe patriarkore.

Megjithatë edhe në lidhje me nyjen katërmbëdhjetë të Kanunit që flet për pozitën e rrogtarit, në dorëshkrimet e Gjeçovit ka një normë që i ve theksin trajtimit njerëzor të tij nga zoti i shtëpisë, ashtu sikurse edhe pjesëtarët e tjerë të familjes, jo vetëm në pikëpamje të ushqimit, por edhe në marrëdhëniet juridike që lindin nga dhuna që mund t'i bëhet atij, sa kohë që është në shërbim të asaj familjeje.

III

Në lidhje me librin e tretë të Kanunit kushtuar martesës e që në fakt përmban edhe normat e së drejtës familjare, shumë nga shënimet e Gjeçovit janë sistemuar vetë prej tij në paragrafet përkatës duke u bërë prej tij ndryshimet e shtesat e duhura, përfshirë këtu edhe institutet e patrajuara fare më parë mbi problemet e zgjidhjes së martesës, ato të shtatzanësisë, të dhunimit të gruas etj. Shumica e këtyre instituteve, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me ritualin, u botuan në një vend tjetër. Megjithatë në dorëshkrim ka edhe mjaft norma të pasistemuara që i takojnë këtij libri (flasim këtu sipas ndarjes së veprës postume që në të vërtetë ka mjaft mangësi, por që na po e respektojmë për të bërë të mundshëm orientimin sa më të lehtë të lexuesit sipas tekstit ekzistues të Kanunit-veprës postume të vitit 1933).

Kështu në lidhje me tagrin e djalit të parashikuar në paragrafin 30 të Kanunit, në dorëshkrimin e Gjeçovit gjendet kjo normë që sintetizon mendimin e ndarë në gërma të paragrafit mbi autoritetin e zotit të shtëpisë dhe që e plotëson atë: «Djali sa të ketë tatën e tij gjallë, s'ka tjetër tagër veç me ndjekë urdhnat e t'et e i ati të zotit të shpis»²⁸.

Pushteti i padiskutueshëm i të zotit të shtëpisë në lidhje me problemet e fejesës e martesës që janë momente të rëndësishme të lidhura edhe me problemet e aleancave për forcimin e fisit si dhe kujdesimi për fëmijët sipas parimit patriarkor, trajtohet gjerësisht në dorëshkrim.

«Vajza në fejesë e në martesë nuk pëvetet, por do të marrë atë burrë që t'i kenë shenjue prindja (e në mungesë të këtyne vëllau ose po s'pat as vëllazën, kushrijt); pse vajza pa u ba nanë s'asht e zoja e vedit»²⁹.

Sikurse u tha më sipër, kjo e drejtë nuk i njihet as djalit, me një farë ndryshimi megjithatë, kur nuk ka prindër gjallë:

«Tagri me mendue për fejesë të vet i mohohet edhe djalit, kur ky

27) D. Gj, f. 22, nr. 136.

28) D. Gj, f. 23, nr. 154.

29) D. Gj, f. 13, nr. 45

të ketë prindën gjall, por po s'pat prindë flet vetë³⁰, (dmth. nuk duhet të ndërhyjnë vëllazënia ose kushrinia, si për vajzën).

Pasi të jetë fejuar nga prindërit «vajza e xanun nuk ka tagër me thënë: nuk e due atë burrë, sido kjoftë ky e me marrë një tjetër, pa i lëshue robët e vet në gjak; e në kjoftë se ajo kurrsesi nuk ndigion me u martue, ka me mbetë gjithmonë e lidhun, edhe mbasi burri i shenjue për të të martohet me një tjetër grue»³¹.

Megjithatë, kjo gjendje ndryshon kur heq dorë shprehimisht i shoqi: «Vajza e fejueme asht gjithmonë e pengueme, jashta në hjekët dorë i shoqi, pse sheji e feja as ndërrohet, as kthehet për të gjall të burrit»³².

Në dorëshkrimet theksohet me nuanca të dukshme dallimi midis prishjes së fejesës që zakonisht nënkupton ndërhyrjen e prindërve dhe sjell ndërlikime gjaku ndërmjet familjeve, me ato të mospranimit ose hikjes së vetë gruas pas martesës, mjafton që mospranimi ose hikja të mos jenë frymëzuar nga familja.

Edhe sikur problemi i gjakut të mos shtrohet apo të jetë zgjidhur, kanuni parashikon pasoja të tjera me karakter juridik civil nga të cilat disa përmenden për të parën herë në dorëshkrimet e Gjeçovit.

Sikurse dihet «prindja dhandrrit i apin vajzën, por petkat e pajën ia ka detyrë dhandrri, prandaj kur shkuesi t'u shkojë te dera m'e u lypë vajzën, i caktojn çmimin e petkave, që i duhet dhandrrit me ia çue ditën e fejesës për të gatue vajzën e me e ba nuse»³³.

Është e qartë se kjo kërkon edhe zbatimin e marrëveshjes dhe eventualisht shpërblimin e dëmit, kur kjo nuk është bërë. Kështu: «Me u çue prindja e vajzës së xanun (nën unazë) edhe me ia dhanë tjetërkuj vajzën e përdorueme, kanuja e len në gjak. Qi të shmanget vrasa, e cila s'pran kurr, kur të filloi pushka në punë të gravet (e të çikave) me ndërmjtsin e dashamirvet, prindja e vajzës janë në detyrë me la paret për vajzë tjetër, qi do ta gjejë njeti ai qi e pat xanë vajzën e tyne. Sa pare të lypë miku i dytë, miku i parë do t'i lajë»³⁴.

Dhe rasti tjetër «Po s'desht kurrsesi vajza me u martue, prindja e vajzës e kanë me detyrë me ia kthye të gjitha paret, qi të ken marrë deri atë ditë për vajzë. Ndërsa djali mundet me hjekë dorë prej aso vajze e me marrë një tjetër, në kët rasë i hupë të gjitha paret qi të ketë dhanë deri n'atë ditë për të»³⁵.

Përveç problemeve të karakterit ekonomik, kanuni zgjidh edhe çështje të tjera që synojnë të parandalojnë ngatërresat e mundshme. Kështu në dorëshkrim shkruhet: «Në rasë se dhandrri hjekë dorë prej vajzës së xanun, kjo nuk mund të martohet në katund të dhandrrit, e po iu vu leçi as në bajrak»³⁶.

Në dorëshkrim ndodhen edhe këto norma, që përforcojnë parimin

30) D. Gj, f. 13, nr. 44.

31) D. Gj, f. 17, nr. 75.

32) D. Gj, f. 17, nr. 76.

33) D. Gj, f. 18, nr. 78.

34) D. Gj, f. 23, nr. 165.

35) D. Gj, f. 19, nr. 77.

36) D. Gj, f. 3.

patriarkor por që megjithatë kanë si karakteristikë se i njohin gruas disa garanci e kufizojnë arbitraritetin e burrit. Këto garanci që spikasin në dorëshkrimet e Gjeçovit venë në dukje në të njëjtën kohë edhe se Kanuni nuk mund të injorohet një gjendje fakti të afirmuar gjatë kohës që e përraqit pozitën e gruas jo si qenie pa kurrfarë të drejtash, sikurse është trajtuar shpesh në mënyrë vulgare e të njëanshme, por si një subjekt relevant që luan një rol të rëndësishëm në jetë dhe nuk mund të jetë e largësuar nga mjetet e mbrojtjes së dinjitetit të saj, jo vetëm nga të huajt, por edhe nga bashkëshorti. Këto mjete, siç do ta shohim edhe në norma të tjera të dorëshkrimeve, pajtohen edhe me rëndësinë që i kushton kanuni paprekshmërisë së gruas, mbrojtjes së jetës e dinjitetit të saj në përgjithësi.

Kështu ndërsa thuhet «Burri ka të drejtë me rrahë gruen e vet, po i ra ndër fjalë, sidomos në sy të huajve», shtohet por «kurr pa kohë» dhe në vijim «Gjithmonë jashta kanunit asht me e vra gruen pa faj ose me e tushkatë punë e pa punë pse kanuja nuk e njeft gruan për rob të xanun, por për nanë fëmijs»³⁷.

Në disa norma të tjera të dorëshkrimit lidhur me këtë problem çështje e keqtrajtimit të gruas nga burri trajtohet në lidhje edhe me të drejtat e kësaj të fundit t'i drejtohet prindërve të vet dhe këta të kërkojnë garanci e mjete të tjera kanunore për të mbrojtur të drejtat e saj.

Kështu «Kanuja ia ban dhandrrit të rrafmen e grues». Po i hiku e erdh te prindja do t'i çohet me dorëzanë, tue i thanë: «Fale se të hiku, se s'të hikë ma. Po pat arsye të randa nusja me hikë se e tundoi kush, atë botë dhandrri do të qesë dorëzanët, jo përndryshej rrin te shpija»³⁸.

Ky moment trajtohet sidomos gjerësisht në këtë pjesë të dorëshkrimit të Gjeçovit që është diçka më tepër se një normë. Ajo trajton siç e thamë edhe tagrin e gjinisë së nuses që Kanuni i Lekë Dukagjinit (vepra postume), e ka parashikuar si paragraf më vete (§ 57) vetëm lidhur me vdekjen e nuses.

«Pse të martohet bija, tagret e saj në jetë e në nderë i ruen e i ndjekë mbas Kanujet prindja e vëllaznija e saj, e po ndodhi qi ndokush ndër malet e Kanus vuni dorë në grue pa kohë — frazë kanuje kjo qi don me thanë: pa njato arsye qi parasheh kanuja-grueja ka të drejtë me hikë në gjini, e tata i saj ose i vëllaj, ndo i kushrini ka të drejtë me i ra në derë shpërdoruesit. Po bani aj, e nuk iu gjegj, gjinija, i grabitka kan e e daka me shokë. Kau i grabitun vendohet krye për krye me nderin e bijës së rrahun pa arsye»³⁹.

Në dorëshkrim ndodhen disa norma që rregullojnë pozitën e gruas së ve. «Gruaja e vejë flet vetë në rasë martese»⁴⁰ thuhet në dorëshkrim duke u plotësuar me fraza lapidare një mendim që vetëm tërthorazi del nga botimi ekzistues i kanunit. Një moment tjetër që trajtohet në dorëshkrim është ai i jetesës të mëtejshme të gruas së ve dhe i marrëdhënieve të saj me të dy shtëpitë, të burrit e të babës.

37) D. Gj, f. 22, nr. 155.

38) D. Gj, f. 22.

39) D. Gj, f. 22, nr. 157.

40) D. Gj, f. 18, nr. 86.

«Detyra e të zott të shpis asht qi pjesën e çdo sendi (të veshës, të mbathës e të haes) deri ditën e daes t'ua qesë të gjithvet baraz e mos me e lanë z bathët as çveshët kurnjisherë robin e shpis simbas punët e nafakët qi të falë zoti»⁴¹, duke marrë parasysh se siç u përmend më parë: «të tanë robt e shpis barabar janë në zollume e fitime»⁴².

Norma të tjera lidhur me ndarjen e pjesëve janë ato që rregullojnë mënyrën e zgjedhjes midis vëllazërve, që ka si parim barazinë e palëve dhe kompensimin e privilegjit të parbiris me privilegjin e vëllait të vogël të zgjedhë pjesën: «Vëllai i madh dan, thuhet, vëllai ma i vogël zgjedhë, ashtu të tjerët me rend e ma i madhi ma i mbrami»⁴³.

Një detyrim tjetër i vëllait të madh, që rrjedh edhe nga privilegji i parbiris është kujdesi për vëllazërit e vegjël po të vdesë babai: «Me i dekë tata djelmvet, ai vëllai ma i madh xen vendin e tij për me kenë kujdestar i vëllazërvet të vegjël sa të jenë pa u da»⁴⁴.

Për sa u përket sendeve vetiake parimi është «Burrat do të zotnojnë armët e veta; grat gojën e arkën e vet, të cillën s'guxon me ia prekë kush»⁴⁵.

Lidhur me pjesën e «kopilit» në dorëshkrim i bëhet një korrigjim parimit të prerë të parashikuar në § 89 të Kanunit sipas të cilit djalin e pa kunorë. Kanuja s'e njeft për trashigues (në fillim Gjeçovi, siç e kemi thënë më parë, i vinte një përjashtim këtij parimi: «Puka e Dukagjini po»⁴⁶, kurse në këtë normë rregullin e sipërm e bën përjashtim. Aty thuhet «Në Mirditë Kanuja kopilin a bastardin s'e njeft trashëgues të pasunis së patundshme të atit»,⁴⁷ pra përjashtohet «kopili» vetëm në Mirditë, dhe atje jo nga gjithë pasuria, por nga ajo e paluejtëshme. Kjo forcon bindjen se parimi i Kanunit është i kundërt dhe se ky rregull i përjashtimit të «kopilit» është vënë nën ndikimin e fesë katolike.

Pjesa e gruas në trashëgimi në dorëshkrim përmban në mënyrë mjaft të përgjithshme sintetike parimin patriarkor: «Grueja s'ka tagër trashigimi si kje motër si kje, nanë. Ndej te shpija, gëzon gjan e babës, u martue e mban burri; mbet e vejë me fëmijë gëzon gjan e fëmijës, mbet e vejë pa fëmijë, ka ngojen deri të desë e të martohet njeti»⁴⁸.

IV

Libri i katërt i Kanunit të Lekë Dukagjinit trajton shpin, gjan, e pronën, ndërsa ai i pestë trajton «Punën». Në krahasim me dy librat e mëparshëm, për këto tema dorëshkrimi i Gjeçovit është më i kursyer. Kjo shpjegohet edhe me karakterin konkret dhe të padiskutueshëm të normave që kanë këtë objekt. Megjithatë edhe në këto dy libra shohim disa plotësime të Gjeçovit që po i përmendim. Kështu p.sh. në lidhje me

41) D. Gj, f. 23, nr. 138.

42) D. Gj, f. 27, nr. 176.

43) D. Gj, f. 23, nr. 150.

44) D. Gj, f. 22, nr. 153.

45) D. Gj, f. 23, nr. 181.

46) D. Gj, f. 9.

47) D. Gj, f. 16, nr. 44.

48) D. Gj, f. 18, nr. 79.

damet e shkaktuar nga qeni në dorëshkrim janë këto rregulla përveç atyre të sistemuara nga Gjeçovi.

«Si të hijë pisha në mulli, e mje ke të shkrepë dielli⁴⁹, po të hangër qeni nuk asht në detyrë me ta la varren. Me hangër qeni kënd ditën, do t'i lahet varra të kafshuemit. Po vrau kush qenin si të hijë pisha në mulli e mje qi të shkrepë dielli, qeni do të paguhet e dorërasit do t'i thehet arma në kuvend të bajrakut»⁵⁰.

Në lidhje me të drejtën e personave të tretë mbi pronat e huaja, është karakteristike edhe kjo normë me konstrukt thjesht popullor, ndërtuar në vetën e parë të njëjësit që flet për të drejtën e fqinjëve të hanë kokrrat e pemëve degët e të cilave kalojnë gardhin e kufirit:

«Pemvet të hueja, qi u lavaren gembat kah vendi i em, un ja u ha kokrrat: ashtu kokrrat e pemvet të mija që janë të lavaruan gembash kah vendi i huej i han ai»⁵¹.

Karakter të spikatur metaforik popullor kanë edhe sentencat e dorëshkrimit që plotësojnë e sqarojnë normat e Kanunit që flasin për udhën e madhe, të cilat edhe ato janë lakonike e të skalitura. Kështu p.sh. në § 269 të Kanunit thuhet se udha ndjekë diellin e s'ndalet, as mund pritët». Këtë normë Gjeçovi e ka konkretizuar në mënyrë të tillë që njëkohësisht të vihen në pah përparësia që i jep Kanuni punës së njeriut dhe mbeturinat e pronës së përbashkët:

«Ara e han livadhin, por livadhi jo arën; ara e han arën e livadhin (kur asht për t'u bajtun drithi a sana)⁵².

Për rastin e shitjes së grazhdit sanës e kashtës në dorëshkrimin e Gjeçovit gjejmë një normë plotësuese që thekson karakterin real të këtyre marrëveshjeve juridiko-civile.

«Grazhdi, sana e kashta, thuhet në këtë normë, e shitun deri qi të qitet kërraba për me ndukë prej tyne, janë të zotit që i shiti e, po u damtuen janë t'atij që i shiti. Si të qitet kërraba janë të atij që i blen; përmbas kërrabës së qitun dami asht i atij qi i bleu»⁵³.

Për problemet e vadës në pjesën e dytë të dorëshkrimit të Gjeçovit ndodhen dy «Oroe» që sipas atij shtrijnë rregullat e Kanunit të Lekë Dukagjinit edhe në Shqipërinë e Mesme (dhe pjesërisht edhe të Jugut). Është interesante të përmendet se Gjeçovi bën dallimin midis Shqipërisë së Mesme dhe Gegërisë:

«Oroe»: Kanunet e vadës (t'ujit) në Shqipërinë e Mesme e ndër shumë vende edhe në atë të Jugut, janë njinji si ato qi mbahen në Gegni. P.sh. në katund të Shtërmendit në qarkun e Elbasanit, e njeti, vijen e ujit, qi asht për të mirë të Katundit, nuk mund të ndalë kush, me kenë se i kalon edhe nëpër oborr e nëpër shpi (rranzë votrës⁵⁴). Dhe më poshtë:

«Oroe: Gjatë e gjatë kam pasë folë me Jaho Hisen, kreun e Belshit.

49) D.m.th. gjatë natës deri në agim,

50) D. Gj, f. 12, nr. 5.

51) D. Gj, f. 13, nr. 12,

52) D. Gj, f. 14, nr. 27.

53) D. Gj, f. 12, nr. 6.

54) D. Gj, f. 15.

e me tjerë belshas, pleqë, tue pëvetë mbi Kanune, doke e sjellje ka-
nunore, qi mbajti vendi e rrethi me të gjitha krahinat dhe u vërtetova se,
posë sa ndryshimesh vendore (si të gjitha vendet e katundet tue e pershi
punën përgjithsisht) i mbahen si ana e maleve të gegnisë»⁵⁵.

V

Për problemet e tregtisë që ndodhen në librin e gjashtë «të dha-
nunit» të Kanunit në dorëshkrim gjendet një saktësim që përjashton për-
gjegjësinë e vëllait për të vëllanë duke u bërë një dallim për borxhet nga
detyrimet e tjera që, siç e përmendëm, rëndojnë mbi të gjithë anëtarët
e familjes patriarkore:

«I vëllaj për të vëllan nuk kapet për detyrë (borxh)»⁵⁶.

Për normat e librit «shtatë» të Kanunit «Fjala e gojës» ka rëndësi si-
domos një «Oroe» e gjatë që Gjeçovi në dorëshkrimin e tij i ka vënë pa-
ragrafeve 355-534 të Kanunit që bëjnë fjalë mbi mënyrat e besë pasi
ka shtuar veç besë mbë gur me Kanu, besë mbi kryq e m'ungjill dhe
«benë me gur të vorrit»⁵⁷, të cilat i ka nxjerrë nga trashëgimet thrako-
-iliriane.

Guri, thuhet në këtë «Oroe» tëhjekë randë n'atë jetë: — Bindja e
nderimi i shqiptarvet ndaj «gurin» janë të përhapuna nëpër të katër anët
e Shqypnis por sidomos në Malsi. Në çdo pleqni e gyyq kryjet e vendit
e xen guri: «Ja merrma gurin, ja ma lësho» thonë ndër pleqni «Merre
gurin e banëm be, merr gurin e folë, e dajë pleqnin a gyyqin».

«Kah Bajza e Pëshkashi i Thëkellës, me pasë për ta kalue kush ujët
e lumit të Matës edhe panë se ka pak si shumë ujë, marrin një gur
(papërdhok) e venë në cup të krahit edhe i biejn ujit tue besue se i pësh-
ton të mos mbyten dhe jau letson mundin në të cam t'ujit njaj gur. Nana
shqiptare së cillës nuk i rrënojn fëmija, merr një gur aq të randë sa t'i
barazohet peshës së fëmijës e si t'ja ketë vu në peshë e t'i përkrasohet
fëmijës, do t'i rrënojë fëmija»⁵⁸.

«Beja mbë gur, — vazhdon dorëshkrimi qi bahej tue e mbajtë gurin në
dorë kishte pasë kenë i randë e ndër ma të shejtrueshmit ndër kavaljete të
lashta»⁵⁹

55) *Po aty*.

56) D. Gj. f. 14, nr. 22.

57) D. Gj. f. 24, nr. 165.

58) Është për t'u përmendur se Gjeçovi, edhe në dorëshkrime të tjera të
tij ka plot shënime mbi legjendat e popullit tonë për gurin, që e kanë prejar-
dhjen në besimet e lashta pagane. Kështu në dorëshkrimin «sa sjellje besimesh
shqiptare» që ndodhet në muzeun e Shkodrës, në mbarim të fletores, nën
kapak ndodhet ky shënim që është nga më të fundit e shkruar prej
dorës së tij. «Në grykë të Dragobits (Krasniqe) asht guri i vajzës, qi thonë se at
gur e paska marrë vajza në breg të Valbonës e çue aty. Guri mund të jet nja
300 okësh. Kushdo qi të kalojë aty pari lëshon ka një gur mbe te» (Gjakovë
12.III.1928). Në këtë fletore dorëshkrim gjejmë edhe disa shënime të tjera të
tilla si atë me datën 4.XII.1923 që flet për «gurin e fatit» në Elbasan, me da-
tën 30.III.1925 që flet për gurin shërues etj.

59) Këtu Gjeçovi ka vënë si poshtëshënim një referencë të gjatë pjesërisht
me gjuhën latine të Gëllius e Levitikut që bëjnë fjalë edhe për dëshmitë e Fes-
tit lidhur me përdorimin e gurit nga populli i Izraelit si dhe për benë që bëri
Hanibali e romakët pasi lidhën marrëveshje.

«Edhe për shqiptarët ndër ma të randat be janë ato qi bahen mbë gur. Kjo be themelin e vet e kishte në një besim të hershëm fort, porse ndër shqiptarët tanë beja mbë gur asht e re, d.m.th. se si herët edhe sot përdoret e Kanuni i Maleve tona e njef kët be për të ligjshëm edhe të randë fort. Mbas fjalës së Plakut çohet ndokush prej djelmësh e shkon me gjetë një papërdhok (gur të vogël) të rrumbullakët e të fortë. Porsa të bihet guri, çohen në kambë të gjithë edhe rreshtohen rreth e rrotull si në valle, ashtu qi mjedisi i vendit të jesi pa njeri. Atëbotë Plaku i katundit hin në mjedis me atë gur në dorë, edhe ia jep atij, qi rrin ma i mbrami kah e djathta, qi të xajë fill beja e katundit. Ai, qi e mban gurin, e ven mbë shuplakë të dorës së majtë, e tue e prekun me të djathtën betohet tue thanë: «Për këtë të mirë të Perëndis e si e bafsha, më ndihmoftë, se as unë as kush i shpis seme për t'i dalë besët katundit nuk kena!».

Si të betohen të gjithë, ma së mbramit e merr gurin Plaku i Katundit e betohet edhe ky si të gjithë tjerët, porse në mbarim të bes ky shton këto fjalë: «Aj qi e theftë këtë be, theftë qafën si unë, qi lëshoj ket gur! «Edhe e lëshon gurin në tokë në mjedis e nder sy të tanvet. Të gjithë përgjigjen» ashtu kjoftë»⁶⁰. Mandej Plaku i katundit e merr atë gur e ose e hiedhë ndër prille (hatulla) të shpis ose e shtien në dhe. Me e tretë përjashta atë gur (shka s'ndodhë kur, e dijn për faj të randë, sepse thonë: Ky gur nuk asht ma si çdo gur; mbë të asht ba beja e do të ruhet si një send i shuguruem. Prej këtej do të ketë mbetë ajo fjalë e kombit tonë, i cilli kur ta pëvesë kush: «A ke besë?» i përgjegjë: «Ma të fortë se guri!».

Guri i bes zgjidhet gjithherë një papërdhok i rrumbullakët, qi u përket gurgacavet a nëmosë të jet gur i fortë»⁶¹.

Veç kësaj «Oroe» të gjatë që Gjeçovi e ka përmendur edhe në studimin e tij Trashëgime Thrako-Iliriane, në dorëshkrimin e Gjeçovit për problemin e bes është edhe një normë që i takon besë lidhur me kërkesat që ka një person ndaj një të vdekuri që sipas atij është debitor. Sipas parimit të Kanunit barra e provës me be i takon jo kërkuetit, po mohuesit. «Ben do ta bajë aj, i cilli i bjen moh zhgarkimit», «Mohi ka ben», «Ban e hup e jo ban e merr». Siç do ta shohim kjo normë e dorëshkrimit përbën një përjashtim nga ky rregull, i cili mbështetet në respektin që kanë njerëzit e Kanunit ndaj të vdekurit dhe në besimin se beja e rreme në këtë rast pas këtij rituali solemn do t'i sjellë fatkeqësi kërkuetit.

«Diq nieri, thuhet në dorëshkrim, e me qillue se del kush përmbas deke me kja mbë të ndoi uha të dhanun për të gjall të tij e të pakëthyeshme e gjindja e shpis s'dije gja, a thue asht njimend a asht shkarkim a shpifje për të dekunin, ia lanë një shpirt atij, qi lyp gjan prej të dekunit, e ky do të bajë be mbë gur të vorrit të tij».

«Beja bahet kështu:

Nieri qi kjan gja më të dekunin, do të marrë mbë krah një gur prej vorrit të të dekunit, e ven në krah të djathtë, e me gjithë gur mbë krah

60) Këtu Gjeçovi ka vënë një shënim që referohet një frazë latinisht e Tacitit.

61) Këtu përmendet si shënim një referencë e një fraze latine të Gëllius mbi ritet e romakëve.

do të siellet rreth vorrit të këtij tri herësh tue thanë: «qaq, gja... unë kjaja mbë këtë të dekun e n'ia shpifsha, e bajsha me gur e me dhe, qi asht mbë të, e bajsha me gur e me dhe gjithkah ka shkelë kamba e tij për të gjallët!».

«Atëbotë prindja e të dekunit do t'i përgjigjin së lypmes»⁶².

Me gjithë se i takojnë procedurës së gjykimit ne për arsye metodike, për të mos u rikthyer prapë te beja po vendosim këtu edhe disa norma të dorëshkrimit të Gjeçovit që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të besë nga pleqtë si provë e gjithanshme e universale, që qëvendëson burimet e tjera të provës si dëshmitarët etj. Këtu duhet patur parasysh se pleqt e besë nuk janë vetëm arbitër ose juri, por edhe njerëz që kanë dijeni mbi faktin apo që të hetojnë atë veças për të marrë të dhëna bindëse lidhur me objektin e të provuarit.

«Ndër të tana pleqnit e Kanus një randësi të veçantë ka beja qi caktohet me një mënyrë të paluejtëshme, fjalë për fjalë, prej pleqvet»⁶³.

«Beja do të bahet në ditë të shënjueme a me pleqë të shënjuem, që për çashtje të randa kapen me 24 pleqë bejë»⁶⁴.

«Pleqët e bes do të gjurmojn e do të ken një kuptim sa ma të kjartë mbi punët e ndodhit përmbi të cillat peshon beja e caktueme në fjalë të paluejtshme»⁶⁵.

«Mbet një plak pa e ba ben, kanuja shton dy për një. Meten dy, beja jet e pabame; por ata dy betare do të bajn be faqe se nuk e lanë për kurrnja tjetër ben pa e ba, veçse asht beja e rrajshme»⁶⁶.

VI

Lidhur me normat e Kanunit që i takojnë librit të tetë «Nderës», në dorëshkrimin e Gjeçovit ka mjaft shënime për nderin e gruas dhe sidomos për mikun, që nuk kanë qenë në redaktimet e para të Kanunit dhe që e plotësojnë mjaft këtë. Kjo dëshmon edhe për rëndësinë e madhe që i ka kushtuar Gjeçovi gërmimit e qëmtimit sa më të imtë të rregullave që kanë të bëjnë me atë që është quajtur parimi kryesor i Kanunit të Lekës.

Lidhja që i bën Kanuni nderit dhe ruajtjes së nderit të gruas, një nga traditat më të forta të popullit shqiptar është skalitur në disa norma nga të cilat mjaft prej tyre ndodhen në dorëshkrimin e Gjeçovit dhe pasurojnë fondin kanunor mbi këtë aspekt të rëndësishëm të jetës shoqërore të malësive tona.

«Sikurse burri i mirë asht ndera e fisit e e shpis, njashtu edhe gruaja e ndershme, fisnike, punembarë e sojnikë asht ndera e shpis ku duel e ku ra»⁶⁷.

62) D. Gj, f. 25.

63) D. Gj, f. 21, nr. 123.

64) D. Gj, f. 21, nr. 124.

65) D. Gj, f. 21, nr. 125,

66) D. Gj, f. 21, nr. 126.

67) D. Gj, f. 22, nr. 169.

Këto fjalë të urta dëshmojnë për pozitën e nderuar⁶⁸ të gruas. Nga këto konsiderata kur preket nderi nga vetë tjerët kanuni është i pamëshirshëm:

«Pushka e grueja nuk hulumtohet» — thuhet solemnisht. «Nana, motra e grueja e pandershme ka plumbin».

«Grueja si asht e pafalshme në faj e ka plumbin mbas shpine njashtu asht e paprekshme në nderë, pse nderin e saj e ruen gjinija e shpija ku vjen, vllaznija e fisi brez mbas brezit»⁶⁹.

«Njimend se fjala mort nuk ba; thuhet në një normë tjetër të dorëshkrimit, por në çdo rrethanë jeta, nderi i nanës, i motrës ose i gruas do të jet i paprekshëm kushdo kjoftë nieri me të cillin ajo flet»⁷⁰.

Dhe më poshtë ky mendim zgjerohet më tej: «Bariu i maleve të kanus, po guzoi kush me i vu gojë në nderë të nanës, të motrës ose të grues, ka me ba dekën aty për aty e me qitë pushkë, tue çue gjak te shpija edhe pa pëvetë kurrnji rob shpijet; në ket rasë asnji nieri i Kanus, — se robt e shpis jo qi jo, — nuk ka për t'ia pru për një punë të keqe e shpis për mprojen e nderit (pse jeta e keqe harrohet, por fjala e keqe as falet as harrohet, e ma mirë i fikun se i koritun»⁷¹.

Në një normë që trajton një shfaqje konkrete të prekjes së nderit të gruas-atë të rrahjes së saj nga personat e tretë thuhet në mënyrë të prerë: «Guxoi kush me rrahë vajzën e gruen asht njiipërnji si me rrahë një mashkull të shpis, pra krejt robt e nji shpije e kanë nderin baraz faqe kanunit»⁷².

Në norma të tjera të dorëshkrimit i mëshohet një objekti tjetër të këtij problemi-paprekshmërisë së gruas në veprimet luftarake.

«Grueja në luftë asht e paprekshme thuhet: I poshtër asht aj qi vret një grue kjoftë edhe prej mbrendanit të ndoi ngujimi kur kjo t'afrohet me shti zjarmin shpis së gjaksit të Kanus»⁷³. Dhe më hollësisht: «Grueja shqiptare prin nëpër flakë të pushkvet për me i qitë zjarmin në derë të ngujuemit, gjaksit të rrethuem prej fisit e s'guxon kush as së mbrendanit as së jashtëmit me i vue pushkën grues shqiptare qi zbaton Kanunin pa kenë i fikun e i koritun»⁷⁴.

«Grueja qi rrëzohet prej pushket të ndaj të poshtrit nsa ajo zbaton

⁶⁸) Është me interes të përmendet në lidhje me këtë problem edhe ky shënim i Gjeçovit i mbajtur në disa fletë të shkëputura që ndodhen në bibliotekën e Shkodrës: «Cuca e gra shqiptare me zemër burrash:

— Shalnjaneja në kohë të Vezirit të Shkodrës.
— Mirditoreja marrë gjakun e t'birin në Gjakovë.
— Shalnjaneja qiti pushkë n'Shkodër për me pague t'vëllan (Mire Çuneja 1910)
— Cuca t'unejnë ndër Malëcina tona veshen si djelm dhe armatosen e tjera.
— (N'kohë t'luftës qi u ba n'Kallmet me 18.V.1912), sa vriteshin burrat e dheut me ushtri të turkut, grat e Kallmetit lshoheshin pors i zënë m'it ndër ushtarë të vram u zgjeshin rrypat e fishekvet e u mereshin armët Mauxerrë edhe i çojshin burrave të dheut tonë të rreshtuem në luftë».

69) D. Gj, f. 17, nr. 69.

70) D. Gj, f. 17, nr. 71.

71) D. Gj, f. 17, nr. 72.

72) D. Gj, f. 22, nr. 159.

73) D. Gj, f. 17, nr. 70.

74) D. Gj, f. 20, nr. 114.

triumfnisht parimin e kanus vehet gjak për gjak me atë burrë, qi fisi për të do të vrasë në ngujim»⁷⁵.

Normat lidhur me mikun Gjeçovi i ka përndarë në disa pjesë të Kanunit por ai i trajton sidomos në kryen e tetëmbëdhjetë të librit të tetë që kish si titull «Ndera shoqërore». Në këto pjesë të Kanunit në veprën postume (§ 602) thuhet: «Shpija e shqiptarit asht e zotit e e mikut».

Këtë sentencë Gjeçovi e ka zhvilluar në këtë mënyrë në një normë të dorëshkrimit:

«Nderimin ma të madh mbas Zotit, kanuja urdhnon me ia ba mikut, haj i dheas, a i fisit, haj mik e armik ose i çdo besimit aj kjoftë, kur t'i thërrasë si kundrejtose te dera asht miku i shpis, hija e Tymzot»⁷⁶.

Një saktësim tjetër i Gjeçovit që nuk thuhet shprehimisht në Kanun megjithëse del nga konteksti është ai i nderimit sidomos të mikut të largët: «Mikut sa më i largët të jet e sa ma i randë⁷⁷, aq ma të madh ia jep Kanuja nderën e rojën»⁷⁸.

Në dorëshkrim flitet veçanërisht dhe për mikeshat: «Mikeshat kanë nderë në votër të gravet e vend e shtroje të posaçme atje. Mikeshat e vjetra e të ndershme kanë leje me ndejë kah burrnimi (por jo me fjetun)⁷⁹.

Përcjellja e mikut gjatë së cilës vazhdon ndorja e zotit të shtëpisë për çdo cënim që do t'i bëhet atij është një nga detyrimet kryesore që kërkojnë rregullat e mikpritjes sipas kanunit. «Miku do të përcillet deri ku të lypë me e përciellë» — thuhet në paragrafin 621 të Kanunit. Më poshtë kanuni parashikon mundësinë që përcjellja të bëhet edhe me një fëmi, sigurisht kur rrethanat janë të tilla, duke mbetur në të gjitha rastet nën përgjegjësinë e të zotit të shtëpisë. Në dorëshkrim gjendet një normë që përcakton konkretisht si një detyrim të të zotit të shtëpisë që përciellja të bëhet mik pas mikut deri përtej kufijve të bajrakut.

«Miku kur ta përcjellish do t'ia dorëzojsh njëj të besueshmi e miku, ta përcjellë dorë më dorë të shëndoshë, deri qi ta xjerrësh përtej kufijve të bajrakut tand⁸⁰. Për mikeshat sipas dorëshkrimit detyrimi i përcjelljesh mund të mbërrijë deri te shtëpia e saj. «Miksha, si bija, po s'pat me ke të besueshëm me dredhun te shpija e vet, asht detyrë kanujet të përcillet mje ke të dueje a mje ke shpija e vet»⁸¹.

Arsyeja e përcjelljes është kryesisht mbrojtja e tij nga ndonjë cënim prej të tretëve. «Po e gjet gja mikun thuhet në dorëshkrim, — (plaçkë e rrafme, e vrame a e shitueme) — i thehet në dorë atij të cillit i hangri bukën e mbrame e atij qi asht tue e përciellë, e ai qi ia dorëzoi, i ban za atij qi e muer me e përciellë: «Çë ma tane atë mik qi ta dorëzova, shëndosh?»⁸².

Por arsye tjetër, sigurisht, e dorës së dytë e përcjelljes është edhe

75) D. Gj, f. 20, nr. 115.

76) D. Gj, f. 22, nr. 162.

77) Për randësin e mikut Gjeçovi ka bërë një diferencim në § 611 e vijnë duke e përcaktuar edhe mënyrën e pritjes së tyre.

78) D. Gj, f. 16, nr. 34.

79) D. Gj, f. 16, nr. 41.

80) D. Gj, f. 15, nr. 48.

81) D. Gj, f. 15, nr. 37.

82) D. Gj, f. 15, nr. 49.

parandalimi i dëmeve që mund të bajë vetë miku pse për to përgjigjet i zoti i shtëpisë. Në paragrafin 628 të Kanunit thuhet: «Kanuja urdhnon qi të përcillet miku sa mos ta gjejë ndoi punë e ligë, sa edhe mos t'i bajë kuej ndo i dam në bukë t'ande». Më tutje përcaktohet se i zoti i shtëpisë do të lajë çdo dëm të mikut, «qoftë për vath të thyem, qoftë për tufë të marrun e pretime tjera», duke u detyruar të shpërblejë këto dëme edhe duke vënë kumbonën e tufës në tra (të shesë përçorin që është simbol duke hjekun kaun e hullisë e duke shitur rendin e ujit (§ 635-636 KLD), që janë sakrificat të mëdha materiale e morale të të zotit të shtëpisë në Malësi.

Por çdo gjë ka kufi, ndryshe do të mbahej një qëndrim donkishotësh që bonsensi popullor nuk e njuh dhe as e përligj. Prandaj kanuni parashikon edhe detyrimet e mikut krahas vargut të të drejtave të tij që janë shfrytëzuar kaq shumë edhe në veprat letrare të asaj kohe. Në dorëshkrimin e Gjeçovit ndodhet ky detyrim kryesor i mikut: «Miku çdo mik do të rrijë si mik përndryshe nuk i delet zot për mik»⁸³.

Këtë sentencë lakonike e gjejmë të zhvilluar më gjerë në një normë tjetër të dorëshkrimit: «Në daç me u quajtë si mik i njimendet shko me mend, rri si mik e mos shpenzo bukën se/as Kanuja, as nierzit s'të biejn mbrapa pse kush then qafën vetë as s'i lan kush gjakun as s'e lypë kush»⁸⁴.

Prerja e mikut është një dhunë jashtëzakonisht e rëndë që i bëhet nderës shoqërore «sipas Kanunit» dhe është trajtuar gjerësisht edhe në veprën e Gjeçovit.

Megjithatë në dorëshkrim ka mjaft plotësime që ndriçojnë në mënyrë të gjithanshme aspektet e veçanta të këtij instituti tipik të së drejtës sonë kanunore.

«Miku — thuhet në dorëshkrim shkurt-kuj s'i preket: po u prek s'falet»⁸⁵. Dhe një normë tjetër e dorëshkrimit me përmendjen e rasteve kryesore të prerjes së mikut: «Gjaksi i pabesë qi të bani za, i ndezë llullën, të muer kafshoren e bukës, të hiji për roje në tufë të krenvet tua të xu emnin në çast të ngushtë, tue u hullë kah oborri yt, po e gjet gja e ligë të pritët mik»⁸⁶.

Hakmarrja për mikun e prerë sipas Kanunit është detyrimi më i lartë moral për malësin, që nuk merr parasysh sakrificat. «Kush pagoi mikun në Kanu, xehet përtej se i ndershëm veçse fiket vetë»⁸⁷ thuhet në dorëshkrim⁸⁸.

83) D. Gj, f. 15, nr. 35.

84) D. Gj, f. 15, nr. 50.

85) D. Gj, f. 16, nr. 42.

86) D. Gj, f. 16, nr. 47.

87) D. Gj, f. 16, nr. 43.

88) Në disa fletë të shkëputura të Gjeçovit që ka biblioteka e Shkodrës është ky shënim i tij mbi këtë problem: «Miku m'kjan zemra se m'ke pre mikun? m'duhet me t'vra jo jo (jo n'mosë) me t'shti beu me 24, po t'lau porota m'ligjove jo jo ma fort m'ke kokën një mik t'pre t'kërkoj si me m'pasë një gjak: ene besë rallë se t'ap; as bile askush s'e shkon n'për mend me hi për besë mikut = do a do ndërmjecë sa ku t'marrin e t'apin e t'zbatohet puna.

Në rast të kundërt, kur nuk merr hakun e mikut, njeriu është i turpëruar e i bojkotuar pa mëshirë për tërë jetën, ai ka vdekur moralisht.

«Ma i madhi shnjëzim asht me ken mikprem»⁸⁹. Mikpremi s'mund të duket ndër bashkime, aj s'ka shka ban me shokë. Hije e zezë randon mbi të e mbi vëllaznin e tij deri ditën qi të lajë vedin edhe mikun; pse gjaku falet edhe me kanu, por ndera s'i falet kuj»⁹⁰.

Në lidhje me këtë problem një rëndësi të madhe ka kjo «Oroe» e dorëshkrimit të Gjeçovit që ve në dukje një veçori lokale që bën përjashtim nga rregulli i njohur se hakmarrësi i mikut të prerë mbetet në gjak!

«Në Shalë, thuhet në këtë Oroe, asht kanu vendit që po ja preu kush mikun kujt, nuk e kërkon gjakun shpija e të vramit por mikpremi. Kur mikpremi vret gjaksin e mikut, lan vedin e merr gjakun e mikut e vehet krye për krye me mik e s'i vjen në gjak kuj. Ndërsa në vende të tjera lan vedin, por jet në gjak»⁹¹.

VII

Në librin e nëntë të kanunit trajtohen «damet» dhe në librin e dhjetë «Kanuni kundra mbrapshtivet». Në lidhje me këto norma në dorëshkrimin e Gjeçovit ndodhen disa saktësime interesante që plotësojnë zbrazësitë e Kanunit.

Kështu lidhur me dëmshtëpërblimet Gjeçovi ka saktësuar një varg të gjatë rastesh sipas praktikës lokale të bajrakëve të Matit e të Thkellës,

Për «kanunin e mbrapshtivet është interesante sidomos një normë e dorëshkrimit që i kushtohet rrahjes të cilat plotësojnë në mënyrë lakonike e sentencioze në kuadrin e kanunit për këtë vepër që prek në radhë të parë nderin.

«Shndërrimi ma i madh, që mundet me iu ba njëj pjestarë të familjes është rrahja, dhunë kjo qi nuk lahet ndryshe veçse me pushkë pse kanuja thotë: e matnja si e ramja, e ramja si e vramja»⁹².

Gjithashtu për gjakun në dorëshkrimet e Gjeçovit gjendet një formulim lapidar i parimit të njohur: «Te gjaku asgjësend nuk hupë»⁹³ dhe gjithshka kalbet, por gjaku s'kalbet kurr (d.m.th. vrasa s'harrohet kurrë)⁹⁴.

Në dorëshkrim ndodhen edhe disa norma të tjera lidhur me vrasjen. Në radhë të parë saktësohet kuptimi i shkarjes në besë si një derogim nga rregullat e përgjithshme të Kanunit që ndjek sistemin akuzues, d.m.th. që i beson vendosjen e drejtësisë të interesuarit dhe ndiqet «ex officio» nga gjithë katundi e jo si një objekt hakmarrjeje thjesht vetiake:

«Me vra kush në besë grihet katundisht»⁹⁵.

Një normë tjetër interesante që i shmanget rregullit të vjetër diskriminues sipas të cilit gjaku i gruas vlen sa gjysma e atij të burrit e shtron

89) D. Gj, f. 24, nr. 164.

90) D. Gj, f. 24.

91) D. Gj, f. 24.

92) D. Gj, f. 22, nr. 160.

93) D. Gj, f. 12, nr. 1.

94) D. Gj, f. 14, nr. 29.

95) D. Gj, f. 27, nr. 163.

këtë problem si një cënim të nderit që siç e trajtuam edhe më sipër është i barabartë për gjithë pjesëtarët e familjes:

«Gjaku i burrit e i gruas barabar, erzi i burrit e i gruas barabar»⁹⁶.

Pastaj vijnë një varg normash që përcaktojnë sidomos përgjegjësinë e vrasjes në familje e ku mbisundon parimi patriarkor e që plotësojnë e saktësojnë paragrafet 960 e vijues të KLD.

Më në fund lidhur me librin e dhjetë «Kanunit kundër mbrapshtive» në dorëshkrimin e Gjeçovit ndodhet edhe një normë që ka të bëjë me pajtimin e plagosjeve, me që problemin e caktimit të bukës së gjakut, d.m.th. të pajtimit e ka trajtuar në pjesën e parë të dorëshkrimit si shtesë të paragrafit 982 të Kanunit. «Kur të pajtohet varra lokale ka gjysmë gjaku, e varra e lehtë ka gjysmën e gjysmës së çmimit»⁹⁷.

VIII

Në librin e njëmbëdhjetë «Kanuni i Pleqnis» në dorëshkrimet ka mjaft norma që kanë të bëjnë me porotën, benë që bëhet nga një numër betarësh sipas rëndësisë së fajit që i ngarkohet kujt.

Qysh në fillim, një formulim më i plotë i paragrafit 1043 që thotë: «Parimi i kanunit asht: «Beja ka porotën, porota ka mundin në hetime e të lidhmen». Në dorëshkrim thuhet në mënyrë koncize e sentencioze: «Mohi ka ben, beja porotën, porota mundin e të lidhmen»⁹⁸.

Një normë nga më të fundit të Gjeçovit, që mban shënimin: Gjakovë 16.II.1928 trajton problemin e procedurës së zëvendësimit të betareve që nuk paraqiten: «Ndër poronikë të shenjueme në kjoftë kush i betuemos me shkue në be ose e mënin të zon e bes, i zoti i bes do t'i diftojë atij, qi e lypë ben në krye të 24 orëvet»⁹⁹, përndryshej jet ajo porotë e shenjueme e nuk ndërrohet ma»¹⁰⁰.

Lidhur me numërin e porotës në dorëshkrim ndodhen mjaft norma interesante nga të cilat disa për raste të veçuara e disa për një varg rastesh.

«Me ia pre shoqit kush mikun, i kërkohen 6 vetë betare e katër qese të zotit po mbet në be»¹⁰¹.

«Poronikë (betare a pleqe beje) për ka do të qiten 6 veta, për lopë 4 vetë; për mushkë 6 vetë, për gomar 6 vetë; për thi 5 vetë; për dhi 2 vetë, për gjak të burrit 24 vetë, për gjak të grues 12 vetë»¹⁰².

Dhe në një vend tjetër: «Hjeksia ka 12 vetë betare kur të jet në mohim, gjaku ka 24 vetë, arma e vjedhun 12 vetë; vija e thyeme 6 vetë; shpija e djegur 12 vetë; mullari i djegun 12 vetë; kësolla e gardhi 6 vetë;

96) D. Gj, f. 15, nr. 133.

97) D. Gj, f. 14, nr. 32.

98) D. Gj, f. 14, nr. 21.

99) D. Gj, f. 13, nr. 11.

100) Këtu ka një mëngesë që e bën frazën e varur dhe pa kuptim. Mendojmë se duhet të jetë fjala për emrat e poronikëve të tjerë që do të zëvendësojnë ata që munguan.

101) D. Gj, f. 13, nr. 9.

102) D. Gj, f. 14, nr. 21.

kali e mushki 8 vetë; kau e lopa 6 vetë; delmja e dashi 3 vetë; kumbona e oqiçit e vjedhun 4 vetë, pema (landa) e preme 5 vetë e një pendë qe gjobë¹⁰³.

Një normë tjetër me këtë karakter: «Varra e pushkës, qi e len nierin me mohë (invalid) ka 12 poronikë (6 e 6), varra e lehtë, qi nuk e len nierin me mohë ka 6 poronikë (3 e 3)¹⁰⁴.

Pas bërjes së besë, një nga saksionet që shënohet në dorëshkrim në disa vende është ai i thyerjes së armës:

«Kështu» Po rrahi kush një burrë thuhet-do t'i thehen armët po mbet në be» dhe më poshtë një «Oroe» që është vendosur gabimisht në normën e mësipërme) ku thuhet: «Edhe Hasi e ka pasë me thye armët»¹⁰⁵.

«Armët i then a kreu i fisit të fajtorit ose kreu i gjithë katundit»¹⁰⁶.

«Kush të jesë në be për shpi të gjueme, bajraku ia then armët në mjedis të logut të Kuvendit, faqe bajrakut të mbledhun»¹⁰⁷. Dhe në një vend tjetër një normë me karakter fetar që tregon qartë ndërhyrjen e klerit në punë të kanunit: «Posë armvet të coptueme, famullitari (në marrëveshje të krenave a edhe ai vetë) i ep një pendësë të randë fajtorit kohën e Meshës përpara popullit të mbledhun, d.m.th. a me bajtë gurin e qirin, a me dhanë aq e aq dyll a edhe i pritshin një gjobë të hollash, të randë a të lehtë simbas peshimit të fajit»¹⁰⁸.

Në këtë libër ndodhet edhe figura e Kapucarit për të cilin Gjeçovi në dorëshkrimin e tij ka vetëm ndonjë formulim më të qartë siç është ai që i takon paragrafit 1090: «Kapucari në rrenë lan damin në vend të cubit»¹⁰⁹ dhe një plotësim për sa i përket pagesës së kapucarit në të kaluarën: «Kapucaria e hershme me dorë në be: 50-500 grosh»¹¹⁰.

Edhe për vendet e kuvendit në dorëshkrim është vënë kjo normë që duhet të zëvendësojë paragrafin 1112 që bën fjalë për faktin se kuvendet mbahen a ndër oborre kishash a ndër rrënime të vjetra faltoresh a në zemër të vendit. Caktimi konkret i këtyre vendeve në të gjithë Shqipërinë ku zbatohet kanuni, listën e të cilëve e ka plotësuar Gjeçovi në dorëshkrimin e tij, megjithë rezervat që mund të kemi sidomos për jugun, tregon se ky përcaktim i kuvendeve nëpër faltore nuk është shumë i saktë. Prandaj këtë normë Gjeçovi e ka formuluar kështu në dorëshkrim:

«Se i cilli mal e fis e ka të caktuem qysh prej të parësh vendin se ku do të bëhet mbledhja e dheut. Nëse do të bahet kuvendi në tjetër vend qi mos të jet i kadimis (jetik) po ranë në fjalë të gjithë xen vend e ngulë»¹¹¹.

103) D. Gj, f. 11, nr. 7.

104) D. Gj, f. 15, nr. 32.

105) D. Gj, f. 15, nr. 30.

106) D. Gj, f. 15, nr. 30. Në një dorëshkrim të Gjeçovit që ndodhet në bibliotekën e Shkodrës është një letër jo e plotë që Gjeçovi ia drejton një kolegu të tij fetar në Mirditë në të cilën i kërkohet si në formë ankete të shënojë sasinë e gjobës dhe numrin e poronikëve që duhen sipas llojit të veprës që caktohet konkretisht prej tij. Kjo shpjegon edhe pse ky problem është trajtuar në disa norma të veçantë të dorëshkrimit.

107) D. Gj, f. 11, nr. 2.

108) D. Gj, f. 15, nr. 31.

109) D. Gj, f. 14, nr. 23.

110) D. Gj, f. 14, nr. 24.

111) D. Gj, f. 13, nr. 15.

«Në rasë lufte ose për ndoi çashtje jetësore për fis, mbas kushtrimit qi qet bajraktari do të bashkohen burrë për shpi në log të Kuvendit»¹¹².

Pas caktimit të vendeve të tjera të Kuvendeve Gjeçovi, në pjesën e pasistemuar të dorëshkrimit ka lënë edhe këtë «Oroe». «Edhe Labëria ose Arbëreshët e Tosknis bajn kuvende mbas Kanunit të Lekë Dukagjinit e krahi qi i afrohet Gjinokastrës thonë: me ba Kuvend mbas Kanunit të Pirrit». Ky pohim i Gjeçovit që është disi kontradiktor mendojmë se synon të theksojë lashtësinë e kanunit, vazhdimësinë e tij prej Pirros deri te Leka dhe unitetin e së drejtës sonë kanunore në normat themelore të saj, i cili buron nga uniteti i traditave të etnisë iliro-shqiptare.

Mjaft të rëndësishme janë shënimet e Gjeçovit lidhur me detyrat dhe zhvillimin e kuvendeve të cilat shprehin disa norma kushtetore që theksojnë një aspekt të rëndësishëm të demokracisë fisnore dhe të lirisë së malësorëve të vendosin sipas parimit «burrë për shpi» për të gjitha çështjet dhe të kërkojnë zbatimin e vendimeve të marra në Kuvend, duke kufizuar kështu pushtetin e aristokracisë fisnore, të krerëve e pleqve. Për këtë janë krijuar edhe organizma të posaçme si stërpleqtë e vogjlja, sidomos djelmnia e Shalës që kanë të drejtën e vetos mbi çdo vendim të padrejtë të krerëve e pleqve. Këto organizma që janë arritje të vegjëlisë gjatë procesit të luftës klasore, kanë luajtur një rol të spikatur përparimtar kundër «rushateve» e korrupsionit të krerëve dhe janë bërë flamur i lëvizjes kryengritëse të malësorëve në dhjetëvjetorin e parë të këtij shekulli, të udhëhequr nga trimi Mehmet Shpendi.

Mbledhjet qi bahen për ushtrimin e pushtetit në fis ose për caktimin e ligjvet të reja e për zbatimin e tynvet quhen Kuvende»¹¹³.

Është e vërtetë se sipas paragrafit 1116 të Kanunit, «ndër gjyqje e peshime Krenët e Pleqtë rrijnë në vedi e vogjlja në vedi, për çështjet e randa qi i përkasin njëj fisi mbarë do të peshohen e do të pleqnohen prej krenvet të fisit bashkë me pleq, stërpleq e vogjli, ndërsa çashtjet qi i përkasin njëj krahine mare... do të peshohen ndër kuvende të përgjithshme «burrë për shpi» §§ 1125, 1126).

Në dorëshkrim ka një normë që rregullon procedurën që ndiqet kur mungojnë në kuvend dy krenë të mëdhej, si dhe disa norma që kanë të bëjnë me mënyrën e zhvillimit të kuvendeve në përgjithësi dhe në rast lufte, të cilën kanuni i botuar nuk e ka trajtuar shprehimisht.

«Po munguen dy krenë të mëdhej, thuhet në dorëshkrim, pa çue fjalë se janë zanë e nuk të dalin në kuvend, çdo punë qi ta pleqnojë e ta këpus Kuvendi nuk mund të qitet në zbatim. Si të bashkohen e të shihen, atëbotë shumica e then pakicën»¹¹⁴.

«Mndyra e Kuvendeve thuhet më tutje në dorëshkrim asht kjo: mbasi të bashkohen pari, krenë e bajraktarë e djelmni të vllaznivet të fisit, bajraktari ose njaj krye, të cillit aj i thotë me folë, merr fjalën i pari në mbledhje, ku i paraqet mbarë fisit arsyet e bashkimit»¹¹⁵.

«Mbas njëj bisedimi të shkurtë të gjitha vëllaznit dahan m'anash

112) D. Gj, f. 20, nr. 150.

113) D. Gj, f. 19, nr. 103.

114) D. Gj, f. 13, nr. 16.

115) D. Gj, f. 20, nr. 106.

për peshimin e çështjes në lidhni me vëllazin të vet e me mbarë fisin»¹¹⁶.

«Atëherë prap të bashkueme, rrihet haptas çashtja ku gojtarët ma të mirët paraqesin një mbas një mendimin e vet për të mirën e përbashkët»¹¹⁷.

«Ndër çashtje të kapërthyeme e ma me randsi shënjohe krenë, të cilët si për parsi e zotsi mendje, ashtu dhe për ndërgjegje gëzojn uzdajen e mbarë fisit. Vendimet e ktyne kanë fuqi ligjë për tanë fisin»¹¹⁸.

Proçedura e zhvillimit të kuvendeve në rast lufte ka edhe këtë karakteristikë se kërkon paraprakisht besëlidhjen e të gjithë atyre që janë në gjak. «Në rasë lufte të vëllaznis me vëllazin, të fisit me fis ose të maleve me të dheas, ma e para punë qi do të bahet asht me lidhë besë për gjaqe e varre me shoqi shoin e me gjithkë të duejë me lidhë besë me fis. Gjaksit në këtë rasë bahen shokë e vëllazën e luftojnë krahas kundra anmikut të përbashkët deri në ditë të shenjuem prej beset të lidhun»¹¹⁹.

«Kush shklet besën e vret nierin ndër këso rasash, përveç që njuhet si ma poshtri në fis brez mba brezit, aj e tanë barku i tij digjet, piqet e qitet jashta fisit e as bijën e tij s'dishron kush me e marrë për grue, pse kotillë e keqe e e pabesë djalë mbas djalit aj ka mbetë»¹²⁰.

«Mbas shejit të kushtrimit të dhanun prej bajraktarit rran tanë fisi; e në kjoftë se do të msyhet ndoi ngujim ose ndoi ballkon lufte, se i cilli krye asht edhe njiheri komandant i vëllaznis së vet nën kryesin e bajraktarit»¹²¹.

«Krenët e njëj fisi në luftë të fisit me fis e pricat e këtyrvet në rasë të njëj lufte mal me mal, ose të malevet me një anmik të përbashkët, janë prej kanujet pushteti ma i madh shtabet madhore) mbi jet e mbi dekë, mbi mall e gja të shpis e t'ushtris për deri sa të ngjasë lufta me kambë»¹²².

Këto norma të qarta nuk kanë nevojë për koment. Ato ndriçojnë e venë pikat mbi «i» në disa kompetenca të Kuvendit që vetëm tërthorazi e në mënyrë jo të plotë janë prekur nga normat ekzistuese të Kanunit të botuar.

Ashtu si për Kuvendin Gjeçovi ka siguruar në dorëshkrimet e tij një varg normash që trajtojnë në mënyrë të plotë e tërësore, krerët e pleqtë dhe në përgjithësi format e procedimit të organizmave me karakter shoqëror-publik, që kanë patur funksione të mirëfillta vet-qeverisjeje në malet ku shtrihet juridiksioni i Kanunit të Lekë Dukagjinit. Kjo formë rregullimi, e trashëguar brez pas brezi, ka marrë një zhvillim origjinal, në kushtet e autonomisë pothuajse të plotë të maleve tona të Veriut dhe të vetqeverisjes fisnore, pa organizma të mirëfillta shtetërore, megjithë shartimet e pashmangshme me organizmat e krijuara nga pushtuesi turk si bajraktarët, bylykbashët e sergjendet e xhibalit sidomos pas Tanzimatit.

Krerët e pleqtë fillimisht nuk dalloheshin nga anëtarët e tjerë të bashkësisë as në të drejtat dhe as në detyrimet. Parimi i njohur i Kanunit i konsideron të gjithë të barabartë. Mirëpo procesi i diferencimit klasor

116) D. Gj, f. 20, nr. 107.

117) D. Gj, f. 20, nr. 108.

118) D. Gj, f. 20, nr. 109.

119) D. Gj, f. 20, nr. 110.

120) D. Gj, f. 20, nr. 111.

121) D. Gj, f. 20, nr. 112.

122) D. Gj, f. 20, nr. 113.

bëri që dalë nga dalë këta të zenë pozitat e privilegjuara të aristokratëve fisnorë, të lidhen drejtpërdrejt apo tërthorazi me pushtetin osman dhe të bëhen të trashëgueshëm.

Kjo del disi edhe nga normat e dorëshkrimit që megjithatë në këtë aspekt nuk janë të thelluara, sidomos për sa i përket rolit të bajraktarit që ka një trajtim global të padiferencuar dhe nuk merr parasysh veçoritë lokale si dhe faktin se në disa vende bajraktarët që fillimisht kanë patur vetëm funksione luftarake, nuk janë njohur si organe drejtuese mbi krerët.

«Organet e bajrakët — thuhet në dorëshkrim —, janë bajraktarët e krenët (e mëdhej e të vagjël ose vojvodët)»¹²³.

«Bajraktari asht kryet e mbarë njëj bajraku e pushtedi me i naltë në një fis¹²⁴. Këtij i përket prija në kohë paqe e në kohë lufte brez mbas brezit»¹²⁵.

«Krenët ose kambët e fisit, ose të parët e vëllaznivet të mëdhaja, prej të cilave përbahet mbarë fisi, janë ndihmsat e bajraktarit»¹²⁶.

«Bajraktari ose kryetari i fisit nuk mund të marrë kurrnji vendim as nuk mund të vejë kurrnji ligjë pamvartas prej kambvet të fisit, qi quhen edhe krerët e mëdhenj. Këta janë ligjédhanas në paqe e prisat ushtriye në luftë»¹²⁷.

«Mbas krenvet të mëdhej vijn krenët e vegjël ose të parët e vëllaznivet të vogla. Këta quhen vojvodë»¹²⁸.

«Secili krye ka një ndihmës të caktuem të vetin, qi mbas kanujet quhet djalë»¹²⁹.

«Bajraktarët, krenët, vojvodët, prisat e vallaznivet n'ushtri-tagrin e paris e ushtrojn mbas kanuje, djalë mbas djalit»¹³⁰.

Ndër funksionet kryesore të organeve lokale të vetqeverisjes ai gjyqësor ka një rëndësi të veçantë. Sikurse e ka vënë në dukje K. Marksi, në lashtësi, gjithë pushteti zyrtar në kohën paqësore ishte sidomos pushteti gjyqësor¹³¹. Prandaj edhe në dorëshkrim Gjeçovi i kushton mjaft norma procedurës së gjykimit duke e plotësuar me të zbrastme e Kanunit.

«Për mprojen e të gjithë tagreve të së cillit e të përbashkëta e për dënimin e fajsis ushtrohet drejtësija prej pleqve të Kanus»¹³².

«Plaku i Kanus asht gjyqtar nën be, i paanshëm e krejt i pamvarshëm»¹³³.

«Se i cilli nieri ndër male të kanus e ka për detyrë me i ardhë shoqit në rrugë (me i dhanë arsye), kur ai t'i bjerë në dorë për ndoi an-

123) D. Gj, f. 19, nr. 96.

124) Këtu Gjeçovi është konfunduar pse bajraku është një nocion territorial pavarësisht se në disa raste shtrirja territoriale mund të përputhet me bashkësinë fisnore.

125) D. Gj, f. 19, nr. 97.

126) D. Gj, f. 19, nr. 98.

127) D. Gj, f. 19, nr. 99.

128) D. Gj, f. 19, nr. 100.

129) D. Gj, f. 19, nr. 101.

130) D. Gj, f. 19, nr. 102.

131) K. Marks dhe F. Engels, Veprat, bot. rus f. 336.

132) D. Gj, f. 20, nr. 116.

133) D. Gj, f. 20, nr. 117.

kesë, e me i paraqitë pengun tue shenjue se i ve plakun ose pleqët e vet»¹³⁴. «Plaku mund të jetë çdo burrë i kanus»¹³⁵. «Pleqët në ditë të caktueme e në vend të caktuem bashkohen ndiejn ankimet e dy lagjevet e mbas njij bisedimi të këthellë ba në themel të ligjeve të kanus, shprehin vendimin, tue u diftue të gatshëm me *gurin e bes* për gjyq të paanshëm të bam mbas kanujë»¹³⁶.

«Në rasë se pleqvet u lypet beja, atëherë këta kanë të drejtë me lypë shpërblimin e pleqnis»¹³⁷.

«Po kje se njani ndër ankuesa i kundrështon pleqnis, mbas pengut të dhanun pleqvet, pleqnohet pleqnija me pleqë të tjerë, tue zgjedhë pleqët ma të përmendun në fis deri te pushteti ligjuer ma i nalti, te dera e Gjomarkut në Mirditë, te dera e Ndarës në Lumë e në Dibër, te bajraktarët e Shalës e të Shoshit në Dukagjin, të Zotnit e Iballës në Pukë. Këta dyer Kanuja i njef si dyer apeli për peshimin e çdo çashtjeje qi s'mund të peshohet prej pleqvet të vëllaznivet ose të fisit»¹³⁸.

Nga kjo normë, që Gjeçovi e ka vënë në mënyrë të prerë e kategorike, duke zgjeruar të drejtën e apelimit të çështjeve pa dallim objekti dhe jo vetëm të Gjomarkajt në Mirditë, por edhe në krahinat e tjera të juridik-sionit të Kanunit të Lekës, del se apelimi nuk është përjashtim po rregull.

Ky pohim i Gjeçovit vjen në kundërshtim me një varg normash të Kanunit të botuar që flasin për parimin se plak mbi plak nuk ka etj. (§ 1034-1037) dhe e largon gjykimin e pleqve nga karakteristikat e procesit akuzues, duke e veshur me tipare të procesit feudal që njeh si rregull hierarkinë e gjyqeve.

Mënyra solemne, me të cilën «vritet pleqnia» siç del edhe nga norma e mëposhtme e dorëshkrimit të Gjeçovit, tregon pikërisht se palët kanë besim te gjyqi i pleqve që u kanë dorëzuar pengun, duke u betuar që më parë me këtë se do t'i përmbahen vendimit të dhanë prej tyre.

«Kur të hetohet — thuhet në këtë normë—ndonjë plak si ka ba pleqni me krah, o caktum prej mndoresh, atëbotë grishet dheu në Kuvend e përmbasi ta qesin për fushë faqen e zezë, i shfrazin pushkat përpjetë, tue britë njijzanit: «Pleqnija (a gjyqi) e këtij plaku kjoft vra». Ai, plak mbarote ma, sepse askush s'e merrte ma për plak, tue mos i xanë besë kush, si të delte i zhye prej nëndoresh»¹³⁹.

Është e vërtetë se këtu kemi të bëjmë me rastet e shpërdorimit të detyrës nga ana e pleqve që sigurisht nënkupton edhe rishikimin e themel-it të çështjes të zgjidhur qëllimisht me anësi¹⁴⁰. Përsa i përket apelimit me efekt pezullues e derogativ tek instanca më e lartë, mendojmë se përveç Gjomarkajve në Mirditë, që kanë patur një pozitë «sui generis», funksione të rregullta rishikimi të vendimeve të apeluara nga palët vështirë të ketë parashikuar Kanuni, pavarësisht nga ndonjë referim që është

134) D. Gj, f. 20, nr. 118.

135) D. Gj, f. 21, nr. 119.

136) D. Gj, f. 21, nr. 120.

137) D. Gj, f. 21, nr. 121.

138) D. Gj, f. 13, nr. 20/Oroe/ dhe f. 21 nr. 122.

139) D. Gj, f. 13, nr. 10.

140) Në këtë drejtim flet edhe § 1038 i KLD dmth. për rastet kur të bëjnë me gjyq» me krehnat e pa rrugë».

bërë në këtë drejtim) për Ndocajt, bajraktarët e Shalës e të Shoshit apo zotrijt e Iballës. Praktikë e mirëfilltë e konstante që ta vërtetojë këtë pohim kategorik të Gjeçovit nuk është konstatuar. Prandaj kjo normë, ashtu sikurse edhe normat që kanë të bëjnë me funksionet e Derës së Gjomarkajve që Gjeçovi i ka trajtuar si universale janë mjaft të diskutueshme e kontradiktore dhe stonojnë me parimet e njohura themelore të Kanunit.

Ne edhe për mungesë vendi nuk po i përmendim këtu normat e dorëshkrimit që kanë të bëjnë me Derën e Gjomarkajve si dhe me Kishën¹⁴¹, duke u rezervuar të bëjmë në të ardhmen një sqarim më të gjerë kritik të tyre.

141) Në pjesën e pasistemuar të dorëshkrimeve të Gjeçovit ndodhen edhe disa shënime mbi Kumbarinë që ne nuk i trajtuam duke menduar se i takojnë pjesës së parë të dorëshkrimeve dhe se nuk sjellin ndonjë të re.

ON THE UNSYSTEMATIZED PART OF THE NEW MANUSCRIPTS OF
GJEÇOVI ABOUT THE CANON OF LEKË DUKAGJINI

In his manuscripts Shtjefën Gjeçovi, collector and codifier of the Canon of Lekë Dukagjini, has made several changes of and supplemented the paragraphs of the Canon written by he himself and published initially in separate chapters during 1913 to 1930. In these notes Gjeçovi made some amendments concerning institutions that had escaped treatment in the previous publications. Likewise, he has also established a series of canon norms which he could not manage to systematize.

This publication includes the majority of these norms, with an attempt at their systematization according to content, and their arrangement in the respective books or parts of the post-humous publication of the Canon of Lekë Dukagjini.

Kolë LUKA

KLOS, KËLCYRË, DERVEN, MBYLLÇ, MSHILT NË REPERTORIN ONOMASTIK TË ARBËRVE

E themi qysh në fillim: kemi përpara nesh një institucion që vjen prej kohëve të lashta. Ky përfaqëson një hallkë të sistemit mbrojtës, d.m.th. një plotësues i atyre *castra, castramenta, castella, vici, oppida, poleis* etj. që u përhapën në kohën romake dhe më vonë bizantine të hershme për ta mbajtur vendin në sundim dhe për ta vënë zhvillimin e tij në një hulli perandorake. Në një fazë më të vonë do t'i lënë gjurmët e veta edhe në emërtimet *gradine, gradishte, selë (selo)* etj., që janë shenja pushtimesh të reja: zotërimet sllavo-bullgare dhe sllavo-serbe. Dhe prapë më vonë, nën pushtimin më të ri osman, do të ndryshojë emërtim.

Natyrisht se si plotësia të këtij sistemi kastelologjik dalin edhe *këlcyrat* dhe *kloset*, që vlenin për të ruajtur rrugët. Këto do të zëvendësohen me fjalën më të re: *derven*, një huazim i ri po bizantin, të cilët osmanët do ta gjejnë në krahun e Anadollit dhe do ta bien me vete në viset tona kur do të ngulin në Ballkan sundimin e tyre.

Nuk ka dyshim se midis këtyre shtresave ka edhe ndryshime konceptesh lidhur me vetë fjalën dhe funksionin e saj, sepse kemi të bëjmë me formacione shoqërore të ndryshme në kohë, pra edhe përcaktuesit janë të tjerë. Mjetet e mbrojtjes nuk kishin ngelur në vend: pushtuesit ishin të ndryshëm dhe binin me vete edhe mjetet e tyre që shkonin përherë duke u përsosur. Shekujt bënin punën e vet dhe teknikat poliercetike merrnin përherë e më tepër një fytyrë më të ndërlikuar dhe më të përkryer. Por, kur e shikojmë në vija të përgjithshme, thelbi i kësaj mënyre mbarshtimi dhe sigurimi të pushtuesit mbetet, prandaj ky është një institucion që vjen prej antikitetit deri në shekujt XVIII-XIX, kur ruajtja e rrugëve bëhej tashmë me mjete të tjera. Megjithatë, mbetet gjithmonë, pavarësisht nga mjetet dhe përsosjet e tyre, boshti sintagmatik, ku i përcaktuari shënon orografinë dhe përcaktuesi vendin ku gjendet objekti. Teknikat këtu nuk na hyjnë në punë. Ne do të shqyrtojmë këtu jetëgjatësinë e këtij institucioni.

Përpjekja kryesore është të zërthejmë repertorin e këtyre fjalëve në toponimi, me një zgjedhje në ato ekzemplarë që na kanë mbetur dhe kemi mundur t'i grumbullojmë në gjendjen e sotme të mbledhjeve të toponomastikës në arkivat e sektorëve të Gramatikës dhe të Leksikologjisë-Leksikografisë së Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, në arkivin toponomastik të sektorit të Etnografisë së Institutit të Kulturës popullore, si edhe në botimet onomastike në shtypin e Kosovës ose në mbledhjet e këtyre toponimeve për viset e Çamërisë.

Harrallamb Mihaescu¹ ka vënë re se lat. *Clausura*, biz. Κλεισσοῦρά, bullg e skr. *Klisura*, arum. *Clisură*, shqip *Këlcyrë* janë krijime vendase nga terminologjia ushtarake, dhe si të tilla të pranishme në vendet ballkanike.

Në vendin tonë ne kemi jo vetëm rrjetin e *këlcyrave*, por edhe atë të *kloseve*, me më se njëqind ekzemplarë, madje edhe me trajtat e ndërmjeme të asimilimit të fjalës, me vendet ku ndodheshin, me kontaminimet, me kalimet nga një pushtim në tjetrin më të ri, me një fjalë me kalimin nga pushtimi romak në atë bizantin etj.

Si gjuhë dhe si etnografi gjejmë edhe përkime të plota asimilimi të fjalëve *klos* dhe *këlcyrë*, që shtrihen në mbarë Shqipërinë, në Veri dhe në Jug, asimilim i bërë me të njëjtat mjete. Dokumentacioni të shpie në një kohë kur dialektet ishin më afër njëri tjetrit, dhe kjo përbën një bazë kronologjike. Kemi për më tepër edhe emrat shqip *Mbyllç* dhe *Mshilt* të krijuara si kalke mbi modelet e huaja, por gjithmonë me lëndë vendi.

Është fjala për apelativa që na e japin kronologjinë e tyre të përafërt dhe gjejnë pika takimi dhe në histori, duke pasur parasysh kohën e pushtimeve. Si të tillë, sipas ligjit të shtegtimit të emrit, janë përhapur si fjalë të leksikut në një farë kohe edhe në vende ku nuk e kanë bërë këtë funksion. Dhe kjo është edhe një gjurmë lashtësie. Me këta emra janë emërtuar edhe kroje, përrenj, shpate malesh, maja etj. të cilët nganjëherë kanë mbetur edhe të vetmuar ose kanë ruajtur gjurmën e një *klosi* ose të një *këlcyre* në ato afërsi, ose, ndonjëherë kanë zënë edhe vendin e njëri tjetrit sipas pushtimeve. Nga mbajtja e këtyre emërtimeve, në disa vendbanime në Veri dhe në Jug, kemi mjaft emra të tillë në onomastikë si patronime, sepse janë shumë të vjetër. Edhe vetë shpeshtësia është një element, që e tregon më së miri këtë vjetërsi.

Natyrisht se ky proces ka ecur duke zhdukur gjurmë të mëparshme, sepse është shuar me të edhe vetë arsyeja e qënies së këtij institucioni me kapërcimin e njëpasnjëshëm të teknikave ushtarake, dhe ka rënë fjala e leksikut në harresë, derisa janë shuar edhe njëra edhe tjetra, ose janë shtresuar njëra mbi tjetrën, sipas huazimeve që kanë lënë pushtuesit. Porse kanë mbetur në toponimi të fosilizuara dhe tregojnë se kanë qënë fjalë të leksikut të gjallë dhe nga të parat që pruri me vete pushtuesi në një kohë.

Në të vërtetë, të gjithë këta emra janë të karakterit leksikografik dhe si të tillë edhe gjenden në kombinimet e shumta që kanë pësuar, duke qënë se toponimia është një ndër dukuritë e fjalorit.

Analiza e këtyre emrave bëhet për tri arsye kryesore:

1) Haralambe Minaescu, *Linguistika dhe etnogjeneza e shqiptarëve*, në «Studime filologjike» nr. 3, 1982, f. 61.

1. Sepse vë në dukje, në pikëpamje të historisë gjuhësore, se ballafaqimi me greqishten dhe me latinishten nuk është bërë vetëm me disa fjalë inventari i të cilave mbetet gjithmonë për t'u diskutuar, por edhe me sisteme të tëra fjalësh dhe objektësh, të cilat ruhen edhe sot në onomastikë dhe nuk mund të mos bënë pjesën në fondin leksikor të shqipes në një kohë derisa më vonë u ndryshuan ose e humbën fare funksionin e tyre;

2. Sepse një analizë e etimologjisë së tyre bën të njihen në një gjuhë matricet leksikografike, që mund të marrin forma nga prejardhje dhe kohë nga më të ndryshmet. Prejardhja e ndryshme, e Lindjes ose e Perëndimit, nuk ia heq kuptimin thelbësor termit që emërton. Kemi në të gjitha të njëjtin vështrim, atë të ruajtjes së rrugëve;

3. Sepse këto fjalë ndjekin pikërisht rrugët e vjetra, shtigjet, arteriet kryesore. Këto rrugë, në rastin më të mirë, kanë lënë vetëm ndonjë kalldrëm ose ndonjë shënim në dokumente. Por, na dalin si gjurmë dokumentare në toponimi, dhe kështu arkeologu njih më mirë itinerarët e këtyre rrugëve të rrahura qysh në antikitet, pikat e forcimit të tyre me kështjella, kloze, këlcyra dhe dervene. Historia ekonomike ndjek kështu nga afër zhvillimin e tregtisë dhe hullitë e saj edhe në ato vende që kanë qenë pista të thjeshta ose ku nuk ka fare gjurmë tjetër dokumentare të shkruar. Kështu gjuhësia dhe etnografia i japin një dorë të mirë historisë dhe arkeologjisë.

Edhe pse shumë gjurmë të toponimisë janë shuar ndër mote, duhet të kënaqemi nganjëherë edhe me ndonjë element të vetmuar dhe ta plotësojmë atë duke studiuar relievin ose ta vëmë në marrëdhënie sa më të plota me të tjera të dhëna, me aq sa na lejojnë këto mjete.

Detyrimisht, si fillim, është një repertor etnografik dhe historik i plotësuar me atë filologjik, sepse duhet të shpjegohen kryesisht faktet dhe të bëhen komentet përkatëse.

Analiza dhe interpretimi i këtyre emrave bëhet në tre drejtime: në vështrimin historik, në vështrimin semantik dhe në vështrimin krahnor gjeografik. Le t'u përmbahemi këtyre tri aspekteve, duke kombinuar, me aq sa të jetë e mundur, metodën sinkronike me atë diakronike.

1. Lexuesit të rëndomtë, që nuk është mësuar t'i flitet për një funksion *kiosesh* dhe *këlcyrash* në Shqipëri, të zëvendësuar më vonë me dervenet osmane gjithandej, i shkon mendja menjëherë te ekzemplari më i madh i këtyre këlcyrave që njohim sot, te *Këlcyra* e viseve të Jugut, dhe te Kloset e njohura, sidomos te *Klosi* i Mallakastrës. Por nuk e di se këlcyra dhe kloze të tilla ka pasur dhe ka edhe sot në të gjithë Shqipërinë.

Në gjendjen e sotme të dokumentacionit, nuk e dijmë a quhej me këtë emër kjo pikë këlcyre në të famshmet *Fauces Antigonae* (Grykat, Këlcyrat e Antigonesë) që përmendin Tit-Livi dhe autorë të tjerë të antikitetit², dhe që bëhej një me *Këlcyrën* nga autorët e paraqirimit³ Me zbulimin nga ana e arkeologëve tanë të qytetit të Antigonesë në Jermë të Gjirokastrës, që na e ka dhënë edhe emrin e tij, marrin një drejtim tjetër

2) Tit-Livi XXXVI, 5, 9; XLIII 23, 3 e 4; Polibi II 5, 6; 6, 6; Plini, NH IV, 10; Ptolemeu III, 1, 3. 7: Stefan Bizantini s/v *Antigonea*.

3) Po përmendim, ndër të tjerë, «*Fjalorin toponomastik*», Shkodër 1943, f. 256.

këto gryka, jo më në drejtim të Lindjes, por të Jugut, sepse këtu e kemi qytetin e vjetër që e njohim tashmë. Bie poshtë edhe të venduarit që i bëhej dikur kësaj Antigoneje pranë Leklit të Tepelenës⁴, por *Fauces Antigonae* duhet quajtur e gjithë ajo grykë ku del lumi Drino për t'u derdhur në Vjosë.

Mbi emrin e kësaj Këlcyre të Përmetit nuk kemi asgjë në dokumentet e vjetra historike. Dijmë vetëm se një Këlcyrë përmendet më 1308 nga Anonimi i Gorkës⁵, por si term i përgjithshëm për një pjesë të vendit tonë. Ky dokument mesjetar e ndante Shqipërinë e Jugut në dy treva të mëdha: *Clissara dhe Tumoristi*, d.m.th. në Këlcyrë dhe Tomorrishtë. Me fjalë të tjera, kjo tregon edhe se emri ishte mjaft i përgjithshëm, sepse këlcyrat ishin të shumta dhe kjo, me sa duket, i ka dhënë emrin një treve të madhe.

E zë në gojë edhe shkrimtari tjetër bizantin, Kantakuzeni, në një dokument të viteve 1335-1336, kur përmend Skraparin, Tomorrin (Timor) dhe Këlcyrën (*Kleissoura*)⁶.

Këlcyra ka edhe gjurmë të tjera vjetërsie, që i provon edhe toponimia. Prapë si *Klisura/Kelsyre* do të përmendet edhe në dokumentet osmane të viteve 1431-1432⁷. Dhe shihet qysh te ky dokument osman se fshati e mbante trajtën e asimiluar shqip *Këlcyrë*. Do ta njohim edhe si *Clausura*, *Kleissoura*, *Clissura* etj. sipas dokumenteve të Lindjes apo të Perëndimit. Por emri i vjetër ruhet jo vetëm këtu, por kemi edhe një *Kroj i Këlcyrës* pak më tutje, në Leskovik.

Por edhe në kohë të Turqisë, më 1582, këto anë kanë luajtur një funksion derveni, sepse si derven e kemi të shënuar në dokumentet osmane fshatin Sheper të Zagorisë për rrugën që shkonte nga Gjirokastra në Përmet⁸. Kemi pastaj edhe fazën më të re të këlcyrës-derven, për një pyll të madh në vetë Këlcyrën tonë, të quajtur *Derven*. Më tutje, kemi një *Derven* në Lekdush të Gjirokastrës.

Fjalën *Derven (Dervin)* na e jep edhe Pukëvili për Lunxherinë. Ky na thotë se ky Derven del në Urën e Subashit⁹, në pjesën e poshtme të luginës së hapur nga Drino e cila që nga Hani i Subashit thirret edhe sot Derven. Fshatrat majtas dhe djathtas përfshihen në këtë trevë, ruajnë në emërtimin Derven atë *Fauces Antigonae* që kemi te Tit-Livi, dhe na japin kështu edhe drejtimin e Antigonesë së dikurshme, por në të gjithë shtrirjen e saj.

Në kohën e pushtimit romak janë emra të tjerë për të treguar institucionin, si *klos* dhe *kluz* në ndonjë rast, një asimilim që nisët nga trajta latine *cludo*, *clusi*, *clusum*, në vështrimin e «mbylljes së një shtegu të ha-

4) Ndër të tjerë edhe «*Ilirët dhe Iliria*», Tiranë 1965, f. 423.

5) «*Burime të zqjedhura për historinë e Shqipërisë*» II, Tiranë 1982, f. 111.

6) *Kantakuzeni II*, 32.

7) Halil Inalcik, «*Sûret-i Defter-i Sancak-i Arvanid*», Ankara 1954, dok. 30, 66, 116, 117, 155.

8) «*Defteri i Sanxhakut të Vlorës*», në Arkivin e tapive dhe të kadastrës në Stamboll (Arkivi i Institutit të Historisë nr. 62). fl. 181.

9) F. Pouqueville, «*Voyage de la Grèce*», tome II, Paris 1826, f. 20.

pur, e rrethimit të një rruge; të një qafe, të një vendi etj.»¹⁰ dhe duket se vjen nga një pjesore e latinishtes vulgare *clousum*.

Dallohen kështu, në vija të trasha, dy shtresa, të cilat na japin edhe një farë kronologjie për kohën romake dhe më vonë bizantine. Këto ngatërrohen njëra me tjetrën, sipas kohës së huazimeve dhe sipas autorëve. Ka edhe pika kontaminimi të njëres shtresë me tjetrën, ose zëvendësime të një klosi me këlcyrë po në atë vend ose pak më tutje.

Në pikëpamje të gjuhësisë historike, shihet se ky sistem këlcyrash, i ardhur nga antikiteti, forcohet edhe më në kohën bizantine. Për këtë tregoi një vëmendje të veçantë krijuesi i temave bizantine, perandori Teofil (825-842), i cili formoi në kohën e vet edhe qëndra «të vogla ushtarake» në këto këlcyra¹¹, dhe kryetarëve të tyre u dha edhe emrin *klisuriarkë*¹². Kemi të bëjmë kështu me një sistem mbrojtjeje të përqëndruar, me sa shihet, edhe në kohën e Turqisë, sepse ky klisuriark duket se lidhet me emërtimin *derven aga*, që do të kemi më vonë.

Për viset tona, shpjegimin e këtyre këlcyrave në këtë kohë e kemi mjaft të plotë te Ana Komnena, gjatë luftimeve që bënë bizantinët kundër normandëve. Ajo thotë se i ati, Aleks Komneni, kishte vënë në «çdo këlcyrë (Κλεισσοῦρα) forca të shumta me krerë të zgjedhur dhe se kishte mbyllur para keltëve të gjitha shtigjet»¹³.

Ana Komnena na e jep edhe më të plotë këtë përkufizim kur thotë se Aleks Komneni kishte caktuar Eustat Kamicin për të ruajtur *Këlcyrat e Arbërit* (τὸ Ἀρδανὸν Κλεισσοῦρα) në fillim të shek. XII (1108)¹⁴ kundër normandëve të Bohemundit. Kur e vëmë në krahasim me autorin tjetër bizantin, Gjergj Akropolitin, 109 vjetë më vonë (më 1219), që zbret me ushtrinë e tij nga Ohri nëpër *Albanon*, për të arritur Durrësin, dhe po me autorin tjetër bizantin, Skutariotin¹⁵, dalim kështu te emërtimi historik i këlcyrës së madhe të Arbërit, që sot na ka lënë gjurmë vetëm te *Shtegu i Arbët* në Skroskë të Qukësit, në afërsi të rrugës Egnatia. Kjo këlcyrë ka edhe fazën më të hershme klos, dhe mund të përmendim *Guri i Klosit* në Polis të Librazhdit, që bëhet një me klosat e Jugut dhe të Veriut, dhe me një *Klos* pak më tutje, në Dëshiran të Dumresë, si mbeturinë.

Këto janë gjurmët e pakta që na kanë mbetur, sepse si *derven* kemi plot në këtë krah: *Derveni*, luginë e vogël në Babje (Librazhd); *Derveni*, vend buzë rrugës Egnatia me *Kullën e Asqeriut*, që e përforcon edhe më këtë emër: *Kroj i Dervenit* në Rajcë të Librazhdit; *Derveni*, lagje e Xhyrës së Librazhdit; *Dervene* në Dardhas të Librazhdit; *Qafë e Dervenit* në

10) Georges-Calonghi, «Dizionario della lingua latina», vëll. I, 1927, f. 432. Si trajtë kryesore jepet aty: *claudo-clausi-clausum-cludere*, por është trajta erudite, sepse kjo që përmendëm sipër është popullorja. Për ta konfirmuar edhe më, po përmendim në itinerarët e antikitetit: *Clodiana* (Tabula Peutingeriana, Itinerarium Antonini dhe ai Burdigalense), dhe trajtën *Cloditana* te Ravennatis Anonymi (*Cosmographia* IV 15), që japin për Peqinin e sotëm.

11) Ch. Diehi-G. Marchais, «*Histoire du Moyen âge*». Paris, 1938, f. 314.

12) Ch. Diehi-G. Marchais, *vep. cit.*, f. 51. Shihet se këto «qëndra të vogla ushtarake» i kanë formuar pikërisht në fshatrat që morën këtë emërtim.

13) Anne Comnène, *Alexiade* XIII, V, 1, f. 140 (bot. Leib).

14) Anne Comnène, *po aty*.

15) «*Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë*» nga Koço Bozhori dhe F. Liço, Tiranë 1975, f. 157.

Polis-Gostimë, që plotëson si epokë Klosin që përmendëm më sipër; *Dervenja* në Kule-Papër (Elbasan) etj. Pra është përhapur emri më i ri derven dhe u ka zënë vendin klosave dhe këlcyrave më të vjetra.

Kjo fjala e re *derven*, e ardhur me pushtimin osman, nuk do të zhdukë një pjesë të fjalëve të vjetra të leksikut, por do t'u zëjë vendin kryesor, duke i lënë shpeshherë fjalët e tjera rreth e qark të fosilizuara, duke bërë kështu kalimin e ndonjë fshati ose të ndonjë gryke klos ose këlcyrë në derven, apo duke caktuar një vendbanim ose një grup tjetër vendbanimesh për ta bërë këtë detyrë, me fjalë të tjera duke zgjedhur një fshat ose një grup fshatrash më «të besueshëm».

Është një shembull se si ndërtohen dhe zhvillohen gjuhët dhe qytetrimet në histori. Boshti mbetet kur ka jetëgjatësi institucioni, edhe pse duke kaluar nga një dorë në tjetrën: ndryshojnë vetëm përcaktuesit.

2. Në qoftë se për Këlcyrën nuk na dalin dokumente të shkruara nga antikiteti, mbasi si e thamë, përjashtohen *Fauces Antigonae*, na del qysh në antikitet një *Clausalis-Clausula* në pikën tjetër të Veriut të Tit-Livi¹⁶, që është e lidhur me Kirin. Kur flasim Tit-Livi dhe autorë të tjerë mbi marrjen e Shkodrës nga romakët, nuk e zënë me gojë Drishtin, që ndodhet pikërisht në daljen e Kirit në fushë, 7 km. nga Shkodra e sotme dhe rreth 8 km. nga Shkodra e kështjellës. Në të vërtetë Drishti është krijim i mesjetës së hershme, siç e kanë vënë re Shuflaj dhe autorë shqiptarë. Megjithëse ka gjurmë parahistorike, shihet se nuk ka qenë tjetër veçse një stacion, si e tregojnë gërmadhat.

Si *Clausalis-Clausula*, një trajtë e latinizuar, kemi qysh në antikitet daljen e parë të këtij emri. Nuk mund të themi se Kiri mbante dy emra, një si *Clausalis-Clausula*, me sa duket përkthimi latin i ndonjë. fjalës së moçme vendase, dhe një tjetër si *Clyrus, Clyros*, që e kemi në mesjetë, si na e shënon edhe shkodrani Marin Barleti. Te Kadastra venedikase e Shkodrës e viteve 1416-1417 e kemi të emërtuar si *Clia*, por në dokumentet venedikase të kohës gjendet edhe si *Clyrus, Clyro*.

Po në këtë shekull të XV-të, më 1485, kadastri i parë osman i njohur për këto vise, na jep për fshatin sipër, në Pult, trajtën *Klir*¹⁷, sepse lumi nuk përmendet fare në këtë dokument.

Po të analizohet trajta *Clyrus-Clyros*, ku *-us, -os* dhe *-o* kanë një funksion prapashtesor të huaj, mbetet trajta shqipe *Klir-i*, si e gjejmë në dokumentet osmane që përmendëm. Atëherë mund të mendohet, si trajtë e hershme mesjetare, një *Kleissoura* me sinkopën e rrokjes së mesme, një metaplazëm i shpeshtë në emrat e antikitetit (khs. p.sh *Pu/bli/ca* = *Puka*) nën ndikimin e theksit dinamik dhe me shkrirjen e disa fonemave, dhe shihet se kështu mbetet *Klei/ssou'r (a)* = *Klir-i*. Kështu do të dilte se në një kohë fshati ose lumi i kanë dhënë emrin trevës.

Për ta analizuar më mirë gjendjen e njëkohshme na vjen në ndihmë emri i vendit *Mbyllç*, që kemi te *Kodrë M (b)yllçit* në kuotën 234 m, në JL të fshatit Mes (Drisht). Rrok Zojzi shënon, në Arkivin etnografik, edhe një *Majë M (b)yllçit* në kuotën 468 m. po në Drisht. Pak më tutje kemi

16) Tit-Livi XLV. 23, 3-4.

17) S. Pulaha. «*Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës në vitin 1485*», Tiranë 1974, fl. 340.

edhe një Çeta M (b) yllë në Spatharin e sotëm të Vadejësit, i vendosur mbi një kodër pas përmytjes së Drinit në shek. XIX, dhe një Majë M (b) yllës në kuotën 460 m. pranë daljes së Drinit në fushë.

Vetë termi *Mbyllç* është një metaforë: niset nga *mbyll* «cludo», dhe për një vend që mund të mbyllet ose të rrethohet bëhet *mbyllç* me kuptimin e cilësisë së një vendi që mund të mbyllet në raste të ndryshme, pra është marrë mundësia skajore e mbylljes së shtegut, sepse për të ai shërbente, atë funksion i kishin vënë këtij vendi.

Nën një trajtë tjetër, *Mshilt* këtë herë, e gjejmë te *Bunī Mshiltit* në Gjugjë të Planit, *Qafë Mshiltit të Makae* në Ducaj të Shkrelit më në lindje të së parës.

Shihet në këto dy raste se është një përpjekje për të dhënë shqip fjalën *klos*, sepse të gjithë këta emra mbizotërojnë vende që duhen mbyllur për të ruajtur vendbanimet nga sulmet e papritura ose nga infiltrimet e huaja, ose kemi ndonjë endje të emrit, ku ka rënë fjala kryesore e mbyllçit ose e mshiltit, pikërisht në pikën që zotëronte grykën ose shtegun dhe është ruajtur gjetkë.

Kështu në Mes dhe në Drisht ose në të dalur të Drinit në fushë, pak më tutje, na del analogjia me të dhënë e Tit-Livit *Clausalis-Clausula* «mbyllje, (vend) që mund të mbyllet», dhe kjo duhet marrë parasysht.

Pikërisht ky parim analogjie na vjen në ndihmë për t'i parë më mirë ato marrëdhënie midis fjalëve dhe për ta bërë më mirë përkufizimin e fjalës dhe shtrirjen e saj në nocione ndihmëse. Te *mbyllç*, *mbyllës* (*mshilt*) kemi transpozicionin e kuptimit të fjalës së huaj në shqip, me fjalë të tjera një kalk që na e zgjeron nocionin me pikat që përdorëshin si mbyllje. Kështu na del krejt sistemi deri te *këlcyra* (*kleissoura*) që formon mbyllçin e mirëfilltë. Prandaj sistemi bëhet më i plotë dhe plotësohen marrëdhëniet midis fjalëve.

Vetë Aleks Komneni do t'i përdorë, në shek. XI-XII, këto këlcyra dhe kloze të vendit tonë në një mënyrë origjinale. Ky kishte krijuar pengesa të mëdha me prerje dhe rrëzim lëndësh në grykat, golat-gulat, ngushticat, gushtat e vendeve më të ngushta, që lidhen si nocione analogjike me të parën, sipas termave që i kemi në toponimi. Ana Komnena e thotë hapur se ky e bëri këtë jo vetëm për t'u prerë shtigjet normandëve në viset tona, por edhe për të ndaluar që arbërit të bashkoheshin me ta, sepse po zbrisnin me shumicë, si flokët e borës, për t'u dhënë një dorë normandëve¹⁸.

Shihet nga kjo dhe nga kryengritjet kundër Bizancit, që i kishin prirë këtij invazioni normand, se kombësia shqiptare kërkonte të përfitonte nga ky rivalitet për të pasur zgjidhjet e veta, dhe njëkohësisht sa i brishtë ishte bërë sundimi bizantin në viset tona. Këtë do ta provojë edhe ndonjë shekull më vonë dalja e parë e Mbretërisë së Arbërit (*Regnum Albanie*), edhe pse nën suzerenitetin angjevin të Napolit, por që tregon një entitet të formuar, si edhe dalja në skenë e principatave të para arbërore.

Prandaj fjalët *mbyllç* dhe *mshilt* janë fjalë-vatra rreth të cilave organizohen fjali të tëra që të japin fushën semantike të fjalëve të tjera,

18) Anne Comnène IV, 2, 2.

që janë të lidhura me to, dhe tregojnë nocionet që i lidhin të gjitha me fjalën kryesore.

Sa mund të kapim sot prej këtyre fjalëve është mjaft pak. Le të kënaqemi me sa na kanë mbetur. Shekujt që kanë kaluar mbi to, sundimet e ndryshme, e kanë bërë punën e vet dhe kanë shuar shumë gjurmë të këtyre fjalëve-vatra, që kanë mbetur rastsore. Si fjalë analogjike mund të rreshtohet edhe klisuriarku, që si e pamë na ka lënë ndonjë gjurmë si derven-aga i kohës së Turqisë.

Por si *mbyllç* dhe *mshilt* shihet se është përpjekja e parë arbërore për të dhënë me mjetet e shqipes fjalën, megjithëse, si shihet sot, kjo nuk pati vazhdimësi dhe mbeti e vetmuar në një zonë të caktuar.

Shihet kështu se shqipja kishte një forcë qëndrueshmërie më të madhe se forca e sulmit e greqishtes bizantine. Krenarë, dhe jo pa arsye, arbërit nuk donin të bëheshin as latin, as bizantinë, as sllavë, as turq më vonë, as të flisnin gjuhët e tyre. Ndër termat thelbësore të çdo pushtimi (dhe për fat të keq këto pushtime kanë qenë shumë të gjata, shekullore) ata bënë asimilimet e tyre dhe patën edhe fjalën e tyre për të treguar mjetet poliercetike dhe u futën me fjalët e reja dhe zunë vend.

3. Po të nisemi nga treva më veriore e habitatit të sotëm, nga viset verilindore të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës, me ato të dhëna që kemi deri tani, gjejmë edhe këtu disa raste të këtyre sistemeve. Ne po i marrim ato më kryesoret që janë botuar, me qytezat dhe ngrehinat e kohëve të ndryshme.

Por duhet të themi qysh në fillim se këtu, ashtu si në viset e skajit jugperëndimor, nuk e kemi kudo dhe kurdoherë veprorë metatezën *kli*: *kël* si në viset e tjera, por kemi bashkë me *këlcyrë* edhe *klisyrë*; *Klisyrrë* në Verilindje, dhe *Klisurë* *Hlisurë* në Jugperëndim, në Çamëri.

Vëmendjen po e ndalim kryesisht në viset vargmalore të Kosovës, sepse mbi to kemi disa të dhëna. Në përgjithësi në viset malore ose rrëzë malesh janë ruajtur më mirë këto sisteme.

Njihen nga dokumentacioni ose nga topogërmadhat disa nga këto vendbanime-qytete e qyteza, të cilat në kohën romake morën edhe titullin e *civitas* pra qytet ose qytezë. Këto ishin bashkari (*universitates*) të mbarrështuara në *municipia*, siç kemi pasur këto kohët e fundit edhe mbishkrimet në Lissus-Lesh, ku kanë bërë kërkime Koço Zheku dhe Frano Prendi. Te ky i fundit kemi edhe një lexim të hollësishëm të këtyre mbishkrimeve të antikitetit¹⁹.

Hulumtime dhe punime mbi këto vendbanime-qyteza në këto vise verilindore të habitatit arbëror kanë bërë tani vonë E. Çershkovi²⁰ dhe Zef Mirdita²¹. Ne do ta ndalim vëmendjen veçanërisht në një punim që ka botuar M. Pirraku²², i cili i ka ndjekur topogërmadhat në Malet e Qyqavicës, në jugperëndim të Prishtinës, në bjeshkët e rrafshnaltës së

19) Frano Prendi-Koço Zheku, *La ville ilyrienne de Lissus — son origigine et son système de fortifications* në «Studia Albanica» 2,1973, f. 35 vv; F. Prendi, *Dy mbishkrimet e ndërtimit të qytetit ilir Lissus*, në «Iliria» 1, 1980.

20) Emil Čerškov, «*Rimljani na Kosova i Metohiji*», Beograd 1959.

21) Zef Mirdita, «*Studime dardane*», Prishtinë 1979. Khs. sidomos ff. 93-141.

22) Muhamet Pirraku, «*Ndihmesë për hartën arkeologjike të pjesës qëndrore të Kosovës*, në «*Onomastika e Kosovës*», Prishtinë 1979, f. 496 vv.

Drenicës, si edhe rrugët që lidhen me to. Mbi këto këlcyra-klysyra Pirraku është ndalur vetëm shkarazi, duke e përqëndruar vëmendjen te qytezat, që kanë një përhapje të madhe në këto vise.

Për ta plotësuar në një farë mënyre pasqyrën, ne do ta shtrijmë shqyrtimin edhe në disa rubrika toponimesh, që ka botuar herë pas here e përkohshmeja «Përparimi» në Prishtinë si edhe në Këngët e kreshnikëve të Kosovës, ku vjelen edhe toponime me *këlcyrë* dhe *klysyre*, që vlejné si plotësim i këtij kuadri.

Këto vise malore janë plot me *gjytete-gjyteza*, *kasterca*, *gradine-gradishte*, me pak *forca*, *forcena*, *fercoja* dhe sidomos me emërtimet e fundit turko-arabe *kala*, që shtresohen njëra mbi tjetrën dhe flasin për pushtimet në kohët e ndryshme si edhe për qëndresën që në çdo kohë u kanë bërë vendasit të huajve.

Për vazhdimësinë e banorëve autoktonë dhe për këtë qëndresë, edhe pse shpesh herë në mungesë të dokumenteve të shkruara ose të mbi-shkrimeve, flasin vetë këto gërmadha-shtresime, që ruajnë emërtimet e fazave të ndryshme, që vijnë prej qytezës më të vjetër dhe kalojnë në shtresat e tjera, me asimilimet më të reja deri te derveni, kur edhe zhduket ky sistem, që i përket një kohe mjaft të gjatë dhe që na thotë me qartësinë më të madhe se mbarshtimi i këtyre vendeve shkante me hapin e kohëve nëpër të cilat përshkoheshin.

Në qoftë se marrim p.sh. Bjeshkën e Drenicës, për qytezat e së cilës na flet M. Pirraku, kemi në krahun e Jugut, në Petrashicë, *Udhën e Klysyres*, që lidhet me qytezën e quajtur *Trolli i Harozit*. Është një qytezë që autori në fjalë na thotë se vjen prej kohëve pararomake, kur vihen themelet e vendbanimeve të tipit qyteza në Dardani²³. Kjo *Klysyre*, që quhet edhe *Drumi i Klysyrave* (siç kemi pak më tutje edhe *Drumi i Stremave*) ruan në dy emrat asimilimet nga gr. *dhromos* për «drum, udhë, rrugë» dhe *kleissoura* për «klysyre».

Po në këtë rreshtim qytezash gjendet edhe *Gjyteti i Bajcës*, afër Bajcës së Kolshit, po në Drenicën jugore. Në këtë qytet ruhet, në anën e bjeshkës, edhe emri *Klysyra e Bajcës*, që bie në anën e Kungullarit për të dalë në qytetin tjetër të Kasmaçit²⁴. Shihet gjithandej se emri i vjetër i sistemit të ruajtjes së rrugëve është mbajtur deri më sot në krahun e epër të këtyre viseve.

Një qytezë tjetër, *Gjyteti i Dubovcit*, gjendet në Majën e Kodrës së kështjellës në grykën e Novalanit, që lidh Vushtrrinë me Drenicën. Aty gjendet edhe *Klysyra* si edhe një *Lugi i Klysyres*, që ndodhën mu në këtë grykë. Si e vë re M. Pirraku, ky emër është regjistruar edhe në fund të shekullit të kaluar si *Brusnički Klisuri* nga B. Nushiçi, dhe njihet edhe sot po me këtë emër si *Klysyra e Brusniçkës*²⁵.

Po ta shtyjmë vështrimin pak më tutje, në viset e quajtura Gropa e Tërpezës së Gllugovcit, kemi vendin *Klysyrat* në perëndim dhe *Lugin e Klysyrave* në Lindje. Po në këtë Tërpezë kemi edhe *Livadhin e Dervendit*

23) M. Pirraku, *art. cit.*, f. 482.

24) M. Pirraku, *art. cit.*, f. 498.

25) M. Pirraku, *art. cit.*, f. 519 vv; B. Nušić, «Kosovo. Opis zemlje i naroda» II, Novi Sad 1903, f. 76.

dhe *Pusin e Udhës së Dervendit*²⁶, që e plotësojnë pasqyrën me një emërtim të mëvonshëm, ose me ndonjë ndryshim, me fjalë të tjera me zgjatjen e këtij institucioni deri në kohën e sundimit osman; kalimin nga klysyra në dervenin e njohur.

Po në këtë shtrirje të Gllgovcit, në fshatin Berhovci të Malësisë së Drenicës, është emri i vendit *Klisura*²⁷. Një emër toke, *Klysyrat*, na e bie vetë M. Pirraku edhe për Volljakë të Klinës²⁸.

Duke analizuar rrugët që përshkoheshin dikur nëpër këto vise. M. Pirraku vë në dukje se udhët «e periudhës romake në këto anë kanë shkuar gjurmëve të rrugëve dardane, dhe këto pista më vonë kanë ndjekur edhe rrugët e periudhave të mëvonshme»²⁹. Pikëpamjen e tij e argumenton edhe me oronimet që kanë mbetur dhe flasin për këto arterie, si Drumi i Qyqavicës i cili pati «rëndësinë e vet edhe më vonë duke lidhur Shkupin me Novi Pazarin dhe me Bosnjen». Kjo rrugë që lidhte qytetet e lashta të Harilaçit, Ballaçevskit, Grabovcit, Majës së Zezë, Strofcit, Dubovcit dhe Drethit në Mokën, vihen në lidhje edhe me dy rrugë kryesore Shkup-Lesh dhe Nish-Lesh³⁰.

Megjithëse shembujt janë të pakët dhe të nxjerrë rastësisht, sepse duhet të ketë shembujt më të shumtë dhe më të qartë në të gjitha ato shtrirje, shihet rëndësia që u vihej këtyre çelësve rrugorë nga krahasimi me toponimet e fshatrave të veçantë. Themi se nuk duhet të mungojnë edhe klosat ose klyzet edhe këtu, mbasi periudha romake ka lënë gjurmë shekullore në këto vise, dhe kjo dihet nga historia dhe nga gjuhësia.

Por, edhe pse nuk kemi shembujt të mjaftueshëm, sepse nuk e kemi toponiminë e mbledhur, edhe këto që nxorëm këtu mjaftojnë për ta ilustruar idenë tonë të këtij sistemi të përhapur gjithandej.

Duke hyrë brenda kufijve të sotëm shtetërorë të Shqipërisë, në malësinë e vjetër të Pjetërshpanëve ose në Pultin historik, që sot quhet me emrin Tropojë, gjejmë po me këtë trajtë fshatin *Klysyre*, që sot shënon pikën jugore më të shtyrë të kësaj trajte pa metatezë.

Fshati i vogël *Klysyre* shkon sot si lagje e fshatit Koçanaj, që ndodhet përfund Dragobisë, Aty janë *Shpati i Klysyres* dhe *Urë Klysyres*, që lidh fshatrat Koçanaj, Shoshaj dhe Dragobi.

Qenia e këtij fshati aty me këtë emër të ruajtur qysh prej kohës bizantine, tregon se në kohë të vjetra shumë, ky bënte funksionin e ruajtjes së rrugës në itinerarin që mirrte krahun e Veriut, nëpër luginën e Valbonës, në drejtim të Pejës dhe të Altinit, që në dokumentet osmane do të quhet *Alltun-ili* ose në dokumentet serbe të shekullit XIV *Altin*. Kjo udhë shkëputej nga Udha e Madhe, që e vazhdonte drejtimin për në Ulpianë (Lipljan) dhe tutje. Prania e kësaj Klysyre këtu, me tri toponimet që na japin edhe urën aty, tregon se kishte interesë të ruhej për të siguruar trafikun tregtar në këtë drejtim. Se ajo udhë ka vazhduar gjatë gjithë

26) S. Krasniqi, *Toponimia e fshatit Tërpezë* në «Përparimi», Prishtinë, nr. 9, 1971, f. 880.

27) H. Kajtazi, *Disa toponime në shqipe* në «Përparimi», Prishtinë, nr. 3-4, 1968, f. 470.

28) M. Pirraku, *Toponimia e fshatit Volljakë* në «Përparimi», Prishtinë, nr. 9, 1971, f. 880.

29) M. Pirraku, *Ndihmesë... cit.*, f. 532.

30) M. Pirraku, *Ndihmesë... cit.*, f. 533.

kohëve edhe më të vona, e tregon edhe fjala *Derven*, që do të dalë në kohë të Turqisë, por në një vend tjetër në këto afërsi, jo më këtu, sepse *Klysyra*, me sa duket, e kishte humbur besimin në një kohë për ruajtjen e rrugëve. Kështu *Klysyra* është zëvendësuar me një *Derven* të një fshati tjetër, jo më këtu por pakë më tutje.

Mbi këtë rrugë ka bërë kërkime A. J. Evans. Ky pranon vazhdimin e rrugës «romake», si e quan ai, në luginën e Valbonës, deri lart «në vendet e Krasniqes»³¹ dhe po këtë pistë ka ndjekur edhe Franc Nopça³². Sot i shtohet një argument i vlefshëm me këtë *Klysyre* dhe udha mund të quhet se vjen prej kohëve të vjetra, si rrugë e rrahur dhe më vonë, deri në kohët turke, për arsye strategjike dhe tregëtie.

4. Por njihet edhe treva e këngëve të Kreshnikëve, që na jep një sasi jo të vogël termash me këlcyrë-klysyre. Këtu e kemi edhe më hapur termin këlcyrë-klysyre si fjalë të thjeshtë të leksikut, që tregon një emër orografik ose vlen të emërtojë emra gjeografikë. Areali që përfshin këngët e kreshnikëve përmbledh Shqipërinë veriore në tërësi, me Rrafshin e Dukagjinit, me Kosovë dhe me Dibër, tej kufijve të sotëm shtetërorë. Dhe, po tej kufijve të sotëm shtetërorë duhen përfshirë edhe viset e Malit të Zi; Krajë, Shestan, Anamal, Ulqin, Tivar, Grudë, Triepshë e pjesa më e madhe e Hotit, sepse quhen të gjitha edhe sot si vazhdim i Shkodrës, ashtu siç kanë qenë deri sa janë cinguar nga Mali i Zi.

Me *Këlcyrë* e kemi në një këngë të regjistruar në Gërgoc të Gjakovës: «Dizdar Osman Aga tradhëton Mujën»³³. Në këtë këngë dalin vargjet: «Shtini Mujën në *Këlsyrë të Zezë*» (v. 97); «Kur janë shkue në *Këlsyrë të Zezë*» (v. 120); «Muja â mbetë n'*Kelsyre të Zezë*» (v. 177); «Fill te Muja n'*këlsyrë* ka shkue» (v. 201); «ta kam lanë-o n'*Këlsyra të Zeza*» (v. 272). Shihet qysh këtu se *këlcyrë*, sidomos në vargun 201, është për «grykë, ngushticë».

Prapë si *Këlcyrë* e kemi të regjistruar në Berishë të Tropojës në këngën «Martesa e Ali Bajraktarit me të bijën e pashës së Trumnikit»³⁴; «Kur janë shkue në *këlcyra t'bjeshkës*» (v. 257), ose «Kur kanë dalë n'*Këlcyra t'Zeza*» (v. 307). Vargu 257 e bën edhe më të qartë fjalën e leksikut dhe i heq çdo dyshim.

Si *klysyre* e kemi në këngën «Orët e Bjeshkëve»³⁵: «Kur janë dalë në *Klysyra t'Zeza*» (v. 308) ose në këngë të tjera si «Gjurë Harambashi plagos të Lumet e Mujit», dhe «Muji e Halili rrethohen në kullë», ose papë «Dedë Kahrmani»³⁶, të regjistruara në Shkrel të Rugovës, në Bare të Shalës së Mitrovicës dhe në Kovaçicë po të Shalës të Mitrovicës; «N'*Klysyre t'Zezë* po, trimi kur â dalë» (v. 22); «Kral Zadari n'*Klysyre t'Zezë* a hi» (v. 293); «ti *klysyren* krushqve me jau nxanë» (v. 95), dhe vazhdojmë me *klisyren* të shënuar edhe nga regjistruesi me germë të vogël, si fjalë e thjeshtë leksiku.

Te kënga e «Smilaliq Alisë»³⁷ e kemi pesë herë të përmendur: «N'*Kly-*

31) A.J. Evans, «*Antiquarium Researches in Illyricum*» II, f. 67.

32) Fr. Nopcsa, «*Aus Sala u. Klementi*», Sarajevo 1910, ff. 15 v., 49, 80 v.

33) *Këngë kreshnike I*, përgatitur nga Anton Çeta, Prishtinë 1974, f. 135.

34) *Epika legjendare II*, përgatitur nga Q. Haxhihasani, Tiranë 1983, f. 225.

35) *Epika legjendare I*, përgatitur nga Q. Haxhihasani, Tiranë, 1966, f. 325.

36) *Këngë kreshnike I*, cit. f. 10, 32 dhe 132.

37) *Epika legjendare, I, cit.*, f. 391.

syra t'Zeza kenka shkue / *N'Klysyra t'Zeza* kur asht hi» (v. 26-27); «Fill janë shkue *n'Klysyra t'Zeza*» (v. 54); «Kur janë dalë *n'Klysyra t'Zeza* (v. 64); «*N'Klysyra t'Zeza* i kanë shti» (v. 102). Pra, i kanë shti në grykë të ngushtë ku janë edhe në rrezik të madh.

Edhe te kënga «Filiske Fiskama» e kemi këtë term bashkë me një përcaktim gjeografik, që nuk është i rrallë në këngët e kreshnikëve: «Kur ka dalë *n'at Qafën e Klisyrës* / E kanë pa at Sokole Halilin / Na ish ulë tu *Kroni i Kushevës*» (v. 337-339), ose «Kur kanë dalë tu *Qafa e Klisurës* / Janë avitë tu *Kroni i Kushevës*» (v. 368-369).

Sidoqoftë, edhe ky përcaktim gjeografik, që do të na jepte dorë ta njohim sipas Kushevës, nuk zë vend, lëviz sipas këngëve. Edhe po të marrim Kotorrin, herë e kemi pranë detit, aty ku ndodhet, po ndonjëherë e kemi edhe në Danub «buzë detit të Zi». Kjo shpërndarje e emrave të vendeve, siç veprohet në këngët legjendare të çdo vendi, ku gjenden qytete imagjinare, edhe emrat gjeografikë të atyre qyteteve që kanë një rrënjë nuk janë në kordinatat e tyre. Metafora topografike e huazimit të gjeografisë fizike qëndron në thelbin e fjalës dhe në rendin e frekuencës del një emër gjeografik, një emër topografik.

Metafora del edhe këtu, sepse kemi «ti klisyrën krushqve me jau xanë», pra dalin edhe këtu «ngushticat, grykat», dhe «në këlcyrë të bjeshkës», e jep edhe më mirë vështrimin.

Por edhe më mirë këtë vështrim e jep një këngë tjetër, që titullohet «Halili nxjerr tridhet djelm nga burgu» e regjistruar në Strelc të Deçanit (Rrafshi i Dukagjinit)³⁸: «dej *n'klisura* shok me mue me ra. / Kur të dalim në *Klisura të Kotorreve*» (v. 75-76); «pritë çatall *n'klisura* i ki xanë» (v. 85); «*n'krye t'klisurave* krezhnikët kakan ra» (v. 89); *n'krye t'klisurave* me djelm kur janë ra» (v. 183); «*N'fund t'klisurave*, shokë, kur kanë mri» (v. 185); «*N'fund t'klisurave*, shokë, un kur jam ra» (v. 205); «Me terr t'natës, *n'klisura* ka ra» (v. 297); «Pa rrezik ai *klisurat* po i len» (v. 300); «si vetima *klisurave* m'â ra» (v. 433); «*N'fund t'klisurave* Muja kur m'â ra», (v. 438). Edhe këtu metafora topografike është fare e qartë: *në krye, në fund të Klisurave*, ose *pritë çatall n'klisura*, etj. që përsërisin sinuozitetet e këlcyrave dhe të japin domethënie të tyre. Shihet gjerësia e lëvizjes që bën kjo këlcyrë në një këngë dhe është ruajtur e plotë në këtë këngë popullore, pa folur për thërrimet e këngëve të tjera, dhe këto pa u përzjerë aspak me barbarizmin osman më të ri.

Këtyre po u shtojmë edhe një varg që hyn në këtë hulli, në këngën «Muji e Halili rivalë»³⁹: «Ti *klisyrën* krushqve me jau xanë» (v. 96), i regjistruar në Cërnushë të Shalës së Mitrovicës. Kështu e kemi edhe më të plotë fjalën «ngushticë, grykë që mbyllet», një *mbyllç*, si e ka në origjinë fjala, si edhe shtrirjen e termit.

Siç shihet, fjalët *këlcyrë* dhe *klisyrë* janë shumë të njohura dhe nuk përfaqësojnë tjetër veçse mbeturina të kohës paraturke në ciklin e Kre-

38) *Këngë kreshnike I, cit., f. 240 vv.*

39) *Këngë kreshnike I... cit., f. 185.*

shnikëve. Këtë vjetërsi e tregon edhe fakti se nuk kemi gjetur asnjëherë zëvendësimin e saj me fjalën tjetër *derven* dhe kjo tregon se është një mbeturinë e ruajtur para se cikli të merrte veshjen e re. Ky është edhe një argument se cikli bart nga kohë më të hershme, në trashëgiminë e tij, elemente të para. Pra edhe një arsye më tepër mbi elementet e vjetërsisë në cikël.

Edhe në rastin e *klystyrës* duhet vënë në dukje se sistemi fonik i të dy gjuhëve, edhe pse kemi një kontaminim me serbishten këtë herë⁴⁰, jep ndryshime pak a shumë të theksuara. Si në fjalët e leksikut të rëndomtë nuk mund të kalohet nga një fjalë në tjetrën pa pësuar një farë përshtatjeje. Ky është ligj i gjuhës. Forma e emrave të vendeve të çdo trevë harmonizohet me strukturën e së folmes, prandaj kemi dhe *klystyrë-klystyrë* për *kleissoura-clausura*.

5. Një shtresë romake tregon grumbullimi i një vendbanimi tjetër të vogël, *Klosi* i Kabashit të Pukës, një fshat i ngulur në kuotën 829 metra mbi nivelin e detit. Edhe këtu është *Guri Klosit*, që dikur ruante rrugën që shkonte nëpër pellgun e çarë nga lumi Gominë, ku gjendet Kabashi me manastirin e tij të përmendur. Po në këto afërsi kemi edhe *Qafën e Klyzve* që lidhet me sistemin e Fercojës së Fletit dhe me vetë Fercojën e Berdhetit të vjetër, sot Kryeziu i Pukës.

Kjo fjalë, *Klyz*, që vihet re këtu dhe në ndonjë vend tjetër, duket se është e njëkohshme po të krahasohet me *Klos*. Ndryshimi *o-u-y* nuk është tjetër veçse metafori. Pas gjithë gjasëve shënon shumësin, pasi kemi të bëjmë me dy klosa, me dy shtigje rrugësh në këtë krah.

Të dy këto klosa ishin mbi Udhën e Madhe, që vinte prej Vaut të Sakanjanëve (*Vaspas*) dhe vazhdonte tej Pukës, nëpër Qerret afër Komanit, ku gjendej kështjella e vjetër *Kome* e rindërtuar në shek. VI nga perandori Justinian⁴¹, dhe vazhdon tutje në Kçirë, kalon për Gomsiqe për të dalur në qytezën e Dejës afër Shurdhakut dhe për të kaluar në Shkodër.

Po këtu, prej bjeshkës së Truenit zbret një përrua i madh që na jep edhe një tjetër *Klyz*. Ky quhet *Prroi i Klyzve*, me fjalë të tjera thekson edhe ky se në këtë lëvizje ka disa *Klyze*. Edhe ky duket se shënon shumësin që përmendëm. Në të vërtetë, në këtë pikë, rruga ka pasur degëzime të ndryshme me dredhojat dhe shkurtojat e saj në kohë, dhe sidomos kur rruga zihej nga bora. Vetë ky hidronim, *Prroi i Klyzve*, flet për vjetërsi. Por këtu kemi edhe *Shtupa e Klyzve* me *Qafën e Shtupës* në Rrafshin që shkon nga Fusharrësi në Dush.

Gjithnjë këtu kemi edhe toponimin tjetër, të kohës së pushtimit osman. *Majën e Dervenit*, në Lumardhin e Qafëmalit. Ky shënon edhe kohën më të re të këtij sistemi, kur klosi bëhet *derven*. Shihet edhe këtu lëvizja e këtij vendi mbrojtës dhe mbyllës, me arteriet magjistrale që ndjekin herë një krah dhe herë një tjetër, sipas kohës. Në të vërtetë, më herët, Udhë e Madhe zbriste prej Fercojës së Fletit dhe nëpër Shkallëbushtër mirrte krahun e Gominës dhe të Kabashit të Pukës.

40) *Këngë kreshnike* I... cit., f. 240 vv.

41) Shih «Etnografia Shqiptare» nr. 11, 1981, f. 282.

Në shekujt më të vonë të Turqisë, ky shteg u ia dhe u hap shtegu tjetër nëpër të cilin kalon sot rruga automobilistike. Megjithatë, deri vonë, në shekullin e kaluar, kur mbyllej prej borës rruga e sotme, rrahej përsëri ky krahu i Gominës, që është gati 500 metra më i ultë.

Këto ishin etapat historike të kësaj rruge, me shtigjet e saj të ndryshme, dhe këto shenja tregojnë krahët që kjo ka marrë gjatë kohëve. Por, në të gjitha rastet, kjo ishte «Udha e Madhe», si e cilëson Frang Bardhi, që na jep edhe prejardhjen e fjalës *Pukë* që e pamë më sipër. Si e tillë i ka lënë gjurmët gjithandej. Edhe ky është një element tjetër që flet për rrahjen e vazhdueshme të kësaj rruge dhe për etapat e ndryshme të kloseve, këlcyrave dhe derveneve.

6. Gjëja ndoshta më interesante në këto viset e Veriut që ne po shqyrtojmë është ajo e një arterie së rrahur, me sa duket, qysh në antikitetin e vonë, por një arterie pak e përshkruar dhe pak e njohur në dokumentet historike. Ky shteg përfaqësonte një shkurtojë për të dalur nga viset e Lindjes në Lesh dhe në Durrës, më vonë edhe në Krujë.

Marin Bici (Bizzi) më 1610, është i pari që na e tregon këtë itinerar të cilin e ka përshkuar ai vetë. Ky na thotë edhe se për ta përcjellur në udhëtimin e tij qenka bashkuar me të edhe famullitari i Ndërfandës. Nikollë Regji, pra pikërisht prej Ndërfandës që ndodhet në çelësin e itinerarëve nëpër dy Fandat dhe nëpër luginën e Matit.

Ndërfanda vjen në krye të kësaj udhe, aty ku bashkohen dy Fandat për t'u derdhur në Mat. Marin Bici, pasi lë «më të majtë fshatrat e Mirditës», në mbrëmje arrin në fshatin e Binit, (sot Shëngjini), një prej fshatrave të Fandit, ku banonin krerët e atyre gjindëve»⁴².

Në goftë se nisemi nga Ndërfanda, ku është Maja e Kalasë dhe Suka Gjytet, dy emra që flasin për dy etapa, dhe ndodhet edhe Vau Vilë, pikërisht në krye të kësaj rruge kemi *Proni Klysh*, që thuhet edhe *Proni i Klyshit*, një zhvillim i fjalës *Klos* që ka dhënë *Kluz-Klyz-Klysh*, luhajtje që flasin edhe për kontaminim, dhe ky zhvillim shihet edhe në ndonjë vend tjetër. Ky gjendet në Parasporë të Rubikut. Pra, paraspori është aty, dhe shihet se u është lënë një vend si shpërblim për funksionin e ruajtjes së rrugëve. Pikërisht në Ndërfandë, në Ndërfushas, është edhe *Kroni i Dervendit*, që flet edhe për kohën më të vonë të ndryshimeve të këtij funksioni si emër dhe si vend i ruajtjes së rrugëve.

Ajo që na jep sigurinë për një rrugë të rrahur nëpër Fand të Vogël, qysh të paktën në kohën antike, është vetë fshati i *Klosit*, që sot quhet *Kloskujt* nga bashkimi tani i dy fshatrave *Klos* dhe *Kujt* mbi Fandin e Vogël. Në këtë krah, në Bisakën e afërt, janë edhe *Mulleni i Klosit* dhe *Urë Klosit*, si dhe *Vijë Klosit*. Kjo e fundit na flet për një shtegtim të toponimit. Por kemi plotësimin edhe me *Kodrë Këlcyrës* në Konaj po në ato anë.

Si *Klos* dhe *Këlcyrë* flasin për dy faza të ruajtjes së këtyre ngushticave, dhe të kalimit nga një kohë në tjetrën. Në goftë se *Këlcyra* në Konaj, që duhet të vijë pas, është zhdukur dhe nuk ka lënë gjurmë përposë në një

42) I. Zamputi, «*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII*», I, Tiranë, 1963, dok. 2/114.

emër vendi majë një kodrës për vrojtimin e rrugës (sepse duket se vetë Konaj e ka bërë punën e Këlcyrës), Klosi, duke ruajtur emrin më të vjetër të fshatit, ka pasur edhe përhapjen më të madhe të këtij emri. Kemi prandaj, me sa duket duke e parë në mënyrë retrospektive, një kalim të së njëjtës zyrë nga një fshat në një tjetër. I është hequr besimi i ruajtjes së udhës një fshati dhe i është dhënë një fshati tjetër. Por ajo që ka rëndësi për ne është se kemi edhe këtu asimilimin e *kleissoura* në *kelcyrë*, me metatezën *klei-kel* si në Jug.

Edhe në krahun tjetër, në Fandin e Madh, që i ka gurrat në Qafëmal, në pjesën e epërme të Urës së Berdhetit, kemi një *Prroj i Durrcit* në Kryezi të Pukës, që shënon fillimin e rrugës në këtë krah. Në Gojan është *Prroj i Klyshë* ose *Klyzë*, një kontaminim i qartë që tregon se edhe ky shteg ishte i ruajtur dhe se gojanasit e bënë këtë punë qysh në kohët romake, në antikitet.

Si kjo udhë që ndiqte për çdo kohë Fandin e Madh dhe dilte në Shpal të Mirditës, ashtu edhe ajo tjetra e Fandit të Vogël, që merr prej malit të Munellës, që të dyja sosin në Ndërfandë (*Trefandina* e dokumenteve), d.m.th. *Derfandëna* në Dukagjin, si e shënon Marin Bici, me disimilimin *n-d*, që duket se ishte edhe në atë kohë, në shek. XVII, në të folmit e këtyre vendeve. Këtu kemi edhe kështjellën e Meshurdhit në Fandin e Madh, që i mbikëqyrte këto lëvizje bashkë me Klyzin në Gojan.

Po të vijmë më në perëndim, në viset e Dibrrit, në afërsi të Vigut, që në vetë emrin e tij ruan edhe gjurmën e antikitetit si *vicus* «fshat i hapur», dhe ka edhe Kastrin që ruan rrugën për të cilën kanë folur Hahn dhe autorë të tjerë⁴³, kemi në Ungrej pranë, që Shtadtmyler e quan Pragu Ungrej (*die Schwelle von Ungrej*)⁴⁴, një shteg daljeje për në fushën e Shkodrës. Pikërisht në Ungrej kemi *M Klozat* dhe po aty janë Sheshi i Gjitezës, Prroj i Gjitezës, Udhë Prrojt të Gjitezës, të gjitha rreth e përgark Majes së Komlikut.

Po në këtë trevë, në Kashnjet, na del përsëri ky emër *M. Klozat*, që bashkë me *M Klozat* e Ungrejt, tregojnë se vendi ishte i përshkuar me disa këso rrugësh që të fusin në Dibërr duke shkuar nga Lezha në Gomsiqe, si shkurtojë, për të vazhduar më tutje.

Pra Ndërfanda ose Ndërfandëna (khs. Trefandina), si e tregon edhe orografia, përfaqësonte një cak të detyruar për udhët që të fusnin në dy Fandat dhe në Mat dhe shkonin më tutje, në viset e Rrafshit të Dukagjinit dhe në Kosovë.

7. Kur dalim në viset e Matit, kemi një dëshmi historike, edhe këtu të plotë, që na e pohon shtresimin më të ri të dervenit, me një dokument historik në defterin e vitit 1467. S. Pulaha vë re se në pjesën e botuar

43) J. G. von Hahn, «Reise Drin-Wardar» I, f. 52; P. Träger në «Ethologische Zeitschrift», nr. 33, 1901, f. 151; Th. Ippen, «Nordwestliche Albanien», f. 54; Fr. Nopcsa në «Wissenschaftliche Mitteilungen» nr. 11, 1909, f. 82 v., dhe *Vorgeschichte*, f. 185; F. Gopčević, «Albanien», f. 161, që ka dhënë edhe skicën; M. Šufflay. «Städte und Burgen...», f. 23; Gj. Karaiskaj, «5000 vjetë fortifikime në Shqipëri», Tiranë 1981, f. 108.

44) G. Stadtmüller, «Forschungen zur albanische Frühgeschichte», Fiechbaden 1960, f. 88. 107.

nga Defteri i Dibrës i këtij viti, ndeshën «tre fshatra të cilësuar si derven: *Bilkamin* dhe *Kilos* në vilajetin e Matit dhe fshati *Gjonëm* në vilajetin e Akça-Hisarit».⁴⁵

Shihet se Turqia, pasi vuri këmbë në viset e Matit, mori masa të menjëhershme për të ruajtur shtegun e rrugës, duke caktuar si *derven* fshatrat Guribardhë dhe Klos në Mat, që e kishin bërë këtë punë edhe më përpara. Dhe shihet se sa rëndësi ruante gjithnjë kjo rrugë, sepse masat janë të menjëhershme për ta lënë shtegun hapur. Nuk duhet harruar se Guribardhë e ka edhe gjurmën e një këlcyre: *Gurra e Këlcyrës*, pra shihet se e kish bërë këtë funksion shumë herët. Ky ka edhe lagjen *Mansajt*, që flet për një mans (mansio) ose stacion rrugor për udhëtarët. Dalin kështu të gjitha elementet: Mansi, Klosi dhe Këlcyra. Prandaj në Guribardhë dhe në Klos shihet se ky funksion i ruajtjes së rrugëve është bërë qysh herët, siç e tregojnë vetë këto fjalë. Klosi i poshtëm quhet edhe *Klos-fushë* për ta dalluar nga Klosi i Epër, që quhet edhe *Plani i Bardhë*. Në Klos-fushë është edhe hidronimi *Prroni i Klosit*. Turqia ia ka njohur rëndësinë të dy këtyre fshatrave dhe i ka lënë përsëri ta bëjnë këtë funksion, por me emrin e ri derven, dhe shihet se këtë emër nuk ka mundur t'ia vëjë.

Ky emërtim i ri që bie tani pushtuesi ka qenë i lidhur me *Gjitetin e Skanderbegut* në Stelush të Matit, që ruante depërtimet osmane në krahun lindor të kësaj lugine, pra me një kështjellë. Dilaver Kurti shënon se këtu në Stelush kryqëzoheshin tri rrugë me rëndësi: «e para nisej nga Shufadaja, kalonte Kulmen e Dervendit, zbriste në Urakë, shkonte në Lis dhe në Stelush; e dyta nisej nga Durrësi, shkonte nëpër Prezë, Zgërdhesh, Qafështamë, Komsi, Burrel, Lis dhe Stelush; e treta merhte nëpër Guribardhë, Stragj, Pleshë, Cërujë, Patin, Kurdari, Lis dhe soste në Stelush»⁴⁶ për të vazhduar pastaj më tutje. D. Kurti mendon se kjo rruga e fundit «duhet të ketë qenë udha nëpër të cilën Gjon Kastrioti u siguronte tregti të lirë raguzanëve nga Shufadaja në Prizren»⁴⁷.

Në luginën e Matit, në krahun e Stelushit, të cilin Skënder Anamali e vëndon në Kalanë e Varoshit⁴⁸, kemi sistemin tjetër që lidhet me këtë kështjellë. Skënder Anamali na thotë se kërkimet arkeologjike tregojnë se kemi të bëjmë me një vendbanim ilir. Objekte të tjera tregojnë vazhdi-

45) S. Pulaha, «*Burime osmane*», Tiranë, 1968, f. 386, shën. 2, Trajta *Bilkamin* për *Guribardhë*, është një sllavizim që bën shkruesi osman. Këtë mënyrë regjistrimi ne e kemi vënë në krahasim me dokumente të tjera, si p.sh. me trajtën që jep Gastaldi në Hartën e tij (rreth vitit 1560) *Guri Bardhë*, që është transkriptimi i Gurit të Madhë (sh. K. Luka, *Raste ndërhyrjesh administrative* në «*Studime filologjike*» nr. 1, 1970, f. 90).

46) Dilaver Kurti, *Kalaja e Varoshit në Mat*, në «*Konferenca e II e Studimeve albanologjike*», vëll. I, f. 608. v.

47) Dilaver Kurti, *po aty*. Ky shënon se në lagjen Vig të Shlliu, ku ndodhen edhe sot rrënojat e këtij *Gjiteti të parë në Mat*, si e quan tradita popullore Stelushin, janë edhe toponimet *Varoshi*, *Pazari* dhe *Farka*. Ka mjaft të drejtë ky autor që Stelushin e quan «qendër administrative, tregtare dhe zejtare». Ne na duket se ka mjaft gjasë që ky qytet të kishte në antikitetin e vonë edhe statutin e *civitas*, qysh se ka edhe *vicus* «fshat i hapur» aty afër, në Vigun e Shlliu.

48) Skënder Anamali, *Kalaja e Varoshit në Mat*, në «*Konferenca e II e Studimeve albanologjike*», vëll. I, Tiranë, 1968, f. 249.

mësinë e jetës në këtë vend. Autori përpiqet të vëjë në lidhje këtë Stelush me *Stephaniakon* të shek. VI, që e kemi në listën e Prokopit të Cesaresë⁴⁹. Ky autor e vë në krahasim këtë edhe me afërsinë e fshatit Shqefen, që ruan edhe sot emrin e vjetër.

Në Lis të Matit kemi edhe toponime më domethënës: *Shpella e Kluserës*, që është një zhvillim i temës me prapashtesë dhe flet qartë për prodhimtarinë e këtij termi.

Nga ana tjetër, kur nisemi nga itinerari i Gjormit, që u shpall edhe ky derven më 1467 dhe që na shënon edhe një *terminus a quo* të daljes së parë në fazën e tretë të këtij sistemi në këto vise, në qoftë se këtu emri i shtresës së tretë ka humbur, në ato afërsi gjendet fshati *Dervend*, dhe më tutje, në Daule të Kurbinit kemi edhe *Bokë Dervendit*. Të dyja lidhen pak a shumë me këtë dalje të parë të emrit dhe shihet se sistemi osman ka bërë lëvizje të mëdha.

Kështjella e Daules, i lidhur me fshatin homonim, është ndërtim i Justinianit në shek. VI. Kjo shënohet në listën e Prokopit të Cesaresë me emrin *Aiula*. Kjo zotëronte rrugën e Hurdhazës, nga e cila mund të shkohej nga Dibri dhe Mirdita shumë shpejt në Krujë. Kjo quhet, si e shpiegon Luan Bajo⁵⁰, *Kalaja e Fshehtë* ose *Kalaja e Skandërbegut*. Kështjella është e ndërtuar në majën e një kodre të vetmuar që bie pothuaj thik mbi Bregun e Hurdhazës, degë e lumit Mat.

Se Gjonmi e ka pasur këtë funksion të dervenit edhe shumë herët, qoftë edhe pse e ka humbur emrin e ri derven, me të cilin e cilëson një kadastër osman, këtë emër do ta marrë edhe fshati që ne do ta quajmë më i ri *Dervend*, të cilit nuk ia dijmë fare emrin e parë⁵¹, në afërsi të Mamurasit, që do ta mbajë të plotë deri në sot apelativin osman. Në të vërtetë, vetë vendi dhe orografia të bën të mendosh se ky *Dervend* nuk ka qenë i pabanuar edhe para pushtimit osman, para se ta merrte emrin e ri, por deri tani nuk kemi të dhëna që të përlligjin një mendim të tillë.

Edhe këtu në Gjonën, në qendrën e sotme të NBSH-së, gjejmë *Kulla e Këlcyrës* dhe si *Këlcyrë* përmendet edhe krejt një vend po në ato afërsi. *Këlcyrë* quhet edhe sinori që ndan Gjonmin me Laç. Pra edhe toponimia e tregon se këtë funksion e ka pasur shumë herët, si një rreth i ruajtjes së rrugëve Shkodër-Durrës, Shkodër-Krujë.

Këtu në Gjonëm, edhe në qoftë se është zhdukur shtresa më e re, derveni, që e kemi vetëm prej dokumentacionit, shtresimet e tjera nuk janë shuar por kanë mbetur, dhe vetë topografia tregon se nuk janë shtegtime por gjurmë të vjetra të ruajtjes së emrit dhe të funksionit.

Këto vise të Kurbinit të Krujës janë plot me të tria shtresat, sipas lëvizjes së itinerarëve dhe të kohëve, me fjalë të tjera ky funksion ka kaluar, sipas kohëve, nga një vend në tjetrin, sipas ruajtjes së krahut të rrahur të rrugës dhe nga shkaqe kënetëzimesh dhe arësye të tjera.

49) Skënder Anamali, *po aty*.

50) Luan Bajo, *Kalaja e Sebastjes (Laçit) dhe e Daules si hallka të sistemit të Skëndërbeut*, në «Konferenca e dytë e Studimeve albanologjike», vëllim I, Tiranë 1969, f. 313.

51) Edhe këtu administrata e vjetër zogiste i kishte vënë këtij vendi emrin *Drunjaj*. Është me të vërtetë për të ardhur keq për këtë papërgjegjësi në emërtimet, dhe të lidhet me sllav. *drvo*, një fjalë që nuk ka të bëjë fare me të.

Një gjurmë prej këtyre tri shtresimeve, që nuk dalin në ato vise që pamë më sipër gjendet në Burizanaj, ku një emër toke është *Klezerë*. Si emër, nuk është tjetër veçse një ndryshim forme.

Pak më në Veri, në Laçin e Kurbinit, aty ku është sot qyteti industrial, ndodhet në majë të një kodrës *Gjyteti i Sebastes*. Në anën perëndimore, është një faqe thik e pjerrët, përfund së cilës gjendet fshati Laç. Në anën tjetër ka një përrua shumë të thellë. Si e përshkruan Luan Bajo, kjo kështjellë ka trajtën e një katërkëndëshi kënddrejtë. Nga ndërtimi i saj, siç e kanë parë edhe Th. Ipen, Prashniker e Shober, kjo kështjellë është mesjetare. Emri e ka shpënë autorin ta quajë këtë vend si ndeja e ndonjë sebasti bizantin⁵², ndoshta në kohët e themës së Durrësit.

Kështjella sot quhet me një emër tautologjik *Kalaja-Gjytet*, që për kohën është e njëjta gjë. Në, ato afërsi është një kodër e quajtur *Këlcyrë* dhe kështu sistemi shënohet plotësisht, sepse në këmbët e kështjellës dalin rrugët që vijnë nga Shkodra, Lezha dhe Fandi. *Emri i vjetër këtu në Laç ruhet jo vetëm në emrin e kësaj kodre, por edhe në një tokë në Jug që quhet Kelcerja, që nuk është tjetër veçse një kontaminim fare i qartë.*

Nga ana tjetër ka *Kulmen e Dervendit*, një rrugë e lartë që i përshkon këto vise mbi 800 metra. *Hija e Dervendit me Pyllin e Dervendit dhe Vathnajen e Dervendit* gjenden në lagjen Sanxhak të Bushkashit (Kthellë). Edhe në Lurth të Kthellës janë *Fusha e Dervendit, Kodra e Fushës së Dervendit dhe Kroj i Dervendit*. Dhe ka edhe një fshat tjetër të quajtur *Dervend* në Mirditë.

8. I pamë fshatrat *Klos* në Kabash të Pukës, *Klos* në Mat, *Klos*, në Fandin e Vogël, dhe kemi edhe një fshat *Klos* në afërsitë e Brizës, që më 1583 përfshihet në kazanë e Ishmit. Tani po shqyrtojmë fshatin *Klos* të Sulovës, në pritje të shohim *Klosin* e Mallakastrës.

Dendësia e emërtimit të fshatrave *Klos*, pa folur për lagjet dhe emërtimet e tjera, që hyjnë të gjitha në mikrotoponimi, flet për një emër të shpeshtë. Është një ndër emërtimet më të dendura të këtij lloji, dhe kjo flet qartë për orografinë e vendit dhe për vjetërsi të madhe. Dhe nuk duhet harruar se emri ka kaluar edhe në onomastikë. I vënë në lidhje me këlcyrat bizantine dhe më vonë me dervenet osmane, flet për gjerësinë që kishte marrë ky sistem, ku sot kapën aq gjurmë dhe gjashtë fshatra me të njëjtin emër dhe me të njëjtin funksion, me një asimilim të njëllë të fjalës së huaj në Veri dhe në Jug.

Sot ky *Klos*, që dikur bënte rolin e ruajtjes së rrugëve në luginën e Devollit, është pjesë e fshatit Qafë po në Sulovë. Natyrisht se sot kushtet janë krejt të tjera: është politika e Partisë për grumbullimin e vendbanimeve të vogla në kooperativa të bashkuara, prandaj në këto vise edhe ka fituar Qafa që ka pozicionin më të mirë në këto hapsirat që lë të lira rrjedha e Devollit. Qafa ka përpirë fshatin *Klos*, që ndodhej në një vend më të përthyer për të ruajtur rrugën dhe për t'u ruajtur edhe ai vetë.

Por, deri pak kohë, më parë e kishim këtë *Klos* si fshat më vete, dhe ky tregonte vendin e mbylljes së një rruge për të cilën dokumentacioni historik nuk thotë asgjë.

52) Luan Bajo, *art., cit.*, f. 312.

Ky Klos është edhe i pajisur me mjetet e tij: ka kështjellën *Kalanë e Klosit*, që përfshin një sipërfaqe mjaft të madhe; *Kishën e Klosit*, me rrenoja pjesërisht në këmbë dhe me varre të vjetra, *Rrugën e Klosit* dhe *Çesmen e Klosit*, si edhe mjaft emra të tjerë me Klos, si faqe mali, ara, shpatina etj.

Si derven kemi edhe një *Dervenshtra*, për një emër arash në Katërlispe të Sulovës, dhe ky na del si i vetmi rast i dervenit që ka pasur zhvillime prapashtesore, sepse deri tani nuk kemi gjetur tjetër.

Më tutje në këtë vijë rrugore na del edhe një *Sese Dervenit*, për një shkëmb që del në udhën e Voskopojës, në fshatin Gjonmadh, dhe tregon edhe itinerarin që ndiqej.

Po ta shtrijmë më tutje shikimin në viset e Kolonjës, megjithëse nuk kemi të dhëna për zonat e ndërmjetme, na del edhe këtu klosi: *Burimi i Klosit* në Kagjinas, si edhe emri tjetër *Kloseri*, i zhvilluar me prapashtesë si e pamë edhe në Veri, në Lis të Matjes dhe në Burizanë. Ky emër përmendet për disa ara përsëri në Kagjinas të Kolonjës.

Po në Kagjinas gjejmë edhe fazën fundore të këtij institucioni, *Dervenin*, me të cilin është emërtuar një pyll shkoze. Kagjinasi duket prandaj se ka luajtur një rol klosi qysh prej antikitetit, të vonë deri në kohën e Turqisë. Kalimi nga klosi në derven, edhe pse nuk e kemi fazën e ndërmjetme këlcyrë, na flet mjaft qartë në këtë vështrim.

9. Në gjysmën e parë të shek. XIV (1319-1337), në vijën e fortifikuar jugore të vendit, së bashku me Beratin dhe Kaninën përmendet në dokumentacionin mesjetar emri i dytë që kishte marrë qyteti *Nikaia-Nicaea* si Klos, nën trajtën *Clissania*, kështjellë bizantine, si e vë re M. Shufflay⁵³. Si qytet, ky ka pasur edhe kontët e tij (*comiti Clissanie*). Por kështjella nuk ishte më në fund të shek. XIV, d.m.th ishte rrënuar.

Si Klos, por vetëm si fshat, do të përmendet edhe 119 vjetë më vonë, më 1431-1432, në dokumentet osmane këtë herë, në kadastrën e parë turke për Sanxhakun Arvanid. Por, më 1678 na del dy herësh, d.m.th. dy fshatra të njohur si *Klosi i Vogël* dhe *Klosi i Madh*, të cilët nuk i paskan paguar të prapambeturat fiskut osman⁵⁴. Kështu njihen dy Klose, që duhen të jenë një zgjerim i fshatit të përmendur ndërmjet 1431 dhe 1678.

Pas gjithë gjasëve, qyteti i vjetër *Nikaia-Nicaea* e ka marrë emrin e ri Klos në kohën e antikitetit të vonë. Shihet më vonë se edhe sllavo-bullgarët bëjnë një përpjekje për ta quajtur kështjellën Gradishte, mbasi kemi po në Klos edhe një emër për këtë ngrehinë: *Gradishtë Klosit*. Por pushtimi bullgar nuk ka pasur pasoja mbi emrin dhe vendbanimi nuk ka luajtur nga emri që kishte marrë qyteti në antikitetin e vonë. Kështu ka mbetur përsëri Klos dhe po me këtë emër do ta gjejmë më vonë edhe pushtimi osman, dhe kështu do ta regjistrojë kur do të bëjë kadastrimin e Sanxhakut Arvanid më 1431-1432.

Klosi e ka bërë funksionin e tij edhe me kështjellën e vet, sepse ndodhet në pikën kur duhet kaluar për të dytën herë Vjosa.

Si shtegtim të emrit kemi edhe *Ullinjt e Klosit* në Rroms të Mallakas-trës, që në të dy komponentët e tij flet për faza të lashta si Rroms dhe si

53) M. Šufflay, «Städte u Burgen», f. 33.

54) S. Pulaha, «Qëndresa...» cit., dok. 118, 122.

Klos, dhe na shpie në antikitetin e vonë, si datim i përafërt të marrjes së këtij emri të ri nga Nikaia-Nicaea.

Gjithnjë në vijën e fortifikatave më jugore, kemi edhe *Bregun e Klosës* në Qeparo të Vlorës. Këtu ndodhet edhe *Qyteza e Karos* në veri të fshatit, mbi një majë shkëmbore, në lartësinë 450 m. mbi nivelin e detit. Ana perëndimore e kodrës ku është kjo, përfundon me një humnerë, e cila krijon një mbrojtje natyrore mjaft të sigurtë. Me pjerrësi të madhe bien edhe dy shpatet e tjera. Fortifikimi përbëhet nga tri harqe muresh që zënë shpatin lindor, me skajet mbi buzën e greminës⁵⁵.

Edhe kjo, në kohën e sundimit sllavo-bullgar, është quajtur *Gradishte* një emër që ka mbetur vetëm këtu, por i dyzuar me emrin shqip *Qytezë*, me fjalë të tjera emri sllavo-bullgar ka rënë në harresë. Por, këtu kemi edhe *Hundë Kastelit*, për të cilin flitet se është i kohës së Venedikut, pas-taj është edhe *Kalajë Kastrisë* në Porto-Palermo, një tautologji popullore. Shihet edhe këtu se të gjitha pushtimet kanë lënë gjurmën e vet dhe flasin për antikitet të vonë.

Qeparoja është në një ngushticë ndërmjet detit dhe maleve të larta, dhe ka mjaft afër shtegun e Sopotit që të fuste nëpër luginën e tij në krahun e Kurveleshit të Epër.

Për klosat e antikitetit flet vetëm ky Klos i Qeparosë. Duket se janë zhdukur të tjerët. Këlcyra bizantine nuk dalin: ndoshta edhe këto janë shuar për gjithnjë.

Më tutje, kemi një *Prroj i Dervenit* në Muzinë të Delvinës. Përsëri më tutje, na del një këlcyrë nën trajtën *klisurë-hlisurë me Prrojn e Hlisurës* në Konispol të Çamërisë. Brenda kufijve të sotëm të Greqisë kemi edhe *Klisirat*, një tokë buke dhe një shesh, dhe *Klisira e Shaban Jahos*, për një arë në Varfanj të Gumenicës.

Si derven kemi emrin *Derven* për një mal, dhe Prari (*Përralli*) i *Dervenit* në Karbunari të Çamërisë, dhe *Derveni* për një shkallë me buza të lumi i Mazrreku në Smokovinë të Margëlliçit.

Këto janë emërtimet që kemi mundur të kapim në tri arkivat që përmenden në fillim, por duhet thënë se ka edhe të tjera.

Si përfundim, në qoftë se nisemi nga gjendja që i kemi sot këto toponime klos, këlcyrë, derven, shohim se ndodhemi përpara një fosilizimi të plotë për dy të parat, të cilat janë harruar fare se ishin fjalë të leksikut në një kohë, dhe gjysëm të fosilizuuar për fjalën derven, që ruhen ende në ndonjë skaj dhe të kujton rojën e rrugëve ose shënon në leksik një shteg të rrahur, një grykë, një dalje etj. Kështu ka zënë vend ky turqizëm edhe në fjalorin e vitit 1980.

Për *klos* kemi variantet *kloz*, *klus*, *klyz*, *klysh* ku trajtat me *-y-* nuk janë tjetër veçse metafoia e trajtave me *-e-* dhe *-u-*, dhe shënojnë

55) J. Koçi, *Qyteza e Karos në Qeparo* në «Buletini arkeologjik» nr. 3, 1971, f. 181.

me sa duket shumësin. Te *klysh* ndërhyr frikativja qiellzore me një kontaminim që nuk lë pikë dyshimi.

Me gjithë këto kalime, që nuk janë veçse të disa zonave të Veriut, mbizotëron tërësisht, në të gjitha toponimet në Veri dhe në Jug, trajta klos, që është më e përgjithshme: Pra kemi një fjalë që nisët nga latinishtja vulgare *clousum*, e marrë nga pjesorja.

Si shpërndarje të këtij emri kemi Klos qysh në pikën veriore të Fandit të Vogël, në tërë Shqipërinë, e mesme dhe në Jug, të përhapur deri në Kagjinas të Kolonjës. Por ka të ngjarë të jetë edhe në zona të tjera në Veri dhe në Jug. Shihet se asimilimi është i njëjtë në tërë këtë shtrirje, me 6 fshatra me këtë emër, nga të cilët njëri ka qenë qytet deri në shek. XIV: Klosi i Mallakastrës, që ka ardhur me po këtë emër deri më sot. Si trajtë, kjo duket se është shtrirë në antikitetin e vonë, kur ky institucion bëhet i qenë.

Me sa duket, këtë kalim e bën edhe më të qenë emërtimi i qytetit *Nikaia-Nicaea* i cili shndërrohet në *Klos (Clissania)* në antikitetin e vonë. Po ky emër Klos do të vazhdojë edhe kur qyteti do të shkatërrohet, ndoshta në kohën e fushatës bizantine të Andronikut më 1336 kundër arbërve kryengritës.

Si zhvillim i mëtejshëm i kësaj rrënje *klos-* kemi *Klezera* në Burizanaj të Krujës dhe *Shpellë-Kluserës* në Lis të Matit, si edhe *Klosera* në Kagjinas të Kolonjës. Kjo *Klisurë*, që me prapashtesën *-erë* shënon një emër vepruesi (*nomen agentis*), edhe kjo tregon si ishte gjendja në leksik para se emri të mbetet pronë e toponimisë.

Në të gjitha këto duhet të kemi parasysh se toponimet janë fond i leksikut dhe si të tilla kanë pasur edhe jetën e tyre paradigmatiche deri që kanë arritur në toponim, me morfemat kombinatore të gjuhës, që sot nuk i kapim, vetëm se na dalin ashtu të fosilizuara me emra vendesh.

Për fjalën tjetër *Këlcyrë*, që e kemi të shtrirë nga i gjithë Veriu deri në Leskovik, të dyzuar me *Klyzyrë-Klisyre* në Rrafshin e Dukagjinit dhe në Kosovë, ose me *Klisurë-Hlisurë* në Çamëri, përfshijmë mbarë habitatin arbër. Këto të fundit duket se janë në ndikimin e gjuhëve fqinje, prandaj janë edhe anësore.

Kjo shënon edhe termin *Kleissoura* që asimiloi greqishtja bizantine nga lat. *clausura*. Por, për ne është një huazim i prurë nga Bizanci, që ka ardhur në shqipen me ndërmjetimin e greqishtes bizantine. Perandoria bizantine këtë term ia kundërvuri *klosit* dhe tek ne kanë bashkëjetuar të dy termat klos dhe këlcyrë.

Megjithëse kishin ndryshuar taktikat ushtarake, strategjia dhe qëllimi nuk kishin ndryshuar. Kemi në këtë kohë vetëm ndonjë ndryshim klosi në këlcyrë, ose krijimin e ndonjë këlcyre të re në ato afërsi, doradorës që forcohej sistemi, ose kemi edhe zhdukjen e ndonjë fshati klos dhe emërtimin e tij me këlcyrë.

Me këtë emër si fshatra kemi *Këlcyrën* e Jugut si edhe fshatin *Klyzyrë (Tropojë)*, përposë Këlcyrave të shumta të tjera, si i pamë, dhe që hyjnë të gjitha në mikrotoponimi. Në të gjitha vepron metateza e thjeshtë në rrokjen e parë *klei-* *kël-* dhe *-ssou-* kalon në *-cy-*.

Të dyja fjalët me sistemet e tyre paradigmatiche vënë në dukje hua-

zimin e këtij institucioni mbrojtës nga dy pushtimet: romake dhe bizantine.

Kemi, si e pamë, edhe fazën e tretë *derven*, që është një fjalë më e re dhe, natyrisht, edhe më e përhapura, për shkak të kontingjencave dhe të kohës së gjatë të sundimit osman, megjithëse në shekujt e fundit ndodh edhe ndryshimi i këtij sistemi me karakollet.

Derven, si e vumë re më sipër, është një term i gjetur nga osmanët në viset e Anadollit dhe i prurë me vete. Por, se këtij sistemi i jepnin rëndësi të madhe edhe osmanët, shihet ndër koncesionet kadastrale që u bëhen atyre vendeve *derven* që gjetën, me zbritje tatimesh, përjashtime të disa rëndimeve fiskale etj. Kjo hetohet qysh në kadastrimet e para osmane dhe në dokumente të tjera.

Fjala *derven* gjendet me shumicë në mikrotoponimi, por ka edhe dy fshatra *Dervend* në afërsi të Mamurasit dhe *Dervend* në Mirditë. Merret vesh se në ato kohë kemi edhe zëvendësime të klosave dhe të këlcyrave me *derven*. Kjo shihet në vetë fjalën se e kemi në pajtim me atë funksion. Natyrisht se, si fjalë më e re, do ta ruante disi më mirë individualitetin e vet dhe do të vinte më me shumicë në ditët tona, duke shlyer shpesh klosët dhe këlcyrat e mëparshme. Por edhe kjo ka pasur rënien e vet tash nja dy shekuj, si e vumë re, dhe prandaj edhe kjo e ka humbur kuptimin dhe është shlyer edhe vetë ose ka shtegtuar si simbol i kohës. Shihet, p.sh., se fjala e re *derven*, që kish shlyer fjalën *klos* në zonën e Tepelenës, është ruajtur deri në kohët e Ali pashë Tepelenës dhe të konsullit frëng Pukëvil, dhe më vonë gati është shlyer edhe kjo, duke u ruajtur sporadikisht në Hanin e Subashit dhe në krahun e tij në këtë anë.

Huazimi osman është plotësuar në disa vise edhe me shqipen *vend*, mbasi në asimilimin e tij, arbëri do ta plotësonte fjalën e huaj, si etimologji popullore, dhe është bërë *dervend*.

Përposë këtyre, një shembull edhe më tipik e kemi në Mat, te fshatrat Guribardhë dhe Klos. Në qoftë se në fshatin Klos shihet përparësia qysh në kohët e antikitetit në vetë termin dhe funksionin që kishte, te Guribardhë kemi *Gurrë Këlcyrës* që flet për kohë të hershme bizantine. Mundet që në këtë kohë Klosi dhe Guribardhë ta kenë bërë bashkarisht këtë funksion, qysh se më 1467 caktohen nga Turqia ta bëjnë bashkarisht. Më vonë, me rënien e sistemit, duket se kanë pasur edhe ndonjë grindje për sinoret midis tyre, qyshse Klosin e Epër e ka marrë Guribardhë me gjithë malin duke i ndryshuar edhe emrin dhe duke e bërë Plani i Bardhë. Pushtimet ndiznin grindje, dhe kjo dihet, dhe një ndër këto grindje është përfaqësuar edhe këtu, ndër sinoret midis dy fshatrave.

Por fakti më tipik është kur arbërit bënë një kalk me një fjalë vendi *mbyllç* dhe *mbyllës* të dy termave të parë, të plotësuar edhe me *mshilt*. Nuk ka dyshim se kjo është bërë në kohë të hershme. Për fat të keq këto fjalë nuk patën vazhdim dhe si të tilla mbetën të vetmuara në një zonë të vogël: në Drisht, në zotërimet e Lekë Zaharisë dhe në Pjetërshpan ose Pult.

E pamë se fjalën *Mbyllç* mund ta quajmë një metaforë nga *mbyll*. Duhet të vëmë në dukje edhe se prapashtesa *-ç* është e cilësuar me një vlerë të saktë, që e mba e gjitha edhe sot, megjithëse ka kohë që funksioni i këtij *Mbyllçi* është shuar fare dhe harruar.

*
* * *

Në të gjitha rastet shihet se dy fjalët e para klos dhe këlcyrë, si fjalë të leksikut të pushtuesve të një kohe, kanë pasur asimilimet e shqipes në një shtrirje më të gjerë, në një kohë kur dialektet ishin më afër njëri tjetrit. Këto janë plotësuar edhe me Mbyllç, Mbyllës, Mshilt, dhe tregojnë sistemin e ruajtjes së rrugëve nëpër vendin tonë aq malor dhe me një orografi aq të thepisur.

KLOS, KËLCYRA, DERVEN, MBYLLÇ, MSHILT
IN THE ONOMASTIC REPERTOIRE OF THE ARBËRIA

From the beginning we may say that we have to do with an institution derived from ancient times, a supplement of those *castra*, *castramenta*, *castella*, *vici*, *oppida*, *poleis*, etc., which spread in the Roman period and later, in the Byzantine period, in order to keep the country under domination and to condition its development by that of the Empire.

Naturally, *klosas* and *këlcyras*, which were posted to guard the roads, emerge as supplements of this castle system. With the extension of the Turkish occupation in our country and the Balkans, they were replaced by the new Turkish word *derven*.

An analysis of them acquaints us with the lexicographic patterns which may assume in time various forms. Their various origin, from the East and West, does not deprive the nominative term of its fundamental meaning. Looking at it from all the points of view, the one and same meaning of something to guard the roads, emerges.

Këlcyra comes from *clysurai* and is a Greek term, more probably of the Byzantine period. *Klos* comes from *clausura* and is a term coming from the Roman period. *Mbyllç* is an early Albanian word. *Derven* is a Turkish word.

In broad outlines, two strata which give some sort of chronology of the Roman and Byzantine periods, are obvious here. It is known that in his time the creator of the Byzantine themes, the emperor Theophilus (825-842), established small military centres in these *këlcyras* and called their chiefs *clysuriarcs*.

This system is derived from ancient times and was preserved up to the Turkish period, when system of guarding the roads begins to be replaced with military posts, called *karakolls*.

A full explanation of these *clysurai* is given by Anna Komneni, when she says that her father Alex Komneni had placed many forces with selected chiefs at every *clysurai*, thus closing all paths to the Normans.

The author examines the onomastics of the country from the northeastern territories in Kosova down to Çamëria, that is, all over the Albanian habitat.

The toponymy of some the settlements in the Roman period assumed also the title of *civitas*, *universitas*, *municipium*, as we find them recorded in documents on Lissus-Lesh, to which Cicero gave title *municipum*.

The author traces all the roads of Albania, giving chronologically the time when these *klos*, *këlcyrra*, *mbyllç*, *derven*, were established, while pointing out several new roads, which were not known before, and placed the historians in great difficulty distinguishing them from the known ones.

It is not rarely that *klos* is replaced with *këlcyra* or even with *derven* according to the religion that each new invader introduced in one or another village and this is natural.

However, in all these cases it may be seen that the assimilations of the first two words *klos* and *këlcyra*, as words pertaining to a foreign lexic at one time, had a greater extension at a time when dialects were closer to one another. These have been supplemented also with *mbyllç*, *mbyllës*, *mshilt*, and are evidence of the system of guarding the roads throughout our country, with a very accentuated mountainous relief.

Aleksandër DHIMA

ECURIA KOHORE E TIPAREVE ANTROPOLOGJIKE NË KOLONJE

Problemi i etnogjenezës shqiptare, ndjekja e lashtësisë dhe e vazhdimësisë së popullit tonë ndër shekuj në trojet e veta, është vënë tashmë në krye të tematikës së kërkimeve dhe studimeve tona antropologjike. Kjo detyrë realizohet përmes krahasimit të tipareve antropologjike të popullsisë së sotme të vendit me ato të skeleteve njerëzore që dalin në gërmimet arkeologjike e që u përkasin periudhave të hershme historike.

Nga hulumtimet mbi popullsinë e gjallë është mbledhur një material i rëndësishëm antropologjik sipas zonave të mëdha etnogjeografike të vendit, i cili shërben për ndërtimin e një profili paraprak mbi tiparet e përgjithshme antropologjike të shqiptarëve. Është pikërisht një profil i tillë që mund të përdoret dora-dorës si mjet krahasues për materialet skeletore të periudhave të hershme historike. Në këtë drejtim, do të ishte me dobi krahasimi dykohësor i fakteve antropologjike që vijnë nga e njejta krahinë; ky studim, i kryer në thellësi, do të na lejonte të ndjekim nga afër lëvizjen kohore të tipave antropologjikë në trevat tona, përmes veçorive lokale, krahinore të tyre.

Një përpjekje të tillë kemi bërë për Kolonjën, mbasi nga kjo trevë kemi të dhëna antropologjike si për skeletet e periudhave të mëparshme, ashtu edhe për të gjallët. Përmendim me këtë rast skeletet e varrezës së Shtikës, që datohen, në bazë të materialit arkeologjik shoqërues, në fundin e mesjetës së hershme (shek. X-XII e. sonë)¹ dhe skeletet mesjetare të zbuluara në shtresat e sipërme të tumës së Rehovës që i përkasin fillimit të shek. XVIII, pra mesjetës së vonë². Nga ana tjetër, në vazhden e kërkimeve për ndjekjen e tipit antropologjik të shqiptarëve, në muajin shtator të vitit 1982 u zhvillua një ekspeditë e gjerë në të gjithë rrethin

1) D. Komata, *Gërmime në varrezën mesjetare të Shtikës (Kolonjë)* «Buletin Arkeologjik «Tiranë 1969, f. 119-126.

2) S. Aliu, *Rezultatet e gërmimeve në tumën e Rehovës (1979)*, Arkivi i Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike, nr. 4101.

për përcaktimin e strukturës tipologjike të banorëve të kësaj treve. Materialet skeletore mesjetare nga Kolonja kanë kaluar tashmë në përpunimin shkencor antropologjik³. Në këtë punim do të përqendrohemi në përbërjen antropologjike të popullsisë së sotme të Kolonjës për ta pasur këtë si bazë për ndjekjen e tipareve fizike njerëzore të kësaj treve deri në shekujt e mesjetës së hershme, mbasi edhe materialet që kemi në dorë shtrihen kryesisht në këtë hark kohor.

* * *

Kolonja shtrihet në një pllajë të lartë e të mbyllur. Nga lindja kufizohet prej kreshtës së Gramozit, nga veriu bregu i Qarrit e Mali i Zi e veçojnë prej zonave të Devollit, Fushës së Korçës e Vakëfeve, në përfundim përroi i Ballabanovës si dhe malet e Qelqezës e Radomit e ndajnë nga Skrapari e Dangëllia, ndërsa lumi i Lëngaricës në jug e kufizon me zonën e Leskovikut. Brenda këtyre kufijve, ndër luginat e përrrenjve të shumtë që furnizojnë me ujë Osumin, gjenden rreth 60 fshatra, banorët e të cilëve kanë tradita e zakone të përbashkëta, duke formuar kështu një zonë të veçantë etnografike. Kolonja në vetvete është pjesë e krahinës së madhe të Toskërisë⁴. Sipas gojëdhënës së popullit, emri *Kolonjë* në fillim përmblihte fshatrat në të dy shpatet e Gramozit; banorët e këtyre fshatrave janë kolonjarët e vjetër. Me kalimin e kohës ky emër lëviz duke zbritur prej viseve malësore në Pllajë⁵ për t'i dhënë Kolonjës një përhapje shumë më të gjerë, pikërisht atë që ka sot. Në tërësinë e territorit të sotëm të Kolonjës nuk shihen dallime të ndjeshme etnografike në mes banorëve të fshatrave të veta. Ndryshimet e lehta që vërehen kur kalon nga njëra zonë në tjetrën i detyrohen kryesisht karakterit të lidhjeve martesore brenda grupeve të caktuara të fshatrave, endogamisë, në të cilën patën, padyshim, ndikimin e tyre edhe përçarjet fetare të së kaluarës⁶.

Pozita e veçantë gjeografike, lartësia e madhe e Pllajës së Kolonjës, rreth 1050 m. mbi nivelin e detit, rrethuar me male të larta e të pasura në kullota verore, ka diktuar zhvillimin e hershëm dhe me përparësi të blegtorisë në këto anë⁷. Mbas çlirimit të vendit sipërfaqja e tokës së punueshme u rrit në mënyrë të ndjeshme dhe sot bujqësia është bërë dega kryesore e ekonomisë.

Gjurmimet informative dhe gërmimet sistematike arkeologjike, të ndërmarra vitet e fundit në rrethin e Kolonjës, kanë nxjerrë në dritë një

3) A. Dhima, Dh. Tole. *Të dhëna mbi tipin antropologjik të shqiptarëve gjatë mesjetës*, «Iliria» IX-X, 1979-1980, f. 314-317; A. Dhima, *Të dhëna antropologjike mbi gjenezën e shqiptarëve (Disertacion)*, Tiranë 1982, f. 168-169.

4) Rr. Zojzi, *Ndamja krahinore e popullit shqiptar*, «Etnografia Shqiptare» I, Tiranë 1962, f. 53.

5) Po ai, *Raport i ekspeditës etnografike në Kolonjë (1950) III*, Arkivi i Sektorit të etnografisë të Institutit të Kulturës Popullore, nr. 12/4, f. 6.

6) *po aty*, f. 9-10.

7) A. Dojaka, *Veshjet popullore në rrethin e Kolonjës*, «Etnografia Shqiptare» 12, 1982, f. 135.




Fig. 1: Harta etnografikë e Kolonjës.

numër të madh vendbanimesh e gjetjesh të tjera, që dëshmojnë për popullimin e pandërprerë të kësaj treve nga neoliti në mesjetë. Gjurmët më të hershme të kulturës prehistorike kanë dalë në vendbanimin neolitik të Kamnikut⁸. Për periudhat pasardhëse dëshmitë arkeologjike janë më të shumta, si qytezat e kalatë në Luaras, Gradec të Bejkovës, Hollm, Kamnik si dhe nekroplet tumulare e varrezat e dysta në Luaras, Qafëzez, Prodan, Taç, Borovë, që shkojnë nga mesi i bronzit deri në kapërcyellin e mijëvjeçarit tonë⁹. Të dhënat e autorëve antikë flasin për vendosjen e kësaj treve në tokat e fisit ilir të desaretëve¹⁰; me këtë nuk mund të vihet në dyshim karakteri i mirëfilltë ilir i banorëve të hershëm të Kolonjës. Për popullimin e kësaj treve gjatë mesjetës dëshmojnë gjurmët e kalave, kishave e varrezave që gjenden në shumë fshatra, si në Shtikë, Hollm, Gradec të Bejkovës, Gradishtë të Barmashit etj.¹¹

Në dokumentet mesjetare Kolonja përmendet përsëpari në shek. XI, pikërisht më 1018 (Κολωνιάς)¹² dhe më 1019 (Κολώνη)¹³ si temë ushtarake bizantine. Në shek. XII përmenden gjithashtu *arhondët kolonjarë* (Κολωνέλαι ἀρχοντές), emërtim ky që lidhet me administratën lokale të kësaj kohe¹⁴. Kolonja është vendi i marrëveshjes së normanëve me bizantinët më 1108¹⁵. Më tej kjo trevë përmendet si krahinë e banuar në dokumente zyrtare e kishtare të shek. XIII¹⁶ e XIV¹⁷. Një pjesë e fshatrave të Kolonjës figurojnë për herë të parë të regjistrin osman të Përmetit, Korçës, e Konicës të vitit 835 h. (1431-1432)¹⁸. Për ndjekjen e dinamikës së zhvillimit të fshatrave dhe të lëvizjes së popullsisë në këtë krahinë, me interes janë regjistrat përmbledhës (mufassal) të administratës osmane të shek.

8) S. Aliu, B. Jubani, *Vendbanimi prehistorik i Kamnikut (Kolonjë)*, «Buletin Arkeologjik», Tiranë 1969, f. 1-13; F. Prendi, S. Aaliu, *Vendbanimi neolitik në fshatin Kamnik të rrethit të Kolonjës (gërmime të vitit 1970)*, «Iliria» I, 1971, f. 13-28.

9) S. Aliu, *Rezultatet e gërmimeve në kodrën e Hollmit (Kolonjë)*, «Materiale të Sesionit Arkeologjik (Tiranë, 2-3 tetor 1967)», Tiranë 1968, f. 30-39; po ai, *Zbulime të reja ilire në rrethin e Kolonjës*, «Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve (Sesion shkencor, Tiranë, 3-4 mars 1969)», Tiranë 1969, f. 85-88; S. Aliu, V. Qiriaqi, *Gërmimet arkeologjike të vitit 1973 në Prodan (Kolonjë)*, «Iliria» III, 1975, f. 421-424.

10) Polyb. Lib. V, 108; Liv. Lib. XXXI, 33, 40, Lib. XLIII, 9; S. Aliu, *Një qytezë e re ilire në Shqipërinë juglindore (rrethi i Kolonjës)*, «Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (Tiranë, 12-18 janar 1968)» II, Tiranë 1969, f. 356.

11) Të dhënat i kemi nga arkeologu S. Aliu.

12) Georgius Cedrenus—Joannis Scylitzae, *Synopsis istorion* II, Bonnae, ed. Weberi 1893, f. 474 (*Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë* II, Tiranë 1962, f. 30; *Burime tregimtare bizantine për Historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*, Tiranë 1975, f. 36).

13) J. Ivanov, *B'lgarski starine iz Makedonija*, Sofija 1931, f. 551 (*Burime të zgjedhura*... II, f. 31).

14) H. Glykatzī—Ahrweiler, *Recherches sur l'administration de l'empire byzantin aux IX^e-XI^e siècles*, «Bulletin de Correspondence Hellénique» LXXXIV-1, 1960, f. 34, 48, 87.

15) Joannis Zonarae, *Epitome historiarum* IV, Lipsiae, ed. Lindorf, 1875, f. 238 (*Burime tregimtare*..., f. 137).

16) Georgii Pachymeris, *Syngrafikai istoriai* I. Bonnae 1835, f. 106-107, (*Burime tregimtare*..., f. 196); *Acta et diplomata Res Albaniae mediane aetatis Illustrantia* I, Vindobonnae, ed. Holzhausen, 1913, f. 44 (*Burime të zgjedhura*... I, f. 85).

17) Joannis Cantacuzeni, *Ex imperatoris historiarum* I, Bonnae, ed. Schopeni, 1828, f. 272 (*Burime tregimtare*..., f. 219).

18) *Defter-i Vilayet-i Gorice ve Premeti ve Konice*, «Basvekalet Arşivi, Maliveden Mudevver» nr. deft. 231 (përkthimi i origjinalit në Arkivin e Institutit të Historisë)

XVI: regjistri i Sanxhakut të Pashës i vitit 976 h. (1568-1569) dhe ai i Sanxhakut të Vlorës i vitit 991 h. (1583)¹⁹. Krahasimi i të dhënave që na japin regjistrat e sipërpërmendur me ato të gjysmës së shek. XIX dhe të fillimit të shekullit tonë²⁰, tregon për luhatje të parregullta, si në drejtim të shtimit, ashtu edhe në atë të pakësimit të popullsisë; këto të fundit janë veçanërisht domethënëse, sepse theksohen në periudha të caktuara historike dhe dëshmojnë për gjendjen e rëndë ekonomiko-shoqërore të banorëve të kësaj krahine gjatë sundimit osman e deri në dhjetëvjeçarët e fillimit të shekullit tonë. Qetësia relative që dokumentohet për dy shekujt e parë të pushtimit turk, ia le vendin më vonë një procesi braktisje e rrënimi të vazhdueshëm të fshatrave. Kështu, mbas tre shekujsh të tjerë robërie, në gjysmën e parë të shek. XIX, jo vetëm nuk ka rritje të ndjeshme të numrit të popullsisë e të fshatrave, por përkundrazi, rreth një e katërta e tyre paraqiten me ulje të numrit të shtëpive, përkatësisht të banorëve. Këtu kanë ndikuar në një masë të rëndësishme konfliktet klasore midis fshatarëve të varfër e feudalëve, të cilat çonin në braktisje masive, siç është rasti i fshatrave Kodras e Gostivisht. Procesi i shpopullimit në Kolonjë arrin kulmin gjatë Luftës së Parë Botërore kur mbi gjysma e fshatrave, veçanërisht ato malore, u zbrazën nga popullsia vendase, për shkak të plaçkitjes e të djegies prej ushtrive të huaja pushtuese e, për pasojë, prej mungesës së burimeve ekonomike. Në kohën e regjimit antipopullor të Zogut shumë fshatra të Kolonjës dalin me numër edhe më të paksuar të shtëpive e të frymëve, ndërsa në disa të tjerë ka rritje relative të banorëve që mbesin në fshat mbas largimit të një pjese të popullatës. Kështu, çdo fshat në Kolonjë ka një histori të gjatë e të hidhur të këtyre shpërnguljeve të detyruara, që ruhet ende e gjallë në kujtesën e popullit.

Këto të dhëna na çojnë në përfundimin se Kolonja, për shkak të kushteve natyrore dhe të rrethanave historike të caktuara, ka njohur shpesh prirjen e dukshme për zbrazje popullate, veçanërisht gjatë këtyre shekujve të fundit. Megjithatë, shpërnguljet e vendasve në asnjë rast nuk janë shoqëruar me ardhje të qëndrueshme popullsish nga zona të tjera të largëta. Edhe blegtorët vllahë, që kanë kaluar nëpër Kolonjë kohë pas kohe, ishin në lëvizje të vazhdueshme; një pjesë fare e vogël e tyre sot janë vendosur në disa lagje fshatrash dhe nuk bëjnë krushqi me të tjerët, ndërkohë që popullsia vendase ka rrethin e vet të lidhjeve martesore, i cili, ndonëse shpeshherë del edhe jashtë zonës përkatëse, nuk i tejkalon zonat fqinje. Nga kjo pikëpamje, Kolonja përbën një njësi shumë të përshtatshme për gjurmimin e tipareve antropologjike lokale.

Nga autorët e mëparshëm, që janë marrë me studimin antropologjik të shqiptarëve, vetëm J. Veningeri ka përfshirë në materialin e tij një

19) *Defter-i liva-i Paşa*, «Tapu ve kadastro müdürlüğünün Arşivi», nr. deft. 52; *Defter-i liva-i Avlonya*, po aty, nr. deft. 62 (leximet e S. Pulahës).

20) P. Aravantinos, *Hronografia tis Ipiru*, shtojca e vëll. I, Athinae 1856, f. 90, 372-374; *Les Sandjaks*, 1901, f. 81-83; J. Bourcart., *Les Confins albanais, administrés par la France (1916-1920)*, Paris 1922, f. 294-301; *Shqipëria më 1923*, Tiranë 1923, f. 85-86, 106-107; *Shqipëria më 1927*, Tiranë 1928, f. 498-568.

subjekt nga kjo krahinë²¹. Kështu që të dhënat tona janë, mund të themi, të parat e kësaj natyre. Materialin e mblodhëm në 13 fshatra të zonave të ndryshme të Kolonjës (tab. 1).

Tabela 1: Fshatrat ku janë kryer kqyrjet

Nr.	Fshati	Këshilli i Bashkuar	♂	♀	Gjithsej
1.	Qytezë	Çlirim	2	3	5 subjekte
2.	Shëmëtir	»	16	7	23 »
3.	Luaras	»	10	7	17 »
4.	Orgockë	»	8	2	10 »
5.	Qafëzez	Qafëzez	15	11	26 »
6.	Shtikë	»	11	4	15 »
7.	Bezhan	minierë	18	5	23 »
8.	Qinam	Selenicë	1	8	9 »
9.	Selenicë	»	12	12	24 »
10.	Gostivisht	Gostivish t	6	3	9 »
11.	Starje	Starje	10	7	17 »
12.	Rehovë	Taç	12	11	23 »
13.	Barmash	Barmash	7	10	17 »
			Gjithsej 128♂	90♀	218 subjekte

Seritë tona prej 128 meshkujsh e 90 femrash kanë vlerë të plotë statistikore dhe shërbejnë si mjet krahasues i sigurtë me seritë e tjera të mbledhura nga territori i vendit. Në zgjedhjen e subjekteve kemi pasur parasysh, ashtu si në rrethinat e tjera, *përbërjen shoqërore të banorëve*. Pjesa më e madhe e tyre merren me bujqësi dhe këto vitet e fundit, me zhvillimin në këtë rreth edhe të industrisë së minierave e të përpunimit të drurit, një pjesë e mirë e banorëve të fshatit punojnë në ndërmarrjet shtetërore. Kqyrjet antropologjike në mjedise të tilla kanë përparësi, sepse brenda një kohe të shkurtër mund të maten shumë subjekte të ardhur nga zona të ndryshme të rrethit. Në seritë tona vendet e para i zënë punëtorët e bujqësisë, duke përfshirë këtu edhe blegtorët (31.3% meshkuj, 66.7% femra) si dhe punëtorët e minierave e të ndërtimit (39.1% meshkuj, 13.3% femra). Në një numër më të madh se në seritë e tjera paraqiten gjithashtu punonjësit e fshatit (29.6% meshkuj, 20% femra).

Mosha e subjekteve luhâtet nga 19-60 vjeç për burrat dhe nga 18-55 vjeç për gratë. Shpërndarja sipas grup-moshave paraqitet si më poshtë (tab. 2).

21) J. Weninger, *Rassenkundliche Untersuchungen an Albanern*, Wien 1934, f. 5.

Tabela 2: Shpërndarja sipas grup-moshave

♂				♀			
19-20	vjeç	2 subjekte	(1.6%)	18-20	vjeç	10 subjekte	(11.1%)
21-30	»	47 »	(36.7%)	21-30	»	36 »	(40.0%)
31-40	»	38 »	(29.7%)	31-40	»	20 »	(22.2%)
41-50	»	22 »	(17.2%)	41-50	»	16 »	(17.8%)
51-60	»	19 »	(14.8%)	51-55	»	8 »	(8.9%)

Siç shihet, vendin kryesor në këtë shpërndarje e zënë grup-moshat mesatare (21-40 vjeç) për të dy sekset, në vend të dytë vjen mosha 41-50 vjeç, ndërsa vendi i tretë në meshkujt i takon grup-moshës së fundit dhe në femrat grup-moshës më të re. Kjo bën që edhe në moshën mesatare të ketë një zhvendosje të lehtë me prirje për moshë më të re të femrat (31 vjeç) në krahasim me meshkujt (37 vjeç).

Një kujdes i veçantë gjatë mbledhjes së materialit i është kushtuar lidhjeve martesore të subjekteve, të cilat kanë ndikimin e tyre në zhvendosjet e tipit antropologjik. Në bazë të ndarjes etnografike të Kolonjës²² do të kishim këtë paraqitje të lidhjeve martesore (tab. 3).

Tabela 3: Lidhjet martesore

I - Martesa brenda krahinës				II - Martesa ndërkrainore			
Babai	Nëna			Babai	Nëna		
Rrëza	Rrëza	26 ♂, 16 ♀		Rrëza	Vithkuqi	1 ♂	
Rrëza	Pllaja	8 » 2 »		Rrëza	Leskoviku	— 2 ♀	
Rrëza	Shëmëtiri	6 » 2 »					
Rrëza	*Dangëllia	1 » —					
Rrëza	Barmashi	2 » —					
Pllaja	Pllaja	17 ♂, 14 ♀		Pllaja	V thkuq	1 ♂	
Pllaja	Rrëza	7 » 4 »					
Pllaja	Shëmëtiri	4 » 4 »					
Pllaja	Radomi	1 » 1 »					
Shëmëtiri	Shëmëtiri	19 ♂, 11 ♀		Shëmëtiri	**Frashëri	1 ♂	
Shëmëtiri	Pllaja	5 » 1 »					
Shëmëtiri	Radomi	2 » 6 »					
Shëmëtiri	Rrëza	10 » 2 »					
*Dangëllia	Dangëllia	4 ♂, 1 ♀					
Dangëllia	Radomi	— 1 »					
Dangëllia	Pllaja	— 1 »					
Dangëllia	Shëmëtiri	— 1 »					

22) Ndarja etnografike e Kolonjës është studiuar kohët e fundit mbi një bazë më të gjerë nga bashkëpunëtori i Institutit të Kulturës Popullore, Bardhyl Prifti, të cilin e falenderojmë për vënien në dispozicionin tonë të hartës së re etnografike të këtij rrethi (fig. 1). Në themel të kësaj ndarjeje qëndrojnë dy zona të dallueshme: Pllaja dhe Dangëllia e Kolonjës. Në gjuhën e popullit Pllaja përbëhet prej dy pjesëve që thirren mbi xhadë (Rrëza e Gramozit) e nën xhadë (Pllaja në kuptimin e ngushtë); këtu përfshihet gjithashtu mikrozona e Barmashit, që paraqet ndonjë veçori lokale. Dangëllia e Kolonjës për qëllime studimore është ndarë në dy mikrozona: Shëmëtiri e Radomi, të cilave mund t'u bashkangjiten disa fshatra të Dangëllisë së Përmetit që sot hyjnë në rrethin e Kolonjës.

I — Martesa brenda krahinës		II — Martesa ndërkrainore	
Babai	Nëna	Babai	Nëna
Radomi	Radomi 3♂, 2 ♀	Radom	Vithkuqi 1 ♂
Radomi	Shëmëtiri —, 1 »	Radom	**Frashëri 1 »
Radomi	*Dangëllia —, 1 »		
Radomi	Barmashi 2, 1 »		
Barmashi	Barmashi 3♂ 8 ♀	Barmashi	Leskoviku 1 ♀
Barmashi	Pllaja 1», 2 »		
Barmashi	Radomi 2», 2 »		
		Vithkuqi	Rrëza 1 ♀
		Vithkuqi	Pllaja 1 »
		Vithkuqi	Shëmëtiri 1 »

* Dangëllia e Kolonjës

** Dangëllia e Përmetit

Në mënyrë të përmbledhur shpërndarja e njerëzve në bazë të lidhjeve martesore paraqitet si vijon (tab. 4).

Tabela 4: Shpërndarja e njerëzve sipas lidhjeve martesore

Nr.	Lidhjet martesore	Meshkuj		Femra		Sëbashku	
		Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
1.	Brenda fshatit 14	51	39.8	36	40.0	87	39.9
2.	Brenda rrethinës	21	16.4	16	17.8	37	17.0
3.	Brenda krahinës	51	39.9	32	35.6	83	38.0
4.	Ndërkrainore	5	3.9	6	6.7	11	5.1

Vendin kryesor në seritë tona e zenë njerëzit nga lidhje martesore brenda fshatit dhe pastaj ata nga lidhje ndërzonale, por brenda krahinës. Së bashku këta përbëjnë 75% të numrit të përgjithshëm të të ekzaminuarve. Në këtë pikë zgjedhja e materialit përkon me të dhënat etnografike mbi lidhjet martesore. Lidhjet ndërkrainore zënë një peshë të pandjeshme, por subjekte të tillë janë përfshirë në studim, sepse ata përbëjnë një realitet fizik në krahinë.

Subjektet u zgjedhën me distancë farefisnore prej 5 brezash e lart, kështu që ata përfaqësojnë shumicën e familjeve në fshatrat përkatës. Gjatë ekspeditës u kujdesëm që të marrim në studim vetëm njerëz të shëndoshë, pa deformime trupore dhe në gjendje normale zhvillimi, pa i zgjedhur paraprakisht nga përmasat e trupit. Matjet u kryen sipas metodikës së njëjtësuar²³. Për çdo njeri u morën të dhëna matëse e pëshkruese të kokës e të trupit si edhe një sërë fotografish.

23) Matjet u kryen në qendrat shëndetësore dhe pjesërisht në vendet e grumbullimit të njerëzve gjatë punës.

Në këtë studim do të përqëndrohemi në shenjat e kokës dhe të shtatit, mbasi edhe në materialet skeletore mesjetare mungojnë kockat e anësive, nëpërmjet të cilave mund të vlerësohim ndërtimin trupor të atyre banorëve mesjetarë të krahinës për t'u krahasuar kështu me banorët e sotëm.

Në programin e matjeve të kokës janë shtuar disa matje e tregues të rinj, në krahasim me studimet e mëparshme; janë bërë gjithashtu disa rregullime në metodën matëse. Kështu, përmasat lartësore të fytyrës në terren janë marrë, ashtu si në rastet e tjera, në rrafshin e mbarimit të vetullave, sepse kjo është mënyra më e sigurt në përfitim të matjeve të këtilla. Në përpunimin e materialit këto përmasa janë korrigjuar njëtrajtshmërisht për t'iu përgjigjur vlerës nga pika klasike e nazionit. Po kështu është vepruar me matjet e gjerësisë së nofullës së poshtme e të ballit, si dhe me treguesit përkatës (pasq. 1). Ndryshime të lehta ka gjithashtu në shkallët e shpërndarjes në kategori të disa shenjave matëse e treguesve (pasq. 2) duke ruajtur përgjithësisht strukturën e mëparshme të shkallëve. Për vlerësimin e shenjave përshkruese janë përdorur skemat tashmë të njohura. Shenjat përshkruese të kokës u përpunuan sipas sistemit të balleve, që lejon një vlerësim sasijor më të saktë të shpërndarjes së kategorive cilësore (pasq. 3).

Po japim një përmbledhje të përgjithëshme mbi këto të dhëna:

Në serinë mashkullore diametrat mesatarë të kubesë flasin për kokë mesatarisht të gjatë, të gjerë, të lartë e me ballë mesatarisht të gjerë. Në skemën e energjisë së zhvillimit përmasat kryesore/të kokës paraqesin një vendosje të shkallëzuar: eu-eu > t-v > ft-ft > g-op. Treguesit mesatarë *hiperbrakicefal*, *hipsicefal*, *metrioccefal* e *metriometop*, pasqyrohen edhe në shpërndarjen sipas kategorive, ku pjesa më e madhe e subjekteve u takon klasave të tilla. Ndër tiparet përshkruese të kokës bien në sy *balli* mesatarisht i lartë e me përkulje të dobët si edhe profili i sheshuar i kockës së zverkut (*planoksipitalia*). *Diametrat e fytyrës* flasin për gjerësi mesatare në të dy katet e kundërta të saj, ndërkohë që lartësia, veçanërisht ajo e pjesës së sipërme të fytyrës, qëndron në vlera të larta. Në skemën e zhvillimit do të kishim një vendosje të tillë: n-st > n-gn > zy-zy > go-go. Në përputhje me këtë zhvillim treguesit kryesorë të fytyrës janë *leptoprosop* e *mezen*, fytyra duket më shpesh mesatarisht e gjerë në pjesën e poshtme dhe e ngushtë, në krahasim me kokën, balli mesatarisht i gjerë në lidhje me fytyrën. Nga tiparet përshkruese bie në sy *mprehtësia e fytyrës*, që shprehet si në daljen anësore, ashtu edhe në daljen ballore të mollëzave, megjithëse janë për t'u shënuar format me zhvillim të theksuar të mollëzave, të cilat në këtë seri ndeshen më shpesh se në disa seri të tjera të studiuara deri tani (6.30%); *konturi* përfaqësues i fytyrës është *trekëndësh*, por ka edhe mjaft forma drejtkëndëshe të spikatura që i japin fytyrës një pamje veriore. *Hunda* më shpesh është mesatarisht e gjatë dhe e ngushtë, *leptorine*, me profil të përgjithshëm *konveks*, veçanërisht në pjesën kockore të saj, ndërkohë që pjesa kërcore duket më e drejtë; në hundët e përkulura konveksiteti është i theksuar në 31% të rasteve, por vetëm në dy subjekte ai merr formën krrut. Tiparet e tjera të hundës në këtë seri janë gjithashtu interesante në pikëpamje të tipologjisë, sepse në tërësi i përkasin të njëjtit variant racor: hunda është mjaft e dalë në profilizimin transversal, me drejtim horizontal të bazës

dhe me rrënjë të lartë, të thellë e të ngushtë, ndërsa dalja e flegrave, ashtu si në seritë e tjera të vendit, është mesatarisht e shprehur dhe maja është rrethore e më pak këndore. Në *tiparet e syve* ka një mospërputhje ndërmjet hapësirës ndërqpallore të brendshme që është e vogël dhe asaj ndërqpallore të jashtme që qëndron në shifra të larta, kështu që çela ka hapje relativisht të gjerë; ky tipar matës përputhet me vlerësimin përshkrues, sipas të cilit pjesa më e madhe e çelave (65.8%) vendosen në kategorinë e hapjes mesatarisht të gjerë. Ndër bashkëformimet lëkurore të syrit, *pala qepallore e sipërme* është e zhvilluar dobët në shumicën e njerëzve, më e shprehur ajo paraqitet në pjesën e jashtme, ndërsa në pjesën e brendshme mungon në 2/3 e rasteve. Një veçori të ndërtimit të syrit në serinë e Kolonjës përbën *zhvillimi i epikantusit*, ndonëse i dobët, në një subjekt, që e çvendos atë vendosmërisht në drejtim të varianteve antropologjike me origjinë nga verilindja. *Drejtimi i çelës*, ashtu si në seritë e tjera, është më shpesh horizontal, ndërsa *forma e saj* mbetet shigjetore. *Buza e sipërme* është e lartë dhe e drejtë (*ortokeile*), kurse *buzët mukoze* paraqesin një shkallëzim në trashësinë e tyre, duke qenë buza e sipërme më e hollë se e poshtmjaja. *Mjekra*, ashtu si në seri të tjera të vendit, është e drejtë në pamjen anësore dhe më shpesh katërkëndëshe e trekëndëshe, ndërsa *harku i nofullës* është mjaft i pjerrët, tipar ky i rëndësishëm tipologjik që haset shpesh në trevat tona. *Veshët* janë më tepër të gjatë (*mezotë e makrotë*) dhe mesatarisht të gjerë, kështu që *treguesi i veshit* jep në shumicën e rasteve vlera të larta që flasin për praninë e veshëve të mëdhenj në këtë seri. Ndër *tiparet përshkruese të veshit* bie në sy prirja për veshë të pjerrët e të çliruar nga muri i kokës, me llapë vezake e bulë rrethore; kjo e fundit, ndryshe nga tërësia e bashkëformimeve lëkurore të veshit, është më shpesh e ngjitur me fytyrën dhe ka madhësi mesatare. *Sythy i Darvinit* është i pranishëm në disa raste të pakta në formën fillestare dhe gungore. *Shtati*, si vlerë mesatare, qëndron në kufrin e sipërm të shtateve mesatare (*mezosomë*) por në shpërndarjen sipas kategorive prurja më e madhe u takon shtateve të lartë (*hipsosomë*), në vend të dytë vijnë shtatet e mirëfilltë mesatarë dhe në vend të tretë shtatet nën mesataren. Përsa i takon *sistemit të flokëzimit*, *flokuri i kokës* është më shpesh i drejtë e i butë, duke përfshirë në këtë kategori flokët me valëzim fillestar, të cilët përbëjnë shumicën dhe janë të lidhur, si formë, me flokët e drejtë. *Vetullat*, si zhvillim e si shtrirje, më shpesh janë në prapun mesatar, ndërsa konturi i vetullave në pjesën më të madhe të rasteve është i përkulur njëtrajtshmërisht.

Në serinë femërore vërehet prirja e përgjithshme për ndjekjen e tipareve qënësore të burrave, gjë që i lidh ngushtë këto seri me njëra-tjetrën dhe vërteton se ato i përkasin të njëjtit grup tipologjik. Megjithatë, te femrat ka edhe disa ndryshime, të cilat, janë të natyrshme dhe i detyrohen në radhë të parë dylojshmërisë gjinore. Në *tiparet e kubesë* përmasat mesatare flasin për kokë të shkurtër, mesatarisht të gjerë e me ballë mesatar, ndërkohë që lartësia qëndron, ashtu si te burrat, në prapun e vlerave të larta. Kjo gjendje e zhvendos skemën e zhvillimit në drejtim të kategorive më të ulta. E kundërta ndodh, siç mund të pritej, me *treguesit*, të të cilët vërehet prirja për vlera më të larta, veçanërisht në treguesin horizontal të kokës, që jep më tepër hiperbrakicefalë e më pak brakicefalë të mirëfilltë, si dhe në treguesin e ballit, që jep më tepër balle të gjerë (*eurio-*

metopë), të cilët janë pothuajse të drejtë (*ortometopë*), ndërsa zverku aty është më i sheshuar, për shkak të shkurtësisë më të madhe të kokës. Vlerat mesatare të *përmasave fytyrore* paraqesin të njejtin profil si te meshkujt, me një prirje të lehtë për nofulla më të gjëra e më të ulta se te të parët, prandaj ka edhe mjaft mezoprosopë e eurienë dhe fytyra, në krahasim me kokën, duket këtu më e vogël (*mikropside*). Këtyre tipareve matëse u bashkohet një *kontur fytyror* më tepër vezak, me mollëza të shprehura e mjekër trekëndëshe që përfundon shpesh me majë. *Përmasat kryesore të hundës* flasin për nivele mesatare, por në shpërndarjen sipas kategorive vërehet prirja për shkurtim e zgjerim, ndërsa *treguesi i hundës* qëndron vendosmërisht në rrafshin e leptorinisë. *Shpina e hundës* te femrat ka më shpesh profil të drejtë, veçanërisht në pjesën kërcore, dalje mesatare, fleg-ra më të hapura dhe rrënjë më të gjërë e më të cekët se sa te burrat. Ndër tiparet e *bashkëformimeve lëkurore të fytyrës* bien në sy *pala qepallore e sipërme* më shpesh e pranishme, lartësia e moderuar e *buzës së sipërme lëkurore* dhe njëkohësisht profili më i drejtë i saj, ndërsa *buzët mukoze* janë më të trasha, gjë që vërtetohet edhe nga shpërndarja në kategori e lartësisë së buzëve, *veshët* janë relativisht të vegjël (*mikrotë* e *mezotë*) dhe të ngushtë, të ngjitur me murin e kokës e më të pjerrët se sa te burrat, *bula* më e madhe e trekëndëshe, shpesh në formë të prerë. *Shtati mesatar*, ashtu si te burrat, qëndron në pragun e lartë të mezosomisë, ndërsa shpërndarja sipas kategorive tregon prirjen për shtate më të ulët. *Flokët* janë më të drejtë te femrat, vetullat me zhvillim më të paktë, ndërsa konturi i tyre është më i përkulur se sa te burrat.

Ngjyra e lëkurës tregon tone të çelëta në të dy sekset, ku pjesa dërrmuese e njerëzve kanë lëkurë të bardhë mat (nr. 7-8) (95.3% te burrat, 93.3% te gratë) dhe vetëm një pjesë fare e vogël kanë ngjyrim më të errët të lëkurës (m. 9-10), por pa kaluar në asnjë rast rrafshin e ngjyrave mesatare. Te gratë vërehet prirja për tone më të çelta të lëkurës. *Ngjyra e flokëve* jep shpërndarjen e mëposhtme (tab. 5).

Tabela 5: *Ngjyra e flokut (shkalla Fisher-Zaler)*

♀	1	2	1	19	2	35	11	4	5	4	1
♂	1	3	2	13	—	25	24	23	3	20	1
Nr.	K	P	R	S	T	U	V	W	X	Y	

Siç shihet, pjesën dërrmuese në të dyja seritë e përbëjnë ngjyrat kafe (82.6% te burrat, 69.4% te gratë) dhe gështenjë (përkatësisht 15.6% e 28.2%). Ngjyrat e çelëta janë shumë të rralla. Në këto seri gjenden edhe 2 subjekte me flokë të kuqërreme (I), të cilat nuk i kemi përfshirë në klasifikimin e përgjithshëm, sepse paraqesin shmangie (çarje) kromozomike. Te femrat vërehet prirja për ngjyrim më të çelët të flokëve, ndryshe nga seritë e tjera, ndërkohë që tonet e errëta në të dyja seritë janë më përfaqësues, siç mund të pritët për këtë trevë jugore të vendit tonë me ndikim mesdhetar të shprehur. Ngjyra e syve jep shpërndarjen e mëposhtme (tab. 6).

Tabela 6: Ngjyra e irisit (shkalla e re Martin)

♀	—	6	9	21	27	2	5	1	—	3	3	13
	1		2	27	38	6	12	2	1	4	8	10
Nr.	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

Numri më i madh i njerëzve përfshihet në dy grupet e para, me një ndryshim të lehtë midis dy serive: te femrat vendi i parë u takon ngjyrave të errëta (nr. 1-4) (40%), ndërsa te meshkujt ngjyrave kalimtare (nr. 5-8) (45.3%), ngjyrat e çelëta vërehen rrallë. Siç shihet, te femrat ekziston prirja për sy më të errët. Të njejtën dukuri e kemi vërejtur edhe në zonat e tjera të vendit.

Kombinimet e ngjyrosjes së të tre përbërësve kryesorë paraqiten si më poshtë (tab. 7):

Tabela 7: Kombinimet e ngjyrosjes

1) ngjyrosje harmonike	{ e errët	42 (35.9%)	34 (40.5%)
	{ e çelët	1 (0.9%)	1 (1.2%)
2) ngjyrosje joharmonike	{ e errët	56 (47.8%)	32 (38.1%)
	{ e çelët	17 (14.5%)	16 (19.0%)
3) kombinime të rastit		1 (0.9%)	1 (1.2%)

Nga paraqitja e mësipërme duket se vendet e para u takojnë ngjyrosjeve të errëta, veçse te femrat ka prirje për ngjyrosje më të njëtrajtshme. Në ngjyrosjet harmonike shumica dërrmuese u takon kombinimeve të lëkurës së bardhë mat (nr. 7-9) me flokët kafe (U-Y) dhe sytë e errët (nr. 1-4), ndërsa në ngjyrosjet joharmonike kombinimeve të lëkurës së bardhë mat me flokët kafe e sytë e zbardhemë (nr. 5-8), në të cilët mbizotërojnë tonet jeshile. Në këto seri ngjyrosjet e çelëta zënë një vend të parëndësishëm, kombinimet e rastit përfaqësohen nga njerëz me lëkurë shumë të çelët (nr. 3), flokë të kuqërremë (I) dhe sy kafe të çelët (nr. 4) ose jeshilë në kafe (nr. 5).

Nga këto të dhëna të përmbledhura vijmë në përfundimin se tiparet antropologjike të banorëve të sotëm të Kolonjës në thelb nuk ndryshojnë nga ato të krahinave të tjera të vendit²⁴, prandaj edhe substrati tipologjik mbetet adriatik. Megjithatë, edhe në këto seri, ashtu si në të tjerat, tiparet e mirëfillta adriatike kombinohen në një masë relativisht të vogël me shenja të elementëve të ndryshëm tipologjikë, si mesdhetar, norik, evropiano-lindor. Në zonat e ndryshme të rrethit përsëritet pothuajse e njëjta tablo, e cila nuk bie ndesh me shfaqjet e karakterit lokal. Të dhënat e morfogramës klasifikuese (fig. 2) flasin për afërsinë e ngushtë antropologjike të këtyre zonave dhe për njëtrajtshmërinë e tipareve fizike themelore, ve-

24) A. Dhima, *Të dhëna antropologjike nga rrethi i Pukës*, «Etnografia Shqiptare» VIII, 1976, f. 239-275; A. Dhima — A. Shahu, *Disa të dhëna antropologjike nga Skrapari*, «Studime Historike» 1977, nr 1, f. 133-152; A. Dhima, *Variacione të tipit fizik në banorët e rrethit të Librazhdit*, «Etnografia Shqiptare» 12, 1981, f. 273-306.




Fig. 2. Morfograma klasifikuese e banorëve të sotëm të Kolonjës

çanërisht ndërmjet Rrëzës, Pllajës e Dangëllisë së Kolonjës. Për sa i përket mikrozonës së Radomit, në shumicën e tipareve ajo tregon ngjashmëri më të madhe me Dangëllinë, me përjashtim të gjerësive fytyrore e hundore, që e veçojnë si një variante tipologjike brenda zonës së madhe të Dangëllisë. E kundërta ndodh me mikrozonën e Barmashit, e cila, në shumicën e tipareve, largohet më tepër nga Pllaja, megjithëse ka lidhje më të ngushta me të. Për këto dy mikrozona të fundit duhet të mbajmë rezerva, për shkak të numrit të vogël të njerëzve të studiuar.

*
* *
*

Në *skeletet mesjetare të tumës së Rehovës* përsëritet pothuajse tërësisht struktura antropologjike e banorëve të sotëm të Kolonjës. Në fillim të shekullit XVIII kjo trevë përfshihej në arealin e mbizotërimit të elementit tipologjik adriatik. Për *skeletet mashkullore* janë karakteristike tipare të tilla, si forma pykore (sfenoide) e kubesë në pamjen nga lart, kafka mesatarisht e gjatë dhe e lartë, hiperbrakikrane e hipsikrane, kocka e zverkut e sheshuar, rrënja e hundës e lartë dhe e thellë, kockat hundore të dala e konvekse ose të drejta, kockat e mollëzave me prirje ballore e mesatarisht të zhvilluara, pjesa fytyrore mesatarisht e lartë e meze, zgavra e hundës leptorine etj., të cilat ndjekin drejtpërsëdrejti shenjat përkatëse të gjallët dhe i detyrohen varianteve adriatike të mirëfillta. Shenja plotësuese në këtë drejtim janë forma katrore e rrethosur e zgavrave të syve, hipsi-mezokonkia, qiellza e gjatë, e gjerë dhe e cekët, nofulla me kënde të topitur e të kthyer nga jashtë, profili i drejtë (ortognat) i fytyrës e kapaciteti i madh (aristencefal) i kafkës. *Skeletet femërore* ndjekin, në vija të përgjithshme, karakteristikën e mësipërme, veçse tek ato ka prirje për shkurtim e lartësim më të madh të kubesë, që rrit vlerat e brakikranisë e hipsikranisë, gjithashtu fytyra zgjerohet e shkurtohet, krejt njësoj siç ndodh te popullsia e sotme femërore e rrethit. Nga kjo pikëpamje, seritë femërore të të dyja periudhave paraqesin përputhje të plotë. Ndërkohë, në *skeletet mashkullore*, krahas tipareve të qarta adriatike, vërehen edhe disa gjurmë të elementit të vjetër mesdhetar që shprehen në prirjen për ngushtim të kubesë deri në rrafshin mesatar, gjë që ul në disa raste vlerat e brakikranisë, në theksimin e tapeinokranisë, zgjerimin e ballit, leptoprosopinë, që i detyrohet më tepër ngushtimit të fytyrës, në uljen e kapacitetit të kafkës deri në rrafshin mesatar. Këto tipare plotësojnë të dhënat e shkëputura që kemi për këtë element nga popullsia e gjallë, si mezocefalia, konturet vezake të fytyrës, ngjyrosja shumë e errët, çelcat e gjera, rrënjët hundore shumë të larta e të cekta dhe buzët lëkurore konkave. Megjithë këto ndërhyrje, struktura antropologjike mbetet edhe këtu me përparësi adriatike, ashtu si në *skeletet e tjera të mesjetës së zhvilluar*, nga Kruja e Elbasani, deri në Ballsh e Kaninë²⁵. Për këtë afërsi dëshmon morfograma klasifikuese përkatëse (fig. 3).

25) A. Dhima, *Vëzhgime antropologjike mbi formimin e popullit shqiptar*, «Iliria» 1983, nr. 1, f. 259.




Fig. 3. Morfograma klasifikuese e serive skeletike të mesjetës së zhvilluar

Në skeletet e mesjetës së hershme nga Shtika ka të dhëna të mjaftueshme që flasin për praninë e sigurt të elementit adriatik, si format pykore të kubesë në pamjen nga lart, gjatësia mesatare e kafkës, gjerësia e lartësia e theksuar e saj, të cilave u detyrohet brakikrania e hipsikrania, rumbullakosja e kubesë, sheshimi i kockës së zverkut, balli i lartë metrio-stenometop, dalëzat thimthake massive, rrënja e hundës më tepër e lartë, me kocka hundore të dala e konvekse ose të drejta, profili fytyror i drejtë e kapaciteti i kafkës i madh. Këto tipare janë veçanërisht të dukshme në skeletet mashkullore, të cilët afrohen kështu me ato të gjetura në zonat e ndryshme të vendit, nga Shurdhahu e Bukli në veri, deri në Biranj në juglindje që u përkasin shekujve të mesjetës së hershme²⁶. Kjo afërsi tipologjike pasqyrohet edhe në rezultatet e morfogramës klasifikuese (fig. 4). Më pak e rëndësishme duket përbërësja mesdhetare në format vezake të kubesë në pamjen nga lart, mezokraninë, mezokonkinë, mezeninë, të cilat e lidhin këtë seri me materialet skeletore të mesjetës së hershme të tumës së Piskovës nga rrethi fqinj i Përmetit²⁷. Rrallë vërehet edhe ndonjë tipar verior, si fytyra e lartë dhe e ngushtë, leptoprosope, hunda e lartë dhe e ngushtë, nofulla brakignate me kënde të kthyer nga jashtë etj, që plotësojnë tipare të kësaj natyre në popullsinë e shtime të Kolonjës, si konturi këndor i fytyrës dhe ngjyrat e çelëta të syve e të flokëve. Në skeletet femërore bie në sy prirja e përgjithshme për ndjekjen e veçorive fizike të kafkave mashkullore, veçse në ndonjë rast të veçantë aty dalin në pah disa tipare të huaja për situatën antropologjike vendase, si fy-

26) A. Dhima, *Vëzhgime antropologjike...*, f. 254.

27) A. Dhima, *Materiale skeletike mesjetare nga tuma e Piskovës (Përmet)*, «Iliria» 1981, nr. 1, f. 159-160




Fig. 4. Morfograma klasifikuese e serive skeletike të mesjetës së herëshme.

tyra mjaft e gjërë euriene, me mollëza të zhvilluara e me prirje anësore, rrënja e hundës e ulët dhe e cekët, gjerësia e theksuar simotike etj., të cilat flasin për një ndërhyrje të lehtë me origjinë nga verilindja²⁸. Është me interes të vërejmë këtu se ndonjë tipar i tillë i veçuar ruhet ende në popullsinë e sotme të Kolonjës, si zhvillimi i theksuar i mollëzave, orientimi i pjerrët i çelës me fillimet e epikantusit, ngjyrat ndërmjetëse të syve me tone gri.

Dhamë kështu një pasqyrë të përgjithshme të ecurisë së tipareve antropologjike në trevën e Kolonjës nga mesjeta e hershme deri në ditët tona. Afërsia tipologjike në një hark të tillë të gjatë kohor këtu është e drejtpërdrejtë dhe mjaft tërheqëse. Ai që i bashkon këto seri kohësisht të ndryshme është elementi adriatik, i cili ka ardhur duke u rritur në shekuj; ky element përbën faktorin themelor në ngjizjen antropologjike të banorëve të Kolonjës. Elementet e tjera, ndonëse anësore, kanë rolin e tyre në këtë proces, mbasi gjenden të ngulitura, në këtë apo atë masë, deri në ditët tona.

Këto fakte antropologjike dëshmojnë për rrënjët e lashta dhe vazhdimësinë e pandërprerë të popullsisë së kësaj treve jugore të vendit.

28) A. Dhima, *Continuité des traits anthropologiques chez les Albanais* «Studia Albanica», 1984, nr. 1, f. 206.

Pasqyra 1: Përmasat dhe treguesit e kokës te banorët e sotëm të Kolonjës

I -- Përmasat e kokës (mm)	N(♂)	Luhatja	M ±m(M)	σ	v	N(♀)	Luhatja	M ±m(M)	σ	v
1. Gjatësia më e madhe e kokës (g-op)	128	201—168	181.47 ±.38	5.80	3.20	90	184—162	173.90 ±.37	5.16	2.96
3. Gjerësia më e madhe e kokës (eu-eu)	128	173—146	159.88 ±.34	5.23	3.53	90	164—144	154.01 ±.32	4.45	2.89
4. Gjerësia më e vogël e ballit (ft-ft)	128	117—107	106.81 ±.27	4.18	3.77	90	112—95	104.10 ±.27	3.81	3.53
6. Gjerësia e fytyrës (zy-zy)	128	156—131	141.58 ±.29	4.49	3.17	90	144—124	133.88 ±.30	4.23	3.16
8. Gjerësia e nofullës së poshtme (go-go)	128	122—93	107.80 ±.35	5.41	4.80	90	112—89	100.69 ±.40	5.63	5.33
9. Gjerësia dyqepallore e brendëshme (en-en)	128	37—28	31.96 ±.15	2.31	7.70	90	37—26	31.51 ±.18	2.59	8.79
10. Gjerësia dyqepallore e jashtme (ex-ex)	128	99—81	90.49 ±.24	3.71	4.61	90	101—81	89.48 ±.30	4.18	4.57
11. Gjerësia e çelës së syrit (ex-en)	128	36—28	31.30 ±.10	1.65	5.27	90	35—28	30.89 ±.11	1.61	5.21
13. Gjerësia e hundës (al-al)	128	38—28	33.06 ±.15	2.32	7.03	90	36—26	31.03 ±.17	2.39	7.71
14. Gjerësia e gojës (ch-ch)	128	63—44	53.31 ±.24	3.71	6.70	90	58—42	49.87 ±.26	3.69	7.12
15. Lartësia e kokës (t-v)	128	151—118	127.85 ±.47	7.21	5.64	90	141—109	127.58 ±.59	8.25	6.78
17. Lartësia fiziognomike e fytyrës (tr-gn)	121	204—162	182.60 ±.54	8.76	4.80	90	187—154	171.01 ±.50	7.05	4.12
18. Lartësia morfologjike e fytyrës (n-gn)	128	148—113	125.36 ±.42	6.40	5.11	90	126—103	115.20 ±.40	5.65	4.90
19. Lartësia e pj. sip. të fytyrës (n-sto)	128	82—65	73.26 ±.26	4.07	5.26	90	79—59	67.63 ±.29	4.13	5.77
21. Lartësia e hundës (n-sn)	128	68—49	56.27 ±.25	3.88	6.89	90	62—44	51.89 ±.25	3.55	6.83
24. Lartësia e ballit (tr-n)	121	75—45	57.46 ±.40	6.57	11.43	90	79—46	59.87 ±.40	5.61	10.04
25. Lartësia e buzëve (is-li)	128	25—12	16.69 ±.17	2.56	16.92	90	22—12	16.61 ±.16	2.25	19.35
26. Lartësia e nofullës së sipërme (sn-sto)	128	26—14	19.24 ±.17	2.85	13.48	90	30—12	17.86 ±.20	2.84	14.28
28. Lartësia pj. së poshtme të fytyrës (sto-gn)	128	63—40	47.99 ±.25	4.21	8.78	90	53—34	43.57 ±.30	4.16	9.55
29. Gjatësia fiziognomike e veshit (sa-sba)	128	74—56	64.62 ±.27	4.16	6.44	90	68—53	59.47 ±.26	3.56	5.99
30. Gjerësia fiziognomike e veshit (pra-pa)	128	45—29	35.25 ±.18	2.70	7.65	90	39—27	31.39 ±.19	2.61	8.32

	N(♂)	Luhatja	M ± m(M)	σ	v	N (♀)	Luhatja	M ± m(M)	σ	v
II - <i>Treguesit e kokës</i>										
Treguesi horizontal i kokës	(3:1) 128	98.21 - 78.19	88.30 ± 2.1	3.50	3.96	90	97.58 - 81.77	88.66 ± 2.3	3.24	3.65
» ballo-muror	(4:3) 128	74.58 - 60.73	67.39 ± 1.6	2.65	3.82	90	75.03 - 62.33	68.22 ± 1.9	2.64	3.75
» mollëzo-ballor	(4:6) 128	82.78 - 68.55	76.23 ± 1.6	2.71	3.47	90	84.61 - 71.94	78.82 ± 1.8	2.52	3.11
» nofullo-ballor	(4:8) 128	99.50 - 83.57	95.35 ± 1.8	3.02	3.15	90	99.50 - 86.61	95.35 ± 2.1	1.98	3.07
» gjatësor fytyrë-kokë	(6:1) 128	94.40 - 75.27	83.92 ± 2.2	3.67	4.40	90	94.58 - 74.23	85.68 ± 2.3	3.19	3.72
» transversal »	(6:3) 128	94.44 - 81.10	88.74 ± 1.5	2.47	2.79	90	93.88 - 81.10	86.97 ± 2.2	3.05	3.50
» nofullo-muror	(8:3) 128	76.02 - 59.23	68.05 ± 2.1	3.55	5.04	90	75.20 - 57.62	66.29 ± 2.7	3.73	5.43
» mollëzo-nofullor	(8:6) 128	85.42 - 68.57	77.00 ± 2.0	3.35	4.22	90	86.14 - 69.14	76.99 ± 2.3	3.26	4.13
» dyqepallor i brendshëm										
» mollëzo-çelor »	(9:3) 128	23.58 - 16.95	20.21 ± 3.4	5.69	9.62	90	23.88 - 14.80	20.09 ± 1.3	1.84	9.61
» i çelës së syrit	(9:6) 128	26.36 - 19.18	22.12 ± 0.9	1.51	7.16	90	26.93 - 18.52	23.04 ± 1.3	1.82	8.26
» dyqepallor i jashtëm	(10:3) 128	41.63 - 31.55	36.31 ± 1.3	2.10	6.51	90	42.46 - 31.17	36.25 ± 1.7	2.36	7.32
» mollëzo-çelor »	(10:6) 128	63.05 - 51.47	56.95 ± 1.4	2.36	4.07	90	65.01 - 51.50	58.44 ± 2.1	2.99	5.03
» i hundës	(13:6) 128	70.64 - 56.24	64.43 ± 1.5	2.49	3.81	90	73.10 - 59.56	67.36 ± 2.0	2.88	4.21
» i gjerësisë së gojës	(13:21) 128	27.41 - 19.44	23.28 ± 1.0	1.62	6.95	90	26.92 - 19.11	23.14 ± 1.2	1.67	7.23
» i lartësi-gjatësi i kokës	(14:3) 128	76.00 - 47.46	59.14 ± 3.7	6.13	10.37	90	76.92 - 51.37	60.14 ± 4.1	5.74	9.54
» lartësi-gjatësi i kokës	(15:1) 128	39.14 - 21.93	32.42 ± 1.4	2.39	6.93	90	36.56 - 26.20	31.68 ± 1.8	2.48	7.37
» lartësi-gjatësi »	(15:3) 128	83.72 - 62.24	70.71 ± 2.6	4.29	6.07	90	83.23 - 62.22	69.94 ± 3.3	4.65	6.65
» morfologjik i fytyrës	(15:3) 128	93.79 - 61.60	79.99 ± 2.9	4.95	6.19	90	90.38 - 69.43	78.91 ± 3.5	4.92	6.24
» kulmor fytyrë-kokë	(18:6) 128	97.86 - 76.87	88.46 ± 2.5	4.24	4.80	90	94.70 - 76.22	86.04 ± 3.0	4.28	4.97
» i pj.sip. të fytyrës	(18:15) 128	100.00 - 83.92	95.21 ± 2.3	3.83	4.02	90	100.00 - 77.61	93.07 ± 3.5	4.95	5.32
» i lartësisë së ballit	(19: 6) 128	60.50 - 45.02	52.56 ± 1.8	3.09	5.66	90	59.65 - 43.22	51.39 ± 2.5	3.51	6.57
» i lartësisë së ballit	(19:21) 128	84.61 - 65.41	74.72 ± 2.2	3.68	5.07	90	81.69 - 62.87	74.12 ± 2.6	3.73	5.17
» i buzëve	(24:17) 121	38.07 - 25.16	32.47 ± 1.6	2.64	8.39	90	43.44 - 28.75	34.60 ± 1.9	2.71	8.31
» kulmor fytyrë-nofull e sip.	(25:14) 128	48.00 - 22.73	31.55 ± 3.0	4.99	13.17	90	46.96 - 24.00	32.53 ± 3.5	4.86	11.59
» kulmor fytyrë-nofull e	(26:18) 128	21.22 - 9.57	15.85 ± 1.3	2.15	12.74	90	26.12 - 11.21	16.14 ± 1.6	2.30	13.41
» posht.	(28:18) 128	43.80 - 31.75	38.21 ± 1.4	2.33	6.09	90	42.74 - 30.51	37.77 ± 1.9	2.69	7.13
» fiziognomik i veshit	(30:29) 128	64.93 - 47.89	54.62 ± 2.3	3.79	6.93	90	64.81 - 45.31	52.91 ± 3.3	4.70	8.87
» Moduli i veshit	(29 + 30/2) 128	57.50 - 44.50	49.98 ± 1.7	2.91	5.82	90	51.00 - 40.00	45.40 ± 1.8	2.47	5.44

Meshkuj		Femra			
Kategoritë e tipareve	Nr.	%	Kategoritë e tipareve	Nr	%
5) zy-zy (shkalla Martin-Saller)* fyturë e ngushtë » mesat. e gjerë » e gjerë » shumë e gjerë	11 73 42 2	8.6 57.0 32.8 1.6	5) zy-zy (shkalla Martin Saller)* fyturë e ngushtë » mesat. e gjerë » shumë e gjerë	8 54 25 3	8.9 60.0 27.8 3.3
6) go-go (shkalla Weninger)** nofull shumë e ngushtë » e ngushtë » mesat. e gjerë » e gjerë » shumë e gjerë	7 22 61 30 8	5.5 17.2 47.7 23.4 6.2	6) go-go (shkalla Weninger)** nofull shumë e ngushtë » e ngushtë » mesat. e gjerë » e gjerë » shumë e gjerë	6 19 30 30 5	6.7 21.1 33.3 33.3 5.6
7) n-gn (shkalla Lebzeiter-Saller) fyturë e ulët » mesat. e lartë » e lartë » shumë e lartë	13 35 50 30	10.2 27.3 39.1 23.4	7) n-gn (shkalla Lebzeiter-Saller) fyturë e ulët » mesat. e lartë » e lartë » shumë e lartë	10 25 29 26	11.1 27.8 32.2 28.9
8) n-sto (shkalla Weninger) masiv fyturor i ulët » mesat. i lartë » i lartë » shumë i lartë	— 31 67 30	— 24.2 52.3 23.5	8) n-sto (shkalla Weninger) masiv fyturor i ulët » mesat. i lartë » i lartë » shumë i lartë	1 28 46 15	1.1 31.1 51.1 16.7
9) sto-gn (shkalla Schlaginhausen) masiv nofullor i ulët » mesat. i lartë » i lartë » shumë i lartë	— 86 39 3	— 67.2 30.5 2.3	9) sto-gn (shkalla Schlaginhausen) masiv nofullor i ulët » mesat. i lartë » i lartë » shumë i lartë	17 68 5 —	18.9 75.6 5.5 —
10) n-sn (shkalla Eickstedt) hundë e shkurtër	2	1.6	10) n-sn (shkalla Eickstedt) hundë e shkurtër	4	4.4

*) shkalla është ndryshuar lehtësisht në rrafshin e parë, për të qenë përpjestimi i njejtë.
**) e njehta shkallë, e ngritur një kategori më lart, mbasi duket më e përshtatshme për trevat tona.

Femra

Meshkuj

Meshkuj		Femra			
Kategorië e tipareve	Nr.	%	Kategorië e tipareve	Nr.	%
hundë mesat. e gjatë	50-52	15.6	hundë mesat. e gjatë	46-48	10.0
» e gjatë	53-55	27.3	» e gjatë	49-51	30.0
» shumë e gjatë	56-x	55.5	» shumë e gjatë	52-x	55.6
11) al-al (shkalla Eickstedt)			11) al-al (shkalla Eickstedt)		
hundë e ngushtë	28-30	13.3	hundë e ngushtë	25-27	4.4
» mesat. e gjerë	31-33	43.8	» mesat. e gjerë	28-30	43.3
» e gjerë	34-36	37.5	» e gjerë	31-33	36.7
» shumë e gjerë	37-x	5.4	» shumë e gjerë	34-x	15.6
12) en-en			12) en-en		
gjerësi shumë e vogël	x-27	-	gjerësi shumë e vogël	x-27	4.4
» e vogël	28-33	74.2	» e vogël	28-33	73.3
» mesatare	34-39	25.8	» mesatare	34-39	22.2
13) ex-e			13) ex-ex		
gjerësi mesatare	80-89	32.0	gjerësi mesatare	80-89	52.2
» e madhe	90-99	68.0	» e madhe	90-99	46.7
» shumë e madhe	100-x	-	» shumë e madhe	100-x	1.1
14) sa-sba (shkalla Weninger)*			14) sa-sba (shkalla Weninger)*		
veshë hipermikrotë	x-54	-	veshë hipermikrotë	x-54	5.6
» mikrotë	55-59	8.6	» mikrotë	55-59	48.9
» mezotë	60-64	43.8	» mezotë	60-64	34.4
» makrotë	65-x	47.6	» makrotë	65-x	11.1
16) pra-pa (shkalla Weninger)			16) pra-pa (shkalla Weninger)		
veshë të ngushtë	x-29	0.8	veshë të ngushtë	x-29	31.1
» mesat. të gjerë	30-36	71.9	» mesat. të gjerë	30-36	65.6
» të gjerë	37-x	27.3	» të gjerë	37-x	3.3

*) J. Weninger, *Rassenkundliche Untersuchungen an Albanern*, Wien 1934, f. 38. Në një studim të mëparshëm, këtë shkallë e kemi përdorur për treguesin fiziognomik të veshit (A. Dhima, *Variacione të tipit fizik në banorët e rrethit të Librazhdit*, «Etnografia Shqiptare» 12, 1981, f. 296).

Femra

Meshkuj

Meshkuj		Femra			
Kategoritë e tipareve	Nr.	%	Kategoritë e tipareve	Nr.	%
17) eu-eu/g-op (shkalla Martin-Saller) kokë mezocefale	2	1.6	17) eu-eu/g-op (shkalla Martin-Saller) kokë mezocefale	1	1.1
» brakicefale	30	23.4	» brakicefale	17	18.9
» hiperbrakicefale	72	56.3	» hiperbrakicefale	55	61.1
» ultrabrakicefale	24	18.7	» ultrabrakicefale	17	18.9
18) t-v/g-op (shkalla Martin-Saller)* kokë ortocefale	1	0.8	18) t-v/g-op (shkalla Martin-Saller)* kokë ortocefale	3	3.3
» hipsicefale	37	28.9	» hipsicefale	30	33.3
{ fillestare	55	43.0	{ fillestare	34	37.8
{ mesatare	35	27.3	{ mesatare	23	25.6
{ e theksuar			{ e theksuar		
19) t-v/eu-eu (shkalla Martin) kokë tapeinocefale	49	38.3	19) t-v/eu-eu (shkalla Martin) kokë tapeinocefale	20	22.2
» metriocefale	58	45.3	» metriocefale	57	63.3
» akrocefale	21	16.4	» akrocefale	13	14.5
20) ft-ft/eu-eu (shkalla Martin-Saller) ballë hiperstenometop	8	6.3	20) ft-ft/eu-eu (shkalla Martin-Saller) ballë hiperstenometop	3	3.3
» stenometop	29	22.7	» stenometop	12	13.3
» metriometop	59	46.1	» metriometop	45	50.0
» eurimetop	26	20.3	» eurimetop	25	27.8
» hipereurimetop	6	4.6	» hipereurimetop	5	5.6
21) ft-ft/zy-zy (shkalla Lebzelter-Saller) ballë shumë i ngushtë (ndaj fytyrës)	2	1.6	21) ft-ft/zy-zy (shkalla Lebzelter-Saller) ballë shumë i ngushtë (ndaj fytyrës)	1	1.1
» i ngushtë	37	28.9	» i ngushtë	18	20.0
» mesat. i gjerë	76	59.4	» mesat. i gjerë	61	67.8
» i gjerë	13	10.1	» i gjerë	10	11.1

*) Shkalla e nëndarë në rrafshin e hipsicefalisë duket më e përshtatshme për trevat tona, ku mbizotëron ky tipar.

Meshkuj		Femra	
Kategoritë e tipareve		Kategoritë e tipareve	
Nr.	%	Nr.	%
22) go-go/zy-zy (shkalla Lundborg-Linders)			
fytirë shumë e ngushtë në p.j. e posht.			
2	1.6	x-67.9	-
» e ngushtë » » »	33	70.0-74.9	14 15.6
» mesat. e gjerë » » »	66	75.0-79.9	49 54.4
» e gjerë » » »	26	80.0-84.9	25 27.8
» shumë e gjerë » » »	1	85.0-x	2 2.2
23) zy-zy/eu-eu (shkalla Olivier)			
fytirë mikropside			
» mezopside	86	x-89.9	74 82.2
» makropside	38	90.0-92.9	14 15.6
	4	93.0-x	2 2.2
24) n-gn/zy-zy (shkalla Martin-Saller)			
fytirë hipereuropose			
» euriprose	2	x-76.9	2 2.2
» mezoprose	17	77.0-80.9	10 11.1
» leptoprose	44	81.0-84.9	25 27.8
» hiperleptoprose	41	85.0-89.9	37 41.1
	24	90.0-x	16 17.8
25) n-st/zy-zy (shkalla Martin)			
fytirë hipereuriene			
» eurine	5	x-46.9	9 10.0
» mezene	47	47.0-51.9	41 45.6
» leptene	67	52.0-56.9	36 40.0
	9	57.0-61.9	4 4.4
26) al-al/n-sn (shkalla Eickstedt)			
hundë hiperleptorine			
» leptorine	37	x-54.9	20 20.0
» mezorine	87	55.0-69.9	65 72.2
	4	70.0-84.9	7 7.8
27) v-pl (shkalla Martin)			
shtat kamesom			
» nënmezom	9	150.0-159.9	8 8.9
» mezom	18	160.0-163.9	14 15.5
» mbimezom	17	164.0-166.9	18 20.0
» hipsom	25	167.0-169.9	24 26.7
» hiperhipsom	49	170.0-179.9	24 26.7
	10	180.0-199.9	2 2.2

Pasqyra 3: Tiparet përshkruese të kokës

I — Sistemi i ngjyrosjes		2. Ngjyra e lëkurës		II — Sistemi i flokëzimit		III — Fytyra	
1. Ngjyra e flokëve				4. Tipi i flokut të kokës		a — dalja anësore	
Nr.	♂ (%)	Nr.	♀ (%)	Nr.	♂ (%)	Nr.	♀ (%)
1 — kafe	95 (82.6)	59 (69.4)	1 — e çelët	122 (95.3)	84 (93.3)	1 — e pakët	11 (21.6)
2 — gështenjë	18 (15.6)	24 (28.2)	2 — mesatare	6 (4.7)	6 (6.7)	2 — mesatare	38 (74.5)
3 — bjonde	1 (0.9)	1 (1.2)	BM	6 (1.05)	1.07	3 — e madhe	2 (3.9)
balli mesatar (BM)	1.17	1.29				BM	
4 — të kuqërremë	0.9	1.2					
3. Ngjyra e syve							
1 — e errët	47 (36.7)	36 (40.0)	1 — i drejtë	90 (70.3)	69 (76.7)	1 — shumë i dobët	22 (43.1)
2 — ndërmjetëse	58 (45.3)	35 (38.9)	1 — i valëzuar	30 (23.4)	18 (20.0)	2 — i dobët	20 (39.2)
3 — e çelët	23 (18.0)	19 (21.1)	3 — i përdredhur	8 (6.3)	3 (3.3)	3 — mesatar	9 (17.7)
BM	1.81	1.81	4 — kaçurrela	—	—	4 — i fortë	5 (9.8)
			BM	1.36	1.27	5 — shumë i fortë	—
						BM	
5. Qimëzimi i fytyrës							
1 — shumë i dobët	1 (1.1)			19 (24.1)	22 (43.1)	1 — e pakët	11 (21.6)
2 — i dobët	27 (28.7)			33 (41.8)	20 (39.2)	2 — mesatare	38 (74.5)
3 — mesatar	61 (64.9)			27 (34.1)	9 (17.7)	3 — e madhe	2 (3.9)
4 — i fortë	5 (5.3)			2.10	1.75	BM	
5 — shumë i fortë	2.74						
BM							
7. Shtrirja e vetullave							
1 — e pakët	21 (26.6)	17 (33.3)	1 — i drejtë	21 (26.6)	11 (21.6)	1 — e pakët	11 (21.6)
2 — mesatare	48 (60.8)	32 (62.8)	2 — i përkulur	49 (62.0)	38 (74.5)	2 — mesatare	38 (74.5)
3 — e madhe	10 (12.6)	2 (3.9)	3 — këndor	9 (11.4)	2 (3.9)	3 — e madhe	2 (3.9)
BM	1.86	1.71				BM	
9. Dalja e mollëzave							
1 — e fshirë	74 (93.7)	46 (90.2)	1 — e fshirë	45 (57.0)	22 (43.1)	1 — e fshirë	22 (43.1)
2 — mesatare	5 (6.3)	5 (9.8)	2 — mesatare	29 (36.7)	24 (47.1)	2 — mesatare	24 (47.1)
3 — e fortë	—	—	3 — e fortë	5 (6.3)	5 (9.8)	3 — e fortë	5 (9.8)
BM	1.06	1.10	BM	1.49	1.67	BM	

	♂ (%)	♀ (%)		♂ (%)	♀ (%)
10. Konturi i përgjithshëm			IV - Hunda		
1 - trekëndësh	49 (62.0)	22 (43.1)	11. Profilit sipinës së hundës		
2 - konik	3 (3.8)	3 (5.9)	a - pjesa kockore		
3 - katror	5 (6.3)	4 (7.8)	1 - konkav	1 (1.3)	6 (11.8)
4 - rrethor	2 (2.5)	8 (15.7)	2 - i drejtë	31 (39.2)	25 (49.0)
5 - drejtkëndësh	13 (16.5)	3 (5.9)	3 - konveks	47 (59.5)	20 (39.2)
6 - vezak	7 (8.9)	11 (21.6)	BM	2.58	2.27
b⁷ - pjesa kërcore			c - profilit i përgjithshëm		
1 - konkav	6 (7.6)	8 (15.7)	1 - konkav	3 (2.4)	8 (9.2)
2 - i drejtë	53 (67.1)	37 (72.5)	2 - i drejtë	47 (37.6)	38 (43.7)
3 - konveks	20 (25.3)	6 (11.8)	3 - konveks	71 (56.8)	32 (36.8)
BM	2.18	1.96	4 - i përbërë	4 (3.2)	9 (10.3)
12. Dalja e hundës			13. Drejtimi i bazës		
1 - e dobët	3 (3.8)	7 (13.7)	1 - ngjitur	19 (15.2)	14 (17.5)
2 - mesatare	21 (26.6)	25 (49.0)	2 - horizontal	62 (49.6)	59 (73.8)
3 - e fortë	55 (69.6)	19 (37.3)	3 - zbritës	44 (35.2)	7 (8.7)
BM	2.66	2.24	BM	2.22	1.91
14. Lartësia e rrënjës			15. Thellësia e rrënjës		
1 - e ulët	4 (5.1)	4 (7.8)	1 - e cekët	8 (10.4)	16 (31.4)
2 - mesatare	17 (21.8)	12 (23.5)	2 - mesatare	27 (35.1)	23 (45.1)
3 - e lartë	57 (73.1)	35 (68.6)	3 - e thellë	42 (54.5)	12 (23.5)
BM	2.68	2.61	BM	2.44	1.92
16. Gjerësia e rrënjës			17) Konturi i ndarësës		
1 - e ngushtë	58 (74.4)	25 (49.0)	1 - i drejtë	56 (70.9)	37 (72.5)
2 - mesatare	16 (20.5)	23 (45.1)	2 - i përkulur	16 (20.2)	11 (21.6)
3 - e gjerë	4 (5.1)	3 (5.9)	3 - i përdredhur	7 (8.9)	3 (5.9)
BM	1.31	1.57			
18. Forma e majës			19. Hapja e flegrave		
1 - e sheshtë	5 (6.3)	4 (7.8)	1 - e pakët	25 (31.7)	9 (17.6)
2 - rrethore	39 (49.4)	26 (51.0)	2 - mesatare	49 (62.0)	39 (76.5)
3 - këndore	25 (31.6)	10 (19.6)	3 - e theksuar	5 (6.3)	3 (5.9)
4 - e pikëzuar	10 (12.7)	11 (21.6)	BM	1.75	1.88

V - Shtë		♂ (%)		♀ (%)		b - pjesa e mesme (m)		♂ (%)		♀ (%)	
Nr.	(%)	Nr.	(%)	Nr.	(%)	Nr.	(%)	Nr.	(%)	Nr.	(%)
20. <i>Paia qepallore e sipërme</i>											
a - pjesa e brendshme (p)											
0 - mungon	55	(70.5)	21	(41.2)	0 - mungon	0		19	(24.4)	6	(11.8)
1 - e dobët	18	(23.1)	21	(41.2)	1 - e dobët	1		11	(14.1)	13	(25.5)
2 - mesatare	5	(6.4)	9	(17.6)	2 - mesatare	2		12	(15.4)	14	(27.5)
BM	0.36		1.76		3 - e fortë	3		0.99		1.45	
c - pjesa e jashtme (d)											
0 - mungon	37	(47.5)	15	(29.4)	0 - mungon	0		78	(98.7)	79	(100.0)
1 - e dobët	15	(19.2)	11	(21.6)	1 - e dobët	1		1	(1.3)	—	
2 - mesatare	9	(11.5)	8	(15.7)	BM	BM		0.01		0.00	
3 - e fortë	17	(21.8)	17	(33.3)							
BM	1.08		1.53		21. <i>Paia mongolike (epikantus)</i>						
22. <i>Hapia e çelës</i>											
1 - e vogël	18	(22.8)	10	(19.6)	1 - mungon	1		20	(25.3)	11	(21.6)
2 - mesatare	52	(65.8)	31	(60.8)	2 - horizontal	2		46	(58.2)	28	(54.9)
3 - e madhe	9	(11.4)	10	(19.6)	3 - këndi i jashtëm lart	3		13	(16.5)	12	(23.5)
BM	1.89		2.00		BM	BM		1.91		2.02	
24. <i>Forma e çelës</i>											
1 - shigjetore	68	(86.1)	44	(86.3)	VI - <i>Goja</i>						
2 - rrethore	9	(11.4)	5	(9.8)	25. <i>Lartësia e buzës së sip. lëkurore</i>						
3 - si bajame	2	(2.5)	2	(3.9)	1 - e vogël	1		5	(6.3)	7	(13.7)
					2 - mesatare	2		31	(39.2)	26	(51.0)
					3 - e madhe	3		43	(54.4)	18	(35.3)
					BM	BM		2.48		2.22	
26. <i>Profili i buzës së sip. lëkurore</i>											
1 - e dalë (prokeile)	8	(10.1)	7	(13.7)	27. « <i>Trashësia</i> » e buzëve mukoze						
2 - e drejtë (ortokeile)	43	(54.4)	32	(62.8)	a - buza e sipërme						
3 - e futur (opistokeile)	28	(35.4)	12	(23.5)	1 - e hollë	1		44	(56.4)	24	(47.0)
BM	2.25		2.10		2 - mesatare	2		30	(38.5)	26	(51.0)
					3 - e trashë	3		4	(5.1)	1	(2.0)
					BM	BM		1.49		1.55	

	Nr. (%)	Nr. (%)	Nr. (%)	Nr. (%)	Nr. (%)
b — buza e poshtme					
1 — e hollë	30 (38.5)	21 (41.2)	VII — Nofulla	12 (15.2)	9 (17.6)
2 — mesatare	41 (52.6)	23 (45.1)	28. <i>Dalja e mjekrës</i>	56 (70.9)	33 (64.7)
3 — e trashë	6 (7.7)	6 (11.8)	1 — e futur	11 (13.9)	9 (17.6)
4 — «e përveshur»	1 (1.2)	1 (1.9)	2 — e drejtë	1.99	2.00
BM	1.72	1.74	3 — e dalë		
			BM		
29. Forma e mjekrës			30. <i>Pjerrësia e harkut të nofullës</i>		
1 — trekëndëshe	24 (30.4)	26 (51.0)	1 — e dobët	9 (11.4)	13 (25.5)
2 — vezake	16 (20.3)	20 (39.2)	2 — mesatare	25 (31.6)	17 (33.3)
3 — katërkëndëshe	39 (49.3)	5 (9.8)	3 — e fortë	45 (57.0)	21 (41.2)
			BM	2.46	2.16
VIII. — Veshi					
31. Forma e vrigullthit			32. <i>Tipi i veshit</i>		
1 — trekëndësh	26 (33.8)	18 (37.5)	1 — i lirë	47 (59.5)	18 (35.3)
2 — rrethor (katror)	44 (57.1)	24 (50.0)	2 — i ngjitur	32 (40.5)	33 (64.7)
3 — «i varur»	7 (9.1)	6 (12.5)	BM	1.41	1.65
33. Drejtimi i kapijes			34. <i>Forma e ilapës</i>		
1 — kulmor	24 (30.4)	9 (17.6)	1 — rrethore (katrore)	7 (8.9)	8 (15.7)
2 — i pjerrët	55 (69.6)	42 (82.4)	2 — vezake	49 (62.0)	30 (58.8)
BM	1.70	1.82	3 — eliptike	22 (27.8)	11 (21.6)
			4 — «si dardhë»	1 (1.3)	2 (3.9)
35. Zhvillimi i syshit të Darvinit			36. <i>Tipi i vrigullthit</i>		
0 — mungon	70 (95.9)	47 (94.0)	1 — i lirë	32 (41.6)	24 (50.0)
1 — i dobët	2 (2.7)	2 (4.0)	2 — i ngjitur	45 (58.4)	24 (50.0)
2 — mesatar	1 (1.4)	1 (2.0)	BM	1.58	1.50
BM	0.06	0.08			

	<i>Madhësia e vrigullit</i>						
37	1 — i vogël	♂	Nr. (%)	IX — Koka	♀	Nr. (%)	♀
	2 — mesatar		17 (22.1)	38. <i>Përkulja e ballit</i>		11 (22.9)	Nr. (%)
	3 — i madh		39 (50.6)	1 — e fortë (opistometop)		22 (45.8)	3 (3.8)
	BM		21 (27.3)	2 — mesatare (metriometop)		15 (31.3)	10 (12.7)
			2.05	3 — e dobët (ortometop)		2.08	66 (83.5)
				BM			2.80
39	<i>Lartësia e ballit</i>						
	1 — e vogël		10 (12.7)	40. <i>Profili i zverkut</i>		7 (13.7)	49 (57.0)
	2 — mesatare		54 (68.3)	1 — i sheshtë (planokspital)		35 (68.6)	23 (26.7)
	3 — e madhe		15 (19.0)	2 — mesatar*		9 (17.6)	14 (16.3)
	BM		2.06	3) i përkulur (kurbokspital)		2.04	1.59
				BM			

*) Ne profilet mesatare të zverkut hyjnë raster me sheshim prelambdik dhe ato me përkulje fillestare

CONTINUITY OF ANTHROPOLOGICAL TRAITS IN KOLONJA

In this article the anthropologist A. Dhima aims to reflect the development in time of anthropological features in the territory of Kolonja by comparing the data from the present population and those provided by the skeletons found in Rehova (the 17th-18th centuries of our era) and in Shtika (the 10th-12th centuries of our era). Kolonja, according to the author, constitutes a very favourable unit for research of local physical characters, as this region is inhabited by a population which, due to the natural conditions and the given historical circumstances, had a continuing tendency to movement, though it was not accompanied by stable settlements of population from more distant zones; on the other hand, the local population had its own circle of marriage links which, allowing for the frequent cases of marriage beyond the respective zone, do not go further than the neighbouring zones.

The anthropological study of the present population centres on measurements (Table 1), divided into categories (Table 2) and descriptive features of the head and body (Table 3), which have been classified according to the unified method of our anthropological research. Basing himself on these data, the author reaches the conclusion that the anthropological features of the inhabitants living today in Kolonja do not differ in essence from those of the other regions of the country, therefore the typological substratum is Adriatic, although the genuine Adriatic features are combined to some extent with traits of other elements such as the Mediterranean, Noric, East-European elements. Nearly the same picture of the fundamental features (fig. 2) is repeated in the various zones of the country, irrespective of some manifestation of a local character in the descriptive features.

The anthropological structure of the inhabitants living today in Kolonja is virtually a repetition of that of the mediaeval skeletons in the tumulus of Rehova, in which the Adriatic element occupies prior place, just as in other mediaeval series unearthed in various places in our country (fig. 3).

The skeletons that belong to the Early Middle Ages, found in Shtika, produce sufficient data that speak of the unquestionable presence of the Adriatic element, which brings this series closer to the contemporary materials of another territory in the country (fig. 4). Nevertheless, more conspicuous in this series are the Mediterranean and northern features which complete the features of this kind met among the population inhabiting Kolonja today. Several traits, alien to the local anthropological situation, are also observed in some women skeletons, which speaks of a slight interference from the northeast.

The typological similarity from the present back to the Early Middle Ages, testify to the ancient roots and the uninterrupted continuity of the population of this territory in the south of our country.

«... quhet garin një lloj tjetër salce e pëlqyer shumë, e cila përgatitet nga zorrët e peshkut dhe pjesë të tjera që në raste të tjera hidhen.»⁵

Për vendin që zinte peshku në strukturën e ushqimit dhe për tregtim njihemi edhe përmes pohimeve të Justinianit: «... Asnjëri nuk ka të drejtë të transportojë për barbarët verë, vaj ulliri, prodhime peshku as për ushqim as për tregti (shpallur midis viteve 370-375)»⁶.

Për pasuritë e mëdha që gjenden në ujërat që e rrethojnë vendbanimin e hershëm të Shkodrës, si dhe për llojet e peshkut bëhet fjalë që në shekullin e XI e XII. «...Peshku i kapur në ujërat e Bunës nga vendasit u grabit nga romakët»⁷. Peshkimi ka qenë veprimtari kryesore e banorëve në breg të liqenit e kryesisht të lumit Buna. Ky lumë ka qenë i pasur me peshk. «... Dy tregtarë dubrovnikas ngarkuan pa leje në Shëngjergj të Bunës dy anije me saraga. Ishte viti 1302 e anijet donin t'i dërgonin me peshk në Apul»⁸.

Duke qenë se fshatrat në dy krahët e lumit Buna përmyteshin nga prurjet e mëdha të lumit Drin, Kir e Bunë 4-5 muaj radhazi, kushtet natyrore sollën si pasojë që banorët të lidhen më ngushtë me mjeshtërinë e peshkzënies. Kjo bëri që peshkimi të sillte fitime të mëdha duke luajtur në këtë mënyrë një rol të rëndësishëm ekonomiko-shoqëror në jetën e këtyre fshatrave dhe të qytetit. Në të njëjtën kohë kjo solli me vete përsosjen e mjeshtërisë së peshkatarisë dhe kërkesa për tregun e vendit dhe të jashtëm me peshk të freskët dhe të përpunuar. A. Dysellie, duke folur pikërisht për këtë zeje, thekson rëndësinë ekonomike dhe format e tregtimit në dy limanet kryesore, në Shirq dhe Shënkoll, si edhe mënyrën e përpunimit të tij. «... Sa për peshkun ai kishte gjithashtu rëndësinë e tij... Njoftohet se tregtarët e Durrësit vijnë për të blerë peshk...»⁹ dhe «... peshqit e kripur janë një prodhim tjetër shqiptar i gjendur, i rikërkuar prej raguzianëve në shekullin XV që nga Shkodra deri në Vlorë»¹⁰. Në «Regjistri i kadastrit dhe i konçesioneve për rrethin e Shkodrës» përmenden dy dajlane të vogla dhe emërtime dajlanesh si: Kalimet, Regaliet, Tejeri i epër, Gramatura, Marica. «... Vendi i epër (thuhet aty) d.m.th. të gjitha dajlanet e sipërme shiten çdo vit pak a shumë sipas stinëve... perperi 1550»¹¹.

M. Barleti tek «Rrethimi i Shkodrës» shënon: «... prej andej shoh bujq që lërojnë tokën, që korrin të lashta, mullinj, peshkatarë sa në lumenj e sa në liqenj, le çfarë liqeni, duke gjuajtur peshk që del me shumicë të madhe...»¹². Në këtë mënyrë peshkimi nga njëri breg në tjetrin, nga shekulli në shekull, jo vetëm u trashëguua, por u përsos dhe u konsolidua shumë më tej duke lindur shtresën shoqërore të peshkatarëve...

5) Plini Secundi, XXX, 8/43.

6) Justiniani, IV, 41/1.

7) Osja, A. *Dajlanet e Shkodrës*, «Jeta e re», Shk. 5 korrik 1983.

8) Bisha, A. *Peshkimi, mënyrat e peshkimit në lumin Bunë e liqenin e Shazit*, f. 258, «Koha» Titograd 2/1970.

9) Ducellier, A. «La facade maritime de l'Albanie au moyen age Durazzo et Valon du XI^e au XV^e siècle», Thessalonyk, f. 361.

10) Ducellier A. *Po aty*, f. 598.

11) «Regjistri i Kadastrit dhe i Konçesioneve për rrethin e Shkodrës» 1416-1417, Tiranë, 1977, f. 125-126, fl. 114/b.

12) Barleti, M. «Rrethimi i Shkodrës», bot. III, Tiranë 1982. f. 41.

Me rëndësi është edhe dëshmia që na jep Evlia Çelebiu për ndarjen e popullsisë së Shkodrës në gjashtë shtresa të ndryshme shoqërore: peshkatarët, ushtarakët, tregtarët, zejtarët, fetarët dhe bujqët.¹³

Shkodra ishte prodhuese e një sasive të madhe drithi, e pasur me verë, mish, peshk për vendin dhe për eksport. «...Liçeni ... ka çdo lloj peshku sipas stinës dhe muajve dhe me dajlanet që ka aty i qet të ardhurat»¹⁴.

Fontanes në studimin e saj për gjuetinë e fiksuar në liçenin e Shkodrës na informon se «...Arkivat e kohës otomane janë të mbushura dhe deri në luftën e parë botërore sistemi i peshkimit në liçen nuk kishte ndryshuar që prej pesë shekujsh»¹⁵.

Dokumente të mëvonshme shënojnë se Shkodra ka qenë gjithnjë qyteti që eksportonte shumë peshk pa prekur nevojat e veta, duke bërë tregti me vende fqinje dhe me shumë qytete të rëndësishme të Evropës (në Vjenë e Itali, Malin e Zi, Serbi, Bosnjë e Kosovë). Eksporti bëhej me peshk të freskët, të thatë e të kryposur. Gjatë pushtimit turk administrata turke përdori «Bezhdibirin», raporti 5 me 1, e cila ishte taksë e tërthortë, që ushtrohej në të gjithë peshkëzënien pa përjashtim; për këtë edhe sot flasin kapidanët e vjetër të dajlanit.

Brenda planimetrisë së pazarit të vjetër në Shkodër shtrihej «Sokaku i peshkut» i cili «ka pasur më shumë se 20 dyqane të peshkëshitjes, ndërtesa shumë të ulta dhe të vjetra të vendosura rresht njëra pas tjetrës»¹⁶. Peshku për treg ekspozohej nëpër stola, tezga, trina para dyqaneve, gjatë gjithë ditës. «...Në vitin 1529, sipas një vakufnameje, rezulton se Ali Beu i vakufnoi bashkë me dy magazina»¹⁷, në tregun e peshkatarëve një nga tregjet e Skënderies. Ky dokument na vë në dukje se «sokaku i skelës së pazarit ekziston që në shekullin XVI»¹⁸. «Ashtu si në zejjet e tjera edhe në peshkim, ka vepruar organizimi esnafor; forma të tilla të drejtuara nga një kryetar ose kapidan gjejmë edhe në peshkim, veçanërisht në organizimin e dajlanit»¹⁹.

«...Si nga burimet dokumentare, letrare apo tradita gojore mësojmë se esnafi blinte lëndën e nevojshme të cilën e shpërndante në mënyrë proporcionale, duke kënaqur të gjithë anëtarët e tij, ndërsa ajo që mbetej u jepej në formë shtese elementeve më të pasur»²⁰.

Ami Bue duke folur për peshkimin në Liçenin e Shkodrës thekson: «Ky liçen shumë i peshkueshëm thellësitë më të mëdha i ka në bregun perëndimor»²¹.

Informatat e para rreth sistemit të sipërmarrjeve i përkasin kryesisht fillimit të shekullit XVII.²² Bue flet edhe për pasurinë dhe shumëllojshmërinë e peshkut të liçenit, për peshkëzënien e bregliqenasve si dhe

13) Naçi, S. «Pashallëku i Shkodrës», Tiranë 1964, fq. 36.

14) Naçi S., *po aty*, fq. 35.

15) Fontanes M., «Une pêcherie fixe du lac de Scutari», Ekstrait de l'Etnografie, «Revue de la Société d'Etnografie de Paris», f. 36, Année 1968-1969.

16) Arkivi Muzeumi Popullor Shkodër «fondi i dorëshkrimeve», f. 113.

17) Osja A, *art. cit.*

18) Shkodra Z., «Esnafët shqiptare», T. 1973, fq. 78.

19) Shkodra Z. *Po aty*, f. 78.

20) Shkodra Z., *po aty*, f. 207.

21) Bue, A. «La Turquie d'Europe», Paris, Arthur Bertrand, VI, 1840, f. 81.

22) Naçi S., *vep. cit.*, f. 30

për tregtinë e përpunimin e peshkut në këtë qytet. Me këtë mjeshtëri u morën drejtpërdrejt shumë familje qytetare e fshatare. Kështu në vitin 1911, si dëshmohet nga gazeta «Shqipëria e re», në Shkodër kishte 150 shtëpi që merreshin me peshkëzënie²³. Veçanërisht janë shquar shirokasit e zoganjorët, të cilët i kanë pasur mjeshtëri bazë të jetës së tyre.

Me peshkim u shquan si mjeshtër edhe bregabunasit dhe anamalasit, fshatarë që banojnë në dy anët e rrjedhës së lumit Buna e që janë marrë kryesisht me bujqësi e blegtori. «... Litari (konopi), spango liri e mjete peshkimi si kariqe, sokë»²⁴. Objektet janë përgatitur kryesisht nga gratë «...puna me lirin ka qenë krejt masive»²⁵.

Në këtë mënyrë peshkimi si një traditë tepër e lashtë erdhi deri në ditët tona. Peshkatarët ndjenë mbi kurrizin e tyre jo vetëm lodhjen e profesionit, por edhe shfrytëzimin e regjimeve antipopullore; megjithatë ata mbetën përgjithnjë punëtorë të zot, zanatçinj të zellshëm, njerëz bujarë të lidhur pazgjidhshmërisht me zejen e peshkimit.

*
* *

Tradita e peshkimit në qytetin e Shkodrës, pasuria e faunës ihtike, porosinë e vazhdueshme të Partisë dhe të Pushtetit për intensifikimin dhe përmirësimin e metodave dhe të teknikave të peshkimit bënë që të rritet në një shkallë më të lartë rendimenti i punës edhe në këtë fushë.

Në vitin 1946 u ngrit kooperativa e peshkimit, e cila më 1960 u shndërrua në ndërmarrje shtetërore. Sot peshkimi bëhet mbi bazën e traditës, por në të njëjtën kohë shfrytëzohen edhe metoda e teknika të reja të peshkimit.

Përmirësime të mëdha janë bërë në mjetet dhe teknikat e peshkimit. Edhe rrjetat e peshkimit të ndërtuara nga kërpi, liri ose pambuku u zëvendësuan me rrjeta najloni me madhësi të ndryshme syzash, që ndryshojnë për çdo lloj gjuetie. Gjuetia e peshkut tani është e organizuar mbi bazën e brigadave dhe secila prej tyre është emërtuar mbi bazën e vendit të gjuetisë. Kështu sot në këtë ndërmarrje numërohen këto brigada: Buna, Dajlani, Bishti, Vraka, Valza, Kastrati.

I. Pozicioni i rrjetit ujqor të Shkodrës, flora, fauna dhe pasuria ihtike.

Kompleksi ujqor Liqeni i Shkodrës, Drini, Buna, formojnë një tërësi ujore të vetme, e cila për veçoritë, përmasat dhe shkallën e ujshmërisë përfaqëson një sistem të madh në kompleksin ujqor të vendit tonë. Ky kompleks shtrihet në pjesën e sipërme të territorit hidrografik të Shqipërisë. Në pellgun ujqor të kësaj tërësie bien reshje më të shumta se në çdo pjesë tjetër të gjithë territorit të vendit tonë.

23) «Shqipëria e re», 13 Korrik 1913.

24) Gogaj Nuri — *Të dhëna për punimin e lirit në krahinën e bregut të Bunës*, «Etnografia Shqiptare» 12, Tiranë, 1982, f. 257.

25) Gogaj Nuri — *po aty*, f. 258.

Rëndësia ekonomike e bimësisë që ka liqeni dhe pellgu uJOR i Shkodrës duket qartë në peshkëzimin e tërë rrjetit uJOR. Ky pellg është shumë i pasur në sasi dhe në cilësi me organizma uJore që përbëjnë bazën ushqimore të peshqve. Kjo është arsyeja që rrjeti uJOR i Shkodrës është i pasur edhe me shumë lloje peshqish.


Ihtiofauna e rrjetit uJOR të Shkodrës përfaqësohet nga lloje të peshqve shtegtarë, si edhe nga llojet e peshqve të hedhur nga rritja artificiale. Peshqit vendas (sedentarë), gjuhca, skorta, skorta e bardhë, skorta e zezë, mlyshi, lloska, barburiaqi, mustaku, bajçaku, kokllani, trofta, melsa, pluhuni (njomishte), bërmaliqi, karasi, lloça, brufulli, llojba, ngjala balçe, krapi, njila, përfaqësojnë prodhimin kryesor vjetor. Ndër peshqit shtegtarë (emigatorë) përmenden: ngjala, kubla, qefulli, blini, levreku, shoja (pastra), ame, korba, kerma dhe delfini.

II. Mjete dhe mënyra peshkimi

1. — *Gjuetia me shkop*. Kjo mënyrë peshkimi është mjaft e lashtë. Ajo nuk kërkon ndonjë përgatitje të veçantë mjetesh (Skica 1). Gjuetia me shkop përdoret në pranverë e në vjeshtë, në ujëra të ngrohta dhe të cekta, në ballanxha, në vija e në kanale, nëpër të cilat më parë ka vërshuar uji. Kjo mënyrë përdoret zakonisht nga fshatarët e të dy anëve të rrjedhës së Bunës. Vijat ose kanali rrethohet me pritë në të dy anët dhe peshkatarët futen në ujë dhe e turbullojnë atë me këmbë. Peshku (lloskë, njilë, krap, karas) i verbuar del në sipërfaqe të ujit. Peshkatarët që mbajnë në duar hunj, e godasin peshkun, e marrin me karvariq dhe e fusin në liqar. Shpesh në këto raste peshkimi bëhet me kariat. Kjo mënyrë peshkimi njihet edhe si «peshkim me rrethim»²⁶.

2. — *Fuzhnja*²⁷ — *Fuzhna, fuzhne, fuzhma*. Është mjet peshkimi tepër i lashtë. Arkeologjia e ka dokumentuar në periudhën e bronxit. Në Bosnje, në Dolinën e Savës është gjetur një fuzhnje e kohës Laten shek. IV-II p.e.s.²⁸. Fuzhnja gjindet me 3, 5, 7 maja të drejta. «... Është shtizë e gjatë nja tri metër me majë në trajtë shigjete, me të cilën theret krapi»²⁹. (Skica 2).

Format e fuzhnjes më të hershme i gjejmë me fije të lidhura në mes në teknikën e hekurit të rrahur dhe më vonë majat e tyre janë të salduara.




1. Hu për turbullimin e ujit dhe për goditje të krapit në vija.

26) Bisha A. — *art. cit.* f. 264.

27) E. Çabej — *vep. cit.* vëll. I, f. 201.

28) Dojaka A. — «Mjete peshkimi në bregun e Bunës», «Etnografia Shqiptare», III, Tiranë, 1966, f. 72.

29) Çabej E. — *vep. cit.* vëll. I, f. 201.



2. Fuzhna

Fuzhnjet më të vona shigjetën e kanë të filetuar dhe në këtë mënyrë majat mund të montohen dhe të zmontohen.

Këndi i Çaprazit, çimit, që është maja e shigjetës së fuzhnjës, varet nga lloji i gjuetisë së peshkut. Kështu në gjuetinë e krapit çaprazi është më i madh se në gjuetinë e karasit. Nga lloji i peshkut varet edhe madhësia e fuzhnjes. Krapit ka fuzhnjen më të madhe. Fuzhnja është e pajisur me një bisht druri prej mani, shelgu, vidhi ose fojletë, gjatësia e të cilit shkon nga 1,5-3 m; në majë të bishtit lidhet një litar që i shërben peshkatarit si rezervë për ta lëshuar fuzhnjen në ujë kur peshku është shumë i madh. Fuzhnja përgatitet nga kovaçi sipas dëshirës dhe porosisë së peshkatarit.

Me fuzhnje bëhet gjuetia e krapit dhe e karasit gjatë riprodhimit të tij. sidomos në stinën e pranverës, në kohën e vërshimit të ujërave.

Gjuetia bëhet nga pema, nga bregu, nga lundra. Ka raste kur peshkatarit gjuetinë e bën edhe duke qenë i futur në ujë. Në këtë rast bishti i fuzhnjes është i shkurtër, po kështu edhe fuzhnja më e vogël. Kur peshku në tufë i afrohet bregut, peshkatarit me njërin dorë mban fuzhnjen dhe kur tufa kalon para tij ai i gjuan me forcë. Në gjuetinë me fuzhnje natën peshkatarit përdor edhe fenerin e dorës. Drita e lëshuar mbi tufën e peshqve ndalon lëvizjet e tyre; kështu që peshkatarit e ka më të lehtë gjuetinë, bile shpesh zgjedh edhe «kokrrën më të mirë» (të madhe).

Në gjuetinë me këtë mjet kërkohet mjeshtëri dhe përpikmëri. Në këtë lloj gjuetie peshkatarit është i pajisur edhe me liçarin.


3. *Gjuetia me ballkot*. Është mënyrë peshkimi tepër e vjetër që ndeshet në rrjetin ujqor të Shkodrës me emra të ndryshëm si: ballgat, ballkot, me rryll³⁰, me rrill, me bar peshku, me kingla etj.

30) Bisha A. *art. cit.*, f. 261.

Bari i peshkut (*Verbascum Thapsus*) është një lloj bime që shtrihet nga zona bregdetare deri në zona të larta. Gjuetia me ballkot bëhet zakonisht në stinën e verës në gomna (vend me ujë të thellë), në ballanxha, në amulli dhe në llomishta, në vende pa rrjedhë ose rrjedhë të lehtë. Në këtë mënyrë gjuhet zakonisht njila, mlyshi, lloska, krapin e karasi. Për të përgatitur ballkotin merret miell misri i bardhë me tëmthin e bagëtive të trasha. Brumi i formuar thërmohet duke krijuar copëra të vogla në trajtë të saçmeve dhe hidhet në ujë. Peshqit, duke gëlltitur, pësojnë një helmim të lehtë dhe pas gjysmë ore a më pak ato dalin të turbulluar mbi sipërfaqe të ujit. Peshkatarin e karvariq i kap ata lehtë. Në gjuetinë me bar peshku, peshkatarët e këpusin në kërcell këtë lloj bime dhe në vende «amulli», «gomna», e hedhin barin duke e rrahur kërcellin për të lëshuar lëngun; uji helmohet dhe peshqit pas pak kohe dalin në sipërfaqe të ujit.

4. *Rrëshanëza*. Është mjet peshkimi për krapin, lakeçin dhe karasin. Ndërtohet me dy hunj të drejtë prej shelgu, vidhi, mani ose akacie me diametër 7-10 cm dhe me gjatësi 50-100 cm. Duhet thënë se gjatësia e hurit është në varësi nga thellësia e ujit. Gjatësia e rrëshanëzave arrin deri në 3 m. Në këtë sipërfaqe vendoset dhe rrjeta me syza të mëdha 24-28 mm, e cila lidhet në të dy anët e saj me hunj dhe vendoset në atë mënyrë që të krijojë bulshin (e fryrë).


Peshku zihet në kohën e vërshimit të ujërave në livadhe me ujë të cekët dhe në ballanxha me ujë të turbullt. Peshku hyn në oborrin e kocës dhe në këtë kohë peshkatarët mbyllin portën e oborrit. Dy peshkatarë që mbajnë rrëshanëzën të hapur kontrollojnë të gjithë oborrin e kocës, të ulur tërheqin rrëshanëzën në mënyrë të pjerrtë me shtratin e lumit. Peshku i rrethuar hyn në rrëshanëz. Mjeti është i përhapur në gjithë pellgun uJOR të Shkodrës. (Skica nr. 3).



3. Rrëshanëza

Duke folur për mjete peshkimi F. Nopcsa shënon «...Në Rragam pash një mjet të gjatë 10 m dhe gati 1 m të lartë të mbajtur nga dy shkopinj; dy burra e kapnin dhe e mbanin atë vertikalisht, lëviznin së pari në drejtim të thellësisë së ujit pastaj përballë bregut. ...Përveç këtij vendi gjuhet në pellgje dhe ujëra të vegjël»³¹.

5. — *Koshi*. Gjuetia me kosh bëhet gjatë muajve prill-tetor. Me këtë mjet gjuhet në të gjithë pellgun ujqor të Shkodrës. Koshi është mjet peshkimi që përgatitet nga «fshatarët e bregut të Bunës»³², me thurje thuprash të paqëruara të drurëve të mrinës, të shëlgut ose të thanës, drurë që rriten gjatë gjithë bregut të liqenit dhe të rrjedhës së Bunës. Koshat e Shqipërisë veriore, sipas Nopcsës, ndërtohen me thupra të shëlqes dhe kanë formën e shishes. Koshi ka formë sferike me dimensione 60-80 cm. Koshi është i pajisur me fener që i ngjajnë një hinke, i futur brenda sferës së koshit me diametër 0,05 m³³. (Skica nr. 4). Grykën e fenerit peshkatari e



4. Koshi

31) Nopcsa F. — *vep. cit.*, f. 113.

32) *Sheldija Gj.* — *art. cit.*, f. 410.

33) Dojaka A. — *art. cit.*, f. 67.

bën me thurje më të shpeshta. Peshkatari e përdor koshin si mjet peshkimi dhe si mjet pune. Takohen tre lloje koshash me madhësi dhe forma të ndryshme në varësi nga lloji i gjuetisë së peshkut. Kështu me koshin e njilave dhe të mlyshave zihen njilë e mlysh, prej të cilës ka marrë dhe emrin³⁴; koshi i bërcakëve që ka thurje tepër të imtë, përdoret për zënien e këtij lloji peshku (peshk i vogël) që nevojitet për meztjen e grepave në gjuetinë e ngjalave. Ndërsa me koshin e valës zihet njila, mlyshi, ngjala etj.³⁵.

Koshi hidhet në ujëra të thella, 1,5-2 m, me rrjedhje të lehtë, në mbrëmje dhe nxirret në mëngjes. Pjesën e brendshme të fenerit peshkatari e mbush me tul buke misri të bardhë ose me gjak të mpiksuar të bagëtive të trasha. Peshku, duke kërkuar ushqim, futet në kosh dhe nuk di të dalë. Koshi lidhet me gur për të mos lëvizur nga vendi i hedhjes. Njëkohësisht pajiset me një shenjë (rrijedha) për verifikim. Shenja përbëhet nga një tufë shkopinjë ose rijedhash (bimë që rriten në liqen ose në kënetë si kallami pa nyje). Me këto peshkatarët formojnë trekëndësja dybrinjëshëm që lidhen së bashku me një tel ose me një tojë këрпи ose liri për të treguar vendin se ku është koshi. Shenja qëndron sipër ujit. Peshkatari mund të hedhë rresht deri në 12 kosha.


6. — *Gomrra*, (*ganërra*, *gangërra*). Gomrra përdoret për gjuetinë e ngjalës. Gjuetia me këtë mjet është e përhapur në gjithë rrjetin ujqr të Shkodrës duke përjashtuar këtu ujërat e ftohta. Rrajzat (krimbat e shiut) përkohën në tërë gjatësinë e trupit të saj me pe mëndafshi ose pambuku, gjatësia e të cilit është nga 1-3 m. Krimbat e përshkuar sillen rreth pëllëmbës së dorës duke krijuar në këtë mënyrë një lëmsh me krimba, të cilët lidhen me një fill spango ose këрпи najlon ose filispanjë me gjatësi 2-3 m me kallamin që është i gjatë 1,5-3 m. Gjuetia bëhet ditën dhe natën në ujë të turbullt, me reshje të mëdha, me erë veri e në shirok si dhe në netë pa hënë. Gjuetia bëhet nga bregu, por shpesh peshkatari hyn në ujë të cekët dhe hedh gomrrën në ujë të thellë. Në gjuetinë nga bregu peshkatari hap një gropëz, e cila do të shërbejë si vend për të depozituar peshkun e për ta mbajtur atë të freskët. Peshkatari e hedh gomrrën dhe ngjala, duke kërkuar ushqim, ndesh në lëmshin me krimba dhe i pëlqen ta hajë. Mëndafshi i mbetet në dhëmbë dhe e tërheq. Peshkatari e ndjen dhe e tërheq jashtë gomrrën. Në gjuetinë me gomërr, kur peshkatari është futur në ujë, procesi është i njëjtë, por gropëzën e zëvendëson me një rrjetë ose çarçaf të vendosur në katër kallama. Në këtë gjueti zakonisht nuk përdoret plumça, por, kur gjuetia bëhet me ujë të rrjedhshëm, vendoset edhe plumbi ose gurë. Gomrra është mjet peshkimi i lashtë, që përgatitet zakonisht nga gratë.

7. — *Therca*. Therca është ndërtuar me dy kallama, gjatësia e të cilëve është 1,5-2 m. Kallamat vendosen paralel njëri me tjetrin me gjerësi 80-100 cm. Në sipërfaqen e krijuar shtrihet rrjeta me syza të imta, që lidhet me kallama. Në kallamin e poshtëm lidhen copa gurësh ose plumbat, me qëllim që rrjeta të qëndrojë «trinë» (e drejtë e hapur), kurse në ka-

34) Bisha A. — *art. cit.* f. 261.

35) Bisha A. *po aty*, f. 260.

llamin e sipërm vendosen dy tapa për ta mbajtur thecën mbi ujë. Në mesin e kallamit të sipërm lidhet një litar, tel, pe najloni ose kërpi, disa metra i gjatë, për ta ulur e çuar thecën gjatë gjuetisë. (Skica 5).




5. Therca

Therca bëhet gjatë shtegtimit të peshkut (gjuhçë). Është mjet për gjuetinë e gjuhçës. Peshkimi bëhet në ujë të thellë, të qartë dhe me rrjedhje. Peshkatari mbi një urë, mbi një pemë ose nga bregu e ul thecën në ujë me ndihmën e litarit duke e vendosur atë përballë rrjedhës. Gjuhca ndesh në rrjetën e thecës dhe velëzat mbesin në rrjetë nga ku nuk mund të dalin. Peshkatari e çon thecën herë pas here, duke nxjerrë peshkun e zënë, të cilin e vendos në vistër ose në shportë që është e ndër-tuar nga thupra të shelgut ose të mrinës.

8. — *Plumça, plumçi*. Është një mjet peshkimi për zënien e krapit, karasit, mlyshit e njilës. Plumça është një rrjetë me syze 32 mm, nga kërpi ose liri, e cila ka formë të rrumbullakët me perimetër 9-12 m (Skica 6). Sipërfaqja e rrjetës është 30 m².³⁶ Rreth perimetrit të rrjetës lidhet një litar liri, në gjithë gjatësinë e të cilit vendosen plumça me peshë deri në 50 gr. Plumçat shpesh kanë formë konike si rezultat i derdhjes, por edhe me të rrahur. Pesha e përgjithshme e plumçës shkon deri në 6 kg.

36) Sheldija Gj. art. cit., f. 409.



6. Plumça

Pikërisht nga plumçat mjeti i peshkimit ka marrë edhe emrin «plumçë». Në qendër të rrjetës është lidhur një litar 6-7 m gjatësi i cili shërben për përdorimin e plumçës gjatë gjuetisë.

Gjuetia bëhet gjatë gjithë vitit. Peshkimi bëhet me mot të mirë dhe të keq, ditën e natën, në liqenin e Shkodrës, në rrjedhjen e lumenjve të Drin, Bunë dhe Kir dhe në kënetën e Vilunit. Gjuetia bëhet në ujëra të thella, ku nuk mund të hidhen rrjeta të mëdha³⁷, si në gomna, në avarde, në amullina, në vija etj. Gjuetia me plumç bëhet nga bregu, nga lundra, nga një pemë ose nga një urë.

Në gjuetinë me lundër peshkimi bëhet me dy veta, njëri vozit nga njëri va në tjetrin, peshkatari tjetër hedh plumçen. Para se të hedhë plumçen në ujë peshkatari mbledh litarin dhe rrjetën, të cilat i hedh në sup, pas shpinës. Me forcën e krahëve e hedh plumçen 2-3 m para lundrës duke krijuar kështu një rreth paralel me pasqyrën e ujit. Me të rënë në ujë plumçat mblidhen në qendër. Peshkatari me ndihmën e litarit tërheq ngadalë rrjetën. Kështu plumça bën një lloj mbylljeje dhe peshku mbetet brenda në rrjetë. Plumça është mjet i lashtë e kërkon mjeshtëri të madhe përdorimi³⁸.

9. *Gjuetia me shtrat grepash*. Me këtë lloj gjuetie bëhet zënia e krapit, karasit, ngjalës. Përdorimi i kësaj mënyre varet nga lloji i gjuetisë së peshkimit. Është mjet që përdoret gjatë gjithë vitit, por më shumë në kohë reshjesh.

Në një fije kërpi ose filispanje lidhen njëri pas tjetrit grepa të njëjtë

37) Dojaka A. — *art. cit.*, f. 75.


38) Sheldija Gj. — *po aty*, f. 409

40-50 rreshta. Gjatësia e fillit shkon nga 15-30 m. Peshkatarët emërtojnë edhe shtretërit si: shtrat për krap ose ngjalë. Në njëren anë të fillit vendosen gurë ose plumb për ta «fundosur shtratin», kurse në anën tjetër lidhet shenji për të ditur se ku është shtrati (Skica 7).


Grepat meqenat sipas llojit të gjuetisë. Kështu në gjuetinë e ngjalave meqitja e grepave bëhet me krimba shiu, kurse në gjuetinë e krapit e të karasit me kërmill, farëra bimësh të ndryshme. Peshkatarit në ujëra të thella e të cekta hedh shtratin e grepave në mbrëmje dhe e nxjerr në mëngjes. Ai mund të hedhi njëherësh 4-5 shtretër në vahe të ndryshme. Në shumë raste peshkatarit për të nxjerrë nga uji shtretërit përdor çengelin. Çengeli është mjet ndihmës i peshkatarit dhe ka formën e një grepi të madh. Është mjet gjuetie i vjetër. Për këtë mjet peshkimi na informon edhe F. Nopsca: «... në liqenin e Kastratit peshkohet, përveçse me dajlan e me kosha, edhe me litar të gjatë në fundin e të cilit vendoset guri që rri në bazamentin e liqenit si dhe një dru për të parë ku është hedhur litari. Ky litar është i gjatë 100 m e quhet «spagë», në të varen grepat e vegjël, të cilëve u futet rrajzë; i gjithë aparati quhet «lenzë»³⁹.

10. — *Grepi për gjuetinë e qefullit.* Gjuetia e qefullit me grep bëhet në periudhën e emigracionit (shtegtimit) të qefullit. Për këtë përdoren tre grepa nr. 10, të cilët saldohen shpinë për shpinë (Skica 8). Grepi lidhet me një fije kërpi, perloni ose fildispanje. Mbi grep në distancën 50-80 cm vendoset copë plumbi për ta mbajtur të fundosur grepin. Grepi nuk meqitet.

Gjuhet në ujë të kthjelltë. Peshkatarit qëndron në një vend të ngritur



7. Shtrat grepash




8. Grep për gjueti qefulli

39) Nopsca F. — *vep. cit.*, f. 113.

dhe e ul grepin. Gjuetia bëhet «me të therur». Peshqit, duke shtegtuar në tufë, kalojnë edhe mbi grepin e ulur; peshkatarit shikon tufën dhe ngre grepin. Peshku theret në trup; kështu mund të gjuhet ditën dhe natën me dritë.

11. *Koca*. Është mjet për gjuetinë e krapit, karasit, mlyshit, lloçës e njilës në periudhën e vërshimit të ujërave. Është mënyrë gjuetie me pritë.

Koca ndërtohet me kallama në formë gardhi, ata lidhen njëri me tjetrin me thupra shelgu, pasi këto në lagështirë «shtanjohen»; kështu që kallamat shtrëngohen mirë; kallamat vendosen afër njëri-tjetrit. Prita është e gjatë 50-100 m e në disa raste edhe më shumë. Në tërë gjatësinë e kocës vendosen feneret që kanë formën e një rrethi të shtypur dhe ngjasojnë shumë me grykën e fenerit të koshit të ngjalave. Feneret janë po nga kallamat me diametër 1-1,70 m. Gjerësia e grykës së fenerit është sa gjerësia e këmbës 0,15-0,20 m. Gryka e fenerit vendoset 5-6 m larg njëra-tjetrës. Jashtë kocës vendoset «shkapërcylli» që është një lloj shkalle që i shërben peshkatarit për të marrë peshkun me karvariq. (Skica 9).




9. Koca*

Peshkatarët përgatisin më parë kocat, që i ndërtojnë me një «valë» e «me dy valë» njëra pas tjetrës. Kjo i lejon peshkatarët që gjuetia e peshkut me kocë të bëhet me ujë të bollshëm e të cekët. Koca është mjet për gjuetinë amatore dhe gjindet në Liqenin e Shkodrës në dy anët e rrjedhës së Bunës dhe në kënetën e Vilunit.

Kocat vendosen në livadhe afër kanalit, peshku «shtrohet në kullosë» dhe ndesh në pritë duke dashur të gjejë të dalur futet në grykën e fenerit nga ku nuk mund të dalë. Në gjueti të mbarë ndodh që gjithë koca të mbushet me peshk. Në disa raste koca vendoset edhe në kanal. Shpesh peshkatarët «paitin» kocat nga prurjet e ujit.


12. *Kovna, kofna*. Është mjet me të cilin bëhet gjuetia e ngjalës. Gjatë gjithë vitit, por më shumë me ujëra të turbullta me mot të shqetësuar.

Kovna ka formë ovale, me dy anë të hapura (Skica 10). Në mesin e kovnës, në gjithë perimetrin e saj, është i fiksuar një dru shelgu në formë rrethi, i cili shërben për t'i dhënë formën dhe për ta forcuar atë. Thurja me fije bëhet shumë shpesh, 2 cm larg njëra-tjetrës. Dy të hapurat e kovnës shërbejnë njëra për fener të kovnës, kurse tjetra për të ma-




10. Kovna

rrë peshkun e zënë. Kjo qëndron e mbyllur me tapë, «shtupë», me gjethe dushku ose frashëri. Fundi i kovnës, feneri, është më i gjatë se gryka tjetër, 75 apo 80 mm dhe është i ndërtuar me shtatë shpatëza (dru i hollë fiku) të cilët vendosen nga perimetri i grykës deri në qendrën e saj në formë koni. Madhësia e shpatëzave është 25 cm. Kovna ndërtohet nga peshkatarët por edhe porositen të fshatarët e Bregut të Bunës sipas dëshirave të tyre.




11. Pinari



12. Pinari

metër 3-5 cm. Rathët vendosen njëri mbi tjetrin në distancë 50-60 cm dhe mbahen në dy purteka shelgu, vidhi, ferrkuqeja, akacie, në formë gjysmërrethi paralel me njëri-tjetrin, në distancë 80-100 cm. Në lartësinë e këtyre gjysmërrathëve, në kulmet e tyre, mbërthehet me gozhdë ose lidhet me litar bishti i rrethit që ndërtohet nga druri i shelgut, i fojletës, i vidhit ose i manit, me gjatësi 3 m. Nga vendi ku lidhet ose mbërthehet bishti deri në bazën e rrethit të poshtëm vendoset një dru në formën e gërmës L që quhet kërбетë. Hapësira e krijuar në mes të dy rrathëve mbulohet me rrjetë liri ose teli me gjerësi 50-60 cm. Mjeti përgatitet nga vetë peshkatarët. (Skica nr. 13).

Me rreth bëhet gjuetia e krapit dhe e karasit. Peshkimi bëhet në pranverë gjatë periudhës së riprodhimit të krapit e të karasit, në ujëra të cekta dhe relativisht të ngrohta, afër bregut, ditën dhe natën. Gjuetia bëhet në bregun lindor të liqenit të Shkodrës, në rrjedhën e Bunës dhe në kënetën e Vilunit. Gjuetia më intensive bëhet në kohë të mirë e në ditë të



13. Rrethi

ngrohta dhe me zagushi, 1-2 ditë pas reshjeve, në muajt prill-maj; pikërisht në këtë periudhë krapit ose karasi, pas vërshimit të ujërave të lumënave dhe të liqenit, i afrohet në tufa bregut për të lëshuar vezë. Krapit femër, në mes të ekzemplarëve meshkuj, kërkon të bëjë riprodhimin, përplasat në cekinë, në ndonjë gur ose cung. Në mungesë të këtyre femrës e godasin edhe meshkujt. Pikërisht këtë moment peshkatarët e quajnë «rreh krapit»⁴². Në shumë raste masës së peshkut në ujë të cekët i duket gjysma e shpinës. Tufa e peshkut është e pavëmendshme dhe në këtë kohë peshkatarit hedh rrethin përmes të cilit mund të rrethojë gjithë tufën. Peshkatarit kontrollon rrethin e hedhur, merr peshkun dhe e vendos në liqen për të qëndruar i freskët. Në periudha të peshkimit të mbarë janë kapur me një rreth deri në 3 kv krap dhe karas.

15. — *Njica*. Është një lloj rrjete për gjuetinë e qefullit, të krapit, të kublës e të gjuhçës. Me këtë mjet gjuhet gjatë gjithë vitit në pellgun ujor të Shkodrës, në ujëra të thella e të cekta. Njicat kanë madhësi të ndryshme dhe emërtohen sipas gjuetisë së peshkut: njica të rralla, të shpeshta, notuese e të thjeshta.⁴³ Zakonisht njica ndërtohet me tri rrjeta me syza të ndryshme të vendosura njëra mbi tjetrën. Peshkatarët e quajnë «petk». Rrjeta e mesme është me syza të imta, kurse e para dhe e treta kanë syza të mëdha me përmasa të njëllajta. Njicat kanë madhësi të ndryshme syzash që i përgjigjen llojit të gjuetisë së peshkut dhe ujit.

42) Dojaka A. — *art. cit.*, f. 70.43) Sheldija Gj. — *art. cit.*, f. 409.

Me madhësinë 46 mm dhe gjatësi 50 m të rrjetës gjuhet krapi. Me syza 70 mm dhe me rrjetë 50 m të gjatë gjuhet qefulli, ndërsa me syza 150 mm dhe me rrjetë 20 m të gjatë gjuhet gjuhca.

Pjesët përbërëse të njicës janë: toja që kidh rrjetën (njicën) dhe tapat, rrjella (tapa, kungulluji) që është lidhur me tojën për të mbajtur sipër njicën, guri me peshë 200 gr ose plumça që vendoset jashtë rrjetës; spiranca, një gur i madh ose hekur me peshë deri në 50 kg, që lidhet në një rën anë të njicës dhe shërben për ta fiksuar atë; shenja, një grumbull rrjellash ose kungujsh uji që shërbejnë për të treguar vendin e hedhjes së njicës. Nga ana tjetër dallojmë njicë të rrallë me pe kërpi ose liri, që fillon me 40 syza e ka gjatësi deri 50 m; njicë të shpeshtë që ndërtohet me pe kërpi ose liri që fillon me 70 syza e që është e gjatë 50 m.

Në të gjitha llojet e njicave elementet janë të njëjta, por madhësia e syzave ndryshon sipas llojit të gjuetisë. Në gjuetinë me njicë vendi që do të peshkohet rrethohet nga 5-8 njica. Njicat hidhen në darkë dhe nxirren në mëngjes. Gjatë ditës ato hapen me «shujka» për t'u tharë, riparuar dhe pastruar nga barërat e këqia. Njica është mjet i lashtë dhe ka rendiment veçanërisht në mot të mirë dhe të qetë. Ato punohen zakonisht nga gratë. Njihen për përgatitjen e këtij mjete kryesisht shirokasit.

16. — *Njicë e thjeshtë*. Njica e thjeshtë është një rrjetë me syza të ndryshme dhe me gjatësi që shkon nga 30-70 m sipas dëshirës së peshkatarit. Poshtë rrjetës nuk vendosen gur e as plumça. Në gjatësinë e rrjetës përshkohet një spango e sipër saj lidhen tapa.

Me këtë mjet gjuhet krapi, karasi, mlushi, qefulli, shojsa, njila dhe lloska. Gjuhet gjatë gjithë vitit, sidomos në kohën e vërshimit të ujërave, veçanërisht në brigjet e liqenit, në të dy anët e lumit Buna, në kënetën e Vilunit, në livadhe etj.

«...Njica lëshohet pingul në ujë, peshku tuj u ulë teposhtë, sidomos kur vjen dimri, shkon e mbetë ndër syza të tyre në mënyrë që s'mundet kurrsesi me u lirue»⁴⁴. Hidhet në mbrëmje e nxirret në mëngjes. Rrjeta e hedhur në ujë shtrihet duke u lidhur me dy kallama në skajet e saj, të cilët ngulen në tokë. Në këtë mënyrë qëndron e lirë.

17. — *Mrexhë (pupunjicë, pupunicë, pupnicë)*. Është një lloj rrjete prej liri me syza të ndryshme që ndryshojnë nga lloji i gjuetisë. Me këtë mjet gjuhet qefulli, kubla, njila e mlyshi. Peshkohet gjatë gjithë vitit, në kohë të mirë e të keqe, ditën dhe natën. Me këtë mjet gjuetia bëhet në liqen, në lumin. Bunë e Drin dhe në kënetë. Pjesët kryesore të mrexhës janë rrjeta me syza 28-45 mm që ndryshojnë në varësi nga lloji i peshkut që peshkohet. Gjithashtu pjesë të tjera janë: toja, plumça dhe tapa rrijella. Gjatësia e mrexhës arrin deri në 30 m. Në vendin e gjuetisë mund të hidhen 1-3 mrexha. Në një rën anë të mrexhës lidhet një grumbull tapash në formë trekëndëshe që tregojnë vend-hedhjen e mrexhës dhe ecurinë e saj. Gjuetia me mrexha bëhet në mënyrë individuale ose nga dy vetë që peshkatarët e quajnë «në vijac». Njëri peshkatar, vozitari, vo-

44) E. Çabej — *vep. cit.*, vëllimi i I. f. 386.

zit, tjetri «kariçagji», hedh rrjetën në drejtim të prirët me ujët. Me këtë lloj gjuetie zihet kubla e qefulli. Gjuetia në vijaç bëhet në pranverë dhe më pak në stinën e dimrit, pasi lumenjtë janë të rrëmbyer. Gjuetia në vijaç bëhet me disa kalatë (rruga e rrjetës nga vendi i hedhjes deri në kthim). Kjo gjueti bëhet duke ndërruar njëri-tjetrin ditën e natën.

18. — *Dajlanet*. Dajlan quhet prita në formë zikzake që i bëhet lumit në një ngushticë të tij për zënien e qefullit të ngjalës e të lloçës.

«Dajlanet në liqenin e Shkodrës dhe më vonë në rrjedhjen e lumit Buna dhe në kënetën e Mërtepsës janë të hershëm. ... Është e pamundur të thuash në ç'kohë është vendosur në këtë vend, mbasi dajlani është zhvendosur për arsye të vetë ndryshimeve të rrjedhës së Bunës. Megjithatë mendohet që ai ka ndryshuar pak nga koha e rrethimit të Shkodrës»⁴⁵. Kështu njihen emërtime të dajlanëve të vjetër si: «...Manuluk, Kapa-xhan, Kanavel, Myseriq, Aman, Kurrina⁴⁶, Marica⁴⁷.

Mbeturina të këtyre dajlaneve duken edhe sot e kësaj dite. «...Lëvizja e dajlaneve nga njëri vend në tjetrin shkaktohej nga inonadat e shpe-shta»⁴⁸ si dhe nga pozita e favorshme për peshkim. Duke qenë objekt ekologjik jo pa rëndësi për qytetin, siç e kemi thënë në hyrje të këtij studimi, ekzistenca e tyre dhe roli që kanë luajtur në ekonominë e qytetit kanë mbetur të shënuar në dokumentet e lashta të autorëve të ndryshëm kronistë, dijetarë e historianë.

Nga sa thamë më lart, del se fillimet e dajlanëve i gjejmë afër fshatit Shirokë. Nga fundi i shekullit XIX fillojnë të ndërtohen gjatë rrjedhës së lumit Buna, të cilët nga viti në vit i afrohen Urës së Bunës dhe u konsoliduan në mes të malit Tarabosh e të kalasë Rozafat. (Foto 1).




Foto 1

45) Fontanës M. — *art. cit.* f. 37.

46) Arkivi i Muzeut popullor Shkodër, fondi dorëshkrimi, dosje 72. f. 3.

47) Regjistri i Kadastrës etj., f. 125, fl. 114/6.

48) Arkivi i Muzeut Popullor — Shkodër, dorëshkrimi po aty.

Për të ndërtuar dajlanet zgjidhet vendi më i përshtatshëm, duke u nisur nga ngushtica e lumit si dhe nga sasia e peshkut të zënë për vite me radhë. Lënda e parë për të krijuar dajlanin është druri i lisit e i gështenjës, që merrej me porosi të peshkatarëve në pyjet e Krajës. Elementet e ndryshme të dajlanit marrin emra të ndryshëm sipas funksionit që kryejnë. «... Vendosja e tanishme e dajlanit gjendet 2 km nga derdhja e liqenit, tatëpjetë lumit... dhe pak përpara vendit ku Buna, para se të bjerë në fushë, bashkohet me Drinin»⁴⁹. Dajlanet ndërtohen në pjesë të ndryshme.

Kulcorë, mexe, mërtëkë, purtekë janë emra me të cilët quhen hunjtë me gjatësi 2,5 m, që vendosen vertikalisht. Janë element bazë për të krijuar pritën e lumit, që vishen me trinë me fije kërpi ose teli që të mos lejojë kalimin e peshkut nga lumi në det. Kulcorët dalin rreth 1 m sipër ujit.

Parikë, dërzhakë janë hunj, listela, binarë, që vendosen në dy anët e pendës së dajlanit në formë të pjerrët dhe që shërbejnë për të mbajtur krahët e dajlanit.

Horoz-ë janë hunj me gjatësi 3 m dhe shërbejnë për të lidhur kulcorët njëri me tjetrin duke u vendosur horizontalisht me ujin.

Rrëgozat punohen me frysë (bimë që rritet në brigjet e liqenit dhe të kënetës) dhe kanë përmasa të ndryshme sipas dëshirave të peshkatarëve. Ato shërbejnë për t'u vendosur ndër shtretër, për dysheme dhe për mbulojë duke u vendosur mbi derëzat e dajlanit për të bërë hije e për të dalluar hyrjen e peshkut në derëz. Punohen nga fshataret e Bregut të Bunës.

Trinat ndërtohen me thupra thane, shelgu ose mrine të njoma me teknikën e thurjes me përmasa 2 X 1 m. Trinat vendosen në faqen e pendës së dajlanit. Ato shërbejnë për të thurur krahët e dajlanit që të mos kalojë peshku nga lumi në det. Porositen nga peshkatarët sipas dëshirave të tyre tek fshatarët bregabunas.

Barbagami është tra prej lisi që vendoset horizontalisht në krahët e dajlanit e për t'i forcuar ato.

Fajkat janë dy trarë të trashë të ngulur në shtratin e lumit në distancën 5-6 m. dhe shërbejnë për të formuar grykën e dajlanit. Këtu vendosen dërrasa. Gjatë gjuetisë shërbejnë për të lidhur rraçat e dajlanit. Fajkat janë djathakë (djathtë) dhe sallake (e majtë).

Shulat janë trarë të mëdhenjë e të trashë që vendosen paralel njëri me tjetrin në grykë të dajlanit. jo më shumë se tri copë dhe shërbejnë për të forcuar grykën e dajlanit. Sasia e vendosjes së shulave është në varësi nga sasia e prurjeve të ujit.

Pela është një tra që vendoset në mes të grykës së dajlanit paralel me fajkat. Shuli forcon rraçën dhe i jep asaj mundësi për të krijuar mirë grykën.

Dollanikët janë binarë të gjatë, të cilët vendosen në mënyrë gjatësore në krahët e dajlanit. Trashësia e tyre është 5-6 cm.

Elemente të dajlanit janë: a) krahu i dajlanit, një gardh i formuar në lumë. Disa krahë në formë zikzake me gjatësi 60-70 m formojnë pendën

49) Fontanès M. — *art. cit.* f. 37.

e dajlanit; b) penda është elementi bazë për të bërë pengimin e peshkut që të kalojë nga lumi në det. Ajo formohet nga disa krahë të dajlanit. Penda ka formë zikzake duke filluar nga njëri breg në tjetrin. Është ndërtuar e fuqishme për t'u bërë ballë prurjeve të shumta të ujit nga shkrirja e dëborës; c) birat, derëzat, feneri janë të hapurat e krahëve të dajlanit me largësi 2 m njëra nga tjetra. Madhësia e derëzave (41x45 cm.) shërben për të kaluar peshku (qefulli), mbi ta vendosen shtretërit për gjueti; d) shtretërit në dajlan shërbejnë për të gjuajtur dhe për të depozituar peshkun e zënë. Shtretërit ngjasojnë më shumë me një kasolle (Foto 2). Numri i tyre është i kushtëzuar nga sasia e derëzave të vendosura



Foto 2

në pendën e dajlanit. Zakonisht në dajlan ka 40 shtretër; dh) gryka e dajlanit është hapësira në mes të krahëve të dajlanit me gjatësi 4-6 m. (Foto 3). Zakonisht në dajlan ka katër gryka të tilla, të cilat shërbejnë për të gjuajtur qefull, lloçë dhe ngjalë. Grykat e dajlanit kanë shërbyer dhe shërbejnë për të kaluar barka të mëdha nga lumi në det dhe anasjelltas. Duke folur për dajlanet e Shkodrës, Fontanes përmend 3 gryka dajlani të emërtuara «Gryka e anës së malit», «Gryka e madhe», «Gryka e babës».




Foto 3

Organizimi i punës në gjuetinë në dajlan.

Zakonisht në gjuetinë e peshkut në dajlan merreshin jo më shumë se 16 peshkatarë me përvojë, më të fuqishmit. Kryesisht ishin fshatarë nga Shiroka, Zogaj e Zusi e më pak nga qyteti i Shkodrës (Foto 4). Në



Foto 4

krye të tyre ishte kapiteni i dajlanit. Ai ishte një drejtues i mirë dhe peshkatar me përvojë, drejtonte dhe udhëhiqte të gjithë punën e dajlantarëve duke u përgjigjur para sipërmarrësit për të gjitha punërat në dajlan. Dajlantarët gjuajnë peshk në dajlan nëpër shtretër me kariqa, ruajnë grykat e dajlanit, ngrejnë e ulin rraçat gjatë gjuetisë, ruajnë pendët e dajlanit nga dëmtimet, hapin derëzat, fenerët e dajlanit, peshojnë peshkun e zënë dhe e transportojnë atë deri në skelën e peshkut (Foto 5). Gjuetia në dajlan fillonte nga muaji korrik deri në muajin mars të vitit




Foto 5

tjetër. Në këta muaj gjuhej qefulli i verës, i vjeshtës dhe i dimrit, lloça dhe ngjala, kurse në muajt e tjerë peshkatarët kishin të drejtë të bënin gjueti në vende të tjera. Në çdo shtrat gjuajnë dy peshkatarë me kariq «ço e ul». Një dajllantar nga më të mirët, vendoset për gjueti në kalimere, një peshkatar tjetër caktohet në ishull pranë kasolles së dajllantarëve për të ruajtur bazën materiale të peshkatarëve dhe dajllanin. Në përbërje të dajllantarëve ishte dhe një guzhinier dhe ndihmësi i tij. Dajllani blihej nga sipërmarrësi me afat 1-3 vjet. Shitja bëhej nga Bashkia e qytetit, pronë e së cilës ishte dajllani.

Për gjueti dajllantari qëndron i ulur në dyshtemenë e shtratit mbi një gur, e mban pa folur peshkun që do të hyjë në derëzën, fenerin, duke mbajtur kariqin të ulur. Uji këtu është i thellë 1-1,5 m. Peshkatarët më parë e kanë rregulluar shtratin e lumit në mënyrë të tillë që të mos ndryshojë nga mjediset përreth dhe peshku të gjejë një fund të këndshëm. Qefulli në tufë gjatë shtegtimit për në det ndesh në pritë (pendë). Ata kërkojnë një vend për të dalë në anën tjetër. Derëzat janë të hapura, qefulli hyn brenda, peshkatarin nga lart e shikon ose «...ndihmohet në këtë përgjim të kujdesshëm nga një instrument delikat të quajtur har-

dhen, që përbën një lëmsh të fillit të mëndafshit dhe më shpesh tani prej najloni, fildispanjë...»⁵⁰ dhe menjëherë e çon kariqin përmes derzhakut. Kështu në rrjetën e kariqit mbesin 7-8 qefuj. Peshkatarin me karvariq merr peshkun e zënë. Në këtë mënyrë gjuhet ditën dhe rralë natën, duke u ndërruar njëri me tjetrin. Gjuetia më e mbarë bëhet me kohë të mirë dhe të ngrohtë. «...Kur dajllani funksionon plotësisht ai ka shpesh 40 shtretër në aktivitet: atëherë arrin që të gjithë peshkatarët të zënë 3 ton në ditë».⁵¹ (Foto 6). Në raste furtunash e reshiesh të mëdha dajllanet mbyten dhe gjuetia e qefullit me kariq nuk bëhet më. Atëherë fillon gjuetia e ngjallës në gryka të dajllanit dhe bezhdebir me rraca.



Foto 6

50) Fontanës M. — *art. cit.* f. 38.

51) Fontanës M. — *po aty*, f. 39.

Peshkatarët jetojnë në dajlan për javë të tëra duke zënë një kasolle dyshe që u shërben atyre për të gjuajtur dhe për t'u ushqyer e fjetur. Shtretërit më të mirë janë ata që janë të vendosur pranë grykave.

19. — *Kariqi*⁵². Është mjet për gjuetinë e peshqve shtegtarë: njila, qefulli, gjuhca, ngjala. Me kariq gjuhet gjatë gjithë vitit. Kariqi gjen përdorim në liqenin e Shkodrës, veçanërisht në fshatin Zogaj, në lumin Drin, në lumin Bunë dhe në kënetë. Me kariq gjuetia bëhet ditën dhe natën, zakonisht në ujë të turbullt e të rrjedhshëm. Kariqi është mjet peshkimi i cili thuret me fije liri, kërpi, najloni, me syza të imta të ndryshme që ndryshojnë në varësi nga lloji i gjuetisë së peshkut. Rrjeta ka formë katrori me brinjë 1,5-2,5 m. Gjatë brinjëve përshkohet toja (litari) po nga kërpi që shërben për ta forcuar rrjetën. Brenat (mërtekë, purtekë) janë dy drunj prej shelgu ose ferrkuqeje të harkuar në formë gjysmërrethi dhe me gjatësi 2-3 m. Në qendër lidhen me litar duke krijuar një kryq, cepat lidhen me këndet e rrjetës. Në qendër të kryqit lidhet bishti (dërzhak, shul) me gjatësi 3-4 m dhe me diametër 7-15 cm nga druri i manit, i shelgut, i vidhit. Në majë të shulit lidhet levliari që është një fije spango ose tel që peshkatarin e mban në dorë dhe që shërben për të çuar e ulur kariqin. Gjuetia e peshkut me kariq në gjithë rrejtin ujon të Shkodrës ndeshet në tre mënyra: a) gjuetia në avarde, b) gjuetia në kalimere, c) gjuetia në dajlan.

a) *Gjuetia në avarde* që bëhet afër bregut të lumit në ato vende ku uji




Foto 7

krijon «gjirin». Shpesh peshkatarët përdorin degë të pemëve për të krijuar gjirin duke i vendosur ato në një rën anë. Gjiri është i mirë me ujë të thellë e të turbullt si dhe me rrjedhje të lehtë. (Foto 7). Peshkimi me avarde bëhet gjatë gjithë vitit ditën dhe natën, por më shumë në stinën e vjeshtës dhe pranverës. Peshkatarin më parë, në breg të lumit, mbi ujë, ndërton një shtrat për gjuetinë e peshkut, për të mbajtur mjetet e punës dhe të fjetjes. Gjuetia në avarde bëhet «ço e ul». Secili peshkatar ka avarden e tij dhe nuk ka të drejtë të gjuaj në avarde tjetër. Shtretërit ndryshojnë nga njëri-tjetri. Madhësia e tyre është në varësi nga madhësia e gjirit. Në përgjithësi mbi shtrat ndërtohet një kasolle për të mbrojtur peshkatarët nga reshjet dhe nga dielli.

b). *Gjuetia me kalimere* është e njëllajtë si në gjuetinë me avarde, por ndryshon nga fakti se shtrati vendoset disa metra para dajlanit. Shtrati

52) Sheldija Gj. — art. cit. f. 32

është më i madh se në avarde dhe në dajlan. Në kalimere bëhet gjuetia e qefullit. Kjo lloj mënyre është përcaktuesi më i mirë nëse gjuetia në dajlan do të jetë e mirë ose jo. Shpesh ka ndodhur që gjatë gjuetisë me kalimere brenda ditës të zihet peshk më shumë se në tre shtretër të marrë së bashku. Kalimerja është mjet i lashtë peshkimi, sezonal, vetëm në gjuetinë e qefullit në dajlan. Kalimeren e ndërtojnë për gjuetinë caktohet peshkatari më i mirë.

20. — *Rraça e dajlanit*. Është mjet peshkimi në grykën e dajlanit dhe në bezhdebir për zënien e ngjalës, të qefullit dhe të lloçës. Rraça është mjet për gjueti sezonale. Ajo përbëhet nga gryka, feneri që ka formë katrore me madhësi sa gryka e dajlanit (4 m). Brinjët anësore quhen «boks»⁵³, ndërsa dy brinjët e tjera «shtrat»⁵⁴. Trupi është gjatësia e rraçës nga gryka, feneri deri tek cupjeli, i cili është në trajtën e një trungu piramide me gjatësi të ndryshme. Cupjeli quhet thesi me syza më të imta se trupi i rraçës dhe ka formë cilindrike. Gjatësia e tij është në varësi nga gjatësia e trupit të rraçës. Sa më i madh të jetë trupi i rraçës aq më i madh është cupjeli. Brenda në cupjel janë vendosur 2-3 fenerë që kanë formën e trupkonit. Feneri është i vendosur ballëpërballë me grykën e rraçës. Ato zvogëlohen njëri pas tjetrit. Rraçat hidhen vetëm natën dhe nxirren në mëngjes. Në gjueti të mbarë zihen deri në 150 kv ngjalë. Gjuetia bëhet kolektive.

21. — *Bezhdebiri*. Është vendi për gjuetinë e ngjalës. Gjuetia bëhet në periudhën e shtegtimit të saj për në det, në muajt shtator-nëntor kryesisht natën, në kohë të keqe me rrjetë rraçë. Bezhdebirët më të mirë janë pas grykave të dajlanit deri në Zall të Cungut (përballë fshatit Zus). Bezhdebirët janë prita të ngritura në ngushticat e lumit Bunë. Ato ndërtohen nga disa gryka. Në çdo grykë lidhen rraça, numri i të cilave varet nga gjerësia e pritës së krijuar. Në traditë bezhdebiri ka qenë pronë private e më vonë kaloi në sipërmarrje. Në gjuetinë me bezhdebir raporti është 5 me 1, d.m.th. «... këta i pagujshin sipërmarrësit 20%»⁵⁵. Gjuetia bëhet në mënyrë kolektive dhe është mjet tepër rezultativ.

22. — *Tratë (tratkë)*. Është një lloj rrjete e madhe prej kërpi liri ose najloni. Madhësia e syzave të tratës ndryshon nga lloji i gjuetisë. Me këtë mjet gjuhet gjatë gjithë vitit çdo lloj peshku. Është mjaft e përhapur. Gjuetia bëhet në mënyrë kolektive nga 6-10 peshkatarë gjithashtu edhe me motobarkë. Ky mjet ka rendiment të lartë në gjuetinë gjuhçës. Mjeti hidhet nëpër «vahe» të ndryshme. Trata fillon me 1000 syza që quhen «thes» dhe mbaron me 206 syza që quhen «dragë»⁵⁶. Përbëhet prej një litari shumë të gjatë që shërben për të tërhequr tragën në breg. Dragat janë dy drunj gështenje 1,20 m që shërbejnë për të mbajtur në ekulibër tratat si tek rrëshanëza. Trata hidhet afër bregut në formë rrethi duke rrethuar një zonë të caktuar, që varet nga madhësia e tratës. Katër deri pesë peshkatarë tërheqin rrjetat nga cepat e tyre duke ngushtuar në këtë mënyrë sipërfaqen e rrethit. Një peshkatar nga lundra qëndron

53) Sheldija Gj. — art. cit. f. 31.

54) Sheldija Gj. — po aty.

55) Sheldija Gj. — art. cit. f. 31.

56) Sheldija Gj. — po aty, f. 408.

prapa tratës dhe me rrema godet ujët për ta detyruar peshkun që të hyjë në thes. E gjithë rrjeta hidhet në breg, pasi ka mbetur peshku në të. Peshkatarët e marrin me karvariq. Ky veprim përsëritet disa herë. Kjc mënyrë peshkimi përdoret në gjuetinë e krapit, (që në këtë rast rrjeta fillon me 100 syza dhe mbaron me 50 syza). Kjo lloj gjuetie quhet «në rrethim» nga peshkatarët e Bregut të Bunës. Rrjeta në këtë lloj gjuetie «... është e gjatë 150-200 m dhe 60 m e gjerë». ⁵⁷ Në tratën e kublës rrjeta fillon me 40 syza dhe mbaron me 45 m gjatësi 250-300 m:

23. — *Traktakoçë*⁵⁸. Është një rrjetë e madhe kërpi ose liri. Me anën e saj gjuhet gjatë gjithë vitit në liqenin e Shkodrës duke e tërhequr me motobarkë. Traktakoça përdoret kryesisht për zënien e krapit. Kur hapet për gjueti, traktakoça merr formën e një poçi të madh me 4 lloje syzash duke filluar nga 34 mm e duke mbaruar me 8 mm. Në poçin e traktakoçës janë të lidhur feneri (gryka) si në gjuetinë me pinar. Kështu peshku i rrethuar hyn në fenerin e traktakoçës dhe nuk di të dalë. Gjuetia bëhet ditën dhe natën. Gjatë natës duhet pajisur me dritë 12-14 qirinj. Duke qenë se traktakoçës i ndryshojnë syzat gjuetia bëhet për shumë lloje peshqish.

III. — Pajisje e mjete pune dhe lundrimi të peshkatarëve.

Liçari është mjet ndihmës i peshkatarëve i cili i shëben atij për të depozituar peshkun e zënë (krap, karas, mlysh) dhe për t'i mbajtur ata të freskët për disa ditë. Liçari është një litar kërpi ose liri me gjatësi të ndryshme deri në 5 m. Gjatësia e liçarit varet nga lloji i peshkut. Peshkatarë e mban atë gjithnjë me vete. Litari në njërën anë është i lidhur me një dru 10-15 cm i gjatë, me diametër 3-5 cm. Mesi i drurit ka një të thelluar që shërben për të lidhur litarin. Në anën tjetër të litarit vendoset një dru i punuar në trajtën e gjilpërës së duhanit. Peshku i zënë peshkohet në liçar. (Skica 14).


Karvariqi ose kacari. Është mjet pune i peshkatarit i përhapur në të gjithë rrjetin ujqor të Shkodrës dhe që përdoret gjatë gjithë vitit. Ai shërben për të marrë peshkun e zënë nga të gjitha llojet e mjeteve të peshkimit e sidomos nga rrjeta. Ka formën e një rakete tenisi. Në perimetrin e rrethit lidhet rrjeta me syza të imta. Rrjeta formon kështu një kon që ndryshon nga madhësia në varësi nga lloji i gjuetisë së peshkut.

Karvariqi bëhet me dru mani, fojlete, vidhi ose ferrkuqeje. Siç e thamë më lart, madhësia e karvariqit ndryshon, por më i përhapuri është me diametër 60-70 cm dhe bishti me gjatësi 80-100 cm (Skica 15).


Si pajisje vetjake peshkatarët mbajnë me vete dhe tangare, mushama, pantallona (beze e lyer me vaj liri), të cilat vendosen mbi këpucë; kapuç (beze e lyer me vaj liri), vela, dyrek, sakic, thika, arkë qymyr, komplet kafeje, arkë buke dhe objekte të fjetjes, objekte të kuzhinës (saxhak, mashë, gradelë-zgarë).

57) Çabej E. — *vep. cit.* vëll. II, f. 192.

58) Çabej E. — *vep. cit.* vëll. I, f. 386.



14. Ljqani



15. Karvariqi, kacari

Si vegla për gjuetinë e peshkut mbajnë njicë, plumç, shtrat grepash, fuzhnje, kariq, pupunjicë, tratë zalli, tapa, rrijella, spoli (enë druri me bisht) që shërben për të hequr ujin nga lundra), armë zjarri. Si vegla ndriçimi përdoren fener karbiti, fener me vajguri, elektrik dore.

Mjete të lundrimit. **Take** — mjet lundrimi që përdoret kryesisht nga peshkatarët e dajlanit, 8-10 m gjatësi.

Takicë — mjet lundrimi i ngjashëm me taken, por më i vogël se ajo.

Sule — mjet lundrimi i manovrueshëm dhe praktik që përdoret nga të gjithë peshkatarët, me gjatësi 3 m.

Ferket — mjet lundrimi si sulja, me dy pope, pa kiç, më i gjerë në fund se në brinjë.

Lundër — mjet lundrimi si sulja e madhe, por me një pope të zgjatur fort që përdoret në gjuetinë e peshkut por edhe për transportin e mallrave, me përmasa 12-15 m e gjatë, transporton deri në 50 kv mall. Lundra është mjet tipik në lundrim nga krajanët.

Lundrica — mjet lundrimi si lundra, por më e vogël.

Trupicë — mjet lundrimi si takica, e ndërtuar nga një trup lënde fojlete ose mani të gdhendur, përdoret vetëm për gjueti nga fshatarët e bregut të Bunës me 1 ose 2 peshkatarë.

Koritë — lundër që përdoret zakonisht për transportin e mallrave, vozitet më shumë me shtysa se sa me rreme, gjithmonë afër bregut.

Stankë — trupicë.

IV. — Parashikimi i kohës dhe lloje erërash

— Kur dalin retë mbi malin e Taraboshit dhe e mbulojnë atë, peshkatarët parashikojnë prishje të motit.

— Kur hëna në buzë të mbrëmjes është e plotë dhe përreth saj ka ngjyrë të purpurt, ka qëndrueshmëri dhe mot të mirë.

— Në mot zagushi dhe kur ujërat e liqenit avullojnë me dendësi parashikohet mot i mirë.

— Nëse shihet qartë bregu nga bregu dhe ka pastërti shikimi menjëherë pas shiut, ka përsëri prishje moti.

— Nëse këndojnë mbrëmjes gargaliqat (bretkosa), pritët prishje e motit.

— Nëse pulëbardhat fluturojnë lart mbi liqen në mënyrë të çrregullt dhe duke kënduar, pritët prishje moti.

— Kur pickojnë mizat në lundër, ka ndryshim moti.

— Kur fryn erë terri dhe liqeni vende-vende nxihet, prishet moti.

— Kur fluturojnë dallëndyshet poshtë, paralel me pasqyrën e ujit, prishet moti.

— Kur fluturojnë insektet në grumbuj dhe afër pasqyrës së ujit, prishet moti.

— Kur gjuhcat e vogla hidhen lehtë mbi ujë, ka prishje moti.

— Kur bie vesë, mban mot i mirë dhe ka gjueti të mbarë.

— Kur sipërfaqja e liqenit është diku e qartë dhe diku me valëzim të lehtë, pritët ndryshim ere.

— Kur i afrohen bajuklat (lloj shpendi) Urës së Bunës dhe molës, pritët ndryshim i menjëhershëm i motit me reshje dhe me erë të fortë.

— Kur zihen shojza në verë dhe në vjeshtë, dimri do të bëjë i ftohtë.

— Kur ke të ftohtë në shputat e këmbëve, bie borë.

Lloje erërash

Ashtër — erë deti.

Borë — erë që fryn nga verilindja.

Denik — erë shiu e fortë, është erë deti⁵⁹.

Duhi — erë e marrë, furtunë, (shtrëngatë⁶⁰).

Erë jugu — erë deti, sushë, sjell batica të mëdha.

Erë Kraje — fryn më lehtë se veriu, është gati si kurrina.

Erë e keqe — erë terri dhe me murla Drishti.

Erë terri — erë me drejtim perëndimor⁶¹, fryn në kohë të drekës; është erë shumë e fortë dhe e ftohtë, sjell shumë dallgë; fryn më shumë në stinën e dimrit dhe të pranverës.

Erë mali — murra⁶².

Erë dielli — erë që fryn nga lindja, rreth orës shtatë ose tetë të mëngjezit.

Erë deti⁶³ — ashtër

Erë Ulqini — fryn nga veriperëndimi, zakonisht kur pushon murlani.

Erë lindje — levandë.

Erë e marrë — duhi.

Furtunë — duhi.

Erë e zezë — shtjellzë.

Garbi — erë perëndimi që fryn nga Mali i Zi; mban perkohësisht kohë të mirë; fryn gjatë dimrit e në pranverë; është erë e fortë, e ftohtë dhe me vrrull; godejçë, garbi.

Godejçë — erë e perëndimit⁶⁴.

Gurric — quhet edhe erë mali⁶⁵, fryn nga verilindja dhe është murlan i vërtetë.

Gjzë — është gati si kurrinë, por ndryshon për faktin se gjeza fryn me mot të keq në drejtim të veri-verilindjes.

Gjaz — lloj ere e liqenit, e dobët, fryn nga veriu në perëndim; sjell dhe e mban motin mirë.

Joshtër — erë e detit që prish të lashtat e bimë të tjera. Është e njëjtë me joshtrin. Erë jugperëndimore e keqe për lundrim dhe e dëmshme për ullinjtë.

59) Çabej E. — *vep. cit.* vëll. II, f. 114.

60) » » *vep. cit.* vëll. II, f. 174.

61) Rakaj Nd. — «Emrat e peshqve dhe organizmave të ujit. Emrat shqip të disa peshqve, Bul. USHT Seria e shkencave natyrore Tiranë 1970. f. 14.

62) Rakaj Nd. — *po aty.* f. 14.

63) Sheldija Gj. — *art. cit.* f. 414.

64) » » — *art. cit.* f. 413.

65) Rakaj Nd. — *art. cit.*, f. 14.

Jugë e bardhë — si erë lezhjane.

Kurrinë — erë që fryn në drejtim të veriut. sidomos në verë e me kohë të mirë⁶⁶, fillon në orët e para të mëngjesit dhe pushon nga ora 14. duke ia lëshuar vendin karajelit; është veriu i dobët, ka gjueti të mbarë, sepse peshku «shtrohet në kullosë».

Kurilë — si kurrinë⁶⁷ (e merr emrin nga mali i Kurilës).

Karajel — është erë e lehtë. e shtruar. zakonisht fryn në stinën e pranverës e deri në fund të verës; mban mot të mirë dhe në mëngjes bie vesë, fryn deri në orët e vona të natës; fryn nga gryka e Bunës në drejtim të perëndimit dhe në këtë orë bëhet gjuetia e kublës.

Kolfiun — erë deti, garbi, erë jugu, erë terri, sushë, quhet dhe «erë vape»⁶⁸.

Levantë — erë lindje që sjell ndryshim të përkohshëm të motit, fryn në mbremje duke ia lënë vendin kurrinës.

Maistro — karajel⁶⁹.

Malunëz — erë paralajmëruese për një kohë të keqe⁷⁰, oshtër.

Mimalëz — erë që fryn para se të priset moti, duke grumbulluar retë mbi malin e Taraboshit dhe që sjell reshje.

Murra, murla — erë e ftohtë e veriut⁷¹, e rumbit veri-verilindor që sjell mot të mirë dhe të ftohtë.

Mol — murla.

Murla fushe — erë e ftohtë, por me mot të mirë.

Murla Drishti — erë e keqe.

Murla i zi — erë e rumbit të lindjes, fryn me mot të vrënjtur, sjell borë në male, reshje e cingërimë në fusha.

Oshter — malunëz.

Rapçë — erë që fryn nga Hoti në drejtim veri-jug në stinën e dimrit.

Sakanak — era e shirokut dhe e shtjellzës në momentin më të furishëm; çdo vrull erë (hov) quhet sakanak⁷².

Stohi — furtunë, shtërngatë, duhi.

Shirok — është erë e rumbit jug-juglindor⁷³; sjell reshje me batica të mëdha; erë jugu; kur fryn kjo erë bëhet gjueti e mbarë, sepse shiroku «e shtron peshkun në kullosë».

Shtjellëz — shtrigë uji; fryn me shirok; është me sakanak; quhet dhe trumë ere; sakanaku vërtit në ajër një masë uji në formën e një shtjellëze që merr çdo gjë që gjen përpara.

Susbë — erë jugu, erë deti, erë terri.

Tenik — erë e freskët dhe e këndshme. fllad; është e kundërta e denikut.

Torolake — murla i keq që fryn furishëm, në kohë të shkurtër duke përfshirë çdo gjë që gjen përpara.

Tivareshtë — është erë e lehtë, gati si oshtër, që mban mot të mirë.

Trumë ere — shtjellzë.

66) Rakaj Nd. — *Art. cit.*, f. 15.

67) » » *po aty*.

68) » » *po aty*.

69) » » *po aty*.

70) » » *po aty*.

71) Çabej E. — *vep. cit.* f. 354.

72) Rakaj Nd. — *art. cit.* f. 18.

73) » » *po aty*.

Tym ere — shtjellzë.

Veri — erë që fryn zakonisht në vjeshtë, në dimër e në pranverë, e ftohtë dhe e thatë.

Veri i vogël — kurrinë gjatë së cilës shtrohet peshku në kullosë.

Veri Podgorice — erë e ftohtë dhe e thatë që merr emrin nga drejtimi.

V. — Zakone, bestytни dhe rite të peshkatarëve

— Peshkatarët gjatë gjuetisë nuk i jepnin shokut litarin në dorë, por e hidhnin në ujë, kështu që shoku ishte i detyruar ta merrte atë nga uji.

— Kur zihej kubla për herë të parë dhe peshku sillej në shtëpi, e zonia e shtëpisë e tërhiqte zvarrë nga dera e oborrit deri te dhoma me oxhak, ku aty e lyente me hi duke e ndjellur në këtë mënyrë mbarësinë e gjuetisë për hapjen e sezonit të gjuetisë së peshkut.

— Kur peshkatarë dilte për gjueti, e zonia e shtëpisë gjuante me hi ose me ujë për të ndjellur mbarësi. Edhe gjatë gjuetisë ky veprim bëhej nga vetë peshkatarët, por me ujë.

— Gjatë gjuetisë, kur lindte nevoja për të transportuar udhëtarë nga njëri breg në tjetrin, udhëtarët këpusnin nga një dorë bar të cilin e hidhnin në lundër, para se të zbrisnin. Para se të niseshin në gjuetinë e kublës peshkatarët e fshatrave Shirokë e Zogaj blinin simite dhe ua shpërndanin fëmijëve të fshatit në shenjë mbarësie.

— Gjatë gjuetisë në dajlan vinin shpesh mysafirë; dajllantarët shtronin dreka dhe darka, ku mysafiri gostitej me qefull të pjekur. Gjatë gjuetisë në dajlan peshkatarë që zinte dallkiçin, «qefulli që prin në tufë», ia dhuronte peshkatarit më të vjetër ose kapidanit të dajllanit.

— Kur peshkatarët gjatë gjuetisë i ka zënë era e fortë («shtjellëza»), dy-tre peshkatarë kanë qëlluar me armë në drejtim të saj për ta «vrrarë».

— Gjuetia bëhej në qetësi, pa zhurmë dhe peshkatarët nuk shanin.

— Shpesh në fshatrat Zogaj e Shirokë, me hapjen e sezonit të gjuetisë së peshkut, të gjuhçës e njilës, peshkatarët organizonin dreka dhe darka që ata i quanin «festa e gjuhçës» ose «festa e njilës»; përmes këtyre drekave peshkatarët bënin shakara, tregonin ngjarje të ndryshme nga jeta e tyre në gjuetinë e peshkut, duke dhënë përvojën e tyre të jetës.

VI. — Frazologji dhe terminologji të peshkatarëve

Udha për ta! — gjueti të mbarë!

qëllofsh! — zënsh peshk!

bereqet i trashë — thuhet ku zihet peshk me bollëk.

bereqet i holl — e kundërta e «bereqet i trashë».

ogur — pasthirrmë gëzimi kur zihet në fillim të gjuetisë mlyshi, njila e krap.

a po t'i bien? — në kuptimin «si shkon gjuetia».

a po e prek? — shih «a po t'i bien».

as s'e prek? — nuk ka gjueti të mbarë.

ia ka njitë — kur peshku ka mbetë në grep.

i ka ra — shih «ia ka njitë».

asht therë — kur grepi ka kapur peshkun në gjueti me grepa.

- e lëshoj çimi** — në gjueti me fuzhnje kur krapit ik nga maja.
mos t'mastortë! — zënsh peshk sa të duash, me bollëk.
ka rrah krapit — kur krapit bën riprodhimin në pranverë. Është e njëjtë me «po rreh krapit», periudha më intensive e zënies së krapit.
ka qorru (verbu) — përdoret që qefullin që zihet në muajt dhjetor, janar, shkurt, i cili nga të ftohtit del mbi sipërfaqe të ujit dhe kapet lehtë.
qefull i mërdhitun⁷⁴ — qefull i qorrum.
asht shtru në kullosë — përdoret kur krapit hyn në livadhe të mbytura për ushqim; këtu bëhet edhe gjuetia e tij.
asht zanë njalë dajlani — njalë migratore e cilësisë së mirë.
asht zanë njalë bahçe — njalë vendi, kënetë, me cilësi më të dobët, më e hollë.
a mreh peshku — grumbullimi i një mase peshku për të pushuar.
u ndalem në va të pushimit — kur peshkatarët për disa orë nuk gjuajnë.
ka burdullue — valëzimi që shkakton qefulli në sipërfaqe të ujërave të turbullta duke lëvizur me anën e pendëve valën, në vjeshtë, në kohën e reshjeve e të vërshimeve të mëdha⁷⁵.
Kerrni i qefullit — shih «ka burdullue».
asht zanë peshk kokllon — kur zihet peshk në ujë të cekët e në baltë (llucë).
asht zanë rropulli — peshkëzënie me cilësi të dobët; njilë, lloçë, skortë, bercak etj.
iku vallja e parë — përdoret zakonisht në gjuetinë e ngjalës në dajlan e në bezhdebir, mbas një nate me erë, vetëtimia e shkrepitima të motit.
kocat i kam me një ose dy valë — kur kocat ndërtohen njeri afër bregut dhe tjetri në livadh me qëllim që gjuetia të bëhet vazhdimisht.
u ndal në va të pushimit — përdoret edhe për tufën e peshkut; shih «a mreh peshku».
a ndry peshku në vath — peshku është rrethuar në gjuetinë me rrëshanëza në oborrin e kocës.
tuj rrah putarkën⁷⁶ — shih «po rreh krapit».
ka ajam⁷⁷ — ka qejf, ka dëshirë, joshet.
kena ba shumë kalatë — quhet distanca në gjuetinë në vijaç nga vendi i hedhjes së rrjetës deri në nxjerrjen e rrjetës.
u zgjedhën dajlanet⁷⁸ — u vendosën se ku do të ngrihen dajlanet.
kena gjuejt vijaç⁷⁹ — përdoret në gjuetinë e kublës me mrexha.
asht mbyllë dajlani — periudha kur në dajlan nuk gjuhet peshk.
kur çilet dajlani — hapja e sezonit të gjuetisë së peshkut.
janë mbyt dajlanet — gjatë reshjeve të mëdha e të menjëhershme Drini ndryshon rrjedhën e Bunës në kah të kundërt në drejtim të liqenit. Ky proces mund të vazhdojë për disa orë e ditë rresht.
asht thye Buna — përdoret kur Buna ndryshon rrjedhën e vet, gjë që ndodh kur ka prurje të mëdha uji lumi i Drinit.

74) Fontanës — *art. cit.*, f. 3975) Rakaj, Nd. — *art. cit.* f. 17.76) Sheldija Gj. — *art. cit.* f. 300.77) » » — *art. cit.* f. 300.78) » » — *art. cit.* f. 30.79) Bisha A. — *art. cit.* f. 265.

ka thye qafën Drini — procesi i kundërt i thyerjes së Bunës.

rrëshqet Buna — në stinën e pranverës dhe të vjeshtës, kur liqeni është shumë i ngarkuar me ujë, lumi Buna kryen procesin e shkarkimit duke rrjedhur me shpejtësi dhe duke ulur nivelin e ujit në mënyrë të ndjeshme.

po don koha — momenti i ndryshimit të motit, ndodh pikërisht kur pushon shiroku dhe fillon e fryn murlani.

u hap koha — shih «po don koha.»

u terrue — vranësimi i plotë i qiellit.

ditë ose natë e ligë — kur gjatë gjithë ditës ose natës bën të ftohtë me erë e shi.

kanë dal tumllat e pranverës — dalja e reve të vogla e të bardha në pranverë mbi malin e Taraboshit.

po presim tërrnaqet e hanës — po presim ndryshimet e hënës.

dolën tufulaqet — dalja e reve të vogla dhe të zeza që lajmërojnë prishje moti.

shtroj era⁸⁰ — va në liqen ku nuk merr era.

i ka zanë torolakja — i ka zënë furtuna.

a mbyll gryka — thuhet kur pritet kthim ere dhe ndërrim kohe i shpejtë, që sjell reshje shiu të menjëhershëm.

ka vue çallem Taraboshi — maja e malit të Taraboshit është mbuluar me një masë mjegulle.

llaç — si ka vu çallem Taraboshi.

ka liqeni qiqlk — është mot me zagushi.

tallaz veri — fryn veri shumë i fortë.

asht ba uji amulli — kur turbullohet uji në vende të vogla me ujë të cektë e me barishte.

uji i vram' — ujë pak i turbullt vende-vende në liqen që shkaktohet nga veriu i lehtë.

ujë i therun — ujë i vram.

ujë mazull⁸¹ — ujë që del në breg nga batica ose nga ndonjë ndërhyrje tjetër dhe që nuk ka lidhje me lumin, është i qartë dhe i nxehtë.

ujë bunac — ujë shumë i qartë kur nuk fryn asnjë lloj ere dhe nuk ka asnjë valëzim në sipërfaqen e tij.

ujë bricë — si bunac, por pritet ndryshim ere.

uji i cemtë⁸² — i ftohtë.

si uji si bira briz — mjedisi para derëzave të dajlanit është i ndërtuar me shumë kujdes që të mos dallohet asgjë e sajuar për zënie qefulli.

zablato — prishet uji në formë rruazash në vendqëndrimin e gjuhçës.

adë⁸³ — njësia e formuar nga prurjet e lumenjve, vendqëndrimi i peshkut për lëshimin e vezëve; kjo njësi gjendet midis grykave të Bunës.

bazhgare⁸⁴ — kashta e kallamave dhe e gjetheve që sjellin ujërat në kohën e reshjeve, që formon një shtresë ose njësi kompakte, e cila qëndron mbi ujë dhe noton mbi të si një re e zezë. Dëmton dajlanet dhe rrjetat e peshkimit gjatë gjuetisë, sidomos gjatë rrjedhës së Bunës.

80) Sheldija Gj. — *art. cit.* f. 19.

81) » » *po aty.*

82) Çabej E. — *vep. cit.* f. 89.

83) Rakaç Nd. — *art. cit.* f. 15.

84) » » *po aty.*

- rrel**⁸⁵ — një vijë uji ose avarde e vjetër të cilën e ka mbuluar dheu, në të cilën është e pamundur gjuetia e peshkut.
- brrokë, brrakë**⁸⁶ — vend me ujë amulli.
- maraxhë** — shih bazhgare.
- avarde** — shih gjuetia në avarde.
- fosa**⁸⁷ — vend i thellë në va, që nuk shterr.
- gomna** — vend me ujë të thellë që ka lidhje me lumin.
- syza** — sipërfaqja e hapësirës që formon kuadratin e rrjetës.
- ka kriju rrjeta bulshi** — thuhet kur rrjeta është e fryrë.
- asht ba rrjeta trin** — rrjeta ka qëndruar drejt (e tërhequr).
- asht ba rrjeta shuk** — është ngatërruar rrjeta (kur fryn veri ose shirok i fortë).
- armatis rrjetën** — lidh dhe shtrëngoj rrjetat.
- sacipoj** — armatis.
- me kopot**⁸⁸ — lidhja e rrjetës së grisur por pa formuar syze.
- qitet tratka** — hidhet për gjueti.
- ço e ul**⁸⁹ — përdoret në gjuetinë me kariat në kalimere, në avarde dhe në shtrat të dajlanit.
- mëzet**⁹⁰ — mbush grepat me llojin e ushqimit.
- koj** — mëzit.
- ri grepat** — mëzit.
- me ndej kariat**⁹¹ — përdoret në dajlan kur peshkatarët nuk gjuajnë.
- hapet ose mbyllet voprazi** — këndi që krijon maja e grepit ose e fuzhnjes.
- kallaftoj**⁹² — mbush të çarat e lundrës me rubë.
- ruboj** — shprish litarin e kerpit.
- me kaltue** — kallaftoj.
- kep** — niveloj dërrasat e lundrës me sqepar.
- pait**⁹³ — pastroj kallamat dhe rrjetat e dajlanit nga prurjet e ujërave ose nga lëmashku që është krijuar gjatë qëndrimit të mjeteve të peshkimit në ujë.
- tajon**⁹⁴ — hyn uji në lundër përmes të çarave të saj.
- lëmashk**⁹⁵ — bimësi e imtë që zhvillohet në gurë, drunj e objekte të tjera nën ujë.
- kena sigurue cakun**⁹⁶ — kur peshkatarin është caktuar për të gjuajtur peshk në dajlan.
- dajlantar** — peshkatarin që gjuan peshk në dajlan.
- kapidani i dajlanit** — kryemjeshtri peshkatar në dajlan.
- kariatqaxhi** — peshkatarin që gjuan peshk me kariat.

85) Rakaj Nd. *art. cit. f. 18.*

86) Çabej E. — *vep cit. f. 64.*

87) Bisha A. — *art. cit. f. 261.*

88) Rakaj Nd. — *art. cit. f. 18.*

89) Sheldija Gj. — *art. cit. f. 27.*

90) Rakaj Nd. — *art. cit. f. 18.*

91) Sheldija Gj. — *art. cit. f. 27.*

92) Rakaj Nd. — *art. cit. f. 18.*

93) » » — *po aty, f. 17.*

94) » » — *po aty, f. 18.*

95) » » — *po aty, f. 17.*

96) Sheldija Gj. — *art. cit. f. 30.*

shtrataxhi⁹⁷ — dajlantar

kasollja e dajlantarëve⁹⁸ — vendi ku rrijnë për të fjetur e peshkuar dajlantarët; ndodhet në ishullin në mes të dajlanit.

në skelë të peshkut — vendi ku ankorohen lundrat për shkarkimin dhe shitjen e peshkut.

gumën⁹⁹ — litar i trashë me diametër mbi 50 mm që përdoret për të lidhur barkat në mot të keq

parik¹⁰⁰ — rrema të vegjël me të cilët vozitet në lundër, sule, trupica.

shamerdan¹⁰¹ — shtypës i madh prej druri që përdoret për të rrahur ose ngulur kulcoret, sidomos kur ndërtohen dajlanet.

drangë — trotë.

petk — njiçë.

shujka, shkujka¹⁰² — hunj të ngulur në tokë në breg të lumit ose të liqenit që shërbejnë për të hapur rrjetat për pastrim.

bokt — rraça e dajlanit.

sixhim — fije kërpi me të cilin lidhet «rrijella».

Rrijella¹⁰³ — lloj bime në trajtë kallami që rritet në brigjet e liqenit. Në gjëndje të thatë formon një trekëndësh. qëndron sipër ujit dhe tregon vendin ku është hedhur mjeti i peshkimit.

rrema — lopata për të vozitur mjetin e lundrimit.

tojë — litar kërpi, liri, që përdoret për të lidhur rrjetat gjatë procesit të përgatitjes së mjetit të peshkimit.

levlar — unazë druri që shërben për të çuar e ulur kariqin.

shuli — hu 3-4 m që përdoret për daljen gjatë ndërtimit.

fushqel — hu i gjatë 3 m i drejtë (shih kariqin).

dërbhakë — shih ndërtimi i dajlanit.

ndrejt — huj që ngulen në tokë për të krijuar konstruktin e kasolles së dajlanit.

rrfana¹⁰⁴ — litari që krijohet nga thuprat e shelqes, i cili fiksohet në kosh.

fuliz¹⁰⁵ — gryka që ndodhet në kosh përmes së cilës peshku mund të hyjë në pjesën e brendshme të saj.

hunjt e koshit¹⁰⁶ — thuprat e shelqes që shkojnë nga lart-poshtë për ndërtimin e koshit.

breza¹⁰⁷ — thuprat periferike të koshit.

shqype¹⁰⁸ — dru shelgu ose mrine, i kthyer në formë të një kulari, që shërben për të lidhur kulcoret me palcorët.

vister — masë peshku gjuhce zakonisht e njomë ose e tharë e përshtuar në një fije bari, shelgu ose kërpi me peshë 1.2 ose 3 kg.

karrigë — mjete prej liri për të zënë peshq të vegjël.

sakë — rrjet liri për peshq të vegjël.

97) Shedijska G. — *art. cit.* f. 27.

98) Shedijska G. — *art. cit.* f. 28.

99) Rakaj Nd. — *art. cit.* f. 16.

100) » » — *po aty*, f.18.

101) » » — *po aty*, f.18.

102) Shedijska G. — *art., cit.* f. 409.

103) Shedijska G. — *po aty*, f. 410.

104) Nopcsa F. — *vep. cit.*, f. 113.

105) » » — *po aty*.

106) » » — *vep. cit.*, f. 113.

107) » » — *po aty*.

108) Fontanez — *vep. cit.*, f. 38.

VII. — Emërtimi i vendeve (vaheve) kryesore të gjuetisë së peshkut

— Liqeni i Shkodrës

Shirokë. Zogqj, Vau i Kokës, Vija e Zezë. Bisht i qindisë, Vau i Flakës, Vau i Rrasave, Vau i Zarufës, Vau i Vrakës, Vau i Ligatës. Përroni i Vrakës, Liqeni i Hotit, (bishti i liqenit që futet në fshatin Hot). Shagoricë. Vau i Virit, Patok. Qoparic e Madhe, Qoparic e Vogël, Vau i Pragut, Shelqa e Zogjëve, Vau i Kazanit, Vau i Gjikës, Syni i Gjonit, Vija e Has Beqirit, Shkježë, Te Ullini i Vetëm, Te Vorri i Lajes, Vau i Ages, Para Shaqes, Vau Urban. Para Pontit. Te Gonxhja e Fratit, Vau i Pavacëve, Mbas Prrojeve. Para Prrojeve, Mrines e Madhe, Mrines e Vogël. Mbas Rrasave. Tek Kallami. Te Syni i Zi, Në Vukpalaj. Tek Mrizat, Tek Postblloku. Tek ura e Hotit. Syni i Virit. Vau i Bardhë. Në Rrethinë, Vau i Kashtës, Në baxhë të Kamicës, Tek Frashnat, Tek Kufiri Lolash. Tek Livadhi i Hajries, Në Plepa. Livadhi i Myrto Naçit, Në Lug të Dobraqit. Në Zabele, Tek Nandi. Tek Livadhi Krajanëve, Tek Livadhi me Tel, Në Voqe, në Lolashë, në Rroskë të Madhe, në Maje të Kasanit, Rrethe Toke e Madhe, Rrethe Toke e Vogël, Livadhi i Sakicës, Livadhi Nervoz. Te Vija e Gjetos, te Livadhi i Zymerit, te Hani, mbas Patokut, Vau qaporet, Vau i Trupit, Vau i Hotit. Vau i Briskut, Vau Bargaen, Vau Plak, Vau Tjhanas. Te ceka e dhive. Vija e Shabes, Vija Zits, Tek Vidhat, Vau Godojë. Mbas Bunkerit, Tek Shelqa e Hajro Dulit, Vau Boriç, Tek Gurët. Tek Mani i Krajanit, Ceka e Dobres, Vau Kuqisht. Tek Ranishta, Vau i Harapit, Vau i Topallit, Vija e Begut. Tek Shelqa e Gjatë. Tek Shtëpia e Kamices, Në Stërbeq, Në buzë të ujit, Tek Maja e Rrjollit, Astashiya, Qoshja e Kalldrunit, Prroj i Milloshit, prroj i Thatë, Prroj i Banushit. Në Kastrat, Tek Stavniku. Tek Shelqet. Në Bostane. Në Hundë, Tek Fiku, Tek Vaporri i Mbytn, Nën Shgoricë. Tek Burgu. Mbas Burgut, Në Prroje, Në Tunele. Tek Fiku i Rrumbullakët. Mbi Buzë të Gegës, Pesë Mandat, Vau i Bucit, Thellana. Nën Breshkaj, Këndi i Hasajve, Para Manit të Pusit, Tek Mani i Pusit. Brishkë. Vau i Shkozës. Livadhi i Haxhi Sabës. Livadhi i Qamil Begut. Livadhi i Alo Shkrelit. Në Shelqet e Gjata. Në Plimë, Vau i Madh, Në Rrugë të Fermës. Në Breg të Ranës, Tek Vau i Rrasës, Mbi Va Rras. Vija e Madhe. Vija e Vogël, Vija e Krapiçës. Vau i Ri, Bishti i Ri. Bishti i Vogël. Vau i Zaganjorëve, Vau i Gjatë. Te Shtegu, Vau i Rrumbullakët. Vau i Madh. Te Gorica e Vogël. Te Vija e Vjetër, Te Vija e Re. Në Cekë, Vau i Shkurtë. Tek Shelqa, Mbi Vaun e Vrakës, Tek Rruga, Tek Posta. Tek Grizha, Tek Valva, Tek Balona (avion i rrëzuar që në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare). Para Shtëpisë, Çekelmend. Tek Vija e Malazezëve. Cekan. Dobra, Tek Pylli i Bukur, Vija e Koplikut. Në Kalldrum. Tek Pompa. Para Kamicës, Në Kamicë, Shegan, Vau i Zefit. Në Hot. Tek Feneri i Lulashit, Tek Feneri i Muriqit, Rraxha e Bovave, në Bova, Tophallvë, Tek Feneri i Zaganjorëve, tek Mandi i Kublave, Bishti i Jugës.

Lumi Bunë

Në Dajlan, në Zus, Shogorcë, Tek Guri i Shenjonit, te Shkëmbi i Sukës, Manalug, Kapaxhan, Kanavel, Myseriq, Mbas Grykave të Dajlanit, Në Bezhdebir, Kurrina, Nën Shkëmbin e Sukës, Para Molës, Në Molë, Tek Bishti i Drinit, Tek Bishti i Thatë, Në Samrisht, Në Oblikë, Në Obot, Në Variq, Në Goricë, Në Sarreq, Në Muriqan, Tek Lisi në Vorr, Tek Trapi, Në Fushë të Bunës, Në Saqe, Tek Fiku, Vau i Bunës, Tek Ura e Bunës, Në Lamije, Në Pulaj, Në Vaun e Dajçit, Në Darragjat, Në Shirq, Në Mushan, Në Gramsh, Tek Suka e Dajçit, Samrishti i Sipërm, Samrishti i Poshtëm, Në Rrushkuj, Në Belaj, Në Pentar, Në Krroq, Në Luarëz, Në Reç, Preva, Kaçerr, Shelgjet e Kolë Gjokës, Tek Kroni, Te Gaviçi, Tek Spiranca, Tek Barka e Mbyton, Në Temele, Tek Gropa e Tjegullave, Tek Gropa e Canit, Bermal, Vau i Shegës, Nen Kala, Në Grykë të Bunës.

— Këneta e Murtepës

Këneta e Pendëtarit, Këneta e Becajve, Këneta e Domnit, Këneta e Shqerës, Këneta e Çasit, Këneta e Vilunit, Këneta e Çerdhe Plakut, Këneta e Bishtyalqibit me grykë të Plentuthit, Mbi Shpellë të Zorrës, Vija e Drinit, Tek Shën Pelegrini, Tek Kanali i Orizit, Tek Vija e Dajçit, Tek Penda, Vija e Murtepsës, Vija e Hamzit, Tek Guri i Pentarit, Në Picigete.

THE FISHING TRADITION IN THE WATER SYSTEM OF SHKODRA

Fishing was practised for many centuries in the city of Shkodra, along the shores of the lake and close to the Drin, Kir and Buna Rivers. Archaeological data and the ancient and mediaeval sources testify to ancient fishing traditions.

The authors of the present article, who have collected a rich material with regard to this craft, lay more stress on the primitive ways of fishing, beginning from the pointed stick to fishing in weirs.

Of interest are the detailed descriptions of the fishing means, the description of weirs, the work tools and sailing crafts of the fishermen, etc. The authors have described the weather forecast and the kinds of winds, the fishermen's customs, prejudices and rituals; they have collected the phraseology used by the fishermen and have shown the fishing places, etc.